



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS CIVILE**

“KONTRATA MARTESORE”

DISERTACION

***PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”***

**Kandidati:
MA. Eniana QARRI**

**Udhëheqësi shkencor:
Prof. Dr. Kudret ÇELA**

Tiranë, Dhjetor 2014

Mirënjohje

Realizimi i këtij punimi ka qenë një përpjekje e gjatë dhe e vështirë, finalizim i cili nuk do të kishte qenë i mundur pa mbështetjen e vazhdueshme, këshillat dhe sugjerimet e udhëheqësit shkencor, të profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë, kolegëve, miqve dhe familjarëve të mi.

Të gjithë tyre i detyrohem një mirënjohje të thellë!

Falenderimi i parë shkon për udhëheqësin shkencor të disertacionit, Prof. Dr. Kudret ÇELA, pa këshillat, vërejtjet, sugjerimet dhe inkurajimin e të cilit, ky punim nuk do të ishte finalizuar sot.

Një falenderim i thellë shkon për Max Planck Institute of Comparative and International Private Law, Hamburg (MPI), dhe për supervizoren time atje Dr. Christa Jessel-Holst, të cilët i dhanë një impuls të rëndësishëm veprimtarisë kërkimore dhe frymëzuan të gjithë punën time.

Mirënjohje e singertë shkon për Konrad Adenauer Stiftung, të cilët mbështetën financiarisht kërkimin shkencor në Bibliotekën e MPI.

I jam, gjithashtu, mirënjohëse profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës si dhe kolegëve të Departamentit të së Drejtës Civile.

Në fund, mbi të gjithë, i jam thellësisht mirënjohëse familjes sime, për besimin dhe mbështetjen e pakushtëzuar që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë për mua. Mbështetja e vazhdueshme shpirtërore, morale dhe financiare e prindërve, më ka dhënë forcën dhe motivimin e nevojshëm për të finalizuar këtë punim dhe për të ecur përpara në jetë. Pa ta asgjë nuk do të kishte qenë e mundur.

Janë ata, prindërit e mi, të cilëve ua dedikoj këtë punim!

Eniana Qarri,

Tiranë, Dhjetor 2014

TABELA E PËRMBAJTJES

Mirënjohje.....	ii
Tabela e Përmbajtjes.....	iii
Lista e Shkurtimeve.....	ix
Hyrje.....	x
I. Kuari ligjor dhe social-ekonomik i studimit.....	x
II. Pyetjet kërkimore dhe objektivat e punimit.....	xi
Metodologjia.....	xiii
Ekspoze e shkurtër e përmbajtjes së punimit.....	xv

KAPITULLI I

AUTONOMIA E VULLNETIT TË BASHKËSHORTËVE NË RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE PASURORE

1.1. Parimet bazë të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në legjislacionin aktual.....	1
1.2. Autonomia e vullnetit në fushën e marrëdhënieve pasurore.....	5
1.3. Instrumentet ligjorë të ushtrimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve: “kontrata” dhe “marrëveshja”.....	8
1.4. Regjimi pasuror martesor.....	13
1.5. Përcaktimi i regjimit pasuror martesor.....	16
1.5.1. Përcaktimi ligjor i regjimit pasuror.....	17
1.5.2. Përcaktimi vullnetar i regjimit pasuror.....	18
1.6. Kufizimet e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve.....	19
1.7. Regjimi pasuror primar si kufizim i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve.....	21
1.7.1. Raporti ndërmjet regjimit pasuror martesor primar dhe atij sekondar.....	21
1.7.2. Mbrojtja e vendbanimit familjar.....	23
1.7.2.1. Përcaktimi i vendbanimit të bashkëshortëve.....	23
1.7.2.2. Ndalimi i disponimit të banesës familjare.....	24
1.7.3. Kontributi material për nevojat e familjes.....	26
1.7.3.1. Kontributi material në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve.....	27
1.7.3.2. Kontributi material në marrëdhëniet e bashkëshortëve me kreditorët.....	28
1.7.4. Pavarësia e bashkëshortëve në marrëdhëniet ndërmjet tyre.....	30
1.7.4.1. Pavarësia profesionale e bashkëshortëve.....	30
1.7.4.2. Pavarësia në administrimin e sendeve vetjake.....	31
1.7.5. Administrimi i pasurisë në situatën e krizës së jetës familjare.....	32
1.7.5.1. Autorizimi gjyqësor në administrim.....	32
1.7.5.2. Përfaqësimi gjyqësor.....	34
1.7.5.3. Raporti ndërmjet dy dispozitave.....	35
1.7.5.4. Masat urgjente.....	36
1.7.5.5. Procedura gjyqësore.....	38

KAPITULLI II
KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI KONTRATËN MARTESORE
(HISTORIKU, KUPTIMI, NATYRA JURIDIKE, KLASIFIKIMI SHKENCOR
DHE FUNKSIONET TIPIKE)

2.1. Modelimi në kohë dhe hapësirë i regjimit pasuror dhe kontratës martesore.....	39
2.1.1. Shoqëria paraindustriale	40
2.1.2. Periudha pas Revolucionit Industrial	42
2.1.3. Shtetet Socialiste	43
2.2. Vështrim historiko-juridik mbi regjimin pasuror martesor në Shqipëri.....	43
2.2.1. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të vitit 1929.....	44
2.2.1.1. E drejta e Perandorisë Osmane.....	44
2.2.1.2. E drejta zakonore shqiptare	45
2.2.1.3. E drejta kanonike.....	47
2.2.2. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore në Kodin Civil të vitit 1929.....	48
2.2.2.1. Kontrata Martesore.....	48
2.2.2.2. Regjimi pasuror ligjor - Bashkëpasunimi midis bashkëshortëve	52
2.2.3. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore në periudhën 1945-1992.....	56
2.2.3.1. Ligji “ <i>Mbi Martesën</i> ” (1948) dhe Dekreti “ <i>Mbi pronësinë</i> ” (1955)	56
2.2.3.2. Kodi i Familjes i vitit 1965	58
2.2.3.3. Kodi Civil i vitit 1981	59
2.2.4. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore nga viti 1992 deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Familjes	60
2.3. Kuptimi i kontratës martesore	62
2.4. Natyra juridike dhe funksionet e kontratës martesore.....	64
2.5. Karakteristikat e kontratës martesore	67
2.6. Kontrata martesore dhe marrëveshje të tjera të bashkëshortëve	69
2.7. Liria kontraktore e bashkëshortëve. Kontrata martesore “ <i>atipike</i> ”.....	69
2.8. Të drejtat dhe detyrimet e pashmangshme si kufizime të lirisë kontraktore të bashkëshortëve	70
2.8.1. Kufizimet e përgjithshme të parashikuara në kod.fam.....	71
2.8.2. Kufizimet e posaçme për secilin regjim pasuror	74
2.9. Klasifikimi i kontratave martesore	76
2.10. Zbatimi i parimeve të Kodit Civil në kategorinë e kontratës martesore	77
2.11. Vështrim i krahasuar. Diversiteti i regjimeve pasurore dhe rregullimi i kontratës martesore në Europë.....	79
2.11.1. Klasifikimi i regjimeve pasurore në Europë	80
2.11.1.1. Regjimet e Bashkësisë.....	81
2.11.1.2. Regjimet Separatiste.....	82
2.11.1.3. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin ligjor “ <i>common law</i> ”- <i>Separation property with distribution by the competent authority</i>	83
2.11.2. Vështrim krahasues i kontratës martesore në Europë	84
2.11.3. Perspektiva Europiane. Drejt një harmonizimi të regjimeve pasurore në Europë?	85

KAPITULLI III

KUSHTET THELBËSORE TË VLEFSHMËRISË SË KONTRATËS MARTESORE, REGJISTRIMI, REVOKIMI DHE PAVLEFSHMËRIA E SAJ

3.1. Kushtet thelbësore të vlefshmërisë së kontratës martesore.....	89
3.2. Pëlqimi i bashkëshortëve.....	90
3.2.1. Bashkëshorti i mitur.....	92
3.2.2. Bashkëshortit të cilit i është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar.....	92
3.3. Objekti i kontratës martesore.....	95
3.4. Shkaku i kontratës martesore.....	97
3.5. Forma e kontratës martesore.....	98
3.6. Regjimi i publicitetit të kontratës martesore.....	99
3.6.1. Sistemi i regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë.....	99
3.6.2. Funksionet e regjistrimit të kontratës martesore.....	100
3.6.3. Disa probleme mbi regjistrimin e kontratës martesore.....	102
3.6.4. Praktika gjyqësore në lidhje me regjistrimin e kontratës martesore.....	106
3.7. Elementët rastësorë në përmbajtjen e kontratës martesore.....	109
3.8. Efektet e kontratës martesore ndaj palëve dhe të tretëve.....	110
3.8.1. Efektet që prodhon kontrata martesore.....	110
3.8.2. Momenti kohor i ardhjes së pasojave të kontratës martesore ndaj palëve dhe ndaj të tretëve.....	112
3.8.3. Praktika gjyqësore në lidhje me efektet prapavepruese të kontratës martesore.....	114
3.9. Ndryshimi dhe modifikimi i regjimit pasuror martesor.....	117
3.10. Rishikimi gjyqësor i kontratës martesore.....	120
3.11. Pavlefshmëria e kontratës martesore.....	122
3.11.1. Klasifikimi i pavlefshmërisë së kontratës martesore.....	122
3.11.2. Shkaqet e pavlefshmërisë së kontratës martesore.....	123
3.11.3. Pavlefshmëria e pjesshme e kontratës martesore.....	124
3.12. Zbatimi i padisë pauliane.....	125

KAPITULLI IV

REGJIMI I BASHKËSISË ME KONTRATË

4.1. Pluraliteti i regjimeve pasurore të rregulluara në Kodin e Familjes.....	128
4.2. Natyra juridike e regjimit të bashkësisë me kontratë.....	129
4.3. Konsiderata të përgjithshme mbi bashkësinë me kontratë.....	131
4.4. Zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore.....	133
4.4.1. Bashkësia e sendeve të luajtshme dhe fitimeve.....	133
4.4.1.1. Aktivi i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve.....	133
4.4.1.2. Pasivi i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve.....	134
4.4.2. Zgjerimi maksimal i objektit të bashkësisë - bashkësia universale.....	136
4.4.2.1. Aktivi i bashkësisë universale.....	137
4.4.2.2. Pasivi i bashkësisë universale.....	140
4.4.2.3. Dhurimet ndërmjet bashkëshortëve në regjimin e bashk. universale.....	141
4.5. Reduktimi i objektit të bashkësisë ligjore.....	142
4.5.1. Përfshirja nga bashkësia e sendeve të veçanta.....	144
4.6. Rregullat e administrimit dhe pjesët takuese.....	146
4.6.1. Rregullat e administrimit.....	146

4.6.2.	Administrimi i përbashkët i bashkësisë.....	147
4.6.3.	Pjesët takuese në bashkësi.....	149
4.7.	Bashkësia me kontratë si regjim pasuror autonom.....	150
4.8.	Transferimi, ndërmjet bashkëshortëve, i pronësisë së sendeve të veçanta gjatë martesës.....	151
4.8.1.	Kalimi i pronësisë së sendit nga pasuria vetjake e njërit bashkëshort në bashkësi.....	153
4.8.2.	Kalimi i pronësisë së sendit nga bashkësia në pasurinë vetjake të njërit bashkëshort.....	154
4.9.	Mbarimi i bashkësisë me kontratë.....	154
4.9.1.	Rastet e mbarimit të bashkësisë me kontratë.....	154
4.9.2.	Mbarimi i pjesëshëm i bashkësisë me kontratë.....	156
4.9.3.	Pasojat e mbarimit të regjimit të bashkësisë me kontratë.....	157
4.10.	Pjesëtimi i pasurisë së bashkësisë me kontratë.....	158

KAPITULLI V

REGJIMI I PASURIVE TË NDARA

5.1.	Natyra juridike, karakteristikat dhe burimet e krijimit të regjimit të pasurive të ndara.....	162
5.1.1.	Natyra juridike.....	162
5.1.2.	Karakteristikat e regjimit të pasurive të ndara.....	164
5.2.	Burimet e krijimit të regjimit të pasurive të ndara.....	165
5.2.1.	Regjimi i pasurive të ndara si regjim kontraktor.....	166
5.2.2.	Regjimi i pasurive të ndara, si regjim ligjor i detyrueshëm.....	166
5.2.3.	Mundësia e zbatimit të regjimit të pasurive të ndara në rastin e shpalljes së zhdukur të njërit bashkëshort.....	167
5.3.	Pjesëtimi gjyqësor i pasurisë së bashkësisë.....	167
5.3.1.	Shkaqet e pjesëtimit gjyqësor të pasurisë.....	168
5.3.2.	Padia e pjesëtimit të pasurisë: legjitimiteti, gjykata kompetente dhe gjykimi i padisë.....	170
5.3.3.	Pasojat e pjesëtimit të pasurisë.....	173
5.4.	Struktura e regjimit të pasurive të ndara.....	175
5.4.1.	Aktivi i pasurisë së bashkëshortëve.....	176
5.4.2.	Pasivi i pasurisë së bashkëshortëve (detyrimet).....	179
5.5.	Kufijtë e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara.....	181
5.6.	Administrimi i pasurisë nën regjimin e pasurive të ndara.....	183
5.6.1.	Konsiderata të përgjithshme.....	183
5.6.2.	Administrimi i pasurisë vetjake të njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër.....	185
5.6.2.1.	Administrimi bazuar në ekzistencën e një mandati.....	185
5.6.2.2.	Administrimi në mungesë të një mandati.....	189
5.7.	Avantazhet dhe disavantazhet e regjimit të pasurive të ndara.....	190
5.8.	Prova e pronësisë së pasurisë së luajtshme.....	192
5.8.1.	Konsiderata të përgjithshme.....	192
5.8.2.	Prezumimet ligjore të pronësisë.....	194
5.8.3.	Shmangia e prezumimeve të pronësisë.....	195
5.9.	Mbarimi i regjimit të pasurive të ndara.....	196

5.9.1. Hipotezat e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara	196
5.9.2. Pasojat e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara	197
5.10. Likuidimi i regjimit të pasurive të ndara.....	198
5.10.1. Domosdoshmëria dhe karakteristikat e likuidimit	198
5.10.2. Detyrimet ndërmjet bashkëshortëve.....	199
5.10.3. Pjesëtimi i sendeve në bashkëpronësi	201

KAPITULLI VI

AUTONOMIA E VULLNETIT NË ZGJEDHJEN E LIGJIT TË ZBATUESHËM DHE KONTRATA MARTESORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE

6.1. Martesa me elementë të huaj	203
6.1.1. Problemet që shtrohen për diskutim.....	204
6.2. Vështrim krahasues ndërmjet ligjit të ri DNP dhe legjislacionit të mëparshëm. Risitë e ligjit të ri DNP.	206
6.3. Ligji i zbatueshëm mbi pasojat e martesës.....	207
6.4. Parimet e unitetit të ligjit të zbatueshëm dhe autonomisë së vullnetit, në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor	209
6.4.1. Lidhja ndërmjet autonomisë materiale të vullnetit dhe autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm.....	209
6.4.2. Autonomia e vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm	209
6.4.3. Natyra juridike e autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm	213
6.4.4. Avantazhet e parimit të autonomisë së vullnetit në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm.....	214
6.4.5. Problemet që sjell zbatimi i parimit të autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm dhe parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm	214
6.4.6. Raporti ndërmjet nenit 24.2 dhe nenit 36.1 të ligjit DNP	216
6.4.7. Kufizimet e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm.....	217
6.5. Përcaktimi me marrëveshje i ligjit të zbatueshëm.....	221
6.6. Marrëveshja e bashkëshortëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm “ <i>Pactum de lege utenda</i> ”	225
6.6.1. Natyra juridike e “ <i>pactum de lege utenda</i> ”	225
6.6.2. Kushtet thelbësore dhe karakteristikat e <i>pactum de lege utenda</i>	227
6.6.2.1. Pëlqimi i palëve (shprehja e vullnetit).....	228
6.6.2.2. Objekti i marrëveshjes.....	229
6.6.2.3. Shkaku.....	234
6.6.2.4. Forma	234
6.7. Kontrata martesore në të drejtën ndërkombëtare private	236
6.7.1. Ligji i zbatueshëm mbi kushtet e vlefshmërisë së kontratës martesore	236
6.7.2. Regjistrimi i kontratës martesore	240
6.7.3. Njohja në RSH e kontratës martesore të lidhur jashtë territorit të saj.....	240
6.8. Ndryshimi i regjimit pasuror dhe domosdoshmëria e mbrojtjes së të tretëve	242
6.8.1. Ndryshimi konfliktual vullnetar	243
6.8.2. Ndryshimi material vullnetar	243
6.8.3. Ndryshimi konfliktual automatik	244
6.8.4. Ndryshimi material ligjor	246

6.9. Mbarimi dhe likuidimi i regjimit pasuror martesor	247
6.9.1. Rastet e mbarimit të regjimit pasuror martesor.....	247
6.9.2. Likuidimi dhe pjesëtimi i regjimit pasuror martesor	249
6.10. Regjimet pasurore dhe kontrata martesore në aktet ndërkombëtare dhe europiane në planin e së drejtës ndërkombëtare private	250
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	256
BIBLIOGRAFIA	276
<i>Abstrakt</i>	294

Lista e Shkurtimeve

ABGB	Kodi Civil Austriak
BGB	Kodi Civil Gjerman
CCB	Kodi Civil Belg
CCE	Kodi Civil Spanjoll
CCF	Kodi Civil Francez
CCI	Kodi Civil Italian
CCS	Kodi Civil Zvicerian
CEFL	Commission on European Family Law
DNP	Ligji “Për të drejtën ndërkombëtare private”
Ed.	Botues (Editor)
Eds.	Botuesit (Editors)
Et seq.	Dhe në vazhdim
Fq.	Faqe
Ibid.	Ibidem
Id.	Idem
Kod. fam.	Kodi i Familjes
Kod.civ.	Kodi Civil
Kod.proc.civ.	Kodi i Procedurës Civile
LGjC	Ligji “Për gjendjen civile”
Nr.	Numër
Op. cit.	Opera citato
Vol.	Vëllimi

HYRJE

*“Zoti ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën të mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë!
Falna durimin ta thellojmë një punë përpara se të shkruajmë përmbi të,
frymëziona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjubës dhe nga lajthimet e shtypit.”*

Faik Konica

I. Kuadri ligjor dhe social-ekonomik i studimit

Punimi është realizuar në kuadrin e reformës së thellë që ka pësuar e drejta familjare në këto 10 vitet e fundit, me një fokus të veçantë në institutin e regjimit pasuror martesor. Kodi i ri i Familjes, i vitit 2003, njeh për herë të parë, që prej Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare, të vitit 1929, një shkallë të gjerë të autonomisë kontraktore të bashkëshortëve, duke i njohur atyre të drejtën për të vetërregulluar interesat pasurorë të familjes. Kë këtë kuadër, kod.fam. ka parashikuar një instrument ligjor, nëpërmjet së cilit bashkëshortët mund të ushtrojnë autonominë e njohur nga ligji, instrumentin e kontratës martesore.

Për të kuptuar më mirë qëllimin e reformës ligjore duhet të ndalemi fillimisht në korrelacionin që ekziston ndërmjet ligjit dhe realitetit ekonomiko-social të shoqërisë. Është e vërtetë që midis realitetit ligjor dhe atij ekonomiko-social ekziston një dialektikë e tillë, ka raste kur faktet (zhvillimet social-ekonomike) i paraprijnë zhvillimeve ligjore dhe mund të pohojmë që ky është rasti më i zakonshëm; por në raste të tjera ndodh e kundërta, është ligji që i paraprin ndryshimeve social-ekonomike, madje bëhet faktor për realizimin e këtyre ndryshimeve¹.

Ajo që ka bërë ligjvënësi në vitin 2003 ka qenë pikërisht reflektimi i ndryshimeve ekonomiko-sociale të shoqërisë shqiptare, në legjislacionin e ri familjar (kod.fam. i vitit 2003). Ndryshimet në strukturën ekonomiko-sociale të shoqërisë shqiptare të pas viteve 1990 sollën domosdoshmërinë e një reforme të thellë e të gjithanshme të legjislacionit civil, në përgjithësi, dhe të atij familjar, në veçanti. Normat e Kodit Civil të vitit 1981, që kanë rregulluar marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve, deri në hyrjen në fuqi të Kodit aktual të Familjes, ishin të vjetruara dhe nuk i përgjigjeshin nevojave të shoqërisë dhe familjes së re shqiptare. Bashkësia “*quasi universale*” e parashikuar në Kodin Civil të vitit 1981, përfaqësonte një regjim të papërshtatshëm me zhvillimet e marrëdhënieve të pronësisë në Shqipërinë e pas viteve 90'. Rregullimi ligjor i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve nga kod.civ. i vitit 1981, pas viteve 90' u kthye në një model anakronist, për shkak të ndryshimit rrënjësor të marrëdhënieve ekonomike, shoqërore, morale dhe politike të shoqërisë shqiptare.

Pikërisht ky është roli i shkencës të së drejtës, ai i studimit të ekuilibrave ndërmjet zhvillimeve ekonomiko-shoqërore dhe ligjit si dhe ai i interpretimit të ligjin në funksion të këtyre ndryshimeve².

Puna interpretuese e normave ligjore, konkretisht në këtë punim, e atyre që rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet anëtarëve të familjes, është e vështirë për shkak të paqartësisë ligjore, paqartësi e cila nuk i referohet vetëm aspektit stilistik dhe atij të teknikës legjislative, por vështirësia interpretuese i referohet kryesisht mungesës së koordinimit të dispozitave të Kodit të Familjes që, rregullojnë marrëdhëniet pasurore me njëra-tjetrën, në disa raste dhe në të tjera

¹ Falzea, Angelo. “Il dovere di contribuzione nel regime patrimoniale della famiglia.” në *Rivista di Diritto Civile*, I, Padova: CEDAM, 1997, fq. 609.

² Falzea, “Il dovere di contribuzione nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 610.

raste, me disiplinën e përgjithshme ligjore të marrëdhënieve pasurore, të rregulluar nga Kodi Civil. Mungesa e koordinimit vjen edhe për shkak të modelit të ndjekur nga ligjvënësi shqiptar në hartimin e Kodit të Familjes. Kujtojmë këtu që marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve janë rregulluar sipas modelit të reformës së Kodit Civil Francez të vitit 1965 dhe 1985 dhe reformës së Kodit Civil Italian të vitit 1975, modeli i cili, ka ndjekur atë francez.

Në këto kushte për shkencën juridike paraqitet i nevojshëm studimi i doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore të këtyre shteteve, me qëllim interpretimin e legjislacionit tonë rregullues të marrëdhënieve familjare dhe identifikimin e problemeve praktike që mund të lindin në të ardhmen dhe ofrimin të opsioneve të mundshme për zgjidhjen e tyre.

Analizën e institutit të regjimit pasuror martesor do të fillojmë me identifikimin e interesave që ligjvënësi ka njohur dhe marrë në mbrojtje, të cilat janë a) interesi i familjes dhe b) interesi i bashkëshortëve dhe c) interesi i personave të tretë, të cilët hyjnë në marrëdhënie pasurore me anëtarët e familjes³.

Si çdo punim tjetër, i këtij lloji, prezantimi i temës, objektivave dhe problematikave kryesore, fillon gjithmonë me ‘justifikimin’ e arsyeve që kanë çuar në përzgjedhjen e temës së marrë në studim.

Arsyeja e parë, e cila ka shërbyer si pikënisje në zgjedhjen e trajtimit të institutit të kontratës martesore, pa dyshim ka qenë dëshira dhe nevoja për të sjellë një kontribut sado modest në doktrinën juridike, në trajtimin e një instituti të ri për të drejtën private dhe familjare në Shqipëri. Kontrata martesore është ripërfshirë në legjislacionin shqiptar në kod.fam të vitit 2003, pas një mungese të gjatë, që nga kod. civ. i vitit 1929. Për një periudhë 60 vjeçare marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë rregulluar nga regjimi ligjor i bashkëpronësisë së detyrueshme, pa i dhënë mundësi bashkëshortëve të rregullojnë regjimin pasuror, sipas interesave të tyre dhe të familjes.

Nga ana tjetër, arsyeja e përzgjedhjes së temës së mësipërme është karakteri ndërdisiplinor i institutit të kontratës martesore dhe domosdoshmëria e trajtimit të tij jo vetëm në kuadrin e së drejtës familjare, por njëkohësisht analiza e ndërthurjes së tij me konceptet e veprimit juridik, kontratës, pronësisë e mënyrave të fitimit të saj si dhe bashkëpronësisë. Karakteri ndërdisiplinor dhe ndërthurja e instituteve të mësipërme përfaqëson njëkohësisht edhe sfidën kryesore të këtij punimi.

II. Pyetjet kërkimore dhe objektivat e punimit

Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve do të studiohet në dy profile të rëndësishme, të cilat janë të ndërthurur njëri me tjetrin, me qëllim ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave që ligjvënësi ka njohur dhe marrë në mbrojtje, të cilat janë: a) interesi i familjes b) interesi i bashkëshortëve dhe c) interesi i personave të tretë, të cilët hyjnë në marrëdhënie pasurore me anëtarët e familjes:

a) Regjimi primar i familjes (*régime primaire*), i cili përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e karakterit pasuror, ku përfshihen: kontributi material i bashkëshortëve për interesat e familjes, mbrojtja e banesës bashkëshortore dhe përgjegjësia solidare për detyrimet që rrjedhin nga martesja, të cilat janë të zbatueshme pavarësisht nga regjimi pasuror martesor dhe kanë për qëllim ruajtjen e një solidariteti minimal ndërmjet bashkëshortëve;

b) Regjimi pasuror martesor (*régime secondaire*) dhe kontrata martesore;

Megjithëse në kod.fam. nuk gjendet një normë e posaçme që të parashikojë shprehimisht parimin e autonomisë private të bashkëshortëve, ligjvënësi ka rregulluar format, nëpërmjet të cilave shprehet kjo autonomi.

Në këtë punim është marrë përsipër analiza dhe paraqitja e zgjidhjeve të mundshme që sugjeron doktrina dhe që ka përpunuar praktika gjyqësore e vendeve të tjera, të problemeve të mëposhtme:

³ Falzea, “Il dovere di contribuzione nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 610-611.

1. Zbatimi i parimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore (regjimi pasuror martesor);
2. Kufijtë e parimit të autonomisë së vullnetit dhe lirisë kontraktore në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve, identifikimin e kufijve të këtij parimi, kufij të cilët rregullohen në plan të dyfishtë, në Kodin Civil dhe në Kodin e Familjes;
3. Studimi i mundësisë së zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës civile si dhe të rregullave të përgjithshme të kod.civ. të veprimit juridik, pavlefshmërisë së veprimit juridik, kontratave dhe detyrimeve mbi institutin e kontratës martesore si dhe studimin e raportit që qëndron ndërmjet normave të përgjithshëm të së drejtës civile me normat e posaçme të së drejtës familjare (studimi i mundësisë dhe kufijve të zbatimit të normave kontraktore të Kodit Civil mbi marrëdhëniet kontraktore të bashkëshortëve).
4. Analiza e natyrës juridike, funksioneve, karakteristikave, kushteve të vlefshmërisë së kontratës martesore;
5. Analiza e regjimeve pasurore kontraktore të rregulluar në dispozitat e kod.fam. si dhe mundësia e zgjedhjes së regjimeve pasurore atipike, që nuk gjejnë rregullim të shprehur në ligj;
6. Studimi i lirisë kontraktore të bashkëshortëve për të vetërregulluar pasojat e zgjedhjes së martesës, kryesisht pasojat pasurore, jo vetëm nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura pasi bashkëshortët kanë marrë vendimin e zgjedhjes së martesës, por edhe nëpërmjet marrëveshjeve preventive, të cilat mund të lidhen “pre” ose “ante nuptial.
7. Studimi i risive që ka sjellë ligji për të drejtën ndërkombëtare mbi zgjerimin e autonomisë së bashkëshortëve, në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të tyre, në rastet e martesave me elementë të huaj;
8. Së fundi, krahasimi i modeleve të ndryshme europiane dhe më gjerë, në fushën e regjimit pasuror martesor, në funksion të kuptimit të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet sistemeve të ndryshme ligjore në këtë fushë.

METODOLOGJIA

Objektivat kryesorë të këtij punimi, ashtu siç e kemi përmendur dhe më sipër, janë hulumtimi i kufijve të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore dhe hulumtimi i mundësisë së zbatimit të normave të përgjithshme të kod.fam. mbi kontratën martesore dhe më tej, hetimi i mënyrës se koordinimit të rregullave të përgjithshme të kod.civ mbi kontratën dhe veprimin juridik me ato specifike të kod.fam. mbi kontratën martesore dhe regjimet pasurore martesore.

Çdo hulumtim serioz kërkon, së pari përcaktimin e metodologjisë që do të përdoret për realizimin e tij dhe për nxjerrjen e përfundimeve. Metoda e studimit lidhet ngushtësisht me fushën e zgjedhur për studim, pasi metoda mbi të gjitha duhet t'i përshtatet fushës së studimit dhe rezultateve që kërkohen të arrihen⁴.

Duke qenë se, objektivi i këtij punimi është studimi i kontratës martesore dhe të zbatimit të rregullave të përgjithshme të kontratës dhe veprimit juridike mbi kontratën martesore, atëherë është e kuptueshme që ky hulumtim do të shtrihet në dispozitat e kod.civ dhe kod.fam, në hetimin e mënyrës së koordinimit të tyre dhe të raportit që ekziston ndërmjet tyre në lidhje me kontratën martesore dhe regjimin pasuror martesor. Gjithashtu, në kuadër të dispozitave të kod.fam do të analizohet raporti ndërmjet regjimeve pasurore kontraktore dhe regjimit ligjor të bashkësisë, i cili gjen zbatim vetëm në mungesë të rregullimit kontraktor të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, metodologjia e përdorur për realizimin e këtij punimi, prezantohet si më poshtë.

Kërkimi doktrinar (mbledhja dhe përpunimi i literaturës). Ky hap konsiston në rishikimin e literaturës në lidhje me objektin e studimit. Ai përfshin identifikimin, mbledhjen dhe sistemimin e librave, monografive, artikujve shkencorë, kumtesave të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën ligjore. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër relativisht të konsiderueshëm autorësh të huaj si edhe disa autorë vendas. Në këtë drejtim, një ndihmë të madhe ka dhënë kërkimi shkencor i realizuar në Bibliotekën e Institutit të së Drejtës së Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private (MPI), Hamburg, Gjermani. Biblioteka e MPI mundësoi konsultimin e një literature të gjerë, në kuadrin europian dhe ndërkombëtar, në fushën e regjimeve pasurore martesore dhe kontratës martesore. Gjithashtu, kërkimi shkencor është shtrirë në analizën e literaturës shqiptare të fushës.

Për realizimin e citimeve gjatë punimit dhe për hartimin e Bibliografisë është përdorur stili Chicago Manual Style, Fifth Edition.

Analiza e legjislacionit. Në realizimin me sukses të objektivave të caktuara në këtë studim jemi mbështetur në metodën e analizës dhe sintezës. Kjo metodë konsiston në formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Në sistemin tonë juridik, normat ligjore gjenden në kode, ligje dhe akte të tjera. Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Gjithashtu, kjo metodë shërben për të sqaruar paqartësinë e normave, vendosjen e tyre në një rend logjik dhe koherent dhe për të analizuar ndërveprimin e tyre më të tjera norma. Veçanërisht e rëndësishme në këtë punim, ka qenë analiza e kombinuar e normave të Kodit të Familjes dhe atyre të Kodit të Familjes, me

⁴ Russo Ennio. "L'oggetto della comunione legale, Artt. 177-179." në *Il Codice Civile. Commentario*, P. Schlesinger, Milano: Giuffrè Editore, 1999, fq. 8.

qëllim hetimin e mundësisë dhe kufijve të zbatimit të normave të Kodit Civil të kontratës dhe veprimin juridik mbi kontratën martesore.

Kërkimi ndërdisiplinor. Procesit të interpretimit dhe analizës së legjislacionit, kryesisht në rastet e paqartësisë së normave, i vijnë në ndihmë faktorë të tjerë të jashtëm si analizimi i aspektit historik, kontekstit social dhe atij ekonomik. Konkretisht në punim është analizuar historiku i rregullimit ligjor të marrëdhënieve pasurore në Shqipëri dhe në Europë, bazuar në kontekstin ekonomiko-social të secilës periudhë historike.

Metoda krahasuese. Pavarësisht se studimi nuk realizohet në kuadrin e së drejtës së krahasuar, për një kuptim dhe interpretim më të mirë të normave të brendshme ligjore është menduar realizimi i analizës krahasuese ndërmjet Kodit të Familjes dhe legjislacioneve të atyre vendeve (legjislacioni Italian, Francez e më gjerë), që kanë shërbyer si model për hartimin e Kodit të Familjes së RSH. Nëpërmjet këtij krahasimi kërkohet të evidentohet shkalla e përqasjes të tyre. Studimit në planin krahasues, të kontratës martesore dhe regjimeve pasurore, i ka ardhur në ndihmë literatura e pasur e Bibliotekës së MPI-së. Studimi krahasues, në këtë punim ka pasur si qëllim arritjen e një interpretimi më të mirë të normave të Kodit të Familjes, nëpërmjet sjelljes së mënyrës së interpretimit të këtyre normave nga mendimi doktrinal me në zë europian.

Metoda e analizës së praktikës gjyqësore është gjithashtu një metodë mjaft e rëndësishme, e cila shërben për të parë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit praktik që gjykatat shqiptare dhe ato të huaja i kanë bërë kontratës martesore. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh faktin që praktika gjyqësore shqiptare, në fushën e kontratës martesore është akoma shumë e varfër (janë arritur të gjenden shumë pak vendime), janë analizuar vendime të gjykatave të huaja, si të Gjykatës Italiane të Kasacionit, Gjykatës Franceze të Kasacionit, Gjykatës Kushtetuese Gjermane, Spanjolle, Gjykatës Supreme Angleze etj. Analiza e praktikës së gjykatave të huaja shërben për të parë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit praktik që i është bërë kontratës martesore nga këto gjykata, në funksion të një kuptimi më të mirë të dispozitave të kod.fam, nga gjykatat shqiptare.

Metoda sasiore. Gjatë punimit është janë pasqyruar të dhëna statistikore të kontratës martesore në disa vende Europiane. Këto të dhëna dëshmojnë për një rritje, vit pas viti, të numrit të kontratave martesore në vende të ndryshme europiane. Duke qenë se në Shqipëri nuk është realizuar asnjë studim statistikor i kontratës martesore, në punim mungojnë të dhënat statistikore për Shqipërinë, çka përbën një ndër kufizimet e këtij punimi.

EKSPOZE E SHKURTËR E PËRMBAJTJES SË PUNIMIT

Në kapitullin e parë, të emërtuar “*Autonomia e vullnetit të në rregullimin e marrëdhënieve pasurore*” është marrë në analizë parimi i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e regjimit pasuror martesor. Parimi i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve është studiuar në disa plane: në planin e rregullimit të marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve; në planin e rregullimit të marrëdhënieve personale jopasurore si dhe në planin e rregullimit preventiv (paraprak) të pasojave të zgjidhjes së martesës. Gjithashtu, në këtë punim janë trajtuar të drejtat dhe detyrimet e pashmangshme (paderogueshme) si kufizim i autonomisë private të bashkëshortëve.

Punimi mbyllet me analizimin e regjimit primar të familjes, të atyre të drejtave dhe detyrimeve të karakterit pasuror, të cilat janë të zbatueshme pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve dhe janë të pashmangshme me marrëveshje ndërmjet tyre.

Në këtë pjesë të punimit kemi arritur në disa përfundime të rëndësishme, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e parimit të autonomisë së vullnetit, në fushën e regjimit pasuror martesor.

Së pari, nën dritën e kodit të ri të fam. është e pamohueshme që, parimi i autonomisë së vullnetit është njohur edhe në kuadrin e marrëdhënies martesore, veçanërisht në kuadër të regjimit pasuror martesor, marrëdhënie të cilat, tradicionalisht në të shkuarën, kanë qenë përjashtuar nga fusha e veprimit të autonomisë së vullnetit. Megjithatë, për shkak të rëndësisë shoqërore të familjes dhe me qëllim ekuilibrimin e interesave të bashkëshortëve me interesin publik, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve, në rregullimin e regjimit pasuror martesor, është më e kufizuar në raport me atë të marrëdhënies të tjera kontraktore, nëpërmjet tërësisë së normave të pashmangshme, të njohura nën termin e “*regjimit primar*”.

Së dyti, nga analiza e realizuar mbi regjimin primar të familjes, është e pamohueshme që, ekzistojnë hapësira për autonominë private të bashkëshortëve edhe në kuadër të vetë regjimit primar.

Së treti, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënies të tyre pasurore është njohur, së fundi me miratimin e ligjit të ri DNP, edhe në kuadër të martesës me elementë të huaj, në drejtim të mundësisë së zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, ndërmjet kritereve alternative të lidhjes së ofruara nga ligjit (neni 24.2 i ligjit DNP).

Kapitulli i dytë, i titulluar “*Konsiderata të përgjithshme mbi kontratën martesore (kuptimi, natyra juridike, klasifikimi shkencor dhe funksionet)*” trajton disa elementë të përgjithshëm të kontratës martesore, në këndvështrimin krahasues me legjislacionin Italian, atë Francez si dhe legjislacionin e disa shteteve Europiane. Kjo pjesë e dytë e punimit analizon kuptimin, karakteristikat dhe natyrën juridike të kontratës martesore. Vëmendje i është kushtuar klasifikimit të kontratave martesore dhe analizës së kontratave martesore “*atipike*”. Puna studimore është përqendruar edhe në analizën e kufizimeve të përgjithshme dhe atyre specifike, të cilave i nënshtrohet liria kontraktore e bashkëshortëve.

Në këtë pjesë të punimit janë arritur disa përfundime. Është e kuptueshme që për të dhënë karakteristikat e një instituti juridik, së pari duhet të realizohet klasifikimi shkencor i institutit në një kategori të caktuar dhe më pas evidentimi i atyre karakteristikave të kategorisë, që i korrespondojnë institutit në fjalë. Padyshim që, në përpjekjen për të analizuar karakteristikat e kontratës martesore si kontratë civile, kemi mbajtur parasysht rezervat e shprehura në punim mbi natyrën juridike të saj. Kontrata martesor ka karakter “*statutor*”, “*rregullues*”, apo “*programatik*”, në një farë kuptimi ajo përfaqëson një statut për marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Në doktrinën juridike të shekujve të kaluar ajo emërtohej ndryshe si “*pakti i*

familjes". Ashtu siç do të shikojmë gjatë këtij punimi, kontrata martesore nuk sjell të drejta dhe detyrime për palët, në ndryshim nga kontratat e tjera që parashikon kod.civ. Ky është aspekti më origjinal i kontratës martesore.

Në kapitullin e tretë, të titulluar "*Kushtet thelbësore të vlefshmërisë së kontratës martesore, regjistrimi, revokimi dhe pavlefshmëria e saj*", janë marrë në analizë kushtet thelbësore të kontratës martesore, dallimi nga kontratat civile dhe mundësia e zbatimit të normave të Kodit Civil në rregullimin e kontratës martesore. Kushtet e vlefshmërisë së kontratës martesore janë analizuar në përputhje me nenin 663 të Kodit Civil, që rregullon konditat e nevojshme për lidhjen e kontratës, të tilla si: pëlqimi i palëve, objekti, shkaku dhe forma. Gjithashtu, në këtë kapitull është studiuar regjimi juridik i regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë (regjistrimi) dhe funksionet që ka regjistrimi i kontratës për bashkëshortët dhe për të tretët. Në përfundim të kapitullit është studiuar pavlefshmëria e kontratës martesore, pasojat e pavlefshmërisë dhe zbatimi i padisë së kundërshtimit të veprimeve juridike të debitorit, në kontratën martesore.

Në këtë pjesë të punimit është studiuar mundësia e zbatimit të disiplinës së përgjithshme të veprimit juridik dhe kontratës në rregullimin e kontratës martesore. Megjithëse kontrata martesore bën pjesë në kategorinë e kontratës, si veprim juridik i dyanshëm, në rregullimin e saj do të gjejë zbatim, në radhë të parë, disiplina ligjore e parashikuar në dispozitat e Kodit të Familjes, si ligji i posaçëm dhe vetëm për ato elementë të cilat nuk gjejnë rregullim në Kodin e Familjes, do të gjejë zbatim disiplina e parashikuar në Kodin Civil, sipas parimit "*lex specialis derogant generalibus*". Në çdo rast të kontradiktës ndërmjet normave ligjore të sipërpërmendura, do të gjejnë zbatim normat e Kodit të Familjes, si legjislacioni i posaçëm, që rregullon kategorinë e kontratës martesore.

Në kreun e katërt dhe të pestë të punimit janë trajtuar regjimet pasurore kontraktore, të cilat gjejnë rregullim të shprehur në dispozitat e Kodit të Familjes.

Në Kapitullin e katërt është trajtuar regjimi i bashkësisë me kontratë, i titulluar "*Regjimi i bashkësisë me kontratë*". Në këtë kapitull është analizuar natyra juridike e regjimit të bashkësisë me kontratë dhe përmbajtja e këtij regjimi, në drejtim të zgjerimit të objektit (zgjerimi maksimal i objektit të bashkësisë ligjore: bashkësia universale) si dhe ngushtimi i objektit të bashkësisë me kontratë. Gjithashtu, punimi analizon të drejtën e bashkëshortëve për ndryshimin e rregullave të administrimit të pasurisë objekt i bashkësisë, si dhe të drejtën e ndryshimit të pjesëve takuese. Në përfundim të kapitullit janë trajtuar rastet e mbarimit të bashkësisë me kontratë, mundësia e zbatimit të nenit 96 të Kodit të Familjes në mbarimin e këtij regjimi dhe pjesëtimi i pasurisë së krijuar gjatë regjimit të bashkësisë me kontratë.

Duke përfshirë të gjitha analizat e realizuara më sipër, mund të përkufizojmë "*bashkësinë me kontratë*" si regjimi pasuror, në të cilin përfshihen të gjitha ato rregullime, me të cilat bashkëshortët, në kuadrin e autonomisë së tyre private, por gjithmonë brenda limiteve të normave të pashmangshme ligjore, rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre, sipas nevojave të tyre specifike, duke modifikuar aspekte të caktuara të regjimit të bashkësisë ligjore.

Në kapitullin e pestë të punimit është trajtuar regjimi i dytë pasuror martesor, i cili gjen rregullim në Kodin e Familjes, regjimi i pasurive të ndara. Ky kapitull, i titulluar "*Regjimi i pasurive të ndara*", analizon natyrën juridike dhe karakteristikat e regjimit të pasurive të ndara. Gjatë punimit analizohen burimet e krijimit të regjimit të pasurive të ndara, duke u ndalur më në hollësi në hipotezën e zbatimit të regjimit të pasurive të ndara si pasojë e pjesëtimit të pasurisë së bashkësisë, bazuar në nenin 98 të Kodit të Familjes. Gjithashtu, është analizuar në detaje

struktura e regjimit të pasurive të ndara, aktivi dhe pasivi i këtij regjimi. Në pjesën e fundit të kapitullit, ka gjetur trajtim mbarimi dhe likuidimi i regjimit të pasurive të ndara, si dhe prova e pronësisë së sendeve të luajtshme.

Regjimi i pasurive të ndara është cilësuar si regjimi pasuror më i përshtatshëm për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtresave ekonomike të mesme dhe të larta të shoqërisë, të cilat kanë pasuri të konsiderueshme, sepse ky regjim përmban një rregullim më elastik (fleksibël) të marrëdhënieve pasurore.

Në kapitullin e gjashtë të punimit është marrë në analizë instituti i regjimit pasuror martesor në një tjetër dimension, në atë të së drejtës ndërkombëtare private. Ky kapitull i titulluar “*Autonomia e vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm. Kontrata martesore në të drejtën ndërkombëtare private*” analizon marrëveshjen e bashkëshortëve me objekt zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore. Ky kapitull është konceptuar në kuadër të reformës së vitit 2011 të së Drejtës Ndërkombëtare Private në Shqipëri. Në ndryshim nga ligji i vitit 1964, ligji aktual “Për të drejtën ndërkombëtare private” njeh autonominë e vullnetit të bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, në fushën e regjimit pasuror martesor, megjithëse një autonomi e kufizuar. Gjithashtu, në këtë kapitull analizohet ligji i zbatueshëm mbi kontratën martesore dhe elementët e vlefshmërisë së saj si dhe njohja në Republikën e Shqipërisë të kontratave martesore të lidhura jashtë saj.

Parimi i autonomisë konfliktuale të vullnetit që, në dekadat e kaluara ka njohur një zbatim të gjerë në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm në legjislacionet ndërkombëtare private të shumë shteteve europiane si dhe në konventat ndërkombëtare ashtu dhe në Rregulloret e Bashkimit Europian, në ditët e sotme po fiton një njohje të gjerë si kriter lidhje në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare familjare dhe veçanërisht në regjimin pasuror martesor. Këtë e dëshmon njohja e këtij parimi si në legjislacionet e së drejtës ndërkombëtare private të shteteve europiane, ashtu edhe në aktet ndërkombëtare, mjafton të kujtojmë edhe një herë këtu Konventën e Hagës së vitit 1978 si dhe në legjislacionin e BE-së, konkretisht Projekt-Rregulloren e vitit 2011.

Në mbyllje të këtij punimi, me modesti dhe me shpresën që ky punim do të sjellë sado pak vlera në fushën e shkencës së të drejtës familjare, në Shqipëri, janë pasqyruar ***përfundimet dhe rekomandimet*** në lidhje me çështjet e trajtuara, si dhe janë paraqitur disa sugjerime modeste për boshllëqet apo paqartësitë e legjislacionit në lidhje me situata të caktuara.

KAPITULLI I

AUTONOMIA E VULLNETIT TË BASHKËSHORTËVE NË RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE PASURORE

1.1. Parimet bazë të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në legjislacionin aktual

Në kuadrin e zhvillimeve të reja të së drejtës familjare në Shqipëri, me miratimin e Kodit të ri të Familjes së vitit 2003⁵, tashmë është plotësisht e pranueshme të flasim për parimin e autonomisë private të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore, i cili së bashku me parimin e barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve qëndrojnë në themel të rregullimit të marrëdhënieve pasurore martesore. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve dhe kryesisht regjimi pasuror martesor, në kod.fam. janë trajtuar mbi bazën e parimeve të reja, që janë në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të marrëdhënieve familjare. Me autonomi të vullnetit do të kuptojmë mundësinë e njohur nga ligji, privatëve për të vetërregulluar interesat e tyre. Ky parim qëndron në themel të rregullimit ligjor të marrëdhënieve juridiko-civile, pra përbën një nga parimet bazë të së drejtës private⁶.

Regjimi pasuror martesor është rregulluar mbi bazën e modelit ligjor të sistemit Francez, deri diku ai Italian si dhe gjithashtu është mbajtur në konsideratë edhe Kodi i Familjes i RPSSH, i vitit 1965 (hyrë në fuqi 1 Janar 1966)⁷.

Ndërsa në të kaluarën, për një kohë të gjatë, fusha e marrëdhënieve familjare ka qenë e përjashtuar nga vullneti i palëve⁸, sot në doktrinën dhe praktikën gjyqësore është pranuar gjerësisht parimi i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve; ndërsa problemet që paraqiten për studiuesit e së drejtës, i referohen përcaktimit të kufijve dhe modaliteteve, brenda të cilëve kjo autonomi mund të ushtrohet⁹.

Objekтиви kryesor i këtij punimi, do të jetë pikërisht studimi i ndërveprimit ndërmjet kornizës ligjore të padreogueshme dhe autonomisë së bashkëshortëve në vetërregullimin e interesave të tyre pasurorë dhe kufijve brenda të cilëve kjo autonomi mund të ushtrohet.

⁵ Kodi i Familjes së RSH, miratura me ligjin Nr. 9062, datë 08.05.2003, ka hyrë në fuqi në 21 Dhjetor të vitit 2003. Hartimi i Kodit të Familjes është rezultat i një pune gati 3 vjeçare. Burimet në të cilat është mbështetur hartimi i Kodit të Familjes janë Konventat ndërkombëtare, kryesisht ato të ratifikuara nga RSH, si Konventa “Mbi të drejtat e fëmijës”, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 20 Nëntor 1980; Konventa Europiane “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve që lidhen me kujdestarinë dhe rifitimin e saj mbi fëmijët”, miratuar në Luksemburg, në 20 Maj 1980; Konventa e Hagës e Majit të vitit 1993 “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet ndërvendase” dhe Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Nga njëra anë, Kodi i Familjes është hartuar mbi bazën e Kodit Civil Francez dhe atij Italian, ndërsa nga ana tjetër është ruajtur tradita shqiptare, në drejtim të ruajtjes së elementëve që kanë qenë bazë në konsolidimin e traditës shqiptare. Për këtë shih: Zaka, Tefta. “Kodi i ri i Familjes - Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” në *Jeta Juridike*, Nr. 2, Shkurt 2004, Tiranë: Botim i Shkollës së Magjistraturës, 2004, fq. 5.

⁶ Shih: Ruggiero Domenico G. *Gli Accordi Prematrimoniali*. Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane, 2005, fq. 7.

⁷ Zaka, “Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” fq.11.

⁸ Carlier, Jean-Yves. *Autonomie de la volonte et statut personnel*. Travaux de la Faculte de droit de l'Universite Catholique de Louvain. Bruylant, Bruxelles: 1992.fq. 41.

⁹ Cubeddu, Maria G. “Autonomia privata e regimi patrimoniali.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.) në Trattati di diritto private, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, fq.1-2.

Pyetja që do të shtrohet vazhdimisht në çdo pjesë të punimit, është se në cilën masë, sistemi ligjor, i lejon ose duhet tu lejojë bashkëshortëve rregullimin kontraktor të marrëdhënieve të tyre pasurore.

Parimi i autonomisë private është shtylla kryesore e marrëdhënieve ekonomike, shprehje e lirisë së individit, për këtë arsye ligjvënësi dhe gjykatat hezitojnë të ndërhyjnë në të. Në çdo sistem ligjor gjenden një grup normash të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe të pashmangshme me marrëveshje të palëve, norma të cilat kufizojnë autonominë e vullnetit të individëve. Të tilla norma kërkojnë një *ratio* shumë të fortë justifikuese dhe zakonisht kanë për qëllim të rregullojnë situatat në të cilat shfaqet një pabarazi ndërmjet palëve, si për shembull, të tilla norma gjejmë në të drejtën e konsumatorit, të drejtën e punës dhe në të drejtën familjare¹⁰. Si rregull i përgjithshëm, sistemi i normave të detyrueshme ka për qëllim që t'i garantojë palëve kushtet e nevojshme për shprehjen e pëlqimit (marrjen e një vendimi) në autonomi të plotë. Në këtë mënyrë pjesa më e madhe e normave impreative, të cilat në pamje të parë duket që kufizojnë autonominë e palëve, kanë për qëllim pikërisht mbrojtjen e kësaj autonomie. Por, në të drejtën familjare, nuk është ky funksioni i normave imperative, funksioni i tyre është mbrojtja e unitetit të familjes, garantimi i solidaritetit ndërmjet anëtarëve të familjes si dhe mbrojtja e bashkëshortit ekonomikisht më të dobët dhe fëmijëve, gjatë martesës ose në rastin e zgjidhjes së saj¹¹.

Megjithëse, në njërin anë ligjvënësi ka zgjeruar fushën e autonomisë së veprimit të bashkëshortëve, në rregullimin e marrëdhënieve pasurore, në anën tjetër, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm në ruajtjen e solidaritetit ndërmjet anëtarëve të familjes, nëpërmjet rregullimit të regjimit primar të familjes, normat e të cilit janë të detyrueshme për zbatim dhe të pashmangshme për bashkëshortët.

Gjykojmë të nevojshëm dhe të arsyeshëm fillimin e kësaj trajtese me disa reflektime mbi parimin e autonomisë së vullnetit në fushën e marrëdhënieve familjare, duke pasur parasysh reformën e thellë që ka pësuar e drejta familjare në Shqipëri me miratimin e kod.fam. të vitit 2003. Kjo reformë është në përputhje të plotë me dy parime themelore të një shteti demokratik, të garantuara nga neni 11/3 dhe 18/1 i Kushtetutës, përkatësisht parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike, aspekt i rëndësishëm i të cilit është autonomia e vullnetit, për rrjedhojë bën pjesë në të drejtat themelore të njeriut, mundësia për të rregulluar sferën e të drejtave personale dhe pasurore të tij; dhe parimi i barazisë juridike, sipas së cilit duhet ti garantohet individëve (bashkëshortëve) e drejta për të kontraktuar, si mundësi për të realizuar barazinë përpara ligjit¹². Legjislatori, në sanksionimin e parimit të autonomisë së vullnetit, në këtë reformë, ka qenë i kujdesshëm në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet dy parimeve të nivelit kushtetues, mbrojtjes së familjes nga njëra anë dhe lirisë personale nga ana tjetër, duke i dhënë jetë marrëdhënieve familjare të ndërtaura mbi konsensusin dhe bashkëpunimin e bashkëshortëve¹³.

Nga një vështrim i shkurtër historik i marrëdhënieve familjare në Shqipëri, mund të themi që në 50 vitet e kaluara, e drejta familjare është karakterizuar nga mungesa e theksuar e njohje së mundësisë së bashkëshortëve për të rregulluar interesat e tyre pasurore. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve ishin rregulluar me dispozita urdhëruese, pa i dhënë asnjë mundësi bashkëshortëve për t'i ndryshuar ato, të cilat rregullonin si të vetmin regjim pasurore, atë të bashkëpronësisë "*quasi universale*". Duhet theksuar, që ky rregullim ligjor ishte plotësisht në përputhje me parimet ekonomiko-sociale, mbi të cilat ishte ndërtaur shteti dhe shoqëria

¹⁰ Scherpe, Jens M. "Introduction." në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe, Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 1-2.

¹¹ Scherpe, Ibid, fq. 2.

¹² De Paola, Vincenzo. *Il regime patrimoniale della famiglia II*. Milano: Giuffrè Editore, 1995, fq. 16.

¹³ Anelli, Franco. "Sul'esplicazione dell'autonomia privata nel diritto matrimoniale." në *Studi in onore di Pietro Rescigno II, Diritto Privato, Persone, famiglia, secessioni e proprietà*, Milano: Giuffrè Editore, 1998, fq. 15.

shqiptare, parime të cilat bazoheshin mbi pronën shtetërore dhe eliminimin e pronës private. Në kushtet kur në pronësinë private të bashkëshortëve ishin vetëm sendet e përdorimit vetjak dhe të ardhurat e fituara nga puna¹⁴, ishte e panevojshme garantimi ligjor, për bashkëshortët, i një autonomie në drejtim të rregullimit të regjimit pasuror.

Sot, pas reformës së vitit 2003, e drejta familjare i është nënshtruar privatizimit të saj dhe pa dyshim, që sot e drejta familjare klasifikohet në korpusin e madh të së drejtës private.

Koncepti i autonomisë private është një prej koncepteve themelore të së drejtës civile, koncept i cili përgjithësisht gjen përkufizim si “*mundësi e privatëve për të vetërregulluar interesat e tyre*”. Mundësia e vetërregullimit të interesave nuk buron *ex novo* nga ligji, por vetëm njihet dhe garantohet prej tij, njëlloj siç Kushtetuta garanton sovranitetin e popullit (neni 2 i Kushtetutës) apo të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 15 i Kushtetutës)¹⁵. Të një rëndësi esenciale, mbeten për tu përcaktuar kufijtë e kësaj autonomie, kufij të cilat do të varen nga raporti ndërmjet interesit publik të familjes me interesin individual të anëtarëve që e përbëjnë atë.

Megjithëse, doktrina juridike e viteve të kaluara është karakterizuar nga debate të shumta¹⁶, në lidhje me zbatimin e parimit të autonomisë private në fushën e marrëdhënieve familjare, në ditët e sotme mund të konsiderohet i kaluar opinioni, sipas së cilit marrëdhëniet familjare për shkak të interesit publik të familjes, karakterizohen nga “statusi” dhe jo nga “vullneti” i anëtarëve të saj. Vitet e fundit, doktrina juridike italiane ka teorizuar ekzistencën e “*veprimit juridik familjar*” si një shprehje e autonomisë private, i karakterizuar nga një nivel më i reduktuar lirie në raport me autonominë e marrëdhënieve kontraktore. Rregullimi i një numri të madh marrëdhëniesh familjare është lënë sot në dikrecion të subjekteve të këtyre marrëdhënieve, megjithëse, nga ana tjetër, kjo liri nuk është njohur për një grup marrëdhëniesh familjare, të cilat rregullojnë funksionin social të familjes¹⁷. Rregullit absolut të interesit më të lartë të familjes, të parashikuar dikur, i është mbivendosur sot rregulli i vetërregullimit të marrëdhënieve familjare, nga bashkëshortët, si në fazën fiziologjike të marrëdhënies bashkëshortore ashtu dhe në atë patologjike¹⁸.

Autonomia private e bashkëshortëve është e kufizuar për sa i përket marrëdhënieve personale jopasurore që lindin nga martesë, në këtë drejtim bashkëshortët nuk mund të eliminojnë (shmangin plotësisht) detyrimin për ndihmë morale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe mbështetje reciproke, detyrimin e jetesës së përbashkët, sepse këto detyrime përbëjnë kuptim social të martesës¹⁹ dhe për këtë arsye janë të parashikuara me dispozita urdhëruese në kod.fam.. Nga ana tjetër, hapësira më të mëdha të autonomisë private gjejnë vend në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve²⁰. Megjithëse bashkëshortët nuk mund të eliminojnë, as me marrëveshje ndërmjet tyre kontributin ekonomik reciprok për nevojat e familjes, ato kanë

¹⁴ Toka truall dhe ajo bujqësore, objektet e banimit dhe ato ekonomike ishin në pronësi të shtetit.

¹⁵ Russo, Ennio. *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*. Milano: Giuffrè Editore, 1983, fq.112

¹⁶ Privatëve nuk mund tu njihet mundësia e vetërregullimit të interesave të tyre, në fushën e marrëdhënieve familjare, sepse familja është një formacion social, që karakterizohet nga intereset e përbashkët të të gjithë antarëve, interesa të cilat nuk korespondojnë gjithmonë me interesat vetjakë të çdo anëtari të saj. Për më shumë shih: Donisi, Carmine. *Giurisprudenza e diritto civile-raccolta sistematica di questi e decisioni-persone fisice ed enti, famiglie e filiazione, negozio giuridico, contratti in genere*. Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane, 1997, fq. 7.

¹⁷ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq.113-114.

¹⁸ Cerri, Francesca. *Gli accordi prematrimoniali*. Milano: Giuffrè Editore, 2011, fq.4.

¹⁹ Patti, Salvatore. “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta Michele (Eds.), në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti, Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq. 3.

²⁰ Patti, “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” fq. 4.

të drejtë të rregullojnë modalitetet e përbushjes së këtij kontributi. Ndërsa, shprehjen e tij më të gjerë parimi i autonomisë private e gjen në fushën e regjimit pasuror martesor²¹.

Autonomia private e bashkëshortëve, në fushën e marrëdhënieve pasurore, gjen bazën e saj në nenin 66 të kod.fam, dispozitë e cila i jep bashkëshortëve lirinë për të vendosur për një regjim pasuror të ndryshëm nga ai ligjor. Kjo është një nga reformat më të rëndësishme, që ka sjellë Kodi i ri i Familjes. Vlen të përmendim këtu që autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve pasurore, ishte inekzistente në Kodin Civil të vitit 1981, në bazë të së cilit pasuria e bashkëshortëve do t'i nënshtrohej, në mënyrë të detyruar, regjimit pasuror ligjor të bashkëpronësisë²², duke eliminuar çdo vullnet të bashkëshortëve, në këtë drejtim. Për më tepër regjimi i bashkëpronësisë ligjore i parashikuar nga ky Kod ishte një regjim i cili bazohej mbi një solidaritet të tepruar të interesave personale dhe pasurore të bashkëshortëve, duke parashikuar që çdo pasuri e fituar gjatë martesës, me përjashtim të sendeve të përdorimit ngushtësisht vetjak, ishte në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.

Nisur nga rëndësia që i jep kod.fam. parimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, është e ligjshme të themi që baza e rregullimit juridik të marrëdhënieve pasurore dhe deri diku edhe marrëdhënieve personale jopasurore nuk është me “statusi” i palëve si “bashkëshortë”²³, por vullneti i tyre, vullneti i cili manifestohet në formën e “marrëveshjeve” dhe “kontratës martesore”²⁴.

Kodi aktual i Familjes²⁵ (ashtu si edhe Kodet e mëparshme të viteve 1965²⁶ dhe 1982²⁷), parashikon parimin e barazisë morale dhe juridike ndërmjet burrit dhe gruas. Parimi i barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve shfaqet po aq i rëndësishëm sa edhe parimi i autonomisë private, sepse mund të flasim për autonomi të vullnetit të bashkëshortëve vetëm nëse ata gjenden në pozitë të barazisë juridike ndërmjet tyre²⁸.

Në raport me të kaluarën, ku zgjidhja e martesës konsiderohej një fenomen i rrallë social, i cili duhej eliminuar sa të ishte e mundur, sot numri i zgjidhjeve të martesave është rritur me ritme të ndjeshme dhe statistikat tregojnë që rritet nga viti në vit. Në këtë drejtim, është thelbësore njohja e një autonomie më të gjerë bashkëshortëve në rregullimin e pasojave pasurore të zgjidhjes së martesës, jo vetëm në fazën fiziologjike të martesës, por dhe në atë patologjike. Kjo sepse, nga eksperiencia e vendeve të tjera dhe praktika gjyqësore e tyre, është konfirmuar që, është më e lehtë për bashkëshortin më të dobët ekonomikisht të gjejë mbrojtje më të përshtatshme të

²¹ Me regjim pasuror martesor do të kuptojmë tërësinë e normave ligjore, të cilat kanë për objekt rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve gjatë martesës, dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe të tretëve. Për më tepër shih: Omari, Sonila. *E drejta familjare*. Tiranë: Botimet Morava, 2010, fq. 57.

²² Për më shumë shiko nenet 86 dhe 87 të Kodit Civil të RPSH, të vitit 1981.

²³ Në bazë të Kodit Civil, të vitit 1981 dhe Kodit të Familjes, të vitit 1982, nga statusi i palëve si “bashkëshortë” rrjedh në mënyrë imperative rregullimi i marrëdhënieve pasurore dhe personale jopasurore nga ligji, pa i dhënë asnjë rëndësi vullnetit të bashkëshortëve.

²⁴ Andriani, Maria C. *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*. Torino: G. Giappichelli Editore, 2006, fq. 5.

²⁵ Neni 1 i Kodit të Familjes të vitit 2003, parashikon: “Martesa si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti”.

²⁶ Neni 2 i Kodit të Familjes së vitit 1965, parashikon: “Martesa lidhet me hirin e lirë të burrit dhe të gruas dhe mbështetet në ndjenja të shëndosha dashurie midis bashkëshortëve dhe mbi parimet e barazisë, të ndihmës dhe respektit midis tyre”.

²⁷ Neni 6 i Kodit të Familjes së vitit 1981, parashikon: “Anëtarët e familjes kanë të drejta dhe detyrime të barabarta në familje. Gruaja, e çliruar nga shtypja politike dhe shfrytëzimi ekonomik, si forcë e madhe e revolucionit, gëzon të drejta të barabarta me burrin në familje”.

²⁸ Patti, “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” fq. 3.

interesave të tij nëpërmjet marrëveshjeve, qoftë edhe atyre preventive, se sa të gjejë një mbrojtje të përshtatshme gjyqësore të këtyre interesave²⁹.

Pas analizës së parimit të autonomisë private, është e rëndësishme të përcaktojmë kufijtë brenda të cilëve bashkëshortët kanë të drejtë të ushtrojnë këtë autonomi, si dhe të përcaktojmë modalitetet e ushtrimit të saj³⁰. Përcaktimi i këtyre kufijve do të përfshijë elementë, të cilët kalojnë nga interesat e ngushtë të bashkëshortëve drejt interesit të përgjithshëm që shoqëria ka për martesën, si një formacion bazë social³¹.

Më poshtë, gjatë këtij punimi, do të diskutojmë një tezë të përpunuar prej kohësh nga doktrina italiane, sipas së cilës, autonomia e vullnetit që gëzojnë bashkëshortët në fushën e kontratës martesore është më e kufizuara në raport me autonominë e vullnetit të palëve në fushën kontraktore (të rregulluara nga Kodi Civil dhe ligje të tjera)³². Diskutime ka gjithashtu në lidhje me mundësinë e bashkëshortëve për të lidhur kontrata martesore atipike³³.

Në analizë të fundit, duhet të pohojmë që, risia që ka sjellë neni 66 i kod.fam. është njohja e një autonomie të gjerë kontraktore të bashkëshortëve, në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve të tyre pasurore, pra të përcaktimit të regjimit juridik, i cili do të zbatohet pasurisë së fituar gjatë martesës nga bashkëshortët dhe mundësia e përshtatjes së këtij regjimi me dinamikën e jetës familjare³⁴. Instrumenti tipik, nëpërmjet së cilit gjen shprehje shfaqja e kësaj autonomie, është “kontrata martesore”. Justifikimin e tij, parimi i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, e gjen në domosdoshmërinë që, në kuadrin e marrëdhënieve të reja ekonomike, në ditët e sotme, të arrihet përshtatja e regjimit pasuror me interesat pasurorë jo vetëm të familjes si entitet social, por edhe të individëve të veçantë që e përbëjnë atë (bashkëshortëve), brenda kufijve të përcaktuara nga ligji³⁵. Për të lehtësuar punën e bashkëshortëve, në zgjedhjen e regjimit pasuror, që më mirë u përshtatet interesave të tyre dhe për të kanalizuar lirinë kontraktore të tyre, ligjvënësi ka rregulluar një numër modelesh të regjimeve pasurore, të cilat nuk kanë për qëllim të kufizojnë lirinë e zgjidhjes së regjimit pasuror, por kanë për qëllim vetëm ta orientojnë atë.

Në çdo rast kufijtë e autonomisë private duhen analizuar mbi bazën e vlerësimit dhe ruajtjes së ekuilibrit ndërmjet interesave të bashkëshortëve, interesave të anëtarëve të familjes dhe mbrojtjes së të tretëve³⁶.

1.2. Autonomia e vullnetit në fushën e marrëdhënieve pasurore

Nëse nga njëra anë, në debatin juridik të ditëve të sotme nuk ka asnjë dyshim që parimi rregullues i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve është ai i autonomisë së vullnetit, nga ana tjetër një debat i gjerë ekziston në lidhje me fushën e zbatimit të këtij parimi³⁷.

Në radhë të parë, autonomia private manifestohet në mundësinë e bashkëshortëve të ardhshëm për të rregulluar me kontratë regjimin pasuror martesor, kontratë e cila mund të lidhet para lidhjes së martesës ose gjatë saj. Kontrata martesore përfaqëson rregullin e përgjithshëm, në

²⁹ Cerri, *Gli accordi prematrimoniali*, fq. 6.

³⁰ Patti, “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” fq. 5.

³¹ Cubeddu, “Autonomia privata e regimi patrimoniali.” fq. 21.

³² Patti, “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” fq. 3.

³³ Me kontratë martesore atipike do të kuptojmë atë kontratë me anë të së cilës bashkëshortët zgjedhin një regjim pasuror martesor të ndryshëm nga regjimet pasurore të rregulluara në kod.fam.

³⁴ Lo Sardo, Giuseppe. “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” në *Rivista del Notariato*, Milano: Giuffrè Editore, 1991, fq. 1230.

³⁵ Për këtë mendim shih: Terré, François. dhe Simler, Philippe. *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*. Paris: Éd. Dalloz, 2008, fq. 117-118.

³⁶ Cubeddu, “Autonomia privata e regimi patrimoniali.” fq. 5.

³⁷ Patti, “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” fq. 7.

rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe vetëm në mungesë të një kontrate martesore do të zbatohet regjimi i bashkësisë ligjore, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm³⁸.

Regjimi i bashkësisë është zgjedhur nga ligjvënësi, si regjimi më i përshtatshëm për të garantuar barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve në marrëdhënien martesore, regjim i cili zbatohet automatikisht në mungesë të një vullneti të shprehur të bashkëshortëve drejt një tjetër regjimi pasuror³⁹. Megjithatë, diskutime të shumta ekzistojnë edhe në lidhje me natyrën juridike dhe ligjshmërinë e këtij regjimi, diskutime të cilat vendosin në pikëpyetje këtë solidarizim kaq të madh të interesave pasurorë të bashkëshortëve, duke pasur parasysh, që baza e marrëdhënieve të pronësisë në sistemin tonë juridik është pronësia private, parim ky i sanksionuar që në Kushtetutën e RSH⁴⁰.

Pyetja e parë që shtrohet për diskutim është se përse ndërmjet të gjitha regjimeve pasurore të mundshme, ligjvënësi ka zgjedhur si regjim ligjor, pikërisht regjimin e bashkësisë së pjeseshme.

Bazuar në doktrinën Italiane dhe atë Franceze, mbi reformën e kod.civ. Italian (reforma e vitit 1975) dhe kod.civ. Francez (reforma e vitit 1985) mbi regjimet pasurore martesore, reforma të cilat kanë shërbyer si model për ligjvënësin tone, në hartimin e Kodit të Familjes (reforma e vitit 2003), rezulton që motivi kryesor është **“garantimi i një barazie më të madhe ekonomike dhe morale”** të bashkëshortëve.

Nga ana tjetër, për të vazhduar sërish debatin, është e paqartë se përse ndërmjet shumë regjimeve të tjera që mund të garantojnë barazinë e bashkëshortëve, si regjimi i pasurive të ndara apo regjimi i pjesëmarrjes në fitime, është zgjedhur pikërisht regjimi aktual i bashkësisë. Arsyeja kryesore, që jep doktrina italiane dhe franceze në këtë drejtim, është që regjimi i bashkësisë ligjore ka si avantazh që **“i lejon gruas të marrë pjesë plotësisht dhe në mënyrë të menjëhershme në pronësinë dhe administrimin e pasurisë së fituar gjatë martesës⁴¹”** dhe padyshim është **“rëndësia ekonomike që i jep punës shtëpiake të gruas⁴²”**, avantazhe të cilat nuk njihen në modelet e tjera të regjimeve pasurore.

Ndërsa kritikët e këtij regjimi, shprehen se bashkësia ligjore është një regjim **“extra ordinem”** në legjislacionin tonë civil, regjim i cili bie në kundërshtim me parimet e përgjithshme mbi të cilat është ndërtuar marrëdhënia e pronësisë në Kushtetutë dhe në kod.civ. Gjithashtu, një kritikë tjetër për këtë regjim, i referohet vështirësisë që sjell qarkullimi ekonomik i sendeve, të cilat janë objekt i bashkësisë ligjore⁴³, për shkak të sistemit të administrimit të pasurisë së bashkësisë që është zgjedhur nga ligjvënësi.

Autonomia private manifestohet, në radhë të parë, në zgjedhjen e një regjimi pasuror kontraktor ndërmjet modeleve të ofruara nga ligji, duke përjashtuar në këtë mënyrë zbatimin e regjimit ligjor të bashkësisë⁴⁴. Kodi i familjes ofron tre modele të regjimeve pasurore kontraktore: regjimi i bashkësisë me kontratë, regjimi i bashkësisë universal (i cili më saktë është një nënkategori e regjimit bashkësisë me kontratë, dhe regjimi i pasurive të ndara.

³⁸ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 58.

³⁹ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 152.

⁴⁰ Neni 11 i Kushtetutës së RSH sanksionon: **“Sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në pronën private dhe publike..... Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”**.

⁴¹ Colomer, André. *Droit civil, Régimes Matrimoniaux*. dixième édition. Paris: Litec, 2000, fq.24.

⁴² Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul diritto di famiglia*, fq.74

⁴³ Mjafton të kujtojmë këtu regjimin juridik të veprimeve të administrimit të bashkësisë ligjore, të parashikuara në nenin 90 të kod.fam, sipas të cilit veprimet e administrimit jo të zakonshëm (ku përfshihen transaksionet e pasurisë) duhet të kryhen me pëlqimin e shprehur të të dy bashkëshortëve.

⁴⁴ Patti, **“Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.”** fq. 9.

Më tej, parimi i autonomisë private manifestohet në mundësinë e kombinimit të regjimeve pasurore të parashikuara nga ligji, si psh. kombinimi i regjimit të bashkësisë ligjore dhe një regjim tjetër kontraktor, sipas së cilit një pjesë e pasurisë së fituar gjatë martesës do të nënshtrohet regjimit të pasurive të ndara, ndërsa pjesa tjetër një regjimi kontraktor të zgjedhur nga bashkëshortët, që mund të jetë regjimi i bashkësisë ligjore.

Ndërsa për sa i përket, së fundi, shfaqjes më të lartë të autonomisë private, mundësisë së zbatimit të regjimeve pasurore atipike⁴⁵, ekziston një divergjencë e lartë opinionesh të studiuesve të ndryshëm të fushës⁴⁶. Me kontrata atipike do të kuptojmë ato kontrata të cilat nuk janë të rregulluara shprehimisht nga ligji, por rregullimi i tyre rrjedh nga parimet e përgjithshme të së drejtës, me një kufizim të vetëm: këto kontrata duhet të ndjekin qëllime të ligjshme. Thelbi i këtij debati është të përcaktohet se cilat janë kufijtë e autonomisë private të bashkëshortëve në hartimin e kontratave atipike, e thënë me fjalë të tjera cilat parime palët duhet të respektojnë gjatë hartimit të përmbajtjes së kontratës, cilat janë interesat që mund të ndjekin palët, të cilat meritojnë të mbrohen nga ligji⁴⁷.

Një pjesë e autorëve, janë të mendimit që, mundësia e bashkëshortëve për të vetërregulluar regjimin pasuror martesor është e kufizuar vetëm në fushën e regjimeve pasurore të parashikuara nga ligji⁴⁸. Sipas këtij qëndrimi, bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin vetëm njërin nga regjimet pasurore kontraktore të rregulluar në kod.fam. (regjimi i bashkësisë kontraktore ose regjimi i pasurive të ndara), ose të bëjnë një kombinim të këtyre regjimeve pasurore me regjimin e bashkësisë ligjore⁴⁹. Argumenti i përdorur nga ky grup autorësh është që, parimi i lirisë kontraktore (përcaktimi lirisht i përmbajtjes së kontratës) nuk gjen zbatim në kontratën martesore, sepse regjimet pasurore martesore janë vetëm ato të përcaktuara shprehimisht nga legjislatori.

Përkundrazi, një grup tjetër autorësh pohojnë që, edhe në fushën e kontratës martesore, gjen zbatim parimi i lirisë kontraktore (neni 660 i kod.civ.), si rrjedhojë e të cilit bashkëshortët mund të lidhin kontrata martesore atipike, duke respektuar kufijtë e përcaktuar nga ligji (kod.civ. dhe kod.fam.).

Në opinionin tonë, qëndrimi i grupit të dytë të autorëve është më i pranueshëm dhe më logjik nëse analizojmë në kompleksitet dhe bashkëveprim, jo vetëm normat e kod.fam, i cili është "*lex specialis*" në këtë rast, por edhe normat e kod.civ, i cili përfaqëson "*lex generalis*". Marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve janë në radhë të parë marrëdhënie civile (private) dhe më pas marrëdhënie familjare, për rrjedhojë legjislacioni i zbatueshëm për rregullimin e tyre është kod.fam. dhe kod.civ. Nëse pranojmë që kontrata martesore përfshihet në kategorinë e përgjithshme të kontratave, atëherë referuar nenit 660 të kod.civ, palët janë të lira të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e kontratës, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji. Nga ana tjetër, marrim në analizë nenin 66 të kod.fam., sipas të cilit, regjimi pasuror i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij kodi dhe të legjislacionit përkatës. Duke analizuar në mënyrë komplementare të dy këto dispozita të kod.fam. dhe kod.civ, si dhe

⁴⁵ Kontrata tipike është ai rregullim i caktuar kontraktor, që paraqet, në lidhje me shkakun, elemente origjinale të tilla që nuk lejojnë identifikimin e tij me një tip kontrate ligjore dhe për rrjedhojë bën të pamundur zbatimin për këtë kontratë të regjimeve ligjore që rregullojnë kontratat tipike. Për më tepër shih: De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 20.

⁴⁶ Për më shumë rreth këtij debati doktrinal shih: Patti, "Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata." fq. 8.

⁴⁷ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq.154-155.

⁴⁸ De Rubertis, Giovanni. "Le Convenzioni matrimoniali in generale." *Vita Notarile*, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo: Buttitta Edizioni Giuridice, 1975.

⁴⁹ Patti, "Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata." fq. 9.

nisur nga fakti që në kod.fam. nuk gjejmë asnjë dispozitë të vetme që të ndalojë në mënyrë të shprehur lidhjen e kontratave martesore atipike, atëherë arrijmë në përfundimin që bashkëshortët janë të lirë të zbatojnë çdo regjim pasuror, i cili nuk bie në kundërshtim njëkohësisht me dispozitat urdhëruese të kod.fam. dhe me ato të kod.civ.⁵⁰. Kështu bashkëshortët janë të lirë të rregullojnë marrëdhëniet pasurore të tyre, nëpërmjet rregullave, të cilat në tërësinë e tyre nuk kanë lidhje me asnjë nga skemat kontraktore tipike të parashikuara nga kod.fam.⁵¹.

Në analizë të fundit, mund të pohojmë që, bashkëshortët janë të lirë të lidhin kontrata martesore atipike, për aq sa i përmbahen limiteve të parashikuara nga dispozitat urdhëruese të legjislacionit civil dhe atij familjar.

Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve shtrihet edhe në drejtim të kontributit material për nevojat e familjes dhe bashkëjetesës. Bazën e saj, e drejta e bashkëshortëve për të vetërregulluar kontributin ekonomik për familjen, e gjen në nenin 54 të kod.fam., sipas së cilit: në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesë nuk është i rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre. Nga interpretimi “*per a contrario*” i kësaj dispozite, rezulton që, si rregull i përgjithshëm, bashkëshortët kanë të drejtë të përcaktojnë në kontratën martesore modalitetet, sasinë, formën e përmbushjes së kontributit material për nevojat e familjes dhe si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, vetëm në mungesë të një kontrate martesore, kontributi i tyre do të përcaktohet në varësi të dy kritereve themelore: a) nevojave të familjes dhe b) kushtet dhe aftësitë që ka secili prej tyre për të kontribuar materialisht apo në natyrë për mbarëvajtjen e familjes. Bashkëshortët nuk mund të shmangin me marrëveshje, ndërmjet tyre, përmbushjen e këtij detyrimi.

Nga gjithë analiza e deritanishme, arrijmë në përfundimin që, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në lidhjen e kontratës martesore, i nënshtrohet dy grupe kufizimesh: a) kufizimet e përgjithshme të përcaktuara në kod.civ. dhe b) kufizimet e veçanta të cilat gjenden në kod.fam. Vetëm ekzistenca e një ndalimi të përcaktuar shprehimisht mund të kufizojë shprehjen autonome të vullnetit të palëve në fushën e rregullimit të marrëdhënieve familjare⁵² dhe në mungesë të një ndalimi të tillë të shprehur dhe në respektim të klauzolës së rendit publik, palët janë të lira të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore.

1.3. Instrumentet ligjore të ushtrimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve: “kontrata” dhe “marrëveshja”

Format e ushtrimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, në funksion të vetërregullimit të interesave të tyre, bazuar në leksikun e kod.fam, janë “*marrëveshjet e bashkëshortëve*” dhe “*kontrata martesore*”.

Natyrshëm lind pyetja, nëse konceptet e “kontratës” dhe “marrëveshjes” janë përdorur në mënyrë sinonime nga ligjvënësi shqiptar, apo secili prej tyre mbart kuptime të ndryshme, cili prej këtyre koncepteve është më i gjerë dhe cili ka një kuptim më të ngushtë? Kriteri, nga i cili duhet të

⁵⁰ Bazuar në parimin që çdo gjë që nuk është e ndaluar shprehimisht nga legjislacioni civil është e lejuar. Limitet e vetme përbëhen nga dispozitat urdhëruese të legjislacionit civil.

⁵¹ Salomone, Luigi M. “Lo sicoglimento della comunione legale dei coniugi.” në *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II. Il regime patrimoniale della famiglia*, G. Cassano (Ed.) në *Trattati P. Cendon* (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2006, fq. 346. Apud: Confrontini, Massimo. “La comunione convenzionale tra coniugi.” në *Il diritto di famiglia, Il regime patrimoniale della famiglia II*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, fq. 298.

⁵² Oberto, Giacomo. *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilità e fattispecie*. Milano: Giuffrè Editore, 1999, fq. 137-138.

nisemi për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme, është, pa dyshim, kriteri i objektit të rregullimit juridik të tyre.

Më vazhdim, duhet theksuar se, legjislatori nuk është koherent në terminologjinë e përdorur, sepse duke iu referuar kontratës martesore, përdor me kuptime sinonime dy terma: termin “kontratë”, në nenet 69 dhe 108-122 dhe termin “marrëveshje e veçantë” në nenin 66 të tij.

Doktrina bën një diferencim të qartë midis termave kontratë martesore⁵³ dhe marrëveshje të lidhura nga bashkëshortët, duke i klasifikuar ato në tre grupe⁵⁴:

A. Marrëveshjet e bashkëshortëve, të cilat kanë si objekt rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të bashkëshortëve (të karakterit personal jopasuror dhe pasuror). Në këtë kategori përfshihen marrëveshjet që rregullojnë elementë të caktuar të jetës familjare si, zgjedhja e vendbanimit të përbashkët⁵⁵, zgjedhja e mbiemrit⁵⁶ që bashkëshortët do të mbajnë gjatë martesës, rregullimi i përmbushjes së kontributit material për nevojat e familjes, rregullimi i mënyrës së rritjes dhe edukimit të fëmijëve, marrëveshja për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve. Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve shtrihet jo vetëm në mundësinë e tyre për të vetërregulluar marrëdhëniet pasurore, por edhe në mundësinë për të shprehur vullnetin e tyre në rregullimin e disa aspekteve të caktuara të jetës bashkëshortore, të cilat përfshijnë marrëdhënie me përmbajtje jopasurore, duke respektuar karakterin e tyre të pashmangshëm dhe limitet e parashikuara nga kod.fam

Vlen të theksohet që, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në drejtim të marrëdhënieve personale jopasurore është shumë më e kufizuar në raport me lirinë e tyre në rregullimin e marrëdhënieve pasurore. Ky kufizim është i kuptueshëm, duke pasur parasysh, që për shkak të rolit social që ka familja në shoqëri, interesi publik i unitetit të familjes predominon mbi atë privat të palëve, të anëtarëve që e përbëjnë atë. Parimi i autonomisë së vullnetit, në rregullimin e marrëdhënieve personale, gjen dy kufizime, së pari karakterin e pashmangshëm të këtyre detyrimeve dhe së dyti interesin e familjes⁵⁷, si një parim i rendit publik.

Këto marrëveshje të bashkëshortëve mund të përfshihen edhe në kuadër të kontratës martesore, por ato i nënshtrohen një regjimi juridik të ndryshëm nga kjo e fundit.

B. Marrëveshje të bashkëshortëve që kanë për qëllim rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës. Vetë këto marrëveshje mund të ndahen në dy grupe: a) marrëveshje të lidhura pasi bashkëshortët kanë filluar procedurat gjyqësore të zgjidhjes së martesës dhe b) marrëveshjet preventive të rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës, të cilat mund të lidhen para lidhjes së martesës ose gjatë saj.

⁵³ Kodi Civil Italian i vitit 1945, pas ndryshimeve të vitit 1975 përdor termin “*convenzioni matrimoniali*”, në dallim nga rregullimi i vitit 1945, në të cilin përdorej termi “*kontratë*”.

⁵⁴ Andrini, *L'autonomia private dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq. 6.

⁵⁵ Bazuar në nenin 55 të kod.fam, vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Përcaktimi i një vendbanimi të përbashkët, përfaqëson një shembull tipik të asaj që tradicionalisht është kuptuar si një kufizim i lirisë personale, që rrjedh prej martesës. Secili bashkëshort nuk është i lirë të përcaktojë vendbanimin e tij, sipas nevojave individuale, por duhet të arrijë në një përputhje me mirëkuptim të nevojave të tij me ato të bashkëshortit tjetër dhe të fëmijëve. Në mungesë të arritjes së një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, ligji ka gjetur si zgjidhjen më të përshtatshme, ndërhyrjen e gjykatës (përfshirjen e një figure ndihmëse për bashkëshortët).

⁵⁶ Bazuar në neni 51 të kod.fam, bashkëshortët janë të lirë të përcaktojnë mbiemrin që ata do të mbajnë gjatë martesës. Është e kuptueshme që, liria e zgjedhjes së mbiemrit është e kufizuar ndërmjet dy mundësive: a) të mbajnë si mbiemër të përbashkët mbiemrin e njërit prej tyre, qoftë të burrit apo të gruas, ose b) të mbajnë secili mbiemrin që kishin para lidhjes së martesës.

⁵⁷ Patti, Salvatore. dhe Cubeddu, Maria G. *Diritto della famiglia*. Milano: Giuffrè Editore, 2011, fq. 138.

Prej kohësh në doktrinën juridike dhe në praktikën gjyqësore ka pasur qëndrime të ndryshme mbi ligjshmërinë e marrëveshjeve me objekt rregullimin e pasojave pasurore të një pavlefshmërie apo zgjidhje eventuale të martesës, marrëveshje të cilave këtej e tutje do t'i referohemi me termin **“marrëveshjet preventive të zgjidhjes së martesës”**⁵⁸.

Marrëveshjet preventive janë instrumente ligjorë mjaft të përhapur në SHBA, të njohura me termin e përgjithshëm **“nuptial agreements”**, ose **“prenuptial agreements”**, nëse janë hartuar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës dhe **“antenuptial agreements”**, nëse janë hartuar gjatë vazhdimit të martesës. Megjithë suksesin e madh që kanë të tilla marrëveshje sot në SHBA, jurisprudenca dhe doktrina e SHBA-ve nuk e ka pranuar me kaq lehtësi futjen e këtyre instrumenteve juridikë në rregullimin ligjor të palëve. Jurisprudenca e para Luftës së Dytë Botërore, marrëveshjet preventive të lidhura para lidhjes së martesës ose gjatë fazës fiziologjike të martesës, i quante të pavlefshme bazuar mbi dy argumente, parimin e rendit publik **“public policy”** dhe argumenti i dytë ishte që lidhja e tyre favorizonte zgjidhjen e martesës⁵⁹.

Gjithashtu, edhe në të drejtën romake këto tip marrëveshjesh nuk ishin të panjohura për bashkëshortët. Shumë burime, dëshmojnë ekzistencën e marrëveshjeve të tilla, të cilat të përfshira në të njëjtin dokument me paktet nuciale, i lejonin bashkëshortëve dhe familjeve të tyre, të rregullonin, para lidhjes së martesës ose gjatë saj, pasojat pasurore të një zgjidhje eventuale martesë⁶⁰.

Në vendet e familjes ligjore romano-gjermanike, duke qenë se sipas kuptimit kristian martesë konsiderohej një lidhje e përjetshme dhe e pazgjidhshme, historikisht marrëveshjet me objekt rregullimin preventiv të pasojave të zgjidhjes së martesës kanë qenë të padëgjura dhe nuk kishin vlefshmëri ligjore deri në momentin e njohjes ligjërisht të së drejtës për të zgjidhur martesën. Megjithatë, edhe pas njohjes ligjërisht të së drejtës për të zgjidhur martesën, marrëveshjet preventive konsideroheshin si të papranueshme dhe të pavlefshme, në shumë shtete europiane, për shkak të papajtueshmërisë së tyre me rendin publik, bazuar në argumentin që në çastin e lidhjes së martesës bashkëshortët “parashikonin” një zgjidhje eventuale të saj⁶¹.

Lidhur me diskutimin e mësipërm, një pjesë e doktrinës juridike mban qëndrimin që, marrëveshjet preventive të zgjidhjes së martesës janë të pavlefshme, sepse tentojnë të rregullojnë marrëdhënie të tilla, të cilat nuk karakterizohen nga vullneti i subjekteve, por nga “statusi” (ligji)⁶². Ky qëndrim duket tërësisht i pabazuar, sepse marrëveshjet preventive, nuk kanë për objekt rregullimin vullnetar të një “statusi”, por objekti i tyre është vetëm rregullimi i pasojave pasurore të një zgjidhje eventuale të martesës. Sipas opinionit të doktrinës juridike italiane të viteve të mëparshme dhe sipas jurisprudencës së gjykatës së Kasacionit, marrëveshjet preventive të zgjidhjes së martesës, janë absolutisht të pavlefshme, sepse shkelin parimin e pamundësisë së heqjes dorë nga një e drejtë e ardhshme, titullar i së cilës subjekti akoma nuk është, në momentin që heq dorë. Në vijim të këtij opinionit, i duhet mohuar individëve e drejta për të hequr dorë ose për të modifikuar një të drejtë, të cilën ato akoma nuk e kanë, sepse kjo e drejtë mund ti përkasë një personi tjetër ose është akoma inekzistente⁶³. Në kundërshtim të kësaj teze, doktrina italiane

⁵⁸ Në lidhje me përdorimin e këtij termi, shih: Anelli, “Sull’esplicazione dell’ autonomia privata nel diritto matrimoniale.” fq. 44. Shiko gjithashtu: Cerri, *Gli accordi prematrimoniali*, fq. 32; Oberto, *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilita e fattispecie*, fq. 140.

⁵⁹ Cerri, *Gli accordi prematrimoniali*, fq. 25-26.

⁶⁰ Cerri, *Ibid*, fq. 11.

⁶¹ Scherpe, Jens M. “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” në *Marital agreements and private autonomy in a comparative perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 445.

⁶² Santosuosso Fernando. “Il divorzio.” në *Trattato di diritto privato*, P. Rescigno (Ed.), Torino: UTET, 2009, fq. 335. *Apud*: Anelli, “Sull’ esplicazione dell’ autonomia privata nel diritto matrimoniale.” fq. 49.

⁶³ Corte di Cassazione, Camera Civile 11/06/1981, nr. 3777. Shënim i: Cerri, *Gli accordi prematrimoniali*, fq. 69.

sjell argumentin⁶⁴, që në bazë të kod.civ. (kujtojmë këtu nenin 680 të kod.civ. të RSH) kontrata mund të përmbajë kryerjen e veprimeve juridike për sendet e ardhshme, përveç se kur ligji e ndalon atë shprehimisht⁶⁵.

Një pjesë tjetër e doktrinës gjykon mbi vlefshmërinë e këtyre marrëveshjeve bazuar në kriterin e momentit kohor kur janë lidhur. Bazuar në këtë opinion, nëse marrëveshjet e rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës, janë lidhur pasi bashkëshortët kanë marrë vendimin e zgjidhjes së martesës, ose pasi kanë paraqitur kërkesën për zgjidhjen e martesës (faza patologjike e raportit martesor), atëherë këto marrëveshje janë të vlefshme. Por, nga ana tjetër, nëse marrëveshjet preventive janë lidhur para lidhjes së martesës ose në fazën fiziologjike të marrëdhënies martesore atëherë janë të pavlefshme, sepse përfaqësojnë një qëllim të palëve për të arritur më lehtë zgjidhjen e martesës⁶⁶. Ky qëndrim doktrinal është kritikuar nga të tjerë autorë, të cilët mendojnë që, nëse praktika gjyqësore ka pranuar vlefshmërinë e marrëveshjeve që mund të jenë lidhur një natë para paraqitjes së kërkesës për zgjidhjen e martesës, atëherë pse të mos pranohet vlefshmëria e marrëveshjeve që janë lidhur mbas një muaji, një viti ose disa viteve para paraqitjes së kërkesës për lidhjen e martesës ose marrëveshjeve që janë lidhur para lidhjes së vetë martesës⁶⁷.

Duke tejkaluar debatet e mësipërme, në vitet e fundit është vënë re një ndryshim i qëndrimeve të doktrinës dhe jurisprudencës, në drejtim të njohjes së ligjshmërisë së marrëveshjeve preventive të zgjidhjes/pavlefshmërisë eventuale të martesës. Këtu mund të përmendim vendimin e Gjykatës së Lartë Spanjolle të 31 Marsit, të vitit 2011 (RJ 2011/3137)⁶⁸, e cila ka pranuar vlefshmërinë e këtyre marrëveshjeve⁶⁹.

Në gjykimin tonë, në kuadër të mundësisë së vlefshmërisë së këtyre marrëveshjeve në të drejtën shqiptare, qëndrimi i grupit të dytë të autorëve dhe i jurisprudencës aktuale është më i drejtë, sepse përderisa nuk ka një dispozitë ligjore në kod.fam, që të ndalojë bashkëshortët të lidhin marrëveshje preventive, atëherë autonomia e vullnetit të tyre mund të shtrihet edhe në këtë drejtim, me kusht që të mos shkelen dispozitat urdhëruese të kod.fam dhe kod.civ. dhe me kushtin që këto marrëveshje të mos kushtëzojnë sjelljen procesuale të palëve. Në vazhdim të arsytimit, marrëveshjet preventive jo vetëm, që nuk shkelin parimet e rendit publik, por duhen inkurajuar, sepse evitojnë proceset e gjata gjyqësore të pjesëtimit të pasurisë dhe çdo tension të mundshëm që mund të ketë ndërmjet bashkëshortëve në fazën e krizës martesore.

Sipas mendimit mbizotërues të doktrinës europiane⁷⁰, duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të zgjidhjeve të martesës nga vitit në vit, konsiderohet se, në ditët e sotme, rregullimi preventiv i pasojave të zgjidhjes së martesës nuk përbën më një “planifikim të zgjidhjes së martesës” siç

⁶⁴ Cerri, *Gli accordi patrimoniali*, fq. 70.

⁶⁵ Bazuar në nenin 762 të Kodit Civil të RSH, dhurimi nuk mund të përmbajë veç se pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi është i pavlefshëm për sa i takon asaj.

⁶⁶ Cerri, *Gli accordi patrimoniali*, fq. 70.

⁶⁷ Oberto, *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilita e fattispecie*, fq. 762.

⁶⁸ Rrethanat e faktit: Pas pajtimit dy bashkëshortët kishin lidhur një marrëveshje, sipas së cilës në rat të zgjidhjes së martesës burri ishte i detyruar t'i jepte gruas një pension muajor prej 1200 euro dhe t'i kalonte në pronësi një apartament, pavarësisht nga pala do të kërkonte zgjidhjen e martesës. Pas dy vitesh gruaja kërkon zgjidhjen e martesës dhe pretendonte pagimin e shumëve mujore prej 1200 euro si dhe kalimin e pronësisë së një apartamenti. Gjykata e Lartë i njohu gruas të drejtën e shumëve mujore, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, por nuk njohu të drejtën e pronësisë mbi një apartament të bashkëshortit, me argumentin që, dhurimi i sendeve të ardhshme nuk është i vlefshëm sipas KC Spanjoll.

⁶⁹ Ferrer-Riba, Josep. “Marital agreements and private autonomy in Spain.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe, Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 361.

⁷⁰ Për këtë qëndrim shih: Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 486-487.

shihet në të shkuarën; por mungesa e këtij parashikimi shihet si një “dështim për të planifikuar”⁷¹ një eventualitet të zgjidhjes së martesës.

Edhe këto marrëveshje mund të rregullohen në kuadrin e kontratës martesore, por do i nënshtrohen një regjimi juridik të ndryshëm nga kjo e fundit. Nëse marrëveshja preventive përfshihet në kontratën martesore, atëherë do të ndjekë formën e kontratës martesore, por nëse marrëveshja e bashkëshortëve përmban vetëm rregullimin preventiv të pasojave të zgjidhjes së martesës, atëherë do të zbatohen dispozitat e kod.civ. mbi formën e kontratës.

C. Marrëveshja e bashkëshortëve për rregullimin e regjimit pasuror martesor, të ndryshëm nga ai ligjor - Kontrata martesore⁷². Bazuar në nenin 659 të Kodit Civil dhe në nenin 66 të Kodit të Familjes, kontrata martesore përkufizohet si një veprim juridik me anë të së cilit bashkëshortët, krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një regjim pasuror, të ndryshëm nga regjimi ligjor.

Për të dalluar kontratën nga marrëveshjet e tjera duhet të marrim në analizë elementët që kategorizojnë kontratën dhe që përcaktojnë veçantinë e saj, në raport me deklaratime të tjera të vullnetit.

Bazuar në doktrinën italiane, kontrata karakterizohet nga tre elementë, të cilët e bëjnë atë të dallueshme nga marrëveshje të tjera të ligjshme: konsensualiteti, karakteri juridiko-pasuror i objektit të këtij konsensusi dhe deklarimi i vullnetit⁷³.

Është shumë e thjeshtë të realizosh dallimin ndërmjet kontratës dhe akteve të tjera të cilat nuk përmbajnë asnjë nga elementët e përmendur më sipër. Vështirësitë më të mëdha paraqiten në dallimin e kontratës nga akte (veprime juridike) të tjera, të cilat përmbajnë dy nga elementët e sipërpërmendur si, konsensusin dhe vullnetin⁷⁴, por që nuk kanë për objekt marrëdhënie pasurore. Në fushën e marrëdhënieve familjare gjenden veprime juridike, të cilat kanë për objekt marrëdhënie jopasurore, akte të cilat vetë kod.fam. i njeh dhe rregullon, të cilat sjellin edhe pasoja juridike, por që nuk mund të cilësohen në asnjë rast si kontrata, sepse u mungon elementi pasuror⁷⁵. Një akt të kësaj natyre gjejmë, në rradhë të parë, në kod.fam, *martesën*, e cila është një veprim juridik, por nuk është kontratë, për shkak se në përmbajtje të saj gjejmë në rradhë të parë marrëdhënie personale jopasurore.

Nga ana tjetër, pa asnjë dyshim, kontrata martesore, objekti i së cilës është zgjedhja e një regjimi pasuror martesor, të ndryshëm nga regjimi i bashkësisë ligjore, është “kontratë” në kuptimin që

⁷¹ Në një farë mënyrë, një autor i krahason marrëveshjet preventive me kontratën e sigurimit të automjetit. Një person i siguruar nuk planifikon të bëjë një aksident me makinë, por megjithatë merr masa paraprake në rast aksidenti, në mënyrë që të menaxhojë pasojat financiare të aksidentit. Për këtë krahasim shih: Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 445.

⁷² Në vazhdim gjatë këtij punimi do të bëjmë dallimin ndërmjet regjimit pasuror martesor në kuptimin e ngushtë të tij, i cili është objekti i rregullimit të kontratës martesore dhe regjimit pasuror martesor në kuptimin e gjërë, në të cilin përfshihet jo vetëm regjimi pasuror, por edhe të tjera marrëdhënie martesore të karakterit pasuror, të njohura në doktrinë me termin “*regjimi primar*” i familjes.

⁷³ Komponenti i parë është përputhja e interesave, pra kontrata është një akt konsensual (accord). Komponenti i dytë i referohet objektit të këtij konsensusi, që është një marrëdhënie juridiko-pasurore. Ndërsa, komponenti i tretë i referohet raportit midis konsensusit dhe objektit të këtij konsensusi, pra një akti të vullnetshëm. Vlerën përcaktuese këta elementë e marrin vetëm nëse i analizojmë të lidhura njëri me tjetrin dhe jo në mënyrë të izoluar. Do të përbëjë kontratë vetëm një akt në të cilin gjenden të pranishëm të tre këta elementë njëherësh. Roppo, Vincenzo. *Il Contratto*. Seconda Edizione. Milano: Giuffrè Editore, 2001, fq. 4.

⁷⁴ Roppo, *Il Contratto*, fq. 5.

⁷⁵ Roppo, *Il Contratto*, fq. 6.

kodi civil i jep kontratës⁷⁶, sepse objekti i rregullimit të saj juridik është i karakterit pasuror (marrëdhëniet pasurore gjatë martesës⁷⁷).

Për të dhënë kuptim e kontratës martesore është e domosdoshme të bëjmë dallimin ndërmjet kontratës martesore në kuptimin e ngushtë *“stricto sensu”* dhe kontratës martesore në kuptimin e gjerë *“lato sensu”*. Në kuptim të ngushtë *“stricto sensu”* kontrata martesore është veprimi juridik i dyanshëm nëpërmjet të cilit bashkëshortët krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një regjim pasuror martesor, ndërsa në kuptimin e gjerë *“lato sensu”*, me kontratë martesore do të kuptojmë çdo marrëveshje që lidhin bashkëshortët jo vetëm për të rregulluar regjimin e tyre pasuror, por edhe për të rregulluar aspekte të tjera të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, të tilla si rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës (detyrimi për ushqim, kontributi kompensues, e drejta e përdorimit të banesës), dhurimet ndërmjet bashkëshortëve, kontributin material për nevojat e familjes etj⁷⁸.

1.4. Regjimi pasuror martesor

Martesa sjell si pasojë për bashkëshortët jo vetëm ndryshimin e statusit të tyre personal, por edhe ndryshimin e regjimit juridik që do t'i zbatohet pasurisë së fituar nga secili bashkëshort gjatë martesës, nëpërmjet zbatimit të të ashtuquajturit *“regjim pasuror martesor”*.

Titulli i tretë i kod.fam., i titulluar regjimet pasurore martesore, hapet me një kapitull të parë, të titulluar *“dispozita të përgjithshme”*, i cili përmban 7 dispozita, përkatësisht nenet 66-72 dhe trajton disa rregulla të përgjithshme mbi kontratën martesore.

Neni 66 i kod.fam. parashikon që, regjimi pasuror i familjes në mungesë të kontratës martesore do të rregullohet nga regjimi i bashkësisë ligjore. Nga kjo dispozitë mund të nxjerrim dy përfundime: a) regjimi ligjor është subsidiar në raport me regjimin kontraktor, në kuptimin që ky bëhet i zbatueshëm vetëm në mungesë të regjimit kontraktor; dhe b) për rrjedhojë legjislacioni i jep prioritet kontratës martesore si instrumenti më i përshtatshëm për rregullimin e aspektit ekonomik të marrëdhënieve familjare⁷⁹.

Nga një lexim i parë i dispozitave të kod.fam, mund të themi që, me regjim pasuror kuptojmë tërësinë e normave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore të tyre me të tretët, gjatë martesës⁸⁰.

Sipas Gjykatës Europiane të Drejtësisë⁸¹ regjimi pasuror martesor përfshin jo vetëm regjimin pasuror *“stricto sensu”*, në kuptimin që i japin atij legjislacionet e shteteve anëtare, por përfshin gjithashtu të gjitha marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve që rrjedhin nga martesa ose nga zgjidhja e saj (vendimet/masat e përkohshme dhe definitive të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës)⁸².

⁷⁶ Roppo, *Il Contratto*, fq. 7.

⁷⁷ Objekti i kontratës martesore është krijimi, ndryshimi ose shuarja e regjimit pasuror martesore. Për më tepër shiko: Omari, *E drejta familjare*, fq. 65.

⁷⁸ Dutta, Anatol. “Marital agreements and private autonomy in Germany.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 159.

⁷⁹ Ragazzini, Luigi. *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*. Rimini: Maggioli Editore, 1987, fq. 7.

⁸⁰ Omari, *E drejta familjare*, fq. 67.

⁸¹ Vendim i GJED C-143/78, 17 Mars 1979 “Jacques de Cavel vs Louise de Cavel. Të njejtin qëndrim GJED ka mbajtur edhe në çështjen C-25/81 “CHW vs CHW”, të 31 Mars 1982.

⁸² Për rrjedhojë, sipas GJED-së, vendimet gjyqësore për marrjen e masave të sigurimit të padisë (psh: mbi pasurinë bashkëshortore objekt pjestimi) në një gjykim të zgjidhjes së martesës nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Konventës së Brukselit të vitit 1968 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile”, për shkak se këto vendime gjyqësore janë të lidhura ngushtësisht me statusin e personit, konkretisht me regjimin pasuror, që rrjedh drejtpërdrejtë nga martesa. Shih: Bariatti, Stefania. *La famiglia nel diritto internazionale private comunitario*. Milano: Giuffrè Editore, 2007, fq. 538-539.

Kontratat martesore, në reformën e re të së drejtës familjare, meritojnë një vëmendje dhe trajtim të veçantë, sepse i japin të drejtën bashkëshortëve, si rregull i përgjithshëm, të zgjedhin një regjim pasuror që më mirë i përgjigjet interesave të tyre, ose të lejojnë zbatimin e normave ligjore, që rregullojnë regjimin ligjor të bashkësisë, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm⁸³.

Kodi i familjes, përveç regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, rregullon në mënyrë të detajuar dy regjime kontraktore:

- a) Regjimi i bashkësisë me kontratë;
- b) Regjimi i pasurive të ndara.

Raporti ndërmjet regjimit pasuror të bashkësisë ligjore dhe regjimit të pasurive të ndara është rregulluar nga parimi i sanksionuar në nenin 66 të kod.fam, sipas së cilit bashkësia ligjore gjen zbatim vetëm në mungesë të një regjimi kontraktor. Ky rregullim ligjor i jep një të drejtë të gjerë vendimmarrje bashkëshortëve, për të vendosur që marrëdhëniet e tyre pasurore të rregullohen nga një regjim pasuror kontraktor nga ata të rregulluar nga kod.fam, të lejojnë që marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre të rregullohen nga bashkësia ligjore duke mos zgjedhur një regjim kontraktor ose së fundi të vendosin me kontratë zbatimin e një regjimi pasuror origjinal të ndryshëm nga regjimet që gjejnë rregullim nga kod.fam⁸⁴.

Madje doktrina italiane shprehet që regjimi i bashkësisë ligjore (duke përfshirë regjimin e bashkësisë kontraktore) dhe regjimi i pasurive të ndara janë regjimet e vërteta pasurore të famijes dhe janë regjime ligjore, në kuptimin që të dy (tre) këto regjime gjejnë rregullim të shprehur në dispozitat e kodit të familjes⁸⁵.

Një autor italian bën klasifikimin e regjimit pasuror në kuptimin e ngushtë dhe regjimit pasuror në kuptimin e gjerë. Sipas tij në kuptimin “*strictu sensu*”, me regjimin pasuror gjithmonë kuptojmë regjimin e bashkësisë ligjore/kontraktore ose regjimin e pasurive të ndara ose një regjim tjetër kontraktor atipik. Sepse, vazhdon arsyetimin e tij i njejtë autor, nën titullin III të kod.fam. me emërtimin “regjimet pasurore martesore”, gjejnë rregullim vetëm regjimi i bashkësisë ligjore dhe regjimet e tjera kontraktore.

Lind pyetja, po marrëdhëniet e tjera pasurore që lindin midis bashkëshortëve gjatë martesës, por që nuk kanë lidhje me regjimin pasuror në kuptimin “*stricto sensu*” a do të përfshihen në kuadrin e konceptit të “*regjimit pasuror*”. Përgjigja, që jep i njejtë autor, është pozitive, sipas tij në kuptimin “*lato sensu*” në konceptin e regjimit pasuror do të përfshihen edhe të tjera marrëdhënie pasurore ndërmjet bashkëshortëve, si kontributi material i bashkëshortëve për nevojat e martesës dhe të familjes, të drejtat dhe detyrimet pasurore që lindin për shkak të zgjidhjes ose anulimit të martesës, përgjegjësia solidare për detyrimet që rrjedhin nga martesat etj⁸⁶.

Doktrina franceze dhe ajo italiane, si dhe doktrina e të gjitha vendeve të sistemit ligjor romano-gjermanik⁸⁷, bën një ndarje të të gjitha marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve në dy kategori⁸⁸:

⁸³ Në këtë këdvështrim regjim i bashkësisë ligjore, paraqitet një regjim përjshimor “*extra ordinem*”. Për më shumë shih: Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 153; Omari, *E drejta familjare*, fq. 70.

⁸⁴ Cassano, Giuseppe. “Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II, Il regime patrimoniale della famiglia.” në *Trattati*, P. Cendon, Milano: Giuffrè Editore, 2006, fq. 345.

⁸⁵ Russo, *Convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 181.

⁸⁶ Russo, *Convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 182-184.

⁸⁷ Ndërsa në vendet e familjes ligjore anglo-amerikane (common law) koncepti i regjimit pasuror martesor është i panjohur. Në këto shtete: Angli, Kanada (me përjashtim të tetë shteteve); lidhja e martesës nuk sjell asnjë ndikim mbi marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Këtë mungesë të organizimit mund ta quajmë si “*regjimi absolut i pasurive të ndara*”. Megjithatë edhe në këto shtete gjenden disa norma, të shpërndara në ligje të ndryshme, të cilat garantojnë mbrojtjen e banesës familjare apo të mbështetjes materiale ndërmjet bashkëshortëve. Për më shumë shih:

- a) **Regjimi primar i familjes**⁸⁹, i cili është i pashmangshëm dhe emërtohet si “*regjimi kontributiv*”. Regjimi primar gjen rregullim në Kreun I, të Titullit të II të kod.fam. nën emërtimin “*Të drejtat dhe detyrimet reciproke të bashkëshortëve*”, kre në të cilin përveç të drejtave dhe detyrimeve pasurore gjejnë rregullim edhe disa të drejta dhe detyrime të karakterit personal jopasuror. Konkretisht, nenet 53-65 të parashikuara në Kreun I, të Titullit të II të kod.fam., vendosin disa rregulla të përgjithshme, për rregullimin e disa interesave pasurorë të bashkëshortëve, të cilat janë të zbatueshme në mënyrë të detyrueshme për të gjithë bashkëshortët, pavarësisht regjimit të tyre pasuror martesor.
- b) **Regjimi sekondar i familjes**⁹⁰, i cili është i derogueshëm me anë të kontratës martesore dhe emërtohet ndryshe si “*regjimi distributiv*”. Regjimi pasuror sekondar gjen rregullim në Titullin e III të kod.fam. nën emërtimin “*regjimet pasuror martesore*”.

Megjithëse, normat e regjimit primar të familjes karakterizohen nga karakteri heterogjen i tyre, kanë një funksion të përbashkët atë të rregullimit të aspekteve bazë të bashkëjetesës në familje⁹¹. Tërësia e këtyre rregullimeve, përbën “*substrukturën*” e të gjitha regjimeve pasurore martesore sekondare⁹².

Regjimin primar mund ta përkufizojmë si “*grupi i normave të pashmangshme, të cilat rregullojnë mënyrën e funksionimit të jetës familjare, me qëllim ruajtjen e solidaritetit të grupit familjar*”⁹³.

Kriteret mbi bazën e të cilave niset doktrina italiane dhe ajo franceze, në realizimin e këtij klasifikimi, janë të ndryshme.

Në këtë mënyrë, doktrina italiane në dallimin e elementit distributiv dhe atij kontributiv, në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, niset nga karakteri i interesit që, secila kategori normash ka për qëllim të mbrojë. Kështu, sipas tyre, normat e regjimit primar kanë për qëllim garantimin e pjesëmarrjes ekonomike të secilit bashkëshortët në nevojat e familjes dhe mbarëvajtjen e jetës së përbashkët. Qëllimi i tyre është mbrojtja e unitetit dhe solidaritetit të familjes. Ndërsa nga ana tjetër, normat e regjimit sekondar përcaktojnë titullarët e pronësisë, të drejtën e gëzimit dhe rregullat e administrimit të pasurisë së fituar nga bashkëshortët gjatë martesës. Qëllimi i këtyre normave është mbrojtja e interesave pasurorë, të secilit bashkëshort, dhe jo më mbrojtja e interesave të tyre si pjesë e kolektivitetit të familjes⁹⁴.

Nga ana tjetër, duke ruajtur të njëjtin klasifikim, doktrina franceze bazohet mbi të tjera kriteret klasifikuese. Kriteri i përdorur nga doktrina franceze është ai i natyrës juridike të normave që rregullojnë regjimin primar dhe atë sekondar si dhe karakteri i shmangshëm apo jo i tyre, me marrëveshje të bashkëshortëve. Sipas autorëve francezë, normat e regjimit primar parashikojnë disa elementë të detyrueshëm dhe të përgjithshëm të të gjitha regjimeve pasurore dhe si të tilla

Droz, George A.L dhe Martin-Bosly, Bernadette. “*Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités.*” në *Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I*, M. Verwilghen, S. Mahieu (Ed.) Bruylant, Bruxelles, 2003, fq. 216.

⁸⁸ Caravaglios, Raffaele. “*La comunione legale II.*” në *Il diritto private oggi*, P. Cendon (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 1995, fq. 53.

⁸⁹ I njohur në doktrinën franceze si “*régime primaire*”, në atë italiane si “*regime primario*”, ndërsa në atë gjermane si “*ehewirkungen*”.

⁹⁰ Edhe ky term ashtu si ai i regjimit primar është huazuar nga doktrina franceze dhe ajo italiane, në të cilat njihet përkatësisht me termat “*régime secondaire*” / “*regime secundario*”, ndërsa në doktrinën gjermane njihet me emrin “*ehewirerstand*”.

⁹¹ Diago D., Maria del Pilar. *Pactos o Capitulaciones Matrimoniales en derecho Internacional Privado*. Zaragoza: El Justicia de Aragon Colecction, 1999, fq. 137.

⁹² Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 31.

⁹³ Trabucchi, Alberto. *Istituzioni di diritto civile*. Quarantesima edizione. Padova: CEDAM, 2001, fq. 7-8.

⁹⁴ Trabucchi, *Istituzioni di diritto civile*, fq. 7-8.

nuk mund të shmangen nga bashkëshortët, ndërsa normat e regjimit sekondar parashikojnë elementë opsionalë dhe të veçantë për çdo regjim pasuror dhe si të tilla i nënshtrohen vullnetit të bashkëshortëve⁹⁵.

Është e qartë që, ndërsa doktrina italiane bazohet në aspektin substancial të normave rregulluese të regjimit pasuror, ajo franceze bazohet në aspektin formal të tyre. Megjithatë, pavarësisht nga këndvështrimet e ndryshme, të dyja doktrinat kanë një pikë të përbashkët takimi ndërmjet tyre, faktin që, karakteri i pashmangshëm i normave të regjimit primar dhe karakteri i shmangshëm i atyre të regjimit sekondar, rrjedh pikërisht nga interesat që këto norma marrin në mbrojtje.

I gjithë diskutimi i realizuar më sipër na çon në një tjetër dilemë në lidhje me funksionin e kontratës martesore. Funksioni i saj është të rregullojë vetëm “regjimin pasuror” në kuptimin “*stricto sensu*”, pra të zgjedhë njërin prej regjimeve të parashikuara nga ligji ose një tjetër regjim atipik, apo ajo ka si funksion edhe rregullimin e të tjera marrëdhënies pasurore ndërmjet bashkëshortëve, të cilat më sipër i përfshijmë në regjimin pasuror të parë në kuptimin “*lato sensu*”⁹⁶.

Në përfundim të analizës së mësipërme, nxjerrim përfundimin që, objekti i kontratës martesore është rregullimi i regjimit pasuror martesor sekondar (*stricto sensu*), megjithëse në të njëjtin dokument me kontratën martesore mund të gjejmë pasqyrim edhe marrëveshjet për rregullimin e aspekteve personale jopasurore të jetës bashkëshortore ose marrëveshjet preventive të rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës ose dhurime ndërmjet bashkëshortëve, por këto marrëveshje paraqesin elementë karakterizues të veçantë për sa i përket kushteve të vlefshmërisë, në raport me kontratën martesore, për rrjedhojë një analizë e veçantë e secilës prej tyre është e nevojshme. Regjimi parimor përbëhet nga një grup rregullash, të cilat janë të dallueshme nga regjimi pasuror martesor. Në vijim të këtij punimi termi regjim pasuror martesor do të përdoret për t’iu referuar “*regjimit pasuror sekondar*”.

1.5. Përcaktimi i regjimit pasuror martesor

Në fillim duhet të theksojmë që, një nga risitë që ka sjellë kod. i ri i fam. është eliminimi i parimit të pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor, gjatë kohëzgjatjes së martesës. Të gjitha legjislacionet e mëparshme, duke përfshirë këtu edhe kod.civ. të 1929, ishin të bazuar në parimin e pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor.

Ndërsa, në legjislacionin e periudhës komuniste, bashkëshortëve nuk i ishte lejuar të vetërregullonin marrëdhëniet e tyre pasurore, por detyrueshmërisht zbatoheshin regjimi ligjor, që nga momenti i lidhjes së martesës dhe vazhdonte deri në përfundimin e saj.

Edhe në kod.civ. të vitit 1929, në të cilin bashkëshortët kishin të drejtën e vetërregullimit të marrëdhënies të tyre pasurore, nëpërmjet instrumentit të kontratës martesore, kjo e fundit mund të lidhej vetëm para lidhjes së martesës dhe nuk mund të ndryshonte në asnjë rast gjatë martesës. Justifikimi kryesor i pandryshueshmërisë së regjimit pasuror, ishte nga njëra anë garantimi i mbrojtjes së të tretëve, të cilët mund të kontraktonin me bashkëshortët gjatë martesës, dhe nga ana tjetër, mbrojtja e vetë bashkëshortëve, pasi mendohej që gjatë martesës, ndenjat e afeksionit të bashkëshortëve ndaj një-tjetrit, nuk mund të garantonin shprehjen e një vullneti real, serioz dhe të pavesuar nga ana e tyre.

Sot, në të gjitha legjislacionet e familjes ligjor romano-gjermanike, duke përfshirë edhe ligjin ton, janë hequr pengesat e ndryshimit të regjimit pasuror gjatë martesës dhe për rrjedhojë,

⁹⁵ Garofalo, Luciano. *I rapporti Patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale private*. Seconda Ed. Torino: Giappichelli Ed., 1997, fq. 8.

⁹⁶ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 185.

regjimi pasuror martesor i është nënshtruar parimit të ndryshueshmërisë, gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Sipas doktrinës⁹⁷, dy janë mënyrat e përcaktimit të regjimit pasuror martesor: a) përcaktimi ligor dhe b) përcaktimi vullnetar i regjimit pasuror martesor.

1.5.1. Përcaktimi ligor i regjimit pasuror

Bazuar në nenet 66 dhe 73 të kod.fam, në mungesë të një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve (kontrata martesore), për rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre, do të gjejë zbatim regjimi pasuror i përcaktuar nga kod.fam, regjimi i bashkësisë ligjore.

Regjimi i bashkësisë ligjore, është konsideruar nga ligjvënësi shqiptar, si regjimi më i përshtatshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, sepse është parë si regjimi pasuror, që më mirë garanton barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve gjatë martesës, jo vetëm duke vendosur sistemin e bashkëpronësisë mbi pasurinë e fituar nga secili bashkëshort gjatë martesës⁹⁸, por edhe nëpërmjet vendosjes së barazisë në administrimin e kësaj pasurie, nëpërmjet sistemit të administrimit konkurrent⁹⁹, të parashikuar nga neni 90 i kod.fam. Regjimi i bashkësisë ligjore, gjithashtu, garanton një njohje dhe vlerësim të barabartë jo vetëm të kontributit monetar të bashkëshortëve në fitimin e pasurisë gjatë martesës, por edhe të kontributit në natyrë, në drejtim të aktivitetit shtëpiak dhe rritjes dhe edukimit të fëmijëve, duke prezumuar në mënyrë absolute se ky kontribut ka bërë të mundur fitimin e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, gjatë martesës¹⁰⁰.

Bazuar në kushtet shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë në kohën e hartimit të kod.fam, në pozitën e gruas në shoqëri dhe në faktin që në pjesën më të madhe të rasteve gruaja kontributin, gjatë martesës, e jep në natyrë nëpërmjet kryerjes së të gjitha atyre veprimeve që sjellin evitimin e shpenzimeve në familjes, ligjvënësi e pa të arsyeshme rregullimin e regjimit pasuror ligjor të bashkëshortëve, në formën e një regjimi bashkëpronësie (bashkësia ligjore), megjithëse një regjim i ridimensionuar¹⁰¹ për sa i përket objektit, në raport me regjimin e bashkëpronësisë, së parashikuar në Kodin Civil të vitit 1981 (neni 86). Me miratimin e kod.fam, ndryshimi i regjimit ligjor, nga një regjim bashkëpronësie në një regjim pasuror diametralisht të kundërt me të (regjimi i pasurive të ndara, regjimi i pjesëmarrjes në fitime), do të shoqërohej në mënyrë të paevitueshme me pasoja serioze, jo vetëm juridike, por edhe ekonomike e sociale, për bashkëshortët dhe për të tretët¹⁰². Regjimi i bashkësisë ligjore siguron ndarjen në mënyrë të barabartë ndërmjet bashkëshortëve të shtimit që pasuria e tyre ka pësuar gjatë martesës, si pasojë e bashkëpunimit dhe kontributit të tyre të përbashkët, duke vlerësuar në mënyrë të barabartë si kontributin material ashtu edhe atë në natyrë¹⁰³.

Mendimi i doktrinës është shoqëruar nga kontradikta klasike mbi natyrën juridike të regjimit të bashkësisë ligjore. Sipas një pjese të doktrinës, zbatimi i regjimit pasuror të bashkësisë, në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, vjen si rrjedhojë e vullnetit të bashkëshortëve për të mos përcaktuar, në marrëveshje ndërmjet tyre, një tjetër regjim pasuror

⁹⁷ Flour, Jacques dhe Champenois, Gérard. *Le régimes matrimoniaux*. Paris: Armand Colin Ed., 1995, fq 135; Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 115.

⁹⁸ Pasuria prezumohet nga ligji e fituar me kontributin e përbashkët të të dy bashkëshortëve.

⁹⁹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 136.

¹⁰⁰ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 108-109.

¹⁰¹ Për më shumë, në drejtim të dallimeve ndërmjet regjimit të bashkësisë ligjore të rregulluar në kod.fam. dhe regjimit të bashkëpronësisë së bashkëshortëve, të rregulluar në Kodin Civil, të vitit 1981, shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 106-107.

¹⁰² Omari, *E drejtë familjare*, fq. 108-109.

¹⁰³ Trabucchi, *Istituzioni di diritto civile*, fq. 303.

martesor, pra përbën një **“kontratë të heshtur”**¹⁰⁴. Ndërsa sipas pjesës tjetër të doktrinës, megjithëse në planin tekstual, leximi *“expressis verbis”* i neneve 66 dhe 73 të kod.fam., mund të na çojnë në përfundimin që, bashkësia ligjore përbën një kontratë të heshtur, në planin racional ky përfundim është i papranueshëm, sepse regjimi ligjor i bashkësisë nuk përfaqëson një kontratë të heshtur martesore, por përkundrazi, përfaqëson një nga efektet ligjore të martesës¹⁰⁵.

Në mbështetje të mendimit të grupit të dytë të autorëve, i cili na duket mendimi më racional, mund të sjellim dy argumente: *së pari*, në një pjesë të madhe të rasteve, bashkëshortët nuk janë në dijeni të mundësisë së tyre për të vetërregulluar marrëdhëniet pasurore, e për rrjedhojë nuk ka vend të flasim për vullnetin e tyre për t’iu nënshtruar regjimit ligjor; *së dyti*, regjimi i bashkësisë ligjore zbatohet automatikisht në eventualitetin e pavlefshmërisë së kontratës martesore, pavarësisht vullnetit të bashkëshortëve¹⁰⁶.

1.5.2. Përcaktimi vullnetar i regjimit pasuror

Në bazë të parimit të lirisë së kontratës martesore, parim, i cili siç do të shikojmë më poshtë, nuk është absolut, bashkëshortët janë të lirë të përcaktojnë me vullnetin e tyre, regjimin juridik, që do të rregullojë marrëdhëniet pasurore, gjatë martesës, i njohur me termin, regjim pasuror martesor. Instrumenti ligjor (veprimi juridik) nëpërmjet së cilit manifestohet vullneti i bashkëshortëve, në drejtim të përcaktimit të regjimit pasuror, është **“kontrata martesore”**.

Bazuar në interpretimin e nenit 66 dhe 73 të kod.fam., rregullimi kontraktor i regjimit pasuror martesor, përfaqëson rregullin e përgjithshëm, ndërsa si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, do të zbatohet regjimi kontraktor, nëse palët (bashkëshortët) nuk kanë lidhur kontratë martesore, kontrata martesore është e pavlefshme ose kanë lidhur kontratë vetëm për një pjesë të pasurisë së tyre¹⁰⁷.

Parimin e lirisë së kontratës martesore, do ta shikojmë në dy aspekte: a) në aspektin e lirisë së përcaktimit lirisht të regjimit pasuror martesor dhe b) në aspektin e kufizimeve të lirisë së kontratës martesore, liri e cila, siç theksuam më sipër nuk është absolute, por i nënshtrohet një seri kufizimesh ligjore.

Në drejtim të zgjedhjes së lirë të regjimit pasuror martesor, alternativat që paraqiten për bashkëshortët janë:

- a) Zgjedhja e një prej regjimeve pasurore të parashikuara në kod.fam.;
- b) Kombinimi i klauzolave të regjimeve të ndryshme pasurore të parashikuara nga kod.fam., kombinime të cilat janë të shumta;
- c) Zgjedhja e një regjimi pasuror atipik, të ndryshëm nga modelet e ofruara nga kod.fam.;
- d) Modifikimi i regjimeve ligjore tipike, të rregulluara nga kod.fam.
- e) Rregullimi në kontratën martesore, të tjerë marrëdhënies pasurore të bashkëshortëve, përveç regjimit pasuror martesor, si psh: dhurimet ndërmjet bashkëshortëve, kontributi material për nevojat e familjes, mandati i përfaqësimit për administrimin e pasurisë etj. Këto marrëveshje janë emërtuar nga doktrina si **“Marrëveshje aneks të kontratës martesore”**¹⁰⁸.

Liria e bashkëshortëve në zgjedhjen e regjimit pasuror martesor, i nënshtrohet kufizimeve ligjore të parashikuara nga dispozitat e kod.civ. mbi kontratat në përgjithësi¹⁰⁹, si dhe kufizimeve të

¹⁰⁴ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 136.

¹⁰⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 136.

¹⁰⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 137.

¹⁰⁷ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 109.

¹⁰⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 143.

¹⁰⁹ Bazuar në nenin 660 të kod.civ *“Palët kanë të drejtë të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e kontratës, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji”*.

parashikuara nga kod.fam. të cilat ndahen në dy grupe: a) kufizime të përgjithshme, të cilat janë të vlefshme për çdo regjim pasuror martesor, ku mund të përmendim kufizimet e vendosura nga regjimi primar dhe ato të drejtat e pashmangshme të parashikuara nga neni 67 i kod.fam, të cilat janë parime të rendit publik; b) kufizimet e posaçme, të parashikuara nga ligji për çdo regjim pasuror martesor¹¹⁰.

1.6. Kufizimet e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve

Bazuar në interesin publik që ka familja dhe martesë për shoqërinë, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve kufizohet nga dy palë norma urdhëruese, normat e kod.civ. dhe ato të kod.fam, çka sjell një ndrydhje më të madhe të autonomisë së bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve martesore, në raport me autonominë e gjerë që gëzojnë palët në rregullimin e marrëdhënieve pasurore jomartesore. Superioriteti i interesave të familjes mbi interesat e individëve, që e përbejnë atë, ka sjellë si pasojë prezencën në kod.fam. të normave urdhëruese, që i shërbejnë mbrojtjes së këtij interesi, norma të cilat nuk e përjashtojnë vullnetin e individëve, por vetëm e kufizojnë atë¹¹¹.

Kod.fam. parashikon një tërësi të drejtash dhe detyrimesh të bashkëshortëve, si të karakterit pasuror ashtu edhe të atij personal jopasuror, të cilat nuk mund të shmangen dhe as të ndryshohen me marrëveshje të palëve. Për rrjedhojë, konsiderohen të pavlefshme të gjitha ato klauzola kontraktore, nëpërmjet të cilave bashkëshortët ndryshojnë mënyrën e rregullimit ose shmangin zbatim e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë¹¹², rregullimit ligjor të përgjegjësisë prindërore, rregullat ligjore të administrimit të bashkësisë ligjore dhe të kujdestarisë. Këtu bëjnë përjashtim ato të drejta dhe detyrime për të cilat kod.fam. i ka lënë bashkëshortëve një liri vetërregullimi. Mund të përmendim këtu të drejtën e bashkëshortëve për të rregulluar me marrëveshje vendbanimin e përbashkët, mbiemrin që ata dhe fëmijët e tyre do të mbajnë gjatë martesës dhe modalitetet e përmbushjes së kontributit material¹¹³.

Në lëmin e të drejtave pasurore, është e pavlefshme çdo klauzolë kontraktore, e cila parashikon shmangien e njërit apo të të dy bashkëshortëve nga detyrimi i kontributit material, por nga ana tjetër bashkëshortët kanë liri të plotë në rregullimin e modaliteteve të përmbushjes së këtij detyrimi, si mënyrës, sasisë, kohëzgjatjes. Të dy bashkëshortët, pavarësisht nga lloji i regjimit pasuror, kanë detyrimin për të kontribuar materialisht për nevojat e familjes, sipas marrëveshjes së tyre, ose në mungesë të një marrëveshje kontributi realizohet nga secili në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre. Parimi i kontributit në përputhje me **“kushtet dhe aftësitë”** e secilit bashkëshort është quajtur ndryshe nga doktrina si **“parimi i barazisë së ponderuar”**¹¹⁴ të detyrimeve materiale, parim i cili vlerëson në mënyrë të barabartë të gjitha format e kontributit material, të secilit bashkëshort, në familje¹¹⁵, duke vlerësuar si të barabartë si aktivitetin profesional ashtu dhe atë shtëpiak.

¹¹⁰ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 139.

¹¹¹ Oberto, *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilità e fattispecie*, fq. 136-137.

¹¹² Për më tepër, në nenin 65 të Kodit të Familjes është parashikuar që, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve të cilat janë të parashikuara nga Kreu I, i Titullit të II këtij kodi, do të zbatohen pavarësisht nga regjimi pasuror që kanë zgjedhur bashkëshortët.

¹¹³ Diskutime në literaturën juridike ka edhe në drejtim të detyrimit të besnikërisë bashkëshortore. Ka një qëndrim sot të doktrinës, sipas së cilit, bashkëshortët janë të lirë të rregullojnë me marrëveshje midis tyre edhe detyrimin e besnikërisë bashkëshortore, madje mund të shmangen nga zbatimi i këtij detyrimi. Nëse lexojmë të kombinuara ndërmjet tyre nenin 50, paragrafi 2 dhe nenin 65, besnikëria bashkëshortore shfaqet si një element i detyrueshëm ligjor, zbatim i të cilit rrjedh *“ex lege”* që me lidhjen e martesës, pa qenë i nevojshëm rregullimi i palëve si dhe një detyrim i pashmangshëm.

¹¹⁴ Ose parimi i “barazisë proporcionale”.

¹¹⁵ Patti dhe Cubeddu, *Diritto della famiglia*, fq. 170-171.

Parashikimi i këtij detyrimi si të pashmangshëm është në funksion të parimit të unitetit të familjes dhe solidaritetit bashkëshortor. Bashkëshortët mund të rregullojnë me marrëveshje, qoftë një marrëveshje e veçantë ose në kontratën martesore, proporcionalitetin e përmbushjes së këtij detyrimi, në përputhje me kushtet ekonomike të secilit prej tyre, por nuk munden, në asnjë rast, të përjashtojnë veten ose njërin prej tyre nga detyrimi i përmbushjes së kontributit material. Shtrohet pyetja, nëse është shkelje e parimit të pashmangshmërisë, nëse bashkëshortët bien dakord që për një periudhë të përcaktuar kohe të kontribuojë vetëm njëri nga të dy bashkëshortët dhe më pas në një periudhë të dytë, vetëm bashkëshorti tjetër. Disa autorë mbajnë qëndrimin që, në lidhje me kontributin material, elementi i pashmangshëm është vetëm reciprociteti i përmbushjes së këtij detyrimi nga bashkëshortët, dhe një marrëveshje e tillë, nuk do të ishte në shkelje të këtij parimi¹¹⁶.

Duke qëndruar sërish në lëmin e detyrimeve pasurore, bashkëshortët nuk mund të shmangin rregullat e administrimit të bashkësisë ligjore, ashtu siç do të shikojmë në vijim të këtij punimi, bashkëshortët mund të parashikojnë që të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe jo të zakonshëm, të pasurisë së bashkësisë ligjore, të kryhen me pëlqimin reciprok të të dy bashkëshortëve, por është e ndaluar të parashikojnë të kundërtën, domethënë që të gjitha veprimet e administrimit të bashkësisë ligjore, si veprimet e administrimit të zakonshëm ashtu dhe ato të administrimit jo të zakonshëm, të kryhen me pëlqimin e vetëm njërit bashkëshort, pa qenë i nevojshëm pëlqimi i bashkëshortit tjetër¹¹⁷.

Për të përmbledhur sa u tha më sipër, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e përmbajtjes së marrëdhënies martesore e gjen kufizimin e saj në dispozitat 65 dhe 67 të kod.fam. Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton, që të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve rrjedhin *ex lege*, pra për shkak të parashikimit nga ligji (që nga momenti i lidhjes së martesës)¹¹⁸, bashkëshortët nuk është e nevojshme t'i rregullojnë këto të drejta dhe detyrime me marrëveshje midis tyre, por nga ana tjetër ata nuk mund të përjashtojnë zbatimin e tyre apo të ndryshojnë përmbajtjen, me përjashtim të rasteve kur vetë norma ligjore i jep atyre një liri të tillë.

Në lidhje me nenin 67 të kod.fam, diskutimi që, ka përfshirë prej kohësh doktrinën, është nëse termi "*pamundësia e bashkëshortëve për të përjashtuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për ta nga martesja*", i referohet vetëm të drejtave dhe detyrimeve me karakter pasuror apo edhe atyre me karakter personal jopasuror.

Një pjesë e doktrinës mban qëndrimin që, neni 67 i kod.fam.i referohet vetëm të drejtave dhe detyrimeve me përmbajtje pasurore, sepse sipas saj nuk është e lejuar të rregullohen me kontratë martesore të drejta dhe detyrime me përmbajtje personale jopasurore. Kështu, vazhdojnë mendimin e tyre këta autorë, neni 67 i referohet kontributit për nevojat e familjes dhe bashkëjetesës dhe kontributit material për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, detyrime të cilat janë të pashmangshme¹¹⁹.

Ndërsa, pashmangshmëria e të drejtave dhe detyrimeve personale jopasurore e gjen bazën e saj ligjore në nenin 65 të kod.fam, i cili parashikon që, dispozitat e kreut I të titullit të II të kod.fam (ato që rregullojnë marrëdhëniet personale jopasurore) zbatohen pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve.

Arsyetimin që kemi dhënë deri tani e mbështet edhe vetë struktura e kod.fam, në të cilën neni 65 është përfshirë në Kreun e I, të Titullit të dytë (të drejtat dhe detyrimet reciproke të

¹¹⁶ De Nova, Giorgio. "Disciplina inderogabile dei rapporti patrimoniali e autonomia negoziale." në *Studi in onore di Pietro Rescigno I*, Persone, famiglia, successioni e proprietà, Milano: Giuffrè Editore, 1998, fq. 261.

¹¹⁷ Omari, E drejtë familjare, fq. 114.

¹¹⁸ Kujtojmë këtu që, momenti i lidhjes së martesës është momenti kur nëpunësi i gjendjes civile i shpall bashkëshortët të martuar në emër të ligjit.

¹¹⁹ Oberto, *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilità e fattispecie*, fq. 149.

bashkëshortëve), kurse neni 67 është përfshirë në Kreun II të Titullit të II (regjimet pasurore martesore).

1.7. Regjimi pasuror primar si kufizim i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve

1.7.1. Raporti ndërmjet regjimit pasuror martesor primar dhe atij sekondar

Rregullat e regjimit primar janë hartuar në mënyrë të tillë që të vendosin një ekuilibër ndërmjet solidaritetit të bashkëshortëve dhe ruajtjes së pavarësisë së tyre gjatë martesës. Mund të vërejmë që, ligjvënësi ka parashikuar disa të drejta dhe detyrime të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e këtij solidariteti, ndërmjet bashkëshortëve, si: pëlqimi i përbashkët në disponimin e banesës familjare (neni 57), kontributi material për nevojat e familjes (neni 54), detyrimet solidare për mbarëvajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve (neni 60), por nga ana tjetër, ligjvënësi ka parashikuar të tjera norma të cilat ruajnë dhe garantojnë pavarësinë e bashkëshortëve si: ushtrimi i lirë i profesionit (neni 63), disponimi i lirë i të ardhurave që rrjedhin nga puna (neni 63), apo administrimi dhe tjetërsimi i lirë i sendeve vetjake (neni 64).

Regjimi primar merr një rëndësi të veçantë në hipotezën e regjimit të pasurive të ndara, aty ku pavarësia e pasurore e bashkëshortëve është maksimale. Megjithëse nga njëra anë, mund të duket që regjimi primar është një kundërshtim me logjiken e regjimit të pasurive të ndara, nga ana tjetër, pavarësia absolute pasurore e bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara, që mund të krijohej në mungesë të rregullave të regjimit primar, është në kundërshtim me vetë thelbin e martesës¹²⁰.

Në ndryshim nga regjimet pasuror martesore, regjimi primar i familjes, ka karakter heterogjen¹²¹, pasi vendos për bashkëshortët një tërësi të drejtash dhe detyrimesh mjaft të ndryshme ndërmjet tyre.

Këto të drejta dhe detyrime të bashkëshortëve, janë të një rëndësie të veçantë për shkak të tre tipareve që i karakterizojnë¹²²:

a) Në radhë të parë ato janë **“parimet të rendit publik”**.

Të drejtat dhe detyrimet e përmendura më sipër, si dhe të gjitha të drejta dhe detyrimet e tjera të parashikuara në kreun I, titulli II I kod.fam, rrjedhin *“ex lege”*, automatikisht për bashkëshortët që nga çasti i lidhjes së martesës dhe zbatohen pavarësisht nga regjimi pasuror martesor.

Regjimi primar është rregulluar me dispozita urdhëruese të cilat janë të pashmangshme, dhe të detyrueshme për bashkëshortët. Çdo marrëveshje nëpërmjet së cilës bashkëshortët përjashtojnë zbatimin e regjimit primar apo të detyrimeve të caktuara të regjimit primar është e pavlefshme. Në lidhje me natyrën juridike të normave të regjimit primar ka debate në doktrinë. Nëse tradicionalisht normat e regjimit primar janë konsideruar si pjesë e rendit publik, në ditët e sotme, doktrina mbështet klasifikimin e normave të regjimit primar në kategorinë e *“jus cogens”*¹²³. Megjithatë, në raste të veçanta vetë ligji i ka njohur bashkëshortëve, mundësinë e rregullimit me marrëveshje, të këtyre të drejtave dhe detyrimeve, por në asnjë rast shmangien e zbatimit të tyre.

b) Së dyti, rregullat e regjimit primar janë **“dispozita të përgjithshme”**.

¹²⁰ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 50.

¹²¹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 50.

¹²² Për më shumë, rreth tipareve që karakterizojnë regjimin primar të familjes, shih: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 31-32.

¹²³ Pintens, Walter. “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 71.

Më këtë kuptojmë që, këto rregulla zbatohen për të gjithë personat e martuar dhe kanë përparësi mbi çdo regjim pasuror martesor¹²⁴, të cilit i nënshtrohen bashkëshortët. Megjithëse dispozitat e regjimit primar vendosin rregulla të përgjithshme, ato do të zbatohen me përparësi, në raport me rregullat specifike të regjimit pasuror martesor, qoftë ky regjim ligjor apo kontraktor¹²⁵.

c) Së fundi, **“pjesa më e madhe e tyre kanë një rëndësi të madhe praktike”**.

Rëndësia praktike rrjedh nga zbatimi i tyre në jetën e përditshme të bashkëshortëve dhe të familjes. Ndërsa dispozitat që kanë për objekt rregullimin e regjimeve pasurore martesore dhe kontratën martesore, gjejnë zbatim më rrallë, në situata të caktuara, dispozitat e regjimit primar gjejnë zbatim në përditshmërinë e jetës së bashkëshortëve.

Pjesa më e madhe e doktrinës për të identifikuar këtë tërësi të drejtash dhe detyrimesh të karakterit pasuror, dhe për t'i dalluar ato nga regjimi pasuror martesor, përdorin termin **“regjimi primar i familjes”**¹²⁶. Ndërsa një pjesë tjerët e doktrinës nuk është shumë e kënaqur me përdorimin e termit **“regjim primar”**, por në vend të tij, për të identifikuar tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të përmendura më sipër, përdor termin **“statuti bazë i detyrueshëm”**¹²⁷.

Pavarësisht karakterit heterogjen të tyre, dispozitat e Kreut I, të Titullit të II të kod.fam. që, përbëjnë **“regjimin primar të familjes”**, duke marrë si kriter objektin e rregullimit të tyre, mund t'i klasifikojmë në tre grupe¹²⁸:

- a) Dispozitat që rregullojnë **“kontributin”** në familje, ku përfshihen: mbrojtja e banesës familjare (neni 55 dhe 57), kontributi material për nevojat e familjes (neni 54) dhe përfaqësimi ndërmjet bashkëshortëve (neni 59).
- b) Dispozitat që rregullojnë **“pavarësinë e bashkëshortëve”** në raport me njëri-tjetrin, të tilla si: ushtrimi i lirë i profesionit, disponimi i të ardhurave nga puna (neni 63) dhe administrimi i sendeve vetjake (neni 64);
- c) Dispozitat që rregullojnë **“mosmarrëveshjet ndërmjet bashkëshortëve”**, të tilla si: mosmarrëveshjet mbi zgjedhjen e vendbanimit (neni 55/4,3); largimi nga vendbanimi (neni 56); masat urgjente (neni 61) dhe masat kundër dhunës në familje (neni 62).

Të njëjtin rregullim ligjor të regjimit primar e gjejmë prezent edhe në KC Francez dhe BGB Gjerman, ndërsa në KC Italian regjimi primar është më i kufizuar duke mos parashikuar asnjë dispozitë mbi kufizimin e së drejtës së tjetërsimit të banesës familjare nga bashkëshorti pronar¹²⁹. Mbrojtja e banesës familjare nga veprime abuzive të njërit bashkëshort është trajtuar edhe nga Këshilli i Europës¹³⁰, i cili adoptuar një rekomandim, duke i kërkuar qeverive të shteteve anëtare

¹²⁴ Në bazë të nenit 65 të kod.fam **“Zbatimi i dispozitave të këtij kreu rrjedh nga martesja dhe zbatohet pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve”**.

¹²⁵ Në këtë rast kemi një shmangie nga parimi klasik i së drejtës **“specialia generalibus derogant”**. Për këtë shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 48-49.

¹²⁶ Në fakt, termi regjim primar nuk ndeshet në asnjë dispozitë të Kodit të Famijes, por është një term i përdorur gjërësisht nga doktrina franceze dhe ajo italiane. Caravaglios, Raffaele. **“La comunione legale II.”**; Vettori, Giuseppe. **“Il dovere coniugale di contribuzione.”** në *Il regime patrimoniale della famiglia*, në *Il diritto di famiglia*, G. Bonilini, G. Cattaneo, Torino: UTET, 1997, fq. 2. Termi përmendet edhe në Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*.

¹²⁷ Këtë term e gjejmë prezent në doktrinën franceze **“le statut impératif de base”**. Për më shumë shih: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 32.

¹²⁸ Për klasifikimin e dispozitave të regjimit primar, shih: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 42.

¹²⁹ Sesta, Michele. dhe Valiagni B. **“Il regime di separazione di beni.”** në *Regime patrimoniale della famiglia*, F.Anelli, M. Sesta (Eds.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P.Zatti (Ed.). Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq. 569; Oberto, Giacomo. **“Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.”** në *Il Codice Civile. Commentario fondato da Schlesinger, P., D. Busnelli (Ed.)*, Milano: Giuffrè Editore, 2005, fq. 14.

¹³⁰ Recommendation of Council of Europe, No. R (81)15, of the Committee of Ministers to Member States on the rights of the spouses relating to the occupation of the family home and the use of the household contents.

të marrin masa “për t’i siguruar bashkëshortëve përdorimin e banesës familjare dhe përdorimin e mobilieve dhe objekteve të saj, që kanë si destinacion përdorimin familjar.

Në këtë pjesë të punimi, gjykojmë të arsyeshme të ndalemi në tre elementë të rëndësishëm të regjimit primar: përcaktimi dhe mbrojtja e vendbanimit të familjes; kontributi material për nevojat e familjes dhe pavarësia e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetri, gjatë martesës.

1.7.2. Mbrojtja e vendbanimit familjar

Kod.fam. i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbrojtjes së vendbanimit të familjes, në dy dispozita të veçanta, neni 55 dhe neni 57, të cilat rregullojnë zgjedhjen e vendbanimit të familjes dhe disponimin e këtij vendbanimi.

Leximi i këtyre dy dispozitave ilustron lidhjen e ngushtë që, ekziston ndërmjet pasojave personale jopasurore dhe pasojave pasurore të martesës.

Mbrojtja e vendbanimit të familjes, megjithëse bazohet mbi një të drejtë të karakterit pasuror, përfaqëson një vlerë ekstrapasurore, që bazohet në interesin që, shoqëria ka në mbarëvajtjen e familjes dhe rritjen e edukimin e fëmijëve¹³¹.

Neni 57 i kod.fam, kërkon pëlqimin e të dy bashkëshortëve për të gjitha veprimet juridike të disponimit të banesës familjare, pavarësisht regjimit pasuror martesor, të cilit i janë nënshtruar bashkëshortët dhe pavarësisht faktit nëse banesa është në pronësi vetjake të njërit apo të të dy bashkëshortëve.

1.7.2.1. Përcaktimi i vendbanimit të bashkëshortëve

Bazuar në nenin 55 të kod.fam, vendbanimi i familjes është vendi që, bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Përcaktimi i një vendbanimi të përbashkët, përfaqëson një shembull tipik të asaj që tradicionalisht është kuptuar si një kufizim i lirisë personale, që rrjedh prej martesës.

Leximi i nenit 55 të kod.fam. shtron një seri pyetjesh për diskutim, në lidhje me natyrën juridike të marrëveshjes së bashkëshortëve, objektin e saj si dhe në lidhje me justifikimin e ndërhyrjes së gjykatës në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së bashkëshortëve, në përcaktimin e vendbanimit. Gjithashtu i paqartë mbetet përcaktimi i limiteve të veprimtarisë së gjykatës, në gjetjen e zgjidhjes që ajo konsideron më të përshtatshme për interesat e familjes. A është e mundur që gjykata t’i imponojë vullnetin e saj bashkëshortëve, dhe nëse po, a është i mundur ekzekutimi i një vendimi të tillë gjyqësor.

A. Marrëveshja e bashkëshortëve për përcaktimin e vendbanimit të familjes. Rregulli i përgjithshëm, i vendosur nga neni 55/2 i kod.fam, në lidhje me përcaktimin e vendbanimit të familjes, është rregulli i marrëveshjes së palëve. Duke cituar “*expressis verbis*” tekstin e nenit 55, mund të përkufizojmë vendbanimin e familjes si banesa që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët.

Megjithëse ligji i ka dhënë një diskrecion të gjerë bashkëshortëve për përcaktimin e vendbanimit të familjes, është e kuptueshme që ky diskrecion do të kufizohet nga interesi i familjes. Megjithatë, secili bashkëshort nuk është i lirë të përcaktojë vendbanimin e tij, sipas nevojave individuale, por duhet të arrijë në një përputhje me mirëkuptim, të nevojave të tij me ato të bashkëshortit tjetër dhe të fëmijëve¹³².

¹³¹ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 50.

¹³² Patti dhe Cubeddu, *Diritto della famiglia*, fq. 139.

Bashkëshortët mund të vendosin që, për një kohë të caktuar të jetojnë në vendbanime të ndryshme, për shkak të zhvillimit të aktivitetit profesional apo të studimeve, të njërit prej tyre, në një rezidencë të ndryshme nga ajo e caktuar si banesë familjare, mjafton që ata të mos ndërpresin jetesën e përbashkët¹³³.

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në mungesë të arritjes së marrëveshjes për caktimin e vendbanimit të përbashkët, secili prej tyre mund t'i drejtohet gjykatës, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

B. Ndërhyrja e gjykatës. *Së pari*, megjithëse nga njëra anë, është e vështirë të kuptohet dhe pranohet, për rendin tonë juridik, ndërhyrja e gjykatës në zgjedhjen e vendbanimit familjar, nga ana tjetër kjo ndërhyrje është e justifikuar me mbrojtjen e unitetit të familjes, si një tentativë për të evituar prishjen e unitetit familjar dhe zgjidhjen e martesës¹³⁴. Sipas mendimit mbizotërues të doktrinës, gjykata, në marrjen e një vendimi, duhet të veprojë në mënyrë të paanshme dhe funksioni i gjykatës nuk është një funksion i mirëfilltë juridiksional, por është më shumë një funksion arbitri. Gjithashtu, një pjesë e doktrinës mban qëndrimin që, megjithë fuqinë detyruese që ka një vendim gjyqësor, në këtë rast bashkëshortët, nëse janë të pakënaqur nga vendimi i gjykatës, kanë të drejtë që me marrëveshje të vendosin moszbatimin e tij.¹³⁵ Gjithashtu, edhe nëse njëri nga bashkëshortët nuk është dakord me vendimin e marrë nga gjykata, ka të drejtë të mos e zbatojë atë dhe në këtë rast nuk mund të zbatohen dispozitat e ekzekutimit të detyrueshëm të një vendimi gjyqësor, sepse në funksion të parimit kushtetues të lirisë personale askush nuk mund të ndalohej apo të detyrohet të jetojë në një vend të caktuar, përveçse si pasojë e një vendimi penal. Pasoja e vetme që mund të sjellë mungesa e zbatimit të vendimit të gjykatës, nga njëri bashkëshort, është e drejta e bashkëshortit tjetër për të kërkuar zgjidhjen e martesës¹³⁶.

1.7.2.2. Ndalimi i disponimit të banesës familjare

Neni 57 i kod.fam. përbën një përjashtim nga parimet e pronësisë, pasi parashikon privimin e pronarit nga e drejta e disponimit të sendit të tij, përjashtim që gjen justifikimin ligjor në rëndësinë thelbësore që mbart banesa familjare për mbarëvajtjen e familjes.

Duke pasur në konsideratë që kufizimi i disponimit të banesës familjare përbën një përjashtim nga parimet e pronësisë së garantuara nga kod.civ. dhe duke pasur parasysh faktin që, në pjesën më të madhe të rasteve në praktikë, banesa familjare përfaqëson të vetmin send në pronësi të bashkëshortëve, mbrojtja që neni 57 i kod.fam. i jep banesës familjare duhet të realizohet brenda kufizimeve të nevojshme, që kanë për qëllim mbarëvajtjen e jetës familjare¹³⁷.

A. Fusha e zbatimit. Neni 57/1 i kod.fam. parashikon *expressis verbis* që, objekti material i zbatimit të normës është **“banesa bashkëshortore”**.

Sipas doktrinës, banesa bashkëshortore është vendbanimi ku familja jeton efektivisht, vendbanimi ku zhvillohet pjesa më e madhe e jetesës së përbashkët¹³⁸, duke përfshirë edhe pajisjet e mobilimit të saj.

Bazuar në nenin 55/2 të kod.fam, banesa familjare është vendbanimi që bashkëshortët kanë zgjedhur me marrëveshje të përbashkët, vendi ku zhvillohet pjesa më e madhe e jetesës familjare.

¹³³ Për një dallim ndërmjet koncepteve të jetesës së përbashkët dhe vendbanimit të përbashkët të bashkëshortëve shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 115.

¹³⁴ Anelli, Franco. “Sul’esplicazione dell’autonomia privata nel diritto matrimoniale.” fq. 27.

¹³⁵ Patti dhe Cubeddu, *Diritto della famiglia*, fq. 143.

¹³⁶ Patti dhe Cubeddu, *Diritto della famiglia*, fq. 143.

¹³⁷ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 33-34.

¹³⁸ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 35.

Banesat e tjera në pronësi të bashkëshortëve, nuk mund të jenë objekt i zbatimit të nenit 57, megjithëse në to mund të zhvillohet një pjesë e jetës së përbashkët të familjes¹³⁹, siç mund të jetë për shembull rezidenca ku familja kalon pushimet.

Gjithashtu, duhet të theksojmë që, objekt i zbatimit të nenit 57 është banesa ku jeton familja bashkëshortore, bashkëshortët së bashku me fëmijët e tyre. Norma nuk mund të gjejë zbatim për të tjerë persona me lidhje gjaku ndërmjet tyre, që jetojnë në të njëjtin vendbanim si psh: vëllezërit dhe motrat. Paragrafi i parë i nenit 57 përdor *expressis verbis* termin “*banesë bashkëshortore*”.

Në paralelizëm me nenin 55 të kod.fam., në të cilin gjejmë termin “*vendbanim i familjes*”, jemi të mendimit që, dispozitat në fjalë, neni 55 dhe 57 do të ishte më saktë të përdorin të njëjtën terminologji.

Në lidhje me objektin personal të zbatimit të nenit 57, është e kuptueshme që, janë vetëm bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të mitur. Norma nuk mund të zbatohet për bashkëshortët që, megjithëse kanë zgjidhur martesën, vazhdojnë të jetojnë së bashku në të njëjtin vendbanim¹⁴⁰.

Nuk ka aspak rëndësi titulli mbi cilën e të cilit bashkëshortët përdorin banesën familjare, mbi bazën e titullit të pronësisë, të uzufuktit, banimit, kontratës së qirasë.

B. Natyra juridike e “disponimit”. Nisur nga ndalimi *expressis verbis* i normës, i disponimit të banesës familjare, është e nevojshme të sqarojmë se cilat janë veprimet juridike të disponimi, të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të normës.

Me termin disponim do të kuptojmë të gjithë veprimet juridike me ose pa kundërshtim, që sjellin tjetërsimin e banesës familjare dhe të gjitha ato veprime juridike që sjellin rrezikun e privimit të familjes nga banesa familjare¹⁴¹. Në veprimet juridike të disponimit do të përfshijmë veprime juridike që, privojnë familjen nga banesa familjare, të tilla si: kontratën e shitje, kontratën e dhurimit, krijimin e një uzufukti apo të drejte banimi; si dhe veprime juridik që mbartin rrezikun e një privimi të tillë, si psh: vendosja e hipotekës mbi banesën familjare.

Dy janë përjashtimet e elaboruara nga doktrina dhe praktika gjyqësore, nga parimi i disponimit në çdo rast të banesës familjare me pëlqimin e shprehur të të dy bashkëshortëve:

a) Bazuar në jurisprudencën e *Court de Cassacion franceze*¹⁴², disponimi i banesës familjare me testament, nuk përfshihet në fushën e zbatimit të normës, sepse ratio e normës është mbrojtja e banesës familjare gjatë martesës. Bashkëshorti pronar është i lirë të disponojmë me testament banesën familjare.

b) Neni 57 i kod.fam. nuk mund t’i kundërdrejtohet kreditorëve të bashkëshortit pronar të banesës¹⁴³. Kjo nënkupton që, nëse bashkëshorti debitor nuk përbush detyrimet që ka ndaj kreditorëve të tij, kreditorët kanë të drejtë të kërkojnë shitjen e detyruar të banesës, në pronësi të tij, dhe bashkëshortët nuk mund të mbrohen duke ekovuar zbatimin e nenit 57 të kod.fam.

Disponimi i banesë familjare është i mundur vetëm nëse për këtë disponim jep pëlqimin edhe bashkëshorti tjetër.

Nëse nga teksti i nenit 57/1 del qartësisht kushti i pëlqimit të bashkëshortit tjetër, mbetet e paqartë forma në të cilën duhet shfaqur ky pëlqim. Sipas jurisprudencës së Court de Cassation, nuk është e nevojshme që pëlqimi të shfaqet domosdoshmërisht në formë të shkruar, përderisa një

¹³⁹ Colomer, Droit civil. Régimes Matrimoniaux, fq. 35.

¹⁴⁰ Colomer, Droit civil. Régimes Matrimoniaux, fq. 35.

¹⁴¹ Flour dhe Champenois, Le régimes matrimoniaux, fq.110.

¹⁴² Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 22 Octobre, 1974, shënim i: Colomer, Droit civil. Régimes Matrimoniaux, fq. 36.

¹⁴³ Bazuar në jurisprudencën e Court de Cassation: Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 21 Juin 1978. Shënim i: Colomer, Droit civil. Régimes Matrimoniaux, fq. 37.

kusht i tillë nuk është kërkuar shprehimisht nga ligjvënësi. Për rrjedhojë, pëlqimi mund të shfaqet në çdo formë, mjafton që të rezultojë qartësisht¹⁴⁴.

Gjithashtu, bazuar sërish në jurisprudencën e Court de Cassation¹⁴⁵, pëlqimi i bashkëshortit tjetër nuk duhet të ketë për objekt vetëm pranimin e disponimit të banesës, por pëlqimi duhet të jepet edhe për modalitet e disponimit, si edhe për çmimin e kontratës, nëse kemi të bejmë me një kontratë shitje¹⁴⁶.

Ut supra, përmendën që pëlqimi i të dy bashkëshortëve, kërkohet në çdo rast të disponimit të banesës familjare, pavarësisht faktit, nëse banesa është pronë e njerit apo e të të dy bashkëshortëve.

Nëse banesa është pjesë e bashkësisë ligjore/kontraktore, atëherë përveç nenit 57, për disponimin e saj, duhet të zbatohen edhe normat e kod.fam, mbi administrimin jo të zakonshëm të bashkësisë.

C. Sanksioni i normës. Sanksioni i parashikuar nga neni 57/2, për veprimet juridike të disponimit të banesës familjare pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër është pavlefshmëria relative e veprimit juridik.

Të drejtën për të kërkuar anulimin e veprimit juridik të disponimit e ka vetëm bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk është marrë.

E drejta për të kërkuar anulimin e veprimit i nënshtrohet afateve të dyfishta ligjore. Nga njëra anë, ligji parashikon që, anulimi mund të kërkohet brenda 1 viti nga data që bashkëshorti ka marrë dijeni¹⁴⁷ për këtë veprim¹⁴⁸, por gjithmonë jo më vonë se 1 vit nga përfundimi i regjimit pasuror martesor.

Vëmë re që, llogaritja e afatit të dytë fillon nga momenti i përfundimit të regjimit pasuror martesor. Në këtë rast, doktrina është e mendimit¹⁴⁹ që, ligji ka dashur t'i referohet në fakt, vetëm hipotezës së përfundimit të regjimit pasuror për shkak të mbarimit të martesës dhe jo hipotezës së përfundimit të regjimit pasuror gjatë martesës, për shkak të ndryshimit me marrëveshje të bashkëshortëve.

Ky konkluzion duket i logjikshëm, nëse kemi parasysh faktin që, normat e regjimit primar janë të zbatueshme pavarësisht regjimit juridik, që rregullon marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve.

1.7.3. Kontributi material për nevojat e familjes

Ajo që shfaqet mjaft interesante është analiza e raportit që ekziston ndërmjet kontributit material për nevojat e familjes dhe regjimit pasuror martesor. Analiza e këtij raporti kërkon domosdoshmërisht analizën e ekuilibrit ndërmjet interesit të familjes dhe interesit të individëve që e përbëjnë atë, ekuilibrin ndërmjet autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve dhe kornizës ligjore të pashmangshme, që synon mbrojtjen e solidaritetit dhe unitetit të familjes¹⁵⁰.

¹⁴⁴ Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 13 Avril, 1983. Shënim i: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 38.

¹⁴⁵ Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 16 Juill, 1985. Shënim i: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 38.

¹⁴⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq.112.

¹⁴⁷ Vihet re që, termi i përdorur nga ligjvënësi nuk është plotësisht i saktë. Ligji ka parashikuar llogaritjen e afatit 1 vit nga data kur bashkëshorti tjetër ka marrë njoftimin për veprimin juridik të disponimit të banesës. Gjykojmë që termi më i saktë është "... nga marrja dijeni...".

¹⁴⁸ Afati 1 vjeçar nga marrja dijeni e veprimit të disponimit është afat parashkrimi. Për më shumë, rreth natyrës së këtij afati, shih: Court de Cassation, Chambre Civile 2e, Décembre 1982. Shënim i: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq.115.

¹⁴⁹ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 59.

¹⁵⁰ Falzea, *Il dovere di contribuzione nel regime patrimoniale della famiglia*, fq. 612.

Kontributi material për interesat e familjes, gjen rregullim në dy dispozita të kod.fam., neni 54, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve në funksion të përmbushjes së kontributit material dhe neni 60, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve nga njëra anë dhe kreditorëve të tyre nga ana tjetër, për detyrimet që secili prej tyre merr përsipër në funksion të mbajtjes së familjes dhe edukimit të fëmijëve. Sipas doktrinës franceze, dispozitat respektive të Code Civil (nenet 214 dhe 220), sipas modelit të të cilave janë hartuar nenet 54 dhe 60 të kod.fam., për një sistematizim më të mirë të normave, do të ishte më mirë, të ishin përmbledhur në një dispozitë të vetme, ose në dy dispozita, të cilat duhej të paraqiteshin në tekstin e ligjit njëra pas tjetrës¹⁵¹. Arsyeya është e evidente, të dy normat rregullojnë dy aspekte të të njëjtit institut, atë të kontributit material të bashkëshortëve në funksion të mbarëvajtjes së familjes.

1.7.3.1. Kontributi material në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve

Neni 54 i kod.fam. ka sanksionuar rregullin e detyrimit reciprok të bashkëshortëve në kontributin material për nevojat e familjes. Vetëm në rastet kur njëri bashkëshort është larguar nga banesa familjare pa shkak dhe refuzon të kthehet, atij i ndërpritet e drejta e përfitimit të kontributit material nga bashkëshorti tjetër, por vazhdon të jetë i detyruar të përmbushë këtë kontribut ndaj bashkëshortit që vazhdon të qëndrojë në banesën familjare (neni 56/1 i kod.fam.).

A. Objekti i “kontributit material”. Nga leximi i kombinuar i nenit 50 me nenin 54 të kod.fam., të cilat në një lexim të parë mund të duken si riprodhim i njëri-tjetrit, vërejmë që, kontributi material i bashkëshortëve përbëhet nga dy komponentë të rëndësishëm¹⁵²:

- a) Detyrimi për ushqim i bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit, i garantuar nga neni 50/1 i kod.fam.;
- b) Detyrimi për kontributin material për detyrimet që rrjedhin nga martesë, në interes të familjes dhe bashkëjetesës.

Megjithëse një pjesë e doktrinës mban qëndrimin që, fusha e zbatimit të neni 54 të kod.fam. përthith atë të nenit 50 të tij, jurisprudenca¹⁵³ ka afirmuar dallimin ndërmjet detyrimit për ushqim që bashkëshortët kanë ndaj njëri-tjetrit, gjatë martesës dhe kontributit material për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga martesë, i cili përfshin jo vetëm mbështetjen materiale të bashkëshortëve, por edhe mbështetjen materiale në lidhje me rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe administrimin e banesës familjare¹⁵⁴.

Nëse njëri nga bashkëshortët gjendet në kushtet e gjendjes në nevojë (për shembull: vuan nga një sëmundje për trajtimin e së cilës, të ardhurat e tij nuk mjaftojë), atëherë bashkëshortit tjetër i lind detyrimi i mbështetjes materiale ndaj bashkëshortit në nevojë, pavarësisht nëse ka përmbushur detyrimin e kontributit material për mbarëvajtjen e familjes¹⁵⁵.

B. Rregulli i përgjithshëm: caktimi me marrëveshje i kontributit material. Si përjashtim nga karakteri i detyrueshëm i normave të regjimit primar, neni 54 i kod.fam, i njohur bashkëshortëve një autonomi të gjerë për të rregulluar modalitetet e përmbushjes së kontributit material. Megjithatë, autonomia e tyre kontraktore, nuk është totale, sepse ligji ka parashikuar

¹⁵¹ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 42.

¹⁵² Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 53.

¹⁵³ Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 9 Mai, 1967; Court de Cassation, Chambre Civile, 2e, 5 Janvier 1973; Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 27 Octobre, 1976. Shënim i: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 55.

¹⁵⁴ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 55.

¹⁵⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 56.

pavlefshmërinë e çdo marrëveshje që përjashton njërin, apo të dy bashkëshortët nga detyrimi i përmbushjes së kontributit material¹⁵⁶.

Marrëveshja e kontributit material mund të realizohet në çdo formë të mundshme të shfaqjes së vullnetit, madje në pjesën më të madhe të rasteve realizohet në formën e një marrëveshje verbale. Bashkëshortët kanë të drejtë të rregullojnë kontributin material në kontratën martesore. Në këtë hipotezë jemi të mendimit që, marrëveshja për kontributin material nuk do t'i nënshtrohet kushteve të vlefshmërisë dhe publicitetit që kod.fam. kërkon për kontratën martesore, sepse objekti i saj nuk është rregullimi i regjimit pasuror martesor.

Objekti i marrëveshjes së kontributit material është përcaktimi i modaliteteve mbi bazën e të cilave bashkëshortët detyrohen të përmbushin materialisht detyrimet që rrjedhin për ta nga martesja dhe nga rritja e edukimi i fëmijëve.

Gjithashtu, bashkëshortët janë të lirë të përcaktojnë modalitetet nëpërmjet të cilëve do të përmbushin kontributi material. Kontributi material mund të përmbushet në të holla, në natyrë ose në kombinim të të dy formave.

C. Përmbushja e kontributit material në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve. Në mungesë të kontratës martesore, bashkëshortët kanë detyrimin për të kontribuar për nevojat e familjes, në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre.

Është e nevojshme të kuptojmë se çfarë ka dashur të nënkuptojë ligjvënësi më **“kushtet dhe aftësitë e bashkëshortëve”**.

Bazuar në mendimin unanimit të doktrinës dhe jurisprudencës, kontributi material përmbushet jo vetëm nëpërmjet të ardhurave të fituara nga puna e secilit bashkëshort, por edhe nëpërmjet vendosjes së sendeve në pronësi vetjake, në përdorim të bashkësisë, nëpërmjet punës shtëpiake. Me punë shtëpiake do të kuptojmë aktivitetin e kryer nga bashkëshortët në drejtim të realizimit të të gjithë atyre aktiviteteve për rritjen, edukimin e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e banesës familjare, që sjellin evitimin e shpenzimeve. Në këtë mënyrë, ligjvënësi i ka dhënë të njëjtën rëndësi ekonomike aktivitetit profesional me atë shtëpiake.

1.7.3.2. Kontributi material në marrëdhëniet e bashkëshortëve me kreditorët

Nëse neni 54 i kod.fam. rregullon mënyrën në të cilën bashkëshortët kontribuojnë, në raport me njëri-tjetrin, për detyrimet që rrjedhin nga martesja, neni 60 i kod.fam., rregullon mënyrën në të cilën bashkëshortët, në raport me kreditorët, përmbushin këto detyrime. Një tjetër dallim ndërmjet dispozitave, është që nëse neni 54 i kod.fam., paraqitet si një dispozitë lejuese, duke i dhënë mundësi bashkëshortëve të vetërregullojnë mënyrën e përmbushjes së këtij kontributi, pa patur të drejtën e shmangies ndaj tij, neni 60 i kod.fam., që rregullon regjimin juridik të përmbushjes së këtij kontributi ndaj të tretëve, është një dispozitë urdhëruese, e detyrueshme për zbatim, pavarësisht regjimit pasuror martesor të bashkëshortëve.

A. Parimet e sanksionuara nga norma. Neni 60 i kod.fam. ka një qëllim të dyfishtë, nga njëra anë garanton solidaritetin dhe barazinë juridike ndërmjet bashkëshortëve, ndërsa nga ana tjetër përfaqëson një garanci më shumë për kreditorët e bashkëshortëve¹⁵⁷.

Nga leximi i dispozitës, mund të dallojmë dy parime të rëndësishme mbi të cilat ajo është mbështetur:

- a) Parimi i pavarësisë së bashkëshortëve në vendimmarrje, në lidhje me mbajtjen e familjes, rritjen dhe edukimin e fëmijëve, që është shprehje e parimit të barazisë morale dhe

¹⁵⁶ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 54-55.

¹⁵⁷ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 61-62.

juridike të bashkëshortëve. Secili prej tyre ka të drejtë të kontraktojë veçmas detyrime në funksion të martesës dhe të rritjes e edukimit të fëmijëve;

- b) Parimi i përgjegjesisë solidare të të dy bashkëshortëve, për detyrimet e kontraktuar veçmas nga secili prej tyre, në interes të familjes dhe fëmijëve.

Justifikimin parimi i solidaritetit të bashkëshortëve në përmbushjen e detyrimeve të kontraktuara veçmas nga secili prej tyre, e gjen në solidaritetin në aspektin moral dhe social, që bashkon bashkëshortët në martesë¹⁵⁸.

Parimi i përgjegjesisë solidare, sanksionuar nga neni 60 i kod.fam., gjen zbatim për të gjithë bashkëshortët, pavarësisht regjimit pasuror martesor, si në rastin e regjimit të bashkësisë ashtu edhe në regjimin e pasurive të ndara.

Në rastin e regjimit të pasurive të ndara, parimi i përgjegjesisë solidare, përbën një përjashtim nga parimi i rëndësishëm i pavarësisë së aktivitetit dhe pasurisë së bashkëshortëve.

B. Fusha e zbatimit të normës. Neni 60 i kod.fam. do të gjejë zbatim vetëm për detyrimet që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve. Përmbushja e detyrimeve të tjera, që bashkëshortët marrin përsipër veçmas, gjatë martesës, do t'i nënshtrohen regjimit juridik të përmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga kod.civ, kombinuar me regjimin juridik, që përcakton regjimi pasuror, të cilit i nënshtrohen bashkëshortët gjatë martesës.

Do të përbëjnë detyrime, që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve, detyrimet që rrjedhin nga shpenzimet për ushqim, veshmbathje, transport, pushimet e familjes, shpenzimet mjekësore dhe ndërhyrje kirurgjikale, qiraja e banesës familjare¹⁵⁹, shpenzime të tjera që janë në funksion të mirëmbajtjes së banesës familjare si faturat e energjisë elektrike, ujit, taksat e pronësisë mbi banesën, duke përjashtuar këtu shpenzimet e mëdha për riparimin apo përmirësimin e banesës familjare¹⁶⁰.

Doktrina franceze, ka shtruar pyetjen, nëse në fushën e zbatimit të nenit 60 të kod.fam., do të përfshihen vetëm detyrimet kontraktore apo edhe ato jashtëkontraktore.

Përgjigja që mund të japim, nga leximi i parë i normës, është që neni 60 përfshin vetëm detyrimet kontraktore, sepse në tekstin e normës gjejmë të sanksionuar shprehimisht **“...veprimet juridike që kanë të bëjnë me...”**.

Sipas opinionit mbizotërues të doktrinës dhe praktikës gjyqësore të gjykatave franceze¹⁶¹, pavarësisht tekstit të nenit 60, në fushën e zbatimit të tij, do të përfshijmë jo vetëm detyrimet kontraktore, por edhe ato jashtëkontraktore, sepse baza e solidaritetit të bashkëshortëve, nuk është burimi i krijimit të detyrimeve, por objekti i detyrimit.

Gjithashtu, sipas opinionit të doktrinës, detyrimet në funksion të mbajtjes së familjes dhe edukimit të fëmijëve, do të angazhojnë solidarisht bashkëshortët, edhe nëse detyrimi është marrë përsipër nga njëri prej tyre, gjatë kohës që bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht, apo gjatë kohës që janë në procesin e zgjidhjes së martesës¹⁶².

C. Përjashtimet. Ligji parashikon disa përjashtime nga karakteri solidar i detyrimeve që bashkëshortët kontraktojnë, me qëllim mbajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve. Bazuar në

¹⁵⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 62.

¹⁵⁹ Court de Cassation, Chambre Civile Ire, 9 Octobre, 1990; shënim i: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 63.

¹⁶⁰ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 63.

¹⁶¹ Këtë konfirmim e gjejmë në fillim të afirmuar në vendimin e Chambre Social de la Court de Cassation, 26 Octobre 1972. Më pas, në gjykatën e shkallës së parë të Parisit: Tribunal gr. Inst. Paris 1973 dhe më pas në jurisprudencën e Chambre Civil de la Court de Cassation, Ire, 7 Juin 1989. Shënim i: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 63.

¹⁶² Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 48.

paragrafin e dytë të nenit 60 të kod.fam., përgjegjësia solidare nuk mund të zbatohet për detyrimet që sjellin shpenzime haptazi të tepërta.

Megjithëse ligjvënësi nuk ka dhënë një përkufizim, se çfarë do të kuptojmë me detyrime haptazi të tepërta, ka parashikuara tre kritere mbi bazën e të cilave do të vlerësohet karakteri haptazi i tepërt apo jo i detyrimit:

- a) Mënyra e jetesës së familjes;
- b) Dobishmëria e veprimit të kryer;
- c) Mirëbesimi apo keqbesimi i personave të tretë kontraktues.

Të tre këta elementë, të parashikuar nga neni 60, duhet të vlerësohen në mënyrë të kombinuar njëri me tjetrin. Megjithatë, në çdo rast, nëse ka mosmarrëveshje ndërmjet palëve për karakterin solidar të detyrimit, është gjykata që do të vlerësojë tre elementët e sipërpërmendur. Në këtë kontekst, gjykatës i është lënë një marzh i gjerë veprimi.

Neni 60 i kod.fam. nuk shprehet se cili është sanksioni, nëse rezulton që detyrimi është haptazi i tepërt, nëse detyrimi do të konsiderohet nga ligji si detyrim vetjak i bashkëshortit që e ka kontraktuar atë, apo do të konsiderohet detyrim i pjesëtueshëm i të dy bashkëshortëve.

Doktrina ka pranuar gjerësisht që, në hipotezën e detyrimeve që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve, të konsideruara haptazi të tepërta, detyrimi do të konsiderohet detyrim vetjak i bashkëshortit që e ka kontraktuar atë¹⁶³.

Nëse bashkëshortët janë të martuar në regjimin e pasurive të ndara, atëherë është e kuptueshme që përmbushja e detyrimit do t'i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të përmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga kod.civ. Kreditorët kanë të drejtë të kërkojnë përmbushjen e detyrimit vetëm mbi pasurinë e bashkëshortit debitor, pa pasur të drejtë të angazhojnë pasurinë e bashkëshortit tjetër.

Nëse, nga ana tjetër, bashkëshortët janë të martuar në regjimin e bashkësisë ligjore atëherë, sërish detyrimi është vetjak i bashkëshortit që e ka kontraktuar, por do të ndryshojë regjimi juridik i përmbushjes së tij, pasi nëse pasuria e bashkëshortit debitor nuk mjafton për të përmbushur detyrimin, atëherë kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit mbi gjysmën e masës së pasurisë së bashkësisë.

1.7.4. Pavarësia e bashkëshortëve në marrëdhëniet ndërmjet tyre

Pavarësisht nga regjimi pasuror të cilit i nënshtrohen, qoftë ky regjimi i bashkësisë universale, bashkëshortët ruajnë një autonomi të gjerë ndaj njëri-tjetrit, në drejtim të ushtrimit të profesionit, administrimit lirisht të të ardhurave të fituara nga puna dhe administrimit, gëzimit dhe tjetërsimit të pasurisë së tyre vetjake.

Megjithëse, funksioni kryesor i regjimit primar është ruajtja e solidaritetit dhe unitetit ndërmjet bashkëshortëve, ky solidaritet nuk mund të jetë në asnjë rast total. Ligji u ka dhënë të drejtën bashkëshortëve të bëjnë disa zgjedhje në aspektin profesional apo të pasurisë së tyre vetjake, të pavarura, pa qenë e nevojshme marrja e pëlqimit të bashkëshortit tjetër.

1.7.4.1. Pavarësia profesionale e bashkëshortëve

Neni 63 i kod.fam. parashikon të drejtën e zgjedhjes së lirë të profesionit për secilin bashkëshort, pa qenë i nevojshëm pëlqimi i bashkëshortit tjetër.

Gjithashtu, secili bashkëshort ruan të drejtën e administrimit lirisht të të ardhurave të fituara nga puna, si dhe të ardhurave të tjera të bashkëshortëve, gjithmonë pasi të ketë kontribuar për detyrimet që rrjedhin nga martesë.

¹⁶³ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 70.

Pas përmbushjes së kontributit material, secili bashkëshort ruan të drejtën e disponimit, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër të këtyre të ardhurave, nëpërmjet veprimeve juridike me ose pa kundërshpërblim.

Me të ardhura të fituara nga puna do të kuptojmë çdo lloj të ardhure, në para apo natyrë, e njohur si e tillë nga normat e së drejtës së punës. Sipas mendimit të doktrinës, nocioni i **“të ardhurave të fituara nga puna”**, duhet të interpretohet gjerësisht¹⁶⁴.

Nga ana tjetër, nuk është shumë e qartë se çfarë ka dashur të kuptojë ligjvënësi me termin **“...dhe të ardhura të tjera...”**. Sipas doktrinës franceze, megjithëse ligji nuk është shprehur qartësisht, me termin të ardhura të tjera do të kuptojmë, të ardhura të fituara si pasojë e aktivitetit profesional të bashkëshortëve dhe jo të ardhurat e fituara nga veprimtari joprofesionale, si psh: frutet natyrore dhe civile të sendeve vetjake. Ky përfundim del nga vetë kuptimi i normës, objekti i së cilës është sanksionimi i lirisë profesionale të bashkëshortëve.¹⁶⁵

Këtu mund të përfshijmë të ardhurat e karakterit jo të përhershëm të fituara nga veprimtaria profesionale e çdo bashkëshorti, përveç pagës së punës, siç mund të jenë shpërblimet e fundvitit. Në praktikë mund të shfaqen probleme në hipotezën kur njëri bashkëshort punon në veprimtarinë profesionale (tregtare, bujqësore, artizanale) të krijuar nga bashkëshorti tjetër, pa shpërblim.

1.7.4.2. Pavarësia në administrimin e sendeve vetjake

Neni 64 i kod.fam. sanksionon parimin e pavarësisë së bashkëshortëve, në raport me njëri-tjetrin, në administrimin, përdorimin dhe disponimin e pasurisë së tyre vetjake.

Në regjimin e pasurive të ndara, parimi i pavarësisë së bashkëshortëve në administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë së tyre vetjake, përbën parimin thelbësor mbi të cilin është ndërtuar ky regjim (neni 115/1 kod.fam.).

Për regjimin e bashkësisë ligjore, ky parim gjen zbatim për sa i përket pasurisë vetjake të secilit bashkëshort, ndërsa pasuria e bashkësisë i nënshtrohet një tjetër regjimi juridik administrimi. Kujtojmë këtu që, në nenin 95 të kod.fam., është parashikuar që, bashkëshortët e martuar në regjimin e bashkësisë ligjore, kanë të drejtë të administrojnë dhe të disponojnë lirisht sendet vetjake. Kjo dispozitë, në bazë të neni 108/2, do të gjej zbatim edhe në rastin e bashkësisë me kontratë, madje edhe të bashkësisë universale, e cila ashtu siç do të shikojmë më vonë, nuk mund të jetë në asnjë rast tërësisht universale, pasi një kategori e caktuar sendesh mbeten gjithmonë vetjake.

Megjithëse neni 64 i kod.fam. është një dispozitë e rendit publik, ky fakt nuk përjashton mundësinë që, bashkëshortët gjatë martesës, bazuar në dispozitat e kod.fam. dhe ato të kod.civ të administrojnë pasurinë vetjake të njëri-tjetrit¹⁶⁶. Bashkëshortët, pavarësisht regjimit pasuror martesor, kanë të drejtë t'i besojnë njëri tjetrit, nëpërmjet prokurës administrimin e pasurisë së tyre vetjake. Bazuar në nenin 68 të kod.fam., të cilin do ta analizojmë gjatë këtij punimi, bashkëshortët, secili bashkëshort mund t'i japë bashkëshortit tjetër, të drejtën për ta përfaqësuar gjatë regjimit pasuror martesor, pavarësisht nga natyra e regjimit, bashkësi apo pasuri të ndara.

Bazuar në nenin 95/2,3,4 secili bashkëshort gjatë regjimit të bashkësisë mund të administrojë, nëpërmjet një prokure të shprehur apo të heshtur, pasurinë vetjake të bashkëshortit tjetër. Të njëjtin rregullim ligjor e gjejmë edhe në regjimin e pasurive të ndara, përkatësisht nenet 117 dhe 118 të kod.fam.

Bazuar në jurisprudencën e Court de Cassation, në lidhje me veprimet e administrimit të pasurisë, mandati mund të jetë i përgjithshëm, ndërsa veprimet e disponimit të pasurisë (në rastin

¹⁶⁴ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 69.

¹⁶⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 69.

¹⁶⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 87

konkret bëhej fjalë për një kontratë dhurimi), mandati (prokura) duhet të jetë e posaçme¹⁶⁷ dhe të realizohet në të njëjtën formë, të cilën ligji kërkon për veprimin juridik për të cilën prokura jepet. Mandat i përfaqësimit është në çdo kohë i revokueshëm, bashkëshorti që I ka dhënë të drejtën bashkëshortit tjetër ta përfaqësojë atë në administrimin e pasurisë, gjatë regjimit pasuror martesor, bazuar në nenin 68/2 të kod.fam., ka të drejtë, në çdo kohë të revokojë mandatin e dhënë.

Është e pavlefshme çdo kaluzolë e kontratës martesore, e cila parashikon parevokueshmërinë e mandatit të përfaqësimit¹⁶⁸.

1.7.5. Administrimi i pasurisë në situatën e krizës së jetës familjare

Rregullat e administrimit të parashikuara nga ligjvënësi, të cilat u analizuan më sipër, kanë për qëllim rregullimin e mbarëvajtjes së jetës bashkëshortore, nëpërmjet garantimit të barazisë së tyre, pavarësinë ndaj njëri-tjetrit dhe njëkohësisht solidaritetin në familje. Paralelisht me këto dispozita, ligjvënësi ka parashikuar të tjera rregulla, të cilat do të gjejnë zbatim në hipotezën e një krize të mundshme të marrëdhënies bashkëshortore, rregulla të cilat devijojnë nga parimet e mësipërme dhe parashikojnë ndërhyrjen e gjykatës.

Konkretisht, në nenet 58 dhe 59 të kod.fam. ligjvënësi ka parashikuar ndërhyrjen e gjykatës në dy hipoteza, të cilat përfaqësojnë një situatë jo të zakonshëm të zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve: a) hipoteza në të cilën njëri nga bashkëshortët ndodhet në kushtet e pamundësisë së shprehjes së vullnetit; dhe b) hipoteza në të cilën, njëri bashkëshort refuzon të shprehë vullnetin dhe ky refuzim i tij, vjen në kundërshtim me interesat e familjes.

Duhet të ndalemi në sqarimin e termit shumë të përgjithshëm të përdorur nga ligjvënësi në nenin 58 dhe 59 të kod.fam. **“nuk është në gjendje të shprehë vullnetin”**. Doktrina dhe jursiprudenca e kanë interpretuar në mënyrë të zgjeruar këtë shprehje.

Sipas doktrinës, me gjendje të pamundësisë së shprehjes së vullnetit do të kuptojmë rastin kur bashkëshortit i është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor, shpallja e zhdukjes së bashkëshortit apo çdo gjendje tjetër që e bën atë objektivist të pamundur të shprehë vullnetin, si psh: shtrimi në spital, ndodhja jashtë RSH, apo edhe braktisja e vendbanimit, pa pasur asnjë lajm prej tij¹⁶⁹, si dhe rasti kur vuan dënimin me burgim¹⁷⁰.

Gjithashtu, shtrohet pyetja nëse dy dispozitat e mësipërme do të gjejnë zbatim në rastin kur njërit prej bashkëshortëve i është hequr zotësia për të vepruar dhe për rrjedhojë i është caktuar një kujdestar, i cili në pjesën më të madhe të rasteve është bashkëshorti tjetër.

Jemi të mendimit që, këto dy dispozita humbasin qëllimin e tyre, në rastin kur bashkëshortit, i cili nuk është në gjendje të shprehë vullnetin, i është caktuar një kujdestar.

Megjithatë, nëse i referohemi praktikës së Court de Cassation, dispozitat e mësipërme gjejnë zbatim edhe në rastet kur njëri prej bashkëshortëve ndodhet në kujdestari¹⁷¹.

1.7.5.1. Autorizimi gjyqësor në administrim

Bazuar në nenin 58 të kod.fam, në rastin kur njëri prej bashkëshortëve ndodhet në kushtet e pamundësisë së shprehjes së vullnetit, ose ai refuzon të shprehë vullnetin dhe ky refuzim bie në

¹⁶⁷ Court de Cassation, Chambre Civile, 1 re Juin 1983. Shënim i: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 88.

¹⁶⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 88

¹⁶⁹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 116-117.

¹⁷⁰ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 103.

¹⁷¹ Court de Cassation, Chambre Civile Ire, 18 Fevrier, 1981. Shënim i: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 104.

kundërshtim me interesin e familjes, atëherë bashkëshorti tjetër ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar autorizimin për kryerjen e veprimit, për të cilin pëlqimi i bashkëshortit tjetër është i nevojshëm. Nga analiza e dispozitës paraqesim përfundimet e mëposhtme.

Së pari, në lidhje me fushën e zbatimit, do të pohojmë që, neni 58 do të gjejë zbatim vetëm për veprime juridike të veçanta, për të cilat bashkëshorti tjetër refuzon të japë pëlqimin ose ndodhet në gjendjen e pamundësisë së shprehjes së pëlqimit, me kushtin që, veprimi të jetë i domosdoshëm për interesat e familjes, moskryerja e të cilit vë në rrezik interesat e familjes.

Në këto hipoteza, pëlqimi i njërit bashkëshort do të zëvendësohet nga autorizimi i gjykatës¹⁷².

Nëse bashkëshortët janë të martuar nën regjimin e bashkësisë, atëherë neni 58 do të jetë i zbatueshëm vetëm për veprimet e administrimit jo të zakonshëm, ndërkohë nuk ka asnjë kuptim të gjejë zbatim në veprimet e administrimit të zakonshëm, të cilat mund të kryhen nga secili bashkëshort, pa qenë i nevojshëm pëlqimi i bashkëshortit tjetër, sepse ligji në këtë rast prezumon ekzistencën e një pëlqimi të heshtur reciprok¹⁷³ ndërmjet bashkëshortëve. Ky përfundim rezulton nga vetë teksti i normës, në të cilën është parashikuar *expressis verbis* “... **veprim juridik, për të cilin bashkëpunimi apo pëlqimi i bashkëshortit tjetër do të ishte i nevojshëm**”¹⁷⁴.

Së dyti, do të përjashtohen nga fusha e zbatimit të normës të gjitha veprimet juridike, të administrimit të zakonshëm apo jo të zakonshëm, të pasurisë vetjake të secilit bashkëshort të martuar nën regjimin e pasurive të ndara, si dhe përjashtohen, gjithashtu, nga fusha e zbatimit të normës, veprimet juridike, të administrimit të zakonshëm apo jo të zakonshëm, të pasurisë vetjake (neni 77 kod.fam.) të bashkëshortëve të martuar në regjimin e bashkësisë ligjore/kontraktore¹⁷⁵. Mbi këto pasuri, secili bashkëshort ruan të drejtën e administrimit, gëzimit dhe disponimit të lirë (nenet 95/1 dhe 115/1 i kod.fam.).

Së treti, bazuar në nenin 58, autorizimi i gjykatës jepet vetëm për kryerjen e një veprimi juridik të caktuar, për të cilin nuk është dhënë pëlqimi i bashkëshortit tjetër. Autorizimi i gjykatës nuk do të ketë vlerë për veprimet e tjera juridike.

Së katërti, barra e provës bie mbi bashkëshortin, i cili kërkon autorizimin e gjykatës. Ky bashkëshort duhet të provojë në gjykim, dy elementë të rëndësishëm¹⁷⁶:

- a) Duhet të provojë që, bashkëshorti tjetër nuk është në gjendje të japë pëlqimin apo refuzon ta japë atë;
- b) Duhet të provojë, që veprimi është i domosdoshëm për interesat e familjes.

Së pesti, është e nevojshme të sqarojmë pasojat që sjell për bashkëshortin tjetër, veprimi juridik i kryer mbi bazën e autorizimit të gjykatës.

“Veprimi juridik, i kryer si më sipër, mund të kundërshtohet nga bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk është marrë, për të mos e ngarkuar atë me asnjë detyrim”.

Formulimi i paragrafit të dytë të nenit 58 paraqet paqartësi të dukshme. Nuk është shumë e qartë se çfarë ka dashur ligjvënësi të nënkuptojmë me shprehjen **“mund të kundërshtohet nga bashkëshorti”**, ndërkohë që një nga kushtet e autorizimit të gjykatës është kundërshtimi paraprak i bashkëshortit për të dhënë pëlqimin, ndërsa në hipotezën e pamundësisë së shprehjes së pëlqimit, nuk shohim se si mund të jetë e mundshme për këtë bashkëshort paraqitja e kundërshtimit, në kushtet e gjendjes së pamundësisë së shprehjes së vullnetit.

¹⁷² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 121.

¹⁷³ Për më shumë rreth regjimit juridik të administrimit të zakonshëm dhe jo të zakonshëm, të regjimit të bashkësisë ligjore, shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 130.

¹⁷⁴ Mbi këtë argument shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 121.

¹⁷⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 121-122.

¹⁷⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 125.

Sipas interpretimit të doktrinës franceze, të nenit 217/2 të Code Civil, i cili ka shërbyer si model për hartimin e nenit 58/1,2 të kod.fam, veprimi juridik i kryer vetëm nga njëri bashkëshort, me autorizimin e gjykatës, sipas kushteve të parashikuara nga neni 58/1:

- a) Do t'i kundërdrejtohet bashkëshortit tjetër, në kuptimin që ky bashkëshort nuk mund të kërkojë pavlefshmërinë e veprimit për shkak të mosmarrjes së pëlqimit të tij;
- b) Veprimi juridik nuk do të sjellë pasoja mbi këtë bashkëshort, në kuptimin që ky bashkëshort nuk do të jetë përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga veprimi juridik.

Le t'i ilustronim me një shembull praktik përfundimet e mësipërme. Nëse njëri bashkëshort ka marrë autorizimin e gjykatës për shitjen e një sendi, atëherë, nga njëra anë, kontrata e shitjes do të jetë e vlefshme, dhe bashkëshorti pëlqimi i të cilit nuk është marrë nuk mund të kërkojë pavlefshmërinë e kontratës, por nga ana tjetër, asnjë detyrim që rrjedh nga kontrata nuk mund t'i kundërdrejtohet këtij bashkëshorti¹⁷⁷. Të gjitha detyrimet, pagimi i çmimit, garancia për evikcion do të merren përsipër vetëm nga bashkëshorti që ka kryer veprimin juridik.

1.7.5.2. Përfaqësimi gjyqësor¹⁷⁸

Megjithëse në pamje të parë mund të duken shumë të ngjashme me njëri tjetrin, nenet 58 dhe 59 të kod.fam., ndryshojnë mjaft ndërmjet tyre, jo vetëm për sa i përket fushës së zbatimit, por edhe pasojave që autorizimi i gjykatës sjell për bashkëshortët.

Bazuar në nenit 59 të kod.fam., nëse njëri bashkëshort gjendet në kushtet e pamundësisë së shprehjes së vullnetit, bashkëshorti tjetër, mbi bazën e autorizimit të gjykatës, si dhe brenda kufijve të këtij autorizimi, ka të drejtë të kërkojë autorizimin e gjykatës për kryerjen e të gjitha veprimeve juridike apo vetëm disa prej tyre, në lidhje me regjimin pasuror martesor.

Le të bëjmë një analizë të shkurtër të përmbajtjes së nenit 59 të kod.fam.

Së pari, neni 59 gjen zbatim vetëm në rastet kur njëri nga bashkëshortët nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij. Në fakt kjo është një shprehje mjaft e gjerë, e cila ka nevojë për interpretimin e doktrinës dhe të praktikës gjyqësore¹⁷⁹.

Së dyti, në fushën e zbatimit të nenit 59 do të përfshihen veprimet juridike të administrimit të pasurisë në bashkësi, dhe në asnjë rast norma nuk mund të gjejë zbatim në administrimin e pasurisë vetjake të bashkëshortëve, pavarësisht regjimit pasuror martesor, regjim i pasurive të ndara, apo regjim bashkësie. Të drejtën e bashkëshortëve për të administruar dhe disponuar lirisht pasurinë vetjake të tyre e gjejmë jo vetëm të sanksionuar në nenin 64 të kod.fam., por e gjejmë të risanksionuar në nenin 95 për regjimin e bashkësisë ligjore dhe në nenin 115/1 për regjimin e pasurive të ndara. Për më tepër, duhet të theksojmë që, parimi i ruajtjes së të drejtës së çdo bashkëshorti në administrimin dhe disponimin e lirë të pasurisë së tij, qëndron në themel të regjimit të pasurive të ndara.

Shmangia nga pavarësia e bashkëshortëve në administrimin e pasurisë së tyre vetjake, mund të bëhet vetëm në bazë të një marrëveshje të bashkëshortëve apo të një prokure të përgjithshëm apo të posaçme, në bazë të së cilës, bashkëshorti pronar, me vullnetin e tij të lirë, i beson bashkëshortit tjetër administrimin e pasurisë së tij vetjake¹⁸⁰. Në asnjë rast nenet 58 dhe 59 të kod.fam, nuk duhen kuptuar si shmangie nga këto parime.

¹⁷⁷ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq 125.

¹⁷⁸ Për përdorimin e këtij termi shih: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 102.

¹⁷⁹ Më sipër, në interpretimin e nenin 58 kemi sqaruar kuptimin e termit “*nuk është në gjendje të shprehë vullnetin*”, kështu që nuk e gjykojmë të arsyeshme t'i rikthehemi edhe një herë trajtimit të së njëjtës çështje.

¹⁸⁰ Gjatë këtij punimi do të trajtojmë gjërësisht këtë çështje. Për më shumë shih nenet 95/2 dhe 117 dhe 118 të kod.fam.

Në këtë drejtim, duket e paqartë pse shprehimisht ligjvënësi i është referuar shprehjes “... **omissis... veprime juridike që lidhen me regjimin pasuror martesor**”. Përdorimi i kësaj shprehje të bën të mendosh që fusha e zbatimit të nenit 59 të kod.fam. përfshin të gjitha regjimet pasurore, por mbi bazën e argumenteve të parashtruar *ut supra*, jemi të mendimit që fusha e zbatimit të nenit 59 (së bashku me nenin 58) është vetëm regjimi i bashkësisë.

Nëse njërit prej bashkëshortëve i është hequr zotësia për të vepruar, atëherë për administrimin e pasurisë së tij, gjykata cakton një kujdestar që, në pjesën më të madhe të rasteve në praktikë është bashkëshorti tjetër. Në këtë hipotezë, bashkëshorti kujdestar, administron pasurinë vetjake të bashkëshortit të vendosur në kujdestari, në cilësinë e kujdestarit dhe jo sipas tagrave që i janë dhënë nga neni 59 i kod.fam.

Së treti, autorizimi i gjykatës mund të jetë autorizim i përgjithshëm ose i posaçëm¹⁸¹, mund të jepet për të kryer një veprim të caktuar juridik, ose mund të jepet “*in toto*” për të gjitha veprimet e administrimit të pasurisë.

Përgjithësisht se, autorizimi i gjykatës është autorizim i përkohshëm, kohëzgjatja e të cilit do të përcaktohet në varësi të kohëzgjatjes së gjendjes së pamundësisë për të shprehur vullnetin¹⁸².

Së katërti, autorizimi i gjykatës i jep jetë një marrëdhënie përfaqësimi, ndërmjet bashkëshortëve, të cilën mund ta përfshijmë në kategorinë e përfaqësimit gjyqësor, nëse marrim si kriter klasifikues burimin e krijimit të tij. Bashkëshorti i autorizuar nga gjykata do të kryejë veprimet juridike të administrimit të pasurisë edhe në emër e për llogari të bashkëshortit tjetër. Tagrat e përfaqësimit, në çdo rast, do të përcaktohen në vendimin gjyqësor.

Së pesti, në lidhje me pasojat e veprimit, bazuar në faktin që, autorizimi i gjykatës sjell krijimin e marrëdhënies së përfaqësimit, duhet të themi që, veprimi juridik i kryer nga njëri bashkëshort do të sjellë pasojat për të dy bashkëshortët, jo vetëm për bashkëshortin që ka shprehur vullnetin.

1.7.5.3. Raporti ndërmjet dy dispozitave

Nga analiza e paraqitur *ut supra* e neneve 58 dhe 59 të kod.fam, është e qartë që, ato paraqesin ndryshime të rëndësishme ndërmjet tyre, të cilat i referohen: shkaqeve për të cilat mund të kërkohet autorizimi gjyqësor, fushës së zbatimit të normave si dhe pasojave që sjell veprimi juridik i kryer nga njëri bashkëshort për palët dhe për të tretët.

Së pari, në lidhje me shkaqet për të cilat mund të kërkohet autorizimi gjyqësor, nga njëra anë, neni 59 parashikon vetëm hipotezën në të cilën njëri bashkëshort nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, ndërsa nga ana tjetër, neni 58 përveç gjendjes së pamundësisë së shprehjes së vullnetit, parashikon edhe hipotezën e refuzimit të dhënies së pëlqimit nga njëri bashkëshort.

Së dyti, në lidhje me fushën e zbatimit të normës, ndërsa neni 58 parashikon dhënien e autorizimit vetëm për një veprim juridik të caktuar, neni 59 parashikon dhënien e autorizimit, jo vetëm për një veprim juridik, por në total për të gjitha veprimet juridike, që lidhen me një regjim pasuror të caktuar.

Së treti, ka sërish ndryshime në lidhje me pasojat që sjell për palët dhe për të tretët, veprimi juridik i kryer mbi bazën e autorizimit të gjykatës. Ndërsa, në bazë të nenit 58, bashkëshorti i autorizuar nga gjykata vepron vetëm në emër të tij dhe për rrjedhojë pasojat e veprimit juridik bien vetëm mbi të dhe jo mbi bashkëshortin tjetër, në bazë të nenit 59 të kod.fam. bashkëshorti i autorizuar nga gjykata vepron jo vetë në emër të tij, por edhe si përfaqësues i bashkëshortit tjetër dhe për rrjedhojë pasojat e veprimit juridik, për të cilin është kërkuar autorizimi, bien mbi të dy bashkëshortët¹⁸³.

¹⁸¹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 120.

¹⁸² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 120.

¹⁸³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 121.

Pavarësisht ndryshimeve të paraqitura më sipër, në hipotezën e gjendjes së pamundësisë për të vepruar të njërit bashkëshort dhe domosdoshmërisë së kryerjes së veprimit për interesat e familjes, fushat e zbatimit të dy dispozitave mbivendosen njëra me tjetrën. Lind problemi, se cila prej tyre do të gjejë zbatim, apo do t'i lihet e drejta e zgjedhjes, bashkëshortit që kërkon autorizimin e gjykatës.

Sipas mendimit të doktrinës, nëse fusha e zbatimit të dy dispozitave të mësipërme mbivendoset, siç ndodh në hipotezën e gjendjes së një bashkëshorti në kushtet e pamundësisë së shprehjes së vullnetit, atëherë i takon bashkëshortit tjetër e drejta e zgjedhjes¹⁸⁴ ndërmjet përfaqësimit gjyqësor (neni 59 kod.fam.) apo autorizimit gjyqësor (neni 58 kod.fam.).

Në analizë të fundit, duke dashur të përmbledhim të gjithë analizën e paraqitur deri tani, jemi të mendimit që, pavarësisht se në parim dispozitat e regjimi primar, gjejnë zbatim për të gjithë regjimet pasurore martesore (neni 64 i kod.fam.), nenet 58 dhe 59 të kod.fam. do të gjejnë zbatim vetëm për pasurinë e regjimeve të bashkësisë ligjore apo bashkësisë me kontratë dhe nuk mund të zbatohen për regjimin e pasurive të ndara apo atë të pjesëmarrjes në fitime, pasi bien në kundërshtim me thelbin e këtyre regjimeve.

1.7.5.4. Masat urgjente

Nëse përfaqësimi gjyqësor (neni 59) dhe autorizimi gjyqësor (neni 58) kanë për qëllim të zgjerojnë kompetencat e njërit bashkëshort në administrimin e pasurisë së përbashkët, masat urgjente, të parashikuara nga neni 61, 62 dhe 56 të kod.fam., kanë për qëllim të ngushtojnë këto kompetenca¹⁸⁵.

Le të marrim shkurtimisht në analizë, nenin 61 të kod.fam, i cili parashikon mundësinë e marrjes së masave urgjente nga gjykata, me kërkesë të bashkëshortëve, nëse njëri prej tyre nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga martesja duke vënë në rrezik interesat e familjes. Shkurtimisht do të ndalemi në analizën e dy elementëve të nenit 61: 1) *kushtet ligjore*, që duhet të plotësohen për të kërkuar ndërhyrjen e gjykatës; dhe 2) *natyrën juridike* dhe llojin e masave që mund të caktohen nga gjykata.

A. Kushtet ligjore. Nga leximi i nenit 61 të kod.fam. rezulton që, dy janë kushtet ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, për të kërkuar ndërhyrjen e gjykatës dhe marrjen e masave urgjente, kushte të cilat, janë formuluar në mënyrë shumë të gjerë nga ligjvënësi dhe për rrjedhojë, vlerësimi i tyre do të mbetet, në çdo rast në diskrecion të gjykatës

a) *Mosplotësimi në mënyrë të dukshme i detyrimeve nga ana e njërit bashkëshort.*

Sipas interpretimit të doktrinës, në mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga martesja do të përfshihen si detyrimet e karakterit personal jopasuror, si psh: shkelja e besnikërisë bashkëshortore apo braktisja e banesës familjare; ashtu edhe detyrimet e karakterit pasuror, si psh. mospërmbushja e kontributit material për nevojat e familjes, keqadministrimi i pasurisë së bashkësisë, apo shpërdorimi i pasurisë së përbashkët¹⁸⁶.

Sigurisht që kod.fam. ka parashikuar të tjera masa që, mund të merren në hipotezat e përmendura mësipër, të keqadministrimit të pasurisë apo të shpërdorimit të kësaj pasurie. Mund të përmendim këtu zbatimin e masave të parashikuara në nenet 92, 93, 94, 98 të kod.fam ose ushtrimin e të drejtës së bashkëshortëve për të kërkuar zgjidhjen e martesës. Duke vlerësuar nenin 61 në raport me këto dispozita të tjera, në lexim të parë, mund të duket që ky nen përfaqëson një dublim të këtyre masave dhe për rrjedhojë është i panevojshëm. Duhet të

¹⁸⁴ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 107.

¹⁸⁵ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 109.

¹⁸⁶ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 110.

theksojmë që, ky pohim është krejtësisht i pasaktë, pasi neni 61 lejon marrjen e masave *preventive dhe urgjente*, në një kohe më të shkurtër, në raport me dispozitat e sipërcituara¹⁸⁷.

Gjithshtu, i paqartë mbetet përdorimi, nga ligjvënësi, i termi “*mospërmbushje në mënyrë të dukshme*”. Çfarë do të kuptojmë më *mënyrë të dukshme* të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga martesë? Sipas doktrinës, mosplotësimi i detyrimeve duhet të jetë i rëndësishëm, mund të përbëjë një mospërmbushje të vazhdueshme të detyrimeve ose mund të përbëjë edhe vetëm nga një veprim i vetëm¹⁸⁸. Edhe në këtë rast, vlerësimi do t’i mbetet gjykatës, për të gjykuar nëse veprime apo mosveprime të caktuara të bashkëshortëve, përbëjnë apo jo mospërmbushje të dukshme të detyrimeve që rrjedhin nga martesë.

b) *Vënia në rrezik e interesave të familjes.*

Mosplotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga martesë duhet të shoqërohet me pasojën e vënies në rrezik të interesave të familjes. Formulimi i përdorur nga ligjvënësi është shumë i gjerë, dhe për rrjedhojë do t’i takojë në çdo rast gjykatës të vlerësojë rrezikun.

Në mënyrë unanime, doktrina mban qëndrimin që, nuk është e nevojshme ardhja e pasojave, mjafton vetëm ekzistenca e një rreziku potencial, të mundshëm¹⁸⁹, i cili duhet të jetë real dhe serioz.

Rreziku duhet të vlerësohet në përputhje me interesat e familjes dhe jo në përputhje me interesat vetjakë të secilit bashkëshort, megjithëse nuk është gjithmonë e lehtë dallimi i këtyre interesave, për shkak se, në mjaft raste këto dy grupe interesash mund të mbivendosen njëri me tjetrin, interesi vetjak i një bashkëshorti mund të përfaqësojë njëkohësisht edhe interesin e familjes¹⁹⁰.

B. Masat urgjente. Në rastin kur, gjykata konstaton dhe vlerëson plotësimin në mënyrë kumulative të kushteve të mësipërme, atëherë, ka të drejtën e marrjes së masave që i gjykon të nevojshme për parandalimin e rrezikut që i kanoset interesave të familjes nga mosplotësimi i detyrimeve të njërit bashkëshort. Është e qartë që, edhe në këtë rast ligji ia ka lënë plotësisht në diskrecion të gjykatës përcaktimin e masave që duhet të merren, në përputhje me situatën e krijuar.

Lidhur me llojin e masave që mund të marrë gjykata, ligji nuk shprehet, duke e lënë çështjen e karakterit të këtyre masave në diskrecion të gjykatës. Kjo zgjidhje e ligjvënësit është e kuptueshme, pasi situatat konfliktuale të jetës bashkëshortore mund të jenë të shumëllojshme dhe është e vështirë për ligjvënësin, të parashikojë tërësinë e situatave të krizës familjare dhe të masave përkatëse, që mund të merren.

Ka një diskutim në doktrinë, nëse masat që mund të ndërmarrë gjykata janë vetëm masat e karakterit pasuror apo mund të marrë edhe masa të karakterit personal jopasuror.

Sipas mendimit mbizotërues të doktrinës, gjykata mund të vendosë vetëm masa të karakterit pasuror, të tilla si: përjashtimi i bashkëshortit fajtor në administrimin e pasurisë së bashkësisë, ndalimin e kryerjes së veprime të caktuara juridike që, vënë në rrezik interesat e familjes, bllokimin e llogarive bankare të përbashkëta, të të dy bashkëshortëve¹⁹¹ etj.

Lidhur me natyrën juridike të masave, që mund të vendosë gjykata, gjykojmë që këto masa janë preventive dhe të përkohshme.

Së pari, masat e marra nga gjykata janë *masa preventive*. Karakteri preventiv i tyre del qartë nga vetë formulimi i nenit 61/1 të kod.fam. Qëllimi i tyre është parandalimi i rrezikut që mund t’i vijë interesave të familjes nga mospërmbushja e detyrimeve të bashkëshortit fajtor.

¹⁸⁷ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 110.

¹⁸⁸ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 110

¹⁸⁹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 112.

¹⁹⁰ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 128.

¹⁹¹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 128-129.

Së dyti, bazuar në paragrafin e dytë të nenit 61, masat janë në çdo rast të **përkohshme**. Gjykata ka të drejtë të caktojë afatin e veprimit të këtyre masave, por në çdo rast, kohëzgjatja e tyre nuk mund të kalojë 3 vjet. Në dispozitë nuk përcaktohet konkretisht e drejta e gjykatës për të caktuar afatin e kohëzgjatjes së masave, por me termin e përdorur nga ligji “*zgjatja e masave në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar*”, nxjerrim përfundimin logjik që, është gjykata që përcakton këtë kohëzgjatje.

Afati maksimal 3 vjeçar është gjykuar i mjaftueshëm nga ligjvënësi për të zgjidhur situatën e krijuar, ose nëpërmjet ndryshimit të sjelljeve që dëmtojnë interesat e familjes nga bashkëshorti fajtor, ose nëpërmjet marrjes së masave të tjera nga bashkëshorti tjetër, si psh: masave të parashikuara nga nenet 91, 92, 92, 94 dhe 98 të kod.fam, ose për të kaluar në masën më ekstreme atë të zgjidhjes së martesës¹⁹².

Nga sa thamë më lart, është e kuptueshme që, marrja e një mase nga gjykata, në zbatim të nenit 61 të kod.fam, nuk ndalon bashkëshortët të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas dispozitave të tjera që parashikon ligji për secilin regjimin pasuror martesor.

Së treti, masat që mund të marrë gjykata mund të ndryshojnë në çdo kohë. Megjithëse neni 61 nuk shprehet, vendimi i gjykatës nuk i nënshtrohet parimit të gjësë së gjykuar. Në çdo kohë, secili prej bashkëshortëve mund t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar pushimin e masës së dhënë, nëse rreziku ka pushuar së ekzistuari¹⁹³.

1.7.5.5. Procedura gjyqësore

Në analizë të fundit, në mungesë të rregullimeve ligjore si në kod.fam. ashtu dhe në atë të proc.civ, gjykojmë të arsyeshme paraqiten e disa refleksione mbi procedurën gjyqësore të gjykimit të padive të parashikuara në nenet 58, 59 dhe 61 të kod.fam.

Së pari, gjykojmë që në nenin 58, rasti i refuzimit të shprehjes së pëlqimit (autorizimi i gjykatës) dhe në nenin 61 (masat urgjente) gjykimi vihet në lëvizje nëpërmjet një kërkesë padie dhe për rrjedhojë është një gjykim që zhvillohet me palë kundërshtare, ndërmjet bashkëshortëve; ndërsa në nenin 59 të kod.fam (përfaqësimi gjyqësor) dhe nenin 58, rasti i pamundësisë së shprehjes së pëlqimit, gjykimi vihet në lëvizje nëpërmjet një kërkesë nga njëri bashkëshort dhe zhvillohet pa palë kundërshtare.

Së dyti, në lidhje me legjitimitimin, duhet të theksojmë që, bazuar në formulimin e tre dispozitave të mësipërme, subjektet e legjitimuar janë vetëm bashkëshortët ose përfaqësuesit e tyre dhe asnjë person tjetër.

Në nenin 58 dhe 61, legjitimitimi aktiv i përket vetëm bashkëshortit jo fajtor, ndërsa i paditur do të paraqitet, në çdo rast, bashkëshorti fajtor, i cili refuzon të japë pëlqimin (neni 58) apo veprimet e të cilit, vënë në rrezik interesat e familjes (neni 61).

Në nenin 59 dhe 58 (pamundësia e shprehjes së pëlqimit), duke qenë se gjykimi zhvillohet pa palë kundërshtare, kërkuar është vetëm bashkëshorti, i cili kërkon të autorizohet të përfaqësojë edhe bashkëshortin tjetër, që ndodhet në kushtet e pamundësisë së shprehjes së vullnetit, në kryerjen e veprimeve juridike në lidhje me regjimin pasuror.

Së treti, në të tre rastet e mësipërme, gjykata kompetente për gjykimin e kërkesë padisë apo kërkesës është seksioni familjar, i gjykatës së shkallës së parë, të rrethit gjyqësor ku bashkëshortët kanë vendbanimin e përbashkët dhe nëse kanë vendbanime të ndryshme, gjykata ku ka vendbanimin bashkëshorti paditës, apo kërkuar.

¹⁹² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 130.

¹⁹³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 131.

KAPITULLI II

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI KONTRATËN MARTESORE (HISTORIKU, KUPTIMI, NATYRA JURIDIKE, KLASIFIKIMI SHKENCOR DHE FUNKSIONET TIPIKE)

2.1. Modelimi në kohë dhe hapësirë i regjimit pasuror dhe kontratës martesore

Marrëdhëniet pasurore në familje janë modeluar në kohë dhe në hapësirë nën ndikimin nga njëra anë, të strukturës së brendshme të familjes dhe nga ana tjetër, nën ndikimin e rolit social dhe ekonomik që, në epoka të ndryshme, familjes i është përcaktuar nga shoqëria¹⁹⁴.

Për këtë arsye, lind domosdoshmëria e paraqitjes së një analize të shkurtër, në planin historiko-juridik, të evoluimit të regjimit pasuror martesor dhe kontratës në disa sisteme ligjore në botë.

Evolucionin e marrëdhënieve pasurore në familje, evolucionin e shkallës së autonomisë së bashkëshortëve në vetërregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, të strukturës, objektit, subjekteve dhe përmbajtjes së kontratës martesore, nuk mund ta studiojmë të veçuar, nga funksioni dhe roli që një shoqëri e caktuar, në një periudhë të caktuar kohe, i jep familjes dhe martesës.

Kontrata martesore nuk është një instrument ligjor i legjislacioneve moderne, siç mund të mendojë dikush në pamje të parë. Në të kaluarën kontratat martesore kanë qenë shumë më të zakonshme ndërmjet bashkëshortëve, në krahasim me ditët tona¹⁹⁵.

Historikisht, kontratat martesore e lidhura nga prindërit ose familjarët e tjerë të bashkëshortëve kanë qenë më të përhapura se kontratat martesore të lidhura nga vetë bashkëshortët, për arsye se, në shumë sisteme ligjore, gruaja për një kohë të gjatë nuk gëzonte zotësinë për të lidhur kontrata¹⁹⁶.

Në të “drejtën romake” u njohën dy forma të martesës, “*conventium in manum*” (në Romën e hershme) dhe “*matrimonium sine manum*”.

Në Romën e hershme, paterfamilias kishte një pozitë të konsiderueshme autoritare dhe një epërsi ligjore mbi anëtarët e tjerë të familjes. Gruaja, me anë të martesës, bëhej pjesë e familjes së burrit dhe subjekt i autoritetit të tij (*conventio in manum*). Martesa “*matrimonium sine manus*” u bë e zakonshme shumë kohë më vonë. Në këtë periudhë, martesa ishte një akt ose fakt juridik, nëpërmjet së cilës gruaja dilte nga familja e saj e origjinës dhe hynte në një familje të re, në pozita nënshtrimi dhe me funksionin e vetëm që t’i siguronte pasardhës të ligjshëm kryetarit të familjes së re ose një personi tjetër të lirë të familjes¹⁹⁷.

Më vonë, lindi martesa “*matrimonium sine manu*”, që mund të konsiderohet si forma tipike e martesës në të drejtën romake. Nëse në martesën “*convention in manum*” e gjithë pasuria e gruas “*sui iuris*” kalonte në pasurinë e burrit ose të paterfamilias-it të burrit, nga ana tjetër, karakteristikë e martesës “*sine manus*” ishte sistemi i pasurive të ndara¹⁹⁸.

Në “*matrimonium sine manus*”, dy ishin komponentët kryesorë të regjimit pasuror martesor:

1. “*Dota*”, pasuria që gruaja apo të tjerë jepnin ose premtinin me rastin e martesës, me qëllim përballimin e nevojave të jetës së përbashkët të familjes së re. Paterfamiljas fitonte vetëm “*manus*” mbi pasurinë dotale dhe në asnjë rast pronësinë.

¹⁹⁴ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 14.

¹⁹⁵ Mjafton të kujtojmë këtu që, një numër shumë i vogël bashkëshortësh në Shqipëri lidhin kontratë martesore.

¹⁹⁶ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 444.

¹⁹⁷ Tardugno, Maria A. *Regimi patrimoniali e annullamento del matrimonio*. Napoli: E.G. Simone, 2003, fq. 6-8; Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 444.

¹⁹⁸ Donatuti, Guido. “Separazione.” Në *Enciclopedia Italiana*, 1936, Marrë në: <http://www.treccani.it>.

2. Dhurimet me rastin e martesës “*donazione ob nuziale*”, pasuria që burri i dhuronte gruas në rastin e martesës.¹⁹⁹

Pasuria dotale përfshihet në pasurinë e burrit, ndërsa pasuria tjetër e gruas, që nuk përfshihen në dotë (bona “*extra dotem*”) mbetet në pronësi të gruas, për rrjedhojë mund të thuhet që lidhja e martesës “*sine manus*” nuk sjell pasoja në pasurinë e bashkëshortëve. Ndërsa, në lidhje me sendet e fituara nga gruaja gjatë martesës vlen prezumimi “*muciana*”, sipas së cilit, këto sende prezumohen në pronësi të burrit, nëse nuk mund të provohet e kundërta nga gruaja.²⁰⁰

Në martesën *munt* gjermane, e cila ishte një martesë e lidhur ndërmjet burrave të lirë dhe grave, një kontratë lidhej ndërmjet fiseve, të cilëve i përkisnin bashkëshortët e ardhshëm. Personi ose fisi, që kishte “*muntwalt*” mbi gruan ose klanin (fisën) merrte përsipër, në kontratën e martesës, t’i transferonte bashkëshortit të saj “*munt-in*” (literalisht: mbrojtje, autoritet). Nga ana tjetër, në të ashtëquajturën martesë “*Friedel*”, martesë lidhej me pëlqimin e të dy bashkëshortëve dhe burri nuk fitonte “*munt*” mbi bashkëshorten e tij.²⁰¹

Ditët e sotme, në *legjislacionet Europiane*, mund të vëmë re një ndikim të fortë të kishës katolike, ndikim i cili ka çuar, shpesh herë, në kufizimin e autonomisë kontraktore të bashkëshortëve.

Në kontrast me vendet Europiane, në legjislacionin *Hebre dhe Islamik*, vetë martesë konsiderohet një kontratë. Në legjislacionin islam, martesë gjithmonë përfshin pagesën e një shume monetare “*mahr*” nga burri tek gruaja, në kohën e lidhjes së martesës ose në rastin e zgjidhjes së martesës. Bashkëshortët kanë të drejtë të rregullojnë, me marrëveshje, termat e përmbajtjes së kontratës, si sasinë dhe kohën e pagesës, por nuk mund ta përjashtojnë atë. Ndërsa, në të drejtën hebreje, duhet të paguhet një shumë “*ketubah*”, nga burri tek gruaja, me lidhjen e martesës dhe zgjidhjen e saj. Të dyja këto pagesa si “*mahr*” ashtu dhe “*ketubah*” luajnë një rol mbrojtës për gruan, në rastin e zgjidhjes së martesës. Këto lloj marrëveshjes janë jo vetëm gjerësisht të pranuar nga palët, por një martesë nuk mund të lidhet në mungesë të tyre.²⁰²

Por, në ndryshim nga e drejta hebreje dhe islame, në legjislacionet europiane duke parë që kuptimi kristian mbi martesën, ishte, për shumë kohë, i bazuar mbi parimin e “*pazgjidhshmërisë*”, marrëveshjet me funksion rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës, nuk kanë qenë të njohura, deri në momentin e njohjes ligjërish të së drejtës për të zgjidhur martesë, ose së paku, nuk kanë qenë ligjërish të detyrueshme deri vonë në vendet Europiane. Lidhja e marrëveshjeve, me objekt rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës, është parë si në kundërshtim me “*rendin publik*”²⁰³, me argumentin që “*që në çastin e lidhjes së martesës bashkëshortët kanë planifikuar një zgjidhje eventuale martesë*”²⁰⁴.

2.1.1. Shoqëria paraindustriale

Në shoqërinë paraindustriale, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve ishin të rregulluara në funksion të rolit të familjes, si qendra kryesore e prodhimit dhe e konsumit dhe të pronësisë mbi tokën, si burimi kryesor i pasurisë²⁰⁵. Në shoqërinë e kësaj periudhe familja ishte qendra kryesore e interesave, që mbante marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet bashkëshortit-kryetar i familjes, ndërsa pronësia mbi tokën përbënte elementin më të rëndësishëm të stabilitetit ekonomik, vazhdimësisë sociale dhe ishte burimi kryesor i pushtetit politik.

¹⁹⁹ Tardugno, *Regimi patrimoniali e annullamento del matrimonio*, fq. 6-8.

²⁰⁰ Donatuti, Guido. “Separazione.” në *Enciclopedia Italiana*, 1936. Marrë në: <http://www.treccani.it>.

²⁰¹ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Vol. II, J. Basedow, K.J. Hopt, R. Zimmermann, A. Stier (Eds.), Oxford: University Press, 2012, fq. 445.

²⁰² Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 445-446.

²⁰³ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1135-1136.

²⁰⁴ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 445.

²⁰⁵ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 15.

Mbi këto baza dhe në përmbushje të këtyre funksioneve, marrëdhëniet pasurore në familje, karakterizoheshin nga dy elementë:

- a) Dhënia bashkëshortit e të drejtës së administrimit të pasurisë së familjes dhe gëzimit të lirë të frutave të saj, pavarësisht nga titullari i pronësisë mbi këtë pasuri;
- b) Nga ana tjetër, në kuadrin e regjimit primar, legjislacionet e asaj kohe parashikonin që, detyrimi i kontributit material për nevojat e familjes (bashkëshortes dhe fëmijëve) rëndonte kryesisht mbi bashkëshortin.

Në sistemin *common law*, parashikohej kalimi në pronësi të bashkëshortit të sendeve të luajtshme, që bashkëshortja gëzonte në momentin e lidhjes së martesës dhe atyre sendeve të luajtshme që fitoheshin pa kundërshtim gjatë martesës, me përjashtim të pasurisë së përdorimit ngushtësisht personal; duke realizuar, në këtë mënyrë, një përqëndrim të të gjithë pasurisë së luajtshme në pronësi të bashkëshortit. Nga ana tjetër, pasuria e paluajtshme mbetej, gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës, në pronësi të bashkëshortes, por bashkëshorti fitonte posedimin "*jure uxorio*" mbi këtë pasuri, posedim nga i cili, ai fitonte të drejtën e administrimit dhe gëzimit të saj. Ligji parashikonte pazotësinë e gruas në administrimin dhe disponimin e pasurisë së paluajtshme të saj, pa pëlqimin e bashkëshortit, megjithëse kjo pasuri mbetej në pronësi të gruas, gjatë gjithë martesës.²⁰⁶

Bashkëshorti pasjetues ruante të drejtën e uzufuktit mbi pasurinë e paluajtshme të bashkëshortes (*curtesy*) së tij, pas vdekjes së kësaj të fundit, në rast se nga martesë kishte lindur një fëmijë i aftë për të trashëguar, ndërsa në rast të vdekjes më parë të bashkëshortit, bashkëshortja pasjetuese fitonte të drejtën e uzufuktit (*dower*) mbi një të tretën e pronësisë së paluajtshme të bashkëshortit²⁰⁷.

Në sistemet ligjore të familjes romano-gjermanike (Italia, Franca, Gjermania, Zvicra dhe Jugu i Austrisë) nuk parashikohej asnjë e drejtë e drejtpërdrejtë e bashkëshortit mbi pasurinë e bashkëshortes së tij, për rrejdhojë regjimi pasuror që, vepronte gjatë martesës, ishte ai i pasurive të ndara, i cili bazohej mbi institutin e dotës dhe pasurive parafernale²⁰⁸.

Pasuria dotale ishte pasuria që, bashkëshortja ose familja e saj i dërgonin bashkëshortit, në momentin e lidhjes së martesës, me funksionin e "*ad sustinenda onera matrimonii*", përballimin e shpenzimeve të familjes (regjimi primar). Bashkëshorti kishte të drejtën e administrimit ekskluziv të pasurisë dotale dhe të mbledhjes së fruteve të saj. Ndërsa pasuria parafernale që, ishte pasuria e bashkëshortes që, nuk përfshihej në dotë, mbetej në pronësinë e gruas, gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës dhe bashkëshorti nuk fitonte asnjë të drejtë mbi të. Megjithatë, administrimi dhe disponimi i pasurisë parafernale nga gruaja kushtëzohej nga dhënia e pëlqimit të bashkëshortit, pasi gruaja nuk gëzonte zotësinë e disponimit të lirë të pasurisë së saj.²⁰⁹ Këto parime, i gjejmë në bazën e *Codice Civile Italian* të vitit 1865 dhe 1942, *Code Civil Francez* të vitit 1804, *BGB Gjerman* të vitit 1896 (hyrë në fuqi në 1 Janar të 1900), *Code Civil Zvicerian* të vitit 1907 (hyrë në fuqi në Janar të vitit 1912)²¹⁰.

Edhe në shtete të tjera, në të cilat regjimi pasuror ligjor ishte ndërtuar mbi modelin e regjimit të bashkësisë, parimet bazë ishin ato të unitetit të pasurisë së familjes dhe administrimit të centralizuar të saj. Në këto regjime, bashkësia përfshinte gjithë pasurinë e fituar nga bashkëshortët para dhe gjatë martesës, me përjashtim të pasurisë së përfshirë në kontratën martesore (Danimarka, Norvegjia, Islanda, Holanda, Portugalia, Brazili). Ndërsa, të tjera

²⁰⁶ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 15-16.

²⁰⁷ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 21

²⁰⁸ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 16.

²⁰⁹ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 17.

²¹⁰ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 17.

regjime e kufizonin bashkësinë vetëm mbi fitimet dhe sendet e luajtshme të përfituara gjatë martesës (Suedia) ose vetëm mbi fitimet (Spanja, “*comunidad de ganancias*”)²¹¹.

Të gjitha këto modele të regjimeve të bashkëpronësisë kishin të përbashkët të drejtën ekskluzive të bashkëshortit në administrimin dhe gëzimin e pasurisë, ndërsa pëlqimi i bashkëshortes, i cili mund të zëvendësohej nga autorizimi i gjykatës, kërkohej vetëm për veprime administrimi, të një rëndësie të veçantë.

Kodi Civil francez i vitit 1804, në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, për shkak të rolit qendror që kishte familja në shoqërinë franceze, bënte disa përjashtime nga parimi i barazisë së palëve, parim ky karakterizues i instituteve të tjera të kodit. Regjimi ligjor bazohej në bashkësinë e sendeve të luajtshme dhe fitimeve, ndërsa parashikonte për bashkëshortin të drejtën ekskluzive të administrimit dhe gëzimit jo vetëm të pasurisë së përbashkët, por edhe të pasurisë vetjake të bashkëshortes, e cila gëzonte vetëm të drejtën e dhënies së pëlqimit për disponimin ose dhënien me qira, për një periudhë të gjatë kohore, të sendeve të paluajtshme në pronësi të bashkësisë, ose në pronësi të saj²¹².

Në analizë të fundit, nxjerrim përfundimin që, elementi karakterizues i regjimeve pasurore martesore të periudhës paraindustriale, pavarësisht nga natyra juridike e tyre, regjime bashkësie universale, bashkësie të pjeshme, regjime të pasurive të ndara ose regjimet e sistemit common law, ishte garantimi i ruajtjes së pronësisë latifondiste (mbi tokën) brenda familjes dhe trashëgimi i saj në vijë vertikale brenda familjes²¹³. Qëllimi i tyre ishte ruajtja e pushtetit politik dhe ekonomik të një grupi të vogël personash, në duart e të cilëve ishte përqendruar pronësia latifondiste, nëpërmjet ruajtjes së unitetit të familjes.

2.1.2. Periudha pas Revolucionit Industrial

Revolucioni industrial, i cili solli si pasojë zhvlerësimin e pronësisë latifondiste dhe zbehjen e rolit të familjes si qendra e prodhimit dhe konsumit, ndikoi thellësisht në rimodelimin e marrëdhënieve pasurore në familje²¹⁴.

Së pari, familja megjithëse nuk humbet rolin qendror social, humbet rolin e saj si njësi prodhuese, duke mbetur tashmë vetëm një njësi konsumi e të mirave, që prodhohen jashtë saj.

Së dyti, në aspektin ekonomik pasuria e luajtshme dhe fitimet e aktivitetit ekonomik, marrin një rëndësi më të madhe në raport me pasurinë e paluajtshme, duke sjellë në mënyrë të paevitueshme humbjen e rëndësisë së pronës së madhe latifondiste.

Së treti, duhet të marrim në konsideratë procesin e urbanizimit dhe shpërndarjes së pasurisë në një gamë më të gjerë të shoqërisë.

Modeli i ri i familjes kërkonte domosdoshmërisht ndërtimin e një modeli të ri të marrëdhënieve pasurore në familje, të cilat të garantonin shpërndarjen e detyrave në familje dhe pjesëmarrjen e bashkëshortëve në pasuritë e fituara gjatë martesës, me kontributin e përbashkët të tyre.

Dy faktorë të tjerë të rëndësishëm ndikuan në rimodelimin e regjimeve pasurore martesore në shoqërinë industriale: a) emancipimi i gruas dhe roli i ri ekonomik-social që shoqëria industriale i jep asaj; dhe b) afirmimi, në legjislacionet e shteteve demokratike, në nivelin kushtetues, i parimit të barazisë juridike të burrit dhe gruas²¹⁵.

Bazuar mbi zhvillimet e reja ekonomiko-sociale, me qëllim përshtatjen e regjimit pasuror martesor me këto zhvillime, sistemet juridike kanë operuar në dy nivele:

²¹¹ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 18.

²¹² Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 20.

²¹³ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 20-21.

²¹⁴ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 23.

²¹⁵ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 24.

- a) **Nivelin primar:** bazuar në parimin e solidaritetit, është parashikuar detyrimi i përbashkët i të dy bashkëshortëve në mbajtjen e familjes, nëpërmjet institutit të kontributit të përbashkët material për nevojat e familjes;
- b) **Në nivelin sekondar:** krijimi i regjimeve ligjore, që garantojnë një rishpërndarje më të drejtë, në përfundim të martesës, të pasurisë së fituar gjatë saj nga secili prej bashkëshortëve dhe nga ana tjetër, garantimi i parimit të administrimit të përbashkët të pasurisë së fituar gjatë martesës.²¹⁶

2.1.3. Shtetet Socialiste

Pavarësisht ndryshimeve ndërmjet shteteve të ndryshme, e drejta familjare e shteteve socialiste paraqet disa karakteristika të përbashkëta, që e dallojnë atë nga e drejta e familjare e shteteve të tjera Europiane, karakteristika kryesore e cila, ishte sanksionimi në ligj i barazisë formale të burrit dhe gruas, në të gjitha aspektet e jetës sociale dhe familjare. Ndryshimet ligjore dhe ideologjike ndërmjet të drejtës familjare të familjes ligjore romano-gjermanike dhe asaj socialiste, mund të përmbliidhen në këto pika kryesore²¹⁷:

Së pari, eliminimin e elementëve të bazuar mbi **“ndryshimin e klasave”** dhe elementëve diskriminues në të drejtën familjare, si psh: privilegjet e bazuar në origjinën sociale, përkatësinë klasore, ndryshimet raciale, fetare dhe kombëtare, si dhe eliminimin e të gjitha ndikimeve të fesë mbi pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në fushën e të drejtës familjare. Ndarjen e plotë të shtetit nga besimet fetare dhe transferimin tek shteti të të gjitha pushteteve që, institucionet fetare ushtronin mbi marrëdhëniet familjare.

Së dyti, proklamimin e **“lirisë së martesës”**, nëpërmjet idesë së institucionalizimit të dashurisë së lirë dhe eliminimit të martesave bazuar mbi përkatësinë klasore të individëve, nëpërmjet lehtësimit të kushteve të lidhjes dhe zgjidhjes së martesës.

Së treti, eliminimin e strukturës patriarkale të familjes, kryesisht eliminimin e pabarazisë formale të burrit dhe gruas në marrëdhëniet me fëmijët, eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të bazuar mbi gjininë dhe moshën dhe veçanërisht mbi origjinën familjare, si psh: dallimet midis fëmijëve të lindur nga martesë dhe atyre të lindur jashtë martesë.

Së katërti, përpjekjen e rritjes së përfshirjes së gruas në të gjitha aspektet e jetës dhe krijimi i kushteve për një ndarje të re dhe të ndryshme të roleve në familje ndërmjet burrit dhe gruas, si dhe marrjen e masave ligjore, që kishin për qëllim barazinë e bashkëshortëve në të drejta dhe detyrime.

Qeveritë e reja që, erdhën në pushtet, në vendet socialiste, abroguan të gjitha ligjet borgjeze duke i zëvendësuar ato me ligje të reja të cilat reflektonin ideologjinë e re socialiste. Këto ligje ishin të bazuara në parimin e barazisë formale të burrit dhe gruas. Në kuadër të marrëdhënieve pasurore martesore, u preferua regjimi i bashkësisë universale shoqëruar me të drejtën e administrimit të përbashkët të pasurisë në bashkësi²¹⁸ si dhe u mohua plotësisht e drejta e bashkëshortëve për vetërregullimin e regjimit pasuror martesor.

2.2. Vështrim historiko-juridik mbi regjimin pasuror martesor në Shqipëri

Në këtë pjesë të punimit prezantohet një analizë e shkurtër historiko-juridike e zhvillimit të institutit të regjimit pasuror martesor dhe kontratës martesore në Shqipëri që nga koha e

²¹⁶ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 24.

²¹⁷ Për më shumë, rreth karakteristikave të marrëdhënieve familjare në shtetet socialiste, shih: Rheinstejn, Max. dhe Glendon, Mary A. “Interspousal Relations.” në *International Encyclopedia of Comparative Law*, Vol. IV, A. Chloros, M. Rheinstejn, Glendon M. A. (Eds.), Tubingen: Mhor Siebeck, 2007, fq. 20-72.

²¹⁸ Rheinstejn dhe Glendon, “Interspousal Relations.” fq. 73-74.

pushtimit otoman e deri në ditët tona, me miratimin e Kodit aktual të Familjes. Analiza historiko-juridike e institutit të regjimit pasuror martesor, duke filluar nga aktet normative (burimet) më të hershme për të arritur tek Kodi aktual i Familjes, shërben për të studiuar evolucionin që ka pësuar rregullimi ligjor i këtij instituti në Shqipëri.

2.2.1. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të vitit 1929

Në territoret e banuara nga shqiptarët marrëdhëniet martesore janë rregulluar, për shumë shekuj rradhazi, nga normat e së drejtës zakonore, e cila është zbatuar deri vonë tek shqiptarët²¹⁹.

Gjatë kohës së pushtimit turk, që nga shekulli XV e deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të Zogut, të vitit 1929, në Shqipëri vepronin paralelisht dy sisteme juridike, në qytete dhe në rrethinat afër tyre zbatoheshin drejta osmane, ndërsa në krahinat autonome në veri dhe në jug të vendit zbatoheshin drejta zakonore shqiptare²²⁰. Zbatimi i këtyre të drejtave, në territoret e banuara nga shqiptarët bëhej në mënyrë të pavarur ose me veprim të ndërsjellët²²¹.

Marrëdhëniet juridiko-civile dhe ato familjare si pjesë përbërëse e tyre, në kohën e pushtimit osman, në territoret e banuara nga shqiptarët, janë rregulluar mbi bazën e përkatësisë fetare të bashkëshortëve, bazuar në bashkekzistencën e disa rendeve juridike: a) rendit juridik osman, i cili nga ana e tij përbëhej nga sheriatit (e drejta zakonore myslimane) dhe e drejta statusore e Perandorisë Osmane; b) e drejta zakonore shqiptare; si dhe c) e drejta kanonike (kishtare) e ritit katolik dhe atij ortodoks. Përgjithësisht, edhe gjatë pushtimit osman, marrëdhëniet familjare për pjesën më të madhe të popullsisë së besimit fetar mysliman vazhduan të rregulloheshin nga e drejta zakonore, ndërsa e drejta myslimane (sheriatit) u zbatua vetëm për një pjesë të shqiptarëve myslimanë, të cilët banonin në qytete ose në fshatra afër qyteteve²²².

Në krahinat malore, të jugut dhe veriut, rregullimi i marrëdhënieve të pronësisë, trashëgimisë, familjare dhe ato të detyrimeve bëhej kryesisht mbi bazën e të drejtës zakonore, ndërsa e drejta e shtetit turk zbatoheshin vetëm për ato marrëdhënie shoqërore që mbronin interesat e vetë shtetit turk²²³.

Edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912) deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të Zogut (1 Prill 1929) marrëdhëniet martesore vazhduan të rregulloheshin mbi bazën e normave të së drejtës zakonore dhe normave fetare, në përputhje me përkatësinë e besimit fetar të secilit bashkëshort²²⁴.

2.2.1.1. E drejta e Perandorisë Osmane

Burimet e së drejtës civile, në kohën e sundimit të Perandorisë Osmane, ishin dy llojesh:

A. E drejta e Sheriatit. Sheriatit, siç quhet ndryshe e drejta myslimane, është kompleksiteti i ligjeve hyjnore, që myslimani i zellshëm i respekton, nëse ai kërkon të zbatojë detyrat e fesë. Burimet kryesore të sheriatit janë: a) Kurani, Libri i shenjtë, b) Suna, këshillat dhe urdhërat e Profetit Muhamed, c) Ixhma, doktrina dhe mendimet e dijetarëve islamë për çështje të caktuara dhe, d) Kijas, interpretimi apo analogjia.

²¹⁹ Zaçe, Valentina. *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë: Dituria, 1999, fq. 21-22.

²²⁰ Semini-Tutulani, Marjana. *E drejta e detyrimeve dhe kontratave. Pjesa e përgjithshme*. Tiranë: Skanderbegbooks, 2006, fq. 12.

²²¹ Aliu, Abdulla. *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*. Prishtinë: Botimi i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2013, fq. 134.

²²² Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 32-33.

²²³ Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 140.

²²⁴ Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 32.

Në Kuran, për të drejtën civile, ka rreth 70 ajete. Kurani i kushton vëmendje së drejtës familjare, të trashëgimisë dhe të drejtës së luftës, ndërsa për të drejtën e pronësisë dhe atë të detyrimeve ka një numër të vogël dispozitash.

Nga njëra anë, e drejta e shariatit ka dominuar në marrëdhëniet familjare, të trashëgimisë dhe i ka dhënë bazat të drejtës penale, ndërsa nga ana tjetër, lëmi i së drejtës publike, të drejtës së luftës, taksat dhe tatimet ishin në kompetencë të shtetit osman (kanunametë).

Në Sheriat martesë konsiderohej si kontratë. Në momentin e lidhjes së martesës, burri detyrohej të jepte në favor të gruas “dhuratën e martesës” që quhej “mehr”²²⁵, e cila caktohej mbi bazën e një marrëveshje të lidhur para lidhjes së martesës, nga përfaqësuesit e palëve dhe kishte për qëllim t’i siguronte gruas mjetet e jetesës, nëse burri zgjidhte martesën²²⁶. Sheriati nuk parashikonte detyrimin e gruas për të sjellë pajën, në momentin e lidhjes së martesës²²⁷.

B. E drejta shtetërore turke²²⁸. Duke qenë se Sheriati nuk realizonte më kërkesat e kohës për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile, Perandoria Osmane nxori akte të tjera ligjore, kanunet e Sulltanit dhe Kodin Civil Osman (Mexhele), të cilët bazat e tyre i kishin nga sheriatit, por ndonjëherë ishin edhe në kundërshtim me shariatin. Kodi Civil Turk, me emrin Mexhele, i cili u nxor pjesë-pjesë, nga viti 1869 deri në vitin 1876, pati rëndësi të madhe, sepse për herë të parë marrëdhëniet juridiko-civile, në Perandorinë Osmane, rregulloheshin nga një kod modern, me orientim perëndimor.²²⁹

Ky kod dhe kanunametë janë zbatuar në Shqipëri, për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile, deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare, 1 Prill të vitit 1929.

2.2.1.2. E drejta zakonore shqiptare

Krahas së drejtës së Perandorisë Osmane, në territoret e banuara nga shqiptarët është zbatuar edhe e drejta zakonore shqiptare²³⁰, si burim i veçantë për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile, në ato hapësira dhe ndërmjet personave ku nuk arriti të imponohet, në tërësi ose pjesërisht, e drejta turke, për shkak se nuk donin ta respektonin ose nuk kishin mjaftueshëm dijeni për të drejtën e shkruar turke²³¹.

E drejta zakonore ka lindur në një fazë të caktuar të zhvillimit ekonomik-shoqëror të shqiptarëve, bashkë me shpërbërjen e rendit gjinor, ashpërsimin e kontradiktave në gjirin e tij, lindjen e pronës private dhe krijimin e shtetit²³². Në territoret shqiptare janë zbatuar Kanuni i lekë Dukagjinit, Kanuni i Labërisë, Kanuni i Skëndërbeut (Shqipëria e Mesme), Kanuni i Maleve, Zakoni i Musë Ballgjinit (lugina e lumit Shkumbin), Sharti i Idriz Suli në Labëri, të cilat konsiderohen si përmendore të pavdekshme të kulturës shqiptare, në përgjithësi dhe asaj juridike, në veçanti²³³.

²²⁵ Bashkëshortët kanë të drejtë të rregullojnë, me marrëveshje, termat e përmbajtjes së kontratës, si sasinë dhe kohën e pagesës, por nuk mund ta përjashtojnë atë.

²²⁶ Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 18.

²²⁷ Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 18-19.

²²⁸ Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 139.

²²⁹ Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 144-146.

²³⁰ E drejta zakonore është krijuar me dy mënyra kryesore: a) nëpërmjet sanksionimit të zakoneve të vjetra të rendit gjinor në norma juridike; b) me nxjerrjen e normave të reja nga pleqtë e Kuvendit, që pasqyrojnë rendin e ri, pronën private dhe shtresimet shoqërore. Për më shumë, mbi formimin e së drejtës zakonore shqiptare, shih: Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 137.

²³¹ Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 139.

²³² Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 137.

²³³ Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 64-65.

Midis kanuneve të ndryshme të popullit shqiptar ekzistojnë pika të ndryshme përkuese, gjë që dëshmon për një bazë të njëjtë të përbashkët juridike, kurse dukuria e emërtimeve të ndryshme të kanuneve, në realitet përfaqëson vetëm variante të kanunit, e cila mund të emërtohet me një emër të përbashkët “e drejta zakonore e popullit shqiptar”²³⁴.

Normat e të drejtës zakonore shqiptare nuk ishin statike, sepse vetë zhvillimi ekonomiko-shoqëror i zonave ku ajo vepronte, determinonte nevojën e zhvillimit të tyre në kohë, sidomos pas viteve 20⁷ të shek. XIX, shekull i cili solli ndryshime sasiore, siç ishin ato që u bënë nga Kuvendi i Labërisë, së vitit 1924²³⁵.

Baza e ekonomisë përbëhej nga veprimtaria ekonomike bujqësore ose blegtorale e familjes patriarkale, pra familja patriarkale ishte baza e shoqërisë²³⁶.

Në të drejtën zakonore shqiptare, pozita juridike e gruas në familje dhe në jetën shoqërore në tërësi përcaktohej nga roli i tyre në ekonominë familjare, si dhe nga pronësia ndaj mjeteve kryesore të prodhimit²³⁷. Gratë ishin të zhveshura nga pronësia mbi pasurinë e përbashkët të familjes; ato dispononin vetëm sendet e thjeshta vetjake. Pasuria e familjes, e përbërë nga shtëpitë, arat, bagëtitë, kullotat, u përkiste vetëm burrave dhe trashëgimtarëve të tyre meshkuj. Gruaja ishte e përjashtuar nga pronësia dhe trashëgimia si në familjen e prindërve, ashtu dhe në atë të burrit.²³⁸ Roli i saj në familje kufizohej në punët e shtëpisë si dhe në lindjen dhe rritjen e fëmijëve, megjithatë ajo mund të merrte pjesë në veprimtarinë ekonomike dhe blegtorale të familjes.

Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve përcaktoheshin nga pozita e gruas dhe e burrit në familje dhe në shoqërinë patriarkale shqiptare, shoqëri në të cilën burri kishte gjithmonë një pozitë më të favorshme në marrëdhëniet me bashkëshorten e tij²³⁹. Detyrimi i kontributit material për nevojat e familjes, për rritjen dhe edukimin e fëmijëve rëndonte vetëm mbi burrin. Marrëdhëniet pasurore ndërmjet anëtarëve të familjes dhe bashkëshortëve në veçanti ishin të thjeshta, pasuria e tyre kufizohej vetëm në pronësinë mbi sendet e përdorimit ngushtësisht vetjak²⁴⁰, ndërsa pronësia mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet e prodhimit, fitimet e veprimtarisë ekonomike i përkisnin në tërësi familjes patriarkale.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, mund të themi që, bazuar në të drejtën zakonore shqiptare lidhja e martesës nuk sillte pasojë të karakterit pasuror për bashkëshortët, gruaja nuk merrte pjesë në pasurinë e burrit, as gjatë martesës dhe as me trashëgimi; pasuria e bashkëshortëve kufizohej vetëm në sendet e përdorimit ngushtësisht vetjak. Kjo është e kuptueshme bazuar në faktin që, marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore ishin të ndërtruara mbi bazën e veprimtarisë së ekonomisë bujqësore ose blegtorale të familjes patriarkale.

²³⁴ Aliu, *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*, fq. 135.

²³⁵ Elezi, Ismet. “Marrëdhëniet familjare e martesore sipas së drejtës zakonore në Labëri.” *Revista Drejtësia*, Nr. 2/1993 (Tetor-Dhjetor), Tiranë: 1994, fq. 41.

²³⁶ Tek iliro-shqiptarët familja patriarkale ka ekzistuar në shekuj, që nga epoka e bronzit, kur lindi së pari familja monogame, deri në shek. XX pas Luftës së Dytë Botërore. Jetëgjatësia e familjes patriarkale tek shqiptarët shpjegohet me vendin që ka zënë bujqësia dhe blegtoria në ekonominë e tyre dhe me kushtet e veçanta historike. Për më shumë shih: Konomi (Perolla), Rezarta. *Rendi etnojuridik në Shqipëri: Nga statutet, tek kanunet*. Studim monografik. Tiranë: 2013, fq. 276.

²³⁷ Luarasi, Aleks. *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*. Tiranë: Luarasi University Press, 2001, fq. 146.

²³⁸ Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 146.

²³⁹ Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 150.

²⁴⁰ Pasuria vetjake e burrit përbëhej nga veshjet e trupit, armët e gjata e gjata e duhanit, sahati, qosteku e ndonjë send tjetër i kësaj natyre. Ndërsa, pasuria vetjake e gruas përbëhej nga arka “të cilën s’guxon me ja prek kush” ku mbaheshin veshjet e stolitë, dhuratat e dasmës etj. Për më shumë shih: Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 177.

Megjithatë, si përjashtim nga rregulli i mësipërm, sipas të cilit individët nuk mund të mbanin pasuri të veçantë brenda ekonomisë familjare (me përjashtim të sendeve të përdorimit ngushtësisht vetjak), shfaqet instituti i *“Selemi”*²⁴¹. Fillimisht, selemi kishte si burim të tij pasurinë që sillte gruaja me vete me rastin e martesës “paja”, ndërsa për burrin selemi përbëhej nga armët, sahati, qosteku, ndërsa më vonë me kalimin e kohës kuptimi i selemi u zgjerua duke përfshirë çdo pasuri vetjake, që i përkiste një anëtarit të familjes, jashtë pasurisë së përbashkët²⁴². Paja ose prika ishte pasuria që merrte vajza kur martohej, duke u larguar nga ekonomia e familjes. Kjo pasuri e gruas ishte e veçantë nga pasuria e burrit dhe anëtarëve të tjerë të familjes, mund të disponohej lirisht nga gruaja dhe mbi të cilën askush nuk mund të vinte dorë, madje as burri²⁴³.

Pas zgjidhjes së martesës, gruas nuk i njiheshin asnjë pjesë në pasurinë e përbashkët të familjes, asnjë kontribut si në pasurinë e luajtshme ashtu edhe në atë të paluajtshme. Si rregull, gruaja merrte vetëm teshat e trupit, ndërsa sipas Kanunit të Lumës, gruaja pa fëmijë merrte jo vetëm teshat e trupit, por edhe ato të arkës si edhe ato që kishte punuar vetë.²⁴⁴ Nëse i referohemi Kanunit të Labërisë²⁴⁵, gruaja e ndarë, me ose pas fëmijë, merrte rrobat e trupit, ndonëse ato ishin blerë nga burri, pajën që sillte me vete, si dhe dhurata që ishin bërë para ose pas martesës²⁴⁶.

2.2.1.3. E drejta kanonike

Për popullsinë katolike dhe atë ortodokse për rregullimin e marrëdhënieve familjare, zbatohet me ndërveprim si e drejta zakonore ashtu dhe normat kanonike të ritit ortodoks apo katolik. Për rregullimin e marrëdhënieve martesore, normat kanonike të ritit ortodoks përbënin një sistemim të disa ligjeve bizantine, të përmbledhura nga juristi selanikas Kostandinos Armenopollos, në gjashtë libra – Heksabiblos. Edhe pas pushtimit osman, gjykatat kishitare të ritit ortodoks bizantin, që u lejuan të vepronin në territorin e perandorisë turke, kanë zbatuar dispozitat e përfshira në këto gjashtë libra, për sa i përket marrëdhënieve martesore dhe familjare ndërmjet të krishterëve ortodoksë²⁴⁷.

Ndërsa, e drejta kanonike e ritit katolik përbëhej nga tërësia e normave të sistemuara në Corpus Juris Canonica. Marrëdhëniet martesore u përfshinë në kompetencën e kishës katolike, me vendim të Këshillit të Shenjtë, që u mbajt në qytetin e Trentos, në vitin 1563 (Sacrum Concilium Tridenti)²⁴⁸.

²⁴¹ Selemi ishte një institut relativisht i ri i të drejtës zakonore shqiptare, ai filloi të shfaqej gjatë kohës së shpërbërjes së familjes së madhe patriarkale dhe kalimit drejt familjeve të veçanta, sipas kurorave. Shih: Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 181. Ky institut emërtohej “selemi” në Veri dhe “pekuli” në Jug. Përveç institutit të selemi, në Kanunin e Lumës dhe të Skënderbeut marrëdhëniet pasurore, ndërmjet anëtarëve të familjes rregulloheshin edhe nga instituti i “Mirazit”. Sipas mirazit, kur trashëgimlënësi nuk kishte djem, por vetëm vajza të martuara, këto thirreshin si trashëgimtarë të radhës së dytë dhe konkuronin në bashku me kushërinjtë e tyre. Shih: Konomi (Perolla). *Rendi etnojuridik në Shqipëri: Nga statutet, tek kanunet*, fq. 289-290.

²⁴² Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 180.

²⁴³ Konomi (Perolla). *Rendi etnojuridik në Shqipëri: Nga statutet, tek kanunet*, fq. 289.

²⁴⁴ Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 200.

²⁴⁵ Përveç tyre, sipas sharteve të Idriz Sulit, kishte të drejtë të merrte edhe 60 okër misër.

²⁴⁶ Luarasi, *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*, fq. 200.

²⁴⁷ Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 15.

²⁴⁸ Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 16.

2.2.2. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore në Kodin Civil të vitit 1929

Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, i cili hyri në fuqi më 1 Prill të vitit 1929, u hartua sipas modelit të Kodit Civil francez të vitit 1804, atij italian të vitit 1865 dhe sipas një modeli të përbashkët franko-italian, i cili nuk u miratua asnjëherë.

Ky kod përfaqëson një progres të mirëfilltë dhe është gjykuar nga doktrina juridike, në raport me kushtet shoqërore në të cilat u miratua, si legjislacioni më i mirë civil, që nga koha e krijimit të shtetit shqiptar e deri më sot²⁴⁹.

Kodi Civil i Zogut pati një rëndësi të madhe për kohën kur u miratua, sepse për herë të parë parashikonte një rregullim unik të marrëdhënieve familjare në Shqipëri²⁵⁰, pavarësisht nga besimi fetar i anëtarëve të familjes; por në praktikë gjeti zbatim me shumë vështirësi për shkak të ndikimit të fuqishëm që vazhduan të kishin e drejta zakonore dhe normat fetare²⁵¹.

Kujtojmë këtu që, deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil, të vitit 1929, marrëdhëniet familjare rregulloheshin sipas normave të së drejtës zakonore si dhe mbi bazën e besimit fetar të subjekteve, në këtë kuadër Kodi pati një rëndësi të madhe për kohën, sepse vendosi mbi baza ligjore marrëdhëniet familjare, të cilat do të ishin unike për të gjithë Shqipërinë. Megjithatë, në praktikë, referuar normave rregulluese të marrëdhënieve familjare, Kodi gjeti zbatim të pakët²⁵² për shkak të ndikimeve të mëdha të së drejtës zakonore dhe normave fetare.

Bazuar në nenin 1321 të Kodit Civil të Zogut, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve **“shoqënia bashkëshortore”**, rregullohen nga kontrata e palëve **“konvencione”** dhe prej ligjit. Për rrjedhojë, si rregull i përgjithshëm marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve rregullohen mbi bazën e kontratës martesore dhe vetëm në mungesë të një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, do të zbatohet regjimi ligjor **“Bashkëpasunimi midis bashkëshortëve”** (nenet 1376-1389).

2.2.2.1. Kontrata Martesore

Si rregull i përgjithshëm, Kodi Civil i Zogut parashikonte mundësinë e bashkëshortëve për të rregulluar me kontratë martesore²⁵³ marrëdhëniet e tyre pasurore, gjatë martesës²⁵⁴.

Legjislatori, në hartimin e Kodit Civil të 1929, ka mbajtur qëndrimin se interesi i shtetit për ndërtimin e një familje të shëndoshë mbi bazat e martesës nuk imponon domosdoshmerisht kufizimin e lirisë individuale në zgjedhjen e regjimit pasuror bashkëshortor. Liria kontraktore në rregullimin e regjimit pasuror martesor nuk mund të jetë e pakufizuar, por pëson disa kufizime, të cilat shteti i konsideron të nevojshme për organizimin e shëndoshë të familjes. Për rrjedhojë, në ndryshim nga kontratat e tjera, në kontratat martesore hasen mjaft norma ndaluese²⁵⁵, që nuk mund të anashkalojnë nga palët.²⁵⁶

²⁴⁹ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 21.

²⁵⁰ Rregullimi i martesës, bazohej në martesën monogame, pavarësisht nga përkatësia fetare e bashkëshortëve; në formën civile të martesës, duke eliminuar martesën fetare; njohu të drejtën e bashkëshortëve për të rregulluar marrëdhëniet e tyre pasurore, nëpërmjet instrumentit të kontratës martesore; njohu të drejtën e zgjidhjes së martesës si dhe të drejtën e trashëgimisë në favor të gruas. Shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 21-22.

²⁵¹ Zaka, Tefta. *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*. Disertacion. Tiranë: 1999, fq. 6.

²⁵² Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 6.

²⁵³ Kodi Civil i Zogut përdorte termin **“konvencion”** për t’iu referuar kontratës martesore, nën shembullin e modelit Italian. Edhe sot Kodi Civil Italian përdor termin **“konvencion”** (convenzione matrimoniale).

²⁵⁴ Ashtu si Kodi Civil i vitit 1929 edhe Kodi aktual i Familjes, neni 66, parashikon mundësinë e bashkëshortëve për të rregulluar me marrëveshje (kontratë martesore) regjimin pasuror martesor që dëshirojnë.

²⁵⁵ Kështu bashkëshortët nuk mund të lidhnin pakte në kundërshtim me të drejtat që i takonin kryetarit të familjes, as me ato që ligji i atribuonte njërit apo tjetrit nga bashkëshortët, as edhe me dispozitat ndalimtare, që përmbante Kodi (neni 1322). Ata nuk mund të parashikonin në kontratën martesore asnjë parashikim që kishte për qëllim ndërrimin e

Kontrata martesore duhet t'i nënshtrohej rregullave të vlefshmërisë që kishin të bënin me formën dhe kohën e lidhjes së kontratës .

Bazuar në nenin 1325 të Kodit Civil, kontrata duhet të bëhet me akt noterial për efekt vlefshmërie, gjithashtu çdo ndryshim i saj, para lidhjes së martesës duhet të bëhet me akt noterial dhe me pëlqimin e shprehur të të gjithë palëve që marrin pjesë në të (neni 1326).

Gjithashtu, bazuar në parimin e pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor, gjatë martesës, Kodi parashikonte që, kontrata martesore mund të modifikohet vetëm para lidhjes së martesës. Gjatë martesës ishte e ndaluar çdo mundësi e ndryshimit të regjimit pasuror martesor (neni 1328 dhe neni 1376, paragrafi 2)²⁵⁷.

Justifikimi i pandryshueshmërisë së kontratës martesore, gjatë kohëzgjatjes së martesës, mbështetet mbi tre arsye kryesore: *së pari*, kontrata martesore konsiderohet si një pakt (marrëveshje) i familjes, në lidhjen e së cilës merrnin pjesë jo vetëm bashkëshortët e ardhshëm, por edhe të tjerë persona si psh: prindërit e bashkëshortëve të ardhshëm, ose persona të tjerë që i dhuronin sende bashkëshortëve, kështu që, modifikimi i saj nuk mund t'i lihej thjesht vullnetit të bashkëshortëve; *së dyti*, pandryshueshmëria ishte parashikuar në favor të mbrojtjes së bashkëshortit më të dobët (gruas), i cili gjatë martesës mund të bënte një zgjedhje jo të duhur dhe t'i bindej bashkëshortit tjetër në kërkesën e tij për të ndryshuar kontratën martesore; *së treti*, parimi i pandryshueshmërisë garantonte edhe mbrojtjen e të tretëve, kur ata kontraktonin me bashkëshortët²⁵⁸.

Kodi Civil parashikonte regjistrimin e kontratës martesore në aktin e martesës. Bazuar në nenin 52/8 të kodit, dhëndri dhe nusja, në momentin e lidhjes së martesës, duhet të tregojnë para nëpunësit të gjendjes civile, nëse kanë lidhur një kontratë martesore, të tregojnë, nëse është e mundshme, datën e lidhjes së kontratës, nëse ka, si dhe emrin e noterit që e ka hartuar kontratën²⁵⁹.

Në kuadër të zotësisë për të lidhur kontratën martesore, Kodi Civil i Zogut, sanksiononte parimin e mirënjohur të së drejtës "*habilis ad nuptias habilis ad pacta nuptialia*", të cilin e ndeshim edhe në legjislacionet aktuale (kodi civil francez, italian, zviceran)²⁶⁰.

I vetmi regjim pasuror kontraktor, që gjen rregullim të detajuar në Kodin Civil ishte regjimi dotal. Në regjimin dotal, pasuria e gruas përbëhej nga dy pjesë, pasuria e konstituuar dotë dhe pasuria parafernale. Përveç krijimit të dotës mbi pasurinë e gruas, bashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të zgjidhnin për zbatim, për pjesën e mbetur të pasurisë që nuk përfshihej në dotë, regjimin e pjesëmarrjes në fitime "*bashkëpasunimi në fitime*"²⁶¹, regjimi, i cili nuk gjen rregullim në Kodin Civil të vitit 1929.

rradhës ligjore të trashëgimtarëve (neni 1323), ose të parashikonin, që martesë e tyre të rregullohet sipas zakoneve të vendit, ose ligjeve të cilat nuk ushtroheshin ligjërisht (neni 1324).

²⁵⁶ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 20.01.2009.

²⁵⁷ Në ndryshim nga Kodi Civil i Zogut, Kodi aktual i Familjes, parashikon mundësinë e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, gjatë martesës, me kushtin që, të kenë kaluar të paktën 2 vjet nga regjimi pasuror i mëparshëm (neni 74/1 i kodit të familjes).

²⁵⁸ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 157.

²⁵⁹ Nëse nëpunësi nuk pasqyron këto elementë në aktin e martesës, ai dënohet me gjobë deri në 200 franga ari.

²⁶⁰ Një rregullim të ndryshëm bën kodi aktual i familjes, në neni 70, i cili parashikon që, në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore, derisa të mbushë moshën 18 vjeç, rast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.

²⁶¹ Bazuar në nenin 1367 të Kodit, bashkëshortët nuk mund të kontraktojnë bashkëpasunim universal tjetër, veç atij të fitimeve, bashkëpasunim i cili, mund të paktohet edhe kur është konstituuar dota.

Regjimi Dotal. Regjimi më i rëndësishëm pasuror kontraktor, i parashikuar në Kodin Civil të Zogut, është regjimi “*dotal*”²⁶², i cili është rregulluar mbi bazën e dy instituteve “*Dota*” (nenet 1331-1360) dhe “*Pasuria parafernale*” (nenet 1368-1375). Në regjimin kontraktor dotal, pasuria e gruas ndahej në dy grupe: a) pasuria dotale dhe b) pasuria parafernale, secilit prej të cilëve i zbatohesh një regjim juridik i veçantë. Për sa i përket natyrës juridike, regjimi dotal ishte një lloj regjimi i pasurive të ndara.

A. Dota (1331-1367)

Dota ishte pasuria që gruaja ose të tjerët në vend të saj ia sillnin burrit për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga martesë (neni 1331). Kontributi ekonomik i gruas për shpenzimet në drejtim të jetës familjare dhe të rritjes dhe edukimit të fëmijëve realizoheshin nëpërmjet pasurisë së vendosur në dotë.

Dota duhet të konstituohej shprehimisht, palët duhet të bënin një parashikim me shkrim të të mirave që do të përfshiheshin në dotë. Dota mund të përfshinte tërësisht ose pjesërisht pasurinë e tashme dhe të ardhme të gruas, ose dhe një send të caktuar si dhe mund të përfshinte edhe pasurinë e personave të tretë (pasuria atërore dhe amënore). Nëse në kontratën e martesës, objekti i pasurisë dotale ishte i rregulluar me fjalët “*gjithë pasuria e gruas*”, atëherë në dotë do të përfshihej vetëm pasuria e tashme e saj dhe jo ajo e ardhshme (neni 1332). Dota mund të konstituohej edhe nga persona të tretë, si psh. prindërit e gruas ose persona të tjerë të familjes së saj (neni 1336-1338). Sendet e fituara me të hollat e dotës nuk përfshihen në pasurinë dotale, me përjashtim të rastit kur në kontratën e martesës është parashikuar ndryshe (neni 1346), ndërsa pasuria e fituar si shkëmbim i një pasurie bëhet dotale (neni 1349).

Rregullimi i dotës në kontratën e martesës, mund të realizohej vetëm para lidhjes së martesës dhe nuk mund t’i nënshtrohej ndryshimit, gjatë vazhdimit të saj (neni 1335).

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës pasuria e përfshirë në dotë ishte në pronësi të gruas, ndërsa burrit nuk i njihesh asnjë e drejtë pronësie mbi këtë pasuri, ai ruante të drejtën e administrimit të dotës²⁶³.

Megjithëse gruaja ishte e përjashtuar nga e drejta e administrimit të pasurisë dotale, në rast se dota keqpërdorej nga bashkëshorti, ose rrezikonte të përdorej vetëm për shlyerjen e borxheve personale të tij, gruaja mund t’i drejtohej gjykatës së shkallës së parë dhe t’i kërkonte veçimin e dotës²⁶⁴. Gjithashtu veçimi i dotës mund të kërkohej nga gruaja edhe kur ishte vendosur veçimi personal për faj të bashkëshortit, ose të të dyve. Kur gjykata vendoste veçimin e dotës, gruaja detyrohej të kontribuonte sipas fuqisë ekonomike të saj në shpenzimet familjare dhe në

²⁶² Regjimi dotal parashikohej si regjimi pasuror ligjor në Kodin Civil Italian, i vitit 1865, si dhe parashikohej si regjim kontraktor në Kodin Civil Francez të vitit 1804.

²⁶³ Bashkëshorti mund të ngrinte padi në gjykatë kundër debitorëve dhe nëdorësve të dotës, si dhe të mblidhte frutat dhe kamatat e saj. Mund të pohojmë që, burri gëzonte një të drejtë uzufukti mbi pasurinë dotale, dhe ishte përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga pakujdesia e tij në administrim (neni 1351).

²⁶⁴ Vendim i Gjykatës së Diktimit, nr. 168, datë 07.09.1938. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Diktimit lidhur me dotën, kryesisht është e lidhur me veçimin e dotës dhe ndikimin e saj në marrëdhënie me të tretët. Në Gjykatën e Diktimit u paraqit çështja me objekt anulimin e kontratës së shitblerjes së një shtëpie e një dyqani, pronë e bashkëshortit, i cili ia kishte shitur këto pasuri bashkëshortes së tij, me qëllim zvogëlimin e pasurisë për shmangien e përmblidhjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tij. Çmimin e blerjes bashkëshortja pretendon se e ka paguar pjesërisht në dorë dhe pjesërisht me kompensim. Pikërisht, pjesa e kompensimit në këtë rast kishte të bënte me dotën, që kishte për të marrë bashkëshortja nga bashkëshorti i saj, dotë të cilën ia kishte dhënë bashkëshortes i ati kur ishin martuar. Gjykata ka pranuar padinë e anulimit të kontratës së shitjes me arsyetimin se, në kontratën e shitblerjes nuk përshkruhet ndryshimi i kontratës së dotës, meqenëse i ati i të paditurës është shprehur për dotën në favor të bashkëshortit, pasi kthimi i dotës nuk mund të bëhet deri sa vazhdon martesë. Gjithashtu, edhe veçimi i dotës, masë tjetër kjo për mbrojtjen e të drejtave të gruas, mund të bëhet vetëm me vendim gjyqësor dhe jo jashtëgjyqësor, sepse një marrëveshje e tillë, në bazë të Kodit Civil, është e pavlefshme.

mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Në këtë rast gruaja merrte administrimin e lirë të pasurisë së saj.

Si rregull i përgjithshëm, ishte i ndaluar tjetërsimi dhe hipotekimi i dotës, gjatë kohëzgjatjes së martesës (nenin 1348). Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, pasuria dotale mund të tjetërsohej ose hipotekohej, vetëm në dy raste të parashikuara në mënyrë taksative nga ligji: a) nëse ishte lejuar tjetërsimi në kontratën e martesës; b) me pëlqimin e të dy bashkëshortëve nëse autorizohet në bazë të një vendimi gjyqësor, në rast nevojë ose dobie evidente (neni 1347 dhe 1348). Çdo veprim juridik për tjetërsimin e dotës, në kundërshtim me kushtet e parashikuara më sipër, është i pavlefshëm (neni 1350).

Në përfundim të martesës, dota kthehet në pasurinë e gruas ose të personit, në pronësi të të cilit, është pasuria dotale (neni 1352-1360).

B. Pasuria parafernale.

Pasuria parafernale ishte pasuria e gruas që nuk përbënte dotë, pra pasuria *“extra dotem”*. Sipas kuptimit të nenit 1368 të Kodit Civil të vitit 1929, ishin parafernale të gjitha të mirat që nuk ishin përfshirë në dotë.

Gruaja mbante të drejta absolute mbi të mirat parafernale. Sipas nenit 1370 të Kodit Civil, të vitit 1929, **gruaja gëzonte të drejtën e zotërimit, administrimit dhe gëzimit të pasurisë parafernale të saj**. Në dallim nga dota, burri nuk gëzonte as të drejtën e administrimit dhe as të kërkonte kreditë e saj, nëqoftëse nuk ishte autorizuar nga gruaja (neni 1370). Megjithatë, ligji nuk e kishte ndaluar gruan që t'i besonte, me anë të një prokure, bashkëshortit të saj administrimin e kësaj pasurie (neni 1371).

Bazuar në interpretimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁶⁵, për të dalluar se cilat të mira ishin parafernale duhet të analizohej nëse ishte bërë kushtituimi i dotës dhe cilat të mira ishin pjesë e saj dhe me metodën e përjashtimit do të përcaktohej se parafernali do të ishin të gjitha ato të mira të gruas së martuar, që nuk ishin të përcaktuara si dotale.

Nga ky interpretim i Gjykatës së Lartë, kuptohet se do të ishin parafernali:

- a) E gjithë pasuria që gruaja kishte në momentin e lidhjes së martesës, me përjashtim të pasurisë së konstituar dotë;
- b) Pasuria e fituar nga gruaja, gjatë martesës, me çfarëdo lloji titulli, qoftë suksedimi, dhurimi, ose si rrjedhojë e punës së saj.

Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, pakica e gjyqtarëve janë të mendimit që, shumica ka bërë një interpretim të zgjeruar të dispozitave që lidhen me këtë institut, dukë përfshirë në këtë pasuri, jo vetëm të mirat që gruaja kishte në momentin e lidhjes së martesës, por edhe ato që kishte fituar më vonë me çdo lloj titulli. Sipas arsytimit të pakicës, vetë fjala parafernale, e ardhur nga fjala greke *“parapherna”*, do të thotë pasuri në pronësi të gruas, e cila në çastin e lidhjes së martesës nuk është kushtituar dotë, për rrjedhojë në pasurinë parafernale nuk përfshihet pasuria e fituar nga gruaja gjatë martesës²⁶⁶.

Në analizë të fundit, bazuar në Kodin Civil Francez të vitit 1804, atë Italian të vitit 1865 si dhe në doktrinën përkatëse, jemi të mendimit që, në përbërje të pasurisë parafernale do të përfshihet jo vetëm pasuria në pronësi të gruas para lidhjes së martesës (me përjashtim të pasurisë së konstituar dotë), por edhe çdo pasuri e fituar nga gruaja *constante matrimoni*. Vetë regjimi pasuror dotal përbënte, në thelb, një regjim të pasurive të ndara dhe bazohet në ndarjen e pasurisë së gruas në dy pjesë: a) pasuria dotale dhe b) pasuria parafernale.

²⁶⁵ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009.

²⁶⁶ Për më shumë shih mendimin e pakicës së gjyqtarëve në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009.

2.2.2.2. Regjimi pasuror ligjor - Bashkëpasunimi midis bashkëshortëve

Në mungesë të kontratës martesore, për rregullimin e regjimit pasuror do të zbatohen dispozitat e titullit “*Shoqënia*”, por në të gjitha rastet do të zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 1378-1389 të kodit, të cilët rregullojnë “*regjimin e bashkëpasunimit midis bashkëshortëve*”. Bazuar në këtë interpretim, regjimi pasuror ligjor, i cili zbatohet në mungesë të kontratës martesore, ishte regjimi i “*bashkëpasunimit*”. Problemi, që paraqitet për zgjidhje, është përcaktimi i natyrës juridike dhe objektit të këtij regjimi.

A. Natyra juridike e “Bashkëpasunimit”. Sipas doktrinës më në zë të kohës²⁶⁷, megjithëse fjalët bashkëpasunim dhe bashkëzotënim konsiderohen të një kuptimta midis tyre, ka një diferencë si ajo që ekziston midis gjinisë dhe llojit: bashkëpasunimi ka një kuptim shumë më të gjerë se bashkëzotënimi. Ai, nga një anë, përfshin bashkëzotënimin, i cili është lloji më me rëndësi i bashkëpasunimit, dhe nga ana tjetër përfshin edhe bashkëpasunimin e sendeve të destinuara për t’u gëzuar së bashku, bashkëpasunimin midis bashkëshortëve, bashkëpasunimin e shokëve, si dhe midis trashëgimtarëve dhe legatarëve.

Sipas arsytimit të Gjykatës së Lartë²⁶⁸, nga leximi i dispozitave të Kodit Civil të Zogut, del qartë se bashkëpasunimi, në kuptimin juridik, dhe bashkëzotënimin nuk janë e njëjta gjë. Bashkëzotënimin përfaqëson në vetvete bashkëpronësinë sipas kuptimit juridik, që i jepet bashkëpronësisë në legjislacionin aktual.

Bashkëpasunimi ka një kuptim më të gjërë sesa bashkëzotënimin. Zotënimin ose bashkëzotënimin është e drejta për të gëzuar ose për të disponuar sendet. Pra tek zotënimin dhe bashkëzotënimin ekzistojnë të dy tagrat, e drejta e gëzimit dhe e drejta e disponimit (neni 794 i K.Civil). Ndërsa tek bashkëpasunimi e drejta e gëzimit dhe e drejta e disponimit mund të qëndrojnë dhe të veçuar nga njëra-tjetra. Kjo del nga krahasimi i dispozitave që rregullojnë bashkëpasunimin (titulli i IV i librit të tretë), me dispozitat që rregullojnë të drejtën e parablerjes (titulli të V të po këtij libri) midis bashkëzotënuarëve të pronave. Bashkëpasunimi konsiston kryesisht në gëzimin dhe në nxjerrjen e fitimeve të përbashkëta mbi sende të veçanta. Bashkëpasunimi ka më shumë karakteristikat e një shoqërie të thjeshtë, ku secili pronar ruan të drejtën e tij të pronësisë, duke pasur të drejtën e disponimit të lirë të këtyre sendeve tek të tretët, pa pëlqimin e bashkëpasunuesve të tjerë.

B. Objekti i Bashkëpasunimit. Bazuar në Kodin Civil të Zogut, në objektin e bashkëpasunimit do të përfshihet pasuria e mëposhtme:

- a) Sendet e luajtshme në pronësi të bashkëshortëve para lidhjes së martesës si dhe sendet e luajtshme të fituara nga bashkëshortët gjatë martesës, nëse nuk ekziston një përshkrim autentik i kësaj pasurie në emër të njërit bashkëshort.

Ky prezumim i bashkëpronësisë për sendet e luajtshme parashikohet në nenin 1380 të Kodit Civil, sipas të cilit “*Bashkëshortët para martesës detyrohen të bëjnë një përshkrim autentik të pasurisë së luajtshme që kanë, si dhe një përshkrim për sendet e luajtshme që u vijnë sa vazhdon bashkëpasunimi. Në mungesë të një përshkrimi të tillë ose të një titulli autentik tjetër, sendet e luajtshme konsiderohen si fitime të bashkëpasunimit.*”

Nga interpretimi “*per a contrario*” i nenit 1380 të Kodit Civil, rezulton që, sendet e luajtshme të fituara para lidhjes së martesës ose gjatë saj, për të cilat ekziston një përshkrim autentik, nuk

²⁶⁷ Benussi, Baltasar. *Komentari i Kodit Civil. Sendet, zotënimin dhe modifikimet e tija*. Tiranë: Botimi i Ministrisë së Drejtësisë, 1931, fq. 45.

²⁶⁸ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009.

përfshihen në objektin e bashkëpasunimit, por konsiderohen pasuri vetjake e secilit bashkëshort²⁶⁹.

- b) E drejta e gëzimit të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të tashme ose të ardhshme, të secilit bashkëshort (neni 1378).
- c) Pasuria e fituar gjatë martesës me fitimet e bashkëpasunimit (pasuria e paluajtshme e fituar me kontributin e përbashkët të të dy bashkëshortëve).
- d) Në zbatim të të nenit 1379 të Kodit Civil, të gjitha fitimet që nxjerr burri dhe gruaja së bashku ose secili prej tyre veç e veç gjatë kohës që vazhdon regjimi i bashkëpronësisë, qofshin këto fitime të rrjedhura nga industria e përbashkët ose nga ekonomia e tyre, janë të përbashkëta dhe të ndashme, duke zbritur më parë debitë që rëndojnë mbi bashkëpronësinë e bashkëshortëve.

Nga ana tjetër, përjashtohen nga objekti i bashkëpasunimit të bashkëshortëve dhe për rrjedhojë konsiderohen pasuri vetjake të bashkëshortit në emër të të cilit janë fituar:

- a) Pasuria e luajtshme e fituar para lidhjes së martesës ose gjatë saj, nga secili prej bashkëshortëve, për të cilën ekziston një përshkrim autentik (neni 1380).
- b) Aktivi dhe pasivi i pasurisë së fituar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës (neni 1367).
- c) Pasuria e fituar me dhurim ose trashëgimi, gjatë kohëzgjatjes së martesës (neni 1367).
- d) Pasuria e fituar nga njëri bashkëshort dhe që figuron e regjistruar në emër të njërit bashkëshort, gjatë kohëzgjatjes së martesës (nëse nuk është fituar me fitimet e bashkëpasunimit).

Pyetja që shtrohet për diskutim është nëse pasuria e paluajtshme, e fituar gjatë martesës nga njëri bashkëshort (duke përjashtuar sendet e fituara me dhurim ose trashëgimi) do të bëjë ose jo pjesë në objektin e bashkëpasunimit.

Sipas interpretimit të Gjykatës së Lartë²⁷⁰: *“Në rastet kur mungojnë pakte të posaçme të hartuara me akt publik para noterit para martesës dhe prona e vënë gjatë martesës figuron në emër të njërit prej bashkëshortëve, kjo pronë i takon bashkëshortit në emër të të cilit është regjistruar. Ekzistenca e titullit të pronësisë në emër të njërit prej bashkëshortëve është provë bindëse se pronësia mbi sendin nuk është rezultat i fitimeve të bashkëpasunimit dhe për pasojë pronësia i mbetet atij bashkëshorti që ka titullin e pronësisë. Pasuria e vënë gjatë martesës konsiderohet në bashkëpronësi vetëm kur vërtetohet se ajo është vënë me fitimet e bashkëpasunimit”*. Në vazhdim të të njëjtit arsyetim, nga interpretimi i këtyre dispozitave del qartë se bashkëpasunimi i përcaktuar në nenet 1376 deri 1389 të Kodit Civil shtrihet vetëm mbi të drejtën e gëzimit të kësaj pasurie dhe bëhet pasuri bashkëshortore vetëm ajo pasuri e vënë me fitimet e përbashkëta të dy bashkëshortëve dhe se sendet, që figurojnë në pronësinë individuale të secilit bashkëshort nuk përfshihen në pasurinë bashkëshortore²⁷¹.

²⁶⁹ Sipas Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009: *“prezumimi i bashkëzotimit është pranuar vetëm për sendet e luajtshme të fituara gjatë martesës, në rastet kur nuk ekziston një përshkrim autentik i kësaj pasurie në emër të njërit bashkëshort”*.

²⁷⁰ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009.

²⁷¹ Nga ana tjetër, bazuar në mendimin e pakicës, në të njëjtin vendim, pasuria e fituar nga njëri prej bashkëshortëve, për sa kohë vazhdon martesa dhe pa qenë në asnjërën prej kushteve të tjera të nenit 1384 të këtij Kodi, do të konsiderohet si pasuri e të dy bashkëshortëve. I takon bashkëshortit që pretendon, të provojë se të ardhurat me të cilat është blerë pasuria kanë qenë të tijat dhe jo të përfshira në bashkëpasunim. Kodi Civil, vazhdon arsyetimin e saj pakica, nëpërmjet përjashtimeve të vendosura në nene të veçanta të tij, për kategori të caktuara të pasurisë që nuk mund të konsiderohen pjesë e bashkëpasunimit (e bashkëpronësisë), ka lënë të kuptohet se gjithçka tjetër që nuk është pjesë e këtyre përjashtimeve është pjesë e bashkëpasunimit dhe duhet trajtuar si e tillë. Kjo do të thotë se, çdo pasuri tjetër veç asaj që nuk është përjashtuar, nga neni 1378, bën pjesë në bashkëpasunim.

C. Vështrim kritik mbi Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 20.01.2009²⁷². Në drejtim të objektit të “*pasurisë parafernale*”, mbështesim arsyetimin e Kolegjeve të Bashkuara²⁷³, sipas të cilit, në përbërje të pasurisë parafernale përfshihet jo vetëm pasuria e gruas para lidhjes së martesës, por edhe pasuria që fiton gruaja *constante matrimonii*. Për rrjedhojë nuk pajtohem me interpretimin që mendimi i pakicës i bën pasurisë parafernale. Gjithashtu nga ana tjetër, si shumica ashtu edhe pakica e gjyqtarëve, ngatërrojnë konceptet e regjimit pasuror dotal me atë të bashkëpasunimit. Regjimi dotal është rregulluar në Kodin Civil të Zogut si regjim pasuror kontraktor dhe është një regjim i pasurive të ndara në thelb, ndërsa regjimi i bashkëpasunimit është regjimi pasuror ligjor, i cili gjen zbatim në mungesë të pakteve të veçanta ndërmjet bashkëshortëve. Megjithatë, me anë të kontratës martesore, bashkëshortët mund të rregullojnë bashkekzistencën e regjimit dotal me regjimin e “*bashkëpasunimit në fitime*”.

Në drejtim të objektit të bashkëpasunimit dhe konkretisht të përfshirjes ose jo në bashkëpasunim të pasurisë së paluajtshme të fituar nga secili prej bashkëshortëve gjatë kohëzgjatjes së martesës, gjykatat më të ulëta dhe vetë Kolegjet e kësaj gjykate kanë bërë interpretime të ndryshme; disa interpretime kanë çuar drejt pranimit të konceptit se me përjashtim të sendeve që secili ka pasur në pronësi para martesës dhe sendeve që iu vijnë trashëgim, gjithçka tjetër e fituar nga bashkëshortët është pjesë e bashkëpronësisë²⁷⁴; ndërsa disa interpretime të tjera²⁷⁵ pranojnë se ato janë pronë e atij bashkëshorti, në emër të të cilit figurojnë të jenë blerë, apo regjistruar.

Bazuar në analizën e vendimit të Gjykatës së Lartë, rezulton që shumica dhe pakica e gjyqtarëve nuk ndajnë të njëjtin qëndrim mbi problemin e përfshirjes ose jo të pasurisë së paluajtshme, të fituar gjatë martesës nga njëri bashkëshort, në bashkëpasunim. Sipas shumicës së gjyqtarëve, pasuria e fituar gjatë martesës, e luajtshme ose e paluajtshme prezumohet se është në pronësi të bashkëshortit që e ka fituar dhe në emër të të cilit është regjistruar. Pasuria e vënë gjatë martesës është në bashkëpronësinë e dy bashkëshortëve, vetëm nëse vërtetohet se është fituar me “*fitimet e bashkëpasunimit*”. Ndërsa nga ana tjetër, sipas mendimit të pakicës së gjyqtarëve²⁷⁶, pasuria e fituar nga njëri prej bashkëshortëve, për sa kohë vazhdon martesa dhe pa qenë në asnjërin prej kushteve të tjera të nenit 1384 të këtij Kodi, do të konsiderohet si pasuri e të dy bashkëshortëve. I takon bashkëshortit që pretendon, të provojë se të ardhurat me të cilat është blerë pasuria kanë qenë të tijat dhe jo të përfshira në bashkëpasunim.

Me qëllim përcaktimin e saktë të objektit të regjimit të bashkëpasunimit dhe konkretisht me qëllim përcaktimin nëse pasuria e paluajtshme e fituar nga njëri bashkëshort gjatë martesës është

²⁷² Rrethanat e faktit: “*Me vërtetimin e datës 19.08.1944 rezulton që, shtetasi S.A. ka blerë një truall, më datë 19.07.1937. Në këtë truall, në vitin 1939, është ndërtuar shtëpia objekt gjykimi, shtëpi kjo që, në bazë të dokumentave zyrtare, datë 07.07.1949, rezulton të jetë ndërtuar me të hollat personale të vetë shtetasit S.A. Gjithashtu, në rastin konkret mungojnë pakte të posaçme të hartuara me akt publik para noterit dhe para martesës, si dhe regjistrimi si i tokës ashtu dhe i banesës është bërë vetëm në emër të shtetasit S.A. Shtetasi S.A ka lidhur martesë me shtetasen N.A., në datë 10.06.1936. Pas vdekjes së bashkëshortes së tij, në datë 09.10.1982, SA. i dhuron njëri prej vajzave të tij BS. (e paditur) shtëpinë objekt gjykimi. Djali i subjektit SA. (paditësi) pretendon pavlefshmërinë absolute të kontratës së dhurimit, me pretendimin se në kohën kur është dhuruar pasuria, babai i tij ka qenë pronar vetëm i gjysmës së shtëpisë.*”

²⁷³ Dy janë çështjet që shtrohen për zgjidhje para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:

a) Cili është trajtimi që Kodi Civil i vitit 1929 i bën pasurisë së vënë gjatë martesës nga bashkëshortët, në rastin kur mungojnë pakte të posaçme midis tyre në kontratën e martesës dhe ajo (pasuria) figuron e regjistruar në emër të njërit prej bashkëshortëve?

b) Po nëse midis bashkëshortëve është lidhur një pakt i posaçëm për rregullimin e bashkëpasunimit, deri ku ky pakt është i lejueshëm?

²⁷⁴ Shih: Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 4254, datë 29.06.2005.

²⁷⁵ Shih: Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 870, datë 07.07.2006.

²⁷⁶ Gjyqtarët në pakicë: Besnik Imeraj, Evelina Qirjako, Majlinda Andrea dhe Evjeni Sinoimeri.

vetjake e bashkëshortit që e ka fituar apo bën pjesë në bashkëpasunim, duhet t'i referohemi modeleve ligjore (Kodit Civil Francez dhe atij Italian) mbi bazën e të cilëve është hartuar Kodi Civil i Zogut, si dhe doktrinës përkatëse. Për këtë analizë krahasimore na vjen në ndihmë tabela e konkordimit, e dispozitave të Kodit Civil të Zogut me Kodin Civil Francez (1804), Italian (1865) dhe modelin e përbashkët franko-italian, e cila është miratuar bashkë me vetë Kodin Civil.

Bazuar në interpretimin e dispozitave të Kodit Civil të Zogut, në doktrinën italiane²⁷⁷ dhe atë franceze²⁷⁸ dhe në tabelën e konkordimit të Kodit Civil, jemi të mendimit, që shumica ka arsyetuar drejt në lidhje me objektin e regjimit të bashkëpasunimit. Duke mos u pajtuar me arsyetimin e shumicës, mbajmë qëndrimin që, në objektin e regjimit pasuror martesor të bashkëpasunimit përfshihej pasuria e luajtshme në pronësi të secilit bashkëshort, për të cilën nuk ekzistonte një përshkrim autentik, si dhe “fitimet e bashkëpasunimit”, pra pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e fituar gjatë martesës me fitimet e përbashkëta të të dy bashkëshortëve. Regjimi i bashkëpasunimit ishte regjimi pasuror ligjor në Kodin Civil francez të vitit 1804, i emërtuar “*communauté réduite aux acquêts*”, ndërsa ishte i parashikuar si regjim pasuror kontraktor në Kodin Civil Italian të vitit 1865²⁷⁹.

Bazuar në mendimin doktrinal shqiptar, Kodi Civil i Zogut parashikonte vetëm regjimin e “bashkëpronësisë mbi fitimet”, pavarësisht nga fakti nëse ishte parashikuar kushtituimi i dotës në kontratën martesore ose jo²⁸⁰.

Në analizë të fundit, duhet ritheksuar që, Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, miratuar më 1 Prill të vitit 1929, hartuar nën ndikimin e modelit francez përfaqësonte një risi në realitetin që prezantonte shteti dhe shoqëria shqiptare e asaj kohe. Padyshim, të drejtat e huaja, e veçanërisht ato franceze, italiane dhe deri diku gjermane e zvicerane, do të frymëzonin legjislatorin shqiptar për të sanksionuar në dispozitat e tij barazinë e të gjithë qytetarëve, emancipimin e pronësisë mbi tokën dhe lirinë për angazhim në aktivitete ekonomike²⁸¹.

Hyrja në fuqi e Kodit Civil të Zogut do të diktonte edhe përkatësinë e të drejtës civile shqiptare në familjen romano-gjermanike, duke e shkëputur atë përfundimisht nga e drejta otomane.

Bazuar në kontekstin historik dhe në marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore të shoqërisë shqiptare, të kohës së miratimit, duhet vlerësuar fakti që, Kodi Civil i Zogut solli përmirësimin e pozitës shoqërore të gruas. Nuk jemi aspak dakord me kritikën e një pjese të doktrinës shqiptare²⁸², kritikë e cila e vë theksin tek pozita e pabarabartë e gruas në raport me burrin, gjatë martesës. Padyshim që Kodi Civil i Zogut parashikonte një pozitë më të disfavorshme të gruas në raport me burrin²⁸³, por kjo metodë e rregullimit të marrëdhënies martesore nuk është karakteristike vetëm e Kodit Civil, por karakterizon të gjitha legjislacionet europiane e më gjerë, të asaj periudhe, dhe i përgjigjet kontekstit shoqëror dhe ekonomik të periudhës së miratimit të vetë

²⁷⁷ Galletta, Franca. “La comunione convenzionale.” në *La comunione legale*, M. Bianca, Milano: Giuffrè Editore, 1989, fq. 1034.

²⁷⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 13-14; Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*; Cornu, Gérard. *Le régimes matrimoniaux*. Paris: Presses Univ. de France, 1974.

²⁷⁹ Kujtojmë këtu që, regjimi pasuror ligjor në Kodin Civil Italian të vitit 1865 dhe në atë të vitit 1942 ishte regjimi dotal.

²⁸⁰ Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 11.

²⁸¹ Parathënie e Kodi Civil 1929 (Kodi Civil i Zogut), Mbretëria Shqiptare - Ministria e Drejtësisë. Shtëpia botuese: Papirus, Prill 2010.

²⁸² Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 12.

²⁸³ Kodi Civil parashikonte që burri është kreu i familjes, gruaja ndjek pozitën civile të burrit, merr mbiemrin e tij, detyrohet ta shoqërojë atë kudo që ai e sheh të arsyeshme të caktojë qëndresën e vet. Gjithashtu, për ushtrimin e një profesioni ose një industrie gruaja duhet të marrë pëlqimin e burrit dhe në rast të refuzimit të tij mund të kërkojë autorizimin e Gjykatës së Paqit.

Kodit. Vëme theksin që, legjislacioni (Kodi Civil në rastin konkret) nuk mund të vlerësohet jashtë kontekstit historik dhe ekonomiko-shoqëror të miratimit të tij.

Referuar marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve Kodi solli si risi, njohjen e autonomisë së bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, brenda kufijve të parashikuar nga ligji. Në mungesë të kontratës martesore, pasuria e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës do të rregullohej mbi bazën e regjimit të *“bashkëpasunimit”*. Parashikimi, në Kodin Civil të Zogut, i kontratës martesore përbën një hap të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve familjare të asaj kohe, sidomos në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, duke patur parasysh pozitën shoqërore të gruas në atë kohë²⁸⁴. Megjithëse ishte mjaft modern, ky kod gjeti zbatim në pakët në rregullimin e marrëdhënieve familjare.

2.2.3. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore në periudhën 1945-1992

Në legjislacionin e regjimit socialist, marrëdhëniet pasurore të krijuara gjatë martesës ishin të rregulluara mbi bazën e parimit të barazisë së të drejtave të bashkëshortëve, duke përcaktuar një regjim pasuror të njëjtë për të gjithë bashkëshortët. Parimi i barazisë juridike të burrit dhe gruas, në çdo fushë të jetës politike dhe shoqërore, si parim rregullues bazë i të drejtës familjare, ishte sanksionuar në Kushtetutën e 14 Marsit të vitit 1946²⁸⁵.

Pas Çlirimit të vendit fillimisht u lanë në fuqi²⁸⁶ normat ligjore të periudhës së para Çlirimit, nëse ato ishin në pajtim me parimet e reja social-ekonomike mbi të cilat ishte ndërtuar shteti socialist, deri në nxjerrjen e akteve të reja ligjore nga qeveria e re, e krijuar pas çlirimit të vendit. Për rrjedhojë, marrëdhëniet familjare vazhduan të rregulloheshin përkohësisht deri në miratimin e ligjeve të reja²⁸⁷, nga dispozitat e Kodit Civil të Zogut, nëse këto të fundit nuk vinin në kundërshtim me frymën e re dhe parimet ekonomik-shoqërore të shtetit të ri socialist.

2.2.3.1. Ligji *“Mbi Martesën”* (1948) dhe Dekreti *“Mbi pronësinë”* (1955)

Deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të vitit 1965 dhe më vonë atij të vitit 1981, baza e rregullimit ligjor të marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve ishte Ligji *“Mbi Martesën”* (i vitit 1948)²⁸⁸ dhe Dekreti *“Mbi Pronësinë”* (i vitit 1955)²⁸⁹. Sipas këtij legjislacioni, në

²⁸⁴ Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 8.

²⁸⁵ Neni 17 i Kushtetutës parashikonte *“barazinë e gruas me burrin në çdo fushë të jetës politike e shoqërore si dhe mbrojtjen e veçantë të familjes nga shteti”*. Parimi i barazisë së burrit me gruan ishte parashikuar që në *“Deklaratën mbi të drejtat e qytetarëve”*, të miratuar në mbledhjen e Beratit, më 23 Tetor 1944.

²⁸⁶ Ligji nr. 61, datë 17.05.1946 *“Mbi abrogimin e dispozitave të posaçme të okupacionit dhe mbi vlefshënjë juridike të dispozitave ligjore të vëna para datës 7.4.1939”*.

²⁸⁷ Në kuadrin e marrëdhënieve familjare, u nxorën një sërë ligjesh, të cilat kishin si objekt rregullimi aspekte të ndryshme të marrëdhënieve juridike ndërmjet anëtarëve të familjes. Kështu mund të përmendim: a) Ligji nr. 223, datë 29.03.1946 *“Mbi disa dispozita të posaçme të shkurorëzimit”*, ligji i cili synonte të jepte fund atyre martesave, që për shkak të tronditjes shumë të thellë të marrëdhënies bashkëshortore, kishin përfunduar, por vazhdonin të qëndronin formalisht të pazgjidhura; b) Ligji nr. 224, datë 29.03.1946 *“Mbi legalizimin e bashkëjetesave ilegale”*, i cili parashikonte se dy persona, që bashkëjetonin rregullisht, pa lidhur një martesë civile, detyroheshin që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të celebronin martesën para nëpunësit të gjendjes civile, përndryshe do të merreshin në përgjegjësi penale; c) Ligji nr. 524, datë 19.08.1947 *“Mbi regjistrat e gjendjes civile”*; d) Dekret-Ligji nr. 529, datë 04.09.1947 *“Mbi disa dispozita në lidhje me martesën dhe korigjimin e regjistrave themelare të popullsisë”*; e) Ligji nr. 602, datë 20.05.1948 *“Mbi raportet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve”*; f) Ligji nr. 602, datë 19.05.1948 *“Mbi adoptimin”*; g) Ligji nr. 603, datë 20.05.1948 *“Mbi Kujdestarinë”*; gj) Ligji nr. 623, datë 31.05.1948 *“Mbi ndalimin e disa zakoneve të prapambetura në lidhje me fejesën dhe martesën”* etj. Të gjithë këto ligje, së bashku me ligjin *“Mbi martesën”* dhe dekretin *“Mbi pronësinë”*, përbëjnë Kodin e Familjes, i cili luajti një rol të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve familjare në atë kohë.

²⁸⁸ Ligji *“Mbi martesën”*, nr. 601, miratuar në datë 18.05.1948.

bashkëpronësinë e bashkëshortëve përfshiheshin vetëm sendet e fituara me punë nga bashkëshortët gjatë martesës²⁹⁰. Bazuar në një Vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë²⁹¹, në paragrafin e parë të nenit 9 të ligjit “Mbi Martesën” (1948) është sanksionuar që “Pasuria e fituar me punë prej bashkëshortëve gjatë martesës bëhet pasuri e përbashkët”. Ndryshe sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë²⁹², kjo dispozitë ka parashikuar që pasuria bëhet e përbashkët gjatë martesës kur është fituar nga puna e secilit bashkëshort, pavarësisht kontributeve sado në disproporcion që mund të jenë ato, apo në raporte të barabarta. Në teorinë e së drejtës ky quhet prezumim ligjor, ndaj si i tillë duhet të ishte interpretuar nga gjykata. Pra, nuk është puna e përbashkët, por dhe e ndarë veçmas që mund të sjellë këtë prezumim ligjor, sepse të tillë e ka parashikuar ligjvënësi i kohës kur është shprehur vullneti i tij.

Jemi plotësisht dakord me mënyrën e interpretimit, nga Gjykata e Apelit, të dispozitave të bashkëpronësisë ndërmjet bashkëshortëve, të ligjit “Mbi martesën”. Gjithashtu, në përputhje me qëndrimin e Gjykatës së Apelit, gjykojmë që, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka referuar në mënyrë të gabuar në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 5 datë 08.01.2009. Ky vendim i referohet vetëm regjimit të bashkëpasurimit ndërmjet bashkëshortëve, të rregulluar në dispozitat e Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare dhe nuk i shtrin efektet e tij edhe në ligjin “Për Martesën”²⁹³.

Ligji “Mbi Martesën” (i vitit 1948), rregulloi mënyrën e ndarjes së pasurisë bashkëshortore, mënyrën e administrimit të saj dhe i dha një liri bashkëshortëve për mbajtjen e ekonomisë familjare. Mënyra e mbajtjes së ekonomisë familjare caktohej me marrëveshje të të dy bashkëshortëve.²⁹⁴

Ligji “Mbi martesën” ndalonte lidhjen e atyre kontratave, ndërmjet bashkëshortëve, që privojnë burrin ose gruan nga të drejtat pasurore që u njeh ligji dhe i konsideron këto kontrata të pavlefshme si për të tretët ashtu dhe për bashkëshortët²⁹⁵.

Dekreti “Mbi Pronësinë”, parashikon në mënyrë të veçantë bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve duke përmirësuar rregullimin e bërë në Ligjin “Mbi Martesën”. Ky dekret

²⁸⁹ Dekreti “Mbi Pronësinë”, nr. 2083, miratuar datë 06.08.1955.

²⁹⁰ Begeja, Ksanthipi. *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkenvace Politike dhe Juridike, 1984, fq. 147.

²⁹¹ Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 1298, datë 25.05.2012. Rrethant e faktit: *Në datë 27.11.1954 në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në emër të të ndjerës J.B nënës së paditësit, ka qenë e regjistruar një shtëpi banimi dykatëshe, e përbërë nga tre dhoma në secilin kat, një kuzhinë, një sallon dhe një oborr. Në vitin 1993, e ndjera (nëna e paditësit), i ka dhuruar djalit të saj, të ndjerit S.B, dy dhoma të kësaj banese. Në vitin 1994, e ndjera i ka dhuruar vajzës së saj, të paditures L.I pjesën tjetër të banesës duke mos pasur më pjesë të vetën në këtë pasuri. Në vitin 1994, e paditura I.L pjesën e saj takuese mbi këtë pasuri ia ka shitur të paditurit tjetër Dh.B, djalit të vëllait të saj (M.B.) Duke qenë se M.B ka vdekur, pjesën e tij takuese e ka trashëguar djali i tij DhB. Paditësi, pretendon se kontratat e mësipërme janë absolutisht të pavlefshme, sepse pavarësisht se pasuria është regjistruar në hipotekë në emër të nënës së të paditurit, sipas ligjit të kohës, Ligji “Mbi martesën 1948” është pasuri bashkëshortore, për rrjedhojë, ajo ka qenë bashkëpronare në pjesë të barabarta me bashkëshortin e saj. Nga tërësia e dokumenteve të pronësisë, rezulton se, pronare e pasurisë së pretenduar nga paditësi, ka qenë vetëm J.B, nëna e të paditurit, dhe jo bashkëshorti i saj. Ajo, në vitin 1954, ka blerë nga të tretët këtë pasuri dhe e ka regjistruar në emër të saj, ndërkohë që ka qenë e martuar me X.B që në vitin 1923 dhe bashkëjetuar me të, në martesë deri në vitin 1962, kur ky i fundit ka vdekur.*

²⁹² Bazuar në argumentin e Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë bën një interpretim të gabuar të nenit 9 të Ligjit “Mbi martesën”, duke argumentuar që, dispozita e mësipërme e lidh bashkëpronësinë bashkëshortore me një kusht determinant: që pasuria të jetë fituar me punën e përbashkët dhe jo të fituar me mënyra të tjera. Ky interpretim, vazhdim arsyetimin e saj gjykata, gjen mbështetje të plotë edhe në trajtimin që i ka bërë pasurisë së vënë gjatë martesës. Vendimi Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 5 datë 08.01.2009.

²⁹³ Për më shumë shih Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 4361 datë 25.05.2011.

²⁹⁴ Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 18.

²⁹⁵ Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 19.

parashikonte se pasuria e fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës së tyre i përket në tërësi të dy bashkëshortëve.²⁹⁶ Sipas nenit 96 të Dekretit, përjashtoheshin nga bashkëpronësia e bashkëshortëve sendet, që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim ose trashëgimi, depozitat që ka secili në arkat e kursimit, sendet e përdorimit thjesht personal si dhe sendet dhe veglat e ushtrimit të veprimtarisë ose mjeshhtërisë së tyre.

2.2.3.2. Kodi i Familjes i vitit 1965

Kodi i Familjes, i vitit 1965, i cili hyri në fuqi në 1 Janar të vitit 1966²⁹⁷, bënte një rregullim të ngjashëm, me dy ligjet e sipërpërmendura, të regjimit pasuror martesor. Bazuar në nenin 45/2 të këtij kodi, pasuria e fituar me punë nga secili prej bashkëshortëve²⁹⁸ gjatë martesës bëhet pasuri e përbashkët e të dy bashkëshortëve dhe çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme. Mbi bazën e interpretimit të nenit paragrafit 2 të nenit 45 të Kodit të Familjes së vitit 1965, pohojmë, që ishte i ndaluar rregullimi kontraktor i regjimit pasuror martesor, thënë ndryshe çdo marrëveshje e bashkëshortëve, që kishte për objekt përcaktimin e një regjimi pasuror martesor të ndryshëm nga regjimi ligjor, ishte e pavlefshme. Regjimi ligjor ishte ai i bashkëpronësisë ndërmjet bashkëshortëve, një lloj i bashkëpronësisë në pjesë, ku bashkëshortët gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës nuk e njihnin pjesën e tyre ideale.

Nga leximi i kombinuar i neneve 45/1 dhe 46 të Kodit të Familjes, së vitit 1965, arrijmë në përfundimin që, përjashtojë nga bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve:

a) Pasuria që ka një bashkëshort në kohën e lidhjes së martesës (neni 45/1); dhe

b) Sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim ose me trashëgimi, sendet e përdorimit thjeshtë personal, sendet dhe veglat e ushtrimit të mjeshhtërisë ose të profesionit, kundërvlehtë që ka zëvendësuar një pasuri individuale ose pasuria në të cilën është kthyer kjo kundërvlehtë si dhe çdo pasuri tjetër që nuk është fituar me punë.

Nga analiza e mësipërme, mund të nxjerrim dy përfundime, në lidhje me natyrën juridike të regjimit pasuror martesor të parashikuar në Kodin e Familjes, të vitit 1965: *së pari*, regjimi ligjor ishte një regjim bashkëpronësie i detyrueshëm, për rrjedhojë ishte e pavlefshme çdo marrëveshje e bashkëshortëve për përcaktimin e një tjetër regjimi pasuror, të ndryshëm nga ai ligjor (normat rregulluese të tij ishin dispozita urdhëruese) dhe; *së dyti*, regjimi ligjor ishte një regjim bashkëpronësie të pjesshme, ku në bashkësi përfshihej vetëm pasuria e fituar me punë, gjatë martesës, nga secili bashkëshort.

²⁹⁶ Zaka, *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, fq. 22.

²⁹⁷ Bazuar në nenin 170 të Kodit të Familjes së vitit 1965, dispozitat e këtij Kodi për marrëdhëniet personale të bashkëshortëve, si dhe për marrëdhëniet pasurore të tyre, zbatohen edhe për martesat e lidhura para hyrjes së tij në fuqi, pra si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i mungesës së fuqisë prapavepruese të ligjit civil, kodi i familjes (1965) kishte fuqi prapavepruese.

²⁹⁸ Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë, vitit 1973, fq. 302), arsyeton se: “*Pretendimi i të padituri, se shumë nga sendet e fituara gjatë martesës, për të cilat pretendohet pjestimi nga pala tjetër, janë blerë vetëm me të ardhurat e tij dhe për rrjedhojë nuk duhet t’i nënshtrohen pjestimit, nuk është i drejtë. Gjatë martesës, secili bashkëshort mund të blejë sende të përdorimit familjar me të ardhurat e tij personale, por kjo nuk do të thotë se këto sende i përkasin në pronësi vetëm atij. Sipas Kodit të Familjes, ajo pasuri që vihet gjatë martesës me fitimet nga puna e të dy bashkëshortëve është e përbashkët dhe çdo marrëveshje e kundërt konsiderohet nga ligji e pavlefshme*”.

2.2.3.3. Kodi Civil i vitit 1981

Kodi Civil i vitit 1981²⁹⁹ (hyrë në fuqi në 1 Janar të vitit 1982³⁰⁰), i cili rregullonte regjimin juridik të bashkëpronësisë së bashkëshortëve solli, si risi, disa ndryshime të rëndësishme, në raport më legjislacionin e mëparshëm:

a) *Së pari*, nga njëra anë u hoq dorë nga parimi i bashkëpronësisë në tërësi që, përfshinte të gjitha pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët gjatë martesës, ndërsa nga ana tjetër, u pranua parimi i bashkëpronësisë në pjesë, i cili shtrihej mbi çdo lloj pasurie të fituar nga bashkëshortët gjatë martesës. Pjesët e secilit bashkëshort në këtë lloj bashkëpronësie janë të caktuara, duke u prezumuar se pjesët janë të barabarta gjersa të provohet e kundërta.

b) *Së dyti*, u zgjerua rrethi i sendeve dhe i objekteve që përbëjnë bashkëpronësinë e bashkëshortëve³⁰¹. Bazuar në nenin 86 të Kodit Civil të vitit 1981, në bashkëpronësinë e bashkëshortëve përfshihen të gjitha sendet, depozitat në arkat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar gjatë martesës, pavarësisht nga mënyra e fitimit (me punë, dhurim³⁰², trashëgimi ose shkëmbim), mjafton që mënyra e fitimit të jetë e ligjshme³⁰³. Në bashkëpronësinë e bashkëshortëve përfshihen edhe shpërblimi nga puna e secilit bashkëshort, shpërblime të tjera nga puna ose nga një veprimtari krijuese, pensioni, bursa, ashtu dhe sendet e tjera, qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, letrat me vlerë tek prurësi, që përmbajnë detyrime për pagimin e një shume të hollash, çeqe, të ardhurat e një sendi në pronësi të bashkëshortit tjetër³⁰⁴.

Ndërsa, në pronësinë vetjake të secilit bashkëshort përfshihej³⁰⁵: a) pasuria e fituar nga secili bashkëshort para lidhjes së martesës, si dhe b) sendet e përdorimit vetjak të bashkëshortëve³⁰⁶, të

²⁹⁹ Kodi i Familjes i vitit 1982, nuk rregullonte marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve, por rregullonte vetëm marrëdhëniet e karakterit personal jopasuror.

³⁰⁰ Si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i mungesës së fuqisë prapavepruese të ligjit të ri, i cili si rregull vepron veçse për të ardhmen, Kodi Civil i vitit 1981, ashtu si edhe Kodi i Familjes së vitit 1966, përsa i përket pasurisë së bashkëshortëve, ka fuqi prapavepruese. Kështu, në paragrafin e dytë të nenit 352 të Kodit Civil të vitit 1981 është përcaktuar se *“Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për marrëdhëniet e pronësisë midis bashkëshortëve të lindura para hyrjes së tij në fuqi (1 Janar 1982), në qoftë se nuk është pjesëtuar me marrëveshje të bashkëshortëve, me vendim gjyqësor ose me akt noterial.”*

³⁰¹ Për këto risi shih: Begeja, *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, fq. 145.

³⁰² Sipas Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë, Nr. 3, datë 03.02.2006 *“Në rastin e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve, referur regjimit të bashkëpronësisë së bashkëshortëve të Kodit Civil të vitit 1981, të sendeve vetjake të bashkëshortit dhurues apo sende të bashkëpronësisë, sendi i dhuruar, nga njëri bashkëshort në favor të bashkëshortit tjetër, do të kalojë në pasurinë vetjake të bashkëshortit përfitues, e në këto rrethana, këto sende nuk bëjnë pjesë në bashkësinë (bashkëpronësinë) ndërmjet bashkëshortëve. Të pranosh që dhuruesi gëzon njëkohësisht cilësinë e debitorit dhe atë të kreditorit mbi të njëjtin detyrim, atë të kalimit të pronësisë mbi një send të paluajtshëm, do të thotë t'i japësh mundësinë një subjekti të së drejtës, të lidhë kontratë me veten e tij, gjë që nuk përfaqëson gjë tjetër veçse një non sens juridik. Titullar i sendit të dhuruar, është vetëm bashkëshorti përfitues i dhurimit. Sendi i përfituar nuk bën pjesë në bashkëpronësinë bashkëshortore dhe si e tillë, bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë i vetem kundrejt çdo subjekti, pa marrë pëlqimin e bashkëshortit dhurues.”*

³⁰³ Begeja, *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, fq. 145.

³⁰⁴ Begeja, *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, fq. 146.

³⁰⁵ Para Gjykatës së Apelit Tiranë është shtruar për diskutim çështja nëse është pasuria e fituar gjatë martesës vetëm nga njëri prej bashkëshortëve për shkak të statusit të tij të posaçëm, në kuadër të Kodit Civil të vitit 1981, do të jetë pasuri vetjake apo pasuri bashkëshortore. Në vitin 1995, i padituri e ka fituar këtë pasuri për shkak të pasjes së statusit të tij si i përndjekur politik, nëpërmjet kontratës së shitblerjes, kontratë e cila është lidhur gjatë kohës që paditësi ka qenë i martuar me të paditurën. Gjykata ka vlerësuar se, fakti që këtë pasuri i padituri e ka përfituar për shkak të statusit të tij dhe për të cilën për efekt të ligjit e ka përfituar falas, nuk përbën argument ligjor për të kundërshtuar parimet e përgjithshme të fitimi të pasurisë bashkëshortore. Kjo pasi edhe pse i padituri nuk ka paguar asnjë të ardhur në kohën e marrjes së këtij sendi, gjatë viteve të martesës me paditësen administrimi, apo mirëmbajtja e pasurisë është bërë bashkërisht. Po kështu edhe fakti që i padituri figuron si person i vetëm titullar i kësaj pasurie në ZRPP, fakti që kjo pasuri është krijuar gjatë martesës e bën për efekt të ligjit bashkëpronarë edhe paditësen dhe nuk e zhvesh atë nga bashkëpronësia.

fituara gjatë martesës si veshje, veshmbathje, ora e dorës, ora e xhepit, syzet, unaza, stolitë e tjera, armët e gjahut, biçikleta, kur këto të fundit nuk përdoren bashkërisht nga bashkëshortët³⁰⁷. Dispozitat e Kodit Civil, që rregullonin bashkëpronësinë e bashkëshortëve (neni 86 dhe 87) ishin urdhëruese dhe nuk mund të ndryshonin me marrëveshje të bashkëshortëve. Marrëveshja e tyre për një regjim të ndryshëm të pasurisë së fituar gjatë martesës, duke e lënë burrin ose gruan pa këto të drejta, është e pavlefshme dhe nuk sjell pasoja juridike. Kështu, do të jetë e pavlefshme kontrata që lidhet midis bashkëshortëve, në të cilën parashikohet që më parë heqja dorë nga e drejta e pronësisë së pasurisë së vënë gjatë martesës. Gjithashtu, është e pavlefshme marrëveshja që mund të bëjnë bashkëshortët, duke i njohur që më parë njërit një pjesë më të madhe dhe tjetrit më të vogël.³⁰⁸

Nga analiza e mësipërme, mund të nxjerrim dy përfundime të rëndësishme, në lidhje me natyrën juridike të regjimit të bashkëpronësisë, së parashikuar në Kodin Civil, të vitit 1981: *së pari*, regjimi i parashikuar nga ligji (regjimi ligjor), ashtu si edhe në Kodin e Familjes së vitit 1965, ishte një regjim ligjor i detyrueshëm, i rregulluar me dispozita urdhëruese dhe për rrjedhojë çdo marrëveshje e bashkëshortëve për të përcaktuar një regjim tjetër pasuror në marrëveshje ndërmjet tyre ishte e pavlefshme dhe; *së dyti*, në ndryshim nga regjimi pasuror i parashikuar në Kodin e Familjes së vitit 1965, ishte një regjim bashkëpronësie “*quasi universale*”.

Ky regjim pasuror gjeti zbatim, në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve, deri në hyrjen në fuqi të Kodit aktual të Familjes (21 Dhjetor 2003)³⁰⁹.

Në analizë të fundit, arrijmë në përfundimin që, legjislacioni rregullues i marrëdhënieve të bashkëshortëve, i periudhës së shtetit socialist mohonte çdo shfaqje të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në drejtim të rregullimit të regjimit pasuror martesor.

2.2.4. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore nga viti 1992 deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Familjes

Pas vitit 1992 ndryshimet e sistemit politik, të cilat u shoqëruan me ndryshime social-ekonomike në shoqërinë shqiptare, ndikuan ndjeshëm edhe në pasurinë bashkëshortore. Pasuria bashkëshortore deri në këtë kohë përbëhej kryesisht nga sendet e përdorimit shtëpiak, të ardhurat nga puna, në raste të rralla nga shtëpi private, si dhe ndonjë pasuri tjetër simbolike e ardhur me dhurim ose trashëgimi. Praktika gjyqësore tregon se edhe depozitat në arkat e kursimit ishin tepër të pakta.

Me ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “*Për dispozitat kryesore kushtetuese*” u sanksionua mbrojtja e pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike³¹⁰. Gjithashtu, në vitin 1992 u miratua ligji “*Për privatizimin e banesave shtetërore*”³¹¹, që i bëri bashkëshortët pronarë të apartamenteve të tyre të banimit; bashkëshortët që përfituan nga privatizimi u bënë bashkëpronarë në pjesë të

³⁰⁶ Sendet e përdorimit vetjak bëhen pronë e atij bashkëshorti që i përdor, pavarësisht se janë blerë me të ardhurat e përbashkëta nga puna dhe pavarësisht nga vlera e tyre. Për këtë shih: Begeja, *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, fq. 144.

³⁰⁷ Begeja, *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, fq. 144.

³⁰⁸ Begeja, *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, fq. 146.

³⁰⁹ Kujtojmë këtu që, në drejtim të regjimit pasuror ligjor, Kodi aktual i Familjes, nga njëra anë, ka ruajtur regjimin e bashkëpronësisë (bashkësia ligjore), por nga ana tjetër e ka ridimensionuar në mënyrë të konsiderueshme këtë bashkëpronësi, në drejtim të reduktimit të objektit të bashkësisë (neni 75, 75 dhe 77 të kod.fam).

³¹⁰ Bazuar në nenin 11 të Ligjit, ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjithë subjekteve ekonomike dhe në rolin rregullues të shtetit.

³¹¹ Ligji “*Për privatizimin e banesave shtetërore*”, nr. 7652, miratuar më datë 23.12.1992. Statusi aktual: i shfuqizuar.

barabarta. Në vitin 1993 u miratua ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”³¹². Gjithashtu, rëndësi të madhe jo vetëm në zhvillimin e ekonomisë së tregut, në zhvillimin e marrëdhënieve private, por edhe në zhvillimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve, luajti ligji “Për shoqëritë tregtare” të vitit 1992³¹³. Neni 46 i këtij ligji, i cili rregullonte transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes³¹⁴.

Hyrja në fuqi e Kodit Civil të vitit 1994, nuk solli asnjë ndryshim në drejtim të rregullimit të regjimit pasuror martesor. Bazuar në dispozitat përfundimtare të tij, neni 1167, hyrja në fuqi e këtij kodi sillte shfuqizimin e Kodit Civil të vitit 1981, me përjashtim të dispozitave që rregullonin bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve (neni 86 dhe 87 të Kodit Civil të vitit 1981)³¹⁵. Për rrjedhojë marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve vazhduan të rregulloheshin nga neni 86 dhe 87 i Kodit Civil të vitit 1981, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të Familjes, 21 Janar të vitit 2003.

Bazuar në kushtet e reja ekonomike dhe sociale të shoqërisë shqiptare, të pas viteve 90’, gjykojmë që vazhdimi i zbatimit të regjimit të bashkëpronësisë “quasi universale”, në të cilën përfshihej edhe pasuria e fituar me dhurim dhe trashëgimi nga njëri prej bashkëshortëve, në kushtet kur ishte e pavlefshme çdo marrëveshje e bashkëshortëve për përcaktimin e një regjimi pasuror të ndryshëm nga ai ligjor, ishte në kundërshtim me të drejtën e pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuara nga ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” të vitit 1991 dhe më vonë nga Kushtetuta e RSH së vitit 1998.

Sipas mendimit të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Bashkim Caka³¹⁶, në mendimin paralel të tij në një Vendim Unifikues të Gjykatës së Lartë³¹⁷, parashikimi nga dispozitat e Kodit Civil, të vitit 1981, të regjimit të detyrueshëm të bashkëpronësisë së bashkëshortëve dhe përfshirja në objektin e kësaj bashkëpronësie edhe të pasurisë së fituar me trashëgimi dhe dhurim, bie ndesh me Ligjin Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, që njeh dhe mbron të drejtat themelore të pronësisë private

³¹² Ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, nr. 7698, miratuar në datë 15.04.1993, i ndryshuar me ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, nr. 9235, datë 29.07.2004.

³¹³ Ligji “Për shoqëritë tregtare”, nr. 7638, datë 19.11.1992, ndryshuar me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nr. 9901, datë 14.04.2008.

³¹⁴ Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve. Gjithashtu, ligji pasrashikon se, në statut mund të caktohen klauzola të veçanta, që bashkëshorti mund të bëhet ortak, vetëm pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Ortakëve, sipas kushteve që caktojnë ata.

³¹⁵ Ligjvënësi në Kodin aktual Civil ka përcaktuar, gjithashtu, në nenin 231, se bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve rregullohet nga dispozita e Kodit të Familjes. Deri në 21 Dhjetor të vitit 2003 (data e hyrjes në fuqi të Kodit aktual të Familjes) ka qenë në fuqi Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.6599, datë 29.6.1982, i cili nuk rregullonte bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, e cila, siç u tha rregullohej nga Kodi Civil i vitit 1981. Neni 231 i kod.civ. aktual është një dispozitë referuese, e cila aktualisht referon për zbatim në kod.aktual të fam.

³¹⁶ Mendim paralel në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 24, datë 13.03.2002.

³¹⁷ Në çështjen në fjalë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore morën në shqyrtim problemin, nëse ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish Pronarëve dhe ai për të përndjekurit politikë, janë mënyra fitimi pronësie dhe nëse duhet konsideruar pasuri bashkëshortore ajo e ardhur me trashëgim dhe e kthyer më vonë sipas këtyre ligjeve.

Në këtë vendim Gjykata ka mbjatur qëndrimin që, Ligji nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të përndjekurve politikë” dhe ligji nr. 7698, dt.15.04.1993, “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish Pronarëve”, nuk janë mënyra të reja të fitimit të pronësisë, por korigjim i padrejtësisë së bërë, dhe për këtë qëllim, shfuqizojnë *ipso lege* të gjitha aktet e mëparshme ligjore, me të cilat u ishte marrë prona pronarëve padrejtësisht. Ato nuk krijojnë një situatë të re, (nuk kanë efekt konstituitiv), por ristabilizojnë ligjshmërinë dhe drejtësinë. Shfuqizimi i akteve të sipërpërmendura, ka si efekt kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke rregulluar në masën më të mundshme, situatën e paligjshmërisë lidhur me të drejtën reale më të rëndësishme, atë të pronësisë (jo të drejta të tjera reale e aq më pak të drejtat e detyrimeve). Nëpërmjet këtyre akteve normative u njihet e drejta e pronësisë ish pronarëve, ose trashëgimtarëve të tyre, dhe u përcaktuan modalitetet për gëzimin efektiv të saj, për shkak të kohës së gjatë të paligjshmërisë, dhe pamundësisë objektive të kthimit fizik të të gjitha pronave të marra, ligji parashikon për rastet kur kjo e para nuk është e mundur, alternativën e kompensimit.

dhe më pas edhe me nenin 11³¹⁸ dhe nenin 41³¹⁹ të Kushtetutën së RSH, dispozita të cilat garantojnë mbrojtjen e pronës private.

Bazuar në argumentimet e mësipërme, vazhdon opinionin e tij gjyqtari B.Caka, jo vetëm në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave apo të ligjit mbi amnistinë dhe rehabilitimin e të përndjekurve politikë, por në tërësi për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve duhet të mbahet qëndrimi i legjislacionit shqiptar në kohën që njëjste qoftë edhe me kufizime pronën private, si dhe qëndrimi i legjislacioneve aktuale të vendeve të tjera perëndimore që, *bashkëpronësia bashkëshortore përfshin të mirat e fituara nga bashkëshortet qoftë edhe veç e veç gjatë martesës, duke përjashtuar të mirat që u përkasin atyre para martesës, ato të fituara nëpërmjet trashëgimisë apo dhurimit, të mirat materiale për përdorim të ngushtë personal si dhe ato që shërbejnë për ushtrimin e profesionit*³²⁰. Për arsyet e sipërpërmendura, gjyqtari B.Caka është i mendimit që, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet që bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, të kishin pezulluar gjykimin dhe materialet t'i dërgoheshin Gjykatës Kushtetuese, e cila të shprehej për kushtetutshmërinë e dispozitave të Kodit Civil të vitit 1981 për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, ose bazuar në parimin “*ius cures lex*”- e drejta kuron ligjin - të unifikoje qëndrimin për pasurinë bashkëshortore në përputhje me definicionin e dhënë më sipër³²¹.

Të njëjtin mendim ndan edhe doktrina shqiptare, sipas së cilës solidariteti i tepruar i interesave pasurorë të bashkëshortëve nëpërmjet regjimit të bashkëpronësisë për të gjitha pasuritë e fituara gjatë martesës zvogëlon pavarësinë pasurore të bashkëshortëve, kufizon lirinë e tyre kontraktore dhe nuk është në përputhje me kushtet ekonomike dhe sociale³²² të realitetit të ri të shoqërisë shqiptare.

2.3. Kuptimi i kontratës martesore

Nga leximi i dispozitave të kod.fam. rezulton që në të nuk gjendet një përkufizim i kontratës martesore, për rrjedhojë, për një kuptim të saj do ti referohemi koncepteve doktrinale, të cilat në këtë pikë nuk kanë qenë unanime.

Sipas një autori Italian, *“Kontratat martesore janë marrëveshje programatike të privatëve, të cilat krijojnë një regjim pasuror, të ndryshëm nga regjimi ligjor”*. Sipas të njëjtit autor, *“Regjimi pasuror mund të përkufizohet si tërësia ose grupi i normave (të vendosura nga ligji ose nga kontrata martesore) që rregullojnë pasojat juridike të veprimeve të ardhshme të subjekteve”*³²³.

Sipas një tjetër autori Italian, *“Kontrata martesore është marrëveshja ndërmjet dy apo me shumë palëve, e lidhur për të rregulluar, në mënyrë pak a shumë të plotë, situatën pasurore të një martese të caktuar”*³²⁴.

Një tjetër autor Italian e përkufizon *“Kontratën martesore si një akt të autonomisë private nëpërmjet së cilës bashkëshortët së bashku, por edhe me ndërhyrjen e personave të tretë,*

³¹⁸ Sipas nenit 11/1 të Kushtetutës së RSH *“Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike”*.

³¹⁹ Sipas nenit 41/1, 2 të Kushtetutës së RSH *“E drejta e pronës private është e garantuar. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Kodin Civil”*.

³²⁰ Mendim paralel në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 24, datë 13.03.2002.

³²¹ Mendim paralel në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 24, datë 13.03.2002.

³²² Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 109-110.

³²³ Russo, *Convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nouvo diritto di famiglia*, fq. 155.

³²⁴ Ieva, Marco. *“Le convenzioni matrimoniali.”* në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta (Eds.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq. 55.

rregullojnë regjimin pasuror të familjes, që buron nga martesë, në një mënyrë të ndryshme nga modeli i regjimit ligjor të bashkësisë, të parashikuar nga legjislacioni familjar³²⁵.

Bazuar në opinionet doktrinale, nga interpretimi “*per a contrario*” i nenit 66 të kod.fam. mund të japim këtë përkufizim për kontratën martesore ***“Bazuar mbi nenin 66 të kod.fam, me kontratë martesore do të kuptojmë kontratën nëpërmjet të cilës bashkëshortët-në kuadrin e autonomisë private të njohur atyre nga rendi juridik, përjashtojnë ose modifikojnë regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore, rregulloar nga nenet 73-107 të kod.fam, dhe e zëvendësojnë atë me një tjetër regjim kontraktor***³²⁶.

Nga të gjitha përkufizimet e mësipërme, vihet re që, një nga karakteristikat dalluese të kontratës martesore është përjashtimi i zbatimit të regjimit ligjor të bashkësisë.

Në kategorinë e kontratave martesore përfshihet çdo marrëveshje e bashkëshortëve, e cila ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe vendosjen e pasurisë së tashme dhe të ardhshme të bashkëshortëve, apo të disa sendeve të caktuara, nën një regjim të caktuar juridik, që rregullon titullarin e pronësisë, administrimin dhe disponimin e saj³²⁷.

Nga ky përkufizim, mund të nxjerrim në pah një karakteristikë shumë të rëndësishme të kontratës martesore, karakterin e saj ***programatik, statutor, apo rregullues***. Kontrata martesore paraqitet si një “plan” apo “skicë” e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe në ndryshim nga kontratat e zakonshme nuk prodhon efekte të menjëhershme reale apo detyrimi për palët³²⁸.

Megjithatë, në disa raste të caktuara kontrata martesore humbet funksionin e saj programatik.

Së pari, kontrata martesore humbet natyrën programatike, duke marrë natyrë dispozitive, në rastin kur bashkëshortët zgjerojnë apo ngushtojnë objektin e bashkësisë ligjore, brenda kufijve të vendosur nga ligji, duke përjashtuar apo përfshirë rishtazi në bashkësi, sende që janë tashmë në pronësi të tyre apo të bashkësisë³²⁹.

Së dyti, kontrata martesore humbet natyrën programatike në rastin kur bashkëshortët në përmbajtjen e saj përfshijnë veprime të tjera juridike, që janë autonome, në raport me regjimin pasuror martesor³³⁰. Në këtë kuptim, përveç rregullimit të regjimit pasuror, kontrata martesore mund të përmbajë edhe të tjera marrëveshje (kontrata) me përmbajtje pasurore, të cilat mund të kenë për objekt rregullimin e pasojave pasurore të një zgjidhjeje apo pavlefshmërie eventuale martesore, kontributin material për nevojat e familjes, dhurimet ndërmjet bashkëshortëve. Të gjithë këtyre marrëveshjeve, në gjuhën e përditshme, shpesh i referohemi me termin kontrata martesore.

Ky përkufizim më kufizuar i kontratës martesore, rrjedh drejtpërdrejtë nga neni 67 i kod.fam, sipas së cilit, me kontratë martesore do të kuptojmë vetëm ato veprime juridike të dyanshme të lidhura ndërmjet bashkëshortëve, ose midis tyre dhe personave të tretë, të cilat kanë për objekt rregullimin e regjimit pasuror martesor, të ndryshëm nga regjimi i bashkësisë ligjore, të parashikuar nga kod.fam.

³²⁵ De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 30.

³²⁶ Mascia, Katia. “La comunione legale, inquadramento storico e fondamento.” në *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II. Il regime patrimoniale della famiglia*, G. Cassano (Ed.), në *Trattati*, P. Cendon (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2006, fq. 343. Apud: Carnevali, Ugo. “Le convenzioni matrimoniali.” në *Il regime patrimoniale della famiglia* në *Il diritto di famiglia*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, fq. 15.

³²⁷ Cubeddu, Maria G. “Le convenzioni matrimoniali.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.) në *Trattati di diritto private*, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, fq. 28.

³²⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 145.

³²⁹ Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 32.

³³⁰ Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 30.

Megjithëse marrëveshjet e tjera, me përmbajtje pasurore, nuk përbëjnë kontratë martesore *strictu sensu*, ato mund të rregullohen në të njëjtin dokument së bashku me kontratën martesore.

Nga pikëpamja funksionale, në çdo rast, funksioni i kontratës martesore është rregullimi i regjimit pasuror martesor, nëpërmjet një modifikimi të regjimit ligjor, ose nëpërmjet një regjimi krejtësisht të ndryshëm nga ai ligjor. Për rrjedhojë, nuk përfshihen në kategorinë e kontratave martesore të gjitha marrëveshjet e bashkëshortëve që, kanë përmbajtje pasurore, por vetëm ato marrëveshje funksioni i të cilave është rregullimi i regjimit pasuror martesor. Pra, mbeten jashtë kuptimit të kontratës martesore, të gjitha ato marrëveshje të lidhur ndërmjet bashkëshortëve, në fazën para lidhjes së martesës ose gjatë saj, me funksion rregullimin e të tjera marrëdhënieve pasurore, përveç regjimit pasuror ose me funksion rregullimin e marrëdhënieve personale jopasurore³³¹.

Gjithashtu, duhet shtuar që, pavarësisht nga përkufizimet e autorëve të ndryshëm, përjashtohen nga kategoria e kontratës martesore dhe për rrjedhojë nga rregullimi juridik i saj edhe marrëveshjet e bashkëshortëve me përmbajtje pasurore, që kanë për qëllim të rregullojnë pasojat e zgjidhjes/pavlefshmërisë së martesës³³², si në rastin e marrëveshjeve preventive (lidhen para lidhjes së martesës osë gjatë saj) ashtu dhe në rastin kur lidhen në fazën e krizës së marrëdhënies bashkëshortore, ose pas zgjidhjes së martesës.

Në analizë të fundit, mund të pohojmë që, kontrata martesore nuk ka një strukturë të mirëpërcaktuar³³³. Në përmbajtjen e saj do të përfshihen jo vetëm marrëveshja programatike për përcaktimin e regjimit pasuror martesor, por edhe të tjera marrëveshje me natyrë pasurore.

2.4. Natyra juridike dhe funksionet e kontratës martesore

Në lidhje me natyrën juridike të kontratës martesore, problemi që shtrohet për diskutim është nëse, ato janë kontrata të zakonshme, të cilat përfshihen në kuadrin e nenit 659 të kod.civ, apo i nënshtrohen një disipline të posaçme për shkak të përfshirjes në to të interesave të familjes, pra formuluar ndryshe nëse kemi të bëjmë me një kategori juridike autonome dhe të ndryshme nga kontratat e zakonshme të së drejtës civile³³⁴.

Diskutimi, mbi natyrën kontraktore të kontratës martesore, nuk ka një natyrë të thjeshtë dogmatike, por përmban vlera të konsiderueshme praktike³³⁵, sepse nga përcaktimi i natyrës juridike të kontratës martesore dhe për rrjedhojë nga kualifikimi shkencor i saj ose jo në kategorinë e kontratës do të varet regjimi juridik, që do t'i zbatohet . Analiza e natyrës juridike të kontratës martesore do të na ndihmojë të përcaktojmë nëse kuadri ligjor rregullues i kontratës martesore do të jetë vetëm kod.fam., apo në një aspekt më të gjerë edhe dispozitat e kod.civ. mbi kontratën dhe detyrimet kontraktore.

Autorët, të cilët, mbështesin teorinë që, kontrata martesore është bën pjesë në kategorinë e përgjithshme të kontratave, pranojnë që, normat e kod.civ janë drejtpërdrejtë të zbatueshme mbi kontratën martesore, ndërsa autorët që mbështesin pikëpamjen e institutit autonom, janë të mendimit që, normat e përgjithshme të kod.civ. zbatohen mbi kontratën martesore jo drejtpërdrejtë, por me analogji³³⁶.

³³¹ De Paola, *Il regime patrimonial e della famiglia*, fq. 34-35.

³³² Ieva, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 58.

³³³ Cubeddu, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 30.

³³⁴ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 17.

³³⁵ Cabanillas Sánchez, Antonio. "Las Capituciones matrimoniales, Capitulo II." në *Derecho de Familia*, G. Díez-Picazo Giménez, Thomson Reuters, 2012, fq. 590.

³³⁶ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 17-18.

Mendimi mbizotërues i doktrinës është që, kontrata martesore është në thelbin e saj një kontratë, për shkak se, objekti i saj ka karakter pasuror³³⁷, megjithëse është objekt i zbatimit të një disipline të posaçme ligjore. Nga ky arsyetim rrjedh edhe deduksioni që, kategorisë së kontratës martesore i zbatohen edhe dispozitat e kod.civ., që rregullojnë kontratën në përgjithësi, për aq sa janë të pajtueshme me dispozitat e kod.fam., që rregullojnë kontratën martesore³³⁸.

Në lidhje me natyrën juridike të kontratës martesore, një pjesë e doktrinës juridike Italiane nuk vë shenja barazie ndërmjet kontratës martesore dhe kontratave të kod.civ, megjithatë fakti që, kontrata martesore është një veprim juridik i dyanshëm me përmbajtje pasurore e bën atë objekt të zbatimit të dispozitave të kod.civ, që rregullojnë kontratën në përgjithësi.³³⁹ Për elaborimin e këtij qëndrimi le ti referohemi një autorit italian, sipas të cilit, në legjislacionin e mëparshëm familjar italian, para reformës së vitit 1975, duke qenë se në Kodin Civil Italian regjimi ligjor ishte regjimi i pasurive të ndara, pra bashkëshortët në lidhje me pasurinë e tyre të fituar gjatë martesës kishin të njëjtin rregullim ligjor si të gjithë shtetasit e tjerë, ishte e drejtë të pohojë që, kontrata martesore ishte një kontratë e mirëfilltë, sepse nëpërmjet saj bashkëshortëve i njihej e drejta të rregullonin regjimin pasuror martesor, duke zgjedhur një nga modelet tipike të dhëna nga ligji, ose një model atipik. Ndërsa, vazhdon arsyetimin e tij, pas reformës së të drejtës familjare të vitit 1975, nuk mund të mbahet më i njëjti qëndrim, sepse legjislatori italian ka parashikuar që regjimi ligjor është regjimi i bashkësisë dhe bashkëshortëve i njihet e drejta, që nëpërmjet kontratës martesore ta modifikojnë këtë regjim ose të shmangin zbatimin e tij duke zgjedhur një tjetër regjim pasuror tipik apo atipik. Pas këtyre ndryshimeve të regjimit pasuror, të parashikuara në legjislacionin italian, nga pikëpamja shkencore duhet bërë një rikualifikim i institutit të regjimit pasuror martesor dhe të kontratës martesore. Në vazhdim të këtij arsyetimi, regjimi pasuror martesore përfaqëson një institut juridik të së drejtës familjare, sepse ai parashikon rregulla juridike pasurore të ndryshme nga normat ligjore civile, që rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet subjekteve që nuk kanë lidhje martesore ndërmjet tyre. Kontrata martesore, sipas së njëjtit autor, nuk mund të kualifikohet më në kategorinë e përgjithshme të kontratave, sepse funksioni i kontratës martesore është ai i rregullimit të regjimit pasuror martesor, pra i marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe ndërmjet tyre dhe të tretëve, për rrjedhojë reflektohet mbi statusin bashkëshortor. Funksioni i tyre është të përjashtojnë zbatimin e regjimit ligjor të bashkësisë, për rrjedhojë, kontrata martesore në ndryshim nga kontratat në përgjithësi, ka fuqi juridike “*erga omnes*”, sepse i drejtohet jo vetëm bashkëshortëve, por edhe të tretëve, kur ata hyjnë në marrëdhënie juridike pasurore me bashkëshortët³⁴⁰.

Në vazhdim të mendimit të të njëjtit autor, kontrata martesore megjithëse nuk mund të klasifikohet në kategorinë e kontratave, gjen vend në kategorinë e madhe të veprimeve juridike të dyanshme, sepse në fund të fundit është shprehje e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve. Konkretisht, kontrata martesore përfshihet në kategorinë e veprimeve juridike familjare së bashku me të tjera veprime juridike si: martesë, zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok, njohja vullnetare e amësisë dhe atësisë si dhe birësimi³⁴¹.

Gjithë diskutimi i mësipërm çon në përfundimin që, dispozita e kod.fam. që rregullojnë kontratën martesore, përbëjnë një grup autonom normash në raport me normat e kod.civ. që rregullojnë

³³⁷ Roppo, *Il Contratto*, fq. 6. Shiko gjithashtu: Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 183.

³³⁸ Qëndrim i mbajtur nga: De Rupertis G., *Le convenzioni matrimoniali in generale*, 1975, fq. 934; Santossuosso, *Delle persone e della famiglia. Il regime patrimoniale della famiglia*, fq.55; Russo, E., *L'autonomia privata nella stipuazione di convenzioni matrimoniali*, fq.154.

³³⁹ Për më shumë mbi këtë argument shih: Arceri, Alessandra dhe Bernardini, Mauro. *Il regime patrimoniale della famiglia*. Maggioli Editore, 2009, fq. 44.

³⁴⁰ De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 37-43.

³⁴¹ De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 44.

kontratën, për rrjedhojë këto të fundit nuk mund të konsiderohen më si “*lex generalis*” dhe nuk janë drejtpërdrejtë të zbatueshme, në fushën e kontratës martesore, por do të zbatohen në kontratën martesore vetëm në vija të përgjithshme ose me analogji. Ndërsa, dispozitat e kod.civ. që rregullojnë veprimin juridik, janë plotësisht të zbatueshme për rregullimin e kontratës martesore, kuptohet përveç atyre që vijnë në kundërshtim me dispozita specifike të kod.fam, sepse kontrata martesore është një veprim juridik i dyanshëm.

Në vazhdim të të njëjtit arsyetim, megjithëse nuk mund të vendosen shenja barazie ndërmjet kontratës martesore dhe kontratës civile³⁴², rregullat e kësaj të fundit për aq sa është e mundur i zbatohen kontratës martesore, për rrjedhojë neni 660 i kod.civ, që sanksionon që palët përcaktojnë lirisht përmbajtjen e kontratës brenda kufijve të përcaktuar nga ligji, përbën kuadrin ligjor rregullues të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre.

Një tjetër problem i rëndësishëm i cili, shtrohet për diskutim është të përcaktojmë nëse përbën kontratë martesore marrëveshja në të cilën një person i tretë merr përsipër detyrime në favor të bashkëshortëve ose të njërit prej tyre në rast të lidhje së martesës ose një person i tretë transferon, në rast të lidhjes së martesës, në pronësi të bashkëshortëve ose njërit prej tyre një pasuri³⁴³.

Përfundimet, në të cilat ka arritur doktrina italiane shkon në drejtim të mohimit të mundësisë së një personi të tretë, të ndryshëm nga bashkëshortët, për të qenë pjesë e kontratës martesore. Nëse do ti njohim mundësinë një personi të tretë për të qenë pjesë e kontratës martesore, atëherë kjo do të na çonte në përfundimin që, i treti do të bëhej pjesë dhe arbitër i regjimit pasuror të familjes³⁴⁴. Patjetër që, bashkëshortët, të dy së bashku ose njëri prej tyre mund të futen në marrëdhënie detyrimi me persona të tjerë, por këto kontrata nuk përfshihen në objektin e kontratës martesore.

Mund ta vazhdojmë diskutimin tonë në drejtim të kontratave me objekt transferimin e pronësisë së sendeve me rastin e martesës të bëra nga bashkëshortët ndërmjet tyre, para lidhjes së martesës. I gjithë problemi shtrohet në përcaktimin e mundësisë së përfshirjes së të tilla marrëveshjeve në kuptimin e kontratës martesore. Përgjigja është negative, për arsye se aktet e transferimit të pasurisë (dhurime, shitje ose shkëmbime), në sistemin tonë ligjor, janë akte që i sjellin menjëherë efektet, që në momentin e lidhjes së kontratës (ose dorëzimit të sendit në rastin e k.dhurimi). Këto janë kontrata me ekzekutim aty për aty dhe për rrjedhojë përfundojnë efektet e tyre që në çastin e lidhjes së kontratës³⁴⁵. Ndërsa, kontrata martesore është një kontratë e cila sjell efekte për të ardhmen, në kuptimin që rregullon regjimin juridik të transaksioneve që do të bëjnë bashkëshortët në të ardhmen.

Rregullimi kontraktor i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve është i lidhur me mbrojtjen e interesave të caktuara pasurore të secilit prej tyre³⁴⁶. Por cilat janë këto interesa, që përgjithësisht shtyjnë bashkëshortët drejt zgjedhjes së një regjimi pasuror, në vend të një regjimi tjetër.

I pari interes që ndeshet në lidhjen e kontratave martesore është ai i **shpërndarjes së të pasurisë brenda familjes**. Me shpërndarje të pasurisë do të kuptojmë, në radhë të parë, shpërndarjen e pasurisë dhe së dyti shpërndarjen e të ardhurave që fiton secili bashkëshort, nëpërmjet punës së tij apo të ardhurave që fiton nga administrimi i pasurisë personale.

Një tjetër interes që udhëheq bashkëshortët, në zgjedhjen e regjimit pasuror, është ai i **mbrojtjes së pozitës së fëmijëve në eventualitetin e prishjes(shpërbërjes) së ardhshme të familjes**.

³⁴² De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 46-47.

³⁴³ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 189.

³⁴⁴ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 189-190.

³⁴⁵ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 191.

³⁴⁶ Për më shumë, rreth trajtimit të interesave të vlerësueshëm në lidhjen e kontratës martesore, shih: Ieva, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 59-60.

Një tjetër interes që, mund të përmendim këtu, është *risku ekonomik që mund të vijë nga aktivitetet ekonomike që kryen secili prej bashkëshortëve*, me qëllim kufizimin e përgjegjësisë pasurore të bashkësisë për detyrimet, që rëndojnë mbi pasurinë personale të bashkëshortëve. Megjithëse kufizimi i përgjegjësisë pasurore të pasurisë së familjes, mbi detyrimet që rëndojnë mbi aktivitetin ekonomik të secilit bashkëshort, mund të realizohet edhe duke përjashtuar nga bashkësia vetë aktivitetin ekonomik të secilit prej tyre dhe për rrjedhojë duke lënë në bashkësi pjesën tjetër të pasurisë, së përcaktuar në nenin 74 të kod.fam.

2.5. Karakteristikat e kontratës martesore

Për të dhënë karakteristikat e një instituti juridik, së pari, duhet të realizohet klasifikimi shkencor i institutit në një kategori të caktuar dhe më pas evidentimi i atyre karakteristikave të kategorisë, që i korrespondojnë institutit në fjalë. Megjithë vështirësitë, që kemi hasur deri në këtë pikë të punimit, në kategorizimin e “kontratës martesore”, po përpiqemi të japim disa karakteristika të saj, duke e konsideruar kontratën martesore si pjesë përbërëse të kategorisë së kontratave civile. Padyshim që, në përpjekjen për të analizuar karakteristikat e kontratës martesore si kontratë civile, kemi mbajtur parasysh rezervat e shprehura deri tani mbi natyrën juridike të saj.

Më poshtë, në mënyrë të përmbledhur, jepen disa elemente që karakterizojnë institutin e kontratës martesore:

1. Kontrata martesore është një *“veprim juridik i dyanshëm”*³⁴⁷, lidhja e së cilës kërkon patjetër shprehjen e vullnetit të dy palëve, që në hipotezën në fjalë janë dy bashkëshortët e ardhshëm/bashkëshortët. Kontrata martesore është *“kontratë me dy palë”*, ku secilës prej palëve i korrespondon një person, i cili ka një status të veçantë atë të bashkëshortit. Ka diskutime në doktrinë, nëse mund të lejohet shprehja e vullnetit edhe të personave të tretë përveç bashkëshortëve në kontratën martesore.

2. *“Karakter i pasuror”*. Kontrata martesore ka karakter pasuror, sepse nëpërmjet saj mund të rregullohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, megjithatë nuk mund të përjashtohen nga kontrata martesore klauzola atipike të cilat rregullojnë marrëdhënie personale jopasurore të bashkëshortëve.

3. Kontrata martesore është *“aksesore”* në raport me martesën, pasi lidhja e martesës ndikon drejtpërdrejtë në ardhjen e pasojave të kontratës. Ashtu siç do të shikojmë më vonë, gjatë punimit, kontrata martesore *“ante nuptial”* lidhet me kushtin *“si nuptiae sequantur”*³⁴⁸. Ekziston domosdoshmëria e një martese të ardhshme ose një martese ekzistuese për lidhjen e kontratës martesore, pa ekzistencën e së cilës, kontrata nuk prodhon pasoja ligjore. Për këtë arsye nga doktrina, kontrata martesore është konsideruar, si një kontratë *“causa matrimonii”*³⁴⁹.

Karakter i aksesor është një nga tiparet dalluese të kontratës martesore në raport me kontratat e së drejtës civile.

4. Kontrata martesore ka karakter *“statutor”*, *“rregullues”* apo *“programatik”*³⁵⁰, në kuptimi që, ajo përfaqëson një statut për marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Në doktrinën juridike të shekujve të kaluar, ajo emërtohej ndryshe si *“pakti i familjes”*. Kontrata martesore nuk sjell të drejta dhe detyrime të menjëhershme për palët, në ndryshim nga kontratat e tjera që parashikon

³⁴⁷ De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 75. Gjithashtu, shih: De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 938.

³⁴⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 145; Cabanillas, “Las Capitulaciones matrimoniales. Capitulo II.” fq. 590.

³⁴⁹ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 37.

³⁵⁰ Termat, *statutor*, *rregullues* dhe *programatik* janë përdorur si sinonime të njëra-tjetrës. Doktrina italiane përdor, më së shumti termin *“programatik”*, ndërsa ajo franceze termin *“rregullues”*. Në lidhje me doktrinën shqiptare shih: Zaka, “Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” fq.13.

kod.civ³⁵¹. Sipas doktrinës shqiptare, ajo konsiderohet si një akt rregullues ose statut për familjen, nëpërmjet së cilës, palët fiksojnë statutin pasuror të familjes që do të themelohet si dhe rregullojnë regjimin e veprimeve juridike, që do të kryejnë me të tretët³⁵². Thënë ndryshe, kontrata martesore është një **“kontratë normative”**, e cila përcakton rregullat ligjore (regjimin juridik), të cilave do t’i nënshtrohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, gjatë martesës. Ky është aspekti më origjinal i kontratës martesore.

5. Kontrata martesore i kundërdrejtohet të tretëve³⁵³. Në ndryshim nga parimet e përgjithshme të së drejtës private, kontrata martesore ka efekte **“erga omnes”**. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i fuqisë **“inter partes”** të kontratës, kontrata martesore mund t’i kundërdrejtohet çdo personi³⁵⁴. Për këtë arsye, për mbrojtjen e interesave të të tretëve që kontraktjnë me bashkëshortët, kod.fam ka parashikuar sistemin e regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë. Kjo karakteristikë përfaqëson një tjetër ndryshim, ndërmjet kontratës martesore dhe kontratave të zakonshme të së drejtës civile, të cilat sjellin efekte vetëm për palët kontraktore.

6. Referuar objektit të saj, kontrata martesore është një **“veprim juridik kompleks”**. Edhe pse nuk parashikohet në mënyrë të shprehur në kod.fam, në përmbajtjen e kontratës martesore, bashkëshortët, jo vetëm kanë të drejtë të rregullojnë regjimin pasuror martesor, të cilit do t’i nënshtrohet pasuria e fituar gjatë martesës, por mund të rregullojnë edhe marrëdhënie të tjera ndërmjet tyre, si dhurimet ndërmjet tyre apo dhurimet e të tretëve në favor të bashkësisë ose të bashkëshortëve, kontributi material për nevojat e familjes, pasojat e zgjidhjes së martesës³⁵⁵.

7. Kohëzgjatja e zbatimit të kontratës martesore varet nga **“kohëzgjatja e martesës”**. Është e kuptueshme që, kontrata martesore nuk mund t’i mbijetojë përfundimit të martesës. Palët gjithashtu mund të vendosin t’i japin fund regjimit pasuror martesore gjatë martesës duke e shfuqizuar atë, nëpërmjet vendosjes së një tjetër regjimi pasuror ose nëpërmjet shfuqizimit të kontratës.

8. Kontrata martesore është **“kontratë formale”** për efekt vlefshmërie. Kod.fam. parashikon formën e aktit noterial si kusht për vlefshmërinë e kontratës martesore (neni 69/1 kod.fam.).

9. Kontrata martesore i nënshtrohet **“regjistrimit”** në regjistrat publikë, regjistrimi i cili kërkohet, nga ligji për efekt publiciteti dhe provueshmërie ndaj të tretëve. Kod.fam. parashikon regjistrimin e kontratës martesore në aktin e martesës, regjistrin tregtar dhe regjistrin e pasurive të paluajtshme. Funkzioni i regjistrimit është mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve dhe të tretëve, të cilët mund të futen në marrëdhënie juridiko-civile në të ardhmen me bashkëshortët.

10. Kontrata martesore **dispozitive**, nëpërmjet së cilës bashkëshortët vendosin të përjashtojnë nga bashkësia një send të caktuar, apo një kategori të caktuar sendesh është konsideruar nga doktrina si kontratë pa kundërshtpërbllim, një **“akt liberaliteti”**³⁵⁶.

11. Kontrata martesore bën pjesë në kategorinë e **“kontratave tipike”**, sepse rregullohet nga ligji, megjithëse nuk përjashtohet që përmbajtja e saj të jetë atipike, në rastin kur bashkëshortët

³⁵¹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 145.

³⁵² Mandro-Balili, A. Meçaj, V. Zaka, T. dhe Fullani, A. *E drejta familjare*. Botim i parë, Tiranë, Kristalina KH, 2006, fq. 322.

³⁵³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 146.

³⁵⁴ Benussi, Baltasar. *Komentari i Kodit Civil. Obligimet dhe kontratat përgjithsisht (Titulli II i librit të Kodit Civil)*. Tiranë: Botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1931, fq. 150.

³⁵⁵ Zaka, “Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” fq.12; Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, *E drejta familjare*, fq. 321; Zaka, “Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” fq.12-13.

³⁵⁶ Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 47.

zgjedhin zbatimin e një regjimi pasuror të ndryshëm nga regjimet kontraktore të parashikuara nga ligji.

2.6. Kontrata martesore dhe marrëveshje të tjera të bashkëshortëve

Nga një lexim i detajuar i dispozitave të kod.fam, mund të pohojmë që termat kontratë dhe marrëveshje nuk janë sinonime të njëra tjetrës. Kur kod.fam. i referohet kontratës martesore kupton gjithmonë ato marrëveshje të bashkëshortëve me objekt rregullimin e regjimit pasuror martesor të ndryshëm nga regjimi ligjor. Ndërsa, nga ana tjetër, me marrëveshje ndërmjet tyre bashkëshortët mund të rregullojnë edhe elemente të tjera të jetës së tyre të përditshme, me përmbajtje pasurore ose jopasurore.

Megjithatë, për të dhënë një argument në mbështetje të tezë së asaj pjese të doktrinës që mbështet idenë e përfshirjes së marrëveshjeve që rregullojnë marrëdhënie të tjera personale ose pasurore në kontratën martesore, mund të përmendim nenet 54 dhe 67 të kod.fam. Sipas nenit 59 të kod.fam, bashkëshortët përgjigjen për kontributin për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre, nëse ky detyrim i kontributit nuk është rregulluar me kontratë martesore. Nga interpretimi *per "a contrario"*, arrijmë në përfundimin që, kontributi material për nevojat e familjes përfshihen në objektin e kontratës martesore. Për të përforcuar këtë qëndrim, le të marrim në analizë përmbajtjen e nenit 67 të kod.fam, i cili nga pikëpamja sistematike gjen vend në kodin e familjes, menjëherë pas nenit 66, i cili parashikon të drejtën e bashkëshortëve për të rregulluar me kontratë regjimin pasuror martesor. Sipas nenit 67 të kod.fam, bashkëshortët nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesja, përgjegjësisë prindërore dhe rregullave të kujdestarisë. Nga interpretimi i nenit 67 së bashku me nenin 66, mund të konkludojmë që, rregullimi i këtyre marrëdhënieve mund të përfshihet në kontratën martesore, për aq sa e lejon ligji, por ato nuk mund të shmangen plotësisht nga bashkëshortët.

Në analizë të fundit, mund të themi që, marrëveshja e bashkëshortëve përfaqëson aktin formal ku mund të përfshihen si kontrata martesore me objekt rregullimin e regjimit pasuror, ashtu dhe paktet e tjera të bashkëshortëve, me objekt rregullimin e marrëdhënieve të tjera pasurore dhe personale midis tyre, deri në limitet e njohura nga kod.fam.

Në përfundim, mbështetur mbi dy tezat e mësipërme si dhe duke marrë në konsideratë të gjithë analizën që kemi bërë që nga fillimi i këtij kapitulli, kontrata martesore në kuptimin e ngushtë të fjalës rregullon vetëm regjimin pasuror. Kontrata martesore mund të paraqitet në një dokument të vetëm, së bashku me marrëveshje të tjera të bëra nga bashkëshortët ose ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve, qoftë me përmbajtje pasurore apo jo pasurore, marrëveshje të cilat kanë lidhje me martesën. Nga sa kemi analizuar deri tani arrijmë në dy përfundime: së pari që, këto marrëveshje nuk përbëjnë kontratë martesore dhe së dyti: regjimi juridik i parashikuar nga kod.fam. për kontratën martesore nuk i zbatohet këtyre marrëveshjeve, megjithëse nga ana formale ato mund të paraqiten në një dokument të përbashkët me kontratën martesore.

Të njëjtin arsyetim mund të përdorim edhe për dhurimet obnuziale, dhurimet e bëra ndërmjet bashkëshortëve ose ndërmjet tyre dhe të tretëve me rastin e lidhjes së martesës. Dhurimet obnuziale janë kontrata që kanë lidhje me martesën, por nuk përbëjnë kontratë martesore³⁵⁷.

2.7. Liria kontraktore e bashkëshortëve. Kontrata martesore “atipike”

Tashmë është pranuar gjerësisht nga doktrina e drejta e bashkëshortëve për të lidhur kontrata martesore atipike, autonomi e cila gjen mbështetjen e saj jo vetëm në nenin 659 të kod.civ, por

³⁵⁷ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 936-937.

edhe në nenin 66 të kod.fam. Problem, mbetet përcaktimi i kufijve, brenda të cilëve mund të veprojnë bashkëshortët. Në këtë kuadër, lind diskutimi mbi mundësinë e bashkëshortëve për të rregulluar me kontratë regjime pasurore, që nuk gjejnë rregullim të shprehur në dispozitat e kod.fam, të quajtur **“regjime pasurore atipike”**.

Përgjigja e parë që do të na vinte ndër mend është që kontrata martesore atipike është ajo kontratë nëpërmjet së cilës bashkëshortët zgjedhin, si regjim juridik rregullues për marrëdhëniet e tyre pasurore, një regjim të ndryshëm nga regjimet kontraktore të parashikuara nga kod.fam, pra një regjim krejt të ndryshëm nga regjimi i pasurive të ndara dhe nga regjimi i bashkësisë kontraktore (duke përfshirë këtu edhe regjimin e bashkësisë universale). Por cili është ky regjim pasuror krejt i ndryshëm nga regjimi i pasurive të ndara dhe regjimi i bashkësisë kontraktore?

Sipas një autori italian, për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet të marrim në konsideratë dy elementë të rëndësishëm: a) midis regjimit të pasurive të ndara dhe regjimit të bashkësisë nuk ekziston, në rregullimet juridike, një regjim i ndërmjetëm; b) një regjim pasuror, i cili derogon edhe pse vetëm pjesërisht nga regjimi i pasurive të ndara (duke parashikuar psh; regjim të pasurive të ndara të pjesshëm) bën pjesë në mënyrë të paevitueshme në regjimin e bashkësisë³⁵⁸.

Pra, sipas teorisë së paraqitur më sipër, çdo regjim pasuror i ndryshëm nga regjimi i pasurive të ndara bën domosdoshmërisht pjesë në regjimin e bashkësisë. Pra për rrjedhojë çdo regjim pasuror atipik, që bashkëshortët vendosin të zgjedhin me kontratë martesore, përbën një modifikim të regjimit të bashkësisë ligjore.

Sipas një tjetër autori nuk mund të përfytyrojmë ekzistencën e një regjimi kontraktor atipik, që të mos jetë njëkohësisht regjim bashkësie kontraktore³⁵⁹, sepse është e vështirë të gjejmë një regjim pasuror që të jetë krejt i ndryshëm nga regjimi i pasurive të ndara dhe i ndryshëm nga regjimi i bashkësisë.

Nga gjithë analiza e mësipërme, duhet saktësuar dallimi midis termave “kontratë atipike” dhe “regjim pasuror atipik”³⁶⁰. Kontrata martesore, në vetvete, pavarësisht nga regjimi pasuror që zgjedhin bashkëshortët, mbetet gjithmonë një kontratë tipike, sepse ajo gjen rregullim në normat e kod.fam. Nga ana tjetër regjimi pasuror që bashkëshortët kanë të drejtë të zgjidhin mund të jetë një regjim tipik ose atipik. Këtej e tutje, në çdo rast, kur do të përmendim termin kontratë martesore atipike, do të kuptojmë atë kontratë martesore nëpërmjet së cilës bashkëshortët zgjedhin një regjim pasuror të ndryshëm nga regjimet e rregulluara nga legjislacioni familjar.

Në analizë të fundit, mund të themi që, bashkëshortët kanë një autonomi të gjerë për të zgjedhur, nëpërmjet kontratës martesore, jo vetëm regjimet kontraktore, që janë parashikuar nga kod.fam, por janë të lirë të modifikojnë normat e kod.fam., që rregullojnë regjimet pasurore, me përjashtim të normave të pashmangshme.

2.8. Të drejtat dhe detyrimet e pashmangshme si kufizime të lirisë kontraktore të bashkëshortëve

Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore nuk është e pakufizuar. Parimi i autonomisë së vullnetit, i sanksionuar në nenin 66 të kod.fam, duket që gjen kufizime serioze në dispozitat 67, 109/2 dhe 114/1 të kod.fam, përveç kufizimeve të parashikuara në kod.civ, të cilat janë të zbatueshme për të gjitha kontratat.

Liria kontraktore e bashkëshortëve, si një nga modalitetet e realizimit të parimit të autonomisë së vullnetit³⁶¹, manifestohet, në kuptimin pozitiv të tij, si: liria e zgjedhjes së regjimit pasuror

³⁵⁸ Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq.19.

³⁵⁹ Corsi, Francesco. “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impersa, II.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Milano: Giuffrè Editore, 1984, fq. 10.

³⁶⁰ Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 196.

³⁶¹ Galgano, Francesco, *Diritto civile e commerciale*, II, fq.130

ndërmjet tipave të ndryshme të regjimeve të parashikuara nga ligji; liria e zgjedhjes së regjimeve pasurore atipike, të ndryshme nga regjimet e kod.fam. dhe si liria për të përcaktuar përmbajtjen e kontratës, brenda limiteve të përcaktuara nga ligji³⁶².

Në identifikimin e të drejtave dhe detyrimeve të pashmangshme duhet, në radhë të parë, të individualizojmë dy regjimet tipike kontraktore, regjimin e bashkësisë kontraktore dhe regjimin e pasurive të ndara, secila prej të cilave ka limitet e veta të pashmangshme si dhe të individualizojmë ato parime që janë të pashmangshme për të gjitha regjimet pasurore³⁶³.

Përveç këtyre kufizimeve, janë të zbatueshme për kontratën martesore edhe kufizimet e parashikuara në kod.civ, të cilave i nënshtrohet çdo kontratë, përfshirë këtu edhe kontratën martesore.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, kufizimet e autonomisë kontraktore të bashkëshortëve, referuar të drejtave dhe detyrimeve të pashmangshme, mund t'i klasifikojmë në tre grupe: a) limitet e së drejtës civile; b) kufizime të përgjithshme, të cilat janë të vlefshme për çdo regjim pasuror martesore dhe c) kufizime të posaçme, të cilat ndryshojnë në varësi të regjit pasuror martesor³⁶⁴.

2.8.1. Kufizimet e përgjithshme të parashikuara në kod.fam.

Nga një lexim kompleks i dispozitave të kod.fam. që, rregullojnë regjimin pasuror martesore, mund të konkludojmë, që kod.fam. ka parashikuar një seri kufizimesh, të cilat vlejné për çdo lloj regjimi pasuror, pavarësisht nëse gjen ose jo rregullim në dispozitat e kod.fam. Këto limite mund të përmbledhen si më poshtë:

A. Parimi i barazisë morale dhe juridike e bashkëshortëve. Një kufizim tjetër i rëndësishëm i shprehjes së autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve është respektim i parimit të barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Nuk mund të jetë e vlefshme një kontratë martesore, e cila i vendos bashkëshortët në një pozitë të pabarabartë morale apo juridike, duke afirmuar pozitën superiore ose pozitën e rezervuar të njërit bashkëshort në raport me tjetrin³⁶⁵. Është e evidente që në këtë rast nuk i referohemi në asnjë rast barazisë ekonomike të bashkëshortëve, sepse, në mendimin tim, ligji nuk duhet të ketë për qëllim garantimin me çdo kusht të barazisë ekonomike të bashkëshortëve³⁶⁶. Edhe pse në nuk del në mënyrë të shprehur në asnjë dispozitë të kod.fam. ndalimi i bashkëshortëve për tu shmangur nga parimi i barazisë morale dhe juridike, ky kufizim del nga fryma e përgjithshme e kod.fam. Madje, duhet pohuar se, barazia morale dhe juridike e bashkëshortëve është parim bazë rregullues i institutit të martesës dhe është parimi i rendit publik. Këtë parim e gjejmë të sanksionuar në vetë nenin 1 të kod.fam “*martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve ...*”. Gjithashtu, sipas nenit 50, paragrafi parë i kod.fam. “*me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime*”.

³⁶² De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 49-50.

³⁶³ Fusaro, Andrea. “Il regime patrimoniale della famiglia.” në *I grandi orientamenti della giurisprudenza civile e commerciale*, F. Galgano (Ed.), Padova: CEDAM, 1990, fq. 24.

³⁶⁴ Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 204

³⁶⁵ Oberto, *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilità e fattispecie*, fq. 148.

³⁶⁶ Megjithëse, në nenin 103/2 të kod.fam, legjislatori ka tentuar të realizojë barazinë ekonomike të bashkëshortëve, nën regjimin pasuror të bashkësisë ligjore duke parashikuar prezumimin absolut të barazisë së pjesëve, pa i dhënë mundësi bashkëshortëve të provojnë kontributin e tyre në fitimin e kësaj pasurie. Në gjykimin tonë, kjo është një dispozitë e cila nuk përputhet me parimet dhe vlerat themelore mbi, të cilat është ndërtuar rendi ekonomik, si parimi i iniciativës së lirë ekonomike, garantuar nga neni 13 i Kushtetutës së RSH.

Një marrëveshje që do të kufizonte paraprakisht parimin e barazisë, duke parashikuar një pozitë juridike favorizuese të njërit bashkëshort, do të konsiderohet e pavlefshme dhe për rrjedhojë nuk do të sjellë asnjë pasojë juridike³⁶⁷.

B. Ndalimi i shmangies së të drejtave dhe detyrimeve reciproke të bashkëshortëve, të parashikuara nga Titulli II i kod.fam., (neni 65 i kod.fam), të cilat përbëjnë “regjimin primar” të familjes. Dispozitat rregulluese të regjimit primar të familjes, janë konsideruar dispozita të rendit publik dhe si të tilla mund t’i nënshtrohen vullnetit të bashkëshortëve, vetëm në rastet kur vetë normat e ligjit e lejojnë³⁶⁸.

C. Pamundësia për të shmangur të drejta dhe detyrimet që rrjedhin për bashkëshortët nga martesja (neni 67 i kod.fam). Bazuar në nenin 67 të kod.fam, bashkëshortët nuk mund t’i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesja. Mbetet e paqartë se çfarë ka dashur ligjvënësi të shprehë me të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga martesja si dhe arsyeja pse e ka përfshirë këtë ndalim në radhën e dispozitave që rregullojnë regjimin pasuror martesor³⁶⁹. Në pamje të parë duket se është një dublim i nenit 65 të kod.fam, të sqaruar në paragrafin e mësipërm, megjithëse nga ana tjetër nuk do të kishte kuptim parashikimi i të njëjtit ndalim ligjor në dy dispozita të ndryshme.

Duhet kuptuar se, cila është fusha e zbatimit të nenit 67, nëse ligjvënësi ka pasur për qëllim të përfshijë në fushën e zbatimit vetëm të drejtat dhe detyrimet e karakterit pasuror, apo edhe ato personale jopasurore.

Nga pjesa më e madhe e doktrinës është vlerësuar që, nëse objekti i zbatimit të nenit 67 janë të drejtat personale jopasurore, atëherë norma është e tepërt, sepse parimi i pashmangshmërisë së të drejtave dhe detyrimeve personale të bashkëshortëve është një parim i nënkuptuar nga fryma e të gjithë legjislacionit që, rregullon marrëdhëniet familjare, si dhe sepse marrëveshja për shmangien e të drejtave dhe detyrimeve bashkëshortore të karakterit personal nuk gjen asnjë rregullim të shprehur ligjor³⁷⁰.

Nëse nga ana tjetër, qëllimi i nenit 67 është ndalimi i shmangies të të drejtave dhe detyrimeve të karakterit pasuror, atëherë kjo normë bie në kundërshtim me atë pararendëse, nenin 66 të kod.fam, që në kuadrin e parimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, lejon shmangien nga regjimi ligjor i bashkësisë, nëpërmjet instrumentit të kontratës martesore³⁷¹.

Qëndrim i doktrinës italiane është që, në këtë dispozitë ligjvënësi ka patur për qëllim ndalimin e shmangies së atyre të drejtave dhe detyrimeve të njohur si “*onera matrimonii*”: barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, detyrimin e jetesës së përbashkët, detyrimin e mbështetjes morale dhe materiale (kontributi material), detyrimin e besnikërisë bashkëshortore, bashkëpunimin në

³⁶⁷ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 87.

³⁶⁸ Kujtojmë këtu që, në regjimin primar të familjes përfshihen detyrime të tilla si: detyrimi për ndihmë dhe bashkëpunim (neni 50), detyrimi për jetesë dhe vendbanim të përbashkët (nenin 55), detyrimi i mbiemrit (neni 51), detyrimi i kontributit material për nevojat e familjes (neni 54), ndalimi i disponimit të banesës familjare dhe paisjeve të saj pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, e drejta e ushtrimit të lirë të profesionit dhe disponimit të të ardhurave të fituara nag puna (neni 63). Këto janë detyrime të pashmangshme, megjithëse në rastin e detyrimit të mbiemrit, vendbanimit dhe kontributit material, bashkëshortët kanë një liri të gjërë vetërregullimi, brenda kufijve të vendosur nga kod.fam.

³⁶⁹ Guerinoni, Ezio. “I regimi patrimoniali convenzionali. La comunione convenzionale.” në *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II. Il regime patrimoniale della famiglia*, G. Cassano (Ed.) në *Trattati P. Cendon* (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2006, fq. 346.

³⁷⁰ Moscarini, Lucio V. “Convenzioni.” në *La comunione legale II*, M. Bianca (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 1989, fq. 1010.

³⁷¹ Moscarini, “Le convenzioni.” fq. 1010-1011.

interes të familjes dhe bashkëjetesës, e drejta për të kërkuar zgjidhjen e martesës e kështu me radhë³⁷².

Ndërsa, doktrina franceze mban qëndrimin që, ndalimi i parashikuar në nenin 67 të kod.fam. i referohet në radhë të parë të drejtave dhe detyrimeve pasurore që rrjedhin nga martesë, të njohura me termin “*regjim primar*” i familjes, por përfshin edhe të drejtat personale jopasurore³⁷³.

Nga ana tjetër, nuk përfshihen në ndalimet e nenit 67 të kod.fam., ato marrëveshje të bashkëshortëve, shprehimisht të parashikuara nga kod.fam, të tilla si: a) në fushën e marrëdhënieve personale jopasurore, marrëveshja për caktimin e vendbanimit, e drejta e caktimit të mbiemrit, e drejta e paraqitjes së kërkesës konsensuale për zgjidhje martesë³⁷⁴; si dhe b) në fushën e të drejtave pasurore, e drejta për të caktuar modalitetet e përmbushjes së kontributit material për nevojat e familjes³⁷⁵.

D. Pamundësia e shmangies së përgjegjësive prindërore (neni 67 i kod.fam). Nga leximi i parë i kësaj dispozite duket i panevojshëm parashikimi nga ana e ligjvënësit i pamundësisë së shmangies së përgjegjësive prindërore në këtë dispozitë, pasi rregullimi i përgjegjësive prindërore në Titullin III të kod.fam. është rregulluar me dispozita urdhëruese. Edhe pa një ndalim të shprehur në nenin 67 të pamundësisë së shmangies nga përgjegjësia prindërore është e kuptueshme që rregullat e përgjegjësive prindërore nuk mund të shmangen me marrëveshje të bashkëshortëve, sepse janë rregulluar me dispozita urdhëruese. Kur ligjvënësi ka dashur t’i japë mundësi bashkëshortëve të rregullojnë ushtrimin e përgjegjësive prindërore me marrëveshje ndërmjet tyre, e ka parashikuar këtë shprehimisht. Sipas nenit 221 të kod.fam, në qoftë se prindërit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës, ata mund t’i drejtohen gjykatës, e cila vendos pasi është përpjekur ta zgjidhë çështjen me pajtim. Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton që, prindërvë i është njohur e drejta vetëm për të rregulluar modalitetet e ushtrimit të përgjegjësive prindërore, bazuar gjithmonë mbi parimin e interesit më të lartë të fëmijës, por nuk i është njohur e drejta për t’u shmangur nga ushtrimi i përgjegjësive prindërore.

E. Pamundësia e shmangies së rregullave të kujdestarisë (neni 67 i kod.fam). Edhe në lidhje me këtë parashikim ligjor mund të përdorim të njëjtin arsyetim të përdorur më sipër në lidhje me rregullat e përgjegjësive prindërore. Madje në këtë dispozitë natyrshëm lind pyetja, se cilave raste të kujdestarisë i referohet kjo dispozitë? Mbase i referohet rastit kur në një të ardhme eventuale njërit nga bashkëshortët mund t’i hiqet/kufizohet zotësia për të vepruar dhe bashkëshorti tjetër caktohet si kujdestar i tij, ose rastit kur, kujdestar i fëmijëve të mitur të bashkëshortit të pazotë për të vepruar caktohet bashkëshorti tjetër.

F. Pamundësia e shmangies së rregullave të administrimit ligjor (neni 67 i kod.fam). Kjo është një dispozitë shumë e kritikuar nga doktrina juridike. Shtrohet pyetja, nëse bashkëshortëve ju njihet e drejta të shmangin totalisht zbatimin e regjimit ligjor, nëpërmjet zgjedhjes së regjimit kontraktor të pasurive të ndara, ose i njeh bashkëshortëve të drejtën për të modifikuar pjesët takuese në bashkësinë ligjore (neni 108/c i kod.fam), atëherë pse mos i njihet atyre e drejta e shmangies së rregullave të administrimit të bashkësisë ligjore?

Arsyeja e këtij parashikimi ligjor është që, për ligjin rregullat e administrimit të bashkësisë ligjore, janë veçanërisht të rëndësishme për të garantuar barazinë e subjekteve (bashkëshortëve)

³⁷² De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 52.

³⁷³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 143.

³⁷⁴ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 52.

³⁷⁵ Kujtojmë këtu që, për gjithë këto të drejta, ligji i ka njohur bashkëshortëve të drejtën e vetërregullimit të interesave të tyre, nëpërmjet marrëveshjes, brenda kufijve ligjorë.

në marrëdhëniet pasurore. Barazia e bashkëshortëve në administrim është konsideruar nga doktrina franceze si pjesë e “*rendit publik*”³⁷⁶. Objekti i bashkësisë ligjore mund të kufizohet, me marrëveshje të bashkëshortëve, por në lidhje me këtë objekt duhet të respektohet regjimi juridik që ligji ka parashikuar për veprimet e administrimit të bashkësisë³⁷⁷.

G. Pamundësia e shmangies së kontributit material për nevojat e familjes dhe jetesës. Bashkëshortët nuk mund të shmangin me marrëveshje përmbushjen e kontributit material për nevojat e familjes, së fëmijëve dhe të bashkëshortit tjetër (neni 54).

H. Detyrimi për ushqim. Është e pavlefshme çdo klauzolë kontraktore, nëpërmjet së cilës bashkëshortët heqin dorë paraprakisht nga e drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim. Bashkëshortët mund të bien dakord, për heqjen dorë nga e drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim, vetëm nëse kjo e drejtë ka lindur, pra nëse bashkëshorti që heq dorë gjendet në kushtet e “*gjendjes në nevojë*”.

I. Kufizimi i lirisë personale të secilit bashkëshort. Janë të pavlefshme marrëveshjet që kufizojnë lirinë personale të secilit bashkëshort, në drejtim të: së drejtës për të kërkuar zgjidhjen ose anulimin e martesë³⁷⁸, kufizimin e së drejtës për të rilidhur një martesë të re pas zgjidhjes së martesës, kufizimin e së drejtës për të kërkuar pjestimin gjyqësor të pasurisë së fituar gjatë saj³⁷⁹ etj. (neni 214 i kod.fam). Është, gjithashtu, e pavlefshme çdo kaluzolë kontraktore e cila, kufizon të drejtat procedurale të bashkëshortëve, si e drejta për të kërkuar zgjidhjen ose pavlefshmërinë e martesës.

J. Disponimi i banesës bashkëshortore (neni 57 i kod.fam). Bazuar në nenin 57 të kod.fam, bashkëshortët nuk mund të disponojnë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e tjetrit, cilido qoftë regjimi pasuror martesor. Nga analiza e kësaj dispozite, arrijmë në konkluzionin që, çdo disponim i banesës familjare dhe i pajisjeve të saj, nga ana e njërit bashkëshort, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër është i pavlefshëm, pavarësisht nga regjimi pasuror martesor që kanë zgjedhur bashkëshortët, regjim bashkësie ligjor/kontraktor ose regjim i pasurive të ndara është në pronësi të të dy bashkëshortëve apo në pronësinë vetjake të vetëm njërit prej tyre.

2.8.2. Kufizimet e posaçme për secilin regjim pasuror

Kufizimet e posaçme variojnë sipas regjimit pasuror që bashkëshortët vendosin të zbatojnë. Në këtë kategori mund të identifikojmë:

A. Koherenca e klauzolave kontraktore me regjimin pasuror të zgjedhur. Klauzolat e kontratës martesore duhet të jenë në koherencë dhe për rrjedhojë nuk mund të jenë kontradiktore me regjimin pasuror të zgjedhur nga palët. Pra, klauzolat kontraktore nuk mund të vijnë në kundërshtim me karakteristikat e përgjithshme të regjimit pasuror martesor të zgjedhur nga palët, psh. në regjimin e bashkësisë me kontratë, bashkëshortët nuk mund të parashikojnë shmangien

³⁷⁶ Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq.82.

³⁷⁷ Russo, Ennio. “*L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.*” në *Rivista Notarile*, Nr.34, Maggio-Aprile 1982/2, Palermo: Edizioni Giuridice Buttitta, 1982, fq. 506.

³⁷⁸ Finocchiaro, Alfio, dhe Finocchiaro Mario. *Diritto di famiglia, Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151.* Volume I, Milano: Giuffrè Editore, 1984, fq. 724.

³⁷⁹ Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq.81.

plotësisht të së drejtës së kompensimeve, por ky element mund të rregullohet ose modifikohet në marrëveshje mes tyre³⁸⁰.

B. Sendet vetjake (neni 109/2 dhe neni 114/1 të kod.fam). Në këto dy dispozita, ligji parashikon që, nuk mund të përfshihen në bashkësinë universale ose në bashkësinë me kontratë pasuria e parashikuar në nenin 77/c, ç, d të kod.fam. Për këtë kategori sendesh - sendet e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake³⁸¹ (neni 77/c i kod.fam); mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit bashkëshort, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare (neni 77/ç i kod.fam) - dhe pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë (neni 77/d i kod.fam) regjimi pasuror i zbatueshëm është gjithmonë regjimi i pasurive të ndara, si në rastin kur bashkëshortët kanë zgjedhur një regjim bashkësie, madje edhe të bashkësisë universale, ashtu edhe në rastin kur zbatohet regjimi i bashkësisë ligjore, në mungesë të një kontrate martesore.

Nga leximi “*per a contrario*” i neneve 109/2 dhe 114/1 i kod.fam, mund të arrijmë në përfundimin që, shpërblimi i dëmit vetjak që vjen si pasojë e humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë dhe mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit bashkëshort që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare, mund të përfshihet në bashkësinë ligjore dhe për rrjedhojë, i nënshtrohet vullnetit të plotë të bashkëshortëve, të cilët mund të vendosin, nëse e gjykojnë të arsyeshme edhe përjashtimin e tyre nga bashkësia.

C. Ndalimi i pjesëtimit vullnetar të sendeve gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë. Në bazë të nenit 97 të kod.fam, pjesëtimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshje të bashkëshortëve. Nga leximi i vëmendshëm i kësaj dispozite, arrijmë në dy përfundime të rëndësishme. Së pari, ndalimi i pjesëtimit të sendeve gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë, i referohet si rastit kur regjimi pasuror martesor rregullohet nga bashkësia ligjore, ashtu dhe rastit kur bashkëshortët kanë zgjedhur një regjim kontraktor, qoftë bashkësi universale ose modifikim i regjimit ligjor, ose një tjetër regjim atipik, që karakterizohet nga bashkëpronësia. Gjithashtu, mund të pohojmë që, ky ndalim nuk i referohet regjimit kontraktor të pasurive të ndara, jo vetëm sepse nuk ka kuptim të flasim për pjesëtim të pasurisë nën regjimin e pasurive të ndara, por edhe pse vetë dispozita ligjore, përdor shprehimisht termin “*bashkësi*”. Së dyti, arrijmë në përfundimin që ky pjesëtim nuk është i lejuar jo vetëm me marrëveshje të bashkëshortëve, por nuk mund të bëhet as pjesëtimi gjyqësor i pasurisë, pa përfunduar bashkësia, përveç përjashtimit të parashikuar në nenin 98 të kod.fam., i cili lejon pjesëtimin e pasurisë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë, nëse bashkëshortët gjenden në një nga rrethanat, shprehimisht të parashikuara nga kjo dispozitë, Sipas nenit 98 të kod.fam, secili nga bashkëshortët, gjatë

³⁸⁰ Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq. 68-88.

³⁸¹ Në gjykimin tonë, nuk duket me vend që ligjvënësi ka bërë këtë zgjedhje, sepse përderisa lejon që e gjithë pasuria e fituar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës, por edhe pasuria e fituar nga secili prej tyre gjatë martesës (pasuri që në regjimin e bashkësisë ligjore përfshihet në kategorinë e sendeve vetjake) të përfshihet në bashkësinë universale, atëherë pse mos lejojë që pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake të mos përfshihen në bashkësinë universale. Kjo është edhe rrjedhojë e parimit të përgjithshëm të së drejtës private, që “*aksesori ndjek fatin e sendit kryesor*”. Arsyetimi që mund të japim, për këtë çështje është që, ligjvënësi në nenin 77/c ka dashur të shprehet për pasurinë e fituar si aksesore e kësaj pasurie vetjake, pra pasuria e fituar si aksesore e sendeve të përdorimit ngushtësisht vetjak të njërit bashkëshort. Ky është i vetmi arsyetim llogjik që mund të japim në këtë rast, duke iu referuar edhe nenit 179 të Kodit Civil Italian, i cili parashikon që, përjashtohen nga bashkësia universale; sendet e përdorimit ngushtësisht vetjak dhe aksesoret e tyre. Ky do të ishte një formulim më i drejtë i nenit 77/c i Kodit tonë të Familjes.

kohëzgjatjes së regjimit të bashkësisë ligjore/kontraktore mund t'i drejtohet gjykatës me kërkesën e pjesëtimit të pasurisë, vetëm nëse është verifikuar një nga tre rrethanat e parashikuara shprehimisht nga kjo dispozitë:

- Paaftësia dhe keqadministrimi i pasurisë nga njëri prej bashkëshortëve, kur mënyra e administrimit të pasurisë, ka vënë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes;
- Njëri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë;
- Kur ka ndodhur një pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi.

2.9. Klasifikimi i kontratave martesore

Sipas doktrinës, kontrata martesore klasifikohen në dy grupe: a) *kontratat martesore programatike* dhe b) *kontrata martesore dispozitive*.

Në grupin e kontratave martesore *programatike* përfshihen të gjitha ato kontrata të cilat kanë për objekt përcaktimin e regjimit juridik që do të zbatohet pasurisë së ardhshme (që do të fitohet në të ardhmen) të bashkëshortëve dhe jo të pasurisë që ekziston në momentin e lidhjes së kontratës martesore. Funkzioni programatik gjendet në kontratat martesore normative, që kanë për objekt rregullimin e pasurisë që bashkëshortët do të fitojë së bashku ose veç e veç gjatë martesës³⁸².

Kontrata martesore në ndryshim nga kontratat e tjera të rregulluara nga kod.civ. ka natyrë programatike, sepse rregullon marrëdhëniet pasurore të ardhshme të bashkëshortëve, pra rregullon regjimin e fitimeve të ardhshme të pasurisë së tyre³⁸³.

Psh: në kategorinë e kontratave programatike mund të përmendim ato kontrata që i vendosin bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara, sipas së cilës, secili bashkëshort do të ruajë pronësisë ekskluzive mbi pasuritë e fituara gjatë martesës me titull personal; ose kontrata martesore, që modifikon bashkësinë ligjore, e cila parashikon që do të përjashtohet nga bashkësia dhe për rrjedhojë do të jetë në pronësinë ekskluzive të çdo bashkëshorti pasuria e paluajtshme e fituar gjatë martesës³⁸⁴.

Ndërsa, janë kontrata martesore *dispozitive*, ato kontrata të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të menjëhershme, në ndryshimin e gjendjes juridike të pasurive ekzistuese të bashkëshortëve, si psh: ato kontrata që parashikojnë përfshirjen në bashkësi të një pasurie, e cila i përkiste më parë pronësisë ekskluzive të secilit bashkëshort ose ato kontrata që, parashikojë përjashtim nga bashkësia të një pasurie, e cila më parë i përkiste bashkësisë³⁸⁵. Gjithashtu, bën pjesë në kontratën dispozitive edhe bashkësisë universale, sipas së cilës bashkëshortët vendosin të përfshijë në bashkësi të gjithë pasurinë që ka qenë në pronësi ekskluzive të secilit prej tyre para lidhjes së kontratës martesore. Funkzioni dispozitiv gjendet në ato kontrata martesore, të cilat krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë të drejta reale ose të drejta krediti mbi pasuri të caktuara³⁸⁶. Duhet theksuar që, edhe kontratat martesore programatike prodhojnë të drejta reale ose krediti, por jo në mënyrë të menjëhershme, që nga çasti i lidhjes së kontratës, siç ndodh në rastin e kontratave dispozitive, por në të ardhmen, dhe vetëm me verifikimin e fakteve të caktuara juridike, si p.sh: blerja e një sendi, fitimi i të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e bashkëshortëve, fitimi i pasurisë me dhurim apo trashëgim, shpërblimi i një dëmi vetjak etj.

³⁸² Cubeddu, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 186.

³⁸³ Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." fq. 1252.

³⁸⁴ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 16-17.

³⁸⁵ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 16-17.

³⁸⁶ Cubeddu, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 186.

Klasifikimi i mësipërm nuk është i ndarë në mënyrë kategorike, sepse bashkëshortët mundet gjithashtu të kombinojnë në një kontratë martesore të vetme si dispozita me natyrë programatike ashtu dhe dispozita me natyrë dispozitive. Kështu, në rastin kur bashkëshortët zgjedhin regjimin e bashkësisë universale ata përfshijnë në bashkësi jo vetëm të gjithë pasurinë që do të fitojnë gjatë martesës (me përjashtim të sendeve të parashikuara në nenit 77/c, ç, d), por edhe sendet që ato kanë fituar para lidhjes së kontratës martesore.

Veprimi juridik dispozitiv, i cili ka për objekt disponimin e pasurive të caktuara në pronësi të bashkëshortëve ose të bashkësisë, është klasifikuar nga doktrina në kategorinë e veprimeve juridike pa kundërshtim. Sipas disa autorëve, nga pikëpamja e strukturës është një “akt liberaliteti, por jo një kontratë dhurimi”³⁸⁷, ndërsa të tjerë autorë i njohin këtij veprimi juridik pa kundërshtim karakterin e kontratës së dhurimit.

2.10. Zbatimi i parimeve të Kodit Civil në kategorinë e kontratës martesore

Diskutimi, i cili vazhdon të ndajë edhe sot doktrinën juridike, i referohet natyrës juridike të kontratës martesore dhe klasifikimit të saj shkencor.

Një pjesë e doktrinës e konsiderojnë kontratën martesore si kontratë në kuptimin teknik, dhe për rrjedhojë, sipas tyre, kontratës martesore di të zbatohen normat e kodit civil që rregullojnë kontratën në përgjithësi, përveç rasteve kur kod.fam. parashikon një rregull të posaçëm³⁸⁸. Sipas këtyre autorëve marrëveshjet e bashkëshortëve për rregullimin e regjimit pasuror martesor janë kontrata të vërteta që u nënshtrohen normave mbi kontratën në përgjithësi³⁸⁹.

Ndërsa pjesa tjetër, mban qëndrimin që, nuk mund të vihen shenja barazie midis kontratës martesore dhe kontratave të rregulluara nga kodi civil, por sipas tyre kontrata është një veprim juridik i dyanshëm pasuror, i ndryshëm nga kontrata e rregulluar nga kod.civ. Në vijim të arsyetimit të tyre, autorët e grupit të dytë janë të mendimit që, megjithëse nuk mund të vihen shenja barazie ndërmjet kontratës dhe kontratës martesore, për aq sa është e mundur kontratës martesore i zbatohen rregullat e parashikuara nga kod.civ. për kontratën.

Objekti i kësaj pjese të punimit do të jetë pikërisht studimi i mundësisë së zbatimit mbi kontratën martesore të parimeve të përgjithshme të së drejtës private dhe të dispozitave të kodit civil që rregullojnë kontratën në përgjithësi.

Para se të nisim analizën e dispozitave konkrete të kod.civ, që rregullojnë kontratën në përgjithësi, le të shohim më parë se cili është raporti që ekziston midis “dispozitave të kod.civ. që rregullojnë kontratën në përgjithësi” dhe dispozitave të kod.civ. apo ligjeve të tjera (në rastin konkret kod.fam) që rregullojnë një kontratë të veçantë (kontratën martesore në rastin tonë).

Ndërmjet grupit të parë të normave (që rregullojnë kontratën në përgjithësi) dhe grupit të dytë (që rregullojnë kontratën martesore) ekziston ky raport³⁹⁰:

a) Normat ligjore, mbi kontratat në përgjithësi, janë norma të përgjithshme “*lex generalis*”, dhe zbatohen mbi të gjitha llojet e kontratave;

b) Normat e kod.fam. për kontratën martesore (normat që rregullojnë kontrata e veçanta), gjejnë zbatim vetëm në rregullimin e kontratës martesore (kontratës së cilës i referohen), ato që emërtohen si “*lex specialis*”;

c) Nëse mbi një element (institut) të caktuar të kontratës martesore mund të zbatohen njëkohësisht si normat e përgjithshme të kontratës së kodit civil ashtu dhe normat e posaçme të

³⁸⁷ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1254-1255.

³⁸⁸ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 938-939.

³⁸⁹ Galgano, Francesco. *E drejta private*. Botim i tretë. Tiranë: Luarasi University Press, 2006, fq. 948.

³⁹⁰ Galgano, Francesco. *Il contratto*. Seconda edizione. Milano: Cedam, 2011, fq. 31-32.

kodit të familjes, atëherë, në bazë të parimit “*lex specialis derogat generalis*”, normat e posaçme të kod.fam. kanë epërsi mbi normat e përgjithshme të kod.civ.

Jemi të mendimit që, pavarësisht diversitetit të tyre, regjimet pasurore martesore janë objekt i rregullimit të disa normave të përgjithshme të parashikuara nga kod.fam si dhe janë gjithashtu objekt i zbatimit të dispozitave dhe parimeve të përgjithshme të kodit civil mbi veprimin juridik, detyrimet kontraktore dhe ato jashtëkontraktore³⁹¹, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me normat e kod.fam. Kontrata martesore, gjithashtu, i nënshtrohet regjimit juridik të veprimeve juridike dhe kontratave, nga njëra anë dhe nga ana tjetër ajo i nënshtrohet një regjimi juridik të veçantë të rregulluar nga kod.fam, për shkak të natyrës së objektit të saj³⁹².

Ajo që paraqitet mjaft interesante në studimin e kontratës martesore është analiza dhe përcaktimi i kufirit deri në të cilin, parimet e përgjithshme të kod.civ. mund të gjejnë zbatim në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, në përgjithësi dhe të kontratës martesore në veçanti.

Para se të kalojmë në analizën e këtij raporti ndërmjet normave të përgjithshme dhe atyre specifike, duhet evidentuar që parimet e përgjithshme të kod.civ mbi detyrimet dhe kontratat nuk mund t'i zbatohen marrëdhënieve personale të bashkëshortëve, marrëdhënie të cilat janë të rregulluara me norma të karakterit imperativ³⁹³.

Parimi i mirëbesimit, në marrëdhëniet kontraktore, është një parim shumë i rëndësishëm i kod.civ, i cili patjetër që zbatohet edhe në disiplinën e kontratës martesore. Gjatë fazë parakontraktore dhe asaj kontraktore, të lidhjes së kontratës martesore, sjellja e bashkëshortëve duhet të karakterizohet nga mirëbesimi. Sipas nenit 664 të kod.civ, palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për lidhjen e kontratës duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës.

Gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në kontratën martesore, dispozitat e kod.civ, që rregullojnë³⁹⁴:

- a) Normat mbi autonominë kontraktore të palëve (neni 660 i kod.civ);
- b) Normat që rregullojnë kushtet thelbësore të kontratave (neni 663 i kod.civ);
- c) Normat që rregullojnë efektet e kontratave (nenet 690-693 të kod.civ);
- d) Normat që rregullojnë interpretimin e kontratës (nenet 681-685 të kod.civ);
- e) Normat që rregullojnë pavlefshmërinë e veprimeve juridike dhe pasojat e pavlefshmërisë.

Të gjithë këto norma do të gjejnë zbatim në rregullimin e kontratës martesore, përveçse kur kod.fam. parashikon norma specifike për rregullimin e marrëdhënieve të mësipërme. Kështu mund të përmendim që i mituri i emancipuar, i cili ka lidhur martesë, sipas kushteve të parashikuara nga neni 7/2 i kod.fam, megjithëse ka fituar zotësi të plotë për të vepruar (sipas nenit 6/3 i kod.civ) dhe mund të kryejë veprime juridike, nuk mund të lidhë kontratë martesore. Si rrjedhojë, kontrata martesore e lidhur nga bashkëshorti i mitur do të jetë absolutisht e pavlefshëm.

Një tjetër përjashtim e ndeshim në rastin e efekteve të kontratës. Si rregull i përgjithshëm, kontrata sjell efekte vetëm inter partes, ndërsa kontrata martesore në devijim të këtij rregulli ka efekte *erga omnes*, i kundërdrejtohet edhe të tretëve, për mbrojtjen e pozitive kontraktore të të cilëve, kod. fam. ka parashikuar sistemin e regjistrimit të kontratës.

Nga ana tjetër, nuk mund të gjejnë zbatim në institutin e kontratës martesore, normat e kod.civ. që rregullojnë zgjidhjen e kontratës për mospërbushje të detyrimeve kontraktore³⁹⁵ (neni 698 e në vijim të kod.civ)³⁹⁶.

³⁹¹ Në mbështetje të këtij opinion shih: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 7.

³⁹² Goré, Marie. “La détermination du régime matrimonial.” në *Droit Patrimonial de la Famille*, M. Grimaldi (Ed.), Paris: Dalloz, 1998, fq. 7.

³⁹³ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 7.

³⁹⁴ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 290-291.

³⁹⁵ Cabanillas, “Las Capituciones matrimoniales. Capitullo II.” fq. 590;

³⁹⁶ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 508.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, jemi të mendimit që, kontrata martesore, në thelb, është një kontratë e zakonshme për ekzistencën, vlefshmërinë dhe interpretimin³⁹⁷ e së cilës zbatohen rregullat e përgjithshme të kontratave, të parashikuara në dispozitat e kod.civ.

2.11. Vështrim i krahasuar. Diversiteti i regjimeve pasurore dhe rregullimi i kontratës martesore në Europë

Megjithëse ndryshimet ndërmjet regjimeve pasurore në Europë janë të dukshme, ato të gjitha bazohen në një sistem të përbashkët, i cili bazohet në ekzistencën e një regjimi, të quajtur “ligjor”, i cili gjen zbatim në mungesë të një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, marrëveshje e cila mund të lidhet *ante nuptial* ose *constante matrimonii*, me objekt përcaktimin e një regjimi pasuror, të ndryshëm nga ai ligjor³⁹⁸.

Të gjitha sistemet ligjore europiane, bazojnë regjimet pasurore, ligjore dhe kontraktore, mbi parimin e barazisë së burrit dhe gruas gjatë martesës. Kështu, legjislacionet europiane janë larguar nga modelet e regjimeve pasurore, të cilat parashikonin një pozitë superiore të bashkëshortit, i cili ishte subjekti që kishte të drejtën e administrimit të pasurisë së përbashkët³⁹⁹. Një tjetër element që karakterizon regjimet pasurore të vendeve europiane është parashikimi, i pjesës më të madhe të tyre, të një grupi dispozitash të karakterit pasuror, të pashmangshme, të njohura me termin “*régime primaire*”. Normat e regjimit primar mund të përmbajnë për shembull, rregulla mbi mbrojtjen e banesës familjare, përgjegjësisë solidare për detyrimet që rrjedhin nga martesë etj⁴⁰⁰. Normat e regjimit primar janë të pavarura nga regjimi pasuror martesor “*régime secondaire*”. Në të gjitha sistemet ligjore europiane bashkëshortët gëzojnë një shkallë të gjërë të autonomisë së vullnetit, për rrjedhojë ata, nëpërmjet instrumentit ligjor të kontratës martesore, mund të shmangin zbatimin e regjimit pasuror ligjor, nëpërmjet zgjedhjes së një regjimi pasuror kontraktor.⁴⁰¹

Regjimet pasurore martesore janë të ngjashëm ndërmjet tyre në shumë legjislacione europiane, por ajo që dallon njërin sistem ligjor nga tjetri është roli që ligjvënësi i ka dhënë këtyre regjimeve pasurore. Kështu për shembull, regjimi i pasurive të ndara në disa sisteme ligjore, parashikohet si regjim ligjor, ndërsa në disa sisteme të tjera e gjejmë të rregulluar në formën e regjimit pasuror kontraktor. Në sistemin ligjor Gjerman regjimi i pjesëmarrjes në fitime është rregulluar si regjim ligjor, në legjislacionin Francez e gjejmë të rregulluar në kategorinë e regjimeve kontraktore, ndërsa në atë Italian dhe Shqiptar, regjimi i pjesëmarrjes në fitime nuk gjen vend as në formën e regjimit ligjor (në të dy shtetet regjimi ligjor është si i bashkësisë së pjeseshme) dhe as në formën e regjimit kontraktor⁴⁰². Holanda është i vetmi shtet evropian që rregullon regjimin pasuror ligjor në formën e regjimit të bashkësisë universale.

Referuar regjimit pasuror ligjor, përgjithësisht, sistemet ligjore të familjes ligjore romanike si dhe ato të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, parashikojnë regjimet pasurore të bashkëpronësisë (bashkësisë), ndërsa nga ana tjetër, vendet e traditës ligjore Gjermanike dhe Nordike, kanë preferuar regjimin e pasurive të ndara të kombinuar me pjesëtimin e fitimeve, në përfundim të martesës (regjimi i pjesëmarrjes në fitime)⁴⁰³.

³⁹⁷ Për më shumë rreth këtij qëndrimi shih: Dutta, “Marital agreements and private autonomy in Germany.” fq. 160.

³⁹⁸ Patti, Salvatore dhe Cubeddu, Maria G. *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*. Milano: Giuffrè Editore, 2008, fq. 195.

³⁹⁹ Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 197.

⁴⁰⁰ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1158.

⁴⁰¹ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1158.

⁴⁰² Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 198.

⁴⁰³ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1158.

Nga ana tjetër, sistemi ligjor “*common law*” nuk e njeh konceptin e regjimit pasuror martesore, në kuptimin kontinental, për rrjedhojë ata nuk kanë një regjim pasuror ligjor. Me miratimin e Ligjit të Statusit Pasuror të Grave të Martuara (Married Women’s Property Act), i vitit 1882, martesë nuk sjell pasoja ligjore në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, në Angli dhe Wells⁴⁰⁴. Megjithatë, gjyqtarët e sistemit ligjor “*common law*” kanë një shkallë të gjerë diskrecioni për pjesëtimin e fitimeve që ka realizuar secili prej bashkëshortëve gjatë martesës, në rastin e zgjidhjes së martesës (një procedurë e ngjashme me operacionin e pjesëtimit të fitimeve që realizohet në regjimet kontinentale të pjesëmarrjes në fitime). Në këtë sistem ligjor, bashkëshortët kanë të drejtë të rregullojnë me kontratë martesore, të njohura si “*prenuptial agreements*”, aspekte të ndryshme të jetës së përbashkët, marrëdhëniet pasurore, ato personale jopasurore, si dhe të rregullojnë në mënyrë preventive pasojat e zgjidhjes së martesës. Prenuptial agreements ndryshojnë nga version kontinental i kontratës martesore, pasi objekti i kësaj të fundit (në kuptimin e ngushtë) është vetëm rregullimi i regjimit pasuror martesor.

Mund të pohojmë që, pavarësisht dallimeve ndërmjet sistemit ligjor *common law* dhe atij kontinental, ekzistojnë ngjashmëri ndërmjet të drejtës angleze dhe regjimit kontinental të pjesëmarrjes në fitime⁴⁰⁵.

Zgjedhja e regjimit ligjor që, bën çdo sistem ligjor, varet nga rëndësia që ligji kërkon t’i japë disa interesave dhe nevojave të familjes në raport me të tjerat⁴⁰⁶.

2.11.1. Klasifikimi i regjimeve pasurore në Europë

Pavarësisht nga diversiteti i tyre, bazuar në faktin nëse lidhja e martesës sjell ose jo pasoja për pasurinë e bashkëshortëve, regjimet pasurore në Europë i klasifikojmë në dy grupe të mëdha: a) regjime pasurore të bashkësisë dhe b) regjime separatiste (të pasurive të ndara).

Nga ana e tyre, regjimet e bashkësisë klasifikohen në dy grupe: a) regjimet e bashkësisë universale dhe b) regjimet e bashkësisë së pjeseshme; ndërsa regjimet separatiste, bazuar në pasojat që sjell zgjidhja e martesës në pasurinë e bashkëshortëve, i klasifikojmë gjithashtu në dy grupe: a) regjime të pasurive të ndara dhe b) regjime të pjesëmarrjes në fitime⁴⁰⁷. Ndërsa regjimi i bashkësisë sjell pasoja të menjëhershme në pasurinë e bashkëshortëve, karakteristikë e regjimeve separatiste është që lidhja e martesës nuk sjell pasoja në pasurinë e tyre. Regjimet e bashkësisë përfaqësojnë shkallën më të lartë të solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve, ndërsa në regjimet separatiste solidariteti i bashkëshortëve nuk është i menjëhershëm, por krijohet në një fazë të mëtejshme, në atë të përfundimit të martesës, në të cilën realizohen kompensime ndërmjet bashkëshortëve ose pjesëtime mbi fitimet e realizuara nga secili prej tyre gjatë martesës⁴⁰⁸.

Shtrohet pyetja se cili prej regjimeve pasurore garanton më mirë barazinë e bashkëshortëve gjatë martesës. Një pjesë e doktrinës është e mendimit që, është regjimi i bashkësisë ai që garanton një barazi më të madhe të bashkëshortëve, sepse nuk bën asnjë dallim ndërmjet bashkëshortit që kontribuon materialisht në familje me atë që kontribuon në natyrë; ndërsa pjesa tjetër e doktrinës

⁴⁰⁴ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1158.

⁴⁰⁵ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1161.

⁴⁰⁶ Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 199.

⁴⁰⁷ Për krahasimin e regjimeve pasurore në Europë jemi mbështetur në: *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1162; Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 443-518; Boele-Woelki, Katharina. Ferrand, Fédérique. Gonzales Beilfuss, Christina. Jänträ-Jareborg, Maarit. Lowe, Nigel. Martiny, Dieter. dhe Pintens, Walter. *European Family Law regarding property relations between spouses*, Cambridge: Intersentia, 2013, fq. 1; *International Encyclopedia of Comparative Law*. Volume IV. Persons and family, A. Chloros, M. Rheinstein, M.A. Glendon, Tubingen: Mhor Siebeck, 2007, fq. 89.

⁴⁰⁸ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 474.

mban qëndrimin që, janë regjimet separatiste që sigurojnë barazinë më të madhe ndërmjet bashkëshortëve, duke garantuar pavarësinë pasurore të tyre, gjatë martesës⁴⁰⁹.

Brenda secilës prej kategorive të regjimeve pasurore ekzistojnë variante të shumta, të cilat ndryshojnë nga njëri shtet European në tjetrin.

2.11.1.1. Regjimet e Bashkësisë

Bazuar në objektin e bashkësisë, nga njëra anë, si dhe në kategorinë e sendeve vetjake të secilit bashkëshort, nga ana tjetër, regjimet e bashkësisë i klasifikojmë në dy grupe.

A. Regjimi i bashkësisë universale. Holanda është i vetmi shtet European, i cili rregullon regjimin pasuror ligjor nëpërmjet regjimit të bashkësisë universale, ndërsa në shtete të tjera europiane ky regjim është rregulluar në kuadrin e regjimeve pasurore kontraktore (Itali, Francë, Gjermani, Spanjë). Çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës dhe çdo pasuri e fituar nga secili prej tyre, gjatë martesës, (duke përfshirë edhe pasurinë e fituar me dhurim ose trashëgimi) është pasuri e përbashkët, nëse bashkëshortët nuk kanë zgjedhur një regjim tjetër pasuror. Pasuria e fituar me dhurim ose trashëgimi përjashtohet nga bashkësia, vetëm nëse dhuruesi ose trashëgimlënësi e ka përjashtuar shprehimisht këtë pasuri nga përfshirja në bashkësi. Me zgjidhjen e martesës, pasuria e bashkësisë pjesëtohet në pjesë të barabarta ndërmjet bashkëshortëve⁴¹⁰. Regjimi i bashkësisë universale është shprehja më e lartë e solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve.

B. Bashkësia e pjesshme “community of acquests/community of acquisitions”. Regjimi i bashkësisë së pjesshme shtrihet vetëm mbi pasurinë e fituar gjatë martesës nga secili bashkëshort, duke përjashtuar pasurinë e fituar nëpërmjet veprimeve juridike pa kundërshtim, trashëgimia, legu, kontrata e dhurimit si dhe duke përjashtuar pasurinë e fituar nga secili bashkëshort para lidhjes së martesës. Ky regjim është parashikuar si regjim ligjor në shtetet e së Drejtës Romanike, psh. Belgjikë, Itali (ligji italian bën dallimin ndërmjet bashkësisë aktuale dhe asaj eventuale), Francë, Luksemburg, Maltë, Portugali, Spanjë (të të drejtën e përgjithshme – *derecho común*⁴¹¹) si dhe në të drejtën e disa rajoneve të Spanjës si: Aragon, Galicia, Navarre dhe Vendet Baske⁴¹², shumë shtete të Europës Qendrore dhe Lindore (Poloni, Hungari, Bullgari, Estoni, Lituani, Sllovaki, Rusi, Republika Çeke, Slloveni, Ukrainë, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë) si dhe disa shtete të SHBA-së.

Pasuria e bashkëshortëve në regjimin e bashkësisë së pjesshme është e ndarë në pasurinë e bashkësisë dhe në pasurinë vetjake të secilit bashkëshort, ndërsa në përfundim të martesës bëhet pjesëtimi i pasurisë në pjesë të barabarta, ndërmjet bashkëshortëve. Gjykata nuk ka asnjë diskrecion ose në disa shtete ka një diskrecion shumë të vogël në përcaktimin e pjesëve jo të barabarta, bazuar në kontributin e secilit bashkëshort në fitimin e pasurisë.

⁴⁰⁹ Për më shumë rreth këtij debati doktrinal shih: Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 475.

⁴¹⁰ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 447-448.

⁴¹¹ E drejta familjare Spanjolle nuk është e unifikuar dhe përveç të drejtës së përbashkët, pra Kodit Civil Spanjoll, shumë rajone kanë të drejtat e tyre, të quajtura “*derecho forales*”. KC Spanjoll është “*derecho supletario*” në raport me “*derecho forale*”. Ky parim i supremacisë së të drejtës së rajoneve në raport me atë shtetërore është sanksionuar në Kushtetutën e Spanjës (neni 149.1.8).

⁴¹² Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 449-450.

Megjithëse, nga njëra anë, ky regjim respekton rolin e bashkëshortëve në familje dhe mbron bashkëshortin më të dobët ekonomikisht, nga ana tjetër, ky regjim nuk është i përshtatshëm për qarkullimin e të mirave, për shkak të rregullit të administrimit të përbashkët të pasurisë⁴¹³.

2.11.1.2. Regjimet Separatiste

Bazuar në pasojat që sjellin regjimet separatiste në pasurinë e bashkëshortëve, në hipotezën e zgjidhjes së martesës, regjimet separatiste i klasifikojmë në tre grupe.

A. *Deferred community property – Regjimi i bashkësisë së ardhshme (mëvonshme)*. Në regjimin pasuror të “deferred community property” lidhja e martesës nuk sjell asnjë ndryshim në pasurinë e bashkëshortëve, ndërsa në përfundim të martesës, e gjithë pasuria e bashkëshortëve (me përjashtim të pasurisë së fituar me dhurim ose trashëgimi kur në kontratën e dhurimit ose në testament është përjashtuar përfshirja e tyre) bëhet pasuri e përbashkët dhe i nënshtrohet pjesëtimit ndërmjet bashkëshortëve, në pjesë të barabarta⁴¹⁴.

“Deffered community property” është regjim ligjor karakteristikë e shteteve Nordike (Danimarkë, Finlandë, Islandë, Norvegji dhe Suedi). Për arsye se, nuk i përgjigjet më realitetit social të këtyre shteteve, ky regjim i është nënshtuar reformimit ligjor, kryesisht në drejtim të parashikimit të pjesëve jo të barabarta në pjesëtim. Kështu për shembull, Danimarka parashikon mosformimin e bashkësisë në përfundim të martesës, nëse a) martesa ka zgjatur më pak se 5 vjet; ose b) para lidhjes së martesës disniveli ekonomik i bashkëshortëve ka qenë i lartë; ose c) pasuria e njërit bashkëshort është shtuar nëpërmjet dhurimit ose trashëgimisë. Në çdo rast përjashtimi i kategorive të caktuara të pasurisë së bashkëshortëve nga bashkësia realizohet vetëm me vendim gjyqësor dhe në këtë drejtim gjykata gëzon një diskrecion të madh⁴¹⁵.

Nga ana tjetër, detyrimi për ushqim ndërmjet ish-bashkëshortëve nuk luan rol në pasojat e zgjidhjes së martesës dhe jepet në raste shumë të rralla nga gjykata, bazuar në dy argumente⁴¹⁶:

- a) Konsiderohet se çon në ruajtjen e mëtejshme të lidhjeve ndërmjet ish-bashkëshortëve, ndërkohë që, tradita ligjore dhe sociale e këtyre shteteve kërkon që, pas zgjidhjes së martesës, këto lidhje të mos ekzistojnë më;
- b) Ndihma ekonomike për personat në nevojë shihet si detyrë e shtetit dhe jo e ish-bashkëshortit në nevojë.

B. *Statutory compensation systems – Regjimi i pjesëmarrjes në fitime*. Në këtë regjim pasuror lidhja e martesës nuk sjell asnjë pasojë në pasurinë e bashkëshortëve, në përfundim të martesës nuk formohet një bashkësi, por ligji i njeh të drejtën bashkëshortëve të ngrënë pretendime pasurore ndaj njëri-tjetrit, në lidhje me pasurinë e fituar nga secili prej tyre gjatë martesës⁴¹⁷. Regjimit pasuror të “statutory compensation system” mund ti bëjmë një klasifikim në dy nënkategori:

a) Regjimi i pjesëmarrjes në fitime “community of accrued gains/participation in acquisitions”, sipas modelit gjerman “zugewinnaungleich”. Sipas modelit gjerman, pasuria e bashkëshortëve mbetet e ndarë si gjatë ashtu dhe pas zgjidhjes së martesës, megjithatë në përfundim të martesës bashkëshortët kanë të drejtë të kërkojnë pjesëtimin e fitimeve, me të cilat është shtuar pasuria e secilit prej tyre gjatë martesës. Bashkëshorti pasuria e të cilit është shtuar

⁴¹³ Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 201.

⁴¹⁴ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 453-454.

⁴¹⁵ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 455.

⁴¹⁶ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 456

⁴¹⁷ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 457-458.

më pak fiton të drejtën e kompensimit me gjysmën e diferencës së shtimit që ka pësuar pasuria e secilit bashkëshort gjatë martesës. Për të realizuar llogaritjen merret në konsideratë gjendja e pasurisë së bashkëshortëve në dy momente kohore: gjendja fillestare (momenti i lidhjes së martesës) dhe gjendja përfundimtare (momenti i përfundimit të martesës), duke përjashtuar nga kjo llogaritje pasuritë e fituara me dhurim dhe trashëgimi⁴¹⁸, realizohet zbritja e pasivit nga aktivi dhe në përfundim, bashkëshorti pasuria e të cilit është shtuar më shumë, gjatë martesës, ka detyrimin t'i kompensojë bashkëshortit tjetër ½ e vlerës së shtuar.

b) Regjimi i pjesëmarrjes në fitime sipas modelit zviceran – “*separation of property with distribution by the competent authority*”. Ky regjim pasuror është regjimi ligjor në Zvicër dhe Greqi. Me zgjidhjen e martesës bashkëshortët kanë të drejtë të kërkojnë gjysmën e fitimeve të realizuara nga bashkëshorti tjetër gjatë martesës. Në Zvicër pjesëtimi realizohet në pjesë të barabarta, ndërsa në Greqi gjykata mund të caktojë pjesë jo të barabarta, bazuar në provën e kontributit⁴¹⁹.

Regjimi i pjesëmarrjes në fitime, pavarësisht nga diferencat teknike ndërmjet shteteve të ndryshme, është konsideruar nga doktrina⁴²⁰ si regjimi pasuror më i ekuilibruar, që jo vetëm mbron të dy bashkëshortët, por edhe i përgjigjet më mirë kërkesave të qarkullimit civil të pasurisë.

C. Regjimi i pasurive të ndara. Në regjimin e pasurive të ndara, nga njëra anë pasuria që fiton secili prej bashkëshortëve, gjatë martesës, mbetet pasuri vetjake e atij bashkëshorti që e ka fituar dhe nga ana tjetër, zgjidhja e martesës nuk sjell asnjë pasojë në pasurinë e bashkëshortëve. Nga njëra anë, ky regjim respekton barazinë e bashkëshortëve, pasi parashikon që bashkëshortët mbeten pronarë të pasurisë që zotëronin para lidhjes së martesës si dhe të pasurisë që fiton secili prej tyre gjatë martesës, si dhe gëzon administrimin e lirë të kësaj pasurie. Nga ana tjetër, ky regjim nuk merr parasysh diversitetin e roleve të bashkëshortëve në familje dhe në veçanti përkushtimin e gruas në rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe kujdesin për banesën familjare⁴²¹. Pikërisht bazuar në këtë kritikë pjesa më e madhe e legjislacioneve europiane, në 30-40 vitet e fundit⁴²², e kanë reformuar regjimin pasuror ligjor, duke kaluar në regjimin e bashkësisë.

2.11.1.3. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin ligjor “*common law*”- *Separation property with distribution by the competent authority*

Në shtetet e sistemit ligjor “*common law*” nuk njihet aspak koncepti i regjimit pasuror martesor. Lidhja e martesës nuk sjell asnjë ndryshim në pasurinë e secilit bashkëshort. Megjithatë, në rastin e zgjidhjes së martesës, gjykatave u njihet një rol mjaft i madh në zgjidhjen e pasojave financiare të zgjidhjes së martesës dhe në rishpërndarjen ndërmjet bashkëshortëve të pasurisë së fituar nga njëri bashkëshort gjatë martesës. Bazuar në dikrecionin e gjykatave për pjesëtimin e pasurisë së fituar nga secili prej bashkëshortëve, gjatë martesës, ose për pjesëtimin e vlerës me të cilën është shtuar pasuria e tyre, shtetet e sistemit ligjor “*common law*” mund t'i klasifikojmë në dy grupe:

⁴¹⁸ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 458.

⁴¹⁹ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 459.

⁴²⁰ Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 202.

⁴²¹ Mbi argumentet pro dhe kundër regjimit të pasurive të ndara shih: Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 199-200.

⁴²² Në këtë drejtim Italia, me reformën ligjore të vitit 1975, kaloi nga regjimi ligjor i pasurive të ndara në regjimin e bashkësisë së pjesshme, influencuar nga reforma ligjore franceze e vitit 1965. Në legjislacionet e shumë vendeve europiane, sot ky regjim gjendet i rregulluar në formën e regjimit kontraktor, psh: Itali, Francë, Spanjë, Gjermani etj. Ashtu si edhe regjimi i bashkësisë universale, regjimi i pasurive të ndara paraqet një model ekstrem të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve.

A. Rule-based discretionary approach⁴²³. Gjykatat shqyrtojnë çdo pretendim pasuror të bashkëshortëve, ndaj njëri-tjetrit, në mënyrë të pavarur: detyrimi për ushqim, e drejta e përdorimit të banesës bashkëshortore, të drejtat e pensionit. Vlerësimi i gjykatës duhet të bazohet në ligj si dhe në praktikën gjyqësore (case law). Këtë diskrecion gjyqësor e ndeshim në disa shtete të SHBA-ve, Skoci, Singapor, Zelandë e Re dhe Austri.

B. Full discretionary approach⁴²⁴. Në raport me shtetet e përmendura më sipër, në disa shtete të “common law” si Angli, Wells, Irlandë dhe Austri, diskrecioni i gjykatave në shqyrtimin e pretendimeve pasurore të bashkëshortëve është më i madh. Pretendimet pasurore, të drejtat e pensionit, e drejta e përdorimit të banesës dhe detyrimi për ushqim nuk shqyrtohen nga gjykata në mënyrë të pavarur, por në tërësi “si një pako e vetme”. Madje, në këto shtete, gjykata kanë të drejtë që të mos zbatojnë marrëveshjet e bashkëshortëve për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës “pre-nuptial agreements”. Vetëm në vitin 2011, në çështjen Radmacher vs. Garantino⁴²⁵, Gjykata Supreme Angleze ka vendosur që këto marrëveshje duhet të zbatohen nga gjykatat angleze nëse plotësojnë disa kushte të caktuara.

2.11.2. Vështrim krahasues i kontratës martesore në Europë

Të gjitha shtetet europiane garantojnë të drejtën e bashkëshortëve për vetërregullimin e interesave të tyre pasurorë, nëpërmjet instrumentit të kontratës martesore. Pavarësisht elementëve të përbashkët ka dallime në drejtim të regjimit juridik, të cilit i nënshtrohet kontrata martesore në secilin prej këtyre shteteve.

A. Kufijtë e autonomisë së vullnetit të palëve⁴²⁶. Shkalla e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve ndryshon në shtete të ndryshme, në varësi të faktorëve të tillë si: shkalla e ndërhyrjes së shtetit në rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile dhe ndikimet fetare e ideologjike në institutin e martesës si dhe nevoja për gjetjen e një balance sa më të drejtë ndërmjet vullnetit të bashkëshortëve dhe nevojës për mbrojtjen e bashkëshortit më vulnerabël. Bazuar në këto kritere, legjislacionet e shteteve europiane i klasifikojnë në tre grupe:

- a) Shtete, në të cilët bashkëshortët kanë *liri të gjerë në zgjedhjen e regjimit pasuror* martesor. Bashkëshortët janë të lirë të zgjedhin një nga regjimet pasurore të rregulluara në mënyrë të shprehur në kod.civ., një regjim pasuror atipik ose të kombinojnë elementë të regjimeve të ndryshme pasurore. Në këtë kategori mund të përfshijmë Austrinë, Italinë, Belgjikën, Francën.
- b) Shtete, të cilat i lejojnë bashkëshortëve *zgjedhjen vetëm të njërit prej regjimeve pasurore të rregulluara shprehimisht në ligj*, të tilla si: Danimarkë, Finlandë, Greqi, Zvicër, Sllovaki.
- c) Shtete, në të cilat *autonomia e vullnetit është akoma më e kufizuar*, si psh. Portugalia, e cila nuk lejon ndryshimin e regjimit pasuror martesor gjatë martesës (neni 1741 i KC Portugez), nuk lejon zgjedhjen e regjimit të bashkësisë universale nga bashkëshortët që

⁴²³ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 460.

⁴²⁴ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 460.

⁴²⁵ Vendim i Gjykatës Supreme Angleze 20 Tetor 2010, (2010) UKSC. Palët kishin lidhur martesë në 28 Nëntor të vitit 1998 në Londër. Disa ditë para lidhjes së martesës ata kishin lidhur në Gjermani, para një noteri, një kontratë martesore. Gjykata Supreme Angleze vendosi që, kontrata martesore ishte e vlefshme edhe në Angli. Për më shumë shih: Anderson, David, *Marriage contracts after the recent Supreme Court decision in Radmacher vs. Garantino* (2010), Tetor 2010.

⁴²⁶ Mbi këtë klasifikim shih: Pintens, Walter. “Matrimonial property law in Europe.” në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J.M. Scherpe, Cambridge: Intersentia, 2011, fq. 39.

kanë fëmijë nga martesë të mëparshme si dhe nuk lejon rregullimin kontraktor të regjimit pasuror për bashkëshortët që janë mbi 60 vjeç (neni 1270 KC Portugez).

B. Forma e kontratës martesore⁴²⁷. Në drejtim të formës së kontratës martesore shtetet europine mund t'i klasifikojmë në tre kategori:

- a) Shtete të cilat kërkojnë formën e *aktit noterial* për vlefshmërinë e kontratës martesore. Pjesa më e madhe e shteteve europiane parashikojnë në legjislacionet e tyre të brendshme aktin noterial, si: Gjermani, Itali, Francë, Belgjikë, Spanjë, Holandë, Portugali, Zvicër, etj.
- b) Shtetet të cilat zbatojnë parimin e përgjithshëm të *lirisë së formës*. Në këtë kategori përfshihen vendet e “common law”, si Angli, Skoci dhe Irlandë.
- c) Shtete të cilat kërkojnë formën e *shkresës së thjeshtë*, si kusht për vlefshmërinë e kontratës martesore, të tilla si: disa shtete të SHBA-së, Zelanda e Re dhe Australia.
- d) Shtete të cilat kërkojnë formën e *shkresës së thjeshtë shoqëruar me regjistrimin* në gjykatë për efekt vlefshmërie të kontratës martesore, si Suedia.

C. Regjistrimi i kontratës martesore⁴²⁸. Në drejtim të kriterit të regjistrimit të kontratës martesore, shtetet europiane klasifikohen në dy grupe:

- a) Shtete të së drejtës romanike, të cilat parashikojnë regjistrimin e kontratës martesore në *regjistrat publikë ekzistues* (regjistri i martesës, regjistri tregtar dhe ai i pasurive të paluajtshme), si Itali, Francë, Spanjë etj;
- b) Shtetet e së drejtës gjermanike, të cilat parashikojnë regjistrimin e kontratës martesore në një *Regjistër të Posaçëm*, të tilla si: Gjermania dhe Vendet Nordike.

D. Mbrojtja e të tretëve⁴²⁹. Me qëllim mbrojtjen e të tretëve, të cilët kontraktojnë me bashkëshortët gjatë martesës, shtete të ndryshme, përveç kriterit të regjistrimit të kontratës martesore, parashikojnë edhe autorizimin gjyqësor “*homologim*” në rastin e ndryshimit të regjimit pasuror gjatë kohëzgjatjes së martesës. Këtu mund të përmendim Francën deri në reformën e vitit 2003, Belgjikën deri në reformën e vitit 2006 si dhe Italinë, Holandën dhe Maltën. Gradualisht, këto shtete e kanë hequr këtë kriter ligjor. Megjithatë akoma sot në Francë kërkohet autorizimi gjyqësor, nëse bashkëshortët që ndryshojnë regjimin pasuror martesor kanë fëmijë të mitur. Me qëllim mbrojtjen e të tretëve në Portugali bashkëshortët nuk kanë mundësinë e ndryshimit të regjimit pasuror martesor gjatë martesës.

2.11.3. Perspektiva Europiane. Drejt një harmonizimi të regjimeve pasurore në Europë?

Intensifikimi i lëvizjeve të lirë dhe koncepti i “*qytetarisë*” kanë sjellë rritjen e diskutimeve mbi unifikimin e të drejtës ndërkombëtare private në fushën e marrëdhënieve familjare si dhe harmonizimin e të drejtës familjare substanciale⁴³⁰.

Harmonizimi i regjimit pasuror martesor në Europë (Bashkimin European) është një proces mjaft i vështirë. Në hapësirën e BE-së ekzistojnë dallime të dukshme ndërmjet regjimeve pasurore martesore, jo vetëm ndërmjet sistemit ligjor common law dhe atij kontinental, por edhe vetë brenda sistemit kontinental; dallime të cilat e kanë burimin e tyre tek historia, kultura, traditat

⁴²⁷ Pintens, “Matrimonial property law in Europe.” fq. 38-39; Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 491-492.

⁴²⁸ Pintens, “Matrimonial property law in Europe.” fq. 38-39.

⁴²⁹ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 487-488.

⁴³⁰ Boele-Woelki, Ferrand, Gonzales Beilfuss, Jänträ-Jareborg, Lowe, Martiny, dhe Pintens, *European Family Law regarding property relations between spouses*, fq. 1-2.

dhe kushtet social-ekonomike të shteteve të ndryshme europiane. Për këtë arsye një harmonizim i ardhshëm i regjimeve pasurore në Europë paraqet mjaft vështirësi.

BE nuk ka kompetenca, sipas TFEU⁴³¹, për harmonizimin ose unifikimin e së drejtës në fushën e të drejtës familjare substanciale, por bazuar në nenin 81 të Traktatit BE ka kompetenca në fushën e marrëdhënieve civile me elementë të huaj, duke përfshirë këtu edhe marrëdhëniet familjare me elementë të huaj. Në këtë kuadër, janë miratuar katër Rregullore mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja, në fushën e zgjidhjes së martesës⁴³², përgjegjësisë prindërore⁴³³, detyrimin për ushqim⁴³⁴ dhe trashëgimisë⁴³⁵. Referuar zhvillimeve më të fundit, ka një përpjekje në BE për harmonizimin e normave të së drejtës ndërkombëtare private në lidhje me regjimet pasurore martesore. Në këtë drejtim, në vitin 2011 Parlamenti European ka përgatitur një Projekt-Rregullore⁴³⁶ për ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, juridiksionin dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve të huaja. Një Projekt-Rregullore⁴³⁷ mbi ligjin e zbatueshëm mbi bashkëjetesat e regjistruara është përgatitur gjithashtu. Ndërsa, është në diskutim mundësia e rregullimit të qarkullimit të lirë të dokumenteve zyrtare dhe njohja e efekteve të akteve të gjendjes civile në hapësirën e BE-së.

Doktrina⁴³⁸ është e mendimit që, duke marrë parasysh ndërveprimin e së drejtës substanciale me atë ndërkombëtare private, instrumentet europiane rregullores të marrëdhënieve familjare me elementë të huaj, do të jenë të suksesshme, në planin afatgjatë, vetëm nëse do të ketë ngjashmëri gjithmonë e më të mëdha në fushën e të drejtës substanciale të shteteve anëtare. Këtij qëllimi i shërben aktualisht puna e CEFL, parimet në fushën e të drejtës familjare substanciale të të cilit shërbejnë si model për harmonizimin e të drejtës familjare në vendet anëtare⁴³⁹. Qëllimi i CEFL është që parimet e hartuara, të shërbejnë si burim frymëzimi për shtetet europiane në procesin e reformimit të legjislacionit të tyre të brendshëm. Në këtë mënyrë mund të arrihet unifikimi. Megjithatë, shtetet anëtare janë të lira t'i marrin parasysh ose jo këto parime.

Në planin e së drejtës substanciale, aktualisht Komisioni i të Drejtës Familjare Europiane CEFL (Commission on European Family Law⁴⁴⁰) ka hartuar Parimet e të Drejtës Familjare Europiane

⁴³¹ Traktati mbi funksionimin e Bashkimit European. Traktati i Lisbonës (2007) rikonstatoi BE-në, duke amenduar Traktatin e BE-së (TEU) dhe Traktatin Themelues të Komunitetit European, i cili u bë më vonë Traktati themelues mbi funksionimin e BE-së (TFUE).

⁴³² Council Regulation (EU) No 1259/2010 of 20 December 2010 "On implementing enhanced cooperation in the area of the law applicable to divorce and legal separation", e njohur si Roma III.

⁴³³ Council Regulation (EU) No 2201/2003 of 27 November 2003 "On jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and in matters of parental responsibility", e njohur si Rregullorja Brussels II bis.

⁴³⁴ Regulation (EC) No. 4/2009 of 18 December 2009 "On jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and cooperation in matters relating to maintenance obligations".

⁴³⁵ Regulation (EU) No. 650/2012 of 4 July 2012 "On jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and authentic instruments in matters of succession and the creation of a European Certificate of Succession".

⁴³⁶ Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions in matters of matrimonial property regimes, COM (2011) 126/2.

⁴³⁷ Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions regarding the property consequences of registered partnerships, COM (2011) 127/2.

⁴³⁸ Në lidhje me këtë qëndrim shih: Boele-Woelki, Ferrand, Gonzales Beilfuss, Jänträ-Jareborg, Lowe, Martiny, dhe Pintens, *European Family Law regarding property relations between spouses*, fq. 2.

⁴³⁹ Në vitin 2008 Portugalia ka harmonizuar legjislacionin mbi divorcin (zgjidhjen e martesës) dhe përgjegjësinë prindërore, bazuar në parimet e hartuara nga CEFL.

⁴⁴⁰ CEFL, themeluar në vitin 2001, është e pavaruar nga çdo organizatë apo institucion. CEFL përbëhet nga 26 shtete europiane, të përfaqëuar në të nga akademikë, gjyqtarë dhe akovatë. Deri tani CEFL ka haruar tre gurpe parimesh: 1) Parimet "Mbi zgjidhjen e martesës dhe detyrimin për ushqim ndërmjet ish bashkëshortëve", viti 2004; 2) Parimet "Mbi përgjegjësinë prindërore", të hartuara në vitin 2007; 3) Parimet "Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve", të hartuara në vitin 2013.

në fushën e regjimeve pasurore martesore, parime të cilat bazohen mbi një “*common core*”⁴⁴¹ të sistemeve ligjore europiane. Nëse nuk ekziston një “*common core*” mbi një element të caktuar, atëherë Komisioni (CEFL) e gjen zgjidhjen nëpërmjet zbatimit të “*a better law approach*”. Në drejtim të kontratës martesore CEFL ka hartuar 6 parime, konkretisht parimet 4:10 – 4:15 të “Parimeve të CEFL mbi Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve”. Në këto parime parashikohet një përkufizimi i kontratës martesore (parimi 4:10), forma e kontratës (parimi 4:11), detyrimi i ndërsjellë i bashkëshortëve për të informuar njëri-tjetrin mbi gjendjen e pasurisë së tyre para lidhjes së kontratës (parimi 4:12), detyrimet e noterit (parimi 4:13), pasojat mbi palët e treta (parimi 4:14) dhe nevoja e madhe (parimi 4:15).

Referuar sërish, aktualitetit të harmonizimit të së drejtës substanciale të regjimeve pasurore në Europë, nuk mund të mos përmendim *Traktatin dypalësh Franko-Gjerman* (Shkurt 2010), i cili parashikon një regjim pasuror martesore opsional, të rregulluar mbi bazën e regjimit gjerman të pjesëmarrjes në fitime (*Zugewinnngemeinschaft*) dhe atij francez (*participation aux acquêts*). Traktati është në fazën e ratifikimit nga të dy shtetet anëtare. Regjimi opsional i rregulluar nga Traktati Franko-Gjerman duhet të integrohet në Kodet Civile të të dy shteteve dhe do të jetë i disponueshëm për tu zgjedhur me marrëveshje nga bashkëshortët, pavarësisht shtetësisë apo vendqëndrimit të tyre të zakonshme⁴⁴². Traktati rregullon të drejtën substanciale të regjimeve pasurore martesore. Megjithëse Konventa është ligj substancial, ajo ka edhe një dimension ndërkombëtar privat, sepse lejon çdo individ (pavarësisht nëse ka ose jo shtetësi/vendqëndrim të zakonshëm gjermane ose franceze) të zgjedhë modelin opsional të ofruar nga Konventa, nëse rregullat e tij të PIL parashikojnë mundësinë e zgjedhjes së legjislacionit gjerman ose atij francez.

Gjithashtu, në kuadër të përpjekjeve për harmonizim të së drejtës ndërkombëtare private në fushën e marrëdhënieve familjare me elementë të huaj, duhet përmendur edhe Konventa e Shteteve Nordike⁴⁴³ e Dhjetori të vitit 2006, hyrë në fuqi në 1 Dhjetor të vitit 2008 “*Mbi amendimin e rregullave mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve*”, e cila u përfshi në Konventën e vitit 1931 “*Mbi çështjet e të drejtës ndërkombëtare private në lidhje me martesën, birësimin dhe kujdestarinë*”⁴⁴⁴. Komisioni mbi Anglinë dhe Wellsin është duke marrë në konsideratë një reformë ligjore mbi marrëdhëniet pasurore kontraktore të bashkëshortëve.⁴⁴⁵ Në analizë të fundit, është e rëndësishme të ripohojmë që megjithëse është e pamundur të sheshohen diferencat që ekzistojnë ndërmjet regjimeve separatiste dhe atyre të bashkësisë, mund të jetë e mundur, në një të ardhme, hartimi i një regjimi pasuror duke harmonizuar të dy regjimet, bazuar në parimet e përbashkëta që qëndrojnë në themel të këtyre regjimeve pasurore “*ius commune*”. Në këtë kuadër, puna e CEFL mund të luajë një rol të rëndësishëm në hartimin e një modeli evropian opsional për një “**European Matrimonial Property Regime**”, i cili të mund të zgjidhet me marrëveshje nga çiftet ndërkombëtare për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore⁴⁴⁶. Kjo ide është propozuar prej kohësh nga studiuesit më në zë evropianë dhe aktualisht është duke u përpunuar nga CEFL, nën mbështetjen e BE-së. Është hedhur idea e krijimit të një “**regjimi primar evropian**”, i cili mendohet të përbëhet nga kontributi material për

⁴⁴¹ *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1162.

⁴⁴² *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Volume II, fq. 1162.

⁴⁴³ Danimarkë, Finlandë, Islandë, Norvegji dhe Suedi.

⁴⁴⁴ Gjithashtu, duke filluar nga vitet 1920 vendet Nordike kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin në fushën e regjimeve pasurore martesore, bashkëpunim, i cili ka çuar në miratimin, në sistemin e tyre të brendshëm ligjor, të modeleve të ngjashme të regjimeve pasurore, bazuar në parime të përbashkëta. Për këtë shih: Pintens, “*Matrimonial property law in Europe*.” fq. 45.

⁴⁴⁵ Pintens, “*Matrimonial property law in Europe*.” fq. 45.

⁴⁴⁶ Boele-Woelki, Ferrand, Gonzales Beilfuss, Jänträ-Jareborg, Lowe, Martiny, dhe Pintens, *European Family Law regarding property relations between spouses*, fq. 28.

nevojat e familjes, mbrojtja e banesës familjare dhe përfaqësimi ndërmjet bashkëshortëve, si dhe një **“regjimi european sekondar”**⁴⁴⁷. Akoma është i paqartë modeli i regjimit sekondar që do të ndiqet, por mendohet kombinimi i elementëve të regjimeve pasurore ligjore të shteteve të ndryshme europiane. Në këtë proces harmonizimi regjimi i pjesëmarrjes në fitime duket që është regjimi më i përshtatshëm, në raport me regjimin e bashkësisë, sepse përfaqëson një urë lidhëse ndërmjet sistemit “civil law” dhe atij “common law”.

Ky duket të jetë hapi dhe projekti për të ardhmen i të drejtës familjare europiane.

⁴⁴⁷ Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 256.

KAPITULLI III

KUSHTET THELBËSORE TË VLEFSHMËRISË SË KONTRATËS MARTESORE, REGJISTRIMI, REVOKIMI DHE PAVLEFSHMËRIA E SAJ

3.1. Kushtet thelbësore të vlefshmërisë së kontratës martesore

Pavarësisht natyrës juridike komplekse, që i referohet përmbajtjes së saj, kushtet e vlefshmërisë së kontratës martesore do t'i gjejmë të parashikuara në normat e kod.civ. dhe në normat e kod.fam. Për rrjedhojë, kushtet e vlefshmërisë së kontratës martesore, bazuar në kriterin e normës ligjore, në të cilën gjejmë rregullim, do t'i klasifikojmë në:

- a) Kushte të vlefshmërisë së parashikuara nga kod.fam, si psh: kushti i formës (neni 69/1 i kod.fam) apo i zotësisë për të lidhur kontratë martesore (neni 70 i kod. fam.), të cilat mund t'i emërtojmë **“kushte të veçanta apo të posaçme të vlefshmërisë së kontratës martesore”**;
- b) Kushtet e vlefshmërisë së parashikuara nga kod.civ (neni 663 i kod.civ), të cilat gjejmë zbatim për çdo kontratë, të cilat i emërtojmë **“kushte të përgjithshme të vlefshmërisë së kontratës martesore”**.

Sipas nenit 663 të kod.civ, konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë, pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Gjatë punimit, kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta të vlefshmërisë së kontratës martesore, do t'i analizojmë së bashku, duke ndjekur strukturën e nenit 663 të kod.civ⁴⁴⁸. Mosrespektimi i qoftë njërit prej këtyre kushteve sjell pavlefshmërinë absolute të kontratës martesore.

Një pjesë e doktrinës shqiptare bën një tjetër klasifikim të kushteve të vlefshmërisë së kontratës martesore në a) kushte të formës së kontratës; b) kushte të përmbajtjes, të cilat kanë të bëjnë me datën e lidhjes së kontratës dhe aftësinë e bashkëshortëve për të lidhur kontratës martesore dhe c) kushte të kundërshtueshmërisë së kontratës⁴⁴⁹.

Në bazë të nenit 674 të kod.civ, palët (bashkëshortët) gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës. Pala që ka ditur ose duhej të dinte shkaku e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk ia ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që, kjo e fundit ka pësuar, për shkak se besoi pa faj në vlefshmërinë e kontratës.

Në këtë drejtim, disa legjislacione parashikojnë detyrimin e bashkëshortëve për të informuar njëri-tjetrin, para lidhjes së kontratës për gjendjen e pasurisë së tyre⁴⁵⁰.

Kod. fam nuk parashikon detyrimin e palëve që ti bëjnë të ditur njëri-tjetrit gjendjen e pasurisë së tyre në momentin e lidhjes së kontratës martesore. Kjo zgjidhje parashikohet në pjesën më të madhe të legjislacioneve europiane dhe gjen justifikimin e saj në vetë qëllimin e martesës. Qëllimi i martesës nuk është përfitimi ekonomik nga bashkëshorti tjetër, për rrjedhojë në lidhjen e martesës duhet të jenë të parëndësishme të ardhurat ose gjendja pasurore e bashkëshortit

⁴⁴⁸ Për analizimin e kushteve të kontratës martesore bazuar mbi elementët e vlefshmërisë së parashikuar në nenin 663 të kod.civ. Shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq 45.

⁴⁴⁹ Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, *E drejta familjare*, fq. 322-323; Zaka, “Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” fq.13-15.

⁴⁵⁰ Kështu për shembull, në Kodin Civil Belg parashikohet detyrimi i bashkëshortëve për t'i njohur njëri-tjetrit gjendjen pasurore të tyre, para lidhjes së kontratës martesore. Për këtë shih: Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq. 79.

tjetër⁴⁵¹. Megjithatë, nga ana tjetër, detyrimi i njohjes së bashkëshortëve me gjendjen pasurore të njëri-tjetrit, para lidhjes së kontratës, do të ishte një mjet për mbrojtjen e bashkëshortëve nga veprimet abuzive të njëri-tjetrit. Në lidhje me këtë çështje, në parimin 4:12 të CEFL “*Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve*”, parashikohet detyrimi i bashkëshortëve për t’i bërë të diturit njëri-tjetrit të drejtat e pronësisë dhe të kreditit (asetet) dhe detyrimet që përbëjnë pasurinë e tyre⁴⁵². Përgjithësisht, shtetet e Europës Kontinentale nuk parashikojnë këtë detyrim, sepse për një kohë të gjatë në legjislacionet e këtyre shteteve lejohej lidhja e kontratës vetëm në fazën para lidhjes së martesës dhe kjo kategori pasurie është përjashtuar gjithmonë nga objekti i bashkësisë. Ndërsa, në shtetet e sistemit ligjor “common law” ky detyrim përgjithësisht parashikohet⁴⁵³. Në disa regjime pasurore si ai i pasurive të ndara apo regjimi i pjesëmarrjes në fitime ky detyrim është i panevojshëm.

3.2. Pëlqimi i bashkëshortëve

Sipas nenit 69/1 të kod.fam. “*kontrata martesore bëhet ... në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre*”.

Nga një interpretim i kombinuar i nenit 69 me dispozitat e kod.civ, që rregullojnë vullnetin kontraktor të palëve, mund të nxjerrim disa përfundime.

A. Kontrata martesore është një veprim juridik i dyanshëm, për lidhjen e së cilës kërkohet patjetër *vullneti i dy palëve*⁴⁵⁴, që janë konkretisht dy bashkëshortët e ardhshëm, në rastin kur kontrata martesore lidhet para lidhjes së martesës ose bashkëshortët, në rastin e kontratës së lidhur gjatë martesës. Secilës palë të kontratës martesore i korrespondon, në çdo rast, një person i vetëm, i cili gëzon një cilësi të posaçme, atë të bashkëshortit të ardhshëm ose të bashkëshortit.

Një diskutim, i cili prej kohësh ka përfshirë doktrinën, është mundësia e shfaqjes së vullnetit të personave të tretë në kontratën martesore. Pavarësisht diskutimeve të shumta, është pranuar gjerësisht nga doktrina pamundësia e ndërhyrjes së personave të tretëve në lidhjen e kontratës

⁴⁵¹ Jänträ-Jareborg, Maarit. “Marital agreements and private autonomy in Sweden.” Në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 370-402.

⁴⁵² <http://www.ceflonline.net>. Principles of CEFL regarding property relations between spouses.

⁴⁵³ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 496.

⁴⁵⁴ Në pamje të parë neni 663 i kod.civ. duket sikur për lidhjen e kontratës kërkon pëlqimin e vetëm njëres palë, pasi shprehet: “.....pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin”. Atëherë lind pyetja, për lidhjen e kontratës mjafton pëlqimi vetëm i palës, që merr përsipër detyrimin dhe nuk është i nevojshëm pëlqimi i palës tjetër? Përgjigja për këtë pyetje është patjetër negative. Lidhja e një kontrate kërkon patjetër pëlqimin e të dy apo më shumë palëve kontraktore. Atëherë si shpjegohet terminologjia e përdorur nga neni 663 i kod.civ, terminologji e cila është në vazhdim të mënyrës së formulimit të nenit 659, sipas së cilit: “kontrata është veprimi juridik sipas së cilit një ose disa palë.....”. I vetimi shpjegim është që, kur neni 659 i referohet “një pale kontraktore” dhe neni 663 “pëlqimit të palës që merr përsipër detyrimin” ka në konsideratë mënyrën e lidhjes së kontratës të përcaktuar në nenin 664 të kod.civ, procedurën e lidhjes së kontratës në kontratat me detyrime vetëm për palën propozuese. Duke dashur të citojmë tekstualisht nenin 664 “Kur kontrata përmban vetëm detyrimin e propozuesit, pritësi mund të refuzojë prozimin brenda afatit të caktuar, ose që rrjedh nga natyra e marrëveshjes. Në mungesë të një refuzimi të tillë kontrata quhet e lidhur”. Nëse pranojmë tezën që kontrata quhet e lidhur që në momentin që propozimi mbërrin në adresë të pritësit dhe kalimi i afatit shoqëruar me mungesën e refuzimit të pritësit, sjell efekte prapavepuese që nga momenti i mbërritjes së propozimit, atëherë mund të kuptojmë mënyrën e formulimit të dispozitave të mësipërme. Megjithatë, vullneti i palës tjetër nuk është se mungon, sepse është non sens juridik të flasësh për vullnet vetëm të një pale në lidhjen e kontratës, sepse vullneti i palës tjetër është shprehur në heshtje, nëpërmjet mungesës së refuzimit të kontratës brenda afatit të caktuar. Në analizë të fundit, duhet theksuar që, kjo procedurë e lidhjes së kontratës nuk mund t’i zbatohet në asnjë rast kontratës martesore, lidhja e së cilës kërkon patjetër vullnetin e shprehur të të dy bashkëshortëve.

martesore. Asnjë person i tretë, duke përfshirë këtu prindërit apo kreditorët e bashkëshortëve, nuk mund të marrë pjesë në lidhjen e kontratës martesore⁴⁵⁵.

Megjithëse nuk gjejmë asnjë dispozitë në kod.fam, që të parashikojë në mënyrë të shprehur ndalesën e personave të tretë në lidhjen e kontratës martesore, ky ndalim rrjedh nga gjuha e përdorur nga ligjvënësi në formulimin e dispozitave që rregullojnë kontratën martesore, nga fryma e përgjithshme e ligjit, nga funksioni i kontratës martesore, që është ai i rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve gjatë martesës, si dhe nga parimi i mbrojtjes së unitetit të familjes.

B. Bazuar në nenin 92 të kod.civ. pëlqimi për të lidhur kontratën martesore duhet të jetë i **lirë dhe i pavesuar**.

C. Në ndryshim nga deklarimi i vullnetit për lidhjen e kontratave të tjera civile, deklarim i cili, si rregull nuk realizohet njëkohësisht nga palët, bazuar në nenin 69/1 të kod.fam, deklarimi i vullnetit të bashkëshortëve osë përfaqësuesve të tyre, për lidhjen e kontratës martesore, duhet të realizohet në mënyrë **simultane** (njëkohësisht)⁴⁵⁶.

D. Kodi aktual i familjes, në ndryshim nga legjislacione të tjera (si psh. KC Italian), lejon përfaqësimin e vullnetit të palëve në lidhjen e kontratës martesore. Bazuar në nenin 69/1 të kod.fam. kontrata martesore lidhet, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të **përfaqësuesve të tyre**.

Kontrata martesore, duke mos qenë një veprim juridik i karakterit ngushtësisht personal, mund të lidhet edhe nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të njërit apo të dy bashkëshortëve. Prokura, sipas mendimit mbizotërues të doktrinës, duhet të jetë prokurë e posaçme, vetëm për lidhjen e kontratës martesore⁴⁵⁷. Përsa i përket formës së prokurës, bazuar në nenin 72/2 të kod.civ. prokura duhet të ketë formën e aktit noterial, ndryshe kontrata martesore është e pavlefshme. Duke qenë se kod.fam, për vlefshmërinë e kontratës martesore kërkon formën e aktit noterial, atëherë dhe prokura për lidhjen e saj duhet të ketë formën e aktit noterial, ndryshe është e pavlefshme⁴⁵⁸.

Njëri bashkëshort nuk mund të përfaqësojë bashkëshortin tjetër në lidhjen e kontratës martesore, për shkak të konfliktit të interesave ndërmjet palëve. Bazuar në nenin 67 të kod.civ. përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveçse kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij. Në lidhjen e kontratës martesore, përfaqësimi i njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër, do të sillte pikërisht cenimin e interesave të bashkëshortit të përfaqësuar.

E. Si për çdo veprim tjetër juridik pëlqimi i bashkëshortëve duhet të deklarohet nga një subjekt që ka **zotësi të plotë për të vepruar**⁴⁵⁹. Megjithatë, bazuar në nenin 70 të kod.fam. vlefshmëria e kontratës martesore kushtëzohet jo vetëm nga gëzimi i zotësisë së plotë për të vepruar të subjektit, por edhe mbushja e moshës 18 vjeç. Subjektet e kontratës martesore, në mënyrë kumulative, duhet të plotësojnë kushtin e gëzimit të **zotësisë së plotë për të vepruar** dhe atë të **moshës 18 vjeç**.

⁴⁵⁵ Në mbështetje të këtij opinioni shih: De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 940.

⁴⁵⁶ Procedura e lidhjes së kontratës martesore paraqet disa veçori në raport me procedurën e parashikuar nga Kodi Civil për lidhjen e kontratave në përgjithësi, veçori që i referohen kryesisht mënyrës dhe momentit të përputhjes së vullnetit të palëve kontraktore.

⁴⁵⁷ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 139.

⁴⁵⁸ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 940.

⁴⁵⁹ Omari, *E drejta familjare*, fq. 89.

Nga sa parashtruam, në lidhje me gëzimin e zotësisë për të lidhur kontratë martesore⁴⁶⁰ “*habilis ad pacta nuptialia*”, paraqiten dy probleme të rëndësishme:

a) Problemi i **personit të mitur**, i cili ka marrë autorizimin e gjykatës për lidhjen e martesës, bazuar në nenin 7/2 të kod.fam;

b) Problemi i dytë, shtrohet për bashkëshortin madhor, të cilit i është **hequr/kufizuar zotësia për të vepruar** me vendim gjykate.

3.2.1. Bashkëshorti i mitur

Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton që, kodi aktual i familjes nuk është mbështetur në parimin e mirënjohur të së drejtës “*habilis ad nuptias habilis ab pacta nuptialia*”. Pra, e thënë ndryshe, i mituri që ka fituar zotësinë për të lidhur martesë me autorizim të gjykatës, apo ka lidhur tashmë martesë, nuk gëzon njëkohësisht zotësinë për të lidhur kontratë martesore.

Megjithëse, i mituri i emancipuar, ka zotësi të plotë për të vepruar dhe mund të kryejë çdo lloj veprimi juridik, duke përfshirë këtu edhe dhurime në drejtim të bashkëshortit tjetër, ai nuk mund të lidhë kontratë martesore⁴⁶¹.

Ky ndalim buron shprehimisht nga neni 70 i kod.fam, sipas së cilit “***në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore, derisa të mbushë moshën 18 vjeç, rast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë***”. Mund të konkludohet që, ligjvënësi ka parashikuar një kusht të dyfishtë për shprehjen e pëlqimit në lidhjen e kontratës martesore: gëzimin e zotësisë së plotë për të vepruar dhe mbushjen e moshës 18 vjeç.

Ratio e këtij kufizimi ligjor, të cilin nuk e ndeshim në legjislacionet e tjera, që kanë shërbyer si modele për hartimin e kod.fam, është mbrojtja e interesit më të lartë të të miturit që lidh martesë⁴⁶² nën moshën 18 vjeç (sipas kushteve të parashikuara në nenin 7, paragrafi i dytë i kod.fam). Megjithatë, gjykojmë që është shumë e diskutueshme, nëse vërtet regjimi ligjor i bashkësisë është regjimi më i përshtatshëm për mbrojtjen më të mirë të interesave të të miturit që lidh martesë.

Pas mbushjes së moshës madhore të bashkëshortit të mitur, bashkëshortët janë të lirë të ndryshojnë regjimin pasuror, por duke respektuar afatet kohore të parashikuara në kod.fam. (neni 72) për ndryshimin e regjimit pasuror martesor (2 vjet nga zbatimi i regjimit të mëparshëm pasuror).

3.2.2. Bashkëshortit të cilit i është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar

Kontrata martesore, si çdo veprim tjetër juridik, kërkon patjetër zotësinë e plotë për të vepruar të bashkëshortëve të ardhshëm. Për rrjedhojë, bashkëshorti të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor, nuk mund të lidhë personalisht kontratë martesore. Kontrata

⁴⁶⁰ Kodi i Familjes nuk e lidh gjithmonë zotësinë për të vepruar me zotësinë për të lidhur martesë. Në praktikë, paraqiten dy momente, në të cilat zotësia për të vepruar nuk përputhet me zotësinë për të lidhur martesë: 1) rasti i personit të mitur, i cili mund të autorizohet të lidhë martesë nga gjykata, nëse ekziston një shkak me rëndësi; dhe 2) rasti i personit madhor, të cilit i është hequr/kufizuar zotësia e plotë për të vepruar, person, i cili është i lirë të lidhë martesë, nëse është në gjendje të kuptojë qëllimin e saj.

⁴⁶¹ Këtej e tutje të miturit, i cili ka fituar zotësi të plotë për të vepruar me lidhjen e martesës do të referohemi me termin e përdorur gjërësisht nga doktrina juridike, të cilin e gjejmë edhe në KC Zogut të vitit 1929: “*I mituri i emancipuar*”. Në bazë të nenit 6/2 të Kodit Civil: “Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe i mituri (gruaja), që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Ai (ajo) nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç”.

⁴⁶² Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, *E drejta familjare*, fq. 325.

martesore e lidhur nga një person madhor pa zotësi/me zotësi të kufizuar për të vepruar është e pavlefshme.

Disa elementë meritojnë diskutim në lidhje me me çështjen e zotësisë për të vepruar të bashkëshortëve, si kërkesë për lidhjen e kontratës martesore.

Së pari, shtrohet pyetja, nëse është e mundur lidhja e kontratës martesore nga përfaqësuesi ligjor (kujdestari) i bashkëshortit, të cilit i është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar⁴⁶³ me vendim gjyqësor⁴⁶⁴.

Megjithëse nuk ka ndonjë dispozitë të shprehur në kod.fam, që të lejojë përfaqësimin nga kujdestari në lidhjen e kontratës martesore, këtë përfundim e mbështesim në dispozitën 69/1 të kod.fam, dispozitë sipas së cilës, kontrata martesore mund të lidhet nga bashkëshortët/bashkëshortët e ardhshëm ose përfaqësuesit e tyre. Neni 69/1 nuk bën specifikime nëse i referohet përfaqësuesit vullnetar ose atij ligjor. Përderisa ligji nuk vendos kufizime të shprehura, as interpretuesi i tij nuk duhet ta lexojë dispozitën ligjore në mënyrë të kufizuar. Për rrjedhojë, mund të pohojmë që, bashkëshorti (bashkëshorti i ardhshëm), të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar mund të përfaqësohet në lidhjen e kontratës martesore nga kujdestari i tij. Kujtojmë këtu që, funksioni kryesor i kujdestarit është mbrojtja e interesave pasurore të të vendosurit në kujdestari⁴⁶⁵.

Të njetën zgjidhje gjejmë edhe në legjislacionet që kanë shërbyer si model për ligjvënësin tonë në hartimin e kod.civ. dhe kod.fam. Sipas nenit 1399 të KC Francez, personi madhor i pazotë për të vepruar mund të lidhë personalisht kontratë martesore, por duhet të asistohet nga kujdestari i tij. Të njëjtin rregullim gjejmë prezent edhe në nenin 166 të KC Italian, sipas së cilit, kontrata martesore e personit madhor të pazotë për të vepruar është e vlefshme vetëm nëse është lidhur nën asistencën e kujdestarit të tij. Nëse vazhdojmë me tej, me KC Gjerman (BGB) shikojmë që, neni 1411 i tij kërkon jo vetëm, për efekt vlefshmërie, që kontrata martesore e personit madhor të pazotë për të vepruar, të lidhet me përfaqësim nga kujdestari, por edhe pas autorizimit të gjykatës që merret me çështjet e kujdestarisë.

Në përmbledhje të asaj që pohuam deri tani, bashkëshorti të cilit i është hequr zotësi apër të vepruar me vendim të gjykatës nuk mund të veprojë personalisht për të lidhur kontratë martesore, por kujdestari do të veprojë në emër dhe për llogari të tij. Ndërsa bashkëshorti, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, me vendim gjyqësor, mund të veprojë personalisht në lidhjen e kontratës martesore, me kushtin që, të marrë pëlqimin paraprak të kujdestarit të tij. Sepse, personi madhor, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, me vendim gjyqësor, barazohet, në lidhje me tagret e zotësisë për të vepruar me të miturin mbi 14 vjeç (neni 309/2 i

⁴⁶³ Shtrohet ky problem, sepse sipas legjislacionit shqiptar, nuk ndalohet të lidhë martesë personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar. Bazuar në nenit 12 të kod.fam: “Nuk mund të lidhë martesë, personi i cili vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose zhvillim i metë mendor, që e bën atë të paafte për të kuptuar qëllimin e martesës”. Nga interpretimi i kësaj dispozite mund të pohojmë që, personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor, nëse është i aftë të kuptojë qëllimin e martesës, ka të drejtë të lidhë kontratë martesore. Për më gjerë shih: Omari, Sonila, *E drejta familjare*, fq. 52.

Problemi mund të shtrohet, gjithashtu, në të gjitha ato raste kur njëri prej bashkëshortëve, në momentin e lidhjes së martesës, ka pasur zotësi për të vepruar, por gjatë martesës kjo zotësi i është hequr me vendim gjyqësor.

⁴⁶⁴ Më sipër, arritëm në përfundimin që, kontrata martesore nuk është veprim juridik i karakterit ngushtësisht personal, sepse objekti i rregullimit të saj janë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, gjatë martesës. Si rrjedhojë, mund të pohojmë që, bashkëshortit, të cilit i është hequr/kufizuar zotësi për të vepruar me vendim gjyqësor mund të lidhë kontratë martesore, por jo personalisht, sepse ai nuk është në gjendje të shprehë një vullnet të lirë, real dhe serioz.

⁴⁶⁵ Bazur në nenin 309 të kod.fam. “Kujdestari i personit, të cilit i është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar, përfaqëson dhe administron pasurinë e tij, ashtu siç prindi përfaqëson dhe administron pasurinë e të miturit që ka/nuk ka mbushur moshën 14 vjeç.

kod.civ). Sipas nenit 7 të kod.fam, i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç mund të kryejë veprime juridike vetë, me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor.

Së dyti, lind pyetja, nëse kujdestari i bashkëshortit të pazotë për të vepruar është bashkëshorti i tij (siç ndodh në pjesën më të madhe të rasteve), a mund të përfaqësojë ai bashkëshortin e pazotë për të vepruar në lidhjen e kontratës martesore.

Bazuar në nenin 274 të kod.fam., nëse midis kujdestarit dhe personit të vendosur në kujdestari ka konflikt interesash ose kur midis tyre duhet të kryhet ndonjë veprim juridik, atëherë gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, për kryerjen e veprimit juridik për të cilin ekziston konflikti i interesave.

Të drejtën për të kërkuar caktimin e kujdestarit të posaçëm e kanë: kujdestari i personit të cilit i është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar, prindërit e tij, të afërmit, vetë personit të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar (i cili, për sa i përket vëllimit të zotësisë për të vepruar, barazohet me të miturin që ka mbushur moshën 14 vjeç) dhe çdo person i interesuar. Sipas nenit 277 të kod.fam, kompetente, nga pikëpamja territoriale, për caktimin e kujdestarit të posaçëm është gjykata ku e vendqëndrimin ose e vendbanimit të personit të pazotë për të vepruar ose gjykata e vendit ku ndodhet pasuria e tij.

Së treti, shtrohet diskutimi, nëse mund të lidhë kontratë martesore, personalisht bashkëshorti, ndaj të cilit është duke u zhvilluar një gjykim për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar.

Bazuar në qëndrimin e doktrinës, lidhja e kontratës martesore nga bashkëshorti ndaj të cilit është duke u zhvilluar një proces gjyqësor për heqjen/kufizimin e zotësisë së plotë për të vepruar është gjithmonë e mundur. Vlefshmëria e kontratës martesore do të varet nga vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës së heqjes/kufizimit të zotësisë së plotë për të vepruar. Nëse gjykata do të vendosë rrëzimin e kërkesës, kontrata është plotësisht e vlefshme, ndërsa nga ana tjetër, nëse gjykata vendos pranimin e kërkesës, atëherë kontrata martesore do të jetë e anulueshme.⁴⁶⁶

Së katërti, shtrohet problemi se deri ku shtrihen kufijtë e tagrave të kujdestarit, në cilësinë e përfaqësuesit të bashkëshortit të vendosur në kujdestari dhe të administruesit të pasurisë së tij. A mund të lidhë kujdestari një kontratë martesore, e cila ndryshon gjendjes juridike të pasurisë ekzistuese të bashkëshortit të ardhshëm, të pazotë për të vepruar? Për shembull, a mund të lidhë kujdestari kontratën martesore të regjimit të “bashkësisë universale”, në të cilën të gjithë pasuritë që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës dhe ajo që do të fitojnë gjatë martesës, të jenë të përbashkëta? Duke qenë se kod.fam. nuk rregullon në mënyrë të shprehur këto probleme, atëherë përgjigjen e pyetjeve të mësipërme do të gjejmë duke marrë në analizë normat e KF, që rregullojnë regjimin juridik të veprimeve të kujdestarit në administrimin e pasurisë së të vendosurit në kujdestari.

Sipas KC Gjerman, kujdestari nuk mund të vlerësojë i vetëm rëndësinë që ka për pasurinë e të vendosurit në kujdestari kontrata martesore. Neni 1411 i BGB kërkon domosdoshmërisht, si kusht për vlefshmërinë e kontratës martesore, jo vetëm pëlqimin e kujdestarit, por edhe autorizimin e gjykatës, që merret me çështjet e kujdestarisë. Në këtë rast, në mënyrë të shprehur BGB, ia lë gjykatës vlerësimin e kryerjes apo jo të këtij veprimi juridik, bazuar në dobishmërinë që ky veprim sjell, në pasurinë e të vendosurit në kujdestari.

⁴⁶⁶ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 947-948.

3.3. Objekti i kontratës martesore

Në vija të përgjithshme, objekti i kontratës është qëllimi për të cilin palët bien dakord njëri me tjetrin, qëllimi mbi të cilin drejtohen dhe përputhen vullnetet e palëve. Pra objekti i kontratës është qëllimi i palëve për të krijuar, ndryshuar ose shuar⁴⁶⁷ një marrëdhënie juridike.

Konkretisht, objekti i kontratës martesore është i përcaktuar nga ligji (dispozitat e kodit të familjes). Objekti i kontratës martesore është krijimi, ndryshimi apo shuarja e regjimit pasuror martesor dhe pranimi nga ana e bashkëshortëve e faktit që, sendet që do të fitohen gjatë martesës do të ndjekin atë regjim që është përcaktuar në kontratë⁴⁶⁸.

Nga leximi i kombinuar i dispozitave të kod.fam që rregullojnë kontratën martesore, në përgjithësi, me dispozitat që rregullojnë secilin regjim pasurore kontraktor, objekti i kontratës martesore paraqitet, si më poshtë vijon:

A. Zgjedhja e një prej regjimeve pasurore, që gjejnë rregullim në kod.fam, të njohura nga doktrina si regjime pasurore tipike. Kujtojmë këtu që, dy janë modelet e regjimeve pasurore që, gjejnë rregullim të plotë në kod.fam: regjimi i pasurive të ndara dhe regjimi i bashkësisë me kontratë. Gjejmë vendin sërish të kujtojmë që, qëllimi i rregullimit të dy modeleve të regjimeve pasurore në kod.fam. është orientimi i vullnetit të bashkëshortëve dhe jo kufizimi i vullnetit të tyre.

B. Modifikimi i modeleve ligjore të regjimeve pasurore. Bashkëshortët kanë të drejtë të modifikojnë ose të kombinojnë ndërmjet tyre modelet ligjore të regjimeve pasurore, në përputhje me interesat e tyre pasurorë dhe interesin e familjes. Disa nga variantet e modifikimit të modeleve ligjore mund të jenë:

a) *Kombinimi ndërmjet tyre i regjimit të bashkësisë me regjimin e pasurive të ndara.* Bashkëshortët mund të vendosin zbatimin e regjimit të pasurive të ndara, gjatë kohëzgjatjes së martesës dhe në përfundim të saj, pjesëtimin e pasurisë së fituar gjatë martesës me kontributet e tyre të përbashkëta, sipas shembullit të regjimit të pjesëmarrjes së fitimeve, të cilin e gjejmë të rregulluar, si një regjim kontraktor, në CC Francez dhe në formën e regjimit ligjor në BGB.

b) *Modifikimi në abstrakt i objektit të bashkësisë ligjore.* Modifikimi i objektit të bashkësisë ligjore/kontraktore mund të realizohet duke zgjeruar ose ngushtuar në mënyrë abstrakte objektin e këtij regjimi, nëpërmjet përfshirjes në bashkësi ose përjashtimit prej saj të kategorive të caktuara të sendeve.

c) *Modifikimi “in concreto” i objektit të bashkësisë.* Objekti i bashkësisë ligjore mund të modifikohet edhe për kategori të veçanta sendesh. Bashkëshortët mund të zgjerojnë objektin e bashkësisë ligjore duke kaluar sende të caktuara nga pronësia e tyre në pronësi të bashkësisë. Gjithashtu, sipas së njëjtës logjike, objekti i bashkësisë mund të reduktohet për kategori sendesh të përcaktuara⁴⁶⁹.

d) *Modifikimi i rregullave të administrimit të bashkësisë ligjore.* Brenda limiteve të caktuara nga ligji bashkëshortët mund të ndryshojnë rregullat e administrimit ligjor.

Në drejtim të pasurisë së bashkësisë ligjore, bashkëshortët mund të vendosin zbatimin e parimit të administrimit të përbashkët, për të gjithë veprimet e administrimit të zakonshëm ose jo të

⁴⁶⁷ Sipas doktrinës italiane, përderisa kontrata martesore i nënshtrohet rregullimit ligjor të kategorisë së përgjithshme të kontratave, nuk ka asnjë pengesë për bashkëshortët që nëpërmjet saj të shuajnë regjimin pasuror kontraktor. Në eventualitetin e një kontrate që shuan efektet e kontratës martesore, atëherë do të zbatohet “*ex nunc*” regjimi i bashkësisë ligjore. Për më shumë shih: Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 32-33.

⁴⁶⁸ Omari, *E drejta familjare*, fq. 90.

⁴⁶⁹ Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 46-47.

zakonshëm, ndërsa e anasjellta është e ndaluar nga ligji⁴⁷⁰. Ndërsa për sendet që përfshihen rishtazi në bashkësinë me kontratë, liria e bashkëshortëve në ndryshimin e rregullave të administrimit është pakufizuar.

Ndërsa, në lidhje me sendet në pronësinë vetjake të bashkëshortëve, ata mund t'i japin njëri-tjetrit prokurë për administrimin e tyre.

e) *Përcaktimi i pjesëve takuese dhe rregullave të pjesëtimit të pasurisë.* Bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë raportin e pjesëve takuese. I vetmi limit, i cili nuk mund të shkelet nga bashkëshortët është parimi i korrelacionit ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të pasurisë së bashkësisë. Pjesës takuese të çdo bashkëshorti, sipas raportit të caktuar në kontratë, do t'i korrespondojë njëkohësisht aktiviteti dhe pasiviteti i pasurisë. Gjithashtu bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë edhe rregullat e pjesëtimit. Në këtë drejtim, asgjë nuk i ndalon bashkëshortët t'i bëjnë dhurime njëri-tjetrit në fazën e pjesëtimit të bashkësisë.

C. Zgjedhja e një modeli tjetër, që nuk gjen rregullim në kod.fam: regjimi pasuror atipik. Brenda kufizimeve të vendosura nga kod.civ. dhe kod.fam, bashkëshortët kanë të drejtë të përcaktojnë regjimin pasuror që më mirë i përshtatet interesave të tyre. Në rastin kur bashkëshortët zgjedhin një model të ndryshëm nga ato ligjorë, për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, është e preferueshme që, rregullimi i modelit të zgjedhur në kontratën martesore, të jetë sa më i qartë dhe i detajuar, në mënyrë që të jenë të mbrojtur jo vetëm interesat e bashkëshortëve, por edhe të të tretëve që kontraktajnë me ta⁴⁷¹.

D. Shuarja e regjimit pasuror martesor. Është pranuar gjerësisht në doktrinë, mbi bazën e parimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, e drejta e tyre për të shuar regjimin pasuror që, rregullon marrëdhëniet e tyre pasurore⁴⁷². Si pasojë e shuarjes së regjimit pasuror, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, për të ardhmen, do të rregullohen nga regjimi i mëparshëm pasuror i bashkëshortëve, i cili mund të jetë regjimi i bashkësisë ligjore ose një regjim kontraktor.

Madje doktrina është e mendimit që, shuarja e regjimit pasuror mund të bëhet edhe në mënyrë prapavepruese, por ky retroaktivitet do të sjellë pasoja vetëm në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe jo në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe të tretëve.

E. Klauzolat atipike të kontratës martesore. Në trajtimin *ut supra* të kuptimit të kontratës martesore, theksuam që, megjithëse nga formulimi i nenit 66 të kod.fam. rezulton që, objekti i kontratës martesore është përcaktimi i regjimit pasuror martesor (kontrata martesore *strictu sensu*), mund të përbëjnë objekt të kontratës së martesës në kuptimin "*latu sensu*", edhe ato veprime juridike nëpërmjet të cilave bashkëshortët rregullojnë aspekte të tjera pasurore ose personale jopasurore, të marrëdhënies martesore. Kështu, përfshihen në objektin e kontratës martesore rregullimi i kontributit material, dhurimet që bashkëshortët i bëjnë njëri-tjetrit me rastin e lidhjes së martesës ose gjatë martesës, apo rregullimi në mënyrë preventive i pasojave të një zgjidhje eventuale martesore.

F. Një diskutim i shtruar në doktrinë, lidhur me objektin e kontratës martesore, shtron problemin, nëse bashkëshortët, në kontratën martesore, mund të vendosin **regjimin e bashkësisë ligjore**⁴⁷³.

⁴⁷⁰ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 137.

⁴⁷¹ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 139.

⁴⁷² Cubeddu, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 65.

⁴⁷³ Për këtë diskutim shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 144-145.

Sē pari, duhet të themi që, lidhja e një kontrate martesore, me objekt vetëm përcaktimin e regjimit pasuror martesor, megjithëse nuk është e ndaluar nga ligji, është e padobishme, sepse regjimi ligjor do të zbatohet njëloj edhe në mungesë të kontratës martesore.

Nga ana tjetër, në mungesë të ndalimeve të shprehura nga ligji, përcaktimi i regjimit ligjor në kontratën martesore, është plotësisht i mundur. Ky rast ndeshet në praktikë, në hipotezën kur palët janë dakord me zbatimin e regjimit ligjor, por duan të rregullojnë në kontratë disa marrëdhënie të tjera të jetës së tyre bashkëshortore, si psh: të përfshijnë në përmbajtjen e kontratës, marrëveshjen për kontributin material apo dhurimet ndaj njëri-tjetrit.

Një tjetër hipotezë, e paraqitur në praktikë, është rasti kur palët në kontratën martesore përcaktojnë zbatimin e regjimit ligjor, duke bërë njëkohësisht edhe listimin e të gjithë pasurisë që është në pronësinë vetjake të tyre, deri në momentin e lidhjes së martesës⁴⁷⁴.

Kjo listë paraqet një rëndësi të madhe, kryesisht për provën e pronësisë së sendeve të luajtshme, në eventualitetin e një zgjidhje të ardhshme të martesës.

3.4. Shkaku i kontratës martesore

Përgjithësisht, shkaku është funksioni ekonomik-social mbi të cilin mbështetet kontrata, ose thënë ndryshe “*justifikimi i mbrojtjes që ligji i bën autonomisë së vullnetit të palëve kontraktuese*”⁴⁷⁵. Për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike, nuk mjafton thjesht vullneti i palëve, por duket patjetër ekzistenca e shkakut, pra e justifikimit ekonomik-social të aktit të autonomisë kontraktore⁴⁷⁶. Kontrata duhet të përmbajë një dobishmëri ekonomik-sociale për shoqërinë.

Nga të tjerë autorë, teoria e dobishmërisë ekonomik-sociale e shkakut të kontratës është kritikuar. Sipas këtij grupi autorësh, në qarkullimin civil, nuk ndeshim vetëm kontratat të cilat kanë një dobishmëri ekonomik-sociale (për pasojë meritojnë mbrojtje ligjore) dhe kontrata që sjellin pasoja negative në aspektin ekonomik-social (për pasojë, jo vetëm nuk meritojnë mbrojtje ligjore, por janë të dënueshme). Në qarkullimin civil ndeshen edhe kontrata, që nuk sjellin as dobishmëri ekonomik-sociale, por nga ana tjetër as pasoja negative. Këto kontrata duhen toleruar nga ligji. Në vijim të këtij arsytimi, shkaku i kontratës është “funksioni” që vetë palët i japin kontratës, në shprehjen e plotë të autonomisë së vullnetit. Për rrjedhojë meritojnë të mbrohen nga ligji edhe ato kontrata, që megjithëse nuk kanë një funksion ekonomik-social të caktuar, nuk janë shoqërisht të dëmshëm për shoqërinë.⁴⁷⁷

Argumenti i parashtruar më sipër, nuk vlen për kontratën martesore, sepse në terma abstraktë, çdo kontratë e cila gjen rregullim në legjislacionin civil, duke përfshirë këtu edhe kontratën martesore, ka një funksion ekonomik-social të caktuar, përderisa ligjvënësi e ka gjykuar të arsyeshme t’i japë rregullimin ligjor. Çdo kontratë tipike ka një shkak, në kuptimin abstrakt të saj. Në këto rrethana në drejtim të kontratës martesore nuk shtrohet problemi i ekzistencës së shkakut (ekzistencës së një funksioni ekonomik-social të kontratës), pasi ai prezumohet nga ligji⁴⁷⁸.

Bazuar në nenin 677 të kod.civ. shkaku i kontratës duhet të jetë i ligjshëm. Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet shkak për të shmangur zbatimin e një norme. Sërish, parë në terma abstraktë, shkaku i kontratës martesore, prezumohet, nga ligji, që është i ligjshëm.

⁴⁷⁴ Kjo është një praktikë mjaft e përdorur në Francë. Për më shumë shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 145.

⁴⁷⁵ Galgano, *Il contratto*, fq. 149; Galgano, *E drejta private*, fq. 287.

⁴⁷⁶ Galgano, *Il contratto*, fq. 149.

⁴⁷⁷ Për më shumë mbi këtë teori shih: Roppo, *Il Contratto*, fq. 346.

⁴⁷⁸ Omari, *E drejta familjare*, fq. 90.

Parë në terma konkretë, për çdo kontratë tipike të lidhur nga palët, duhet parë nëse ekziston vërtet shkak dhe nëse ky shkak është i ligjshëm. Një shembull i paligjshmërisë së shkakut, që do të sillte automatikisht pavlefshmërinë absolute të kontratës martesore, do të ishte lidhja e kontratës martesore për të ndryshuar regjimin juridik të përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të bashkësisë ose kreditorëve personalë të bashkëshortëve, me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve. Në një rast të tillë, barra e provës për të provuar paligjshmërinë e shkakut, i takon subjektit që e pretendon atë, psh. kreditorit.

Bazuar në analizën e mësipërme, **shkak i kontratës martesore është përcaktimi i një regjimi pasuror, të ndryshëm nga ai që përcakton ligji**⁴⁷⁹.

Është e rëndësishme dallimi i shkakut të kontratës nga motivet që, janë arsyt subjektive që i shtojnë palët të kontraktojnë dhe mund të jenë të ndryshme për kontraktuesit. Si rregull, motivet e kontratës janë të parëndësishme për të drejtën⁴⁸⁰.

3.5. Forma e kontratës martesore

Parimi i përgjithshëm i legjislacioneve moderne të kontratave është parimi i *“lirisë së formës kontraktore”*⁴⁸¹.

Përjashtime, nga parimi i përgjithshëm i lirisë së formës kontraktore, parashikohen në kod.civ, në rastin e kontratave që kanë për objekt kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme si shitja, shkëmbimi apo dhurimi i një sendi të paluajtshëm apo në rastin e veprimeve juridike të njëanshme si prokura për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme apo testamenti.

Një tjetër shmangie nga parimi i lirisë së formës kontraktore gjendet në dispozitat e kod.fam. që rregullojnë formën e kontratës martesore. Sipas nenit 69/1 të kod.fam: **“Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre”**. Bazuar në nenin 69/1 të kod.fam, kontrata martesore është një veprim juridik formal **“ad validitatem”** dhe për rrjedhojë, mungesa e formës noteriale sjell si pasojë pavlefshmërinë absolute të kontratës martesore.

Por, cili është qëllimi për të cilin ligjvënësi kërkon një formalitet të tillë për kontratën martesore. Sipas doktrinës italiane, shpjegimi që duket më i arsyeshëm për këtë kërkesë të ligjit, është mbrojtja që legjislatori i jep regjimit ligjor të bashkësisë, duke e konsideruar atë si regjimin më të përshtatshëm për ruajtjen e ekuilibrit të interesave të bashkëshortëve dhe familjes.

Qëllimi kryesor, i parashikimit të formës noteriale, për kontratën martesore është mbrojtja e palëve kontraktore. Nëpërmjet formës noteriale dhe pjesëmarrjes së njëkohshme të të dy bashkëshortëve ose përfaqësuesve të tyre për lidhjen e kontratës martesore, duket që ligjvënësi ka dashur të bëjë të mundur që bashkëshortët të kuptojnë “pasojat” që mund të sjellë për to derogimi i regjimit ligjor dhe zbatimi i regjimit të ri kontraktor si dhe të realizojë një shprehje reale dhe serioze të vullnetit të tyre⁴⁸², të pandikuar nga faktorë të tjerë. Noterit ka detyrimin të sqarojë palët mbi pyetjet apo paqartësitë që ato mund të kenë⁴⁸³.

Në bazë të nenit 40, paragrafi i dytë të ligjit **“Për Noterinë”**, gjatë redaktimit të një akti ose kryerjes së një veprimi noterial, noterit u bën të qartë palëve kërkesat e ligjit për rastin konkret

⁴⁷⁹ Omari, *E drejta familjare*, fq. 90.

⁴⁸⁰ Galgano, *E drejta private*, fq. 293.

⁴⁸¹ Si rregull i përgjithshëm, që kontrata të jetë e vlefshme dhe të sjellë efekte juridike për palët është kusht i nevojshëm shfaqja dhe përputhja e vullnetit të palëve, pavarësisht nga forma e shfaqjes së vullnetit, nëpërmjet shfaqjes së vullnetit në mënyrë të shprehur (qoftë verbalisht ose me shkrim), të heshtur ose me veprime konkludente. Për këtë shih: Galgano, *Il contratto*, fq. 191.

⁴⁸² De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 940.

⁴⁸³ Ieva, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 77-78. Gjithashtu, mbi këtë argument shih: Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, fq. 728.

dhe brenda kufijve të tij, ruan si interesat e palëve ashtu dhe ato të të tretëve⁴⁸⁴. Gjithashtu noteri duhet t'i shpjegojë palëve termat e kontratës në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshëm për ta, në mënyrë që të dy bashkëshortët të jenë të vetëdijshëm për pasojat pasurore që do të sjellë kontrata për palët. Noteri duhet të kryejë konsultime me të dy bashkëshortët veç e veç në drejtim të verifikimit të vullnetit të secilit prej tyre. Të gjitha këto janë në funksion të qartësisë dhe sigurisë juridike të kontratës martesore, në mënyrë që, të reduktohet rreziku për pavlefshmërinë e saj si dhe të reduktohen konfliktet gjyqësore në të ardhmen për palët⁴⁸⁵.

Referuar parimeve të CEFL "*Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve*", në parimin 4:13 parashikohen detyrimet e noterit a) për t'i dhënë këshillim secilit prej bashkëshortëve, veçantë nga njëri-tjetri; dhe b) për të siguruar që çdo bashkëshort të kuptojë pasojat ligjore të kontratës martesore⁴⁸⁶.

3.6. Regjimi i publicitetit të kontratës martesore

Me qëllim mbrojtjen e kreditorëve dhe personave të tretë, që mund të përfshihen në marrëdhënie juridike me bashkëshortët gjatë martesës, ligjvënësi ka rregulluar sistemin e regjistrimit të kontratës martesore. Një nga risitë që ka sjellë legjislacioni aktual i familjes, është padyshim ndërtimi i një sistemi të shumëfishtë të publicitetit të kontratës martesore në regjistrat publikë. Duhet theksuar që, regjistrimi nuk është pjesë e formës së kontratës martesore.

3.6.1. Sistemi i regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë

Nga leximi i kombinuar i neneve 69, 70 dhe 72 të kod.fam. dhe nenit 83 dhe 193 të kod.civ, rezulton që, ligji parashikon një sistem të trefishtë regjistrimi për kontratën martesore.

Së pari, kod.fam. parashikon detyrimin e regjistrimit të kontratës martesore në aktet e gjendjes civile, konkretisht në *Aktin e Martesës*. Sipas nenit 69/2,3: "**Noteri ka detyrimin të depozitojë një kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës. Në qoftë se, në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar, nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore**".

Së dyti, kontrata martesore i nënshtrohet regjistrimit edhe në *Regjistrin Tregtar* në ato raste kur, kontrata martesore parashikon përfshirjen ose përjashtimin nga bashkësia të një veprimtarie tregtare ekzistuese, në momentin e lidhjes së kontratës martesore. Pra regjistrimi në regjistrin tregtar i kontratës martesore, nuk bëhet për çdo kontratë martesore. Nëse para lidhjes së martesës bashkëshortët e ardhshëm lidhin kontratë martesore me të cilën zgjedhin të zbatojnë regjimin e pasurive të ndara ose regjimin e bashkësisë universale dhe asnjëri nga të dy nuk ushtron veprimtari tregtare, atëherë është e kuptueshme që nuk ekziston detyrimi i regjistrimit. Në bazë të nenit 71 të kod.fam: "**Në qoftë se njëri nga bashkëshortët ushtron veprimtari tregtare, ndryshimet në kontratën e martesës lidhur me veprimtarinë tregtare duhet të depozitohen, në çdo rast edhe në regjistrin tregtar**"⁴⁸⁷.

⁴⁸⁴ Në bazë të nenit 44, paragrafi i parë të ligjit "Për noterinë" "*Aktet noteriale redaktohen në gjuhën shqipe. Kur i interesuari, njëra ose të dyja palët nuk e dinë gjuhën shqipe, noteri kërkon ndihmën e një përkthyesi, që pranohet prej tij dhe prej palëve, i cili përkthen gjithçka fjalë për fjalë dhe të gjitha këto përmenden në akt, ku shënohet edhe deklarimi i personave se e kanë kuptuar përkthimin.*"

⁴⁸⁵ Dethloff, Nina. "Contracting family law: A European perspective." në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe (Eds.), Cambridge: Intersentia, 2011, fq. 88-89.

⁴⁸⁶ <http://www.ceflonline.net> "*CEFL principles regarding property relations between spouses*".

⁴⁸⁷ Duhet sqaruar se çfarë kuptojmë me veprimtari tregtare të bashkëshortëve, term i cili gjen përdorim edhe në nenin 74 dhe 75 të kod.fam.

Së treti, regjistrimi i kontratës martesore duhet realizuar edhe në **Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme** në ZRPP⁴⁸⁸, në rastin kur kontrata martesore parashikon ndryshimin e gjendjes juridike të pasurive të paluajtshme, në pronësi të njërit apo të të dy bashkëshortëve, duke parashikuar kalimin e pasurisë së paluajtshme nga pronësia vetjake e njërit bashkëshort në pronësi të bashkësisë ose anasjelltas. Në bazë të nenit 193 të kod.civ: **“Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sende të paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtje, enfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale”**. Leximi i kësaj dispozite duhet bërë patjetër nën dritën e interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës, sistemi i regjistrimit, i parashikuar nga kjo dispozitë, është një sistem transkriptimi, i cili ka vlerë deklaruese dhe jo krijuese⁴⁸⁹.

Regjistrimit, në regjistrat e sipërpërmendur, i nënshtrohet jo vetëm kontrata martesore e lidhur para lidhjes së martesës, por edhe çdo kontratë e mëvonshme, pra e lidhur gjatë martesës, e cila sjell ndryshimin e regjimit pasuror martesor.

Parashikimi i sistemit të trefishtë të kontratës martesore krijon jo pak probleme në praktikë, probleme të cilat lindin për shkak të vështirësisë së koordinimit të këtyre tre regjistrave.

Në të drejtën e krahasuar të regjimeve pasurore në Europë, dallojmë dy modele të regjistrimit të kontratës martesore:

- a) Ato sisteme ligjore të cilat, kanë krijuar një regjistër të posaçëm në funksion të regjistrimit të kontratave martesore, si: Gjermania, Holanda, Lituania dhe Letonia;
- b) Ato sisteme ligjore, të cilat parashikojnë regjistrimin e kontratës martesore në regjistrat publikë ekzistues: regjistri i gjendjes civile, regjistri tregtar dhe ai i regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Këtu mund të përmendim sistemin Italian, Francez dhe atë Spanjoll.

Legjislati shqiptar, nën ndikimin e modelit Francez dhe atij Italian, parashikon sistemin e trefishtë të regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë ekzistues.

3.6.2. Funksionet e regjistrimit të kontratës martesore

Në analizë të përgjithshme, regjistrimi i një veprimi juridik parashikohet nga ligji për arsyet e mëposhtme: a) për efekt vlefshmërie, pra regjistrim **“konstitutiv”** (rasti i kontratës së hipotekës⁴⁹⁰, regjistrimi i së cilës kërkohet nga ligji si kusht për vlefshmërinë e kontratës); b) **për ta bërë të njohur të tretëve** (për t’ia kundërdrejtuar të tretëve), ku në mungesë të regjistrimit kontrata është e vlefshme, por nuk sjell efekte ndaj të tretëve⁴⁹¹.

Le të analizojmë me radhë se cilën prej këtyre funksioneve ka parashikuar kod.fam., për regjistrimin e kontratës martesore.

⁴⁸⁸ Omari, *E drejta familjare*, fq. 56.

⁴⁸⁹ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009. Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se “Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. Kontrata e cila nuk është e regjistruar është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve”.

⁴⁹⁰ Neni 562 i Kodit Civil: “Hipoteka vihet në bazë të kontratës ose të ligjit dhe me regjistrimin e saj. Kontrata duhet të bëhet me akt noterial”. Bazuar në dispozitën e mësipërme, kontrata e hipotekës duhet të lidhet me akt noterial dhe të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, për efekt vlefshmërie *“ad validitatem”*.

⁴⁹¹ Zaccaria, Alessio. “La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina.” në *Rivista di diritto civile*, 1980, Vol. II, Padova: CEDAM, 1980, fq. 435.

Bazuar në nenet 69, 71 dhe 72 të kod.fam., rezulton që, funksioni i sistemit të publicitetit në aktin e martesës dhe në regjistrat tregtarë është bërja e njohur dhe kundërdrejtimi të tretëve, të regjimit pasuror, që rregullon marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Regjistrimi i kontratës në aktin e martesës dhe në regjistrin tregtar nuk ndikon në vlefshmërinë e kontratës martesore, pra nuk ka efekt konstitutiv. Nëse kontrata martesore plotëson të gjitha kushtet thelbësore të vlefshmërisë, së parashikuara në kod.civ. dhe kod.fam., por mungon regjistrimi në regjistrin e martesave ose/dhe në atë tregtar, ajo është e vlefshme për bashkëshortët, por nuk ajo nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve. Mungesa e regjistrimit nuk sjell asnjë pasojë për bashkëshortët, në marrëdhëniet midis tyre, ato do të konsiderohen nga ligji të martuar nën regjimin kontraktor të zgjedhur prej tyre. Mungesa e regjistrimit të kontratës sjell në fakt vetëm pasoja në marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe personave të tretë, për të cilët bashkëshortët do të konsiderohen të martuar nën regjimin pasuror të mëparshëm, i cili i fundit figuron i regjistruar⁴⁹², që mund të jetë një regjim kontraktor i mëparshëm ose regjimi ligjor i bashkësisë, në mungesë të një kontrate martesore. Në mungesë të regjistrimit, kontrata martesore është e vlefshme, por ajo nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve (nuk sjellë pasoja për të tretët).

Për kontratën martesore të lidhur para lidhjes së martesës, regjistrimi i saj, sjell efekte, si për palët ashtu dhe për të tretët, që nga momenti i lidhjes së martesës. Ndërsa për kontratën martesore të lidhur gjatë martesës, regjistrimi sjell efekte ndaj palëve që nga momenti i lidhjes së kontratës, pa qenë nevoja të regjistrohet, ndërsa për të tretët, 3 muaj pas realizimit të regjistrimit. Megjithatë, edhe në mungesë të regjistrimit, kontrata martesore i kundërdrejtohet të tretëve, nëse në veprimet juridike të kryera me të tretët, bashkëshortët i kanë vënë ata në dijeni të ndryshimit të regjimit pasuror.

Por cila është natyra juridike e regjistrimit të kontratës martesore në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Regjistrimi i kontratës martesore në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk është gjë tjetër veçse një mjet i nevojshëm për t'i dhënë publicitetin kontratës, për të bërë të njohur ekzistencën e saj të tretët⁴⁹³ të cilët do të kryejnë në të ardhmen veprime juridike me bashkëshortët. Regjistrimi ka funksionin e publikimit deklarativ. Regjistrimi është shërbim publik, që i lejon kujtdo të marrë të dhëna mbi aktet që transkriptohen. Pikërisht, marrja e saktë e informacionit nëpërmjet publikimit krijon siguri në qarkullimin civil të sendeve duke mundësuar që përfituesi i të drejtave mbi këto sende të jetë i garantuar për sendin që blen dhe të drejtat reale përkatëse.

Problemi që lind në këtë rast, për të tretët që hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me bashkëshortët, të cilët pasi kanë konsultuar regjistrin e pasurive të paluajtshme, nga ku nuk figuron asnjë ndryshim i gjendjes juridike të sendit objekt i marrëdhënies juridiko-civile, duhet tu shkojë në mendje, në çdo rast, të konsultojnë edhe regjistrin e martesave për të verifikuar ekzistencën e një kontrate martesore.

Problemi qëndron në moskoordinimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme me regjistrat e gjendjes civile⁴⁹⁴. Jemi të mendimit që, kontrata martesore (e cila ndryshon gjendjen juridike të pasurisë së paluajtshme të bashkëshortëve) e pa regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, por e regjistruar në aktin e martesës, nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve.

Shtrohet problemi nëse, sistemi i regjistrimit të kontratës martesore dhe ndryshimeve që i bëhen kontratës martesore gjatë kohëzgjatjes së martesës, është realisht i efektshëm. A përmbush sistemi i regjistrimit, qëllimin që ka pasur ligjvënësi, pra mbrojtjen e të tretëve dhe konkretisht të kreditorëve të bashkëshortëve? Për këtë qëllim KC Francez, përveç sistemit të regjistrimit në

⁴⁹² Zaccaria, "La pubblica del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina." fq. 416.

⁴⁹³ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009.

⁴⁹⁴ Cian, Giorgio. "Sulla pubblica del regime patrimoniale della famiglia. Una revisione che si impone." *Rivista di diritto civile I*, Padova: CEDAM, 1976, fq. 37.

regjistrat publikë, parashikon edhe detyrimin e bashkëshortëve, në eventualitetin e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, për të njoftuar paraprakisht për këtë ndryshim fëmijët e tyre madhorë dhe kreditorët e tyre (të bashkëshortëve), nëpërmjet një njoftimi në gazetë⁴⁹⁵. Nëpërmjet publikimit në gazetë, të ndryshimit të regjimit pasuror martesor, garantohej më mirë mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve nga kontratat martesore fiktive, të lidhura për pakësimin e pasurisë së bashkëshortit debitor me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tij.

3.6.3. Disa probleme mbi regjistrimin e kontratës martesore

Bazuar në nenin 69, paragrafi 2 dhe 3 të kod.fam:

“Në çastin e nënshkrimit të kontratës, noteri i lëshon palëve një akt noterial, i cili përmban identitetin e plotë të palëve, adresën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe datën e lidhjes së kontratës.

Noteri ka detyrimin të depozitohet një kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës”.

Nga leximi i kësaj dispozite, lindin disa çështje për diskutim.

Së pari, nga neni 69/1,2 rezulton që, noteri është subjekti i cili ka detyrimin ligjor për të regjistruar kontratën martesore në zyrën e gjendjes civile, duke dorëzuar atje një kopje të saj. Nga ana tjetër, ligji parashikon detyrimin e noterit për t'i dorëzuar bashkëshortëve një certifikatë me përmbajtje të elementëve të tillë si: identiteti i plotë i palëve, adresa e tyre dhe vendi i lidhjes së kontratës. Mbetet e paqartë në ligj, se përse kod.fam parashikon pikërisht këtë detyrim të noterit. Cili është funksioni i certifikatës, që noteri i dorëzon bashkëshortëve dhe përse u duhet bashkëshortëve një certifikatë me këto të dhëna, përderisa palët kontraktore mbajnë gjithmonë secila nga një kopje të kontratës. E vetmja zgjidhje logjike për këtë dilemë, është ajo, që ndoshta “ratio legis” ka qenë dorëzimi i certifikatës, nga ana e bashkëshortëve tek nëpunësi i gjendjes civile në momentin e lidhjes së martesës, me qëllim regjistrimin e saj. Kjo zgjidhje nuk gjen mbështetje në dispozitat e kod.fam. për dy arsye: 1) kodi i familjes ka parashikuar detyrimin e noterit për të regjistruar kontratën martesore, nëpërmjet dorëzimit në zyrën e gjendjes civile të një kopje të kontratës, çka e bën dorëzimin e certifikatës nga ana e bashkëshortëve të panevojshëm, madje një veprim të tepërt; dhe 2) në asnjë dispozitë të kod.fam. nuk gjejmë të parashikuar detyrimin e bashkëshortëve për të regjistruar personalisht kontratën martesore në aktin e martesës ose për të dorëzuar certifikatën e dorëzuar nga noteri.

Në përfundim të analizës së këtij problemi, mund të pohojmë që, certifikata e dorëzuar nga noteri palëve, nuk luan asnjë rol në gjithë procesin e regjistrimit të kontratës martesore dhe është e paqartë pse ligji ka parashikuar një detyrim të tillë. Për të kuptuar më mirë këtë rregullim ligjor mund të referojmë në KC Francez, i cili parashikohet detyrimin e noterit për t'i pajisur bashkëshortët me një certifikatë të tillë, nëpërmjet së cilës bashkëshortët, si subjekte të detyruar nga ligji, bëjnë regjistrimin e kontratës në zyrën e gjendjes civile. Në KC Francez, certifikata i shërben bashkëshortëve për të realizuar regjistrimin e kontratës martesore, në zyrën e gjendjes civile, sepse sipas KC Francez subjekti i detyruar për regjistrimin e kontratës martesore janë bashkëshortët dhe jo noteri.

Në mungesë të regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë, bazuar në nenin 24 të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë”⁴⁹⁶, noteri ka detyrimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar bashkëshortëve, si pasojë e mungesës së regjistrimit. Për këtë arsye ligji “Për

⁴⁹⁵ Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq.79.

⁴⁹⁶ Në bazë të nenin 24 të ligjit “Për Noterinë”: “Kur noteri ushtron veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar”.

Noterinë” ka parashikuar të drejtën e noterit për të lidhur kontratë sigurimi, për përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë noteriale.

Së dyti, sipas nenit 69/2 të kod.fam. regjistrimi i kontratës bëhet në zyrën e gjendjes civile, para lidhjes së martesës. Disa pyetje shtrohen për diskutim.

Në rastin e kontratës martesore të lidhur para lidhjes së martesës, cila është zyra e gjendjes civile ku noteri duhet të dorëzojë noteri kopjen e kontratës martesore? Për ti dhënë përgjigje pyetjes duhet të merret në analizë fakti nëse bashkëshortët kanë bërë ose jo kërkesën për shpallje martese.

Në rastin kur është realizuar kërkesa për shpallje martese, atëherë jemi të mendimit që, noteri duhet të dorëzojë kopjen e kontratës martesore, në zyrën e gjendjes civile, ku është bërë kërkesa për shpallje martese, zyrë e cila, bazuar në nenin 28 të kod.fam, është zyra ku do të lidhet martesa.

Nëse bashkëshortët e ardhshëm akoma nuk kanë bërë kërkesën për shpalljen e martesës, shtrohet problemi se si do të përmbushë noteri detyrimin e tij ligjor të regjistrimit të kontratës martesore. A ka detyrimin ligjor nëpunësi i gjendjes civile, të marrë në dorëzim një kontratë martesore të lidhur nga dy personave, të cilët akoma nuk i kanë shprehur nëpunësit, qëllimin e tyre për lidhjen e martesës (akoma nuk kanë paraqitur në zyrën e gjendjes civile kërkesën për shpallje martese). Nëse, nëpunësi i gjendjes civile pranon të marrë në dorëzim kontratën, në cilin regjistër do të bëhet regjistrimi i saj. Nëse bashkëshortët e ardhshëm akoma nuk kanë bërë kërkesën për shpallje martese dhe ato kanë vendbanimin e tyre në njësi të ndryshme territoriale, në cilën zyrë të gjendjes civile duhet të dorëzojë noteri kontratën martesore.

Vihet re se, pozita e noterit është mjaft delikate, përderisa atij i kërkohet nga ligji, detyrimi i regjistrimit të një kontrate martesore, para se martesa të jetë lidhur, lidhje martese për të cilën ai mund të mos marrë dijeni në kohën e duhur⁴⁹⁷ ose mund të lidhet në një tjetër qytet nga ai në të cilin është lidhur kontrata martesore (qyteti në të cilin noteri zhvillon veprimtarinë e tij)⁴⁹⁸. Janë palët ato që, duhet të informojnë noterin pranë të cilit kanë lidhur kontratën martesore për vendin dhe datën e lidhjes së martesës, në mënyrë që noteri të përmbushë detyrimin e tij ligjor për regjistrimin e kontratës.

Ligji ka lënë, gjithashtu, pa rregulluar afatet ligjore brenda të cilave noteri duhet të kërkojë regjistrimin e kontratës në regjistrin ku figuron i regjistruar akti i martesës, sipas nenit 72/3, në eventualitetin e kontratës martesore të lidhur nga palët gjatë martesës. Neni 72/3 parashikon vetëm detyrimin për regjistrim, në mënyrë që, kontrata t’i kundërdrejtohet të tretëve, por nuk e vë noterin para afateve brenda të cilave duhet të veprojë për regjistrim.

Së treti, bazuar në nenin 69 të kod.fam., kontrata martesore regjistrohet në “Aktin e Martesës”⁴⁹⁹. Bazuar në nenin 48, pika gj) të ligjit “Për gjendjen Civile”, një nga elementët e detyrueshëm që duhet të përmbajë akti i martesës është edhe regjimi pasuror, nën të cilin janë të martuar bashkëshortët e ardhshëm⁵⁰⁰. Më pas akti i martesës, së bashku me elementët e tij përbërës pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (neni 50 i LGJC). Gjithashtu në Modelin (formularin, Nr. 2) e Aktit të Martesës të rregulluar në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formës, elementëve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të

⁴⁹⁷ Zaccaria, “La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina.” fq. 432.

⁴⁹⁸ Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, fq. 761.

⁴⁹⁹ Sipas nenin 46 të ligjit “Për gjendjen civile”, nr. 10 129, datë 11.05.2009: “Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes”.

⁵⁰⁰ Sipas nenit 48 të Ligjit Për gjendjen civile: Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm:
gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve.

dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, nr. 332, datë 17.03.2010, parashikohet regjistrimi i numrit dhe datës së kontratës martesore në një rubrikë të veçantë të këtij formulari.

Në hipotezën e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, gjatë kohëzgjatjes së martesës, bazuar në nenin 72 të kod.fam, kontrata martesore regjistrohet në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës, i cili bazuar në nenin 50 të ligjit LGJC është Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile. Në këtë hipotezë, kontrata martesore nuk do të regjistrohet në aktin e martesës, por në vetëm në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, regjistër ku është pasqyruar edhe akti i martesës.

Së katërti, cili është roli i nëpunësit të gjendjes civile në regjistrimin e kontratës martesore. A ka ai detyrimin ligjor për të verifikuar plotësimin e kushteve ligjore të vlefshmërisë së kontratës martesore. Nga leximi i dispozitave të kod.fam, rezulton që, roli që ligjvënësi i ka dhënë nëpunësit të gjendjes civile është thjesht ai i regjistrimit të kontratës martesore në aktin e martesës. Nëpunësit të gjendjes civile nuk i është lënë asnjë funksion tjetër, përveçse atij të verifikimit të identitetit të noterit që bën kërkesën për regjistrim dhe të identitetit të palëve kontraktore.

Së pesti, cilat janë elementët që regjistrohen në aktin e martesës. Për të sqaruar këtë pyetje i kthehemi përsëri diskutimit të certifikatës që noteri i lëshon palëve. Duke qenë se, funksioni kryesor i certifikatës, bazuar në legjislacionin francez, është ai i regjistrimit të kontratës, atëherë mund të arrijmë në përfundimin që, në aktin e martesës shënohen elementët që përmban certifikata noteriale, të tilla si: identiteti i palëve, vendbanimi i tyre dhe data e lidhjes së kontratës. Jemi të mendimit që edhe identiteti i noterit pranë të cilit është lidhur kontrata martesore duhet të jetë një element i detyrueshëm për regjistrim.

Së gjashti, në rastin e pjesëtimit gjyqësor të pasurisë, gjatë martesës, sipas nenit 98 të kod.fam, ligji ka parashikuar detyrimin e regjistrimit të vendimit të gjykatës, që i vendos bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara, në regjistrin e gjendjes civile dhe në origjinalin e kontratës së martesës.

Me të drejtë ligjvënësi ka parashikuar regjistrimin e vendimit gjyqësor të pjesëtimit të pasurisë, sepse ky vendim sjell dy pasoja të rëndësishme: përfundimin e regjimit të bashkësisë nga njëra anë, dhe njëkohësisht i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive të ndara, nga ana tjetër.

Neni 100/2 i kod.fam. parashikon depozitimin e kërkesës së bashkëshortëve për pjesëtimin e pasurisë si dhe vendimin e gjykatës, në zyrën e gjendjes civile dhe nëse është rasti edhe në regjistrin tregtar. Është e kuptueshme që, përdorimi i fjalës **“depozitim”** është bërë për të treguar që kërkesa e pjesëtimit të pasurisë, duhet t’i nënshtrohet regjistrimit në regjistrin e martesave dhe në regjistrin tregtar, në eventualitetin kur në pasurinë e bashkësisë gjenden edhe aktivitete tregtare.

Nga ana tjetër, paragrafi i dytë i nenit 100, parashikon regjistrimin e vendimit të gjykatës në regjistrin e gjendjes civile. Duhet theksuar që, pavarësisht formulimit jo të kënaqshëm të kësaj dispozite, regjistrimi i vendimit të gjykatës do të bëhet në regjistrin e martesave, duke ndjekur të njëjtën logjikë me paragrafin e tretë të nenit 72 të kod.fam, i cili parashikon regjistrimin e kontratës martesore, të lidhur gjatë martesës, në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës. Duke lexuar në mënyrë të kombinuar të dy paragrafët e nenit 100 të kod.fam. nxjerrin konkluzionin që, regjistrimit i nënshtrohet vetëm vendimi i gjykatës që, pranon kërkesën për pjesëtimin e pasurisë, sepse vetëm ai sjell ndryshimin e regjimit pasuror të bashkëshortëve, ndërsa vendimi i gjykatës që rrëzon kërkesën për pjesëtim nuk do t’i nënshtrohet detyrimit për regjistrim. *Expresis verbis*, neni 100/1 parashikon **“... vendimi i ndarjes së pasurisë⁵⁰¹ duhet të depozitohet pranë zyrës së gjendjes civile dhe, nëse është rasti, edhe në regjistrin tregtar”**.

⁵⁰¹ Për një koordinim më të mirë të normave ligjore, jemi të mendimit që, ligji duhet të kishte përdorur termin *“pjesitim”* në vend të termit *“ndarje”*.

Bazuar në paragrafin e fundit të nenit 98 të kod.fam. për bashkëshortët vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurive ka efekt prapaveprues, që nga data e paraqitjes së kërkesës për pjesëtim. Për rrjedhojë, në eventualitetin e pjesëtimin të pasurisë, nga gjykata, bashkëshortët do të vendosen në regjimin e pasurive të ndara, që nga data e paraqitjes së kërkesës për pjesëtim.

Një dilemë tjetër shtrohet, në lidhje me personin që, ka detyrimin ligjor për të bërë regjistrimin në këtë rast, bashkëshortët apo gjykata? Në gjykimin tonë, është gjykata organi që ka detyrimin për t'i dërguar një kopje, të vendimit, zyrës së gjendjes civile, në regjistrin themeltar të së cilës, figurojnë të regjistruar bashkëshortët, pavarësisht se në ligj nuk është parashikuar shprehimisht ky detyrim.

Së shtati, në legjislacionin shqiptar (kod.fam, Ligji “Për gjendjen civile” apo akte të tjera nënligjore) nuk parashikohet asnjë zgjidhje, për problemin e bërjes së njohur të tretëve të pavlefshmërisë së kontratës martesore, në eventualitetin kur ajo është deklaruar apo është shpallur e pavlefshme nga gjykata. Duke pasur parasysh që, vendimi i gjykatës për pavlefshmërinë e kontratës martesore, sjell si pasojë vendosjen e bashkëshortëve në regjimin ligjor të bashkësisë, shtrohet problemi i regjistrimit të këtij vendimi⁵⁰². A duhet fshirë regjistrimi nga akti i martesës, apo përkrah regjistrimit të kontratës martesore duhet regjistruar edhe vendimi i gjykatës që konstaton/shpall pavlefshmërinë e kësaj të fundit? Si duhet realizuar vënia në dijeni e nëpunësit të gjendjes civile, të zyrës ku është hartuar akti i martesës, për vendimin e gjykatës mbi pavlefshmërinë e kontratës martesore? Si mund të arrihet koordinimi ndërmjet gjykatës dhe zyrës së gjendjes civile, ku është regjistruar kontrata martesore?

Jemi të mendimit që, një përgjigje për këtë problem do të ishte detyrimi i gjykatës për t'i dërguar një kopje të vendimit gjyqësor, që konstaton apo shpall pavlefshmërinë e kontratës martesore, zyrës së gjendjes civile ku është regjistruar kontrata martesore⁵⁰³. Në vazhdim të këtij arsyetimi, nëpunësi i gjendjes civile bën shënimin përkatës të pavlefshmërisë së kontratës, në akti e martesës, ku është regjistruar kontrata martesore.

Së teti, akoma nuk është e qartë, nëse për qëllimin për t'ia bërë të njohur të tretëve vlen data e regjistrimit të kontratës martesore apo data e depozitimit në zyrën e gjendjes civile të kërkesës për regjistrim. Është e kuptueshme që, ky diskutim shtrohet vetëm në lidhje me kontratën martesore të lidhur gjatë martesës. Afati tre mujor i parashikuar nga neni 72/3 i kod.fam. do të fillojë të llogaritet nga data e regjistrimit të kontratës në aktin e martesës apo nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim⁵⁰⁴. Problemi paraqitet nëse, nëpunësi i gjendjes civile, që merr kërkesën për regjistrim, nuk realizon shënimin në aktin e martesës, në atë moment, por pas një ose disa ditësh.

Nëse, për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, lexojmë me vëmendje nenin 72/3 “...tre muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës...”, shikojmë që problemi komplikohet edhe më tej. Në nenin 72/3 përdoret nga ligjvënësi, termi “depozitim”, i cili na çon të mendojmë që ligji i është referuar datës së depozitimit/paraqitjes së kërkesës për regjistrim. Por nëse vazhdojmë më tej me interpretimin e kësaj norme, kuptojmë që, “*ratio legis*” është që kontrata martesore t'i bëhet e zbatueshme të tretëve, (3 muaj) pasi është realizuar regjistrimi i saj në Regjistrin Themeltar ku është pasqyruar edhe akti i martesës. Mbase termi i duhur për t'u përdorur në këtë rast do të ishte “regjistrim në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës” dhe jo termi “depozitim”.

⁵⁰² Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 45.

⁵⁰³ Këtë qëndrim mban edhe doktrina juridike italiane. Për më shumë shih: Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, fq. 758; Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 45.

⁵⁰⁴ Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, fq. 758.

Së nënti, lidhur me regjistrimin e kontratës martesore në regjistrin tregtar, në të cilin regjistrohen kontratat martesore dispozitive, pra që sjellin ndryshimin e regjimit juridik të një veprimtarie tregtare, shumë probleme lindin nga paqartësia e nenit 71 të kod.fam. Nuk është e qartë, se cili subjekt ka detyrimin për regjistrimin e kontratës martesore në regjistrin tregtar, noteri apo bashkëshortët, sepse neni 71 i kod.fam. nuk shprehet në këtë drejtim, siç bën për shembull, me regjistrimin në regjistrin e martesave, ku parashikon qartësisht detyrimin e noterit për regjistrim. Përderisa ligji nuk shprehet, atëherë duke iu referuar edhe mendimit mbizotërues të doktrinës, janë bashkëshortët, subjektet e detyruar për të realizuar regjistrimin e kontratës martesore në regjistrin tregtar. Në mungesë të regjistrimit, nga ana e bashkëshortëve, noteri nuk mund të ngarkohet me asnjë përgjegjësi, por ai ka detyrimin që të vë në dijeni palët, në momentin e lidhjes së kontratës martesore, për detyrimin e regjistrimit në regjistrin tregtar⁵⁰⁵.

Së fundi, një tjetër dilemë që lind nga leximi i dispozitive të kod.fam. mbi regjistrimin e kontratës martesore, është nëse kontrata martesore, megjithëse e paregjistruar në aktin e martesës, mund t'i kundërdrejtohet të tretit në keqbesim, i cili megjithëse nuk është informuar nga bashkëshortët për ekzistencën e një kontrate martesore ka marrë dijeni për lidhjen e saj⁵⁰⁶? Ngrihet kjo pyetje, sepse sipas neneve 69 dhe 72 të kod.fam., kontrata martesore mund t'i kundërdrejtohet të tretëve në dy raste: a) nëse është e regjistruar; b) nëse bashkëshortët kanë vënë në dijeni të tretin për ekzistencën e saj. Megjithëse problemi i parashtruar nuk gjen zbatim në dispozita e kod.civ, mund t'i referohemi gjithmonë parimeve të përgjithshme të së drejtës civile sipas së cilave ligji nuk i ofron mbrojtje kontraktuesit në "*mala fides*".

Në analizë të fundit, pas gjithë dilemave që paraqitëm në paragrafët e mësipërm, mund të pohojmë që, sistemi i regjistrimit të kontratës martesore, të parashikuar nga kod.fam., nuk është rregulluar në mënyrën më të kënaqshme të mundshme. Problemet e përmendura më sipër nuk gjejnë rregullim ligjor në kod.fam., në ligjin "Për gjendjes civile" si dhe mungojnë aktet nënligjore për rregullimin e detajuar të regjistrimit të kontratës martesore në aktin e martesës dhe në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nxjerrja e akteve nënligjore për rregullimin në mënyrë të detajuar të mënyrës së regjistrimit të kontratës martesore, të afateve të regjistrimit, rubrikës së veçantë për regjistrim në regjistrat e gjendjes civile, është një domosdoshmëri.

Nëpërmjet akteve nënligjore duhet rregulluar edhe procedura që duhet të ndiqet për konsultimin e regjistrimit dhe të kontratës martesore nga të tretët, që hyjnë në marrëdhënie juridike me bashkëshortët.

Gjithashtu, domosdoshmëri paraqet koordinimi i regjistrat të pasurive të paluajtshme me regjistrat e gjendjes civile, për një mbrojtje më të mirë të të tretëve, të cilët hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me bashkëshortët.

3.6.4. *Praktika gjyqësore në lidhje me regjistrimin e kontratës martesore*

Nga analiza e praktikës së pakët gjyqësore të gjykatave shqiptare, mbi mosmarrëveshjet e bashkëshortëve në lidhje me regjimet pasurore dhe kontratën martesore, janë evidentuar probleme në lidhje me zbatimin e dispozitive të kod.fam. mbi funksionet dhe pasojat ligjore të regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë. Këtu merren në analizë dy vendime të gjykatave shqiptare mbi funksionin e regjistrimit të kontratës martesore.

A. Rrethanat e faktit. Padiësja dhe bashkëshorti i saj kanë lidhur martesë në vitin 1990. Bashkëshorti i padiësës ka ushtruar aktivitete tregtare si ortak dhe administrator i disa shoqërive tregtare, si "*EUROIL sha*", "*EDSONY shpk*", "*LAJTHIZA INVEST sha*". Në cilësinë e

⁵⁰⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 153

⁵⁰⁶ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 36.

administratorit të shoqërisë EUROIL sha. bashkëshorti i paditëses ka nënshkruar me Raiffeisen Bank sha disa kontrata kredish bankare, nga viti 2009 e në vazhdim. Për garantimin e kthimit të kredive, kredimarrësi ka dalë garant si dorëzanës, apo duke nënshkruar kontrata hipotekimi me bankës dhe dorëzanësit “*Petrol Impenks sha*”. Pesëmbëdhjetë (15) ditë para marrjes së kredisë, në datë 26.12.2008, bashkëshortët kanë lidhur një marrëveshje⁵⁰⁷, me anë të së cilës, kanë zgjedhur regjimin e pasurive të ndara⁵⁰⁸.

Bashkëshorti i paditëses, në kohë të ndryshme, ka tjetërsuar pasurinë e tij në favor të bashkëshortes⁵⁰⁹. Nga ana tjetër, ai nuk ka likuiduar detyrimet ndaj “*Raiffeisen Bank*”. Me kërkesë të bankës ka hyrë në veprim shoqëria përmbarimore *EPSA shpk*, e cila ka kërkuar në gjykatë lëshimin e urdhërave të ekzekutimit, për të mundësuar ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre titujve. Paditësja, bashkëshorte e debitorit, ka kërkuar në gjykatë pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë mbi pasurinë e saj.

Njëkohësisht, shoqëria përmbarimore, ka depozituar në gjykatë një tjetër padi me objekt veçimin e pjesës së debitorit nga pasuria në bashkëpronësi, me arsyetimin që, kontrata e regjimit të pasurive të ndara nuk mund t’i kundërdrejtohet kreditorit, sepse nuk është regjistruar në zyrën e gjendjes civile.

B. Vendimet e Gjykatave për pavlefshmërinë e titujve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin Nr. 3403, datë 10.04.2012, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe deklarimin e pavlefshmërisë së pjeshme të titujve ekzekutivë⁵¹⁰ në masën që, kërkohet ekzekutimi i tyre mbi pasurinë në bashkëpronësi të bashkëshortëve, me arsyetimin që, ndërmjet bashkëshortëve ekziston një kontratë martesore për zbatimin e regjimit të pasurive të ndara. Sipas arsyetimit të gjykatës, kontrata e lidhur ndërmjet bashkëshortëve i kundërdrejtohet plotësisht të tretëve, megjithëse kontrata nuk është e regjistruar në zyrën e gjendjes civile. Detyrimin e regjistrimit, vazhdon arsyetimin e saj gjykata, në bazë të nenit 69/3 të kod.fam, ligji ia ngarkon noterit dhe mosregjistrimin e saj, ligjvënësi nuk e ka lidhur me asnjë përgjegjësi ligjore, për sa kohë që personi i detyruar është nëpunësi publik. Për rrjedhojë, marrëveshja është plotësisht e vlefshme dhe shtrirja e ekzekutimit të detyruar edhe mbi pasurinë në pronësi të paditëses është kryer në kundërshtim me ligjin.

Kundër këtij vendimi i padituri (Shoqëria përmbarimore EPSA dhe Raiffaisen Bank) ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit, me arsyetimin që, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është i padrejtë dhe i pambështetur në ligj dhe prova dhe se në gjykatë nuk është kërkuar pjestimi i pasurisë në pronësinë vetjake të bashkëshortes së kreditorit, por pasurisë në bashkëpronësi të kreditorit me bashkëshorten e tij. Gjithashtu, shoqëria përmbarimore pretendon që, regjimi pasuror që vepron ndërmjet bashkëshortëve është ai i bashkësisë dhe jo regjimi i pasurive të ndara, sepse kontrata martesore e lidhur ndërmjet palëve nuk është regjistruar në gjendjen civile dhe regjistrin tregtar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i kundërdrejtohet kreditorit (të tretëve).

⁵⁰⁷ Palët kanë lidhur një kontratë martesore, megjithëse të emërtur Akt-Marrëveshje në të cilën kanë përcaktuar “... ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për detyrimet që mund të lindin (gjatë) punës tonë apo aktivitetit që e administrojmë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, gjë e cila na përjashton nga detyrimet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të punëve tona të administruara në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. ... Që sot ne do të kemi regjim pasuror të ndarë nga njëri tjetri dhe nuk do të kemi asnjë detyrim që do të lindë nga ushtrimi i aktivitetit personal të secilit”.

⁵⁰⁸ Gjykojmë që, terminologjia e përdorur nga marrëveshja e bashkëshortëve nuk është i saktë. Për t’iu referuar regjimit të pasurive të ndara është përdorur termi “regjimi i veçantë pasuror”.

⁵⁰⁹ Në vitin 2010 të gjitha aksionet e shoqërisë “Lajthiza Invest sha”, shoqëri në të cilën ka qenë ortak me bashkëshorten e tij, i kalon në favor të bashkëshortes së tij; ndërsa në vitin 2007, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Edsony shpk” i shet bashkëshortes së tij një godinë me sip. 7000 m², në pronësi të shoqërisë.

⁵¹⁰ Përdorimi i termit tituj ekzekutivë nuk është i saktë. Vendimet e gjykatës përbëjnë urdhëra ekzekutivë dhe jo tituj ekzekutivë.

Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin Nr. 2712, datë 16.11.2012, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si një vendim në përputhje të plotë me ligjin dhe provat.

C. Vendimet e Gjykatave për veçimin e pjesës së debitorit në pasurinë në bashkëpronësi.

Ndërkohë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shoqëria përmbarimore ka paraqitur një tjetër kërkesë për veçimin e pjesës takuese të debitorit, të përbërë nga pasuri të paluajtshme dhe aktivitete tregtare në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij (bashkëshortët janë thirrur të paditur në gjykim).

Në vendimin Nr. 6139, datë 14.02.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vensodur rrëzimin e padisë së shoqërisë përmbarimore, me të njejtin arsyetim të mbështetur mbi regjimin e pasurive të ndara.

Shoqëria përmbarimore ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Gjykatën së Apelit Tiranë, e cila me vendimin Nr. 1048, datë 30.04.2013 ka vendosur riçeljen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues, për shkak të shkeljeve procedurale, lidhur me formimin e ndërgjyqësisë, mos hetimin e plotë të fakteve duke iu referuar në mënyrë të gabuar ligjit material dhe pa mbështetur përfundimet në provat e administruara në gjykim.

Së pari, Gjykata e Apelit, arsyeton që, ndërgjyqësia nuk është formuar në mënyrë të drejtë, në përputhje me ligjin procedural, sepse padia është paraqitur vetëm nga shoqëria përmbarimore.

Së dyti, Gjykata e Apelit vlerëson që, nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk janë vlerësuar drejt provat e marra në gjykim, pasi kjo gjykatë nuk ka marrë në konsideratë faktin se në cilin moment marrëveshja e palëve për ndryshimin e regjimit pasuror martesor prodhon efekte kundrejt të tretëve. Sipas arsyetimit të Gjykatës së Apelit, bazuar në nenin 69 dhe 72 të kod.fam, se kontrata martesore nuk është regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile dhe as nuk i është bërë e ditur kreditorit, në momentin e lidhjes së kontratës së huasë bankare. Vetëm në këto raste ky regjim (regjimi i pasurive të ndara) shtrin efektet mbi kreditorin (Raiffeissen Bank).

Kjo gjykatë vlerëson se, në çështjen objekt gjykimi nuk vihet në diskutim vlefshmëria e marrëveshjes së bashkëshortëve të paditur, por efektet e kësaj marrëveshje tek të tretët, efekte këto që, ligji i ka përcaktuar qartë.

Ndërkohë, edhe në mungesë të shënimit (regjistrimit) si më sipër në aktin martesor të gjendjes civile, ligji në mënyrë të detajuar përcakton se në marrëdhëniet me të tretët, janë bashkëshortët që duhet të deklarojnë marrëveshjen e ndryshimit të regjimit pasuror, pikërisht në lidhjen e kësaj marrëdhënie, dhe mosdeklarimi lë pa efekt marrëveshjen kundrejt të tretit⁵¹¹.

⁵¹¹ Në këtë vendim gjykata shprehet edhe për vendimin e Gjykatës së Apelit mbi pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë, duke u shprehur se:

“Gjykata e Apelit Tiranë, në përgjigje të pretendimeve të mbrojtësit të të paditurve, vlerëson se nuk ka as kompetencë dhe as çështje për gjykim, që të kontrollojë vendimet gjyqësore të mëparshme, për më tepër edhe të së njejtës shkallë gjykimi.

Nga ana tjetër, pavarësisht sa me sipër, kjo gjykatë e ka të pakuptueshëm efektin e disponimit për “pavlefshmëri të pjesëshme të një urdhëri ekzekutimi ...”, i cili është vetëm një mjet procedural me të cilin vihet në lëvizje shërbimi përmbarimor për të ekzekutuar titullin ekzekutiv.

Për më tepër i pakuptueshëm bëhet ky disponim, kur kjo “pavlefshmëri e pjesëshme lidhet me pasuritë ekskluzive të paditëses ...”, e cila as është debitorë, dhe as pretendohet nga kreditori apo shërbimi përmbarimor si e tillë.

Titulli ekzekutiv është akti i marrjes së kredisë bankare, akt në të cilin është i specifikuar kredimarrësi debitor. Për këtë titull është lëshuar urdhëri i ekzekutimit, dhe të deklarosh pjesërisht të pavlefshëm këtë urdhër për paditësen që nuk është debitorë, do të thotë të gjykosh një konflikt që nuk ekziston.

Sa më sipër, kjo gjykatë nuk gjen të bazuar analizën në gjykime të mëparshme, kur në interpretim të nenit 72 të Kod.Fam. gjykatat kanë arsyetuar se “... domosdoshmëria për të depozituar marrëveshjen e bashkëshortëve për

Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson se, veç analizës si më sipër të fakteve referuar nënitet 72 të kod.fam., Gjykata e Shkallës së Parë duhet të hetonte dhe të analizonte faktet referuar nënitet 71 të këtij kodi. Rezulton që, të paditurit ushtrojnë veprimtari tregtare, ndërkohë që në mënyrë të shprehur edhe në marrëveshjen mes tyre, kanë përcaktuar se ndryshimet në kontratën martesore lidhen pikërisht me ushtrimin e këtij aktiviteti. Në këto rrethana, Gjykata e Shkallës së Parë do të duhet të hetonte depozitimet e mundshme të të paditurve në regjistrin tregtar dhe referuar këtij fakti, të dilte në përfundimin e efektshmërisë ose jo të marrëveshjes për ndryshim të regjimit pasuror mes bashkëshortëve kundrejt të tretëve.

D. Analizë kritike mbi vendimet e gjykatave. Jemi të mendimit që, Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 3403, datë 10.04.2012; Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 2712, datë 16.11.2012 dhe Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr. 6139, datë 14.06.2012 janë vendime të marra plotësisht në interpretim të gabuar të dispozitave të kod.fam. mbi regjistrimin e kontratës martesore.

Pajtohem plotësisht me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Apelit Tiranë, në Vendimin Nr. 1048, datë 30.04.2013. Ashtu siç shprehet edhe kjo gjykatë, mungesa e regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë (Regjistri i Martesave-neni 69 dhe 72 të kod.fam; regjistri tregtar-neni 71 i kod.fam) nuk çënon vlefshmërinë e kontratës (kontrata është e vlefshme nëse është lidhur në formën e aktit noterial), por sjell si pasojë faktin që, kontrata martesore nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve. Në mungesë të regjistrimit, bashkëshortët do të konsiderohen kundrejt të tretëve të martuar nën regjimin e bashkësisë ligjore (neni 69/paragrafi 4 i kod.fam). Është pikërisht ky funksioni i regjistrimit të kontratës martesore, ai i mbrojtjes së të tretëve që do të kontraktojë me bashkëshortët gjatë martesës si dhe mbrojtjes së kreditorëve të secilit bashkëshort dhe kreditorëve të bashkësisë.

Në një tjetër vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë⁵¹², në lidhje me pretendimet e paditëses për pavlefshmërinë e kontratës martesore për shkak të mosregjistrimit të saj në gjendjen civile dhe regjistrin tregtar, Gjykata, në përputhje me qëllimin e ligjit (kod.fam.) lidhur me regjistrimin e kontratës për ndryshimin e regjimit pasuror martesor, vlerëson se mosregjistrimi i saj, nuk e cilëson kontratën si të pavlefshme, pasi mes palëve ajo sjell të gjitha efektet juridike, por regjistrimi përbën garanci për të tretët, në raport me marrëdhëniet juridike, që ata mund të kenë me bashkëshortët.

3.7. Elementët rastësorë në përmbajtjen e kontratës martesore

Një debat, që prej kohësh ka angazhuar doktrinën juridike të huaj, i referohet mundësisë së zbatimit të "*elementëve rastësorë*" në përmbajtjen e kontratës martesore. A është e mundur që, bashkëshortët të kushtëzojnë efektet e kontratës martesore me elementët rastësorë, të tilla si: afati, kushti dhe modusi? Thënë ndryshe, i gjithë problemi shtrohet në vlerësimin nëse kontrata martesore është një veprim juridik i pajtueshëm ose jo me elementët rastësorë.

Mendimi dominant i doktrinës juridike është që, elementët rastësorë mund të përfshihen në kontratën martesore me kushtin e vetëm që, klauzola rastësore të mos vijë në kundërshtim me normat urdhëruese të kod.fam, sidomos me ato norma që rregullojnë fillimin dhe përfundimin e regjimit pasuror martesor⁵¹³.

ndryshimin e regjimit pasuror martesor në zyrën e gjendjes civile, është detyrim i noterit dhe mosushtrimi i këtij detyrimi nga nëpunësi publik, nuk e bën të pavlefshme këtë marrëveshje...".

⁵¹² Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2423, datë 16.10.2012.

⁵¹³ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 187-188; Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 76-77.

Doktrina, në lidhje me pajtueshmërinë e elementëve rastësorë me kontratën martesore, bën një dallim ndërmjet afatit dhe kushtit pezullues dhe atyre zgjidhës.

Në vazhdim të këtij arsyetimi, bashkëshortët mund të kushtëzojnë fillimin e efekteve të kontratës martesore nëpërmjet vendosjes së një afati kohor, nga i cili kontrata të fillojë të sjellë pasoja, ose nëpërmjet vendosjes së një kushti pezullues, me verifikimin e të cilit do të fillojnë efektet e kontratës. Megjithatë është i pavlefshëm çdo kusht apo afat verifikimi i të cilëve parashikon ardhjen e pasojave të kontratës martesore para lidhjes së martesës ose zgjatjen e pasojave edhe pas përfundimit të martesës⁵¹⁴.

Problemi i vetëm që mund të lindë, në rastin e kontratës me kusht ose afat pezullues, është regjistrimi i saj në aktin e martesës. Në rastin e afatit pezullues, noteri, në momentin e kalimit të afatit duhet të realizojë regjistrimin e kontratës martesore në aktin e martesës, sepse verifikimi i kalimit të afatit mund të konstatohet lehtësisht nga noteri. Përmbushja e detyrës së regjistrimit të kontratës në aktin e martesës, nga ana e noterit bëhet e vështirë në rastin kur palët kanë kushtëzuar ardhjen e efekteve me një kusht pezullues, për shkak se noteri, nuk mund të konstatojë personalisht verifikimin e kushtit. Në këtë rast, i takon bashkëshortëve, që të njoftojë menjëherë, sapo kushti të verifikohet, noterin në mënyrë që, t'i lejojnë përmbushjen e detyrës së tij ligjore të regjistrimit të kontratës në aktin e martesës⁵¹⁵.

Nga ana tjetër, bazuar në të njëjtën doktrinë, kushti dhe afati zgjidhës, janë të papajtueshëm me kontratën martesore, për shkak se bien në kundërshtim me dispozitat e kod.fam. që rregullojnë ndryshimin dhe përfundimin e regjimit pasuror martesor. Kështu, palët nuk mund të përfshijnë në kontratë një afat me përmbushjen e të cilit⁵¹⁶, ose një kusht, me verifikimin e të cilit, të pushojnë efektet e regjimit kontraktor dhe për rrjedhojë të zbatohet bashkësia ligjore, sepse në të dyja rastet bashkëshortët do të parashikonin një rast të ri të përfundimit të regjimit pasuror⁵¹⁷, përveç atyre të parashikuara nga dispozitat urdhëruese të kod.fam⁵¹⁸.

Sipas një tjetër qëndrimi doktrinal, bashkëshortët mund të vendosin një afat apo kusht zgjidhës në kontratën martesore, verifikimi i të cilit sjell pushimin e efekteve të kontratës, përderisa nuk ka një normë ligjore që të parashikojë këtë ndalim. Nëse ligji u ka njohur bashkëshortëve të drejtën për të ndryshuar tërësisht, modifikuar apo shuar regjimin pasuror, gjatë martesës, atëherë pse mos i njihet e drejta për të përcaktuar paraprakisht nëpërmjet afatit apo kushtit zgjidhës, kohëzgjatjen e kontratës dhe eventualisht të regjimit pasuror të rregulluar nëpërmjet saj. Kohëzgjatja e kontratës martesore nuk korrespondon domosdoshmërisht me atë të martesës⁵¹⁹.

3.8. Efektet e kontratës martesore ndaj palëve dhe të tretëve

3.8.1. Efektet që prodhon kontrata martesore

Sipas doktrinës, efektet juridike që sjell kontrata e zakonshme për palët janë klasifikuar gjithmonë në dy grupe: a) efektet reale; me efekte reale do të kuptojmë transferimin e një të drejte reale nga njëra palë tek tjetra (p.sh. kontrata e shitjes, dhurimit, shkëmbimit sjellin efekte

⁵¹⁴ Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 77.

⁵¹⁵ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 189.

⁵¹⁶ Tedeschi, Guido. "Il regime patrimoniale della famiglia. Quinta edizione." në *Tratatto di diritto civile*, Vol. III, Torino: UTET, 1963, fq. 43.

⁵¹⁷ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 188-189.

⁵¹⁸ Bazuar në kod.fam, regjimi pasuror i bashkësisë ligjore ose një regjim kontraktor përfundon në rastin e përfundimit të martesës (vdekje të njërit bashkëshort, zgjidhje ose pavlefshmëri të martesës), të ndryshimit ose shuarjes së regjimit pasuror me marrëveshje të palëve (kontrata martesore) dhe për regjimin e bashkësisë ligjore edhe në rastin e pjestimit gjyqësor të sendeve (neni 98 i kod.fam).

⁵¹⁹ Russo, "L'autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali." fq. 542.

juridike reale për palët, sepse transferojnë të drejtën e pronësisë nga njëra palë tek tjetra) dhe b) efektet detyruese, të cilat sjellin për palët kontraktore detyrimin për të kryer ose moskryer një veprim të caktuar apo për të dorëzuar një send të caktuar. Është vështirë të gjesh kontrata që sjellin vetëm efekte reale dhe kontrata që sjellin vetëm efekte detyrimi⁵²⁰.

Natyrshëm lind pyetja se, cilat janë llojet e efekteve që prodhon kontrata martesore efekte detyrimi, efekte reale apo të dyja bashkë.

Sipas doktrinës italiane, efektet juridike që sjell kontrata martesore nuk mund të klasifikohet në klasifikimin klasik, efekte reale dhe efekte detyrimi. Kontrata martesore nuk krijon, ndryshon apo shuan të drejta subjektive dhe as nuk sjellin marrjen përsipër të detyrimeve juridike për palët (bashkëshortët). Thënë ndryshe kontrata martesore nuk mund të klasifikohet as në kategorinë e kontratave që sjellin detyrime për palët dhe as në kategorinë e atyre që sjellin transferimin e të drejtave reale nga njëra palë tek tjetra.⁵²¹

Me lidhjen e kontratës martesore, bashkëshortët nuk marrin menjëherë përsipër të drejta dhe detyrime dhe as nuk realizohet transferimi i të drejtave reale nga njëri bashkëshort drejt tjetrit. Kontrata martesore do të prodhojë efektet e saj juridike, për palët, në të ardhmen me verifikimin e disa fakteve juridike të ardhshme si: blerja e sendeve nga njëri prej bashkëshortëve, shtimi i prodhimit të pasurisë së bashkëshortëve, fitimi i të ardhurave nga puna, shpërblimi i një dëmi vetjak etj⁵²².

Efektet që prodhon kontrata martesore konsistojnë në vetë vendosjen e një regjimi të caktuar pasuror kontraktor. Këto lloj efektesh janë cilësuar nga doktrina si **“efekti final”** (efficacia finale), i cili është një lloj efekti juridik, nëpërmjet të cilit realizohet qëllimi kontraktor i palëve, pa qenë e nevojshme kryerja ose moskryerja e të tjera veprimeve, apo dorëzimi i sendeve. Qëllimi kontraktor i palëve përmbushet me vendosjen e një regjimi të caktuar kontraktor.

Pasojat pasurore që sjell për bashkëshortët zbatimi i regjimit pasuror kontraktor, ku mund të përfshihen fitimi i të drejtave reale, marrja përsipër e detyrimeve etj, nuk janë pasojë e drejtpërdrejtë e kontratës martesore, por janë pasojë e zbatimit të rregullave (regjimit pasuror) të përcaktuar nga palët në kontratën martesore⁵²³.

Analiza e realizuar në sipër, në lidhje me natyrën juridike të efekteve që prodhon kontrata martesore, nuk ka vetëm vlera doktrinale por edhe vlera të rëndësishme praktike, sepse nëpërmjet kësaj analize mund të përcaktojmë se cilat norma ligjore të parashikuara nga kod.civ. për rregullimin e kontratës në përgjithësi mund të zbatohen edhe për kontratën martesore dhe cilat jo.

E gjithë analiza e realizuar deri tani, mbi natyrën juridike të kontratës martesore, i referohet llojit më të përhapur në praktikë të kontratave martesore, atyre programatike.

Nga ana tjetër, nëse marrim në analizë kontratat martesore dispozitive, me të drejtë mund të pohojmë që këto kontrata sjellin efekte reale për palët, sepse sjellin ndryshimin e regjimit juridik të një sendi, duke e kaluar atë nga pronësia ekskluzive e njërit bashkëshort në pronësi të bashkësisë, ose anasjelltas.

Në analizë të fundit, efektet e kontratës martesore i klasifikojmë në dy grupe:

- a) Efektet programatike;
- b) Efektet dispozitive (të drejta reale dhe të drejta krediti).

⁵²⁰ Nëse marrim si shembull kontratën e shitjes, mund të pohojmë që, kjo kontratë sjell efekte reale, sepse realizon transferimin e së drejtës së pronësisë nga shitësi tek blerësi, por nga ana tjetër sjell edhe efekte detyrimi, sepse i vendos palët në marrëdhënie detyrimi ndërmjet tyre. Kështu p.sh. shitësi ka detyrimin për të dorëzuar sendin tek blerësi, detyrimin e garantimit të të metave të sendit dhe garantimin e eviksionit, ndërsa nga ana tjetër blerësi ka detyrimin e pagimit të çmimit. Për këtë shih: Galgano, *E drejta private*, fq. 720.

⁵²¹ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 532.

⁵²² Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 532.

⁵²³ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 532-533.

3.8.2. Momenti kohor i ardhjes së pasojave të kontratës martesore ndaj palëve dhe ndaj të tretëve

Veçori tjetër e kontratës martesore është dallimi ndërmjet momentit kohor të lidhjes së saj (perfeksionimit) dhe momentit të fillimit të prodhimit të efekteve ligjore.

Si përjashtim nga parimi i përgjithshëm i së drejtës private, sipas së cilit kontrata sjell pasoja vetëm “*inter partes*”, pra vetëm ndërmjet palëve kontraktore, kontrata martesore sjell pasoja jo vetëm për bashkëshortët, në cilësinë e palëve kontraktore, por ka efekte “*erga omnes*”⁵²⁴, edhe për të tretët që nuk kanë marrë pjesë në lidhjen e kontratës. Në funksion të përcaktimit të momentit kohor të ardhjes së pasojave për të tretët, ligji parashikon sistemin e regjistrimit të kontratës martesore.

Analiza e momentit kohor të ardhjes së pasojave, për palët dhe për të tretët, kërkon bërjen e dallimit ndërmjet kontratave të lidhura para lidhjes së martesës “*kontratat ante nuptial*” dhe atyre të lidhura gjatë martesës “*kontratat post nuptial*”. Ky dallim nuk ka vlera vetëm teorike, por mbart njëkohësisht edhe vlera praktike, për shkak se momenti kohor i fillimit të prodhimit të efekteve juridike të kontratës martesore për bashkëshortët dhe për të tretët ndryshon në varësi të kohës së lidhjes së kontratës martesore, *ante* ose *post nuptial*⁵²⁵.

Lidhur me shtrirjen kohore të efekteve të kontratës martesore, duhet evidentuar që, ajo prodhon efekte juridike për aq kohë sa zgjat dhe martesja, e për rrjedhojë, efektet e saj nuk mund të fillojnë kurrsesi para lidhjes së martesës dhe as nuk mund t’i mbijetojnë përfundimit të saj⁵²⁶. Jetëgjatësia e kontratës martesore, fillimi dhe përfundimi i saj, përveçse nga vullneti i palëve kontraktore, varet ngushtësisht nga jetëgjatësia e martesës, sepse funksioni i saj ekonomiko-social është ai i shmangies së regjimit pasuror martesor ligjor.

A. Kontrata martesore “*ante nuptial*”. Në rastin e kontratës martesore ante nuptial efektet juridike, si për palët kontraktore ashtu dhe për të tretët, kontrata nuk do t’i prodhojë nga momenti i lidhjes së kontratës (rasti i kontratave konsensuale), por nga çasti i lidhjes së martesës⁵²⁷. Që kontrata martesore e lidhur “*ante nuptial*” të prodhojë efekte për të tretët, përveç lidhjes së martesës është e nevojshme edhe regjistrimi i saj në aktin e martesës. Mungesa e regjistrimit në aktin e martesës i bën ato pa efekte juridike ndaj të tretëve, për të cilët bashkëshortët do të konsiderohen të martuar nën regjimin ligjor të bashkësisë.

Ka diskutime në doktrinën juridike, në lidhje me vlerën që ka “lidhja e martesës” mbi kontratën martesore “*ante nuptial*”.

Sipas opinionit mbizotërues të doktrinës, “*lidhja e martesës*” përfaqëson një kusht ligjor pezullues “*condicio juris*” për kontratën martesore, plotësimi i të cilit nuk ndikon mbi vlefshmërinë e kontratës martesore, por vetëm mbi efektet e saj⁵²⁸. Lidhja e martesës përfaqëson një *conditio juris*, me verifikimin e të cilit, kontrata martesore fillon të sjellë pasojat ligjore, njëkohësisht për palët dhe për të tretët. Verifikimi i “*conditio juris*” nuk ka efekte retroaktive, kështu që, duhet theksuar se, verifikimi i kushtit ligjor të lidhjes së martesës sjell efekte për palët dhe për të tretët, që nga çasti i lidhjes së martesës, dhe jo që nga çasti i lidhjes së kontratës

⁵²⁴ Tedeschi, “Il regime patrimoniale della famiglia.” fq. 43.

⁵²⁵ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 184.

⁵²⁶ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 939; Goré, “La détermination du régime matrimonial.” fq. 79.

⁵²⁷ Kujtojmë këtu që, një nga reformat, që ka sjellë kodi aktual i familjes në raport me kodin e mëparshëm, është çasti i lidhjes së martesës nga momenti që nëpunësi i gjendjes civile i shpall bashkëshortët të martuar në emër të ligjit.

⁵²⁸ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 939. Githashtu në mbështetje të këtij opinion: De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 184.

martesore⁵²⁹. Nga ana tjetër, nëse lidhja e martesës nuk verifikohet, kontrata martesore mbetet e vlefshme, por nuk sjell pasojat e dëshiruara nga palët kontraktore.

Një tjetër teori e vlerëson “*lidhjen e martesës*” si një kusht thelbësor “*sin qua non*” të kontratës martesore, plotësimi apo jo i të cilit, ndikon drejtpërdrejtë në vlefshmërinë e kontratës martesore. Në vazhdim të këtij opinioni, nëse martesë nuk lidhet, kontrata martesore është e pavlefshme për mungesë të shkakut, sepse shkak i saj është përcaktimi i regjimit pasuror martesor, të ndryshëm nga regjimi ligjor. Nëse martesë nuk lidhet atëherë, nuk ekziston një regjim ligjor, të cilin bashkëshortët të mund të shmangin, nëpërmjet kontratës martesore, si dhe ajo mbetet pa asnjë funksion ekonomik-social dhe për rrjedhojë, jemi përpara një kontrate të pavlefshme për inekzistencë të shkakut.

Në mendimin tonë, qëndrimi i autorëve të grupit të parë është më i pranueshëm. Kontrata martesore e “*ante nuptial*” është e vlefshme që nga momenti i perfeksionimit të saj, pra që nga momenti i lidhjes së saj. Mos lidhja e martesës nuk ndikon mbi vlefshmërinë e kontratës martesore, e cila nëse ishte e vlefshme në momentin e perfeksionimit e tillë mbetet edhe nëse martesë nuk lidhet, por ndikon mbi efektet e saj⁵³⁰. Nëse martesë nuk lidhet kontrata martesore është e vlefshme, por e padobishme, sepse nuk ka mundësi të përmbushë qëllimin për të cilin ishte krijuar⁵³¹.

B. Kontrata martesore “*post nuptial*”. Kontrata martesore të lidhur “*post nuptial*” fillon të sjellë efekte për palët dhe për të tretët në momente të ndryshme kohore. Për palët kontrata sjell efekte nga momenti i lidhjes së saj, kuptohet pasi janë respektuar të gjithë elementët e formës që kërkon kod.fam. Ndërsa, momenti i prodhimit të efekteve ndaj të tretëve do të varet nga fakti nëse personi i tretë që kontraktonte me bashkëshortët ose njërin prej tyre është apo jo në dijeni të ekzistencës së kontratës⁵³².

Si rregull i përgjithshëm, kontrata martesore do të sjellë efekte për të tretët vetëm 3 muaj pas regjistrimit në regjistrin e martesave. Deri në këtë moment për të tretët, bashkëshortët do të jenë të martuar nën regjimin e mëparshëm pasuror, që mund të jetë regjimi i bashkësisë ligjore ose një tjetër regjim kontraktor i mëparshëm.

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, nëse bashkëshorti/ët kontraktues e kanë vënë në dijeni të tretin për ekzistencën e regjimit pasuror kontraktor, para kontraktimit me të atëherë kontrata martesore sjell efekte për të që nga momenti që ai merr dijeni.

C. Fuqia prapavepruese e kontratës martesore. Duke qenë se, kontrata martesore është një veprim juridik që bën pjesë në kategorinë e përgjithshme të kontratave, jemi të mendimit që, bashkëshortët mund të vendosin që t’i shtrijnë efektet e kontratës edhe për të shkuarën, pra t’i japin kontratës martesore fuqi prapavepruese⁵³³, si duke vendosur një regjim të ri pasuror me fuqi edhe për të shkuarën ashtu edhe duke shuar me fuqi prapavepruese regjimin pasuror që është zbatuar ndërmjet tyre.

Nëse palët i kanë dhënë kontratës fuqi prapavepruese, ajo nuk do të sjellë pasojat për të tretët, në lidhje me të shkuarën, sepse nuk mund të paragjykohej, në asnjë rast, të drejtat e fituara nga të

⁵²⁹ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1256-1257.

⁵³⁰ Në këtë rast kemi të bëjmë me paefekshmëri absolute të kontratës martesore, sepse kontrata nuk prodhon efekte as për palët kontraktore dhe as për të tretët. Për më shumë shiko: Roppo, *Il Contratto*, fq. 691.

⁵³¹ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 939.

⁵³² Bazuar në nenin 72/3 të kod.fam.: “Ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka efekt kundrejt të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës, Në mungesë të këtij shënimi, ndryshimi nuk kundërshtohet nga të tretët, në qoftë se në aktet e bëra midis tyre, bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimin pasuror martesor.”

⁵³³ Cubeddu, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 207.

tretët, para lidhjes së kontratës. Për të tretët, bashkëshortët do të konsiderohen të martuar nën regjimin pasuror që ishte në fuqi para lidhjes së kësaj kontrate. Kontrata martesore prapavepruese do të sjellë efekte “*ex tunc*” për palët kontraktore (bashkëshortët), ndërsa për të tretët që kanë fituar të drejta ose kanë marrë përsipër detyrime nga bashkëshortët, kontrata martesore prapavepruese do të sjellë efekte “*ex nunc*”, pra vetëm për të ardhmen.

Referuar parimeve të CEFL “*Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve*”, në parimin 4:14 parashikohet që “Kontrata martesore sjell pasoja ndaj palëve të treta, nëse në momentin e realizimit të transaksionit ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve a) kontrata martesore është publikuar (regjistruar); ose b) të tretët ishin në dijeni të kontratës martesore⁵³⁴.”

3.8.3. *Praktika gjyqësore në lidhje me efektet prapavepruese të kontratës martesore*

A. Rrethanat e faktit. Palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë në datën 30.09.1991. Nga martesë ata rezultojnë të kenë dy fëmijë. Në datë 11.07.2007 palët kanë lidhur një kontratë martesore për ndryshimin e regjimit pasuror martesor dhe zbatimin e regjimit të pasurive të ndara. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 01.02.2008, është regjistruar padia për zgjidhjen e martesës mes palëve ndërgjyqëse. Martesa është zgjidhur me vendimin Nr. 4184, datë 20.05.2011.

Bashkëshortja (pala paditëse) ka kërkuar në gjykatë pjestimin e pasurisë në bashkësi ligjore⁵³⁵, ndërsa bashkëshorti (i padituri), nëpërmjet kundërpadisë, pretendon mungesën e masës së pasurisë objekt të bashkësisë ligjore, sepse sipas tij, bashkëshortët kanë rënë dakort që çdo pasuri e cila figuronte në emer të secilit prej tyre veçmas, në datën e lidhjes së marrëveshjes, do të trajtohej si pasuri vetjake e atij bashkëshorti, me të drejta të plota pronësie.

B. Problemet që shtrohen për diskutim para gjykatave. Disa çështje parashtrohen për zgjidhje para Gjykatës së Shkallës së Parë:

Së pari, vlefshmëria e kontratës martesore, nëpërmjet së cilës bashkëshortët i japin efekte regjimit pasuror martesor (në rastin konkret regjimi i pasurive të ndara) jo vetëm për të ardhmen, por edhe për të shkuarën, që nga data e lidhjes së martesës (a mund të sjellë kontrata martesore efekte prapavepruese).

Së dyti, shtrohet problemi i interpretimit të kontratës martesore, në përputhje me qëllimin që kanë patur palët, në momentin e lidhjes së saj, në kushtet kur kontrata nuk është formuluar shumë kënaqshëm.

Së treti, para Gjykatës së Apelit janë parashtruar edhe pretendime, nga pala paditëse, mbi pavlefshmërinë e kontratës martesore për shkak të mungesës së regjistrimit të saj në regjistrat publikë dhe mosparashikimi i të drejtave dhe detyrimeve, të parashikuara në nenin 67 të kod.fam.

C. Vendimet e gjykatave. Vendimet e gjykatave do të analizohen bazuar në pretendimet e palëve.

a) Në lidhje me çështjen e parë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin Nr.8090, datë 18.10.2011, ashtu edhe Gjykata e Apelit Tiranë në Vendimin Nr. 2423, datë 16.10.2012 (lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor), kanë vendosur që, kontrata martesore me efekte prapavepruese është e vlefshme, duke arsyetuar që, palët me vullnetin e tyre të lirë mund

⁵³⁴ <http://www.ceflonline.net>. “*CEFL principles regarding property relations between spouses.*”

⁵³⁵ Ajo ka kërkuar të përfshihen: pasuria e paluajtshme, të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme të shitura dhe të dhëna me qira, të ardhurat nga veprimtaria e biznesit, kompensimi në bashkësi dhe pjestimi i detyrimeve që palët kanë ndaj të tretëve. Në favor të paditëses është vendosur sigurimi i padisë së pjestimit të pasurisë bashkëshortore, duke u bllokuar tjetërsimi i pasurisë që është e regjistruar në emër të bashkëshortit në ZVRPP.

të vendosin që regjimi pasuror martesor t'i shtrijë efektet jo vetëm për pasuritë që do të fitohen në të ardhmen, por edhe për pasuritë që janë të regjistruara në emër të secilit prej tyre, në datën e lidhjes së kontratës martesore. Në asnjë moment nuk është vënë në diskutim, nga këto gjykata, vlefshmëria e kontratës martesore me efekte prapavepruese.

b) Problemi më i rëndësishëm, shtrohen në lidhje me interpretimin e dispozitave kontraktore, të cilat janë interpretuar nga të dyja gjykatat në mënyrë që të sjellin efekte prapavepruese⁵³⁶.

Së pari, gjykatat kanë interpretuar termin **“pasuri të luajtshme”** të parashikuar në nenin 1 dhe 2 të kontratës. Sipas interpretimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe ajo e Apelit **“termi i përdorur nga noterja pasuri e luajtshme, duke u analizuar në lidhje me fazën e mëpasshme “e regjistruar në ZRPP”, të çon në përfundimin se, ky parashikim ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme si të vetmet sende në qarkullimin civil që, i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit në regjistrat e ZVRPP-së”**.

Së dyti, gjykatat kanë interpretuar fjalinë e parë dhe të dytë të nenit 1 dhe 2 të kontratës së palëve, bazuar në qëllimin që kanë patur palët. Bazuar në interpretimet e gjykatave **“Fjalitë e para dhe të dyta të pikave 1 dhe 2 të kontratës, trajtojnë sende të ndryshme nga njëri-tjetri. Kështu, ndërsa në fjalitë e para të pikave (nenet) 1 dhe 2, bëhet fjalë për çdo pasuri të paluajtshme (sipas kontratës “të luajtshme ...të regjistruar në ZRPP”) që do të blihet vetëm në emër të bashkëshortit dhe vetëm në emër të bashkëshortes, në fjalitë e dyta të këtyre pikave respektive, trajtohen të gjitha pasuritë që figurojnë në emër të bashkëshortit nga data e nënshkrimit të kontratës e në vijim dhe të gjitha pasuritë që figurojnë në emër të bashkëshortes, nga data e nënshkrimit të kontratës e në vijim. Pra, nëpërmjet këtyre përcaktimeve, palët kanë përfshirë në regjimin e ndryshuar pasuror, të gjitha pasuritë që palët kanë apo do të kenë vetëm në emër të tyre. I vetmi rast ku nuk do të gjente zbatim kontrata e mësipërme do të ishte pasuria që do të figuronte në emër të të dy bashkëshortëve në momentin e nënshkrimit të kontratës, por nga hetimi gjyqësor nuk rezultoi që të ekzistonte ndonjë pasuri e tillë”**.

Nga analiza e mësipërme, gjykatat kanë arritur në përfundimin që, regjimi pasuror i zgjedhur ndërmjet palëve është ai i pasurive ta ndara, lidhur me pasuritë që palët gëzojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës si dhe pasuritë që do të fitohen në të ardhmen. Për rrjedhojë, gjykatat kanë rrëzuar si padinë ashtu dhe kundërpadinë me arsyetimin që, duke qenë se të gjitha pasuritë e palëve janë të ndara nuk ekziston pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortëve dhe për pasojë nuk ka vend për pjesitim.

⁵³⁶ Kontrata e lidhur mes palëve .

“...1. Çdo pasuri e luajtshme që do të blihet vetëm në emër të bashkëshortit, me kontratë shitblerje dhe e regjistruar në ZRPP dhe me kontratë sipërmarrje ose dhe me çdo formë tjetër, është pasuri vetëm e bashkëshortit. Me të gjitha pasuritë që do të jenë në emrin e tij që nga dita e sotme dhe në vazhdim, ka të drejtë që të veprojë i vetëm duke i tjetërsuar, dhuruar, dhënë me qira, në huapërdorje etj. mbasi nga të dy bashkëshortët konsiderohen si pasuri të vëna vetëm me kontributin e bashkëshortit. Për të gjitha veprimet e mësipërme ka të drejtë që të nënshkruajë kontrata noteriale dhe çdo lloj dokumenti tjetër, nënshkrim i cili do të bëhet vetëm nga bashkëshorti.

2. Çdo pasuri e luajtshme që do të blihet vetëm në emër të bashkëshortes, me kontratë shitblerje dhe e regjistruar në ZRPP dhe me kontratë sipërmarrje ose dhe me çdo formë tjetër, është pasuri vetëm e bashkëshortes. Me të gjitha pasuritë që do të jenë në emrin e saj që nga dita e sotme dhe në vazhdim, ka të drejtë që të veprojë e vetme duke i tjetërsuar, dhuruar, dhënë me qira, në huapërdorje etj. mbasi nga të dy bashkëshortët konsiderohen si pasuri të vëna vetëm me kontributin e bashkëshortes. Për të gjitha veprimet e mësipërme ka të drejtë që të nënshkruajë kontrata noteriale dhe çdo lloj dokumenti tjetër, nënshkrim i cili do të bëhet vetëm nga bashkëshortja.

3. Që nga dita e sotme secili bashkëshort do të përgjigjet me pasurinë dhe të ardhurat e tij, për të gjitha detyrimet që do të lindin nga veprimet e tyre, për pasurinë që do të vënë që nga dita e sotme dhe në vazhdim.

4. Secili bashkëshort ka të drejtë që të administrojë vetë të ardhurat nga pasuritë që do të ketë në emrin e tij që nga dita e sotme dhe në vazhdim.”

c) Në lidhje me pretendimet e paditëses për pavlefshmërinë e kontratës martesore, për shkak të mosregjistrimit të saj në gjendjen civile dhe regjistrin tregtar, Gjykata e Apelit vlerëson se mosregjistrimi i saj, nuk e cilëson kontratën si të pavlefshme, pasi mes palëve ajo sjell të gjitha efektet juridike, por regjistrimi përbën garanci për të tretët, në raport me marrëdhëniet juridike, që ata mund të kenë me bashkëshortët.

d) Në lidhje me pretendimet e paditëses për pavlefshmërinë e kontratës martesore për shkak të shkeljes së neneve 67 dhe 108 të kod.fam, Gjykata e Apelit i gjen ato të pabazuara në ligj, sepse në asnjë prej klauzolave të kontratës nuk parashikohet shmangia e bashkëshortëve nga përmushja e të drejtave dhe detyrimeve, të cilësuar në nenin 67 të kod.fam. si të pashmangshme.

D. Vështrim kritik mbi vendimet e gjykatave. Në lidhje me çështjen e fuqisë prapavepruese të regjimit pasuror kontraktor, jemi plotësisht dakort me qëndrimin e gjykatave, sipas së cilave, bashkëshortët me vullnetin e tyre të lirë kanë të drejtë t'i shtrijnë efektet e regjimit pasuror me kontratë edhe për pasuritë që janë fituar prej secilit prej tyre deri në datën e lidhjes së kontratës. Duhet theksuar që, kontrata martesore me efekte prapavepruese do të sjellë pasoja vetëm për palët kontraktore (bashkëshortët) dhe jo për të tretët.

Nga ana tjetër, nuk pajtohem me mënyrën se si gjykatat kanë interpretuar klauzolat kontraktore, në mënyrë që t'i jepnin kësaj kontrate efekte prapavepruese. Në gjykimin tonë, klauzolat kontraktore (neni 1 dhe 2 i kontratës së palëve) nuk mund të interpretohen në mënyrën që palët në fjalitë e dyta të këtyre klauzolave, kanë dashur tu referohen disponimeve për të shkuarën, ndërsa fjalitë e para i referohen disponimeve për të ardhmen. Pavarësisht formulimit jo të kënaqshëm të klauzolave kontraktore (do të ishte preferuar një formulim më i saktë i disponimeve të palëve mbi regjimin pasuror martesor), interpretimi i gjykatave ka shkuar përtej vullnetit që palët kanë shprehur në kontratë. Në gjykimin tonë, mbi bazën e interpretimit të nenit 1 dhe 2 të kontratës, rezulton që, vullneti i palëve ka qenë ai i zbatimit të regjimit të pasurive të ndara vetëm për të ardhmen (nga data e lidhjes së kontratës martesore) dhe jo për të shkuarën.

Pajtohem me Gjykatën e Apelit, në qëndrimin e saj se, kontrata martesore është e vlefshme pavarësisht mungesës së regjistrimit të saj, pasi regjistrimi nuk është element i formës së kontratës martesore, por shërben për t'ia kundërdrejtuar kontratën martesore të tretëve. Bazuar në nenin 69/paragrafi 4 i kod.fam. në mungesë të regjistrimit kontrata martesore është e vlefshme dhe sjell pasoja për bashkëshortët, por për të tretët bashkëshortët do të konsiderohen të martuar në regjimin e bashkësisë ligjore.

Gjithashtu, në analizë të fundit, pajtohem me qëndrimin e Gjykatës së Apelit mbi vlefshmërinë e kontratës martesore, e cila pavarësisht nga pretendimet e paditëses nuk rezulton të vijë në kundërshtim me nenin 67 të kod.fam. Pretendimi i paditëses, se mosparashikimi në kontratën martesore i të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në nenin 67 të kod.fam. e bën kontratën të pavlefshme, është tërësisht i pabazuar në ligj. Neni 67 është një dispozitë urdhëruese, e cila parashikon ndalimin e bashkëshortëve për tu shmangur nga të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, përgjegjësia prindërore, administrimi ligjor dhe rregulla e kujdestarisë. Nuk është e nevojshme që bashkëshortët t'i rregullojnë këto elementë në kontratën e lidhur ndërmjet tyre, pasi këto të drejta dhe detyrime janë të rregulluara me dispozita të karakterit urdhërues në kod.fam dhe për rrjedhojë zbatimi i tyre është i detyrueshëm për shkak të parashikimeve të ligjit.

3.9. Ndryshimi dhe modifikimi i regjimit pasuror martesor

Një nga parimet mbi të cilin ligjvënësi ka bazuar rregullimin e regjimit pasuror martesor, përveç parimit të autonomisë së vullnetit dhe barazisë së bashkëshortëve, është ai i ndryshueshmërisë së regjimit pasuror, gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Në këtë mënyrë ligjvënësi, nën shembullin e legjislacioneve të tjera Europiane, është larguar nga parimi klasik i pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor, që ka karakterizuar këto legjislacione⁵³⁷, deri para reformave të 30-20 viteve të fundit.

Bazuar në momentin kur realizohet ndryshimi i kontratës martesore, modifikimin e saj e ndajmë në dy grupe:

- a) **Modifikimi i kontratës martesore para lidhjes së martesës.** Bashkëshortët janë të lirë të modifikojnë në çdo kohë kontratën martesore, deri në momentin e lidhjes së martesës dhe nuk i nënshtrohen kushtit të kalimit të afatit 2 vjeçar, të parashikuar nga nenin 72/1 i kod.fam;
- b) **Modifikimi i kontratës martesore pas lidhjes së martesës,** modifikim i cili, i nënshtrohet kushtit të përmendur më sipër. Për këtë modifikim të kontratës martesore do të flasim në këtë pjesë të punimit.

Nëse do të shikojmë në planin historik, evoluimin e parimit të modifikimit të kontratës martesore, duhet të kujtojmë këtu që ky parim gjendet prezent vetëm në legjislacionet moderne. KC i Zogut⁵³⁸, KC Francez i vitit 1804 dhe ai Italian, parashikonin parimin pandryshueshmërisë së kontratave martesore gjatë martesës, si një parim absolut. Kontrata martesore mund të ndryshohej para lidhjes së martesës, por pas lidhjes së saj bashkëshortëve nuk i njihej asnjë mundësi modifikimi qoftë edhe të pjesshme të tyre. Justifikimi i pandryshueshmërisë së kontratës martesore, gjatë kohëzgjatjes së martesës, mbështetet mbi tre arsye kryesore: *së pari*, kontrata martesore konsiderohej si një pakt (marrëveshje) i familjes, në lidhjen e së cilës merrnin pjesë jo vetëm bashkëshortët e ardhshëm, por edhe të tjerë person si psh: prindërit e bashkëshortëve të ardhshëm, ose persona të tjerë që i dhuronin sende bashkëshortëve, kështu që, modifikimi i saj, nuk mund t'i lihej thjesht vullnetit të bashkëshortëve; *së dyti*, pandryshueshmëria ishte parashikuar në favor të mbrojtjes së bashkëshortit më të dobët, i cili gjatë martesës mund të bënte një zgjedhje jo të duhur dhe t'i bindej bashkëshortit tjetër në kërkesën e tij për të ndryshuar kontratën martesor; *së treti*, parimi i pandryshueshmërisë garantonte edhe mbrojtjen e të tretëve, kur ata kontraktonin me bashkëshortët⁵³⁹.

⁵³⁷ Aktualisht, gati të gjitha legjislacionet e vendeve europiane kanë pranuar parimin e modifikimit të regjimit pasuror martesor *constante matrimonii*, si Franca, Italia, Zvicera, Gjermania, Spanja. Në disa vende modifikimi i regjimit pasuror realizohet vetëm me vullnetin e bashkëshortëve, si në rastin e Shqipërisë, ndërsa në disa shtete të tjera modifikimi i regjimit pasuror, gjatë martesës, përveç vullnetit të bashkëshortëve kërkon edhe autorizimi e gjykatës. Aktualisht në Europë i vetmi legjislacion që nuk lejon ndryshimin e regjimit pasuror martesor, *constante matrimonii*, është Kodi Civil Portugez.

⁵³⁸ Në ndryshim nga kod.civ. i vitit 1929 i cili nuk parashikonte mundësinë e modifikimit të regjimit pasuror martesor gjatë martesës, kodi aktual i familjes, është mbështetur në parimin e mundësisë së lidhjes dhe ndryshimit në çdo kohë të kontratave martesore. Bashkëshortët janë të lirë të rregullojnë në çdo kohë marrëdhëniet pasurore të tyre, si para lidhjes së martesës ashtu dhe gjatë kohëzgjatjes së saj. Sipas nenit 1328, kodi civil i Zogut parashikonte "Konvencionet martesore të çdo lloji nuk mund të ndërrohen në asnjë mënyrë pas celebrimit të martesës". Gjithashtu, sipas nenit 1376/paragrafi 2 "Konventa e bashkëpunimit duhet të bahet në kontratën e martesës dhe nuk mundet me u stipulue fillimi i saj në një kohë të ndryshme nga ajo e celebrimit të martesës".

⁵³⁹ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 157.

Ndërsa sot, është pranuar gjerësisht mundësia e bashkëshortëve për të ndryshuar regjimin pasuror martesor gjatë martesës, mjafton të përmendim reformën e vitit 1975 të KC Italian dhe reformën e vitit 1985 të KC Francez, megjithëse me kufizime⁵⁴⁰.

Ndryshimet sociale, ekonomike dhe morale të shoqërisë sollën nevojën e eliminimit të parimit të pandryshueshmërisë, si dhe mundësia për t'i dhënë zgjidhje problemeve që kishin çuar në sanksionimin e këtij parimi: tashmë kontrata martesore lidhet vetëm ndërmjet bashkëshortëve dhe nuk pranohet pjesëmarrja e personave të tretë në të, interesat e bashkëshortit më të dobët janë të mbrojtur nëpërmjet aktit noterial, ndërsa interesat e personave të tretë gjejnë mbrojtje nëpërmjet sistemit të regjistrimit⁵⁴¹.

Në funksion të parimit të autonomisë së vullnetit, bashkëshortëve i është dhënë e drejta për të ndryshuar, në vazhdimësi të martesës, regjimin pasuror, në përputhje me ndryshimin e nevojave të tyre dhe nevojave të familjes⁵⁴².

Në kuadrin e ndryshimit të kontratës martesore, doktrina italiane përdor dy terma: termin **“ndryshim”** dhe atë **“modifikim”** të regjimit pasuror. Me **ndryshim** të regjimit pasuror do të kuptojmë ndryshim tërësor të regjimit nga një formë regjimi në një formë të re, psh: ndryshimin nga regjimi i bashkësisë kontraktore, në regjimin e pasurive të ndara, ose anasjelltas. Ndërsa, me **modifikim** të regjimit pasuror do të kuptojmë jo ndryshimin total të regjimit pasuror, por një ndryshim të pjesshëm të tij⁵⁴³.

Legjislacioni ynë, neni 72/1 i kod.fam, përdor termat **ndryshim tërësor** ose **i pjesshëm** i regjimit pasuror, pa bërë ndonjë diferencim në lidhje me regjimin juridik që i zbatohet. Si në rastin kur kontrata martesore përmban një ndryshim tërësor apo një ndryshim të pjesshëm të regjimit pasuror të mëparshëm, regjimi juridik që i zbatohet ndryshimit të kontratës martesore është i njejtë.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi që, kemi ndryshim të regjimit pasuror martesor në këto raste⁵⁴⁴:

- a) Kontrata martesore nëpërmjet së cilës bashkëshortët zgjedhin një regjim të ri pasuror, duke shfuqizuar në të njëjtën kohë regjimin e mëparshëm kontraktor;
- b) Kontrata martesore nëpërmjet së cilës bashkëshortët kalojnë nga regjimi ligjor i bashkësisë, në një regjim kontraktor të zgjedhur prej tyre;
- c) Kontrata martesore nëpërmjet së cilës bashkëshortët realizojnë disa modifikime të regjimit pasuror kontraktor të mëparshëm, pa e ndryshuar atë tërësisht;
- d) Kontrata martesore nëpërmjet së cilës bashkëshortët modifikojnë disa elementë të caktuar të regjimit ligjor sipas rregullave të parashikuara në nenin 108 të kod.fam.

Klasifikimi i modifikimeve të regjimit pasuror martesor në modifikime të pjesshme apo tërësore, përveç rëndësisë teorike, mbart edhe rëndësi praktike, rëndësi e cila qëndron tek pasojat që sjell në çdo rast modifikimi i regjimit pasuror.

Nëse bashkëshortët zgjedhin të modifikojnë tërësisht kontratën martesore, duke ndryshuar regjimin pasuror martesor, atëherë në varësi të raportit ndërmjet dy regjimeve pasurore, atij ekzistues dhe regjimit të ri, do të vijnë këto pasoja:

⁵⁴⁰ Kodi Civil Francez ka vendosur një kusht të dyfishtë për modifikimin e kontratës martesore: pëlqimin e gjykatës dhe kalimin e afatit 2 vjeçar; ndërsa kodi civil italian, në reformën e vitit 1975, kërkonte si kusht për ndryshimin e kontratës martesore autorizimin e gjykatës. Domosdoshmëria e autorizimit të gjykatës si kusht për ndryshimin e tyre, fillimisht ishte parashikuar në nenin 162/3, i abroguar nga ligji nr. 142/81 i vitit 1981. Tashmë, për ndryshimin e regjimit pasuror martesor është i domosdoshëm vetëm vullneti i të gjithë personave që kanë dhënë pëlqimin në lidhjen e kontratës martesore. Për këtë shih: Galgano, *E drejta private*, fq. 948.

⁵⁴¹ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 158.

⁵⁴² De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 176.

⁵⁴³ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 950.

⁵⁴⁴ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 177-178.

- a) Nëse bashkëshortët kalojnë nga një regjim bashkësie (ligjore/kontraktore) atëherë, modifikimi i kontratës martesore do të sjellë njëkohësisht; ndryshimin e regjimit pasuror për të ardhmen dhe njëkohësisht mbarimin e bashkësisë, sipas nenit 96/c të kod.fam;
- b) Nëse bashkëshortët kalojnë nga regjimi i bashkësisë (ligjore/kontraktore) në regjimin e bashkësisë universale, ose zgjerojnë objektin e bashkësisë, atëherë kontrata e re martesore nuk do të sjellë për pasojë mbarimin e bashkësisë, por bashkësia vazhdon, kuptohet sipas ndryshimeve të reja që bashkëshortët kanë paraqitur⁵⁴⁵;
- c) Nëse bashkëshortët reduktojnë objektin e bashkësisë, atëherë shtrohet çështja nëse, ky ndryshim do të sjellë apo jo si pasojë mbarimin e bashkësisë, vetëm për sendet që janë përjashtuar nga bashkësia.

Si në rastin kur kemi një ndryshim të pjesshëm ashtu dhe kur kemi një ndryshim tërësor të regjimit pasuror, kontrata duhet të lidhet me pëlqimin e njëkohshëm të të dy bashkëshortëve⁵⁴⁶ ose të përfaqësuesve të tyre (përfaqësues me prokurë të posaçme), në formën e aktit noterial dhe të regjistrohët në regjistrin ku është regjistruar akti i martesës. Sipas nenit 72 të kod.fam, bashkëshortët mund të ndryshojnë pjesërisht ose tërësisht regjimin pasuror martesor, ndryshimet duhet të bëhen në të njëjtën formë, që kërkohet për kontratën fillestare.

Si kufizim i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, për të ndryshuar ose modifikuar regjimin pasuror martesor gjatë martesës, ligjvënësi ka vendosur afate kohore. Sipas nenit 72/1 të kod.fam, duhet të kalojnë 2 vjet nga zbatimi i një regjimi pasuror, qoftë ku regjim ligjor ose kontraktor, në mënyrë që bashkëshortëve t'i lindë e drejta e ndryshimit të plotë ose të pjesshëm të tij.

Cila është “*ratio legis*” e vendosjes së këtij kufizimi kohor në drejtim të ndryshimit të regjimit pasuror. Një nga arsytet që mund të kenë shtyrë ligjvënësin në këtë zgjidhje është mbrojtja e interesave të të tretëve që, hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me bashkëshortët. Ndryshimet e shpeshta të regjimit nga ana e bashkëshortëve mund të sjellin paqartësi në marrëdhëniet e tyre me të tretët. Nga ana tjetër, frika e ligjvënësit mund të ketë qenë, se ndryshimi shumë i shpeshtë i regjimit pasuror, mund të përdorej si një mjet për shmangien e përmbushjes së detyrimeve që bashkësia apo ato personalisht kanë ndaj të tretëve. Afati 2 vjeçar është vendosur në funksion të qëndrueshmërisë së marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe në funksion të mbrojtjes së të tretëve dhe konkretisht të kreditorëve të bashkëshortëve.

Gjithashtu, është e rëndësishme të pohojmë që, afati 2 vjeçar zbatohet për çdo ndryshim të regjimit pasuror që realizohet gjatë martesës, edhe nëse gjatë martesës bashkëshortët realizojnë disa modifikime të njëpasnjëshme, të plota apo të pjesshme të kontratës martesore, çdo ndryshim duhet t'i nënshtrohet kushtit të afatit 2 vjeçar. Megjithatë ky përfundim nuk rezulton në mënyrë të shprehur nga teksti i nenit 72/1, është i vetmi interpretim logjik që del nga *ratio* e normës⁵⁴⁷.

Në vazhdim, duhet bërë dallimi ndërmjet termave “*modifikim i regjimit pasuror*” dhe termit “*modifikim i kontratës martesore*”. Jo gjithmonë ndryshimi i kontratës martesore sjell ndryshimin e regjimit pasuror martesor. Ndërsa e kundërta është gjithmonë e vërtetë, nuk ka asnjë mënyrë tjetër të ndryshimit të regjimit pasuror martesor, përveçse nëpërmjet kontratës martesore, me përjashtim të rastit të zbatimit të regjimit të pasurive të ndara, në kushtet e nenit 98 të kod.fam.

⁵⁴⁵ Për pikat a) dhe b) shiko: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 170-171.

⁵⁴⁶ Megjithatë, nuk kanë munguar edhe qëndrime të kundërta në doktrinën shqiptare. Sipas disa autorëve, me mendimin e të cilëve nuk pajtohem, kontrata martesore mund të ndryshojë me vullnetin e vetëm njërit bashkëshort së bashku me autorizimin e gjykatës, autorizim i cili zëvendëson vullnetin e bashkëshortit tjetër, sipas neneve 58 dhe 59 të kod.fam. Për më shumë shih: Mandro-Balili, Arta. *E drejta familjare. Familja, martesa, bashkëshortët*. Botim i parë. Tiranë: Emal, 2009, fq. 224.

⁵⁴⁷ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 163.

Një tjetër çështje që ka vlerë për tu diskutuar është problemi i pasojave që sjell ndryshimi i regjimit pasuror martesor në kontratën martesore mbi marrëveshjet e tjera të bashkëshortëve (psh: dhurimet, marrëveshja për kontributin material) të pasqyruara në kontratën e mëparshme, nëse në kontratën e re, bashkëshortët nuk shprehen për to. Megjithëse mendimi i doktrinës është i ndarë në lidhje me këtë çështje, pjesa me e madhe i gjykon këto marrëveshje të revokuara, nëse bashkëshortët nuk janë shprehur për to në kontratën e mëparshme, duke pranuar që ekziston një vullnet i heshtur për revokimin e tyre; ndërsa pjesa tjetër është e mendimit që këto marrëveshje janë të vlefshme⁵⁴⁸. Në mbështetje të grupit të këtyre autorëve, jemi të mendimit që, këto marrëveshje do të vazhdojnë të sjellin pasoja për palët, sepse ekzistenca e tyre është e pavarur nga ekzistenca e regjimit pasuror martesor, që bashkëshortët kanë ndryshuar nëpërmjet kontratës së re.

Në bazë të paragrafit të parë të nenit 72 të kod.fam. *“bashkëshortët mund të bien dakord, në interes të familjes, për ta ndryshuar pjesërisht ose tërësisht regjimin pasuror martesor...”*. Nuk është shumë e qartë pse ligjvënësi ka parashikuar *“interesin e familjes”* si kriter për ndryshimin e regjimit pasuror martesor.

Në gjykimin tonë, kushte të nevojshme për ndryshimin e regjimit pasuror martesor, përveç konditave të vlefshmërisë së kontratës, të parashikuara në nenin 663 të kod.civ. (pëlqimi i palëve, objekti, shkaku i ligjshëm dhe forma), kushteve të vlefshmërisë së parashikuar në nenin 69 dhe 70 të kod.fam. (pëlqimi i bashkëshortëve dhe mënyra e shfaqjes së vullnetit) është edhe kushti i pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor për një afat 2 vjeçar, i parashikuar në nenin 72 paragrafi i parë i kod.fam. Në vijim të këtij arsyetimi, jemi të mendimit që, nuk mund të kushtëzohet ndryshimi i regjimit pasuror martesor nga interesi i familjes, sepse interesi i familjes është i mbrojtur nga të tjera norma të kod.fam. (kontributi material (neni 54), mbrojtja e banesës familjare (neni 57) dhe përgjegjësia solidare e bashkëshortëve për shpenzimet e familjes (neni 60), të njohura në doktrinë me termin *“regjim primar”*.

Gjithashtu, në këtë kuadër, mbetet e paqartë se si do të vlerësohet *“interesi i familjes”* dhe cilët janë subjektet që do të vlerësojnë dhe mbrojnë këtë interes. Megjithëse nuk gjendet e shprehur në dispozitat e kod.fam. janë vetë bashkëshortët, që do të vlerësojnë jo vetëm interesin e familjes, por edhe interesat e tyre personalë pasurorë, në momentin e ndryshimit të regjimit pasuror martesor.

Nuk pajtohem me mendimin e një pjese të doktrinës shqiptare, sipas së cilës ndryshimi i regjimit pasuror martesor duhet të bëhet vetëm nëse justifikohet nga interesi i familjes, çka duhet të jetë legjitim⁵⁴⁹.

3.10. Rishikimi gjyqësor i kontratës martesore

Bazuar në nenin 690 të kod.civ. kontrata ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjelltë të palëve ose për shkaqe të parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, gjykata është e detyruar të zbatojë kontratën e lidhur mes palëve, nëse plotëson të gjitha kushtet e vlefshmërisë së parashikuara në dispozitat e kod.civ. dhe kod.fam.

Një çështje që shtrohet për diskutim është nëse gjykata ka të drejtë të vendosë moszbatimin e kontratës martesore nëse ajo nuk garanton trajtimin e barabartë të palëve ose është ekonomikisht e pandershme për njërin prej palëve kontraktore⁵⁵⁰.

⁵⁴⁸ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 172.

⁵⁴⁹ Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, *E drejta familjare*, fq. 328; Mandro-Balili, *E drejta familjare. Familja, martesë, bashkëshortët*, fq. 223-226.

⁵⁵⁰ Boele-Woelki, Katharina dhe Jännerä Jareborg, Maarit. “Initial results of the work of CEFL in the field of property relations between spouses.” në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe, (Eds), Cambridhe: Intersentia, 2011, fq. 61.

Bazur në parimin 4:15 të CEFL “Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve”, duke marrë në konsideratë rrethanat në të cilat është lidhur kontrata martesore ose rrethanat që lindin në një moment të mëvonshëm kohor, autoriteti kompetent (gjykata) mundet që në rastin e nevojës së madhe “exceptional hardship”, të refuzojë zbatimin ose të modifikojë kontratën martesore “set aside or adjust”.

Sipas Gjykatës Kushtetuese Gjermane⁵⁵¹ (Bundesverfassungsgericht – BverfG), për arsye kushtetuese, në raste ose rrethana të caktuara kontrata martesore mund të rishikohet nga gjykata. Autonomia e vullnetit, vazhdon më tej arsyetimin e saj BverfG, mbrohet nga Kushtetuta si një e drejtë e individit për vetëpërcaktim ose vetërregullim të interesave të tij, jo vetëm nëpërmjet kontratave në përgjithësi, por edhe atyre martesore në veçanti. Nga njëra anë, duke qenë se kontrata është një vetërregullim i interesave pasurorë të palëve, prezumohet që ajo realizon një balancë të drejtë të interesave të palëve dhe për rrjedhojë duhet të respektohet dhe të zbatohet nga shteti. Nga ana tjetër, sipas BverfG, vetërregullimi i interesave pasurorë, nuk është i detyrueshëm të respektohet nga shteti, nëse si pasojë e një pozite të pabarabartë të palëve është njëra palë që në fakt ka përcaktuar kushtet e kontratës. Për rrjedhojë, në emër të mbrojtjes së vetërregullimit të interesave të tyre, kontrata të cilat nuk janë rezultat i vetërregullimit të palëve nuk gëzojnë të drejtën e zbatimit nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit⁵⁵².

Në vendimin e 6 Shkurtit të vitit 2001, Gjykata Kushtetuese Gjermane vendosi që, kontrata martesore mund të jetë objekt i rishikimit gjyqësor nëse kontrata, në kundërshtim me kornizën ligjore të detyrueshme, në mënyrë të dukshme sjell disavantazhe për njërin nga bashkëshortët, duke i imponuar atij, në mënyrë të njëanshme më shumë detyrime; dhe nëse kontrata nuk është rezultat i një marrëveshje ndërmjet të barabartëve, por reflekton një pozitë dominante të njërit bashkëshort.

Sipas një vendimi tjetër të Gjykatës Kushtetuese Gjermane të 29 Marsit 2001, **“një pozitë e pabarabartë ndërmjet burrit dhe gruas mund të jetë rasti kur kontrata sjell disavantazhe për gruan dhe është lidhur para martesë në lidhje me një shtatëzani të gruas”**. Në këtë rast, gruaja ishte gjendur përpara pozitës së lindjes dhe rritjes së fëmijës e vetme (nënë e pamartuar)⁵⁵³ ose martesës me atin e fëmijës duke pranuar njëkohësisht lidhjen e një kontrate martesore të disfavorshme për të⁵⁵⁴.

Këto dy vendime të Gjykatës Kushtetuese Gjermane kanë detyruar gjykatat gjermane të rishikojnë qëndrimet e tyre liberaliste.

Bazuar në qëndrimin e doktrinës europiane⁵⁵⁵, në ndryshim nga kontratat e tjera duhet lejuar moszbatimi i kontratës martesore nga gjykata, në raste të pandershmërisë, padrejtësisë së një kontrate martesore, sepse kontrata martesore paraqet disa karakteristika në raport me kontratën civile:

a) Në kontratën martesore palët janë emocionalisht të përfshirë njëri me tjetrin dhe kanë besim në marrëdhënien e tyre dhe në të ardhmen e martesës. Ky faktor mund të çojë në anashkalimin ose moskushtimin e vëmendjes së duhur në drejtim të pasojave negative të kontratës martesore.

b) Nuk duhet të anashkalohej influenca që të dy bashkëshortët mund të kenë nga anëtarët e familjeve të tyre.

⁵⁵¹ Për këtë shih: Dutta, “Marital agreements and private autonomy in Germany.” fq. 174.

⁵⁵² Dutta, “Marital agreements and private autonomy in Germany.” fq. 175.

⁵⁵³ Sipas një asyrtimi shtesë të Gjykatës Kushtetuese Gjermane, nënat e pamartuara i nënshtrohen akoma një presioni social dhe vështirësive më të mëdha ekonomike, në raport me nënat e martuara.

⁵⁵⁴ Përmbledhja e këtyre dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Gjermane është marrë nga: Dutta, “Marital agreements and private autonomy in Germany.” fq. 175-176.

⁵⁵⁵ Boele-Woelki, Ferrand, Gonzales Beilfuss, Jänträ-Jareborg, Lowe, Martiny, dhe Pintens, *European Family Law regarding property relations between spouses*, fq. 138.

c) Kontrata martesore është planifikuar për të zgjatur në kohë dhe zakonisht nuk merr në konsideratë ndryshimin e rrethanave në jetën familjare, në të ardhmen, si psh: lindja e një fëmije, sëmundja e një anëtarit të familjes, rrethana që zakonisht detyrojnë njërin bashkëshort (gruan) të lë punën ose të reduktojë të ardhurat e fituara nga puna.

Referuar legjislacionit shqiptar, bazuar në nenin 686/ 2 të kod.civ, gjykata ka të drejtë të deklarojë të pavlefshëm një kusht kontraktor ose të gjithë kontratën (nëse kushti i pavlefshëm është vendimtar për kontratën), nëse kushti ose kontrata sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palëve kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë dhe paañsisë të shprehura në dispozitat e këtij kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktore.

3.11. Pavlefshmëria e kontratës martesore

3.11.1. Klasifikimi i pavlefshmërisë së kontratës martesore

Si çdo veprim tjetër juridik, për kontratën martesore zbatohet sanksioni i pavlefshmërisë, nëse nuk janë respektuar kushtet thelbësore që kërkon legjislacioni për vlefshmërinë e saj. Duke qenë se, kod.fam. nuk rregullon institutin e pavlefshmërisë së kontratës martesore, atëherë rregullat e përgjithshme të kod. civ, mbi pavlefshmërinë e veprimit juridik do të gjejnë zbatim edhe për institutin e kontratës martesore, për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e kod.fam. Problemi i vetëm është të përcaktojmë se cilat janë kufijtë e zbatimit të normave të kod.civ. të pavlefshmërisë së veprimit juridik mbi pavlefshmërinë e kontratës martesore.

Pavlefshmëria e kontratës martesore nuk do të sjellë asnjë ndikim mbi vlefshmërinë ose jo të veprimeve të tjera juridike që gjenden në përmbajtje të kontratës, si psh: dhurimet obnuziale, rregullimi i kontributit material për nevojat e familjes⁵⁵⁶, sepse objekti i kontratës martesore është vetëm rregullimi i regjimit pasuror martesor, dhe për rrjedhojë mbi këto klauzola nuk mund të zbatohet regjimi juridik i kontratës martesore duke përfshirë këtu edhe pavlefshmërinë. Vlefshmëria ose jo e klauzolave atipike të kontratës martesore do të vlerësohet në bazë të normave ligjore ku ato gjejnë rregullim.

Duhet dalluar gjithashtu koncepti i pavlefshmërisë së kontratës martesore nga koncepti i **“paefektshmërisë”** së saj. Ekzistojnë dy forma të paefektshmërisë së kontratës: a) **paefektshmëria absolute**, që vepron si midis palëve ashtu dhe ndaj të tretëve dhe b) **paefektshmëria relative**, që vepron vetëm kundrejt të tretëve (kontrata e pakundërshtueshme ndaj të tretëve)⁵⁵⁷. Moslidhja e martesës sjell paefektshmërinë absolute të kontratës martesore; ajo nuk prodhon pasoja si për palët ashtu edhe për të tretët. Ndërsa, rastin e paefektshmërisë relative të kontratës martesore e ndeshim në hipotezën e mungesës së regjistrimit të saj në regjistrat publikë (regjistri i martesës, regjistri i pasurive të luajtshme dhe regjistri tregtar).

Mund të ndodhë që një kontratë edhe pse e vlefshme, të jetë joefektive ose të mos prodhojë efekte (pasoja ligjore)⁵⁵⁸. Mund të flasim për kontratë martesore pa efekte, vetëm nëse kontrata është e vlefshme por për arsye të ndryshme nuk prodhon efekte juridike për palët, siç ishte rasti, i kontratës martesore të lidhur *ante nuptial*, e cila nuk shoqërohet me lidhjen e martesës⁵⁵⁹. Në këtë eventualitet, kontrata martesore është e vlefshme, nëse ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të vlefshmërisë, por është e paefektshme, pasi nuk është verifikuar *“conditio juris”*, pra lidhja e martesës.

⁵⁵⁶ Tedeschi, “Il regime patrimoniale della famiglia.” fq. 44.

⁵⁵⁷ Galgano, *E drejta private*, fq. 343.

⁵⁵⁸ Galgano, *E drejta private*, fq. 343.

⁵⁵⁹ Për më shumë mbi dallimin e pavlefshmërisë nga paefektshmëria e kontratës shih: Roppo, *Il Contratto*, fq. 688-689.

3.11.2. Shkaqet e pavlefshmërisë së kontratës martesore

Për të evidentuar rastet e pavlefshmërisë së kontratës martesore mund të përdorim disa kriterë klasifikimi.

Nëse si kriter klasifikimi marrim atë të interesit të mbrojtur nga norma që parashikon shkakun e pavlefshmërisë, atëherë do të dallojmë: a) kontratën martesore **absolutisht të pavlefshme** (nul) dhe **kontratën martesore relativisht e pavlefshme** (e anulueshme). Sanksioni i pavlefshmërisë absolute mbron interesat e përgjithshme (interesin e përgjithshëm të shoqërisë, interesin e mbrojtjes së respektimit të kushteve ligjore objektive nën të cilat shprehet autonomia e vullnetit të privatëve), ndërsa sanksioni i pavlefshmërisë relative është parashikuar nga ligji për mbrojtjen e interesave individualë të palëve që marrin pjesë në veprimin juridik, pra të kushteve subjektive nën të cilat realizohet autonomia e vullnetit të subjekteve⁵⁶⁰.

Nëse nisemi nga kriteri i normave ligjore, mosrespektimi i të cilave sjell pavlefshmërinë e kontratës martesore atëherë, rastet e pavlefshmërisë absolute të kontratës martesore i klasifikojmë në tre grupe⁵⁶¹:

A. Shkaqe e pavlefshmërisë së veprimit juridik, të rregulluara në kod.civ. Shkaqe të përgjithshme të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik (neni 92 i kod.civ.⁵⁶²) janë të zbatueshme edhe mbi kontratës martesore, për aq sa janë në përputhje me dispozitat e kod.fam. Këto shkaqe do t'i zbatohen kontratës martesore drejtpërdrejtë ose me analogji. Janë shkaqe të tilla:

- a) Lidhja e kontratës martesore në kundërshtim me normat urdhëruese të kod.civ. dhe kod fam, si mungesa totale e pëlqimit të palëve, shkakun i paligjshëm ose mungesa e shkakut, objekti i paligjshëm, i pamundshëm, i papërcaktuar ose i papërcaktueshëm);
- b) Lidhja e kontratës martesore në mashtrim të ligjit;
- c) Lidhja e kontratës pa pasur për qëllim që të sjellë pasoja ligjore ndërmjet bashkëshortëve (psh: me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve personale ose atyre të bashkësisë).

B. Shkaqe që lidhen me mosrespektimin e normave ligjore urdhëruese të kod.fam. që rregullojnë kontratën martesore, në përgjithësi. Janë raste specifike të pavlefshmërisë absolute të kontratës martesore, ato shkaqe që lidhen me mosrespektimin e dispozitave urdhëruese të kod.fam. që rregullojnë kontratën martesore:

- a) Mosrespektimi i formës së aktit noterial të parashikuar nga kod.fam (neni 69/1 kod.fam.);
- b) shprehja e vullnetit të bashkëshortëve ose përfaqësuesve të tyre jo në mënyrë simultane (nënshkrimi i kontratës para noterit në data të ndryshme nga bashkëshortët (neni 69/1 kod.fam.);
- c) Lidhja e kontratës martesore nga bashkëshorti i mitur (neni 70 i kod.fam.);
- d) Lidhja e kontratës martesore në shkelje të nenit 67 të kod.fam. (të drejtat e pashmangshme), në rastin kur shmangia nga këto të drejta është arsyeja e lidhjes së kontratës martesore, në të kundërt, pavlefshmëria do të prekë vetëm klauzolën që vjen në kundërshtim me ligjin;

⁵⁶⁰ Roppo, *Il Contratto*, fq. 713.

⁵⁶¹ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 45.

⁵⁶² Sipas nenit 92 të kod.civ: "Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla, janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të miturit nën moshën 14 vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive apo të simuluar).

- e) Ndryshimi i regjimit pasuror martesor, pa kaluar 2 vjet nga zbatimi i tij (neni 72/2 kod.fam)⁵⁶³.

C. Shkaqe që lidhen me shkeljen e normave ligjore urdhëruese, që i referohen konkretisht kontratës së lidhur mes palëve. Mund të identifikojmë shkaqe të tjera të pavlefshmërisë absolute të kontratës martesore të cilat lidhen konkretisht me regjimin pasuror të zgjedhur nga palët për zbatim. Do të jetë e pavlefshme kontrata martesore nëpërmjet së cilës bashkëshortët vendosin:

- a) Ndryshimin e rregullave të administrimit ligjor (neni 108/b);
- b) Zgjerimin e objektit të bashkësisë duke përfshirë sendet e përdorimit ngushtësisht vetjak, mjetet e ushtrimit të profesionit, ose shpërblimin e dëmit vetjak (ndalime të cilat parashikohen në nenin 109, paragrafi dytë dhe nenin 114/1 të kod.fam. ndryshimi i rregullit të përmbushjes solidare të detyrimeve që rrjedhin nga martesja, në derogim të nenit 60 të kod.fam (neni 115, paragrafi dytë i kod fam);
- c) Shmangien nga regjimi juridik i disponimit të banesës familjare me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, në rastin e regjimit të pasurive të ndara;
- d) Shmangien nga përgjegjësia solidare për detyrimet mbi familjen dhe fëmijët, në regjimin e pasurive të ndara;
- e) Shmangien nga detyrimi i përmbushjes së kontributit material për nevojat e familjes.

Këto shkaqe të sipërpërmendura do të sjellin pavlefshmërinë e të gjithë kontratës martesore ose vetëm të klauzolës së veçantë, që vjen në kundërshtim me ligjin⁵⁶⁴. Nëse kontrata martesore përmban një dispozitë në shkelje të të drejtave të pashmangshme ose në shkelje të nenit 114/1, shkelja e këtyre dispozitave urdhëruese mund të çojë në pavlefshmërinë e kontratës martesore ose në pavlefshmërinë e dispozitës përkatëse⁵⁶⁵. Nuk ka asnjë arsye për të mos u zbatuar edhe në këtë rast parimi “*utile per inutile non vivatur*”, nisur nga fakti që, kontrata martesore në thelb është një akt autonomie private⁵⁶⁶.

Në zbatim të nenit 94 të kod.civ, kontrata martesore është absolutisht e pavlefshme nëse, në momentin e lidhjes së saj, vullneti i bashkëshortëve ka qenë i vesuar për shkak të lajthimit, kanosjes ose mashtrimit ose në kushtet e nevojës së madhe; nëse është lidhur nga një person të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjykate, ose është lidhur nga personi që në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishte i ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimit të kryer.

3.11.3. Pavlefshmëria e pjesshme e kontratës martesore

Sipas një tjetër kriteri klasifikimi, bazuar mbi faktin nëse shkelja e dispozitave urdhëruese të ligjit, sjell pavlefshmërinë e të gjithë kontratës martesore apo vetëm të një pjese të saj, pavlefshmëria e kontratës martesore klasifikohet në:

- a) **Pavlefshmëria e të gjithë kontratës martesore**, të cilën e trajtuam më sipër;
- b) **Pavlefshmëria e pjesshme** e kontratës.

Konkretisht, në rasti kur në përmbajtje të kontratës martesore gjenden klauzola në shkelje të normave urdhëruese të kod.fam. (normat të cilat në bazë të neneve 59 dhe 67 nuk mund të

⁵⁶³ Ka diskutime në doktrinë nëse me kalimin e afatit 2 vjeçar kontrata martesore bëhet sërish e vlefshme. A mund të shërbejë kalimi i afatit dy vjeçar një rast të asgjësimit të shkakut të pavlefshmërisë së kontratës. Në gjykimin tonë, kontrata martesore nuk mund të bëhet më e vlefshme. Regjimi i asgjësimit të shkakut të pavlefshmërisë zbatohet vetëm në eventualitetin e rregullimit *expressis verbis* nga ligji.

⁵⁶⁴ Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 45.

⁵⁶⁵ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 494.

⁵⁶⁶ Carnevali, “Le convenzioni matrimoniali.” fq. 45.

derogohen), shtrohet problemi nëse pavlefshmëria e këtyre klauzolave do të sjellë njëkohësisht edhe pavlefshmërinë e kontratës martesore.

Së pari, duhet theksuar që, klauzola të tilla të cilat shmangin nga të drejta dhe detyrime të cilat, për nga rëndësia që kanë për marrëdhënien familjare, ligji i ka konsideruar të pashmangshme, janë absolutisht të pavlefshme, sepse bien në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit⁵⁶⁷.

Së dyti, për t'i dhënë përgjigje problemit të paraqitur më sipër, nga doktrina është sugjeruar përdorimi i kriterit të rëndësisë që ka pasur për palët klauzola e pavlefshme në lidhjen e kontratës martesore⁵⁶⁸, natyra juridike e klauzolës⁵⁶⁹ si dhe qëllimit që kanë ndjekur palët në momentin e lidhjes së kontratës⁵⁷⁰. Nuk ka arsye pse, parimi "*utile per inutile non viuiatur*", i parashikuar në kod.civ, të mos gjejë zbatim edhe për pavlefshmërinë e kontratës martesore⁵⁷¹, nisur nga fakti që, kontrata martesore në thelb është një akt autonomie private (veprim juridik). Në këtë kuptim duhet hetuar nëse palët pa klauzolën e pavlefshme njëlloj do ta kishin lidhur kontratën martesore apo klauzola e pavlefshme ka luajtur një rol determinant (përcaktues) në kontratën martesore të lidhur nga palët.

Nëse përgjigja është pozitive, pra palët do ta kishin lidhur kontratën martesore pavarësisht nga prania ose jo e klauzolës së pavlefshme, atëherë arrijmë në dy përfundime: *së pari*, kontrata martesore është e vlefshme dhe *së dyti*, jemi përpara rastit të pavlefshmërisë së pjesëshme⁵⁷² të veprimit juridik dhe për rrjedhojë pavlefshmëria e klauzolës deroguese nuk do të ndikojë në pavlefshmërinë e kontratës martesore.

Ndërsa, nëse përgjigja është negative, pra nëse palët nuk do ta kishin lidhur kontratën martesore në mungesë të klauzolës së pavlefshme, arrijmë në dy përfundime të tjera, të ndryshme nga të parat: *së pari*, kontrata martesore është absolutisht e pavlefshme, sepse bie në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, për rrjedhojë për ligjin ajo nuk ka ekzistuar kurrë dhe; *së dyti*, marrëdhëniet pasurore të palëve do të rregullohen nga regjimi i bashkësisë ligjore, me efekt prapaveprues, që nga momenti i lidhjes së kontratës martesore.

Klauzola e pavlefshme do të zëvendësohet nga norma urdhëruese e ligjit.

3.12. Zbatimi i padisë pauliane

Padia e kundërshtimit të veprimeve juridike të debitorit është një mjet garancie e përgjithshme e kreditorit mbi pasurinë e debitorit⁵⁷³, nëpërmjet së cilës kreditori ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e atyre veprimeve juridike të kryera nga debitori me persona të tretë, të cilat pakësojnë pasurinë e këtij të fundit (debitorit)⁵⁷⁴.

Duke qenë se rregullat e përgjithshme të kod.civ, zbatohen edhe për kontratën martesore, për aq sa janë në përputhje me natyrën juridike të saj dhe nuk ka një rregullim specifik në kod.fam, atëherë mund të pohojmë që, padia pauliane (padia e kundërshtimit të veprimeve juridike të debitorit) gjen zbatim edhe në rastin e kontratës martesore. Kreditorët e njërit prej

⁵⁶⁷ Neni 92 i kod.civ: "Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që:

a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit"

⁵⁶⁸ Corsi, "Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa." fq. 11.

⁵⁶⁹ Zaka, "Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare." fq.15.

⁵⁷⁰ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 146.

⁵⁷¹ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 45.

⁵⁷² Neni 111 i kod.civ: "*Kur shkaku i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveçse kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik*".

⁵⁷³ Ragazzini, *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*, fq. 25.

⁵⁷⁴ Rregulluar nga neni 607 i Kodit Civil të RSH.

bashkëshortëve ose kreditorët e bashkësisë kanë të drejtë të kërkojnë pavlefshmërinë e kontratës martesore, nëse plotësohen kushtet ligjore të parashikuara nga neni 607 i kod.civ.

Si rregull i përgjithshëm, ose të paktën në pjesën më të madhe të rasteve, kontrata martesore rregullon të ardhmen e gjendjes pasurore të bashkëshortëve, ose e thënë ndryshe rregullon regjimin juridik të sendeve që do të fitohen nga bashkëshortët pas lidhjes së kontratës, (psh: kontrata martesore e cila i vendos bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara ose regjimin e bashkësisë universale për të ardhmen). Në këtë rast nuk mund të flasim për zbatimin e padisë pauliane nga kreditorët e bashkëshortëve, sepse nuk plotësohet një nga kushtet e padisë pauliane, që është pakësimi i pasurisë së debitorit, me qëllim shmangien nga përbushja e detyrimit, sepse kontrata në këto raste nuk sjell ndryshimin e gjendjes juridike të pasurisë ekzistuese të bashkëshortëve, por vetëm të asaj që do të fitohet nga të dy apo secili prej tyre në të ardhmen⁵⁷⁵. Sipas doktrinës italiane, është shumë e vështirë, në mos gati e pamundur, ushtrimi i padisë pauliane, sepse duket që të paktën kreditori të provojë që kontrata programatike është lidhur nga bashkëshortët me qëllim që të përjashtojë një kategori të caktuar pasurish nga bashkësia, për të shmangur përbushjen e detyrimeve ndaj kreditorëve të ardhshëm⁵⁷⁶.

Por nga ana tjetër, nëse me anë të kontratës martesore bashkëshortët vendosin të rregullojnë regjimin juridik të sendeve që janë në pronësi të tyre deri në datën e lidhjes së kontratës, duke ndryshuar gjendjen juridike të sendeve që ato kanë në pronësi, ose i japin kontratës martesore efekte prapavepruese, atëherë patjetër që kreditorët e tyre personalë ose kreditorët e bashkësisë kanë të drejtë të mbrohen nëpërmjet padisë pauliane. Sepse, këto kontrata martesore kanë natyrë dispozitive, janë veprime juridike që realizojnë transferimin e pronësisë së sendeve, pa kundërshtim dhe mund të sjellin zvogëlimin e pasurisë së bashkëshortit debitor ose të bashkësisë debitore, me qëllim shmangien e përbushjes së detyrimit⁵⁷⁷. Për ilustrim mund të marrim rastin kur bashkëshortët nxjerrin nga bashkësia një send që më parë i përkiste bashkësisë, duke e kaluar në pronësinë vetjake të njërit bashkëshort, me qëllim zvogëlimin e pasurisë së bashkësisë, ose kur vendosin të kalojnë një send të caktuar nga send në pronësi ekskluzive të njërit bashkëshort në send në pronësi të bashkësisë (zgjerojnë objektin e bashkësisë). Në rastin e parë, kreditori personal të njërit bashkëshort është i dëmtuar nga ky veprim, për shkak se ai nuk mund të kërkojë më shitjen e detyruar të të gjithë sendit, me qëllim realizimin e së drejtës së tij, përkundëjt bashkëshortit debitor, por mund të kërkojë vetëm shitjen e detyruar të ½ pjesë të sendit, që është në pronësi të bashkëshortit debitor, në cilësinë e bashkëpronarit të bashkësisë, sepse ½ pjesë e sendit i përket në bashkëpronësi bashkëshortit tjetër dhe mbi të kreditori nuk ka asnjë të drejtë. Arsyetim analog mund të bëjmë edhe për rastin e dytë, kur bashkëshortët nxjerrin sendin nga bashkësia dhe e kalojnë atë në pronësi të njërit prej bashkëshortëve.

Në këto raste, kreditori i bashkësisë ose kreditori personal i njërit prej bashkëshortëve ka të drejtë të mbrohet nëpërmjet padisë së kundërshtimit të veprimeve juridike të debitorit, duke kërkuar pavlefshmërinë e kontratës martesore.

Kreditorët e bashkëshortëve ose të bashkësisë janë të vetmit titullarë të padisë pauliane. Nuk gëzojnë të drejtën e padisë kreditorët e siguruar me hipotekë ose peng, për kundërshtimin e veprimit juridik me të cilin debitori nxjerr nga pasuria e tij sendin mbi të cilin rëndon pengu ose hipoteka⁵⁷⁸, për arsye se kreditori nuk mund të mbrojë të drejtën e tij në këtë rast, por nuk mund ta mbrojë atë me padinë pauliane, sepse në rastin në fjalë kreditori gëzon mbi sendin e lënë peng apo në hipotekë, të drejtën e ndjekjes së sendit⁵⁷⁹.

⁵⁷⁵ Corsi, "Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa." fq. 57.

⁵⁷⁶ Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." fq. 47.

⁵⁷⁷ Galletta, "La comunione convenzionale." fq. 1065.

⁵⁷⁸ Ragazzini, *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*, fq. 26.

⁵⁷⁹ Është karakteristikë e të drejtave reale, gëzimi nga titullari i tyre i të drejtës së ndjekjes së sendit.

Subjekt i paditur do të jetë bashkëshorti debitor, nëse detyrimi është vetjak i këtij bashkëshorti; ose të dy bashkëshortët, në cilësinë e bashkëpronarëve, nëse debitore është bashkësia.

Është kusht i domosdoshëm që të ekzistojë “*consilium fraudis*” apo “*animus nocendi*”⁵⁸⁰ i debitorit, qëndrimi subjektiv i debitorit ndaj veprimit juridik të kryer, që nuk është gjë tjetër veçse qëllimi i tij për t’u shmangur nga përmbushja e detyrimit. Kontrata martesore duhet të lidhet nga bashkëshortët me qëllim pakësimin e pasurisë, për të shmangur përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Detyrimi i bashkësisë ose i njërit prej bashkëshortëve duhet të ketë lindur më parë në kohë, në raport me datën e lidhjes së kontratës martesore. Nëse detyrimi ka lindur më vonë në raport me datën e lidhjes së kontratës martesore, atëherë nuk mund të kërkohet pavlefshmëria e kontratës martesore.

Gjatë gjykimit të padisë, barra e të provuarit të kushteve objektive dhe subjektive, ndahet ndërmjet palëve: kështu kreditori duhet të provojë, ekzistencën e detyrimit, “*consilium fraudis*”, pra qëllimin e debitorit dhe “*eventus damni*”; ndërsa debitori duhet të provojë që detyrimi nuk ekziston ose është shlyer, ose nëse detyrimi ekziston duhet të provojë mungesën e “*eventus damni*” dhe të “*consilium fraudis*”; ndërsa personi i tretë, që në rastin konkret është bashkëshorti tjetër duhet të provojë “*mirëbesimin*”⁵⁸¹, mungesën e dijenisë⁵⁸².

Karakteristikë e padisë pauliane është se, deklarimi i pavlefshmërisë ka efekte vetëm kundrejt kreditorit që ka ngritur padinë dhe jo kundrejt personave të tjerë, përfshirë këtu edhe kreditorët të cilët nuk e kanë ngritur këtë padi. Veprimi juridik anulohet vetëm për atë që janë dëmtuar interesat e kreditorit dhe jo për pjesën tjetër, sepse padia pauliane nuk është padi reale, por është një padi personale e kreditorit⁵⁸³.

⁵⁸⁰ Ragazzini, *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*, fq. 28.

⁵⁸¹ Një kusht tjetër është ekzistenca e keqbesimit të personit të tretë. Personi i tretë është subjekti më të cilin debitori ka realizuar veprimin juridik të disponimit të pasurisë, veprim për të cilin kërkohet pavlefshmëria. Bazuar në nenin 607 të kod.civ, nëse veprimi juridik është me kundërshtpërblim, personi i tretë prezuohet që është në mirëbesim, dhe i takon kreditorit të provojë keqbesimin e tij. Në hipotezën e kontratës martesore, person i tretë do të jetë gjithmonë bashkëshorti tjetër, i cili bazuar në paragrafin e dytë të nenit 607 të kod.civ., prezumohet që është në “keqbesim”.

⁵⁸² Ragazzini, *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*, fq. 34.

⁵⁸³ Nuni, Ardian. “Padia Pauliane – Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit (Neni 607 i Kodit Civil).” *Revista Studime Juridike*, Nr. 1/2002, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë: Tetor 2002, fq. 61- 62.

KAPITULLI IV

REGJIMI I BASHKËSISË ME KONTRATË

4.1. Pluraliteti i regjimeve pasurore të rregulluara në Kodin e Familjes

Kodi aktual i Familjes parashikon një pluralitet regjimesh pasurore. Është e pamundur të flasim vetëm për një **“regjim pasuror martesore”**, ndërsa më korrekte do të ishte përdorimi i termit **“regjime pasurore martesore”**. Bazuar në kriterin e burimit të krijimit, regjimet pasurore martesore klasifikohen në: a) **regjime ligjore** (regjimi i bashkësisë dhe regjimi i pasurive të ndara në hipotezën e nenit 98 të kod.fam) dhe b) **regjime kontraktore**.

Regjimi pasuror ligjor i parashikuar në kod.fam. është një regjim bashkëpronësie, i quajtur **“bashkësia ligjore”**. Regjimi i bashkëpronësisë së bashkëshortëve mbi pasurinë e fituar gjatë martesës e gjen rregullimin e tij të parë në Kodin Napoleon, i cili nga e huazoi këtë regjim nga e drejta zakonore e Parisit **“coutumes de Paris”**. Regjim i bashkësisë i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e gruas dhe mbështetjet në parimin që progresi ekonomik i burrit i dedikohet edhe kontributit material dhe shpirtëror (në natyrë) të gruas⁵⁸⁴.

Sipas një teorie, që nuk ka gjetur aspak mbështetje në doktrinën juridike, regjimi ligjor i bashkësisë përfaqëson në vetvete një regjim kontraktor dhe jo një regjim ligjor, sepse zbatimi i tij varet nga vullneti i bashkëshortëve për të mos lidhur kontratë martesore. Në vazhdim të këtyre argumenteve, në rastin e zbatimit të regjimit pasuror ligjor të bashkësisë, vullneti i bashkëshortëve ekziston, por ai është shprehur në mënyrë të heshtur, nëpërmjet moslidhjes së kontratës martesore.

Teoria e paraqitur më sipër jo vetëm që nuk ka gjetur mbështetje në doktrinë, por është mjaft e kritikuar. Sipas kritikës së një autori italian, **“heshtja”** ka vlerën e shprehjes së vullnetit, vetëm kur ligji shprehimisht i njeh pasoja juridike heshtjes⁵⁸⁵. Në raste kur ligji i njeh pasoja qëndrimit në heshtje të palëve të një veprimi juridik, e bën këtë jo sepse palët kanë qëndruar në heshtje, por sepse ato nuk kanë refuzuar shprehimisht një propozim që i është bërë. Në pjesën më të madhe të rasteve, regjimi ligjor i bashkësisë gjen zbatim jo sepse bashkëshortët kanë shprehur një vullnet heshtësor për zbatimin e tij, nëpërmjet moslidhjes së një kontrate martesore, por sepse bashkëshortët madje injorojnë plotësisht mundësinë e rregullimit kontraktor të marrëdhënieve të tyre pasurore, në momentin e lidhjes së martesës⁵⁸⁶ si dhe në rastet kur kontrata martesore është e pavlefshme.

Nga analiza e dispozitave të kod.fam, rezulton që dy janë skemat tipike të regjimeve pasurore kontraktore⁵⁸⁷:

- a) **Regjimi i pasurive të ndara**, i cili konsiston në përjashtimin e zbatimit të regjimit të bashkësisë ligjore;
- b) **Regjimi i bashkësisë me kontratë**, i cili përfaqëson një modifikim të regjimit pasuror ligjor dhe për rrjedhojë ka një përmbajtje aq të gjerë sa mund të jenë mundësitë e modifikimit të bashkësisë ligjore.

Duhet evidentuar që, edhe në rast të një regjimi bashkësie ligjore/ me kontratë, regjimi i pasurive të ndara bashkekziston gjithmonë me regjimin e bashkësisë, madje edhe në rastin e

⁵⁸⁴ Galgano, *E drejta private*, fq. 496-497.

⁵⁸⁵ Depingente, Romana P. “Autonomia dei coniugi e mutamento del regime patrimoniale legale.”, *Rivista del diritto civile II*, Padova: CEDAM, 1980, fq. 520-521.

⁵⁸⁶ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 4-5.

⁵⁸⁷ Russo, “L'autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 492.

bashkësisë universale, bashkësia nuk mund të përfshijë në asnjë rast të gjithë sferën pasurore të bashkëshortëve, për shkak të ndalimeve të shprehura që parashikon neni 114/1 i kod.fam⁵⁸⁸.

4.2. Natyra juridike e regjimit të bashkësisë me kontratë

Në doktrinë ekziston një debat i ndezur lidhur me natyrën juridike dhe klasifikimin shkencor të regjimit të bashkësisë me kontratë.

Një pjesë e doktrinës e klasifikon regjimin e bashkësisë me kontratë në një kategori më vete nga bashkësia ligjore duke i njohur këtij regjimi *karakterin autonom*, të ndryshëm nga bashkësia ligjore, ndërsa një pjesë tjetër e doktrinës është e mendimit që bashkësia me kontratë nuk përfaqëson një regjim pasuror krejtësisht të ndryshëm nga ai i bashkësisë ligjore, por përfaqëson një bashkësi ligjore të modifikuar⁵⁸⁹, pra një modifikim të regjimit ligjor.

Përveç vlerave teorike, ky debat ka edhe vlera praktike, në drejtim të përcaktimit të disiplinës ligjore të zbatueshme mbi regjimin e bashkësisë me kontratë. Autorët, të cilët mbështesin tezën e bashkësisë me kontratë si një modifikim të bashkësisë ligjore pohojnë që, rregullat e bashkësisë ligjore janë të zbatueshme drejtpërdrejtë edhe për bashkësinë me kontratë, pa qenë nevoja e parashikimit nga palët, për ato elementë që nuk gjejnë rregullim në kontratë. Ndërsa, autorët e grupit të parë, të cilët mbështesin tezën e regjimit autonom shprehen që, rregullat e bashkësisë ligjor do të gjejnë zbatim në bashkësinë për me kontratë, vetëm nëse kjo mundësi është parashikuar shprehimisht nga palët në kontratë ose vetëm nëse pas procesit të interpretimit sistematik të klauzolave të kontratës, nuk evidentohet që ato shkojnë në një drejtim të ndryshëm nga dispozitat ligjore dhe vetëm për ato elementë që nuk gjejnë rregullim në kontratën martesore⁵⁹⁰.

Sipas një autori italian, bashkësia me kontratë nuk është një regjim pasuror autonom, por është një mënyrë e veçantë e shprehjes së regjimit ligjor të bashkësisë. Argumentet mbi të cilat ky autor e bazon mendimin e tij janë analiza e dispozitave të kod.fam. (ato korresponduese të KC Italian) mbi bashkësisë ligjore. Nëse lexojmë titullin *“Bashkësia me kontratë”* e Kreut të III, Titulli III të kod.fam, atëherë mund të pohojmë që, bashkësia me kontratë është një regjim pasuror autonom, përderisa rregullohet nga një sistem autonom normash, në raport me bashkësinë ligjore. Megjithatë, për të nxjerrë një përfundim më të qartë duhet të ndalemi në përmbajtjen e këtij kreu. Neni 108 i kod. fam. fillon me fjalët e mëposhtme: *“Bashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të ndryshojnë bashkësinë ligjore me marrëveshje, e cila nuk mund të vijë në kundërshtim ...”*. Nga leximi i kësaj dispozite mund të deduktojmë që, nëpërmjet bashkësisë ligjore, bashkëshortët nuk zgjedhin një regjim të ri pasuror, por thjesht modifikojnë elementë të caktuar të regjimit ligjor të bashkësisë. Për rrjedhojë, vazhdon arsyetimin i njëjti autor, normat rregulluese të bashkësisë ligjore do të zbatohen mbi bashkësinë me kontratë, jo për shkak të vullnetit të palëve kontraktore, por për shkak të ligjit, sepse zbatimi i tyre nuk përjashtohet për shkak të modifikimit kontraktor të bashkësisë ligjore. Vullneti i palëve shfaqet vetëm në derogimin e një ose disa elementëve të regjimit ligjor të bashkësisë⁵⁹¹.

Ndërkohë një grup tjetër autorësh, nisur nga rregullimi i veçantë i regjimit të bashkësisë me kontratë në raport me regjimin ligjor si dhe duke u nisur nga fakti që, regjimi ligjor i bashkësisë përfaqëson një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe gjen zbatim vetëm në mungesë të një

⁵⁸⁸ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 498.

⁵⁸⁹ Giunchi, Paolo. “Brevi note sulla, autonomia private dei coniugi nei rapporti familiari.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Arceri, M. Bernardini (Eds.): Maggiolino Ed., 2009, fq. 41. Gjithashtu pro të njëjtit argument është: Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 503.

⁵⁹⁰ Ieva, “Le convenzioni matrimoniali”, fq. 54-65.

⁵⁹¹ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 503. Në mbështetje të këtij mendimi gjithashtu është: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 561.

marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, arrijnë në përfundimin që, regjimi i bashkësisë me kontratë është një regjim autonom dhe jo thjesht një modifikim kontraktor i regjimit ligjor të bashkësisë⁵⁹². Në vijim të këtij qëndrimi, ky grup autorësh, shprehet se pavarësisht karakterit autonom, regjimi ligjor mbetet gjithmonë një pikë referimi për regjimin e bashkësisë me kontratë, për rregullimin e atyre elementëve që palët kanë lënë të parregulluara ose të atyre elementëve që nuk gjejnë zgjidhje pavarësisht interpretimin sistematik të kontratës martesore⁵⁹³. Për një vështrim kritik ndaj këtij qëndrimi mund të themi që vërtet regjimi ligjor i bashkësisë gjen zbatim vetë në mungesë të një kontrate martesore, por nga ana tjetër, i vetmi regjim që mundëson plotësisht eliminimin e zbatimit të regjimit ligjor është regjimi kontraktor i pasurive të ndara⁵⁹⁴.

Sipas një tjetër arsytimi, të gjitha regjimet pasurore klasifikohen në regjime të pasurive të ndara dhe regjime bashkësie dhe nuk ekziston një regjim që të paraqesë karakteristika krejtësisht të ndryshme nga regjimi i bashkësisë ose ai i pasurive të ndara⁵⁹⁵. Por kjo nuk do të thotë që nuk ka një ekzistencë të pavarur ndërmjet regjimeve të ndryshme të bashkësisë. I vetmi regjim që bën kombinimin e regjimit të pasurive të ndara me regjimin e bashkësisë, është ai i pjesëmarrjes në fitime, sipas së cilit bashkëshortët gjatë martesës ruajnë pronësinë dhe të drejtën ekskluzive të administrimit të pasurisë së fituar gjatë martesës, por në përfundim të martesës, pasuria që është fituar gjatë saj nëpërmjet punës së bashkëshortëve, futet në bashkësi dhe për rrjedhojë i nënshtrohet pjesëtimit.

Debati, i paraqitur më sipër, ekziston për shkak të terminologjisë së paqartë të përdorur nga kod.fam. Nga leximi i dispozitave të kod.fam. do të rezultojnë që, nga pikëpamja e rregullimit sistematik, regjimi i bashkësisë me kontratë gjendet në një kre të veçantë në kodin e familjes, më vetë nga regjimi i bashkësisë ligjore, konkretisht Kreu III i Titullit III, të titulluar **“Bashkësia me kontratë”**. Emërtimi i këtij kreu, të le të mendosh që, ligjvënësi e ka parashikuar regjimin e bashkësisë me kontratë si një regjim alternativ përkundërt atij të bashkësisë ligjore, i zbatueshëm nëpërmjet kontratës martesore⁵⁹⁶.

Por, nëse menjëherë pas Titullit të III, të Kreut të III të kod.fam, lexojmë tekstin e nenit 108 (dispozita e parë e kreut) atëherë, duhet të hedhim poshtë përfundimin e arritur më sipër, sepse nga mënyra e formulimit të kësaj dispozite duket sikur ligjvënësi i ka dhënë bashkëshortëve, vetëm të drejtën e modifikimit të bashkësinë ligjore dhe jo të drejtën për të krijuar një regjim bashkësie tërësisht të ndryshëm nga bashkësisë ligjore⁵⁹⁷.

Ka të tjerë autorë që, duke kombinuar dy qëndrimet e mësipërme, kanë përpunuar një tezë të re sipas së cilës, bazuar në autonominë e gjerë që kod.fam i ka njohur bashkëshortëve, në fushën e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të tyre, ata mund të realizojnë nëpërmjet kontratës martesore disa modifikime të thjeshta të regjimit ligjor të bashkësisë ose mund të zgjedhin të zbatojnë një regjim bashkësie me kontratë që është tërësisht i ndryshëm nga regjimi i bashkësisë ligjore⁵⁹⁸.

⁵⁹² Pittalis, Margherita. “Modifiche convenzionali alla comunione dei beni.” në *Il regime patrimoniale della famiglia. Vol. III*, F. Anelli, M. Sesta (Ed.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq.524-525, Corsi, “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa.” fq. 73

⁵⁹³ Corsi, “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa.” fq. 10-11.

⁵⁹⁴ Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1043.

⁵⁹⁵ Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 54.

⁵⁹⁶ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 286-287.

⁵⁹⁷ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 286-287.

⁵⁹⁸ Galasso, Alfredo. dhe Tamburello, Mimma. “Del regime patrimoniale della famiglia I.” në *Commentario del c.c. Scialoja-Branca*, Bologna: Zanichelli Editore, 1999, fq. 783. Apud: De Paola-Macri, *Il nuovo diritto patrimoniale della famiglia*.

Sipas të njëjtit autori, pavarësisht nëse bashkëshortët zgjedhin një regjim bashkësie me kontratë, të ndryshëm nga regjimi ligjor, ose nëse realizojnë vetëm disa modifikime të regjimit ligjor të bashkësisë, ata nuk mund të shmangin zbatimin e **“regjimit primar”** (nenet 54, 65, 67, 108, 109 dhe 114 të kod.fam)⁵⁹⁹.

Në analizë të fundit, teza e cila duket më bindëse është teza e përpunuar nga grupi i fundit i autorëve. Bashkësia e rregulluar nga neni 108 i kod.fam përcakton shkallën e fleksibilitetit që kanë palët ndaj regjimit ligjor. Bashkësia me kontratë, e rregulluar në nenin 108 të kod.fam. nuk përbën një regjim pasuror autonom, por përfaqëson një modifikim të regjimit të bashkësisë ligjore⁶⁰⁰. Për rrjedhojë, në rregullimin e regjimit të bashkësisë me kontratë mbeten të zbatueshme, për të gjitha pikat që nuk janë objekt i kontratës, rregullat e bashkësisë ligjore (regjimi juridik i bashkësisë ligjore)⁶⁰¹. Nga ana tjetër, bazuar në parimin e autonomisë së vullnetit të njohur bashkëshortëve nga neni 66 i kod.fam dhe neni 660 i kod.civ, bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin një regjim bashkësie me kontratë të ndryshëm nga regjimi i bashkësisë ligjore dhe nga modelet e regjimit të bashkësisë me kontratë të parashikuar nga nenet 108-122 të kod.fam. Në këtë hipotezë të fundit do të ishim para një regjimi bashkësie me kontratë autonom, të pavarur nga regjimi ligjor.

4.3. Konsiderata të përgjithshme mbi bashkësinë me kontratë

Kod.fam i ka njohur bashkëshortëve të drejtën e modifikimit të regjimit të bashkësisë ligjore duke e përshtatur atë me interesat e tyre pasurore dhe nevojat e familjes. Zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore mund të realizohet nëpërmjet kontratave martesore me natyrë programatike, në të cilat bashkëshortët përfshijnë në bashkësi kategori sendesh të cilat do të fitohen në të ardhmen nga secili prej tyre, ose nëpërmjet kontratave me natyrë dispozitive, nëpërmjet të cilave bashkëshortët vendosin të përfshijnë në bashkësi sende të veçanta (të individualizuara)⁶⁰².

Në këtë drejtim, nenet 108-114 të kod.fam. orientojnë vullnetin e bashkëshortëve në drejtim të modifikimit të disa elementëve të bashkësisë ligjore, në drejtim të zgjerimit apo ngushtimit të objektit të saj, të ndryshimit të rregullave të administrimit dhe ndryshimit të pjesëve takuese. Ligjvënësi është treguar i kujdesshëm në mbrojtjen e pozitës së personave të tretë, të cilët gëzojnë të drejta apo kanë marrë përsipër detyrime ndaj bashkësisë, duke përcaktuar rregulla të qarta për mënyrën e përmbushjes së detyrimeve që bashkësia ka ndaj të tretëve.

A. Pavarësisht shkallës së zgjerimit të objektit të bashkësisë ligjore, bashkëshortë duhet t'i përmbahen gjithmonë **limiteve të përgjithshme** të parashikuara në nenet 66 dhe 67 të kod.fam. Bazuar në nenin 108 të kod.fam, marrëveshja e bashkëshortëve, që ka për objekt ndryshimin e bashkësisë ligjore, nuk duhet të vijë në kundërshtim me nenet 66 dhe 67 të kod.fam.

B. Paragrafi i parë i nenit 108 përdor termin **marrëveshje** dhe jo **kontratë**, ndërkohë që emërtimi i Kreut të III, Titulli III, në përmbajtjen e të cilit gjendet kjo dispozitë përdor termin “kontratë”. Të njëjtin dyzim të termave, rikujtojmë këtu, evidentohet edhe në nenin 66 të kod.fam.

Kjo terminologji e dyzuar e kod.fam me termat “kontratë” dhe “marrëveshje” nuk sjell probleme në praktikë. Është e kuptueshme që, neni 108 i referohet kontratës martesore, por për një koherencë më të madhe ndërmjet normave, duhet që ligjvënësi të kishte përdorur të njëjtën terminologji. Termi më i saktë, nga pikëpamja ligjore, do të ishte termi “kontratë”.

⁵⁹⁹ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 720.

⁶⁰⁰ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 294.

⁶⁰¹ Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, *E drejta familjare*, fq. 356.

⁶⁰² De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 721.

C. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, **disa përfundime** të rëndësishme evidentohen nga leximi i nenit 108 të kod.fam.⁶⁰³:

- a) Neni 108 prezanton një **listë të modifikimeve** që bashkëshortët mund t'i bëjnë regjimit të bashkësisë ligjore, në drejtim të objektit, rregullave të administrimit dhe pjesëve takuese. Neni 108 nuk është një listë e mbyllur. Listimi i elementëve të bashkësisë ligjore, që mund të modifikohen nga bashkëshortët, nuk ka për qëllim të kufizojë autonominë e tyre të vullnetit, por shërben për ta orientuar atë;
- b) Bashkëshortët kanë të drejtën e kombinimit të varianteve të ndryshme, të parashikuara nga neni 108 i kod.fam., ose të zgjedhin të zgjedhin e të gjitha varianteve së bashku si në drejtim të objektit të bashkësisë ashtu dhe në drejtim të rregullave të administrimit dhe pjesëve takuese. Gjithashtu, bashkëshortët nuk janë të kufizuar vetëm në modifikimin e elementëve të përmendur shprehimisht në këtë dispozitë, por ata kanë të drejtë të realizojnë edhe modifikime të tjera, mjafton të mos vijnë në kundërshtim me nenet 66 dhe 67 të kod.fam, madje mund të shmangen plotësisht nga skema ligjore dhe të parashikojnë të tjera skema atipike të regjimit të bashkësisë;
- c) Rregullat e bashkësisë ligjore do të jenë të zbatueshme për të gjithë ato elementë të bashkësisë me kontratë, të cilat nuk gjejnë rregullim në kontratën martesore, për aq sa janë të pajtueshme me regjimin e zgjedhur nga palët.

D. Neni 108 të kod.fam. bën një renditje logjike të elementëve të regjimit të bashkësisë ligjore, që i nënshtrohen vullnetit të bashkëshortëve. Një klasifikim më shkencor do të ishte klasifikimi i normave të bashkësisë ligjore, që bashkëshortët mund të modifikojnë, në tre kategori:

- a) Norma që modifikojnë **objektin e bashkësisë**, në këtë drejtim bashkëshortët mund të realizojnë zgjerimin ose reduktimin e objektit të bashkësisë ligjore, si në drejtim të kategorive të caktuara të sendeve ose në drejtim të sendeve të veçanta;
- b) Norma që rregullojnë **administrimin** e bashkësisë;
- c) Norma që rregullojnë **pjesët takuese dhe likuidimin** e bashkësisë⁶⁰⁴.

E. Nga leximi i kombinuar i nenit 108/a, nenit 109 dhe 114 të kod.fam. nxjerrim përfundimin që, në këto dispozita gjenden të parashikuar dy modele të regjimit të bashkësisë me kontratë, të cilat, është e nevojshme të theksohet, edhe një herë, *nuk* janë të vetmet modele të mundshme për bashkëshortët, pasi ata kanë të drejtë të realizojnë modifikime të panumërta të bashkësisë ligjore, mjafton që të respektojnë nenet 66 dhe 67 të kod.fam dhe limitet e lirisë kontraktore të kod.fam. Dy modelet e bashkësisë me kontratë, të rregulluar nga kod.fam. janë⁶⁰⁵:

- a) **Modeli i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve;**
- b) **Modeli i bashkësisë universale.**

Klasifikimi i mësipërm i bashkësisë me kontratë është realizuar vetëm për efekt të studimi dhe të analizës së dispozitave të kod.fam.

Jemi të mendimit që, përveç dy modeleve të rregulluar në kod.fam. bashkëshortët kanë të drejtë të përfshijnë në bashkësinë me kontratë, në mënyrë programatike ose dispozitive, një ose disa nga kategoritë e sendeve të parashikuara në nenin 77 të kod.fam. (me përjashtim të pasurisë së parashikuar në pikat c, ç dhe d të nenit 77). Gjithashtu, bashkëshortët kanë të drejtë të kalojnë

⁶⁰³ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 501.

⁶⁰⁴ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 502. Shih edhe: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 563.

⁶⁰⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 566.

nga bashkësia eventuale në bashkësinë aktuale⁶⁰⁶ të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti (neni 74/b) dhe frutet e pasurisë vetjake të çdo bashkëshorti (neni 74/c).

4.4. Zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore

4.4.1. Bashkësia e sendeve të luajtshme dhe fitimeve

Nga leximi i kombinuar i nenit 108/a dhe nenit 109 të kod.fam. rezulton që, një nga modelet e bashkësisë që gjen rregullim në kod.fam, është modeli i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve të sendeve vetjake, të cilin shkurtimisht emërtohet **“regjimi i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve”**.

Për efekt studimi, do të marrim në analizë aktivin dhe pasivin e bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve. Si rregulli i përgjithshëm, zgjerimi i aktivitetit të bashkësisë me kontratë sjell njëkohësisht edhe zgjerimin e pasivit të bashkësisë⁶⁰⁷, pra të detyrimeve që bashkësia ka ndaj të tretëve. Korrelacioni ndërmjet aktivitetit dhe pasivit të bashkësisë përbën një nga parimet themelore të regjimeve të bashkësisë.

4.4.1.1. Aktiviteti i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve

A. Kategoria e sendeve të bashkësisë. Bazuar në nenin 108 të kod.fam, bashkëshortët kanë të drejtë të zgjerojnë objektin e bashkësisë ligjore, nëpërmjet përfshirjes në bashkësi të dy kategori sendesh:

a) Pasuritë e luajtshme të cilat kanë qenë në pronësi të bashkëshortëve para lidhjes së martesës (neni 108/a). Ky formulim i nenit 108/a nuk është shumë i kënaqshëm, sepse i referohet vetëm situatës së kontratës martesore së lidhur para lidhjes së martesës. Bazuar në nenin 72/1 të kod.fam, bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë regjimin pasuror edhe gjatë martesës, me kushtin e respektimit të afatit 2 vjeçar, nga data e fillimit të zbatimit të tij. Bazuar në këtë argument propozojmë një formulim më të saktë të nenit 108/a të kod.fam: **“Bashkëshortët mund të bien dakort që, bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme që kanë qenë në pronësi të bashkëshortëve para lidhjes së kontratës martesore”**.

b) Fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës (neni 108/a). Bashkëshortët kanë të drejtë të përfshijnë në bashkësi frytet natyrore dhe civile të pasurisë vetjake të tyre, që janë fituar gjatë martesës, deri në momentin e lidhjes së kontratës.

Nga analiza e mësipërme, duhet konkluduar që, objekti i bashkësisë me kontratë përbëhet nga tërësia e pasurisë, objekti i bashkësisë ligjore si dhe nga kategoria e sendeve të parashikuara nga neni 108/a i kod.fam⁶⁰⁸, të cilat bashkëshortët përfshijnë rishtazi në bashkësi. Nga leximi i kombinuar i dispozitat të kod.fam që rregullojnë objektin e bashkësisë ligjore me nenin 108/a të kod.fam, mund të pohojmë që, objekti i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve përbëhet nga:

⁶⁰⁶ Bazuar në momentin e hyrjes së sendeve në bashkësi, doktrina bën klasifikimin e sendeve, objekt të bashkësisë ligjore, në dy kategori:

a) Sendet që hyjnë në bashkësi që nga data e fitimit të tyre (pikat a, d të nenit 74), duke formuar kështu një bashkëpronësi të menjëhershme, e cila njihet si bashkësi aktuale;

b) Sendet që hyjnë në bashkësi në datën e përfundimit të saj, nëse janë të pakonsumuara (pika b, c të nenit 74), e cila njihet si bashkësia e së ardhmes ose si bashkësi eventuale. Sendet e bashkësisë eventuale kanë natyrë dualiste. Megjithatë të fituara gjatë martesës, konsiderohen vetjake të bashkëshortit që i ka fituar, por njëkohësisht janë të destinuara ta humbasin këtë karakter, në momentin e mbarimit të bashkësisë, duke u shndërruar në sende të përbashkëta. Për më shumë shih: Omari, *E drejta familjare*, fq. 95-103.

⁶⁰⁷ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 567.

⁶⁰⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 566.

1. **Pasuria që përfshihet në objektin e bashkësisë ligjore, sipas nenit 74 dhe 75 të kod.fam:**
 - a) Pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët së bashku ose veç e veç gjatë martesës;
 - b) Të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
 - c) Frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
 - d) Veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës;
 - e) Fitimet dhe shtimin e prodhimit të veprimitarisë tregtare të krijuar para lidhjes së martesës, por që gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët;
 - f) Pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimitarisë tregtare të njërit prej bashkëshortëve dhe shtesat e prodhimit të saj, nëse ekzistojnë si të tilla në çastin e mbarimit të bashkësisë.
2. **Pasuria, që bashkëshortët kanë përfshirë rishtazi në bashkësi, nëpërmjet kontratës martesore, sipas nenit 108/a⁶⁰⁹.**

B. Kategoria e sendeve vetjake. Zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore do të sjellë njëkohësisht dhe reduktimin e kategorisë së sendeve vetjake të bashkëshortëve. Megjithatë, sipas nenit 109/2 të kod.fam, mbetet pasuri vetjake e bashkëshortëve dhe për rrjedhojë, **nuk mund të përfshihet** në asnjë rast në bashkësi, sendet e luajtshme që përfshihen në:

- a) Pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të tyre (neni 77/“c”);
- b) Mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve (neni 77/“ç”);
- c) Pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak (neni 77/ “d”).

4.4.1.2. Pasivi i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve

Zgjerimi i aktivitetit të objektit të bashkësisë ligjore korrespondon njëkohësisht me zgjerimin e pasivit të saj, të detyrimeve që bashkësia ka ndaj të tretëve⁶¹⁰.

Janë detyrime të bashkësisë me kontratë:

- a) **Të gjitha detyrimet që kanë këtë karakter, nën regjimin e bashkësisë ligjore.** Pra të gjitha detyrimet, të cilat sipas dispozitave të kod.fam. mbi bashkësinë ligjore, janë detyrime të përbashkëta;
- b) **Detyrimet** e marra përsipër nga bashkëshortët para lidhjes së kontratës martesore dhe detyrimet që do të lindin në të ardhmen, **të cilat rëndojnë mbi sendet që bashkëshortët kanë përfshirë në bashkësinë me kontratë, sipas nenit 108/a.**

Pasivi i bashkësisë me kontratë rritet në mënyrë proporcionale me aktivin e saj.

Zgjerimi i objektit të bashkësisë mund të sjellë dëmtimin e interesave të kreditorëve vetjakë të bashkëshortëve, për shkak të zvogëlimit të masës së pasurisë vetjake të bashkëshortit debitor duke zvogëluar në këtë mënyrë mundësitë e kreditorit për të realizuar të drejtën e tij, nëpërmjet ekzekutimit të pasurisë së bashkëshortit debitor.

Për këtë arsye, ligji ka parashikuar disa rregulla për mbrojtjen e pozitës së kreditorëve personalë të bashkëshortëve, në nenin 110 të kod.fam.

⁶⁰⁹ Sipas nenit 109/1 të kod.fam: “Kur bashkëshortët bien dakort që të ketë ndërmjet tyre bashkësi, sipas nenit 108 shkronja “a”, pasuria në bashkësi përbëhet nga pasuria në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore, nga pasuria e luajtshme para martesës dhe nga pasuritë vetjake gjatë martesës”.

⁶¹⁰ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 567.

“Bashkëshortët, për detyrimet e tyre para martesës, përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi, deri në kufirin e vlerës së pasurisë së tyre, e cila, në bazë të kontratës së lidhur, sipas këtij Kodi, është pjesë përbërëse e bashkësisë”. (Neni 110 i kod.fam.)

Së pari, duke përmbledhur analizën e mësipërme, “ratio” e nenit 110 është evitimi i përdorimit të kontratës martesore nga ana e bashkëshortëve, si një instrument për të zvogëluar pasurinë personale të tyre, me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tyre personalë⁶¹¹.

Së dyti, jemi të mendimit që, formulimi i nenit 110 nuk është shumë i kënaqshëm. Duhej të ishte zgjedhur një formulim më i qartë, i cili do të ndihmonte si studiuesit e kod.fam ashtu dhe zbatuesit e tij, për një kuptim dhe përdorim më të qartë të kësaj dispozite, në të ardhmen.

Së treti, vihet re një lapsus i përsëritur shpesh nga ligjvënësi në dispozitat që rregullojnë kontratën martesore, lapsus, i cili i referohet përdorimit të termit “...për detyrimet e tyre para lidhjes së martesës”. Termi më i saktë do të ishte: “për detyrimet para lidhjes kontratës martesore”⁶¹². Kujtojmë këtu që, ligjvënësi ka pranuar mundësinë e zgjedhjes së një regjimi pasuror kontraktor, jo vetëm “ante nuptias”, por edhe “constante matrimonii”. Ky është i vetmi interpretimi logjik i nenit 110, interpretim që i përshtatet edhe “ratio legis”, pra mbrojtjes së kreditorëve personalë të bashkëshortëve. Një interpretim i kundërt do të na çonte në përfundimin e gabuar që, kjo dispozitë nuk ofron mbrojtje për kreditorët personalë të bashkëshortëve, për detyrimet që kanë lindur para lidhjes së kontratës martesore⁶¹³.

Së katërti, për një interpretim më të mirë të nenit 110 në kod.fam, gjykojmë të nevojshme t’i referohem nenit 1501 të KC Francez dhe interpretimeve të doktrinës franceze.

Sipas doktrinës franceze⁶¹⁴, neni 110 (neni 1501 i Code civil) parashikon që, kreditori personal i njërit bashkëshort ka të drejtë të ndjekë të gjitha sendet që debitori i tij kishte në pronësi vetjake ditën e lidhjes së martesës (ose lidhjes së kontratës martesore), pavarësisht nga fakti nëse nëpërmjet kontratës martesore, këto sende janë përfshirë në bashkësi ose kanë mbetur vetjake⁶¹⁵. Përfshirja në bashkësi e sendeve të luajtshme në pronësi të bashkëshortëve ose e fitimeve të pasurisë vetjake, do të sjellë efekte vetëm për bashkëshortët dhe jo për kreditorët e tyre, të cilët për detyrimet e lindura para lidhjes së martesës (kontratës martesore) do të sillen ndaj këtyre sendeve njëllor sikur këto sende të vazhdonin të ishin në pronësi vetjake të bashkëshortit debitor. Në praktikë, mund të shfaqen probleme në identifikimin e pasurive të luajtshme të përfshira nga bashkëshortët në bashkësinë me kontratë, nëse gjatë martesës ato janë bashkuar me aktivin ekzistues të bashkësisë ligjore, aq sa nuk mund të identifikohen. Kod.fam nuk jep zgjidhje për këtë problem. Nëse i referohemi nenit 1501 të KC Francez, në hipotezën e konfondimit të sendeve, të përfshira nga bashkëshortët rishitazi në bashkësi, me sendet e luajtshme ekzistuese të bashkësisë ligjore, i ka dhënë të drejtë kreditorit të ndjekë të gjitha sendet e luajtshme të

⁶¹¹ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1376.

⁶¹² Në mënyrë të përmbledhur, rekomandohet zëvendësimi i frazë “ante nuptias” me frazën “ante coventionem”.

⁶¹³ I vetmi shpjegim për këtë lapsus të përsëritur të ligjvënësit është trashëgimi i këtij gabimi nga dispozitat e kodit civil italian, që janë marrë si model në hartimin e regjimit pasuror martesor në kodin tonë të familjes. Kodi civil Italian mbart këtë lapsus, sepse ndryshimi kontraktor i regjimit pasuror martesor gjatë martesës nga bashkëshortët ishte i ndaluar ndiqej pari i “pamodifikueshmërisë së kontratave martesore”. Në këto kushte ligjvënësi italian ka përdorur para reformës së vitit 1975 termin “para lidhjes së martesës”, sepse i vetmi momenti i lidhjes së kontratës martesore ishte ai “ante nuptial”. Të njëjtin rregull ligjor ndeshim edhe në Kodin Civil të Zogut të vitit 1929.

⁶¹⁴ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 568.

⁶¹⁵ Të njëjtin interpretim të nenit 110 të kod.fam. e gjejmë edhe në doktrinën shqiptare. Për më shumë shiko: Omari, *E drejtë Familjare*, fq. 57.

bashkësisë, me përjashtim të të ardhurave që vijnë nga veprimtaria profesionale e bashkëshortëve⁶¹⁶.

Bazuar në interpretimin e koordinuar të nenit 110 të kod.fam. me dispozitat që rregullojnë përmbushjen e detyrimeve të bashkësisë ligjore, nxjerrim përfundimin që, skema e përmbushjes së detyrimeve vetjake të bashkëshortëve, në regjimin e bashkësisë me kontratë, paraqitet si më poshtë:

A. Detyrimet “ante nuptias” ose “ante conventionem”:

- a) Fillimisht, kreditori personal ka të drejtë të realizojë kredinë e tij mbi sendet vetjake të bashkëshortit kreditor që nuk janë përfshirë në bashkësinë me kontratë;
- b) Nëse kjo pasuria nuk është e mjaftueshme, për përmbushjen e detyrimit, atëherë kreditori ka të drejtë të realizojë kredinë e tij mbi sendet e përfshira në bashkësinë me kontratë, që “ante conventionem” ishin në pronësi të këtij bashkëshorti kreditor;
- c) Nëse sërish pasuria nuk është e mjaftueshme, atëherë ky kreditor do të barazohet me kreditorët e tjerë personalë të bashkëshortëve dhe për rrjedhojë do të zbatohen dispozitat e kod.fam, që rregullojnë përmbushjen e detyrimeve të bashkësisë ligjore. Kreditori ka të drejtë të realizojë kredinë e tij mbi ½ pjesë të bashkësisë ligjore, që është në pronësi të bashkëshortit debitor.

B. Për detyrimet “post nuptial/conventionem” si detyrimet vetjake ashtu dhe ato të bashkësisë do të gjejnë zbatim dispozitat e kod.fam që rregullojnë përmbushjen e detyrimeve të regjimit të bashkësisë ligjore (nenet 81-89 të kod.fam.).

Nga interpretimi i mësipërm rezulton që, pozita e kreditorëve personalë të bashkëshortëve për detyrimet “ante nuptial/conventionem” është më e favorshme në raport me pozitën e kreditorëve personalë për detyrimet “post nuptial/conventionem”⁶¹⁷.

Në doktrinë është shtruar diskutimi mbi mundësinë e modifikimeve, nga bashkëshortët, të regjimit juridik të përmbushjes së detyrimeve vetjake të bashkëshortëve dhe detyrimeve të bashkësisë, të rregulluar në nenet 81-89 të kod.fam⁶¹⁸.

Pjesa më e madhe e doktrinës kanë dhënë përgjigje negative, duke argumentuar që, këto dispozita janë të parashikuara me norma urdhëruese dhe për pasojë modifikimi i tyre nuk mund t’i lihet vullnetit të bashkëshortëve. Qëllimi i këtyre dispozitave është, në radhë të parë, mbrojtja e interesave të kreditorëve personalë të bashkëshortëve, duke bërë të mundur maksimalisht realizimin e të drejtës së tyre të kredisë, si dhe mbrojtja e pasurisë së bashkësisë nga kreditorët personalë të bashkëshortëve apo anasjelltas mbrojtja e pasurisë vetjake të bashkëshortëve nga kreditorët e bashkësisë⁶¹⁹.

4.4.2. Zgjerimi maksimal i objektit të bashkësisë - bashkësia universale

Neni 114 i kod.fam, i titulluar “**bashkësia universale**”, parashikon mundësinë maksimale të zgjerimit të objektit të bashkësisë ligjore.

Përdorimi i termi “**bashkësi universale**” nuk është plotësisht i saktë, pasi me bashkësi universale do të kujtojmë atë regjim bashkëpronësie, që përfshin të gjithë pasurinë shkuar dhe të ardhshme

⁶¹⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 569.

⁶¹⁷ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1380.

⁶¹⁸ Për këtë opinion shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 570.

⁶¹⁹ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1246.

të bashkëshortëve. Ndërsa, bashkësia me kontratë e rregulluar në nenin 114 të kod.fam është një bashkësi “*quasi universale*”, për shkak të ndalimeve të parashikuara në nenin 114 të kod.fam. Kontrata martesore e regjimit të bashkësisë “*quasi universale*” ka njëkohësisht **karakter programatik** dhe **karakter dispozitiv**, sepse në objektin e saj përfshihen:

- a) **Pasuria e luajtshme dhe pasuria e paluajtshme që bashkëshortët kanë në pronësi të tyre, deri në momentin e lidhjes së kontratës martesore.** Këtu shfaqet karakteri dispozitiv i kontratës, në përfshirjen në bashkësi të pasurisë së tashme, në pronësi të secilit bashkëshort.
- b) **Pasuria e ardhshme e luajtshme dhe pasuria e paluajtshme,** që do të fitohet në të ardhmen nga secili bashkëshort. Këtu shfaqet karakteri programatik i bashkësisë, në përfshirjen në objektin e saj të pasurisë që do fitohet në të ardhmen.

4.4.2.1. Aktivi i bashkësisë universale

Bashkësia me kontratë, sipas nenit 114 i kod.fam. përfshin “*in toto*” të gjithë pasurinë ekzistuese dhe të ardhshëm të bashkëshortëve, me disa përjashtime, të cilat lidhen me natyrën dhe funksionin e një kategorie të veçantë sendesh.

A. Pasuria vetjake. Bazuar në ndalimet e nenit 114, nuk mund të përfshihen në objektin e bashkësisë me kontratë, pra mbetet vetjake gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës:

- a) **Pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të tyre**⁶²⁰.
- b) **Mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve,** përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare. Kjo do të thotë që mjetet e caktuara për administrimin e një veprimtarie tregtare janë pjesë e bashkësisë ligjore;
- c) **Pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, më përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së plotë apo të pjesshme të aftësisë për punë.** Nga interpretimi “*per a contrario*” nxjerrim përfundimin që, të ardhurat që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së plotë apo të pjesshme të aftësisë për punë janë pjesë e bashkësisë ligjore.

Natyrshëm lind pyetja se, cila është “*ratio legis*” që ka udhëhequr ligjvënësin në ndalimin e përfshirjes, së kategorisë së sipërpërmendur të sendeve, në bashkësinë me kontratë. Sipas mendimit të doktrinës, “*ratio legis*” është ruajtja e një sfare minimale të autonomisë dhe individualitetit pasuror të secilit bashkëshort, që lidhet me ruajtjen e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor⁶²¹, si dhe funksioni ekonomik-social të pasurisë së përfshirë në nenin 77/c, ç, d, të kod.fam⁶²².

Në praktikë, paraqitet problemi i identifikimit të atyre sendeve që konsiderohen si sende të përdorimit ngushtësisht vetjak apo mjeteve të ushtrimit të profesionit, sepse nuk ka një përcaktim të saktë të këtyre sendeve⁶²³. Evidentimi i tyre do të mbetet një “*questio factio*”, i cili do të realizohet rast pas rasti.

⁶²⁰ Term i përdorur nga ligji në nenin 77/c të kod.fam. “...dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake” ashtu siç e kemi theksuar edhe më parë në këtë punim, nuk është plotësisht i saktë. Termi më i saktë do të ishte “...dhe pasuritë e përdorura si aksesore të pasurive të përdorimit ngushtësisht vetjak”. Për të përmbledhur mund të themi se, qëllimi i ligjvënësit ka qenë t’i referohet pasurive të përdorimit ngushtësisht vetjak dhe pasurive të fituara si aksesore të tyre.

⁶²¹ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 304.

⁶²² Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1236.

⁶²³ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1238.

Kufizim i vendosur nga neni 114 i kod.fam. nuk i ndalon bashkëshortët që, në funksion të lirisë kontraktore të njohur nga neni 660 i kod.civ, të krijojnë bashkëpronësi “*ex post*” pas datës së fitimit të tyre, mbi këtë kategori sendesh.

Gjithashtu, bashkëshortët kanë të drejtë që t’i transferojnë njëri-tjetrit pronësinë e këtyre sendeve, nëpërmjet veprimeve juridike me apo pa kundërshtpërblim.

B. Objekti i bashkësisë. Duke lexuar në mënyrë të kombinuar nenet 74, 75 dhe 77 dhe nenin 114 të kod.fam. dhe duke mbajtur parasysh kufizimet e parashikuara në nenin 114, objekti i bashkësisë “*quasi universale*” do të përbëhet nga kjo kategori sendesh:

- a) *Pasuria e fituar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës ose pasuria e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi* (neni 77/a i kod.fam.), *pavarësisht nga mënyra e fitimit të kësaj pasurie.*
- b) *Pasuria e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës, “ante conventionem”.*
- c) *Pasuria e fituar nga bashkëshortët para lidhjes së kontratës martesore me dhurim, me trashëgimi ose leg.*
- d) *Veprimtaria tregtare e krijuar nga secilit bashkëshort para lidhje së martesës ose gjatë saj* (neni 74/d i kod.fam).
- e) *Të ardhurat e fituara nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti si dhe frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti* (neni 74/b,c i kod.fam).

Sipas nenit 74 të kod fam. këto dy kategori sendesh do të përfshihen në bashkësinë ligjore, vetëm nëse janë të pakonsumuara në mbarimin e bashkësisë, ajo që doktrina e ka njohur me termin “bashkësi eventuale” ose “bashkësi e të ardhmes”. Ky termi i referohet pikërisht natyrës juridike të dyfishtë të tyre, si sende vetjake gjatë regjimit të bashkësisë ligjore, por që shndërrohen në sende të bashkësisë, vetëm në përfundim të saj dhe në eventualitetin që gjenden të pakonsumuara. Bashkëshortët kanë të drejtë t’i kalojnë këto sende nga bashkësia eventuale, në bashkësinë aktuale, pra t’i përfshijnë sendet në objektin e bashkësisë, që në momenti i fitimit të pronësisë mbi to.

Doktrina shtron problemin e statusit (natyra juridike) që do të ketë përfshirja në bashkësinë e menjëhershme të të ardhurave nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti. Do të krijohet një bashkëpronësi e menjëhershme e të dy bashkëshortëve mbi këto të ardhura, apo do të t’i njihet njërit bashkëshort një e drejtë krediti mbi gjysmën e të ardhurave që fiton bashkëshorti tjetër nga veprimtaria e tij profesionale. Nëse do të pranojmë alternativën e parë, atë të bashkëpronësisë së menjëhershme, atëherë mund të arrijmë në përfundimin që, bashkëshorti tjetër ka të drejtën e tërheqjes së të ardhurave që fiton nga puna bashkëshorti titullar, në cilësinë e bashkëpronarit, përfundim i cili është i papranueshëm⁶²⁴. Jemi të mendimit që, njërit bashkëshort do t’i njihet një e drejtë krediti mbi të ardhurat e fituara nga veprimtaria profesionale e bashkëshortit tjetër.

- f) *Pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare të njërit prej bashkëshortëve dhe shtesat e prodhimit të kësaj veprimtarie* (neni 75 i kod.fam.).

Edhe në këtë rast arsyetimi është i njëjtë me atë të paraqitur në pikën e). Bashkëshortët kanë të drejtë të përfshijnë në bashkësinë me kontratë, që nga data e fitimit të tyre, shtesat e prodhimit të një veprimtarie të njërit prej bashkëshortëve dhe pasurinë e krijuar gjatë martesës, të caktuar për administrimin e kësaj veprimtarie tregtare.

Megjithatë, duhet përmendur që, në doktrinë ka shumë kritika rreth mundësisë së kalimit të pasurisë së caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare të njërit prej bashkëshortëve, nga kategoria e bashkësisë eventuale në atë të bashkësisë aktuale. Argumenti kryesor i përdorur është

⁶²⁴ Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1063.

që, kjo kategori sendesh lidhet ngushtësisht me ushtrimin e autonomisë së bashkëshortit në veprimtarinë e tij tregtare, si dhe për më shumë do të kishim një papërputhshmëri të normave që rregullojnë administrimin e pasurisë⁶²⁵ në bashkësi me lirinë e iniciativës ekonomike të bashkëshortit⁶²⁶.

g) Pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive që përmendëm në pikat e mësipërme ose pasuria e fituar nga shkëmbimi i tyre (neni 77/dh, e i kod.fam).

h) Pasuria e cila do të fitohet në të ardhmen, pas lidhjes së kontratës, së bashku ose veç e veç nga bashkëshortët, pavarësisht nga mënyra e fitimit të pronësisë, me përjashtim të pasurisë së parashikuar në nenin 77,c,ç,d. (neni 114 kod.fam).

Prej kohësh ekziston një debat në doktrinë mbi mundësinë e përfshirjes në bashkësinë universale të sendeve që bashkëshortët do të fitojnë në të ardhmen me dhurim, trashëgim apo leg. Nuk ka asnjë pengesë për përfshirjen, në mënyrë dispositive, në bashkësi të sendeve ekzistuese në pasurinë e bashkëshortëve, të fitura me dhurim apo trashëgimi. Problemi qëndron nëse është e mundur përfshirja në bashkësi e dhurimeve dhe trashëgimeve të ardhshme, në mënyrë programatike.

Analiza e këtij problemi meriton jo vetëm analizën e dispozitave të kod.fam, por në të njëjtën kohë studimin komplementar, të dispozitave të kod.civ. që rregullojnë trashëgiminë dhe kontratën e dhurimit.

Në një lexim të parë, neni 109 dhe 114 të kod.fam., ka përjashtuar nga objekti i bashkësisë universal vetëm kategorinë e sendeve të parashikuara nga neni 77/c,ç,d. Në mënyrë indirekte, nga interpretimi “*per a contrario*” i këtyre dispozitave, mund të arrijmë në përfundimin e gabuar, që lejohet përfshirja në kontratën e martesës, në mënyrë programatike të pasurisë që do të fitohet nga bashkëshortët, në të ardhmen, me dhurim apo trashëgimi.

Doktrina juridike ka qenë e ndarë, në lidhje me këtë problem.

1. Një pjesë e doktrinës juridike është e mendimit që, nuk mund të përfshihen në bashkësinë me kontratë, qoftë kjo një bashkësi, pasuria që do të fitohet nga bashkëshortët në të ardhmen me trashëgimi ose kontratë dhurimi, sepse transferimi i pronësisë së dhurimeve të ardhshme dhe trashëgimisë që nuk është çelur akoma, bie në kundërshtim me dispozitat e kod.civ që rregullojnë përkatësisht këto dy institute⁶²⁷. Sipas këtyre autorëve, neni 114 i kod.fam nuk sjell shmangien e dispozitave të kod.civ, por sipas tyre, është detyrë e studiuesit interpretimi në mënyrë të koordinuar, i dispozitave të kod.fam. me ato të kod.civ. Në çdo rast, shprehen ata, disponimi programatik në kontratën martesore i sendeve të fituara me dhurim apo trashëgim është i ndaluar, sepse është në kundërshtim me dispozitat e kod.civ.

Sipas dispozitave të kod.civ:

“Dhurimi nuk mund të përmbajjë veçse pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi është i pavlefshëm për sa i takon asaj.” (neni 761 i kod.civ)

“Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën disponohen ose përdoren të drejtat që rrjedhin nga një trashëgim ende i paçelur.” (neni 319 i kod.civ.)

⁶²⁵ Kujtojmë këtu që, ndërsa për pasurinë që përfshihet në bashkësinë eventuale, gjatë gjithë martesës, bashkëshortët ruajnë të drejtën e pronësisë, të administrimit dhe disponimit të lirë të tyre, për pasurinë që bën pjesë në bashkësinë aktuale, kod.fam parashikon një tjetër regjim juridik administrimi, sipas të cilit për veprimet e administrimit jo të zakonshëm kërkohet pëlqimi i shprehur i të dy bashkëshortëve.

⁶²⁶ Shih: Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1056; Pittalis, “Modifiche convenzionali alla comunione dei beni.” fq. 522.

⁶²⁷ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 722; Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1299.

2. Ndërkohë, disa autorë janë të mendimin që, përfshirja në mënyrë programatike në kontratën martesore e pasurisë së fituar me dhurim apo trashëgimi është në çdo rast e mundur, sepse interpretimi përjashtues i kësaj kategorie sendesh do të sillte, në mënyrë të gabuar, kufizimin e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, duke mos inkurajuar, në planin praktik, marrëveshjet e bashkëshortëve në drejtim të zgjerimit të objektit të saj. Kështu, vazhdojnë arsyetimin e tyre autorët, neni 104 i kod.fam. duhet kuptuar si një shmangie nga dispozita e kod.civ, që ndalojnë marrëveshjet për disponimin e trashëgimisë së paçelur dhe ndalimet e dhurimit të sendeve të ardhshme⁶²⁸.

3. Një pjesë tjetër e doktrinës mban qëndrime të ndryshme për sa i përket dhurimit dhe trashëgimisë⁶²⁹. Ndërsa, sipas tyre, përfshirja në bashkësi, e sendeve që do të fitohen në të ardhmen nga bashkëshortët, me dhurim është e vlefshme, nuk mund të mbahet i njëjti qëndrim sendet që do të fitohen në të ardhmen me trashëgimi. Autorët e këtij grupi përdorin dy argumente, për të mbështetur tezën e vlefshmërisë së përfshirjes në bashkësi të durimeve të ardhshme. Argumenti i parë, është që bashkëshortët përshijnë në bashkësi sendet që do të fitohen nga dhurimet e ardhshme, dhe nuk shprehen për kalimin e pronësisë në bashkësi të një sendi të ardhshëm. Neni 761 i referohet ndalimit të disponimit me dhurim të një sendi të ardhshëm, që akoma nuk ekziston në momentin e dhurimit, ose pronësinë e të cilit dhuruesi nuk e ka akoma në momentin e dhurimit. Ndërsa, argumenti i dytë bazohet në tezën që, kalimi i pronësisë nga pasuria e dhuruesit të njërit prej bashkëshortëve, në pasurinë e bashkësisë realizohet drejtpërdrejtë dhe automatikisht, pa kaluar më parë pronësia e sendit tek bashkëshorti palë i kontratës së dhurimit. Për këtë arsye nuk gjen zbatim ndalimi i parashikuar në ligj⁶³⁰ (neni 761 i kod.civ). Sipas këtij qëndrimi doktrinal, në kategorinë e marrëveshjeve, në të cilat ndalohet të disponohen të drejtat që rrjedhin nga një trashëgimia e paçelur, padyshim do të përfshihet edhe kontrata martesore që, ka për objekt përfshirjen në bashkësi të pasurisë që do të fitohet në të ardhmen me trashëgimi. Nenin 114 i kod.fam, i cili parashikon të drejtën e bashkëshortëve për të përfshirë në bashkësi çdo pasuri të ardhshme të bashkëshortëve, më përjashtim të pikave “c”, “ç” dhe “d” të nenit 77 të kod.fam. nuk mund ta interpretojmë në kuptimin e shmangies nga neni 319 i kod.civ. Neni 319 i kod.civ. do të ishte i shmangshëm, vetëm në prezencë të një norme që të parashikonte shprehimisht, dhe jo me interpretim, shmangien e tij⁶³¹.

Në analizë të fundit, në mbështetje të tezës së autorëve të grupit të tretë, jemi të mendimit që, bashkëshortët nuk mund të përfshijnë në bashkësi të drejtat që do të rrjedhin për ta nga trashëgimia e paçelur, por janë të lirë të përfshijnë pasurinë që do të fitojnë në të ardhmen, nëpërmjet kontratës së dhurimit. Pra, përfshirja në bashkësi e sendeve të fituara nga bashkëshortët me trashëgimi mund të realizohet vetëm nëpërmjet kontratave martesore me natyrë dispozitive dhe në asnjë rast nëpërmjet atyre me natyrë programatike.

4.4.2.2. Pasivi i bashkësisë universale

Edhe në rastin e bashkësisë universale zbatohet parimi i lidhjes së drejtpërdrejtë të aktivitetit të pasurisë së bashkësisë me pasivin e saj⁶³². Në këtë kuptim zgjerimi i aktivitetit të pasurisë do të

⁶²⁸ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1298.

⁶²⁹ Mascia, Katia. “La comunione convenzionale.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, di A. Arceri, M. Bernardini, Maggiolo Ed., 2009, fq. 290. Shih gjithashtu: Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 306.

⁶³⁰ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 307.

⁶³¹ Confrontini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 307-308.

⁶³² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 570.

sjellë automatikisht zgjerimin e pasivit të saj, me qëllim mosdëmtimin e interesave të kreditorëve personalë të bashkëshortëve.

Neni 114 i kod.fam parashikon shprehimisht që, bashkësia universale përballon të gjitha detyrimet e bashkëshortëve:

- a) *Detyrimet e përbashkëta dhe detyrimet vetjake që, ekzistojnë para lidhjes së kontratës martesore;*
- b) *Detyrimet që do të marrin përsipër bashkëshortët së bashku ose veç e veç, në të ardhmen.*

Duke qenë se, bashkësia universale nuk përfshin asnjëherë të gjithë pasurinë e bashkëshortëve, por një pjesë e pasurisë, për shkak të ndalimeve ligjore, vazhdon të mbetet vetjake, atëherë edhe pasivi i saj nuk mund të përfshijë të gjitha detyrimet e bashkëshortëve. Në këtë drejtim, detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë vetjake të secilit bashkëshort (neni 77c,ç,d, do të mbeten vetjake.

4.4.2.3. Dhurimet ndërmjet bashkëshortëve në regjimin e bashkësisë universale

Në hipotezën kur bashkëshortët kanë zgjedhur regjimin e bashkësisë universale, shtrohet për diskutim problemi i natyrën juridike të dhurimeve që bashkëshortët i bëjnë njëri tjetrit, gjatë këtij regjimi. A do të përfshihet në bashkësi pasuria e dhuruar nga njëri bashkëshort në favor të bashkëshortit tjetër apo do të konsiderohet si pasuri vetjake e bashkëshortit që e ka fituar?

Për zgjidhjen e këtij problemin nuk mund të referojmë në ndalimet e parashikuara në nenin 114 të kod.fam., pasi kjo dispozitë nuk bën asnjë rregullim të shprehur për dhurimet ndërmjet bashkëshortëve. Për rrjedhojë, në mungesë të një zgjidhje të shprehur në dispozitat e kod.fam., zgjidhja do të kërkohet në parimet e përgjithshme të së drejtës civile.

Jemi të mendimit që, dhurimet ndërmjet bashkëshortëve, të realizuar në regjimin e bashkësisë universale, do të rregullohen në përputhje me interpretimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr. 3, datë 03.02.2006⁶³³. Megjithëse ky vendim nuk rregullon situatën konkrete, por i referohet natyrës juridike të dhurimeve ndërmjet bashkëshortëve, të realizuara në kuadër të regjimit të bashkëpronësisë, së rregulluar nga KC të vitit 1981, gjykojmë që ai do të zbatohet, me analogji, edhe në hipotezën e dhurimeve ndërmjet bashkëshortëve, në regjimin kontraktor të bashkësisë universale. Megjithëse, me vullnetin e tyre të lirë bashkëshortët kanë zgjedhur zbatimin e regjimit të bashkësisë universale, do të ishte një nonsens juridik të pranohet lidhjen e kontratës me veten.

⁶³³ Rrethanat e çështjes: “Padiësi me një padi rivendikimi ka kërkuar kthimin e sendit pronë e tij dhe çregjistrimin e tij nga Z.Rr.P.Paluaajtshme nga emri i të paditues në emrin e tij, detyrimin që e paditura t’i paguajë dëmin e shkaktuar nga mbajtja padrejhtësisht e sendit dhe pagimin e qirasë deri sa të lirojë sendin (banesën). Ka rezultuar nga aktet e administruara në gjykimin e çështjes, se padiësi, me kontratën e dhurimit datë 14.08.1982, është bërë pronar mbi një shtëpi dykatëshe me dy dhoma e koridor në katin e parë, dy guzhina në katin përdhe me koridor në mes dhe një aneks, shtëpi e veçantë në oborr njëkateshe me dy dhoma ndodhur në Tiranë. Në datën 26.04.1988, padiësi ka marrë leje ndërtimi me vendim të Komitetit Ekzekutiv të K.E. të lagjes nr.4, për shtesa në këtë shtëpi në pronësi të tij dhe ka filluar të realizojë punimet. Padiësi ka lidhur martesë në datë 01.02.1989 dhe me kontratën e dhurimit të datës 02.12.1995, lidhur para noterit me nr.2846 rep., i dhuron bashkëshortes “një aneks shtëpi e veçantë me aborr, një katëshe me dy dhoma si dhe ndërtimet e reja të pa përfunduara ngjitur me banesën ekzistuese”. Në këtë kontratë theksohet se ai i dhuron bashkëshortes pronën e mesipërme, “...e cila bëhet pronë ekskluzive e saj për t’a gëzuar, poseduar e disponuar sipas dëshirës dhe ajo bëhet pronare e vetme duke u zhveshur faktin juridik të ndërtimit të shtëpisë të cilën, me kontratën e datës 26.11.1996, ja ka shitur të paditurës. Padiësi pretendon se këtë shitje bashkëshortja e tij e ka bërë duke qenë e detyruar për të shlyer një detyrim financiar dhe se, nga ana tjetër, përsërit edhe në gjykim se shitja është bërë pa pëlqimin e tij”.

Në vendimin e sipërpërmendur, para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është shtruar problemi i **“Vlerës që ka kontrata e dhurimit e lidhur midis bashkëshortëve në raport me bashkëpronësinë? A konsiderohet sendi i dhuruar në këtë rast pronë ekskluzive e njërit bashkëshort, apo me këtë duhet kuptuar se bashkëshorti tjetër jep pëlqimin e plotë për çdo veprim që bashkëshorti përfitues kryen me atë pronë përfshi dhe tjetërsimin e saj, apo ky është një veprim juridik fiktiv që nuk sjell asnjë pasojë lidhur me statusin e bashkëpronësisë së pronës së bashkëshortëve pavarësisht disponimit që njëri bashkëshort bën në favor të bashkëshortit tjetër”**.

Gjykata e Lartë arsyeton se, në këto rrethana, të pretendosh që dhuruesi kalon pronësinë mbi gjithë sendin e dhuruar dhe në të njëjtën kohë përfiton ½ pjesë të tij, duhet të pranosh që dhuruesi gëzon njëkohësisht cilësinë e debitorit dhe atë të kreditorit mbi të njëjtin detyrim, atë të kalimit të pronësisë mbi një send të paluajtshëm. Me fjalë të tjera, do të thotë t'i japësh mundësinë një subjekti të së drejtës, të lidhë kontratë me veten e tij, gjë që nuk përfaqëson gjë tjetër veçse një *non sens* juridik⁶³⁴. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara unifikojnë praktikën gjyqësore **“Në rastin e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve të sendeve vetjake të bashkëshortit dhurues apo sende të bashkëpronësisë, sendi i dhuruar do të kalojë në pasurinë vetjake të bashkëshortit përfitues, e në këto rrethana, këto sende nuk bëjnë pjesë në bashkësinë (bashkëpronësinë) ndërmjet bashkëshortëve”**⁶³⁵.

4.5. Reduktimi i objektit të bashkësisë ligjore

Në kuadër të autonomisë së vullnetit të njohur nga ligji, bashkëshortët kanë të drejtën reduktimit të objektit të bashkësisë ligjore, jo vetëm nëpërmjet përjashtimit nga bashkësia të kategorive të caktuara të sendeve që, janë në pronësi të bashkëshortëve, apo do të vihen në pronësi të tyre në të ardhmen, por edhe nëpërmjet përjashtimit nga bashkësia të sendeve të caktuara ekzistuese. Disa autorë e shtrijnë deri aty lirinë e bashkëshortëve për të modifikuar bashkësinë ligjore, sa njohin mundësinë e reduktimit të objektit të saj, deri në një send të vetëm. Sipas tyre objekti i bashkësisë ligjore mund të reduktohet deri aty sa ky objekt të përbëhet nga një send i vetëm⁶³⁶.

Argumenti kryesor, mbi të cilin doktrina e mësipërme e mbështet qëndrimin e saj, është mungesa e normave të shprehura ligjore, që të ndalojnë reduktimin e objektit të bashkësisë, apo të përcaktojnë shkallën e reduktimit të këtij objekti. Në vazhdim të këtij arsyetimi, nëse ligjvënësi do të kishte dashur të ndalonte reduktimin e objektit të bashkësisë ligjore do të kishte parashikuar shprehimisht pamundësinë e shmangies⁶³⁷ nga neni 74 dhe 75 i kod.fam, siç ka bërë për shembull, në rastin e bashkësisë universale, në ndalimin e shtrirjes së bashkësisë mbi kategoritë e pasurisë të përmendura në gerrat “c”, “ç” dhe “d” të nenit 77 të kod.fam (për këtë ndalim shiko nenin 109/2 dhe 114/1 të kod.fam).

Argumenti i dytë, i përdorur nga doktrina, është parashikimi nga ana e ligjvënësit e mundësisë së bashkëshortëve për të zbatuar regjimin e pasurive të ndara. Përderisa ligji u ka njohur të drejtën

⁶³⁴ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 03.02.2006

⁶³⁵ Gjykata vazhdon arsyetimin se *“Nëse objekt i kontratës së dhurimit është kalimi i pronësisë së një sendi, bashkëshorti tjetër bëhet përfitues i të gjithë sendit, i cili kalon në pasurinë e këtij të fundit. Në rastet kur objekt i dhurimit janë sende që bëjnë pjesë në bashkësinë ndërmjet bashkëshortëve, do të konsiderohet se objekt i dhurimit është pjesa ideale mbi sendet në bashkëpronësi, e cila pas lidhjes së kontratës së dhurimit bashkohet me pjesën ekzistuese që gëzonte bashkëshorti përfitues mbi sendin, duke u kthyer kështu në pasuri ekskluzive të këtij të fundit. Titullar i sendit të dhuruar, është vetëm bashkëshorti përfitues i dhurimit. Sendi i përfituar nuk bën pjesë në bashkëpronësinë bashkëshortore e, si të tillë, bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë i vetëm kundrejt çdo subjekti, pa marrë pëlqimin e bashkëshortit dhurues”*.

⁶³⁶ Mascia, “La comunione convenzionale.” fq. 291-292.

⁶³⁷ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1273.

bashkëshortëve për të përjashtuar tërësisht (“*in toto*”) zbatimin e regjimit të bashkësisë ligjore, nëpërmjet zgjedhjes së regjimit të pasurive të ndara, atëherë pse mos u njihet e drejta bashkëshortëve për të reduktuar pa asnjë limit objektin e bashkësisë ligjore⁶³⁸, deri në një send të vetëm, ose në një kategori të vetme sendesh⁶³⁹.

Të tjerë autorë, më të paktë në numër, shprehen kundër mundësisë së bashkëshortëve për të reduktuar objektin e bashkësisë ligjore, duke i njohur bashkëshortëve vetëm të drejtën e zgjerimit të tij. Justifikimin e tezës së tyre, këta autorë e gjejnë në nenin 67 të kod.fam, nën i cili parashikon pamundësinë e bashkëshortëve për të shmangur rregullat e administrimit ligjor të bashkësisë. Sipas tyre përjashtimi me kontratë martesore, i kategorisë së sendeve, të parashikuara në nenet 74 dhe 75 të kod.fam. do të vinte në kundërshtim me nenin 67 të tij, sepse sipas tyre nuk do të kishte asnjë kuptim parashikimi nga ana e ligjvënësit e pamundësisë së shmangies së rregullave të administrimit të bashkësisë ligjore, nëse ligjvënësi do të kishte dashur të lejonte reduktimin e objektit të saj⁶⁴⁰.

Një tjetër grup autorësh mbështet tezën e reduktimit të kufizuar të objektit të bashkësisë ligjore. Sipas tyre, lejimi apo jo i reduktimit të bashkësisë ligjore do të varet nga rëndësia ekonomike që ka sendi i përjashtuar, në tërësinë e pasurisë së familjes si dhe nga fakti nëse pas përjashtimit të një/disave sendeve apo kategorive të veçanta të sendeve, bashkësia do të jenë akoma në gjendje të përmbushë funksionet e saj. Kështu, sipas tyre, nëse bashkëshortët vendosin të përjashtojnë nga bashkësia të vetmin send të paluajtshëm të bashkësisë, që mund të jetë p.sh. banesa familjare, atëherë ky veprim nuk mund të lejohet, sepse në këtë mënyrë bashkësia ligjore nuk do të jetë në gjendje të përmbushë funksionet për të cilat është krijuar nga ligjvënësi⁶⁴¹.

Reduktimi i objektit të bashkësisë ligjore, mund të realizohet në dy drejtime, të cilat nuk përjashtojnë njëra tjetrën, por mund të kombinohen ndërmjet tyre⁶⁴²:

- a) **Në mënyrë programatike**, duke përjashtuar nga bashkësia një ose disa kategori pasurie që do të fitohen nga bashkëshortët në të ardhmen, gjatë martesës, të parashikuara në nenet 74 dhe 75 të kod.fam. si psh: përjashtimi i pasurisë që do të fitohet, nga secili bashkëshort, në të ardhmen, me dhurim ose trashëgimi;
- b) **Në mënyrë dispozitive**, nëpërmjet përjashtimit nga bashkësia të pasurive ekzistuese, që ndodhen në të, të kategorive të caktuara ose të sendeve të veçanta, si psh: përjashtimi i veprimtarisë tregtare të njërit bashkëshort.

Përjashtimi nga bashkësia i sendeve të veçanta apo kategorive të sendeve që ekzistojnë tashmë në aktivin e pasurisë së bashkësisë, mund të realizohet vetëm nëpërmjet kontratave martesore *post nuptial*⁶⁴³, ndërsa në kontratat *ante nuptial*, bashkëshortët mund të përjashtojnë kategori sendesh apo pasuri të veçanta që do të fitohen prej tyre në të ardhmen.

Në analizë të fundit, jemi të mendimit që, bashkëshortët nuk kanë kufizime në shkallën e reduktimit të objektit të bashkësisë ligjore, duke pasur të drejtën e reduktimit të tij për një/disave sende apo për kategori të caktuara sendesh. Megjithatë, nëse bashkëshortët e reduktojnë së tepërmi objektin e bashkësisë ligjore, duke lënë në objektin e saj vetëm një kategori sendesh ose

⁶³⁸Mascia, “La comunione convenzionale.” fq. 293. Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1273.

⁶³⁹ Për të vazhduar më tej me argumentet në favor të mundësisë së reduktimit të objektit të bashkësisë ligjore mund të përmendim këtu nenin 199 të Kodit Civil Zvicërian, i cili e parashikon në mënyrë të shprehur mundësinë e bashkëshortëve për të reduktuar objektin e bashkësisë ligjore. Për këtë argument shih: Cornu, *Lés regimes matrimoniaux*, fq. 720.

⁶⁴⁰ Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, fq. 1199-1200.

⁶⁴¹ Për më shumë rreth kësaj teze shih: Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1070.

⁶⁴² Për këtë klasifikim shih: Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1067.

⁶⁴³ Corsi, “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa.” fq. 78.

një/disa sende të veçanta, është e preferueshme, që ata të zgjedhin regjimin e pasurive të ndara duke krijuar bashkësi vetëm për atë kategori sendesh apo ato sende që u interesojnë⁶⁴⁴.

4.5.1. Përjashtimi nga bashkësia i sendeve të veçanta

Ndërsa në rastin e reduktimit programatik të objektit të bashkësisë pjesa më e madhe e doktrinës shprehet pozitivisht, në rastin e përjashtimit nga bashkësia të sendeve që tashmë janë pjesë e aktivitetit të saj (reduktimit dispozitiv të objektit të bashkësisë) një sërë problemesh lindin për diskutim.

Problemi i parë është vlefshmëria të kontratës, nëpërmjet së cilës bashkëshortët përjashtojnë sende ekzistuese nga bashkësia. Pjesa mbizotëruese e doktrinës ka mbështetur legjitimitetin e kontratës me objekt përjashtimit të sendeve të veçanta nga bashkësia, ndërsa diskutimet më të shumta janë kanalizuar drejt natyrës juridike të kontratës dhe drejt regjimit juridik që do t'i zbatohet sendeve pas përjashtimit të tyre nga bashkësia.

Megjithatë, një pjesë tjetër e doktrinës, mbështet idenë e mungesës së legjitimitetit të kontratës së përjashtimit nga bashkësia të sendeve të veçanta. Sipas tyre, nuk është e pranueshme që ligjvënësi të ketë pasur për qëllim reduktimin e objektit të bashkësisë ligjore, deri në pikën që të lejojë bashkëshortët, që pasi të kenë zgjedhur regjimin e bashkësisë ligjore, të mund të reduktojnë objektin e saj, herë pas here, nëpërmjet përjashtimit të sendeve të veçanta. Kjo do të çonte në një regjim vetëm formal të bashkësisë ligjore.⁶⁴⁵

Jemi të mendimit që, bashkëshortët janë të lirë të reduktojnë objektin e bashkësisë edhe nëpërmjet përjashtimit të sendeve ekzistuese nga objekti i saj, mbështetur jo vetëm në mungesën e një ndalimi të shprehur ligjor, por mbështetur në frymën e përgjithshme të kod.fam. Nga fryma e kod.fam rezulton që, ligjvënësi i ka dhënë një fleksibilitet të madh bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, duke lejuar ndryshime të regjimit pasuror gjatë martesës, me qëllim përshtatjen e tij me interesat e tyre pasuror dhe me interesat e familjes.

Problemi i dytë është nëse përjashtimi nga bashkësia i një/disa sendeve të caktuara apo një kategorie të caktuar sendesh do të sjellë njëkohësisht përfundimin e bashkësisë për këto sende.

Për këtë problem, një pjesë e doktrinës është e mendimit që, nuk do të verifikohet mbarimi i bashkësisë ligjore, për kategorinë e sendeve të përjashtuara, sepse sipas tyre, është i papranueshëm çdo mbarim i pjesshëm i bashkësisë dhe duhet dalluar sipas tyre mbarimi i bashkësisë nga përjashtimi nga bashkësia i sendeve të veçanta, që është çdo herë i mundshëm⁶⁴⁶. Në vazhdim të këtij qëndrimi, të tjerë autorë shprehen që, reduktimi i objektit të bashkësisë, nëpërmjet përjashtimit të sendeve të veçanta nuk do të sjellë mbarimin e pjesshëm të saj, sepse nuk kemi ndryshim të regjimit pasuror, bashkëshortët vazhdojnë të jenë të martuar nën regjimin e bashkësisë, vetëm se tashmë me një objekt të më të reduktuar në raport me atë të bashkësisë ligjore⁶⁴⁷.

Ndërsa, pjesa mbizotëruese e doktrinës, qëndrimin e së cilës e gjykojmë më të arsyeshëm, njeh mundësinë e mbarimit të pjesshëm të bashkësisë, duke mbështetur këtë qëndrim në nenin 96/c të kod.fam, i cili shprehet ***“bashkësia mbaron me ndryshimin e regjimit pasuror martesore, kur ky sjell mbarimin e bashkësisë”***.

⁶⁴⁴ Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1069.

⁶⁴⁵ Për këtë opinion shih: Laurini, Giancarlo. “L’esclusione parziale dalla comunione legale.” *Revista del Notariato*, Milano: Giuffrè Editore, 1985, fq. 1074.

⁶⁴⁶ Corsi, “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa.” fq. 175-177.

⁶⁴⁷ Pittalis, “Modifiche convenzionali alla comunione dei beni.” fq. 544. Gjithastu për këtë mendim shiko: De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 724.

Problemi i tretë, që shtrohet për diskutim, në rastin e reduktimit dispozitiv të objektit të bashkësisë (nëpërmjet përjashtimit të sendeve të veçanta), i referohet regjimit juridik që do t'i zbatohet këtyre sendeve në të ardhmen (pas përjashtimit nga bashkësia).

Në vijim të këtij diskutimi, duhen dalluar patjetër dy raste: a) nëse bashkëshortët shprehen në kontratën martesore vetëm për përjashtimin e sendit nga bashkësia; b) nëse bashkëshortët përveç përjashtimit të sendit nga bashkësia, shprehen edhe për kalimin e pronësisë së tij njërit prej tyre.

Nëse në kontratën e martesës, me natyrë dispozitive, bashkëshortët shprehen vetëm që sendi përjashtohet nga bashkësia ligjore, por pa përcaktuar pronësinë mbi të, atëherë në këtë rast do të kemi përfundimin e bashkësisë ligjore për sendin/sendet që janë përjashtuar nga bashkësia dhe zbatimi për të ardhmen të regjimit të bashkëpronësisë në pjesë të rregulluar nga dispozitat e kod.civ. Ky është qëndrimi mbizotërues i doktrinës. Kështu sipas një autori Italian, qëllimi i përjashtimit të një sendi të veçantë nga bashkësia është pikërisht eliminimi i bashkëpronësisë mbi këtë send dhe pas përjashtimit sendi do t'i nënshtrohet regjimit të bashkëpronësisë në pjesë e për rrjedhojë është i lirë për tu pjesëtuar nga bashkëshortët ose ato mund t'ia kalojnë pronësinë e tij njëri-tjetrit⁶⁴⁸ nëpërmjet veprimeve juridike pa kundërshtpërblim (kontrata e dhurimit) ose veprimeve juridike me kundërshtpërblim (kontratë shitje apo shkëmbimi). Një tjetër autor, në mbështetje të të njëjtit qëndrim, shprehet që, përjashtimi sjell si pasojë daljen e sendit nga bashkësia ligjore dhe kalimin e tij në kategorinë e sendeve vetjake të bashkëshortëve, të cilët tashmë do të jenë bashkëpronarë në pjesë të barabarta mbi sendin, sipas regjimit të bashkëpronësisë në pjesë, të rregulluar nga dispozitat e kod.civ⁶⁴⁹.

Nga ana tjetër, njëkohësisht me përjashtimin e sendit/sendeve nga bashkësia ligjore bashkëshortët mund të shprehen për kalimin e sendit në pronësi të njërit apo tjetrit bashkëshort. Në këtë hipotezë, sipas doktrinës, nuk kemi mbarimin e pjesëshëm të bashkësisë, sepse mungon natyra programatike e kontratës martesore, por realizohet vetëm transferimin e ½ pjesë të pronësisë së sendit nga njëri bashkëshort tek bashkëshorti tjetër. Në këtë rast, kontrata martesore e përjashtimit të sendit dhe e kalimit të pronësisë së tij tek njëri bashkëshort ka karakter kompleks, sepse kemi të bëjmë me dy veprime të ndryshme juridike, eliminimin e regjimit të bashkësisë mbi këtë send dhe përfaqëson njëkohësisht një veprim juridik disponimi pasurie, pa kundërshtpërblim, për natyrën juridike të të cilit ka diskordanca në doktrinë⁶⁵⁰.

Problem, në këtë hipotezë të fundit, paraqitet mbrojtja e palëve të treta të cilat do të kontrakttojnë me bashkëshortët lidhur me sendin e përjashtuar nga bashkësia, sepse ligji nuk parashikon asnjë sistem regjistrimi të veprimit juridik.

Ndërsa, në kontratën martesore programatike, e cila redukton objektin e bashkësisë ligjore, për pasurinë që do të fitohet nga secili prej tyre në të ardhmen, problemet e mësipërme nuk gjejnë vend, sepse në këtë rast eliminohet zbatimi i regjimit të bashkësisë ligjore për të ardhmen dhe sendet që do të fitohen në të ardhmen nga bashkëshortët do të jenë në pronësinë ekskluzive të bashkëshortit që i ka fituar. Mbi këto sende do të veprojnë regjimi i pasurive të ndara.

Në mbyllje të diskutimeve të mësipërme, duhet theksuar që, përjashtimi dispozitiv i sendeve nga bashkësia nuk do të sjellë asnjë pasojë mbi sendet e të njëjtës kategori që do të fitohen në të ardhmen nga bashkëshortët, nëse bashkëshortët nuk janë shprehur ndryshe. Kështu sendet e të njëjtës kategori me sendin e përjashtuar, që do të fitohen në të ardhmen nga bashkëshortët do të përfshihen në bashkësi, nëse në kontratën e martesës bashkëshortët nuk kanë parashikuar përjashtimin programatik të kategorisë ku ato bëjnë pjesë.

⁶⁴⁸ Pittalis, "Modifiche convenzionali alla comunione dei beni." fq. 544. Gjithashtu për këtë mendim shiko: De Paola, Il regime patrimoniale e della famiglia, fq. 550.

⁶⁴⁹ Falcone, Ennio. "Scoglimento parziale della comunione legale fra coniugi, estromissione di un singolo bene e rapporto con la pubblicità legale." në *Rivista del notariato*, 1987, Milano: Giuffrè Editore, 1987, fq. 698.

⁶⁵⁰ Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." fq. 1277.

Për të përmbledhur atë që kemi trajtuar më sipër, mundësia e bashkëshortëve për të reduktuar objektin e bashkësisë ligjore, shtrihet në këto drejtime:

- a) Përjashtimi programatik, nga bashkësia, i kategorisë së sendeve që bëjnë pjesë në bashkësinë aktuale, të parashikuara në pikat “a” dhe “d” të kod.fam.;
- b) Përjashtimi programatik, nga bashkësia, i sendeve të bashkësisë eventuale, të parashikuara nga pikat “c” dhe “ç” të kod.fam.;
- c) Përjashtimi dispozitiv, nga bashkësia, i sendeve ekzistuese. Në pjesën më të madhe të rasteve në praktikë, bashkëshortët përjashtojnë nga bashkësia veprimtarinë tregtare të krijuar nga njëri prej tyre gjatë martesës.

Bashkëshortët mund të zgjedhin të kombinojnë disa prej elementëve të sipërpërmendur ose të parashikojnë përjashtimin e të gjitha kategorive të mësipërme, me kushtin e vetëm që, bashkësia të përmbajë qoftë edhe një send të vetëm, sepse përndryshe nuk do të kishte kuptim të flisnim për regjim bashkësie.

4.6. Rregullat e administrimit dhe pjesët takuese

4.6.1. Rregullat e administrimit

Bazuar në nenin 108/b të kod.fam, bashkëshortët mund të ndryshojnë me marrëveshje rregullat e administrimit, nëse marrëveshja (kontrata martesore) nuk bie në kundërshtim me nenin 66 dhe 67 të kod.fam.

Nga leximi i kombinuar i nenit 108 me nenet 66 dhe 67 të kod.fam, vihet re që, autonomia e bashkëshortëve në drejtim të ndryshimit të rregullave të administrimit nuk është e pakufizuar⁶⁵¹. Sipas interpretimit të pjesës më të madhe të doktrinës⁶⁵², bashkëshortët nuk mund të ndryshojnë rregullat e administrimit ligjor vetëm për ato sende që ndërkohë janë objekt të bashkësisë ligjore, të parashikuara në nenet 74 dhe 75 të kod.fam., ndërsa për sendet që bashkëshortët përfshijnë me marrëveshje në bashkësinë me kontratë, duke zgjeruar objektin e saj (me kategorinë e sendeve të parashikuara në nenin 77 të kod.fam) ata kanë liri të plotë për të përcaktuar rregullat e administrimit, që më shumë i përshtaten interesave të tyre.

Parimi i mosderogimit nga rregullat e administrimit ligjor, të sanksionuar nga neni 67 i kod.fam. ka vlerë vetëm për sendet, që përbëjnë objektin e bashkësisë ligjore (neni 74 dhe 75 të kod.fam.) Por cila është “*ratio legis*” e pashmangshmërisë së rregullave ligjore të administrimit për pasuritë që janë objekt i bashkësisë ligjore (neni 74 dhe 75 i kod.fam.) Padyshim që, ratio e ndalimit është garantimi i pozitës së barazisë juridike dhe morale të bashkëshortëve në drejtimin dhe administrimin e pasurisë së përbashkët, gjatë martesës⁶⁵³. Regjimi i administrimit të bashkësisë, së parashikuar nga kod.fam. është krijuar me qëllim që ti garantojë edhe bashkëshortit që nuk ka marrë pjesë në fitimin e pasurisë së përfshirë në bashkësi, të njëjtat të drejta në administrim, që ka edhe bashkëshorti tjetër, në emër të të cilit është fituar pasuria⁶⁵⁴. Në këtë mënyrë, regjimi juridik i administrimit të përbashkët të pasurisë së bashkësisë ligjore, lidhur me veprimet e administrimit jo të zakonshëm është konsideruar nga doktrina si një parim i

⁶⁵¹ Rikujtojmë edhe një herë, që ndërsa neni 66 sanksionon parimin e autonomisë kontraktore të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, neni 67 parashikon limitet e kësaj autonomie, duke i ndaluar ndër të tjera bashkëshortëve të shmangen nga rregullat e administrimit ligjor.

⁶⁵² Për këtë interpretim shih: De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 725; Galletta, “La comunione convenzionale.” fq. 1055; Paladini, Mauro. “La comunione convenzionale.” në *Diritto della famiglia*, S. Patti, M.G. Cubeddu (Eds.), Milano: Giuffrè Editore, 2011, fq. 295.

⁶⁵³ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1271.

⁶⁵⁴ Paladini, “La comunione convenzionale.” fq. 294.

rendit publik e për rrjedhojë i pashmangshëm, thelbi i së cilit është garantimin i barazisë së bashkëshortëve në administrimin e pasurisë së përbashkët.

Nga ana tjetër, bazuar sërish në opinionin mbizotërues të doktrinës, bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë rregullat e administrimit të zakonshëm të bashkësisë ligjore, duke caktuar rregullën e administrimit të përbashkët, që ligji përcakton vetëm për veprimet e administrimit jo të zakonshëm⁶⁵⁵.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të paraqesim si më poshtë vijon, alternativat e bashkëshortëve, në drejtim të rregullimit të regjimit juridik të administrimit të bashkësisë:

A. Për atë pjesë të pasurisë së bashkësisë me kontratë, që është njëkohësisht pjesë e objektit të bashkësisë ligjore, bashkëshortët mund të vendosin:

- a) Për veprimet e administrimit jo të zakonshëm, bashkëshortët nuk mund të ndryshojnë regjimin ligjor dhe për rrjedhojë për këto veprime do të zbatohet regjimi juridik i përcaktuar nga kod.fam., i cili bazohet mbi parimin e bashkëadministrimit të bashkësisë nga të dy bashkëshortët⁶⁵⁶;
- b) Lidhur me veprimet e administrimit të zakonshëm të bashkësisë ligjore, bashkëshortët mund të ndryshojnë regjimin ligjor⁶⁵⁷, duke vendosur që edhe veprimet e administrimit të zakonshëm të kryhen me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, pra të vendosin të njëjtin regjim administrimi si për veprimet e administrimit jo të zakonshëm.

B. Për atë pjesë të pasurisë së bashkësisë me kontratë, që bashkëshortët kanë përfshirë me vullnetin e tyre të lirë në objektin e bashkësisë, duke zgjeruar objektin e saj, ata kanë të drejtë të përcaktojnë çdo rregull administrimi që konsiderojnë të arsyeshëm, si për veprimet e administrimit të zakonshëm ashtu dhe për ato të administrimit jo të zakonshëm. Në këtë drejtim ata mund të vendosin që të gjitha veprimet e administrimit të kryhen vetëm me pëlqimin e njërit bashkëshort, ose të kryhen me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, ose mund të ruajnë të njëjtin regjim administrimi, të caktuar nga ligji për bashkësinë ligjore.

4.6.2. Administrimi i përbashkët i bashkësisë

Bashkëshortët mund të vendosin rregullën e bashkëadministrimit të bashkësisë për të gjitha veprimet e administrimit, të zakonshëm ose jo të zakonshëm, si për pasurinë objekt të bashkësisë ashtu dhe për pasurinë e përfshirë rishtazi në bashkësi. Ky përfundim del nga leximi i nenit 111 të kod.fam, sipas së cilit **“Bashkëshortët mund të bien dakort që të administrojnë së bashku bashkësinë. Në këtë rast, aktet e administrimit të zakonshëm dhe të disponimit të pasurisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të të dy bashkëshortëve...”**

Formulimi i nenit 111 nuk është shumë i saktë nga pikëpamja e teknikës. Përdorimi i fjalës **“nënshkrim”** nga ana e ligjvënësit nuk është e përshtatshme. Jo të gjitha veprimet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë, duhet patjetër, nga pikëpamja formale, të realizohen në një akt të shkruar. Kod. civ. ka njohur lirinë e formës së veprimit juridik, ndërsa akti formal është detyrim ligjor vetëm për veprime juridike të caktuara.

Nga përdorimi i termit **“nënshkrim”** mund të arrijmë më dy përfundime të ndryshme: a) *së pari*, ose *“ratio”* e normës është përcaktimi i detyrimit të të dy bashkëshortëve për të kryer në formë

⁶⁵⁵ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 59.

⁶⁵⁶ Sipas nenit 90/3 të kod.fam: “Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve”.

⁶⁵⁷ Bazuar në nenin 90/1,2 të kod.fam: “Secili bashkëshort ka të drejtën e administrimit të pasurisë në bashkësi. Secili bashkëshort është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër para organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë.”

të shkruar të gjitha veprimet juridike të administrimit dhe disponimit të pasurisë, në hipotezën kur ata kanë caktuar parimin e bashkëadministrimit për të gjithë pasurinë e bashkësisë, përfundim, i cili nuk është i logjikshëm; b) ose së dyti, termi i përdorur është vetëm një lapsus dhe “ratio” e normës është vetëm të kërkojë pëlqimin e të dy bashkëshortëve në veprimet e administrimit dhe disponimit të pasurisë.

Jemi të mendimit që, alternativa e dytë është më afër qëllimit të normës dhe se nuk duhet të ndalemi në interpretimin literal të normës, por ta interpretojmë atë sipas qëllimit që ka pasur ligjvënësi në hartimin e saj.

Më shumë se sa një lapsus, pasaktësia e termit vjen nga përkthimi i nenit 111 të kod.fam mbi bazën e nenit 1503 të KC Francez, termi i cili është kritikuar edhe nga doktrina franceze për pasaktësi⁶⁵⁸.

De lege lata, megjithëse termi i përdorur është “**nënshkrim**”, *de lege ferenda*, termi më i saktë do të ishte “**pëlqim**”. *De lege ferenda*, formulimi më i saktë i normës duhet të ishte si më poshtë:

“... omissis...në këtë rast, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë bëhen me pëlqimin e përbashkët të të dy bashkëshortëve...”

Nëse njëri prej bashkëshortëve kryen një veprim administrimi apo disponimi të pasurisë së bashkësisë, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, atëherë veprimi është i pavlefshëm. Jemi në rastin e pavlefshmërisë relative të veprimit juridik.

Në këtë rast, jemi të mendimit që, do të gjej zbatim neni 94 i kod.fam, sipas së cilit, nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, mund të kërkohej nga bashkëshorti tjetër anulimi i veprimit, nëse më vonë ai nuk ka dhënë pëlqimin për këtë veprim. Bashkëshorti pëlqimi i të cilit nuk është marrë ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e veprimit brenda 1 viti nga marrja dijeni për veprimin, por në çdo rast jo më vonë se 1 vit nga mbarimi i bashkësisë.

Regjimi juridik i administrimit të përbashkët do të shtrihet vetëm për pasurinë në bashkësi dhe nuk mund të përfshijë edhe pasurinë vetjake të bashkëshortëve. Sipas nenit 64 të kod.fam. secili prej bashkëshortëve ka të drejtën e administrimit dhe të tjetërsimit lirisht të sendeve të tij vetjake, pa qenë nevoja e pëlqimit të bashkëshortit tjetër. Bazuar në nenin 65 të kod.fam., ky rregull është i pashmangshëm, dhe zbatohet pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve. Megjithatë asgjë nuk ndalon bashkëshortët që, me anë të një prokure të përgjithshme ose të posaçme, të autorizojnë njëri-tjetrin në administrimin dhe tjetërsimin e pasurisë së tyre vetjake.

Nëse njëri prej bashkëshortëve refuzon të japë pëlqimin për një veprim që është në interes të familjes, ose nuk është në gjendje që të japë pëlqimin, atëherë do të gjejnë zbatim dispozitat e administrimit të bashkësisë ligjore, të cilat i japin zgjidhje këtyre situatave, përkatësisht nenet 91⁶⁵⁹, 92 dhe 93⁶⁶⁰ të kod.fam⁶⁶¹.

⁶⁵⁸ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq.576.

⁶⁵⁹ Bazuar në nenin 91 të kod.fam., secili bashkëshort mund të kryejë i vetëm, edhe në mungesë të autorizimit të gjykatës ose të prokurës, veprime që janë të nevojshme për administrimin e pasurisë në bashkësi, për të cilat kërkohej pëlqimi i të dy bashkëshortëve, nëse bashkëshorti tjetër nuk është në gjendje të shprehë pëlqimin, për shkak të largësisë ose për shkaqe të tjera, që bëjnë të pamundur shprehjen e pëlqimit.

Veprimi i kryer nga njëri bashkëshort do të jetë i vlefshëm, nëse plotësohen dy kushte, në mënyrë kumulative:

a) Bashkëshorti tjetër nuk është në gjendje të shprehë pëlqimin, për shkak të largësisë ose për shkaqe të tjera, që e vendosin atë në kushtet e pamundësisë së shprehjes së vullnetit;

b) Veprimi i kryer duhet të jetë në interes të bashkësisë.

⁶⁶⁰ Ndërsa nenet 92 dhe 93 të kod.fam. përcaktojnë zëvendësimin e pëlqimit të njërit bashkëshort nga gjykata për një veprim administrimi ose për të gjitha veprimet e administrimit të pasurisë, nëse bashkëshorti tjetër refuzon të japë pëlqimin pa asnjë shkak të arsyeshëm, nuk është në gjendje ta japë këtë pëlqim ose tregon paaftësi në administrimin e bashkësisë.

Nëse bashkëshortët bien dakort të administrojnë së bashku bashkësinë, neni 111 i kod. fam. parashikon detyrimin solidar të bashkëshortëve për detyrimet e marra përsipër gjatë administrimit. Ky është interpretimi që mund t'i japim pjesës së fundit të nenit 111 të kod.fam, i cili sërish nuk është formuluar në mënyrën më të kënaqshme të mundshme. De lege ferenda, formulimi më i saktë do të ishte: **“...Për detyrimet që bashkëshortët marrin përsipër nën regjimin e bashkëadministrimit të bashkësisë do të përgjigjen në mënyrë solidare”**.

Gjithashtu, janë detyrime solidare, bazuar në nenin 60/1 i kod.fam, detyrimet që rrjedhin nga veprimet juridike që njëri bashkëshort kryen pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, për mirëmbajtjen e familjes ose edukimin e fëmijëve⁶⁶².

Neni 60/1 është i zbatueshëm për të gjitha regjimet pasurore, pavarësisht regjimit pasuror të bashkëshortëve, qoftë ky regjimi ligjor i bashkësisë, modifikim i tij, bashkësi universale apo regjim i pasurive të ndara.

Mbeten detyrime vetjake detyrimet që në bazë të dispozitave të regjimit të bashkësisë ligjore konsiderohen vetjake.

Në analizë të fundit, duhet theksuar që, nga njëra anë regjimi i administrimit të përbashkët i krijon mundësinë bashkëshortëve të bashkojnë jo vetëm aktivin e pasurisë, por të krijojnë një unitet edhe për sa i përket mënyrës së përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta dhe për rrjedhojë gjen zbatim në praktikë kryesisht kur bashkëshortët zgjedhin regjimin e bashkësisë universale; ndërsa nga ana tjetër paraqet disavantazhe në lidhje me fleksibilitetin e bashkësisë. Në një kohë kur kërkohet një shpejtësi më e madhe në qarkullimin e të mirave dhe shërbimeve, rregulli i pëlqimit të njëkohshëm të të dy bashkëshortëve në administrimin e bashkësisë do të sillte vonesa të tepërta në administrimin e bashkësisë dhe për rrjedhojë dëmtim të interesave të saj. Akoma më problematike, situata shfaqet, në rastin kur krijohet një klimë mosmarëveshësh ndërmjet bashkëshortëve, në administrimin e pasurisë, e cila mund të çojë në paralizën e sistemit të bashkësisë⁶⁶³.

4.6.3. Pjesët takuese në bashkësi

Nga leximi i kombinuar i neneve 108/b dhe 113 të kod.fam. rezulton që, ligjvënësi ka lejuar bashkëshortët të derogojnë, me marrëveshje ndërmjet tyre, nga parimi i barazisë absolute të pjesëve⁶⁶⁴, duke i njohur të drejtën për të pasur pjesë jo të barabarta. Bazuar në nenin 108/c dhe 113 të kod.fam. **“Bashkëshortët mund të bien dakort që të kenë pjesë jo të barabarta për pasurinë në bashkësi, ndryshe nga bashkësia ligjore”**.

Në këtë drejtim neni 108/c dhe neni 113 kanë të njëjtën përmbajtje, që të dyja dispozitat, në thelb, i japin të drejtë bashkëshortëve të caktojnë, në kontratën martesore, pjesë takuese të ndryshme nga pjesët takuese të përcaktuara nga ligjvënësi për bashkësinë ligjore. Duket e tepërt përsëritja e të njëjtit rregullim ligjor në dy dispozita të ndryshme, thuajse identike njëra me tjetrën.

Liria e bashkëshortëve për të vendosur pjesë jo të barabarta shtihet mbi të gjithë pasurinë objekt të bashkësisë me kontratë, si mbi pasurinë që është njëkohësisht objekt i bashkësisë ligjore, ashtu edhe mbi atë pjesë të pasurisë, që bashkëshortët kanë përfshirë në bashkësi në marrëveshje

⁶⁶¹ Të njetin qëndrim mban edhe doktrina franceze. Për këtë shih: Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 517; Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq.576-577.

⁶⁶² Karakteri i shpenzimeve, nëse janë në interes të familjes apo janë haptazi të tepërta vlerësohet mbi bazën e tre kriterëve, të përcaktuar nga paragrafi i dytë i nenit 60 të kod.fam., të cilat janë: mënyra e jetesës së familjes; dobishmëria e veprimit të kryer; dhe mirëbesimi apo keqbesimi i personave të tretë kontraktues.

⁶⁶³ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 520.

⁶⁶⁴ Kujtojmë këtu, që neni 103/2 i kod.fam. ka sanksionuar parimin e barazisë absolute të pjesëve të bashkëshortëve mbi pasurinë e bashkësisë ligjore, pa i njohur atyre të drejtën e provës së kontributit.

ndërmjet tyre, duke zgjeruar në këtë mënyrë objektin e saj. Bashkëshortët janë, gjithashtu, të lirë, të rregullojnë në kontratën martesore vetëm pjesët takuese, pa ndryshuar objektin e bashkësisë. Bazuar në mendimin unanimit të doktrinës, bazuar në lirinë që i jep neni 108/c bashkëshortëve, lidhur me pjesët takuese në bashkësi, ata mund të vendosin:

- a) **Pjesë jo të barabarta ndërmjet tyre.** Në këtë drejtim nuk ka asnjë kufizim lidhur me madhësinë që do të ketë pjesa takuese e secilit bashkëshort;
- b) **Shmangien nga prezumimi absolut i barazisë së pjesëve.** Bashkëshortët mund të vendosin që të kenë pjesë të barabarta ndërmjet tyre dhe t'i njohin të drejtën njëri-tjetrit, për të ndryshuar këtë barazi të pjesëve, në fazën e pjesëtimit të pasurisë, në bazë të kontributit që secili prej tyre ka realizuar në fitimin, shtimin dhe administrimin e pasurisë, gjatë martesës⁶⁶⁵.
- c) **Kombinimin e dy alternativave të mësipërme.**

Megjithëse mund të duket e tillë në pamje të parë, në rastin kur bashkëshortët vendosin për pjesë jo të barabarta ose kur vendosin përcaktimin e pjesëve takuese mbi bazën e provës së kontributit, nuk kemi të bëjmë me dhurime që bashkëshortët i bëjnë njëri-tjetrit gjatë martesës, sepse gjithmonë ekziston një relacion i drejtë ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të pasurisë së bashkësisë⁶⁶⁶. Ndryshimi i pjesëve takuese nuk do të thotë vetëm rritje e aktivitetit të pasurisë, por rritjes së aktivitetit i korrespondon gjithmonë, në përpjesëtim të drejtë, rritja e pasivitetit të saj. Ky përfundim gjen mbështetje në nenin 103/1 i kod.fam. sipas së cilit, pjesëtimit i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivitetit me pasivitetin e saj.

Përmbushja e detyrimeve të bashkësisë në përpjesëtim të drejtë me pjesët takuese është një parim i pashmangshëm. Bazuar në nenin 113 të kod.fam., në rastin kur bashkëshortët në kontratën e martesës, kanë përcaktuar pjesë jo të barabarta në bashkësi, ata ose trashëgimtarët e tyre i përballojnë detyrimet në raport me pasurinë që kanë në bashkësi ose kanë përfituar nga bashkësia.

Në këtë drejtim bashkëshortët nuk mund të vendosin pjesë të ndryshme takuese për aktivitetin dhe të tjera për pasivitetin e pasurisë.

Do të jetë e pavlefshme çdo klauzolë kontraktore, e cila ngarkon njërin bashkëshort të përmbushë më shumë detyrime në raport me ato që i takojnë, në bazë të pjesëve të tij takuese ose anasjelltas të përballojnë një detyrim më të vogël ose të përjashtohen nga përmbushja e detyrimit në raport me pjesën takuese (neni 113/2 i kod.fam.).

4.7. Bashkësia me kontratë si regjim pasuror autonom

Sipas doktrinës⁶⁶⁷ ekzistojnë dy nëntipa të regjimit të bashkësisë me kontratë:

A. Bashkësia me kontratë si **modifikim i regjimit të bashkësisë ligjore**, e cila është trajtuar gjerësisht më sipër;

B. Bashkësia me kontratë si **regjim pasuror autonom**, në të cilin bashkëshortët vendosin të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore, sipas modeleve tërësisht të ndryshme nga modeli ligjor, model i cili mund të ketë variante të panumërta, mjafton që në bazë të paragrafit të parë të nenit 108 të kod.fam të mos vijë në kundërshtim me nenet 66 dhe 67 të kod.fam.

Për shembull bashkëshortët mund të vendosin të zgjedhin regjimin e pjesëmarrjes në fitime, një regjim i tipit skandinav, i cili e ka origjinën në Kodin Civil Gjerman (BGB)

⁶⁶⁵ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 62.

⁶⁶⁶ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 527; Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." fq. 1302-1303.

⁶⁶⁷Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." fq. 1302-1303; De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia. II*, fq. 726-729.

“zugewinnngemeinschaft”. Këtë model e gjejmë prezent edhe në KC Zvicëran dhe në atë Francez (në KC Francez e gjejmë të rregulluar si regjim kontraktor)⁶⁶⁸.

Regjimi i pjesëmarrjes në fitime paraqitet si një ndërthurje ndërmjet regjimit të pasurive të ndara dhe regjimit të bashkësisë. Ky regjim realizon një ekuilibrim të dy parimeve të kundërta, të cilat ligjëvënësi mundohet gjithmonë ti vendosë në ekuilibër, parimit të solidaritetit pasuror ndërmjet anëtarëve të familjes dhe parimit të pavarësisë pasurore të bashkëshortëve⁶⁶⁹.

Regjimi i pjesëmarrjes në fitime funksionon në këtë mënyrë:

- a) **Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së martesës**, bashkëshortët ruajnë të drejtën e pronësisë, administrimit dhe disponimit të lirë të pasurisë së tyre të fituar para dhe pas lidhjes së martesës. Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së martesës, regjimi shfaqet si regjim i pasurive të ndara;
- b) **Ndërsa, në përfundim të martesës**, bashkëshortëve i njihet e drejta mbi aktivin e pasurisë së njëri-tjetrit, në formën e një të drejte kompensimi mbi shtesat e realizuara nga pasuria e tyre gjatë martesës. Në rastin e mbarimit të martesës (ose regjimit pasuror) formohet në letër një lloj regjimi bashkëpronësie, i kufizuar vetëm në blerjet e bëra gjatë martesës, në vlerë, por jo në natyrë. Vlerësohet se sa është shtuar vlera neto e secilit bashkëshort, që nga fillimi i regjimit e deri në përfundim të tij. Nga shuma më e madhe zbritet më e vogla dhe për rrjedhojë bashkëshorti që është pasuruar më pak ka të drejtën e gjysmës së diferencës⁶⁷⁰.

Pavarësisht nga regjimi pasuror i zgjedhur, bashkëshortët nuk mundet në asnjë rast të shmangen nga përbushja e kontributit material për nevojat e familjes.

Në analizë të fundit duhet ritheksuar, që ndërmjet dy poleve ekstreme të regjimeve pasurore të rregulluara nga kod.fam, regjimit të bashkësisë ligjore dhe atij të pasurive të ndara, bashkëshortët mund ti japin jetë regjimeve të ndërmjetme⁶⁷¹, të cilat mund të realizohen në variante të panumërta mjafton të mos bien në kundërshtim me normat urdhëruese të ligjit.

4.8. Transferimi, ndërmjet bashkëshortëve, i pronësisë së sendeve të veçanta gjatë martesës

Mjaft kompleks paraqitet pozicionimi në kategorinë e veprimeve juridike, të kontratave martesore të cilat përveçse rregullojnë në mënyrë programatike regjimin pasuror të bashkëshortëve, përmbajnë edhe transferimin e pronësisë së sendeve ekzistuese.

Nëse kontrata martesore, përmban përveç përcaktimit të regjimit pasuror edhe transferimin e pronësisë së sendeve të veçanta atëherë, duhen dalluar dy veprime juridike, të veçanta, si për nga natyra juridike, ashtu edhe për nga regjimi juridik, të cilit i nënshtrohen:

- a) Njëri veprim juridik është **“kontrata martesore”**, e cila përmban rregullimin programatik të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve. Ky veprim juridik do t’i nënshtrohet regjimit juridik të kod.fam, mbi kontratën martesore;
- b) Veprimi tjetër është **“kalimi i pronësisë së një/disa sendeve të veçanta nga pronësia e bashkësisë në pronësi të njërit bashkëshort, nëpërmjet përjashtimit të sendit nga bashkësia ose kalimi i pronësisë së sendit nga njëri bashkëshort në pronësi të bashkësisë, nëpërmjet zgjerimit të objektit të bashkësisë”**. Në lidhje me natyrën juridike, karakteristikat e këtij veprimi juridik dhe për rrjedhojë në lidhje me regjimin juridik që do t’i zbatohet ka mjaft diskutime në doktrinë.

⁶⁶⁸ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1304.

⁶⁶⁹ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1305.

⁶⁷⁰ Zaçe, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, fq. 105.

⁶⁷¹ Laurini, “L’esclusione parziale dalla comunione legale.” fq. 1070.

Gjithashtu, duke ruajtur të pandryshuar regjimin pasuror martesor, bashkëshortët mund të lidhin marrëveshje vetëm për transferimin e një ose disa sendeve ekzistuese, nga bashkësia në pronësinë e njërit bashkëshort ose anasjelltas.

Një diskutim, që prej kohësh ka përfshirë doktrinën juridike i referohet natyrës juridike, pra kategorizimit shkencor të marrëveshjeve të lidhura nga bashkëshortët, me objekt transferimin e një/disa sendeve të caktuara nga kategoria e sendeve vetjake në bashkësi ose përjashtimin e sendit nga bashkësia dhe njëkohësisht kalimin e tij në pronësinë e njërit bashkëshort⁶⁷².

Dy janë hipotezat e transferimit të pronësisë së sendeve të veçanta gjatë martesës:

- a) Hipoteza në të cilën, bashkëshortët zgjerojnë objektin e bashkësisë ligjore, duke përfshirë në përmbajtje të saj sende ekzistuese, të cilat janë në pronësinë vetjake të tyre, madje edhe ato të parashikuara nga neni 77/c,ç,d, sepse kufizimi ligjor në këtë rast qëndron vetëm për përfshirjen e tyre në bashkësi në mënyrë programatike, pra për të ardhmen;
- b) Hipoteza në të cilën, bashkëshortët reduktojnë objektin e bashkësisë ligjore, nëpërmjet parashikimit të përjashtimit nga bashkësia të një sendi ekzistues dhe kalimin e tij në pronësinë e njërit prej bashkëshortëve.

Meriton një vëmendje të veçantë, në këtë rast, përcaktimi i natyrës juridike të kontratës së transferimit të pronësisë së këtyre sendeve gjatë martesës. Në mënyrë të përmbledhur problemi i mësipërm shtrohet në përcaktimin nëse një kontratë e lidhur midis bashkëshortëve për transferimin e pronësisë së sendeve ekzistuese, përfshihet ose jo në kategorinë e kontratës martesore.

Ky problem mbart përveç vlerave doktrinale edhe vlera të rëndësishme praktike, sepse nga kategorizimi shkencor i këtij instituti do të varet regjimi juridik që atij i zbatohet. Nëse do të pranojmë që kjo marrëveshje përfshihet në kategorinë e kontratave martesore, atëherë duhet të pranojmë që, për të do të jetë i zbatueshëm regjimi juridik që kod.fam parashikon për kontratën martesore, duke përfshirë këtu formën noteriale, pavarësisht nga objekti material i kontratës, send i luajtshëm apo i paluajtshëm, dhe regjistrimi përveçse në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme (vetëm për sendet e paluajtshme) edhe në regjistrin e martesës (për të gjithë kategoritë e sendeve).

Në lidhje me formën e kontratës, nëse do t'i njihnim kontratës së bashkëshortëve, me objekt transferimin e pronësisë së sendeve, karakterin e kontratës martesore, atëherë duhet të pranojmë që, sipas neneve 69/1 dhe 72/2 të kod.fam. kontrata duhet të realizohet në formën e aktit noterial, "*ad substantiam*", pavarësisht nëse objekti i saj material janë sende të paluajtshme apo sende të luajtshme.

Nëse, nga ana tjetër, mbështesim tezën që nuk i njeh këtyre kontratave, karakterin e kontratës martesore, atëherë do të pohojmë që këto kontrata i nënshtrohen rregullave të parashikuara nga kod.civ. për kontratën në përgjithësi dhe për kontratat e veçanta në varësi të tipit të tyre, kontratë shitje, dhurimi apo shkëmbimi.

Ky disponim i pasurisë së njërit bashkëshort drejt bashkësisë ose anasjelltas është shumë i ngjashëm me kontratën e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve, sepse në të dyja rastet gjejmë prezent pasurimin e njërit bashkëshort nga ana e bashkëshortit tjetër, nëpërmjet një veprimi juridik që transferon të drejtën e pronësisë së sendit, pa kundërshpërblim⁶⁷³.

Një tjetër çështje që vlen për tu shtruar për diskutim për atë pjesë të doktrinës që nuk i njeh këtyre kontratave natyrën juridike të kontratës martesore, është se cila është natyra juridike e kontratës dhe nëse kemi të bëjmë në këtë rast me një kontratë dhurimi?

⁶⁷² Roy, Alain. "Le changement de qualification d'un bien en cours de régime matrimonial est-il permis?." në *La Revue du Notariat*, Vol. 102, Montréal: Mars 2000, fq. 152.

⁶⁷³ Galletta, "La comunione convenzionale." fq. 1058.

4.8.1. Kalimi i pronësisë së sendit nga pasuria vetjake e njërit bashkëshort në bashkësi.

Bashkëshortët, siç kemi diskutuar më sipër, mund të parashikojnë zgjerimin e objektit të bashkësisë, jo vetëm nëpërmjet përfshirjes në bashkësi të kategorive të sendeve të parashikuara nga neni 77 i kod.fam., por edhe nëpërmjet përfshirjes në bashkësi të një/disa sendeve ekzistuese në pronësinë vetjake të secilit prej tyre. Në këtë rast njëri bashkëshort, pronar i sendit, në mënyrë vullnetare, merr përsipër kalimin e pronësisë së sendit në bashkësi, duke u kthyer nga pronar ekskluziv në bashkëpronar të sendit, në ½ pjesë. Në këtë rast bashkëshorti pronar i kalon pa kundërshtim pronësinë e ½ pjesë të sendit bashkëshortit tjetër, duke e përfshirë sendin në bashkësinë ligjore.

Ky veprim juridik a ka karakterin e kontratës së dhurimit apo karakterin e kontratës martesore. Sipas një mendimi doktrinal, kontratat e lidhura nga bashkëshortët njëri me tjetrin, me objekt transferimin pa shpërbllim të pronësisë së një sendi të caktuar gjatë martesës, nga pronësia e njërit bashkëshort në pronësi të bashkësisë (nëpërmjet përfshirjes në bashkësi të një sendi që bën pjesë në pasurinë vetjake të njërit bashkëshort), nuk përbëjnë kontratë martesore dhe për rrjedhojë nuk do të jenë objekt i disiplinës juridike të kontratës martesore të parashikuar nga kod.fam, sepse këto kontrata nuk paraqesin natyrën programatike që është karakteristikë e kontratës martesore⁶⁷⁴. Veprimi juridik nuk përbën kontratë martesore, megjithëse nga pikëpamja formale mund të paraqitet në të njëjtin dokument me të dhe për rrjedhojë nuk i nënshtrohet regjimit juridik të kontratës martesore, por përfaqëson një lloj dhurimi indirekt, ndërmjet bashkëshortëve. Sipas një tjetër autori, këto veprime juridike, nuk mund përbëjnë kontratë martesore, në kuptimin klasik të fjalës, pikërisht sepse funksioni i tyre nuk është krijimi i një “programi” të përgjithshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore gjatë martesës, por funksioni i tyre është ai i transferimit të pronësisë së sendeve të veçanta në pronësi të njërit bashkëshort ose të bashkësisë, në derogim të regjimit ligjor ose si korrigjim i tij. Në vazhdim të këtij qëndrimi, këto veprime juridike emërtohen si **“kontrata martesore atipike”**. Sipas tij, atipizmi i kontratës martesore nuk i referohet përmbajtjes së saj, sepse bashkëshortët janë të lirë të zgjedhin regjimin që më mirë i përshtatet interesave të tyre pasurore, por objektit të kontratës. Në vazhdim të arsyetimit të tij, kontrata martesore është atipike, jo sepse ajo përmban një regjim pasuror të ndryshëm nga regjimet ligjore, por është atipike, sepse objekti i saj në rastin konkret janë **“singulas rea”**, pra sende të veçanta⁶⁷⁵. Në vazhdim të arsyetimit të tij, këto veprime juridike, i nënshtrohen regjimit juridik të kontratës martesore, sepse megjithëse nuk paraqesin natyrën programatike të saj, sjellin një **“modifikim sasior të objektit të bashkësisë”**⁶⁷⁶.

Jemi të mendimit që, megjithëse kontrata e mësipërme nuk ka natyrë programatike dhe për rrjedhojë nuk përbën kontratë martesore në kuptimin klasik të saj, do t'i nënshtrohet regjimit juridik të kontratave martesore. Arsyetimi i këtij qëndrimi gjen mbështetje në nenin 108/a të kod.fam. i cili parashikon të drejtën e bashkëshortëve për të zgjeruar objektin e bashkësisë me përfshirjen e sendeve që janë fituar prej tyre, para lidhjes së kontratës martesore. Në këtë rast ligji i jep karakterin e kontratës martesore këtij zgjerimi të bashkësisë, megjithëse ai nuk përmban natyrën klasike programatike, që karakterizon kontratën martesore.

⁶⁷⁴ Në mbështetje të kësaj teorie janë: Confortini, “La comunione convenzionale tra coniugi.” fq. 312; Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1258-1259.

⁶⁷⁵ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1259.

⁶⁷⁶ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1260.

4.8.2. Kalimi i pronësisë së sendit nga bashkësia në pasurinë vetjake të njërit bashkëshort.

Problemi paraqitet akoma më i komplikuar nëse bashkëshortët parashikojnë jo vetëm përjashtimin e sendit nga bashkësia, por kalimin njëkohësisht të tij në pronësinë e njërit bashkëshort. Në këtë hipotezë, shfaqen njëkohësisht dy veprime juridike:

- a) Veprimi juridik i reduktimit të objektit të bashkësisë, nëpërmjet përjashtimit të sendit/sendëve të caktuara;
- b) Veprimi juridik i kalimit të sendit në pronësi të njërit bashkëshort. Njëri bashkëshort në mënyrë vullnetare dhe pa kundërshtim, heq dorë nga pronësia mbi ½ pjesë të këtij sendi dhe e transferon atë në pronësi të bashkëshortit tjetër, i cili nga pronar mbi ½ pjesë të sendit, fiton pronësinë mbi të gjithë sendin. Ky veprim i dytë juridik, shfaq karakteristikat e kontratës së dhurimit.

Në vazhdimin e mëtejshëm të diskutimit, mund të pohojmë që bashkëshortët mund ta realizojnë këtë qëllim pra transferimin e pronësisë së sendit nga bashkësia në pronësi të njërit prej tyre, edhe nëpërmjet kontratës së dhurimit, objekti i së cilës do të jetë kalimi i pronësisë së ½ pjesë të sendit nga njëri bashkëshort (bashkëpronar) në pronësi të bashkëshortit tjetër, i cili është pronar i ½ pjesë të sendit dhe do të kthehet tashmë në të vetmin pronar të sendit.

4.9. Mbarimi i bashkësisë me kontratë

4.9.1. Rastet e mbarimit të bashkësisë me kontratë

Bazuar në nenin 108/2 i kod.fam, për të gjithë elementët që nuk gjejnë rregullim në kontratën martesore do të zbatohen dispozitat e regjimit të bashkësisë ligjore. Për rrjedhojë, arrijmë në përfundimin që, mbarimit të bashkësisë me kontratë do t'i zbatohen i njëjti regjim juridik i parashikuar nga neni 96 i kod.fam. për përfundimin e bashkësisë ligjore.

Sipas doktrinës, rrethanat e parashikuara nga kod.fam. për përfundimin e regjimit të bashkësisë, i klasifikojmë në tre grupe⁶⁷⁷.

A. Shkaqet ligjore të mbarimit të bashkësisë me kontratë. Janë shkaqe ligjore të përfundimit të bashkësisë:

- a) *Vdekja e njërit prej bashkëshortëve ose shpallja i vdekur i njërit prej tyre;*
- b) *Zgjidhja e martesës;*

Këto tre shkaqe, zgjidhja e martesës, vdekja ose shpallja e vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, sjellin njëkohësisht edhe përfundimin e martesës.

c) *Shpallja e zhdukjes së njërit prej bashkëshortëve. Ratio e ligjvënësimit në parashikimin e rrethanës së shpalljes së zhdukjes së njërit prej bashkëshortëve, rrethanë e cila nuk i jep njëkohësisht fund martesës, është “mungesa e prezumimit të kontributit të përbashkët të bashkëshortëve në fitimin e pasurisë, prezumim që qëndron në thelbin e bashkësisë ligjore”⁶⁷⁸.*

⁶⁷⁷ Omari, *E drejtë familjare*, fq. 76.

⁶⁷⁸ Në doktrinë dhe praktikë kanë lindur diskutime të ndryshme, mbi regjimin ligjor që do të vazhdojë të rregullojë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, nga data e zhdukjes së personit, deri në datën kur ky person të shfaqet ose martesë përfundon. Sipa doktrinës, për periudhën e mungesës së njërit bashkëshort (mungesë e shpallur me vendim gjyqësor) për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve nuk mund të zbatohet regjimi i bashkësisë me kontratë, për shkak të mungesës së kontributit të përbashkët të bashkëshortëve, por do të gjejë zbatim regjimi i pasurive të ndara. Megjithatë ligji hesht, në këtë pikë, ky është i vetmi përfundim i logjikshëm që mund të arrihet, duke zbatuar me analogji nenin 98/3 i kod.fam, nën i cili i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive të ndara, nëse realizohet pjestimi gjyqësor i bashkësisë. Për më shumë shih: Dogliotti Massimo. “Rapporti patrimoniali tra

Në lidhje me bashkëshortët, data e mbarimit të bashkësisë do të jetë data e caktuar në vendimin gjyqësor si data e vdekjes apo e zhdukjes së njërit bashkëshort, ndërkohë në raport me të tretët, mbarimi i bashkësisë do t'i sjellë efektet nga data kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë⁶⁷⁹.

d) *Shpallja e pavlefshme e martesës*. Martesa e pavlefshme apo ajo që shpallet e pavlefshme, konsiderohen nga ligji sikur të mos kishin ekzistuar kurrë dhe shuhen me efektet prapaveprues çdo pasojë që ato kanë sjellë për bashkëshortët, ligji (neni 96/1,a i kod.fam.).

B. Mbarimi gjyqësor i bashkësisë me kontratë. Bazuar në nenin 96/b e kod.fam, bashkësia përfundon për shkak të pjesëtimit gjyqësor të sendeve, sipas rrethanave të parashikuara nga neni 98 i kod.fam.

Pjesëtimi gjyqësor i pasurisë gjatë regjimit të bashkësisë, sipas parashikimeve të nenit 98 të kod.fam do të sjellë si pasojë jo vetëm përfundimin e regjimit të bashkësisë, por vendosjen e bashkëshortëve nën regjimin e pasurive të ndara. Regjimi i pasurive të ndara zbatohet, me efekte prapavepruese, që nga data e paraqitjes së kërkesës për pjesëtimin e pasurisë.

Gjejmë sërish vend për të sjellë në vëmendje që, neni 98 i kod.fam. do të gjejë zbatim edhe mbi regjimin e bashkësisë me kontratë për shkak të parashikimeve të nenit 108/3 i kod.fam.

C. Mbarimi vullnetar i bashkësisë me kontratë. Regjimi pasuror i bashkësisë me kontratë do të përfundojë edhe nëse bashkëshortët vendosin të ndryshojnë regjim me anë të një kontrate të re martesore.

Së pari, kontrata e re martesore sjell përfundimin e regjimit të bashkësisë me kontratë, vetëm nëse bashkëshortët në kontratën e re, vendosin një regjim të ri, të ndryshëm nga regjimi i bashkësisë me kontratë, si psh: regjimin e pasurive të ndara, ose regjimin e pjesëmarrjes në fitime.

Së dyti, nëse nëpërmjet kontratës së re, bashkëshortët realizojnë vetëm disa modifikime të regjimit ekzistues të bashkësisë me kontratë, atëherë bashkësia nuk përfundon. Ky përfundim logjik rezulton dhe nga leximi i nenit 96/c i kod.fam. **“ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjell mbarimin e bashkësisë”**.

D. Diskutime të shumta ka në doktrinë edhe në lidhje me çështjen e shtrirjes së autonomisë kontraktore të bashkëshortëve në drejtim të modifikimit të shkaqeve për të cilat ligji (neni 96 i kod.fam) parashikon përfundimin e bashkësisë.

A mundet që, bashkëshortët në bashkësinë me kontratë mund të parashikojnë të tjera raste të mbarimit të bashkësisë, përveç atyre të parashikuara nga neni 96 i kod.fam. Raste të tjera të mbarimit të bashkësisë me kontratë mund të jenë psh: ndarja faktike e bashkëshortëve (veçimin personal), humbja e zotësisë për të vepruar të njërit prej tyre, braktisja e banesës familjare etj?

Anasjelltas, a mundet që, bashkëshortët të përjashtojnë një nga rrethanat që i jep fund regjimit të bashkësisë, të parashikuara nga neni 96 të kod.fam.

Një pjesë e doktrinës është e mendimit që, bashkëshortët nuk mund të zgjerojnë ose ngushtojnë rrethin e rrethanave që sjellin mbarimin e bashkësisë, sepse këto rrethana janë të parashikuara në mënyrë taksative nga ligji, duke njohur kështu karakterin urdhërues të nenit 96 të kod.fam⁶⁸⁰.

Të tjerë autorë shprehen që, ndalimi i bashkëshortëve për të modifikuar rregullat ligjore të mbarimit të bashkësisë me kontratë i referohet vetëm rastit kur palët vendosin të modifikojnë

coniugi: Lo scoglimento della comunione legale e convenzionale.” në *Studi in onore di Pietro Schlesinger I*, Milano: Giuffrè Editore, 2004, fq. 472.

⁶⁷⁹ Carleo, Liliana R. “Cause di scioglimento della comunione.” në *La comunione legale*, Tomo II, B. Massimo (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 1989, fq. 871.

⁶⁸⁰ Salomone, Luigi M, “Lo scoglimento della comunione legale dei coniugi.” fq. 276.

regjimin ligjor, sipas nenit 108 të kod.fam, ndërsa në rast se bashkëshortët vendosin të zgjedhin një regjim pasuror kontraktor autonom (si psh: regjimi i pjesëmarrjes në fitime) atëherë bashkëshortët janë të lirë të modifikojnë rastet ligjore të mbarimit të bashkësisë me kontratë⁶⁸¹. Megjithatë mjaft autorë të tjerë, i njohin autonomisë private të bashkëshortëve një fushë më të gjerë zbatimi, duke njohur të drejtën e tyre për të parashikuar të tjera rrethana, që i japin fund bashkësisë me kontratë, përveç atyre të parashikuara nga ligji

E rëndësishme në këtë rast, shprehet doktrina, është plotësimi i dy kushteve:

- a) Rrethana që i jep fund bashkësisë ligjore duhet të jetë objektivist e vërtetueshme dhe verifikimi i realizimit apo jo të saj të mos i lihet diskrecionit të bashkëshortëve⁶⁸²;
- b) Duhet të garantohet mbrojtja e interesave të të tretëve, nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e martesave të rastit që i jep fund bashkësisë me kontratë⁶⁸³.

Nëse, bashkëshortët kanë parashikuar në kontratën e martesës një rrethanë që i jep fund bashkësisë, përveç atyre të nenit 96 të kod.fam, por pa u shprehur për regjimin pasuror që do të zbatohet pas verifikimit të saj, atëherë, lind pyetja, cili është regjimi pasuror që do të zbatohet pas verifikimit të kësaj rrethane, që sjell përfundimin e bashkësisë?

Sipas një autori italian, bashkëshortët do të kalonin automatikisht nga regjimi i bashkësisë në regjimin e pasurive të ndara. Pikërisht këtu qëndron problemi vazhdon arsyetimin e tij ky autor, do të kishim kalimin automatik nga regjimi i bashkësisë në regjimin e pasurive të ndara, regjim i cili mund të zbatohet vetëm nëse bashkëshortët e parashikojnë shprehimisht në kontratën martesore, ose nëse verifikohet rrethana e parashikuar nga neni 98 i kod.fam. Për rrjedhojë, sipas tij, bashkëshortët nuk mund të parashikojnë të tjera rrethana të përfundimit të bashkësisë⁶⁸⁴.

Nga ana tjetër shtrohet diskutimi i reduktimit të shkaqeve të përfundimit të bashkësisë, të parashikuara nga neni 96 i kod.fam. A mund të shtrihet liria kontraktore e bashkëshortëve, deri në përjashtimin e një/disë shkaqeve të përfundimit të bashkësisë, që janë të parashikuara në neni 96 të kod.fam?

Qëndrimi i doktrinës, për këtë problem, është gati unanim, autorë të ndryshëm shprehen kundër mundësisë së përjashtimit të rrethanave që ligji përcakton për përfundimin e bashkësisë ligjore, sepse të gjitha këto rrethana janë të lidhura ngushtësisht me përfundimin e marrëdhënies martesore⁶⁸⁵ (si psh: vdekja ose shpallja e vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, zgjidhja ose shpallja e pavlefshme e martesës), marrëdhënie jashtë së cilës nuk mund të ekzistojë regjimi pasuror martesor; ose disa prej tyre janë të lidhura me pushimin e gjendjes së prezumimit të kontributit të përbashkët të bashkëshortëve në fitimin e pasurisë (si psh: shpallja e zhdukjes së njërit bashkëshort, pjesëtimi gjyqësor të sendeve).

Janë absolutisht të pavlefshme, ato klauzola të kontratës martesore, që parashikojnë shtrirjen e efekteve të regjimit të bashkësisë me kontratë (në vija të përgjithshme të çdo regjimi pasuror) edhe pas përfundimit të martesës.

4.9.2. Mbarimi i pjeshëm i bashkësisë me kontratë

A mund të flasim për mbarim të pjeshëm të bashkësisë me kontratë?

Ashtu siç e kemi përmendur tashmë, në mungesë të një rregullimi të shprehur nga ana e ligjit, mendimi i doktrinës është ndarë ndërmjet autorëve që nuk pranojnë në asnjë rast mundësinë e

⁶⁸¹ De Paola, Vincenzo dhe Macri, Antonio. *Il nuovo regime patrimoniale della famiglia*. Milano: Giuffrè Editore, 1978. *Apud*. Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." fq. 1242.

⁶⁸² Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." fq. 1243.

⁶⁸³ Pittalis, "Modifiche convenzionali alla comunione dei beni." fq. 535.

⁶⁸⁴ Mendim i referuar në: Pittalis, "Modifiche convenzionali alla comunione dei beni." fq. 535.

⁶⁸⁵ Pittalis, "Modifiche convenzionali alla comunione dei beni." fq. 536.

mbarimit të pjesshëm të bashkësisë dhe atyre autorëve të cilët shprehen në favor të mbarimit të pjesshëm.

Në parantezë, duhet pohuar që, mbarimi i pjesshëm i bashkësisë, në asnjë rast, nuk duhet kuptuar si mundësia e vazhdimit të regjimit pas verifikimit të një prej shkaqeve që përcaktojnë mbarimin e tij (neni 96 kod.fam), por duhet kuptuar si mbarim i regjimit për atë pjesë të sendeve që nxirren nga bashkësia, nëpërmjet kontratës martesore⁶⁸⁶, e cila sjell reduktimin e objektit të bashkësisë, jo vetëm në mënyrë programatike, por edhe për sende ekzistuese, pjesë e bashkësisë.

Sipas shumicës së autorëve, përjashtimi i sendeve nga bashkësia nuk sjell mbarimin e bashkësisë për sendet e përjashtuara, sepse nuk është i pranueshëm një mbarimi i pjesshëm i bashkësisë. Në vazhdim të këtij qëndrimi, të tjerë autorë shprehen që, reduktimi i objektit të bashkësisë, nëpërmjet përjashtimit të sendeve të veçanta nuk do të sjellë mbarimin e pjesshëm të saj, sepse nuk kemi ndryshim të regjimit pasuror, bashkëshortët vazhdojnë të jenë të martuar nën regjimin e bashkësisë, vetëm se tashmë me një objekt të më të reduktuar në raport me atë të bashkësisë ligjore⁶⁸⁷.

Ndërkohë një pjesë tjetër e autorëve e shikojnë plotësisht të mundshëm, mundësinë e mbarimit të pjesshëm të bashkësisë. Sipas tyre, është plotësisht e ligjshme, përjashtimi nga bashkësia, nëpërmjet kontratës martesore, i një apo disa sendeve të caktuar. Ashtu siç është e mundur për bashkëshortët të kalojnë nga regjimi i bashkësisë në regjimin e pasurive të ndara, nuk ka asnjë arsye pse t'i ndalohet atyre e drejta e përjashtimit të disa sendeve të veçanta nga objekti i bashkësisë. Në një hipotezë të tillë do të kemi mbarimin e pjesshëm të bashkësisë, vetëm për sendet e përjashtuara dhe për rrjedhojë atyre do t'i zbatohet i njëjti regjim juridik si në rastin e mbarimit në total të bashkësisë, për shkak të verifikimit të një prej rrethanave të përcaktuara nga neni 96 i kod.fam⁶⁸⁸.

Më sipër kemi mbajtur qëndrimin që, regjimi i bashkësisë me kontratë, sipas parashikimeve të nenit 108 të kod.fam. përbën thjesht një modifikim të regjimit të bashkësisë ligjore dhe jo një regjim pasuror autonom. Në vazhdim të qëndrimi që nuk i njeh karakterin autonom regjimi të bashkësisë me kontratë, jemi të mendimit që, kalimi nga regjimi i bashkësisë ligjore në regjimin e bashkësisë me kontratë nuk sjell mbarimin e regjimit të bashkësisë ligjore, por ky regjim vazhdon të veprojnë sipas modifikimeve që bashkëshortët kanë bërë dhe për rrjedhojë bashkëshortët nuk mund të pjesëtojnë pasurinë objekt të tij.

4.9.3. Pasoja e mbarimit të regjimit të bashkësisë me kontratë

Mbarimi i bashkësisë me kontratë sjell si pasojë pushimin e efekteve të bashkësisë me kontratë për të ardhmen, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër transformimin e regjimit të bashkësisë me kontratë në regjimin e bashkëpronësisë në pjesë⁶⁸⁹, të rregulluar nga dispozitat e kod.civ. Pas verifikimit të njërit prej shkaqeve të parashikuara nga neni 96 i kod.fam., ose të një shkakut të parashikuar nga vetë bashkëshortët në kontratë, bashkësia me kontratë nuk do të prodhojë më pasoja për të ardhmen.

⁶⁸⁶ Carpino, Brunetto. "Effetti dello scioglimento." në *La comunione legale*. Tomo II, M. Bianca, Milano: Giuffrè Editore, 1989, fq. 942.

⁶⁸⁷ Pittalis, "Modifiche convenzionali alla comunione dei beni." fq. 544. Gjithashtu për këtë mendim shiko: De Paola, *Il regime patrimoniale e della famiglia*, fq. 724.

⁶⁸⁸ Në mbështetje të tezës së mbarimit të pjesshëm të bashkësisë shih: Carpino, "Effetti dello scioglimento." fq. 944.

⁶⁸⁹ Në lidhje me regjimin juridik që do t'i zbatohet regjimit të bashkësisë nga momenti i përfundimit të tij deri në momentin e pjestimit të bashkësisë, ka mendime të ndryshme në doktrinë, të cilat do t'i pasqyrojmë pak më poshtë, por mendimi mbizotërues është që, do të gjejë zbatim regjimi i bashkëpronësisë në pjesë, për sa i takon rregullave të administrimit që do t'i zbatohen pasurisë së bashkësisë gjatë këtij harku kohor.

Në lidhje me pasojat që sjell mbarimi i regjimit të bashkësisë me kontratë mbi regjimin pasuror martesor të bashkëshortëve, duhen marrë në analizë dy hipoteza:

A. Bashkësia me kontratë mbaron për shkak të mbarimit të martesës.

Në këtë hipotezë mbarimi i martesës sjell si pasojë, mbarimin e bashkësisë me kontratë dhe njëkohësisht të regjimit pasuror martesor. Në asnjë rast regjimi pasuror (ligjor apo kontraktor) nuk mund t'i mbijetojë përfundimit të martesës. Pas mbarimit të martesës, bashkëshortët janë të lirë të vendosin pjesëtimin e pasurisë objekt të bashkësisë me kontratë ose të ruajnë gjendjen e bashkëpronësisë.

B. Bashkësia me kontratë mbaron gjatë martesës, për shkak të vullnetit të bashkëshortëve ose për shkak të një vendimi gjyqësor (neni 98 të kod.fam).

Në këtë hipotezë, mbarimi i bashkësisë me kontratë nuk do të sjellë njëkohësisht edhe mbarimin e regjimit pasuror martesore. Në vazhdim të martesës, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve do të rregullohen nga:

- a) Një regjim tjetër kontraktor i zgjedhur nga bashkëshortët. Ky rast paraqitet në hipotezën kur bashkëshortët lidhin një kontratë të re martesore, që parashikon një regjim pasuror krejt të ndryshëm nga regjimi i bashkësisë me kontratë. Për shembull: regjimi i pasurive të ndara ose regjimi i pjesëmarrjes në fitime. Regjimi i bashkësisë me kontratë nuk mbaron nëse bashkëshortët në kontratën e re martesore, realizojnë disa modifikime të regjimit të bashkësisë me kontratë, por pa ndryshuar thelbin e tij.
- b) Regjimi i pasurive të ndara, në rastin kur ka një vendim gjykate për pjesëtimin e pasurisë së bashkësisë, sipas kushteve të parashikuara nga neni 98 i kod.fam. vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurisë i vendos bashkëshortët menjëherë në regjimin e pasurive të ndara, që nga çasti i paraqitjes së kërkesës për pjesëtim.
- c) Regjimi i bashkësisë ligjore, nëse bashkëshortët, në kontratën e re, kanë vendosur vetëm mbarimin e regjimit të bashkësisë me kontratë, pa u shprehur për regjimin që do të zbatohet pas tij. Ky rast paraqitet në hipotezën e lidhjes së një kontrate martesore me objekt shuarjen e regjimit të bashkësisë me kontratë, ose kur verifikohet një rrethanë ligjore ose kontraktore, që i jep fund regjimit të bashkësisë me kontratë.

Kalimi nga regjimi i bashkësisë me kontratë drejt regjimit të bashkësisë ligjore, nuk sjell përfundimin e regjimit të bashkësisë, i cili vazhdon, por do të sjellë përfundimin e pjeshëm të bashkësisë për ato kategori sendesh të cilat nuk do të jenë më pjesë e regjimit të bashkësisë ligjore⁶⁹⁰.

4.10. Pjesëtimi i pasurisë së bashkësisë me kontratë

Me verifikimin e një prej rrethanave të nenit 96 të kod.fam. bashkësia me kontratë pushon së prodhuari efekte për të ardhmen, por gjendja e bashkëpronësisë mbi pasurisë e përbashkët vazhdon deri në momentin që bashkëshortët vendosin pjesëtimin e saj ose njëri prej tyre kërkon pjesëtimin gjyqësor. Pas përfundimit të regjimit të bashkësisë me kontratë, bashkëshortët janë të lirë të vazhdojnë të ruajnë gjendjen e bashkëpronësisë mbi pasurinë e fituar gjatë këtij regjimi, ose të vendosin t'i japin fund bashkëpronësisë, nëpërmjet pjesëtimin të pasurisë.

Mbarimi dhe pjesëtimi i bashkësisë me kontratë janë dy faza të ndryshme, dhe si rregull i përgjithshëm, në aspektin kronologjik, mbarimi i paraprin pjesëtimin të bashkësisë. Pjesëtimi është vetëm një fazë eventuale, jo e domosdoshme, që mund të realizohet pas mbarimit të

⁶⁹⁰ Për më shumë rreth kësaj qëndrimi shih: De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 659-660.

bashkësisë⁶⁹¹. Vetëm në një rast specifik, të trajtuar më sipër, është pjesëtimi që pasjellë dhe për rrjedhojë i paraprin, përfundimit të bashkësisë, rasti i pjesëtimin gjyqësor të bashkësisë, së parashikuar nga neni 98 i kod.fam., nen, i cili do të gjejë zbatim edhe në rastin e bashkësisë me kontratë.

Shkaqet e mbarimit të bashkësisë me kontratë, sjellin si pasojë pushimin për të ardhmen të efekteve të bashkësisë, verifikimi i tyre nuk i jep fund bashkëpronësisë së bashkëshortëve mbi sendet e fituara nën këtë regjim, por thjesht sjell ndërprerjen e bashkësisë me kontratë për të ardhmen.

Nga ana tjetër, pjesëtimi i pasurisë së bashkësisë, që realizohet gjithmonë pasi bashkësia ka përfunduar, me përjashtim të hipotezës së pasqyruar në nenin 98 të kod.fam, sjell si pasojë përfundimin e bashkëpronësisë së bashkëshortëve mbi pasurinë e fituar gjatë regjimit të bashkësisë.

Ndërsa mbarimi i bashkësisë realizohet automatikisht me verifikimin e njërës prej shkaqeve të parashikuara nga neni 96 i kod.fam, pjesëtimi i pasurisë së bashkësisë është një zgjedhje e palëve (bashkëshortëve), zgjedhje e cila verifikohet në momentin që palët e gjykojnë më të përshtatshëm⁶⁹².

Diskutime të shumta në doktrinë ka mbi regjimin juridik që do të zbatohet pasurisë objekt të bashkësisë, gjatë periudhës kohore që shtrihet, nga mbarimi i bashkësisë deri në pjesëtimin e saj, nëse do të jetë regjimi i bashkëpronësisë në pjesë (rregulluar nga dispozitat e kod.civ), apo do të vazhdojë të zbatohet regjimi i bashkësisë (rregulluar nga kontrata e bashkëshortëve).

Në mënyrë gati unanime, doktrina është shprehur që, pasurisë, objekt të bashkësisë me kontratë, pas përfundimit të regjimit të bashkësisë deri në momentin kur të realizohet pjesëtimi do t'i zbatohet regjimi juridik i bashkëpronësisë në pjesë, të rregulluar në dispozitat e kod.civ⁶⁹³. Regjimi i bashkëpronësisë në pjesë do të gjejë zbatim lidhur me regjimin juridik që do t'i zbatohet administrimit të pasurisë. Pas këtij momenti, administrimi i pasurisë do t'i nënshtrohet regjimit juridik të parashikuar nga kod.civ. për bashkëpronësinë në pjesë, i cili ndryshon nga regjimi i administrimit të bashkësisë.

Nuk mund të pranohet vazhdimi i zbatimit të regjimit të bashkësisë me kontratë, zbatimi i të cilit lidhet me kohëzgjatjen e martesës.

Megjithatë, në doktrinë nuk mungon edhe opinioni i kundërt, sipas së cilit, pas përfundimit të bashkësisë deri në momentin e pjesëtimin do të vazhdojë të zbatohet regjimi i bashkësisë⁶⁹⁴. Gjithashtu, ekziston një tjetër zgjidhje që propozon kalimin e pasurisë së bashkësisë në një “fazë likuidimi”, si në rastin e shoqërisë së thjeshtë⁶⁹⁵.

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi mund të realizohet në dy rrugë: a) **pjesëtimi vullnetari i pasurisë**, që realizohet mbi bazën e marrëveshjes/kontratës së pjesëtimin ose; b) **pjesëtimi gjyqësor i pasurisë** në bashkësi. Bashkëshortët mund të realizojnë pjesëtimin vullnetar edhe nëse kanë filluar ndërkohë procedurën gjyqësore të pjesëtimin të pasurisë. Në këtë rast, gjykata e zgjidh çështjen me pajtim dhe miraton marrëveshjen e palëve, nëse e gjen atë në përputhje me ligjin. Kështu, në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁹⁶, paditësi dhe e paditura kanë lidhur martesë në 23.11.1982, martesë e cila është zgjidhur me vendim gjyqësor në datë 30.04.2009. Paditësi kërkon në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pjesëtimin e pasurisë së fituar gjatë martesës, pasuri e cila përbëhet nga dy apartamente banimi. Në seancat gjyqësore

⁶⁹¹ Mora, Andrea. *Il contratto di divisione*. Milano: Giuffrè Editore, 1995, fq. 174.

⁶⁹² Montecchiari, Tiziana. “In tema di forma e contenuto delle convenzioni mstrimoniali modificative.” në *Il diritto di famiglia e delle persone*, Milano: Giuffrè Editore, 1997, fq. 1333-1334.

⁶⁹³ Mora, *Il contratto di divisione*, fq. 175; Fusaro, “Il regime patrimoniale della famiglia.” fq. 525.

⁶⁹⁴ Furgiule, Giovanni. *Liberta e famiglia*. Giuffrè Editore: Milano, 1979, fq. 189.

⁶⁹⁵ De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 638.

⁶⁹⁶ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3921, datë 20.04.2012.

palët ndërgjyqëse kanë arritur pajtimin mes tyre, i pasqyruar në marrëveshjen për pjesëtimin e pasurisë, e lidhur me akt noterail, datë 19.04.2012. Në marrëveshjen e pjesëtimi palët ndërgjyqëse kanë përcaktuar objektin e bashkëpronësisë (neni 2 dhe neni 3⁶⁹⁷), pjesët takuese të secili prej tyre (1/2 pjesë ideale - neni 1⁶⁹⁸) si dhe kanë realizuar pjesëtimin faktik të pasurisë, duke marrë secili prej bashkëshortëve nga një apartament në pronësinë e tij (neni 5, 6 dhe neni 7)⁶⁹⁹. Marrëveshja e palëve për pjesëtimin e pasurisë së fituar gjatë martesës, pas shqyrtimit nga gjykata është miratur si e bazuar në ligj.

E drejta e bashkëshortëve për të pjesëtuar vullnetarisht, nëpërmjet kontratës së pjesëtimi të pasurisë, pasurinë e bashkësisë është një nga aspektet e shfaqjes së autonomisë së vullnetit në rregullimin e marrëdhënieve pasurore. Pjesëtimi gjyqësor, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, realizohet në rastin kur bashkëpronarët (bashkëshortët) nuk bien dakort për pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi. E drejta për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë në bashkësi, në rrugë gjyqësore është një e drejtë që mund të ushtrohet në çdo kohë, është e paparashkrueshme. Gjithashtu është e pavlefshme çdo marrëveshje që i kufizon bashkëshortëve të drejtën për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë në bashkësi, nëpërmjet vendosjes së afateve apo kushteve, apo që parashikon heqjen dorë nga e drejta e pjesëtimit.

Pjesëtimit i pasurisë rregullohet nga zbatimi i kombinuar i dispozitave të kod.fam. mbi pjesëtimin e bashkësisë ligjore, dispozitave të kod.civ. mbi pjesëtimin e bashkëpronësisë në pjesë, dhe dispozitave të kod.proc.civ. që rregullojnë aspektin procedural të pjesëtimit të pasurisë në bashkëpronësi.

Në nenin 103/1 i kod.fam është sanksionuar një nga parimet më të rëndësishme të pjesëtimit të pasurisë së bashkësisë, parimi i barazisë së aktivitetit me pasivitetin e pasurisë: ***“pjesëtimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivitetit dhe pasivitetit të saj.”***

Pozita juridike e secilit bashkëshort mbi pasurinë e bashkësisë është zotërimi i së drejtës së pronësisë mbi pjesën takuese, në tërësi, mbi të gjithë pasurinë e bashkësisë dhe nuk duhet kuptuar në asnjë rast si shuma e të drejtës së pronësisë mbi pjesët takuese të sendeve të veçanta, që përbëjnë objektin e bashkësisë⁷⁰⁰.

Bazuar në këtë parim, që sanksionon karakterin unitar të objektit të pasurisë së bashkësisë, një pjesë e doktrinës është e mendimit që, në pjesëtimin e bashkësisë, duhet të gjejë zbatim, me analogji, disiplina ligjore e pjesëtimit të pasurisë trashëgimore. Në të dy institutet, atë të pjesëtimit të pasurisë trashëgimore dhe atë të pjesëtimit të pasurisë së bashkësisë, objekti i pjesëtimit është e gjithë pasuria dhe jo sendet e veçanta që e përbëjnë atë⁷⁰¹.

⁶⁹⁷ Neni 2 i marrëveshjes, i titulluar Përbërja e bashkësisë ligjore, parashikon që: *“Bashkësia ligjore përbëhet nga këto pasuri: a) Apartamenti me numër pasurie X, zona kadastrale Y, me sipërfaqe 106 m², i cili rezulton i regjistruar në ZRPP në emër të të paditurës; b) Apartamenti me numër pasurie Z, zona kadastrale Y, me sipërfaqe 63 m², i cili rezulton i regjistruar në ZRPP në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve”*. Sipas nenit 3 të marrëveshjes: *“Objekti i Akt marrëveshjes është likuidimi i bashkësisë ligjore të palëve dhe pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore të përshkruar në nenin 2 të marrëveshjes”*.

⁶⁹⁸ Bazuar në nenin 1 të marrëveshjes *“...palët deklarojnë se pasuria e vënë gjatë martesës është pasuri e përbashkët e të dy palëve me nga 1/2 pjesë secila”*.

⁶⁹⁹ Sipas nenit 5 të marrëveshjes *“Pjesëtimi do të bëhet me pjesë takuese në natyrë duke marrë secili nga pjesëtuesit nga një një apartament në pronësinë e tij sipas kushteve të kësaj marrëveshje”*. Ndërsa në nenin 6 dhe 7 të marrëveshjes përcaktohet pjesëtimi në natyrë dukë parashikuar që *“Pala e parë (paditësi) heq dorë nga pjesa e tij takuese mbi apartamentin 106 m² dhe merr në pronësi apartamentin 63 m², ndërsa pala e dytë (e paditura) heq dorë nga bashkëpronësia mbi apartamentin 63 m² dhe merr në pronësi apartamentin 106m²”*.

⁷⁰⁰ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 752.

⁷⁰¹ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 752.

Parimi i barazisë së aktivitetit me pasivin e pasurisë në bashkësi, sipas mendimit mbizotërues të doktrinës⁷⁰², është një parim i pashmangshëm, sepse qëndron në thelb të regjimit të bashkësisë, të qëllimit që ligji ka pasur për t'i bërë të dy bashkëshortët, në mënyrë të barabartë, pjesëmarrës në marrëdhëniet pasurore të lindura gjatë martesës.

Nëse bashkëshortët nuk kanë përcaktuar pjesë të ndryshme, pjesëtimi do të realizohet në pjesë të barabarta ndërmjet bashkëshortëve, ose sipas pjesëve të përcaktuara nga bashkëshortët në kontratën e martesës. Asgjë nuk ndalon bashkëshortët që të ndryshojnë pjesët takuese ose të vendosin zbatimin e parimit të “provës së kontributit” në momentin e pjesëtimit të bashkësisë. Parimi i barazisë së pjesëve është një parim nga i cili bashkëshortët mund të shmangen, bazuar në nenin 108 të kod.fam.

Gjithashtu, në fazën e pjesëtimit bashkëshortët, në marrëveshje ndërmjet tyre, mund të reduktojnë objektin e bashkësisë, duke përjashtuar sende të veçanta.

Diskutime në doktrinë ka në lidhje me mundësinë e bashkëshortëve për të shmangur, me marrëveshje, zbatimin e institutit të **“kthimeve dhe kompensimeve”** të bashkësisë në drejtim të bashkëshortëve dhe anasjelltas si dhe mundësinë e shmangies së zbatimit të **“provës së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme”**. Sipas doktrinës, bashkëshortët mund të shmangin zbatimin e kthimeve dhe kompensimeve⁷⁰³ si dhe të provës së sendeve të luajtshme dhe paluajtshme. Në këto hipoteza, jemi përpara dhurimeve indirekte.

⁷⁰² Për këtë qëndrim shih: De Paola, *Il regime patrimoniale della famiglia*, fq. 710; Mora, *Il contratto di divisione*, fq.181; Zavaglia, Susanna. “La comunione legale, lo scioglimento.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Arceri, M. Bernardini, Rimini: Maggiolino Ed., 2009, fq. 804.

⁷⁰³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 580.

KAPITULLI V

REGJIMI I PASURIVE TË NDARA

5.1. Natyra juridike, karakteristikat dhe burimet e krijimit të regjimit të pasurive të ndara

5.1.1. Natyra juridike

Në Kreun IV të Titullit të III të kod.fam., i sistemuar menjëherë pas regjimit të bashkësisë me kontratë, gjen rregullim regjimi i pasurive të ndara.

Së bashku me regjimin e bashkësisë me kontratë, regjimi i pasurive të ndara përfaqëson një nga dy regjimet kontraktore tipike, që gjejnë rregullim të plotë në kod.fam (nenet 115-22).

Në doktrinë, regjimi i pasurive të ndara është përkufizuar si regjimi pasuror martesor, në të cilin pasuritë e secilit bashkëshort janë plotësisht autonome dhe administrohen nga bashkëshortët në pavarësi të plotë nga njëri-tjetri⁷⁰⁴. Regjimi i pasurive të ndara, tradicionalisht, karakteristikë e vendeve të “*common law*” dhe të Gjermanisë⁷⁰⁵, përmbush kërkesat e lirisë së disponibilitetit, të shpejtësisë dhe sigurisë të qarkullimit të të mirave materiale.

Ekziston prej kohësh në doktrinën debati mbi natyrën juridike të regjimit të pasurive të ndara, nëse ky regjimi përfaqëson një “*regjim të mirëfilltë pasuror*” apo thjesht përfaqëson “*mungesën e një regjimi*”, teori e cila, duhet thënë nuk ka gjetur shumë mbështetje në radhët e studiuesve të së drejtës familjare. Kjo është një ekspozë e shkurtër e debatit doktrinal mbi këtë çështje.

A. Teoria e mungesës së regjimit. Sipas disa autorëve, në rastin kur bashkëshortët në kontratën e martesës, zgjedhin regjimin e pasurive të ndara, rregullat që do të zbatohen për të ardhmen mbi marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, nuk janë gjë tjetër veçse rregullat e regjimit të bashkëpronësisë në pjesë, të rregulluar nga dispozitat e kod.civ, pra të njëjtat norma që do të gjenin zbatim në hipotezën kur palët nuk do të kishin të lidhur në martesës. Për rrjedhojë, vazhdojnë qëndrimin e tyre këta autorë, regjimi i pasurive të ndara nuk është një regjim pasuror, por është “*mungesa e një regjimi*”, më konkretisht një “*jo regjim*”⁷⁰⁶. Madje sipas tyre, në kontratën martesore të pasurive të ndara, bashkëshortët nuk shprehin vullnetin për zbatimin e regjimit të pasurive të ndara, por ata shprehin vullnetin për përjashtimin e zbatimit të regjimit ligjor të bashkësisë dhe për rrjedhojë gjejnë zbatim normat e përgjithshme të kod.civ. Rregullimi i këtij regjimi në kod.fam. ka vetëm për qëllim të tregojë alternativën që kanë bashkëshortët për të zgjedhur rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore sipas skemave të kod.civ, duke përjashtuar regjimin ligjor.

Ky grup autorësh shkon edhe më tej, në drejtim të mohimit të karakterit “*negocial*” të kontratës martesore, që i vendos bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara. Sipas tyre, e vetmja pasojë

⁷⁰⁴ Për këtë përkufizim shih: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 617. Në gjuhën origjinale përkufizimi është: “*La separation de bien est le régime matrimonial dans lequel les patrimoines des époux restent pleinement autonomes et sont gérés par eux en total indépendance.*”

⁷⁰⁵ Regjimi ligjor i rregulluar në Kodin Civil Gjerman është regjimi i pjesmarrjes në fitime. Sipas këtij regjimi, gjatë të gjithë kohëzgjatjes së martesës, pasuria është në pronësinë vetjake të bashkëshortit që e ka fituar dhe vetëm në përfundim të martesës, pjestohet vlera me të cilën është shtuar pasuria e secilit prej bashkëshortëve, gjatë kohëzgjatjes së martesës.

⁷⁰⁶ Fillimisht teza e mësipërme, që nuk i njeh karakterin e regjimit pasuror, regjimit të pasurive të ndara është përpunuar në doktrinën franceze nga autori: René, Savatier. *La séparation de biens en droit français*. Paris: Dalloz, 1973, fq.1. Më pas kjo teori u përqaftua edhe nga një pjesë e vogël e autorëve italianë. Në mbështetje të kësaj ideje shih autorin Italian: Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq.147.

e dëshiruar nga palët është mosveprimi i regjimit ligjor, pasojat e tjera vijnë automatikisht, për shkak të parashikimeve nga ligji⁷⁰⁷.

B. Teoria e regjimit të mirëfilltë pasuror. Nga ana tjetër, pjesa mbizotëruese e doktrinës juridike, kritikon tezën e parashtruar nga autorët e mësipërm, duke i njohur regjimit të pasurive të ndara, karakterin e një regjimi pasuror të **mirëfilltë dhe autonom**⁷⁰⁸. Autorët që mbështesin tezën e regjimit pasuror të mirëfilltë, sjellin argumente të shumta në mbështetje të tezës së tyre. *Së pari*, një argument në mbrojtje të karakterit autonom të regjimit të pasurive të ndara është parashikimi “*exresis verbis*” i këtij regjimi në kod.fam. Regjimi i pasurive të ndara gjen rregullim në nenet 115-122 të kod.fam.

Së dyti, në rastin kur bashkëshortët shprehin vullnetin e tyre për zbatimin e regjimit të pasurive të ndara, është e gabuar të pohosh që ato i nënshtrohen skemës së kod.civ të regjimit të bashkëpronësisë në pjesë. Nga leximi me vëmendje i dispozitave të kod.fam, që rregullojnë regjimin e pasurive të ndara, që rregullojnë të drejtën e njërit bashkëshort për të administruar dhe gëzuar pasurinë e bashkëshortit tjetër, dispozitat mbi provën e pronësisë së sendeve të luajtshme, pjesëtimin e pasurisë, është lehtësisht e evidentueshme që, ligjvënësi ka parashikuar një seri rregullash të cilat derogojnë nga parimet e kod.civ. të pronësisë dhe bashkëpronësisë në pjesë⁷⁰⁹.

Së treti, bazuar në nenin 65 të kod.fam, çdo regjimi pasuror martesor i zbatohen normat e regjimit primar të familjes, si: kontributi material për nevojat e familjes, mbrojtja e banesës familjare, karakteri solidar i detyrimeve që rrjedhin nga martesë, regjim i cili është i detyrueshëm dhe i pashmangshëm për bashkëshortët⁷¹⁰.

Së katërti, një autor tjetër, në mbështetje të tezës së mësipërme, e nis arsyetimin e tij me kuptimin e termit “regjim”. Regjimi juridik, sipas tij, përfaqëson një grup normash që parashikojnë pasojat ligjore që vijnë nga veprimet ose mosveprimet e subjekteve të së drejtës. Nëse lexojmë nenet 115-122 të kod.fam, konstatojmë që, ato rregullojnë: a) titullarët e të drejtave që do të fitohen, nga bashkëshortët, gjatë martesës; b) administrimin e pasurisë së njërit bashkëshort nga bashkëshorti jopronar; c) gëzimin e sendeve vetjake të njërit bashkëshort dhe frutave të tyre nga bashkëshorti tjetër; d) provën e pronësisë së sendeve të luajtshme dhe së fundi rregullat mbi likuidimin e regjimit. Pa dyshim që, gjithë kjo seri rregullash përbën një regjim ligjor dhe në rastin konkret një regjim pasuror martesor, përderisa parashikojnë një rregullim të plotë të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, gjatë martesës⁷¹¹.

Gjithashtu, autorët e sipërpërmendur kanë kritikuar edhe tezën që nuk i njeh karakterin “*negocial*” kontratës martesore, të regjimit të pasurive të ndara. Sipas tyre, kontrata martesore e regjimit të pasurive të ndara është një “*akt negocial*”, pasojat e së cilës janë të dëshiruara nga palët⁷¹².

⁷⁰⁷ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 500.

⁷⁰⁸ Për këtë qëndrim shih: Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 27-28; Tatarano, Giovanni. dhe Capobianco, Ernesto. “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” në *Rassegna di diritto civile*, P. Perlingieri (Ed.), 1996, fq. 531; Guernioni, Enzo. dhe Ganzarolli, Emiliano. “Il regime di separazione dei beni”, në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Fusaro (Ed.), Padova: Padova, 1990, fq. 374; Raggi, Silvia. “La separazione dei beni.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Arceri, M. Bernardini, Rimini: Maggiolino Editore, 2009, fq. 77.

⁷⁰⁹ Për këto dy argumente të para shih: Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 27-28; Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 570-571.

⁷¹⁰ Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 570-571.

⁷¹¹ Për këtë argument shih: Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 531.

⁷¹² Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 578.

Në analizë të fundit, jemi në mbështetje të tezës së autorët e grupit të dytë. Regjimi i pasurive të ndara është një regjimi i mirëfilltë pasuror, i cili përbëhet nga një grup sistematik rregullash, në drejtim të administrimit të pasurisë së secilit bashkëshort, provës së pronësisë së sendeve, pamundësisë së shmangies nga kontributi material, mbrojtjes së banesës familjare, karakterit solidar të detyrimeve në interes të familjes, rregulla të cilat nuk mund të gjejnë në asnjë rast zbatim mbi dy persona që nuk kanë lidhur martesës. Është e gabuar të pranojmë që, bashkëshortët, nën regjimin e pasurive të ndara, barazohen me personat që nuk kanë lidhur martesë, pasi për bashkëshortët zbatohen një seri rregullash që nuk gjejnë zbatim për bashkëpronarët e tjerë.

5.1.2. Karakteristikat e regjimit të pasurive të ndara

Nisur nga analiza e dispozitave të kod.fam. që rregullojnë regjimin e pasurive të ndara, si dhe duke e analizuar këtë regjim në kompleks së bashku me regjimet e tjera pasurore martesore, doktrina italiane dhe ajo franceze kanë përpunuar disa elementë karakterizues të regjimit të pasurive të ndara.

A. Regjimi i pasurive të ndara karakterizohet nga mungesa e masës së sendeve të përbashkëta, pra **mungesa e bashkësisë**. Secili prej bashkëshortëve ruan pronësinë ekskluzive, jo vetëm të pasurisë që ka fituar para lidhjes së martesës, por edhe të pasurisë që do të fitojë në të ardhmen gjatë martesës ose më saktë gjatë regjimit të pasurive të ndara⁷¹³.

B. Një tjetër karakteristikë e regjimit të pasurive të ndara është **pavarësia pasurore** reciproke e bashkëshortëve. Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së regjimi bashkëshortët nuk fitojnë asnjë të drejtë mbi pasurinë e njëri-tjetrit⁷¹⁴. Bashkëshortët, në lidhje me pasurinë e njëri-tjetrit (në lidhje me fitimin e pasurisë⁷¹⁵), qëndrojnë në të njëjtën pozitë sikur të mos kishin lidhur martesës⁷¹⁶.

C. Regjimi i pasurive të ndara ka **karakter autonom**, në raport me regjimin ligjor të bashkësisë. Nëse lidhur me regjimin e bashkësisë me kontratë, doktrina ndahet në qëndrime ndërmjet atyre autorëve që njohin karakterin autonom të bashkësisë me kontratë dhe atyre që e shikojnë atë vetëm si një modifikim të regjimit ligjor, në rastin e regjimit të pasurive të ndara, doktrina është unanime në qëndrimet e saj⁷¹⁷.

D. Regjimi i pasurive të ndara ka **karakter të përgjithshëm**. Është i vetmi regjim që, përjashton çdo formë të regjimit të bashkësisë dhe shtrihet **“in toto”** mbi të gjitha pasuritë që do të fitohet nga bashkëshortët në të ardhmen. Regjimi i pasurive të ndara nuk bashkekeqziston me

⁷¹³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 11; Cornu, *Lés régimes matrimoniaux*, fq. 735; Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 545.

⁷¹⁴ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 11.

⁷¹⁵ Vetëm për sa i përket fitimit të pasurisë, sepse ashtu siç kemi parë më sipër dhe do ritrajojmë në pjesët në vazhdim, kod.fam. parashikon një regjim të posaçëm për administrimin e pasurisë së njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër dhe për provën e pronësisë së sendeve të luajshmë. Për këto arsye nuk mund të barazohet plotësisht pozita e bashkëshortëve të martuar nën regjimin e pasurive të ndara me pozitën e dy personave që nuk kanë lidhur martesës.

⁷¹⁶ Raggi, “I regimi convenzionali. La separazione dei beni.” fq. 76, 87; Cattaneo, Giovanni. “Del regime di separazione dei beni.” në *Commentario alla riforma del diritto di famiglia*, Tomo I (Artt.1-89), L. Carraro, G. Oppo, A. Trabucchi, Padova: CEDAM, 1977, fq. 465.

⁷¹⁷ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 561; Raggi, “I regimi convenzionali. La separazione dei beni.” fq. 73; Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 572.

asnjë regjim tjetër pasuror. Në këtë kuptim mund të shprehemi që është regjim pasuror “*universal*”⁷¹⁸. Regjimi i pasurive të ndara është i vetmi regjim pasuror, nga ata që gjejnë rregullim në dispozitat e kod.fam, me karakter universal, madje, ashtu siç e kemi theksuar edhe më parë, as regjimi i bashkësisë universale, sipas termit që përdor neni 114 i kod.fam, nuk është regjim universal, sepse ligji nuk lejon zgjerimin universal të bashkësisë, duke parashikuar përjashtimin nga bashkësia të disa kategorive të caktuara sendesh.

Regjimi i pasurive të ndara përbën një disiplinë që rregullon të gjitha aspektet e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve. Është e gabuar të flasim për një regjim të pjesshëm të pasurive të ndara, ky regjim nuk mund të ketë kurrë për objekt vetëm një kategori të caktuar sendesh, por ai përfshin në tërësi të gjithë pasurinë që bashkëshortët që do të fitojnë gjatë ekzistencës së këtij regjimi.

Nëse në kontratën e martesës bashkëshortët vendosin të zbatojnë regjimin e pasurive të ndara për pjesën më të madhe të pasurisë së tyre dhe regjimin e bashkësisë për një kategori të caktuar sendesh, atëherë është e gabuar të shprehemi që në këtë rast regjimi i zgjedhur nga bashkëshortët është një regjim i pjesshëm i pasurive të ndara, por duhet të flasim për regjim të bashkësisë me objekt të reduktuar. Kujtoje këtu që, në kuadër të modifikimit të regjimit ligjor, bashkëshortët gëzojnë të drejtën e zgjerimit ose ngushtimit të objektit të bashkësisë ligjore⁷¹⁹.

Nga ana tjetër, një pjesë e autorëve gjykojnë të mundshëm ekzistencën e regjimit të pjesshëm të pasurive të ndara. Sipas tezës së tyre, nëse palët në kontratën martesore, përjashtojnë zbatimin e regjimit ligjor, duke shprehur qartësisht vullnetin për zbatimin e regjimit të pasurive të ndara, por ndërkohë, në të njëjtën kontratë, shprehen për krijimin e bashkëpronësisë mbi një ose disa pasuri të caktuara, atëherë mund të pohojmë që, regjimi pasuror i bashkëshortëve është regjimi i pasurive të ndara dhe jo regjimi i bashkësisë me kontratë me objekt të reduktuar⁷²⁰. Në vazhdim të këtij opinioni, autorët shprehen që, të pranosh ekzistencën e zbatimit të pjesshëm të regjimit të pasurive të ndara nuk cenon karakterin autonom dhe universal të tij.

Në analizë të fundit, duhet theksuar që, pjesa mbizotëruese e doktrinës mban qëndrimi që, në eventualitetin e një kontrate martesore që parashikon krijimin e bashkëpronësisë, mbi një pjesë të pasurisë ose qoftë mbi një send të vetëm, atëherë regjimi pasuror është ai i bashkësisë me kontratë me objekt të modifikuar dhe jo një regjim i pjesshëm i pasurive të ndara. Bazuar në natyrën universale të regjimit të pasurive të ndara, ai përfshin “*in toto*” të gjithë pasurinë e bashkëshortëve, me përjashtim të regjimit primar, i cili gjen zbatim në çdo rast, pavarësisht regjimit pasuror të bashkëshortëve.

5.2. Burimet e krijimit të regjimit të pasurive të ndara

Bazuar në burimin e krijimit, regjimi i pasurive të ndara mund të klasifikohet në dy grupe:

- a) **Regjim pasuror kontraktor**, burimi i krijimit të të cilit është vullneti i bashkëshortëve, kontrata martesore;
- b) **Regjim pasuror ligjor**, burimi i krijimit të të cilit nuk është vullneti i bashkëshortëve, por ligji, konkretisht vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurisë së bashkësisë, bazuar në nenin 98 të kod.fam.

⁷¹⁸ Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq.1370; Raggi, “I regimi convenzionali. La separazione dei beni.” fq. 73; Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 573.

⁷¹⁹ Në mbështetje të tezës së mësipërme janë: Zaccaria, Alessio. “La separazione dei beni.” në *Il diritto di famiglia. Il regime patrimoniale della famiglia II*, G. Bonilini, G. Cattaneo, Torino: UTET, 1997, fq. 323; Raggi, “I regimi convenzionali. La separazione dei beni.” fq. 88; Corsi, “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa.” fq. 62; Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 838.

⁷²⁰ Në mbështetje të këtij mendimi është: Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 539.

5.2.1. Regjimi i pasurive të ndara si regjim kontraktor

Kontrata martesore e regjimit të pasurive të ndara, mund të lidhet në dy momente të ndryshme kohore: a) para lidhjes së martesës; b) gjatë kohëzgjatjes së martesës, në respektim të afatit 2 vjeçar, të zbatimit të regjimit të mëparshëm pasuror (nenin 72/1 të kod.fam).

Ndërsa kontrata martesore “*ante nuptial*” e regjimit të pasurive të ndara sjell si pasojë përjashtimin e zbatimit të regjimit ligjor të bashkësisë duke i mundësuar bashkëshortëve ruajtjen e ekskluzivitetit mbi pasurinë e fituar gjatë martesës, kontrata martesore “*post nuptial*” e regjimit të pasurive të ndara, sjell si pasojë, jo vetëm përjashtimin e zbatimit të regjimit ligjor për të ardhmen, por nga ana tjetër sjell si pasojë mbarimin e regjimit të bashkësisë (neni 96/c i kod.fam.), duke i dhënë të drejtën bashkëshortëve të pjesëtimin e pasurisë së krijuar gjatë këtij regjimi⁷²¹.

Kontrata martesore e regjimit të pasurive të ndara ka karakter programatik. Në kontratën e regjimit të pasurive të ndara “*ante nuptial*” bashkëshortët mund të parashikojnë që regjimi i pasurive të ndara, të zbatohet jo vetëm për të ardhmen, por edhe për të shkuarën nga momenti i lidhjes së martesës, duke i dhënë fuqi prapavepruese kontratës martesore. Në këtë hipotezë, regjimi i mëparshëm pasuror (që mund të jetë regjimi ligjor ose një regjim i bashkësisë me kontratë) do të konsiderohet që nuk ka ekzistuar kurrë, ndërsa marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve do t’i nënshtrohen regjimit të pasurive të ndara, që nga momenti i lidhjes së martesës.

Megjithëse nuk ka asnjë dispozitë të kod.fam që të parashikojë fuqinë prapavepruese të regjimit të pasurive të ndara, derisa nuk ka një dispozitë ligjore që të parashikojë një ndalim të shprehur, jemi të mendimit që, bashkëshortët kanë të drejtë t’i japin fuqi prapavepruese kontratës martesore. Problemi që shfaqet në këtë hipotezë i referohet nevojës për mbrojtjen e personave të tretë, të cilët që nga momenti i lidhjes së martesës kanë kontraktuar me bashkëshortët. Kontrata martesore, me efekte prapavepruese, e regjimit të pasurive të ndara, nuk do të sjellë pasojë për të tretët. Regjimi i pasurive të ndara do të sjellë pasojë për të tretët, vetëm për të ardhmen, 3 muaj pas regjistrimit në regjistrin e martesave (neni 72/1 kod.fam).

Gjithashtu bashkëshortët kanë të shtrijnë veprimin e regjimit të pasurive të ndara edhe marrëdhëniet pasurore që kanë lindur, nën regjimin pasuror të detyrueshëm të bashkëpronësisë së parashikuar në kod.civ. të vitit 1981. Në bazë të nenit 315/1 të kod.fam, bashkëpronësia e bashkëshortëve, e krijuar para hyrjes në fuqi të kodit të familjes, mund të ndryshojë me marrëveshje të bashkëshortëve, sipas dispozitave të këtij kodi.

5.2.2. Regjimi i pasurive të ndara, si regjim ligjor i detyrueshëm⁷²²

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, regjimi i pasurive të ndara shfaqet edhe si një regjim ligjor, i cili zbatohet “*ipso lege*” pas dhënies së vendimit të gjykatës për pjesëtimin e pasurisë së bashkëshortëve, sipas neni 98 të kod.fam. Në këtë hipotezë, regjimi i pasurive të ndara merr karakteristikat e regjimit ligjor të detyrueshëm, zbatimi i të cilit nuk varet nga vullneti i bashkëshortëve, por vjen si pasojë e parashikimit nga ligji. Në këtë hipotezë, regjimi i pasurive të ndara është emërtuar nga doktrina si “*regjimi ligjor zëvendësues*” (subsidiar)⁷²³.

⁷²¹ Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 538.

⁷²² Për përdorimin e termit “regjim ligjor i detyrueshëm” shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 69.

⁷²³ Përdorimi i termit regjim ligjor subsidiar vjen nga doktrina gjermane. Për këtë shih: Cattaneo, “Del regime di separazione dei beni.” fq. 465; Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 575.

5.2.3. Mundësia e zbatimit të regjimit të pasurive të ndara në rastin e shpalljes së zhdukur të njërit bashkëshort

Nga leximi i kombinuar i nenit nenin 96 të kod.fam. (rastet e mbarimit të regjimit të bashkësisë) dhe nenit 123 të kod.fam. (rastet e mbarimit të martesës) rezulton që, shpallja e zhdukjes e njërit bashkëshort sjell si pasojë mbarimin e regjimit të bashkësisë (ligjore/me kontratë), pa sjellë mbarimin e martesës. Ligji nuk shprehet mbi regjimin që do të rregullojë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve deri në mbarimin e martesës ose shfaqjen e bashkëshortit të shpallur të zhdukur.

Në mënyrë thuajse unanime, doktrina juridike mban qëndrimin që, megjithëse nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj, regjimi i pasurive të ndara do të veprojë në të gjitha ato raste, në të cilat mbarimi i regjimit të bashkësisë ligjore nuk shoqërohet njëkohësisht edhe me mbarimin e martesës. Në vazhdim të këtij arsyetimi, në rastin e shpalljes së zhdukjes së njërit bashkëshort, do të gjejë zbatim regjimi i pasurive të ndara⁷²⁴.

Dispozitat e regjimit të pasurive të ndara zbatohen në hipotezën e shpalljes së zhdukjes së njërit prej bashkëshortëve, brenda kufijve të diskutuara nga gjendja e re, pra për atë sa përputhen me situatën e re të krijuar, sepse dispozitat e regjimit të pasurive të ndara e kanë bazën në prezumimin e bashkëjetesës së bashkëshortëve dhe solidaritetit familjar, elementë të cilët, në rastin e shpalljes së zhdukjes, mungojnë⁷²⁵.

Jemi të mendimit që, regjimi i pasurive të ndara do të zbatohet me efekte prapavepruese, nga data e zhdukjes së bashkëshortit dhe jo nga data kur vendimi i gjykatës për shpalljen e zhdukjes ka marrë forcë të prerë. Gjithashtu, në funksion të mbrojtjes së të tretëve, vendimi i gjykatës për shpalljen e zhdukjes së njërit bashkëshort dhe regjimi i ri pasuror duhet të regjistrohen në aktin e martesës.

5.3. Pjestimi gjyqësor i pasurisë së bashkësisë

Pjesëtimi gjyqësor i pasurisë së bashkësisë, që gjen rregullim në dispozitat 98-100 të kod.fam., përbën një përjashtim nga rregullat e përgjithshme të pjesëtimit të pasurisë së bashkësisë.

Në ndryshim nga bashkëpronësia në pjesë, pasuria objekt i së cilës mund të pjesëtohet në çdo kohë nga bashkëpronarët, qoftë vullnetarisht ose në rrugë gjyqësore, pjesëtimi i pasurisë së bashkësisë ligjore/me kontratë nuk mund të realizohet pa përfunduar më parë regjimi pasuror, me verifikimin e një prej rrethanave të parashikuara nga neni 96 i kod.fam. Këtë ndalim e gjejmë të shprehur në nenin 97, të kod. fam. i cili parashikon: **“Pjesëtimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshje të bashkëshortëve”**.

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në nenin 98 të kod.fam. ligjvënësi ka parashikuar, në disa rrethana specifike, mundësinë e pjesëtimit në rrugë gjyqësore të pasurisë së bashkësisë, gjatë zbatimit të saj.

Pjesëtimi gjyqësor i pasurisë së bashkësisë përfaqëson një mekanizëm autonom, rregullator të mosfunksionimit të regjimit të bashkësisë. Ky mekanizëm është parashikuar nga ligji si mjete i fundit dhe më radikal, që i jep zgjidhje situatës së mosfunksionimit të regjimit të bashkësisë⁷²⁶. Kod.fam. parashikon edhe mekanizma të tjerë të cilët kanë për qëllim të zgjidhin problemin e

⁷²⁴ Anelli, Franco, dhe Sesta Michele. “Regime patrimoniale della famiglia.” në *Trattato di diritto di famiglia*, Paolo Zatti (Ed.), Vol. III, Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq. 585; Corsi, “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impresa.” fq. 59; Zaccaria, “La separazione dei beni.” fq. 321.

⁷²⁵ Anelli dhe Sesta, “Regime patrimoniale della famiglia.” fq. 586; Guernioni dhe Ganzarolli, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 380.

⁷²⁶ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 464-466.

mosfeksionimit të regjimit të bashkësisë, në nenet 91, 92, 93 dhe 94, por në ndryshim nga këto mekanizma, pjesëtimi gjyqësor i sendeve paraqitet si më radikali, sepse sjell përfundimin e regjimit të bashkësisë, ndërkohë që mekanizmat e tjerë paraqiten më shumë si mjete shëruese të bashkësisë.

Ratio e normës konsiston në “dhënien e mundësisë së njërës prej bashkëshortëve, interesat pasurorë të të cilit apo të familjes janë cënuar nga administrimi i bashkëshortit tjetër, të kërkojë përfundimin e bashkësisë dhe njëkohësisht pjesëtimin e pasurisë së saj”⁷²⁷.

Instituti i pjesëtimit gjyqësor të pasurisë, ka për qëllim që t’i japë të drejtë njërës prej bashkëshortëve, që në rast të verifikimit të një prej rrethanave të parashikuara në mënyrë taksative nga ligji, të mund të realizojë mbarimin e bashkësisë dhe vendosjen në regjimin e pasurive të ndara, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër⁷²⁸.

Në praktikën gjyqësore, ky institut nuk ka gjetur aspak zbatim, për shkak se si logjikë do të zbatohet në ato raste kur bashkëshortët, pavarësisht ekzistencës së njërës prej këtyre rrethanave, duan të vazhdojnë martesën. Në fakt është e vështirë të mendosh që, pas pjesëtimit gjyqësor të pasurisë për shkak të njërës së rrethanave të parashikuara nga neni 98, bashkëshortët të duan të vazhdojnë martesën⁷²⁹.

Në përfundim, funksioni i mekanizmit të pjesëtimit gjyqësor të pasurisë, shfaqet në dy drejtime: **mjet shërues**, sepse sjell mbarimin e regjimit të bashkësisë në një moment kur ky regjim nuk funksionon, por është njëkohësisht edhe një **sanksion**⁷³⁰, pasi parashikon vendosjen e bashkëshortëve, automatikisht në regjimin e pasurive të ndara, me efekte prapavepruese, që nga data e paraqitjes së kërkesës për pjesëtim.

Identifikimi i natyrës juridike, ndërmjet sanksionit dhe mjetit shërues do të marrë rëndësi në përcaktimin e rrethit të subjekteve që gëzojnë të drejtën e legjitimitetit aktiv.

5.3.1. Shkaqet e pjesëtimit gjyqësor të pasurisë

Në paragrafin e parë të nenit 98 të kod.fam. janë parashikuar tre raste, me verifikimin e të cilave bashkëshortëve, i lind e drejta për të kërkuar pjesëtimin gjyqësor të pasurisë së bashkësisë.

Të gjitha rrethanat e parashikuara nga neni 98 i kod.fam. janë rrethana **“objektive”**⁷³¹ dhe **“taksative”**⁷³², për rrjedhojë nuk është e mundur pjesëtimi gjyqësor i pasurisë së bashkësisë, për rrethana të tjera të ndryshme nga ato të listuara në ligj.

A. Paaftësia dhe keqadministrimi i pasurisë. Bazuar në nenin 98/1, njëri bashkëshort ka të drejtë të kërkojë pjesëtimin e pasurisë, nëse bashkëshorti tjetër tregon paaftësi në administrim dhe administrim të keq të pasurisë, kur kjo mënyrë administrimi vë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes.

Nga ky formulimi i normës, rezulton që, ligjvënësi përfshin si rrethanën kur njëri prej bashkëshortëve qëllimisht apo në neglizhencë keqadministron pasurinë e bashkësisë, ashtu edhe rastin kur njëri bashkëshort është i paaftë në administrimin e pasurisë. Por çfarë ka dashur ligjvënësi të kuptojë me termin **“paaftësi në administrim”**? Gjykojmë që, ligjvënësi ka dashur t’i

⁷²⁷ Për këtë përkufizim shih: Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 543-544.

⁷²⁸ Për këtë përkufizim shih, gjithashtu: Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 741.

⁷²⁹ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 742-743.

⁷³⁰ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 466.

⁷³¹ Venditti, Amedeo. “La comunione legale tra coniugi. Lo scioglimento.” në *Il regime patrimoniale della famiglia II*, në *Il diritto di famiglia. Trattato*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, fq. 259.

⁷³² Zavaglia, “La comunione legale. Lo scioglimento.” fq. 788.

referohet rastit kur njëri prej bashkëshortëve është i pazotë të kujdeset për interesat e tij pasurorë, pavarësisht nëse i është hequr ose jo zotësia për të vepruar.

Doktrina konsideron, si raste kur mund të kërkohet pjesëtimi gjyqësor për keqadministrim të pasurisë, rastin kur njëri bashkëshort kryen dhurime pa shkak, në favor të personave të tjerë, ose në përgjithësi kryen veprime të administrimit jo të zakonshëm pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, gjithmonë nëse veprimet janë të tilla që, vënë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të bashkësisë⁷³³.

Nisur nga formulimi i teksti të nenit 98/1 **“vë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes”**, gjykojmë që, nuk është e nevojshme ardhja e pasojave, për shkak të keqadministrimit apo të paaftësisë në administrim. Në këtë hipotezë do të mjaftonte thjesht vënia në rrezik e interesave të familjes apo bashkëshortit tjetër, sepse ligji shprehimisht i referohet **“mënyrës së administrimit që vë në rrezik interesat”**. Mund të jemi edhe përpara një veprimi që fillimisht i sjell dobi ekonomike pasurisë, por që mbart rrezik të lartë humbje për bashkësinë, si psh. veprimet spekulative në bursën e aksioneve.

Termi **“interes”** i përdorur nga neni 98/1 ka kuptimin e **“interetit pasuror”**.

Nga leximi i kombinuar i nenit 98 me nenin 93 të kod.fam, rezulton që, në rastet ku interesat e bashkësisë vihen në rrezik nga veprimet e njërit bashkëshort, bashkëshorti tjetër ka në dispozicion dy mjete ligjore për të mbrojtur interesat pasurorë të tij dhe të familjes. Përveç padisë së pjesëtimin të pasurisë (neni 98 i kod.fam.), instrumenti tjetër në mbrojtje të bashkëshortëve është padia e zëvendësimit në administrim (neni 93 i kod.fam.)⁷³⁴, instrumente të cilat kanë ngjashmëri me njëri-tjetrin, si në aspektin thelbësor, sepse hipotezat e parashikuara nga ligji për të dy institutet janë shumë të ngjashme, ashtu dhe në aspektin procedural, duke e bërë të paqartë raportin që ekziston ndërmjet dy padive, nëse ato paraqiten njëkohësisht në gjykatë, njëra nga njëri bashkëshort dhe tjetra nga bashkëshorti tjetër⁷³⁵.

Disa rrethana, si rasti kur njëri bashkëshort tregon keqbesim ose paftësi në administrimin e bashkësisë, gjenden prezentë në të dy normat, si në nenin 98 të kod.fam. duke i dhënë të drejtë bashkëshortit tjetër për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë ashtu dhe në nenin 93⁷³⁶ të kod.fam. duke i dhënë të drejtën bashkëshortit tjetër, të kërkojë përjashtimin e bashkëshortit të paftë ose në keqbesim nga administrimi i bashkësisë.

Pavarësisht të përbashkëtave, ndërmjet instituteve ka dallime të rëndësishme.

B. Mungesa e kontributit për nevojat e familjes. Bazuar në nenin 98/2, mund të kërkohet pjesëtimi gjyqësor i pasurisë, nëse njëri prej bashkëshortëve nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë.

Qëllimi i normës është mbrojtja e njërit bashkëshort përballë bashkëshortit tjetër, i cili nuk merr pjesë ekonomikisht në familje, nëpërmjet të ardhurave nga veprimtaria ekonomike apo nëpërmjet kryerjes së aktiviteteve të tjera në familje, që sjellin reduktimin e shpenzimeve, edhe pse nga ana tjetër përfiton nga bashkësia, bashkësi e cila do të formohej në këtë rast si rezultat i aktivitetit ekonomik të bashkëshortit tjetër⁷³⁷.

⁷³³ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 744.

⁷³⁴ Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 544.

⁷³⁵ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 743.

⁷³⁶ Neni 93 i kod.fam. “Nëse njëri nga bashkëshortët, për një kohë të vazhdueshme, ndodhet jashtë gjendjes për të shprehur vullnetin e tij, ose nëse administrimi i bashkësisë nga ana e tij dëshmon për paftësi ose keqbesim, bashkëshorti tjetër mund t’i kërkojë gjykatës të zëvendësojë atë në ushtrimin e të drejtave të tij. Bashkëshorti i privuar nga të drejtat e administrimit të bashkësisë mund t’i kërojë gjykatës rikthimin e tyre, nëse provon se janë zhdukur shkaqet e përjashtimit të tij nga administrimi.”

⁷³⁷ Gennari, Giuseppe. “Lo scioglimento della comunione.” në *Regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta, në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq. 492.

Sipas doktrinës, mungesa e kontributit duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe se moskontributi vetëm në raste sporadike, nuk legjitimon bashkëshortin tjetër për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë⁷³⁸.

C. Pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi. Kjo rrethanë mund të evidentohet në rastin e ndarjes faktike të bashkëshortëve. Në rastin kur bashkëshortët kanë ndërprerë jetesën e përbashkët dhe njëkohësisht kanë realizuar një ndarje faktike të pasurisë në bashkësi, qëllimi dhe funksioni i regjimit të bashkësisë që bazohet në solidaritetin e bashkëshortëve dhe bashkëpunimin ekonomik në interes të familjes, ka pushuar së ekzistuari.

5.3.2. Padia e pjesëtimit të pasurisë: legjitimiteti, gjykata kompetente dhe gjykimi i padisë

Pjesëtimi i pasurisë, mund të bëhet vetëm në rrugë gjyqësor, neni 97 i kod.fam. ka përjashtuar mundësinë e një pjesëtimi vullnetar të pasurisë, gjatë kohëzgjatjes së regjimit të bashkësisë.

Në mungesë të një ndalimi ligjor, neni 98 i kod.fam. do të gjejë zbatim si në rastin e regjimit të bashkësisë ligjore, ashtu dhe në rastin e regjimit të bashkësisë me kontratë⁷³⁹.

Nga leximi i dispozitave të kod.fam dhe kod.proc.civ. rezulton që, ligjvënësi nuk ka përcaktuar rregullat procedurale lidhur me kompetencën tokësore dhe gjykimin e padisë së pjesëtimit të pasurisë, ndërkohë që rregullat lidhur me subjektet e legjitimuara janë të paqarta.

A. Natyra juridike e padisë. Bazuar në mendimin mbizotërues të doktrinës, padia e pjesëtimit të pasurisë së bashkësisë, i jep jetë një gjykimi me palë kundërshtare ku si palë paditëse dhe të paditur do të paraqiten respektivisht bashkëshortët⁷⁴⁰. Në aspektin procedural, gjykimi i pjesëtimit të pasurisë vihet në lëvizje nëpërmjet kërkesë-padisë.

Vihet re një pasaktësi në termin e përdorur në nenet 98/3, 99 dhe 100/1 të kod.fam, në të cilat është përdorur termi “*kërkesë*”.

Gjykojmë që, do të ishte më e saktë, përdorimi i termit “*padi*”, për t’iu referuar së drejtës së bashkëshortëve për të vënë në lëvizje gjykatën, ose përdorimi, në aspektin procedural, i termit “*kërkesë-padi*”, nëse qëllimi i ligjvënësit ka qenë për të përcaktuar mjetin procedural me të cilin bashkëshortët mund t’i drejtohen gjykatës.

Një tjetër karakteristikë e padisë së pjesëtimit gjyqësor të pasurisë është karakteri ngushtësisht personal i saj. Janë vetëm bashkëshortët subjektet e legjitimuar për të kërkuar pjesëtimin gjyqësor të pasurisë.

B. Gjykata kompetente. Bazuar në nenin 349/d të kod.proc.civ⁷⁴¹, kompetencën lëndore për gjykimin e padisë së pjesëtimit të pasurisë e ka seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare pranë gjykatës së shkallës së parë.

⁷³⁸ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 745.

⁷³⁹ Navarrini, Gianluca. “Contributo allo studio dell’azione di separazione giudiziale dei beni tra i coniugi.” në *Studi in onore di Giovanni Giacobbe. Tomo I. Teoria generale, Persona e Famiglia*, G. della Torre (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2010, fq. 621.

⁷⁴⁰ Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, fq. 1170; Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 426.

⁷⁴¹ Neni 349/d “Seksionet për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare pranë gjykatës së shkallës së parë janë kompetente për: d) ndarjen e pasurisë bashkëshortore dhe të banesës së bashkëshortëve.”

Gjykojmë që ligjvënësi duhej të kishte përdorur termin “pjestim”, në vend të termit “ndarje”, për të qenë më në harmoni me dispozitat e tjera të këtij kodi dhe të kod.fam. dhe kod.civ, ligje në të cilat gjen përdorim termi “pjestim”.

E paqartë mbetet çështja e përcaktimit të gjykatës që ka kompetencën territoriale në gjykimin e padisë, sepse nuk gjendet asnjë dispozitë në kod.fam, apo atë të proc.civ. që të përcaktojë gjykatën territorialisht kompetente.

Për shkak të heshtjes së ligjit, në doktrinë janë mbajtur qëndrime të ndryshme, lidhur me kriteret e përcaktimit të kompetencës lëndore të gjykatës. Dilema qëndron ndërmjet referimit tek rregullat e kod.proc.civ. për përcaktimin e gjykatës kompetente për gjykimin e padisë së pjesëtimit të sendeve⁷⁴² apo tek rregullave të përgjithshme të kompetencës territoriale⁷⁴³.

Nëse do të pranojmë zbatimin e rregullave të përgjithshëm të kompetencës territoriale, atëherë bazuar në nenin 42/1 të kod.proc.civ. kompetente për gjykimin e padisë do të jetë gjykata e vendbanimit ose e vendqëndrimit të të paditurit dhe kur këto nuk dihen gjykata e vendit ku ai ka banimin e përkohshëm⁷⁴⁴.

Në kodin francez të procedurës civile, neni 1292, është përcaktuar qartësisht që gjykata kompetente për pjesëtimin e pasurisë së bashkësisë është gjykata ku bashkëshortët kanë vendbanimin e tyre.

C. Legjitimimi. Për shkak të paqartësisë së ligjit, e debatueshme në doktrinë ka mbetur edhe çështja e përcaktimit të subjekteve që kanë të drejtën e legjitimitetit aktiv. Në mënyrë të përmbledhur, dilema shtrohet nëse të drejtën për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë e kanë të dy bashkëshortët apo kjo e drejtë do t'i njihet vetëm bashkëshortit jo fajtor. Në rastin e situatës së ndarjes faktike të pasurisë, nuk mund të flasim për fajësi, por diskutimi shtrohet nëse do t'i njihet e drejta për të kërkuar pjesëtimin edhe bashkëshortit që keqadministron pasurinë e bashkësisë apo bashkëshortit që nuk kontribuon në familje.

Nëse i referohemi paragrafit të dytë të nenit 98, **“ndarja e pasurisë mund të kërkohet nga njëri prej bashkëshortëve”**, zgjidhja mbetet e paqartë, sepse i paqartë mbetet qëllimi i ligjvënësit në përdorimin e termit **“njëri prej bashkëshortëve”**. Shtrohet pyetja, nëse qëllimi i ligjvënësit ka qenë t'i njohë të drejtën e padisë secilit prej bashkëshortëve (duhej të kishte përdorur termin “secili prej tyre” dhe jo “njëri prej tyre”), apo qëllimi ka qenë të tregojë që padia paraqitet nga njëri bashkëshort kundrejt bashkëshortit tjetër.

Pjesa mbizotëruese e doktrinës është e mendimit që, të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e kanë të dy bashkëshortët. Duke qenë se ligjvënësi nuk bën specifikim, atëherë nuk duhet interpretuar në mënyrë të kufizuar dispozita duke bërë dallimin ndërmjet bashkëshortit fajtor dhe atij jo fajtor, duke pasur parasysh që parimi i solidaritetit bashkëshortor, i imponon të dy bashkëshortëve të drejtën dhe njëkohësisht detyrimin për të vepruar, pa cenuar interesat e familjes⁷⁴⁵.

Sipas të tjetër autorëve, të drejtën e padisë e ka vetëm bashkëshorti jo fajtor, si rregull i përgjithshëm, megjithatë kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet edhe bashkëshortit tjetër, nëse pjesëtimi është në interes të familjes dhe të bashkësisë⁷⁴⁶.

Në analizë të fundit, jemi të mendimit që, të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e kanë të dy bashkëshortët, pavarësisht nga fajësia, sepse qëllimi i instituti të pjesëtimit të pasurisë, nuk është vendosja e një sanksioni ndaj bashkëshortit fajtor, por qëllimi i tij është mbrojtja e interesave pasurorë të bashkësisë, familjes dhe bashkëshortit jo fajtor, e për rrjedhojë do të ishte kundër

⁷⁴² Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 545.

⁷⁴³ Venditti, “La comunione legale tra coniugi.” fq. 260.

⁷⁴⁴ Kur i padituri nuk ka vendbanim apo vendqëndrim ose banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, kompetente është gjykata ku ka vendbanimin paditësi.

Përkundrazi, nëse pranojmë qëndrimin, që kërkon zbatimin e rregullave të padisë së pjesëtimit të sendeve, atëherë bazuar në nenin 45/1 të kod.proc.civ. kompetente do të jetë gjykata ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre.

⁷⁴⁵ I këtij qëndrimi është: Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 544; Gennari, “Lo scioglimento della comunione.” fq. 492.

⁷⁴⁶ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 746.

frymës së ligjit mohimi i së drejtës së padisë edhe bashkëshortit tjetër, nëse kjo do të ishte në mbrojtje të këtyre interesave⁷⁴⁷. Keqadministrimi i bashkësisë mund të vijë edhe për rrethana të cilat e bëjnë njërin bashkëshort të paaftë për tu kujdesur për interesat e tij, siç mund të jetë një sëmundje mendore, apo të tjera rrethana që pengojnë njërin bashkëshort në miradministrimin e pasurisë, por që nuk varen nga vullneti i tij. Do të ishte e palogjikshme dhe kundër *ratios* së normës t'i mohosh këtij bashkëshorti të drejtën e padisë. Për më tepër, ligji ka parashikuar që e drejta e padisë mund të ushtrohet edhe nga përfaqësuesi ligjor i bashkëshortit që nuk ka zotësi për të vepruar, që në rastin kur ky përfaqësues është bashkëshorti tjetër, do të procedohet sipas rregullave të kujdestarisë së posaçme.

Nisur nga karakteri personal i padisë, ligjvënësi nuk ka legjitimuar kreditorët e bashkëshortëve për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë (neni 98/2 kod.fam.). Jemi të mendimit, që nisur nga karakteri personal i padisë, ky ndalim duhet të shtrihet edhe mbi kreditorët e bashkësisë, megjithëse ligji është shprehur vetëm për kreditorët personalë të bashkëshortëve. Kreditorëve i është njohur e drejta për të ndërhyrë në seancën gjyqësore, në mbrojtje të të drejtave të tyre, pasi gjykimi ka filluar (neni 99). Kështu për shembull, kreditorët mund të ndërhyjnë në gjykim, nëse ata gjykojnë që padia e ndërmarrë nga bashkëshortët, ka për qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve që bashkësia apo bashkëshortët kanë ndaj tyre.

Në doktrinë shtrohet problemi nëse kreditorët kanë të drejtë të vazhdojnë gjykimin, në rast të vdekjes, gjatë gjykimit, të bashkëshortit debitor të tyre. I njëjti problem shtrohet edhe në lidhje me të drejtën e trashëgimtarëve të njërit bashkëshort për të vazhduar gjykimin e filluar⁷⁴⁸. Për këto dy subjekte interesi i padisë qëndron në fuqinë prapavepruese që sjell pranimiti i saj, nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë.

Subjekt i paditur është, në çdo rast bashkëshorti tjetër.

D. Publiciteti i kërkesës. Ligji (neni 100/1) parashikon regjistrimin e kërkesës për pjesëtimin e pasurisë në zyrën e gjendjes civile si dhe në regjistrin tregtar, nëse në pasurinë e bashkësisë përfshihen edhe veprimtari tregtare të bashkëshortëve.

Publiciteti i kërkesës së pjesëtimit ka një qëllim të dyfishtë: a) nga njëra anë qëllimi i publicitetit është informimi i kreditorëve të bashkëshortëve dhe kreditorëve të bashkësisë, në mënyrë që atyre t'i jepet mundësia e ushtrimit të së drejtës së ndërhyrjes në procesin gjyqësor të pjesëtimit, për mbrojtjen e të drejtave të tyre; b) nga ana tjetër, qëllimi i publicitetit është edhe vënia në dijeni, në përgjithësi e të tretëve, të cilët mund të hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me bashkëshortët⁷⁴⁹. Mbetet e paqartë se si do të realizohet regjistrimi i kërkesës nga nëpunësi i gjendjes civile dhe cili do të jetë subjekti përgjegjës për të kërkuar regjistrimin e kërkesës.

Kërkesa do të regjistrohet në regjistrin e martesave të zyrës së gjendjes civile ku bashkëshortët kanë vendbanimin apo vendqëndrimin e tyre.

Lidhur me subjektin që ka përgjegjësin e regjistrimit, duket më e arsyeshme që, gjykata të dergojë një kopje të kërkesës për regjistrim pranë zyrës së gjendjes civile të sipërpërmendur.

Megjithatë, specifikime të mëtejshme mbi procedurën që duhet ndjekur për regjistrimin e kërkesës, duhet të ishin parashikuar në kod.proc.civ.

E. Gjykimi i kërkesës. Gjykimi i kërkesës së pjesëtimit të pasurisë në bashkësi do t'i nënshtrohet rregullave të kod.fam. mbi pjesëtimin e bashkësisë, rregullave të kod.civ, mbi

⁷⁴⁷ Për këtë kritikë shih: Galasso dhe Tamburello, "Del regime patrimoniale della famiglia I." fq. 746.

⁷⁴⁸ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 467.

⁷⁴⁹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 426-427; Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 472.

pjesëtimin e bashkëpronësisë si dhe rregullave të përcaktuara në kod.proc.civ. mbi pjesëtimin e pasurisë.

Bazuar në dispozitat e kod.proc.civ. pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi kalon në dy faza. Specifike për pjesëtimin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 98 të kod.fam. është që para se të kalohet në fazat e pjesëtimit gjyqësor, duhet të realizohet më parë një fazë paraprake.

Në këtë fazë paraprake, bashkëshorti paditës ka barrën e provës, për të provuar ekzistencën e dy elementëve të rëndësishëm⁷⁵⁰:

- a) *Së pari*, duhet të provojë ekzistencën e bashkësisë ligjore/me kontratë. Kjo mund të realizohet nëpërmjet një certifikate martese, ku ndërmjet të tjerash të tregohet edhe regjimi pasuror, që rregullon marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Në hipotezën e regjimit të bashkësisë me kontratë, duhet të paraqitet në gjykim edhe kontrata martesore.
- b) *Së dyti*, bashkëshorti paditës ka detyrimin të provojë ekzistencën e njërës prej rrethanave të parashikuara nga neni 98/1 i kod.fam.

Vetëm pas shqyrtimit të dy elementëve të mësipërm, gjykata mund të kalojë në fazat që kanë lidhje me pjesëtimin e pasurisë.

Secili prej bashkëshortëve dhe kreditorët e tyre që kanë ndërhyrë në gjykim, kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e gjykatës në Gjykatën e Apelit, sipas procedurës dhe afateve të përgjithshme të parashikuara nga kod.proc.civ. Kjo e drejtë nuk mund t'i njihet kreditorëve të bashkëshortëve, të cilët nuk kanë ndërhyrë në gjykimin e shkallës së parë⁷⁵¹.

5.3.3. Pasoja e pjesëtimit të pasurisë

Vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurisë ka karakter konstitutiv, ai sjell dy pasoja të rëndësishme:

A. Mbarimin e regjimit të bashkësisë. Bazuar në nenin 96/b të kod.fam, pjesëtimi i pasurisë, në hipotezën e nenit 98 të kod.fam. sjell mbarimin e regjimit të bashkësisë. Ky është i vetmi rast kur pjesëtimi i pasurisë sjell njëkohësisht edhe mbarimin e bashkësisë, madje i paraprin këtij të fundit. Në çdo rast tjetër, pjesëtimi i pasurisë është një fazë që mund të realizohet pas përfundimit të bashkësisë.

Regjimi i bashkësisë do të mbarojë jo vetëm për të ardhmen, por edhe për të shkuarën, me efekte prapavepruese, që nga momenti i paraqitjes në gjykatë të kërkesës për pjesëtim.

B. Vendosjen e bashkëshortëve nën regjimin e pasurive të ndara. Sipas nenit 98/3 të kod.fam. vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurisë do t'i vendosë bashkëshortët nën regjimin e pasurive të ndara, me efekte prapavepruese që nga momenti i paraqitjes së kërkesës për pjesëtim.

Mbetet e diskutueshme çështja e përcaktimit të momentit kohor kur regjimi i pasurive të ndara do të sjellë pasoja për të tretët. *De lege lata*, ky regjim do të sjellë pasoja për të tretët ashtu si dhe për bashkëshortët, me fuqi prapavepruese, që nga data e paraqitjes së kërkesës për pjesëtim, në mungesë të një parashikimi të ndryshëm nga neni 98 i kod.fam.

Për shkak të heshtjes së ligjit, a mund të pranojmë që, mbarimi i regjimit të bashkësisë dhe vendosja e bashkëshortëve nën regjimin e pasurive të ndara, do të ketë efekte prapavepruese, që nga dita e paraqitjes së kërkesës për pjesëtim, si për bashkëshortët ashtu dhe për të tretët? Ky është interpretimi që doktrina franceze⁷⁵² i ka bërë normës 1445/2 të KC Francez, nën modelin e

⁷⁵⁰ Navarrini, "Contributo allo studio dell'azione di separazione giudiziale dei beni tra i coniugi." fq. 661-662.

⁷⁵¹ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 473.

⁷⁵² Në mbështetje të këtij interpretimi shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 429.

së cilës është hartuar edhe neni 98 i kod.fam. Në mbështetje këtij interpretimi qëndron detyrimi i ligjit për regjistrimin e kërkesës për pjesëtim, detyrim i cili, ka për qëllim mbrojtjen e të tretëve nga fuqia prapavepruese e vendimit të gjykatës.

Nga ana tjetër, pasi bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës, i treti në mirëbesim duhet të mbrohet gjithmonë nga ligji. Për këtë arsye, bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës, *de lege ferenda*, me qëllim mbrojtjen e të tretëve në marrëdhëniet juridiko-civile me bashkëshortët, regjimi i pasurive të ndara, jo vetëm që nuk mund të zbatohet për ta në mënyrë prapavepruese, që nga data e paraqitjes së kërkesës, por me analogji duhet të zbatohet neni 72, paragrafi i tretë i kod.fam. Në bazë të nenit 72 paragrafi i tretë i kod.fam. ndryshimi i regjimi pasuror martesor ka efekt kundrejt të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës⁷⁵³. Jemi të mendimit që, ligjvënësi duhet të kishte parashikuar shprehimisht mbrojtjen e të tretëve. Nëse referojmë në KC Italian vërejmë që, në nenin 193 është parashikuar shprehimisht që vendimi i gjykatës, i cili i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive të ndara, ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të të tretëve.

Bazuar në nenin 100/2 të kod.fam. vendimi i gjykatës regjistrohet në regjistrin e gjendjes civile. Nga ky formulim aspak i kënaqshëm mund të nxirren disa përfundime dhe të shtrohen disa çështje për diskutim:

Së pari, jemi të mendimit që, në linjë logjike me dispozitat e regjistrimit të kontratës martesore, vendimi do të regjistrohet në regjistrin e martesave. Ky do të ishte termi i saktë që duhej të kishte përdorur ligjvënësi, në vend të termit të përgjithshëm **“regjistri i gjendjes civile”**. Nuk ekziston një regjistër i vetëm i gjendjes civile.

Së dyti, nëse në pasurinë e bashkëshortëve gjenden edhe veprimtari tregtare, bazuar në nenin 100/1 të kod.fam. vendimi regjistrohet edhe në regjistrin tregtar.

Së treti, në rastin kur paragrafi i dytë i nenit 100 të kod.fam. parashikon regjistrimin e vendimit të gjykatës në origjinalin e kontratës së martesës, i referohet pa dyshim hipotezës kur bashkëshortët janë të martuar nën regjimin e bashkësisë me kontratë. Në hipotezën kur regjimi pasuror është ai i bashkësisë ligjore, kontrata martesore mungon.

Së katërti, mbetet e paqartë nëse regjistrimit i nënshtrohet vetëm vendimi i gjykatës që miraton kërkesën për pjesëtim apo do të regjistrohet edhe vendimi që rrëzon kërkesën për pjesëtim. Në këtë pikë doktrina juridike është e ndarë. Në mënyrë gati unanime doktrina italiane⁷⁵⁴ pranon regjistrimin vetëm të vendimit të pjesëtimit të pasurisë duke përjashtuar çdo mundësi të regjistrimit të vendimit që rrëzon kërkesën për pjesëtim. Ndërsa nga ana tjetër, doktrina franceze⁷⁵⁵ është në favor të regjistrimit si të vendimit të pjesëtimit ashtu dhe të vendimit që rrëzon kërkesën për pjesëtim.

Në përfundim të këtij trajtimi të shkurtër të institutit të pjesëtimit të pasurisë, gjykojmë të nevojshme të shtrojmë edhe një tjetër çështje për diskutim. Në heshtje të ligjit, lind pyetja nëse bashkëshortët kanë të drejtë të rikthehen, për të ardhmen, në regjimin e bashkësisë nëpërmjet një kontrate martesore, apo detyrimisht regjimi i pasurive të ndara do të zbatohet deri në përfundim të martesës. Në situatën hipotetike kur për shkak të ndarjes faktike të bashkëshortëve dhe të ndarjes faktike të pasurisë së tyre, është pjestuar në rrugë gjyqësore pasuria dhe në një moment të mëvonshëm, bashkëshortët vendosin të rifillojnë jetesën e përbashkët. A kanë ata të drejtë të vendosin me marrëveshje rikthimin e tyre në një regjim bashkësie?

⁷⁵³ Në mungesë të këtij shënimi, ndryshimi nuk kundërshtohet nga të tretët, në qoftë se në aktet e bëra midis tyre, bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimi pasuror martesor (neni 72, paragrafi 3 i kod.fam).

⁷⁵⁴ Navarrini, “Contributo allo studio dell’azione di separazione giudiziale dei beni tra i coniugi.” fq. 674.

⁷⁵⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 427.

Doktrina franceze⁷⁵⁶ i ka dhënë përgjigje pozitive, duke pranuar që, vendosja e regjimit të pasurive të ndara nuk është përfundimtare⁷⁵⁷ dhe bashkëshortët janë të lirë ta ndryshojnë atë, në drejtim të regjimit të bashkësisë ligjore ose të një tjetër regjimi kontraktor, që i përgjigjet interesave të tyre (pasi të kenë respektuar afatin 2 vjeçar të vendosur nga neni 72/1 i kod.fam).

5.4. Struktura e regjimit të pasurive të ndara

Struktura e regjimit të pasurive të ndara paraqitet shumë më e thjeshtë në raport me regjimin e bashkësisë dhe për rrjedhojë edhe kontrata martesore, nëpërmjet së cilës vendoset regjimi i pasurive të ndara përgjithësisht ka një përmbajtje më të thjeshtë, në raport me kontratën e regjimit të bashkësisë⁷⁵⁸.

Nëse në kontratën e regjimit të bashkësisë, bashkëshortët duhet të rregullojnë objektin e bashkësisë, duke treguar kategorinë e sendeve që përfshihen dhe kategorinë e atyre që do të përjashtohen nga bashkësia, në kontratën e regjimit të pasurive të ndara, duke qenë se ky regjim, karakterizohet nga mungesa e masës së përbashkët të sendeve, është e mjaftueshëm që bashkëshortët të shprehen thjesht për përjashtimin e zbatimit të regjimit ligjor dhe për zbatimin e regjimit të pasurive të ndara⁷⁵⁹.

Kontrata martesore e regjimit të pasurive të ndara mund të paraqitet e thjeshtë, duke përmbajtur vetëm vullnetin e bashkëshortëve për vendosjen e tyre në këtë regjim, pa qenë i nevojshëm parashikimi i asnjë klauzole tjetër⁷⁶⁰, mjafton vetëm që vullneti i bashkëshortëve, për përjashtimin e regjimit ligjor të jetë i qartë⁷⁶¹. Nëse në kontratë, bashkëshortët nuk vendosin klauzola të tjera, atëherë do të jenë automatikisht të zbatueshme dispozitat e kod.fam. mbi regjimin e pasurive të ndara (nenet 115-122 të kod.fam).

Nga ana tjetër, në zbatim të parimit të autonomisë së vullnetit, bashkëshortët janë të lirë të përfshijnë në kontratën martesore të regjimit të pasurive të ndara, klauzola të tjera, nëpërmjet të cilave të vendosin rregulla të ndryshme nga ato të parashikuara nga kod.fam. në drejtim të mënyrës së administrimit të pasurisë, provës së sendeve, mbarimit dhe likuidimit të pasurisë. Në këtë hipotezë, shtrohet problemi se cilat janë kufijtë e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, në shmangie nga normat ligjore që rregullojnë regjimin e pasurive të ndara.

Parimi mbi të cilin është ndërtuar regjimi i pasurive të ndara, *prima facie*, paraqitet mjaft i thjeshtë: secili nga bashkëshortët ruan pronësinë ekskluzive, të drejtën e administrimit dhe të gëzimit të pasurisë së fituar para lidhjes së martesës dhe të pasurisë që do të fitohet gjatë veprimit të këtij regjimi. Në përcaktimin e titullarit të së drejtës së pronësisë, nuk ka aspak rëndësi fakti nëse pasuria është fituar nëpërmjet një veprimi juridik me ose pa kundërshtpërblim. Gjithashtu të njëjtit regjim juridik do t'i nënshtrohen frytet (natyrore apo civile) të pasurisë së bashkëshortëve, që do të përftohen gjatë martesës⁷⁶².

⁷⁵⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 430.

⁷⁵⁷ Cornu, *Lés régimes matrimoniaux*, fq. 556.

⁷⁵⁸ Nisur nga thjeshtësia e përmbajtjes së regjimit të pasurive të ndara, legjislationet e disa shteteve, në ndryshim nga Kodi Familjes shqiptar: si KC Italian, KC Francez dhe BGB gjerman, parashikojnë mundësinë e bashkëshortëve për të deklaruar në momentin e lidhjes së martesës, para nëpunësit të gjendjes civile, zgjedhjen e regjimit të pasurive të ndara, pa qenë nevoja e lidhjes së një kontrate martesore. Kjo është një procedurë më thjeshtë për bashkëshortët dhe është e mundur të realizohet për shkak se në këto legjislatione regjimi i pasurive të ndara gjen një rregullim të detajur në ligj.

⁷⁵⁹ Raggi, "I regimi convenzionali. La separazione dei beni." fq. 88.

⁷⁶⁰ Cattaneo, "Del regime di separazione dei beni." fq. 470.

⁷⁶¹ Tatarano dhe Capobianco, "Il regime della separazione dei beni tra coniugi." fq. 538.

⁷⁶² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 607.

Nga ana tjetër, nëse gjatë regjimit të pasurive të ndara, bashkëshortët fitojnë pasuri me të ardhura të përbashkëta ose marrin përsipër bashkërisht detyrime, atëherë do të gjejnë zbatimin e kodit civil mbi fitimin dhe humbjen e pronësisë dhe mbi përmbushjen e detyrimeve.

Në mënyrë unanime, sipas doktrinës franceze, gjatë regjimit të pasurive të ndara, bashkëshortët do të jenë jo vetëm titullarë të pasurisë së fituar gjatë martesës, por njëkohësisht janë titullarë edhe të detyrimeve që marrin përsipër personalisht gjatë martesës, apo të detyrimeve para lidhjes së martesës, përveç rastit kur detyrimet janë marrë përsipër në emër të të dy bashkëshortëve. Parimi i korrelacionit ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të pasurisë së bashkëshortëve është një parim mjaft i rëndësishëm, i cili qëndron në themel të të gjitha regjimeve pasurore martesore pavarësisht nëse janë regjime bashkësie apo regjime separatiste. Ky është një parim i pashmangshëm.⁷⁶³

5.4.1. *Aktivi i pasurisë së bashkëshortëve*

Paragrafi i parë i nenit 115, parashikon që, secili prej bashkëshortëve ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij. Nga leximi i këtij paragrafi, nxjerrim përfundim që, bashkëshortët, gjatë regjimit të pasurive të ndara, ruajnë pronësinë ekskluzive mbi:

a) Pasurinë që është në pronësi të tyre, para datës së lidhjes së martesës (kur kontrata martesore është lidhur *ante nuptial*) ose para datës së lidhjes së kontratës martesore (nëse kontrata është lidhur *constante matrimonii*);

b) Pasurinë që do të fitojnë gjatë regjimit të pasurive të ndara.

Bashkëshortët ushtrojnë mbi pasurinë e fituar para dhe gjatë regjimit të pasurive të ndara, të gjitha të drejtat që gëzon pronari mbi sendin.

Si rregull i përgjithshëm pronar i pasurisë së fituar gjatë martesës do të jetë bashkëshorti në emër të të cilit është fituar pasuria.

Në përcaktimin e bashkëshortit titullar të pasurisë së fituar gjatë martesës, për ligjin nuk ka asnjë rëndësi nëse pasuria është fituar nëpërmjet një veprimi juridik me ose pa kundërshpërblim.

Ndërsa, për pasurinë e fituar me anë të veprimeve juridike pa kundërshpërblim, është më e lehtë të përcaktohet bashkëshorti titullar, problemet më të shumta në praktikë shfaqen në rastin e pasurisë së fituar nëpërmjet veprimeve juridike me kundërshpërblim, veçanërisht në hipotezën kur për fitimin e sendit ka kontribuar ekonomikisht edhe bashkëshorti tjetër, apo në rastin kur pronësia është fituar nëpërmjet bashkimit dhe përzierjes së sendeve që i përkasin në pronësi të dy bashkëshortëve.

Gjithashtu për ligjin nuk ka asnjë rëndësi nëse bashkëshorti pronar është titullar ekskluziv i së drejtës së pronësisë apo e gëzon atë në bashkëpronësi me persona të tjerë, apo e gëzon në bashkëpronësi me bashkëshortin tjetër (sipas regjimit të bashkëpronësisë në pjesë), sepse në këto hipoteza, kuota (pjesa takuese) e secilit bashkëshort konsiderohet si një “send” më vete, të cilin bashkëshorti pronar është i lirë ta administrojë, posedojë dhe disponojë lirisht, apo të kërkojë pjesëtimin gjatë martesës⁷⁶⁴. Le të trajtojmë disa nga këto probleme.

A. Fitimi i pasurisë me veprime juridike pa kundërshpërblim. Në këtë eventualitet, pronar do të jetë bashkëshorti i cili figuron si përfitues i dhurimit në kontratën e dhurimit, ose në rastin e pasurisë së fituar me trashëgimi, bashkëshorti që është trashëgimtar i “*de cuius*it”. Nëse dhurimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve, atëherë të dy ata do të jenë bashkëpronar mbi sendin, sipas dispozitave të kodit civil.

⁷⁶³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 607-612.

⁷⁶⁴ Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 134.

B. Fitimi i pasurisë me veprime juridike me kundërshpërblim, me kontributin e përbashkët të të dy bashkëshortëve. Nuk është e pazakontë që gjatë regjimit të pasurive të ndara, njëri bashkëshort fiton pasuri në emër të tij apo në emër të të dy bashkëshortëve, duke përdorur të ardhurat e të dy bashkëshortëve apo vetëm të ardhurat e bashkëshortit tjetër.

Përcaktimi i pronësisë dhe mbrojtja e të drejtave të bashkëshortit tjetër do të realizohen nëpërmjet zbatimit të parimeve të kod.civ mbi pronësinë dhe detyrimet. Jemi të mendimit që, për t'i dhënë zgjidhje këtyre situatave, në asnjë rast nuk mund të gjejnë zbatim dispozitat e kod.fam. mbi bashkësinë ligjore, as nëpërmjet interpretimit me analogji të tyre, sepse në momentin kur bashkëshortët, në kontratën martesore, kanë vendosur zbatimin e regjimit të pasurive të ndara, atëherë vullneti i tyre është përjashtimi tërësisht i regjimit ligjor.

Në rastin e fitimit të pasurisë me të ardhurat e të dy bashkëshortëve, duhen dalluar dy hipoteza:

1. Pasuria fitohet në emër të njërit bashkëshort me të ardhurat e të dy bashkëshortëve, ose vetëm të bashkëshortit tjetër.

Është pranuar nga doktrina që, pronar i sendit të fituar gjatë regjimit të pasurive të ndara, nëpërmjet veprimeve juridike me kundërshpërblim, është bashkëshorti në emër të të cilit është kryer veprimi juridik, pavarësisht, nëse në pagimin e çmimit ka kontribuar vetëm ky bashkëshort, të dy bashkëshortët apo bashkëshorti tjetër⁷⁶⁵.

Në praktikë, nëse njëri prej bashkëshortëve lidh një kontratë shitje për blerjen e një sendi psh: të një apartamenti, por çmimi i blerjes paguhet tërësisht nga bashkëshorti tjetër ose paguhet me të ardhurat e të dy bashkëshortëve, atëherë kjo nuk do të sjellë asnjë pasojë në përcaktimin e titullarëve të apartamentit, titullar është bashkëshorti në emrin e të cilit është lidhur kontrata e shitjes⁷⁶⁶.

Për të përmbledhur mendimin e mësipërm, mund të themi që, në rastin kur në fitimin e sendeve në emër të njërit bashkëshort ka kontribuar me një pjesë të shumës edhe bashkëshorti tjetër, atëherë duhet hetuar nëse, shumën e paguar prej tij është një dhurim që i është bërë bashkëshortit pronar, apo një hua. Nëse shumën është dhënë në formën e dhurimit, atëherë bashkëshorti që e ka dhënë atë nuk mund të kërkojë kthimin mbrojtës të saj. Ndërsa, nëse shumën është dhënë në formën e huasë, atëherë do të zbatohen dispozitat e kod.civ. mbi përmbushjen e detyrimeve. Sipas mendimit doktrinal, bashkëshortit tjetër duhet t'i njihet një e drejtë kreditit mbi pasurinë e bashkëshortit pronar, për kthimin e shumës së paguar, por nuk do t'i njihet asnjë e drejtë pronësie mbi sendin. Në asnjë rast për nuk do të gjejë zbatim instituti i kthimeve dhe kompensimeve që karakterizon fazën e likuidimit të regjimit të bashkësisë⁷⁶⁷.

2. Sendi është fituar në emër të të dy bashkëshortëve.

Megjithëse karakteristikë e regjimit të pasurive të ndara është pavarësia pasurore e bashkëshortëve gjatë martesës, asgjë nuk i ndalon ata të fitojnë pasuri së bashku.

Në hipotezën kur pasuria, gjatë regjimit të pasurive të ndara, është fituar në emër të të dy bashkëshortëve, nëpërmjet veprimeve juridike me ose pa kundërshpërblim, atëherë të dy bashkëshortët do të jenë bashkëpronarë të pasurisë së fituar në emër të tyre dhe do të zbatohet i njëjti regjim juridik, që zbatohet për personat që fitojnë pasuri bashkërisht pa qenë të lidhur në martesë. Regjimi juridik i zbatueshëm do të jetë regjimi i bashkëpronësisë në pjesë, sipas dispozitave të kod.civ. Në asnjë rast nuk mund të gjejë zbatim regjimi ligjor i bashkësisë.

⁷⁶⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 607.

⁷⁶⁶ Sesta dhe Vagliani, "Il regime di separazione dei beni." fq. 603.

⁷⁶⁷ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 547-548.

C. Fitimi i sendeve që i shërbejnë përdorimit familjar. Është e zakonshëm që, edhe gjatë regjimit të pasurive të ndara, bashkëshortët të veç e veç ose së bashku, të fitojnë sende të cilat janë në funksion të mbarëvajtjes së jetës së përbashkët dhe në përgjithësi të familjes, siç mund të jenë për shembull pajisjet e banesës familjare.

Nëse sendet janë fituar në emër të të dy bashkëshortëve, atëherë është e kuptueshme që të dy do të jenë bashkëpronarë mbi këto sende, bazuar në regjimin juridik të bashkëpronësisë në pjesë të rregulluar nga dispozitat e kod. civ.

Nga ana tjetër, nëse sendet janë fituar në emër vetëm të njërit bashkëshort, është opinion i doktrinës që, duhet hetuar nëse ka ekzistuar edhe një pëlqim, qoftë i shprehur apo i heshtur i bashkëshortit tjetër për fitimin e pronësisë së sendit.

Sipas doktrinës edhe në rastin kur sendet e përdorimit familjar, janë fituar në emër vetëm të njërit bashkëshort, mund të jenë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, nëse për fitimin e tyre ka pasur një marrëveshje ndërmjet bashkëshorteve, qoftë të shprehur apo të heshtur, edhe nëse çmimi i blerjes është pagur vetëm nga njëri prej tyre⁷⁶⁸.

D. Në truallin në pronësi të njërit bashkëshort, realizohet një ndërtim me kontributin ekonomik të të dy bashkëshortëve, ose të bashkëshortit tjetër. Nuk janë të pakta rastet, kur gjatë martesës, në truallin në pronësi të njërit bashkëshort realizohet një ndërtim me kontributin e përbashkët të të dy bashkëshortëve ose tërësisht me kontributin e bashkëshortit jopronar.

Për zgjidhjen e problemit të pronësisë së truallit dhe të ndërtimit të realizuar në të, do të zbatohen dispozitat e kod.civ. mbi fitimin e pronësisë me bashkim të një sendi të paluajtshëm me sende të luajtshme⁷⁶⁹. Në bazë të nenit 173 të kod.civ, mbjelljet, si dhe ndërtesat e çdo vepër tjetër që ndodhen mbi ose në sipërfaqen e tokës, i përkasin pronarit të saj. Do të zbatohen parimet e përcaktuar nga dispozitat e kod.civ. mbi fitimin dhe humbjen e pronësisë⁷⁷⁰.

E. Njëri bashkëshort pasurohet si pasojë e punës së bashkëshortit tjetër. Një tjetër problem, që është evidentuar në praktikë, është rasti kur gjatë regjimit të pasurive të ndara, njëri bashkëshort fiton pasuri, si pasojë e punës (kontributit në natyrë) të bashkëshortit tjetër.

Për ilustrimin e problemit, mund të marrim rastin kur njëri bashkëshort, pa shpërblim, angazhohet në administrimin e veprimtarisë tregtare të bashkëshortit tjetër.

Ky bashkëshort nuk mund të pretendojë pjesë në të ardhurat e fituara nga veprimtaria tregtare, pasi këto të ardhura janë në pronësi të bashkëshortit që, është njëkohësisht pronar edhe i veprimtarisë tregtare.

Sipas doktrinës franceze⁷⁷¹, marrëdhëniet e bashkëshortëve, në një hipotezë të tillë do të rregullohen nga instituti i begatimit pa shkak.

Nëse njëri bashkëshort ka ofruar kontributin e tij në natyrë, në shtimin e pasurisë së bashkëshortit tjetër, pa marrë asnjë në shpërblim, atëherë jemi në situatën kur njëri bashkëshort është pasuruar pa shkak nga puna e bashkëshortit tjetër dhe për rrjedhojë për të rregulluar marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre, do të gjejë vend instituti i begatimit pa shkak. Nuk mund të ketë begatim pa shkak, nëse puna e ofruar nga njëri bashkëshort klasifikohet në kontributin material për nevojat e familjes⁷⁷² (neni 54 kod.fam.).

Bazuar sërish në doktrinën dhe jurisprudencën franceze, momenti kohor i vlerësimit respektivisht të varfërimit të njërit bashkëshort dhe pasurimit të bashkëshortit tjetër, nuk do të jetë momenti i

⁷⁶⁸ Sesta dhe Vagliani, "Il regime di separazione dei beni." fq. 604.

⁷⁶⁹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 607-608.

⁷⁷⁰ Paladini, "La comunione convenzionale." fq. 283.

⁷⁷¹ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 545.

⁷⁷² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 609.

marrjes dijani, por momenti i paraqitjes së kërkesës për zgjidhjen e martesës, për shkak të “pamundësisë morale” të bashkëshortit të varfëruar pa shkak, për të vepruar kundër bashkëshortit tjetër, gjatë kohëzgjatjes së martesës⁷⁷³.

F. Fitimi i sendeve të luajtshme. Në praktikë, problemet më të shumta shfaqen në përcaktimin e pronësisë së sendeve të luajtshme, sepse për sendet e paluajtshme përcaktimi i pronësisë është më i thjeshtë, sepse rezulton nga dokumente të shkruara⁷⁷⁴ (sipas nenit 83/1 kod.civ. veprimet për transferimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale që lidhen me to, duhet të kryhen me akt noterial, për efekt vlefshmërie).

Për të lehtësuar përcaktimin e titullarëve të pronësisë së sendeve të luajtshme të fituara gjatë martesës, ligjvënësi ka parashikuar disa rregulla të cilat bazohen mbi prezumime, të cilat do ti analizojmë gjatë këtij kapitulli.

5.4.2. Pasivi i pasurisë së bashkëshortëve (detyrimet)

Bazuar në parimin e rëndësishëm të lidhjes së drejtpërdrejtë që ekziston ndërmjet aktivitetit dhe pasivit të pasurisë, parim që është konsideruar nga doktrina si i pashmangshëm dhe aktiviteti ashtu edhe pasivi i pasurisë së bashkëshortëve, mbetet i ndarë gjatë regjimit të pasurive të ndara.

Ky parim, konkretisht, gjen shprehje në nenin 115/2 të kod.fam., sipas së cilit, secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur atij, para ose gjatë martesës.

Duhet venë në dukje që, termi i përdorur nga ligjvënësi “**para ose gjatë martesës**” nuk është shumë i kënaqshëm. Do të kishte qenë më saktë përdorimi i termit “**para ose gjatë regjimit të pasurive të ndara**”, sepse kujtojmë edhe një herë që, ligjvënësi ka lejuar jo vetëm lidhjen e kontratave martesore *ante nuptial*, por edhe mundësinë e ndryshimit të regjimit pasuror “*constante matrimonii*”.

Në varësi të regjimit juridik të cilit i nënshtrohen, detyrimet e bashkëshortëve, në regjimin e pasurive të ndara, mund t’i klasifikojmë në këto grupe:

A. Detyrimet vetjake të secilit bashkëshort. Bazuar në nenin paragrafin e dytë të nenit 115 të kod.fam. detyrimet që kanë lindur para vendosjes së regjimit të pasurive të ndara dhe detyrimet që janë marrë personalisht përsipër nga bashkëshortët, gjatë këtij regjimi, janë detyrime vetjake.

Detyrime vetjake të secilit bashkëshort do të përmbushen me pasurinë e tyre vetjake. Nëse pasuria vetjake e bashkëshortit debitor është e pamjaftueshme për të përmbushur detyrimin, atëherë kreditorët nuk mund të veprojnë mbi pasurinë e bashkëshortit tjetër, për të realizuar të drejtën e tyre. Në ndryshim nga regjimi i bashkësisë ligjore, ku ligjvënësi parashikon norma të veçanta që rregullojnë regjimin juridik të përmbushjes së detyrimeve që bashkëshortët kanë ndaj të tretëve, në regjimin e pasurive të ndara, regjimi juridik që i zbatohet përmbushjes së detyrimeve të bashkëshortëve ndaj të tretëve, është ai i parashikuar në kod.civ.⁷⁷⁵

Në praktikë mund të paraqiten situata ku njëri bashkëshort, pa qenë i detyruar, përmbush detyrimin vetjak të bashkëshortit tjetër. Cili do të jetë mjeti ligjor që ka në dispozicion ky bashkëshort për të realizuar kthimin e shumës që, ka paguar si dhe ndaj cilit subjekt duhet të veprojë, ndaj kreditorit apo ndaj bashkëshortit debitor.

Së pari, duhet hetuar se me cilin titull është realizuar përmbushja e detyrimit. Nëse njëri bashkëshort ka përmbushur detyrimin në formën e një dhurimi ndaj bashkëshortit debitor,

⁷⁷³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 609.

⁷⁷⁴ Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 603.

⁷⁷⁵ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 842-843.

atëherë ai nuk mund të kërkojë kthimin e shumës së paguar as ndaj bashkëshortit debitor dhe aq më pak ndaj kreditorit.

Nëse, nga ana tjetër, përmbushja e detyrimit nuk është realizuar me qëllim dhurimi, atëherë bashkëshortit që ka përmbushur detyrimin, ka të drejtën e regresit ndaj bashkëshortit debitor.

B. Detyrimet e përbashkëta. Pavarësisht parimit të pavarësisë së aktivitetit dhe pasivitetit të pasurisë së bashkëshortëve, bashkëshortët, me vullnetin e tyre ose për shkak të parashikimeve të ligjit, mund të lindin detyrime të përbashkëta.

Bazuar në mënyrën e përmbushjes së tyre dhe në regjimin juridik që i zbatohet, detyrimet e përbashkëta, që lindin gjatë regjimit të pasurive të ndara, mund t'i klasifikojmë në dy grupe:

1. *Detyrime solidare.* Detyrimet solidare, bazuar në burimin e krijimit, i klasifikojmë në dy kategori:

a) *Detyrime solidare ligjore, atë që doktrina franceze e quan “solidaritet ligjor”⁷⁷⁶.*

Bazuar në nenin 60 të kod.fam. bashkëshortët detyrohen solidarisht për të gjitha ato detyrime, që njëri prej tyre ka marrë përsipër në funksion të mbajtjes së familjes edhe të edukimit të fëmijëve, qoftë edhe pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Sipas nenit 60 të kod.fam. bashkëshortët kanë ndaj njërit tjetrit një liri veprimi në lidhje me kryerjen e veprimeve juridike që janë në funksion të mbajtjes së familjes dhe edukimit të fëmijëve. Për detyrimet që rrjedhin nga këto veprime juridike janë solidarisht përgjegjës të dy bashkëshortët, pavarësisht nëse veprimet juridike kryhen nga njëri bashkëshort, qoftë edhe pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, apo nga të dy bashkëshortët. Përmbushja e detyrimeve solidare do të realizohet sipas dispozitave të kod.civ, që rregullojnë detyrimet solidare.

Kreditori mund të kërkojë përmbushjen e të gjithë detyrimit apo të një pjese të tij nga secili prej bashkëshortëve. Nëse detyrimi është përmbushur tërësisht nga njëri bashkëshort, apo nëse ka paguar një pjesë më të madhe të detyrimit, në raport me atë që i takonte, atëherë atij i lind e drejta e regresit ndaj bashkëshortit tjetër.

Megjithatë, nëse detyrimi është haptazi i tepërt, duke pasur parasysh disa kritere si: mënyrën e jetesës së familjes, dobishmërinë e veprimit të kryer si dhe mirëbesimin ose keqbesimin e personave të tjerë kontraktues, atëherë nuk mund të detyrohet bashkëshorti jokontraktues që të përgjigjet për të. Në një eventualitet të tillë, detyrimi do të konsiderohet vetjak i bashkëshortit që e ka marrë përsipër dhe do të përmbushet me pasurinë e tij vetjake.

b) *Detyrimet solidare vullnetare*

Do të jenë detyrime solidare dhe për rrjedhojë do t'i nënshtrohen regjimit juridik të parashikuar nga kod.civ. të gjitha ato detyrime që kontraktohen nga bashkëshortët në mënyrë solidare.

2. *Detyrime të pjesëtueshme.* Bashkëshortët gjatë regjimit të pasurive të ndara mund të marrin bashkërisht përsipër detyrime ndaj personave të tretë. Për përmbushjen e detyrimeve do të zbatohen rregullat e kod.civ. të përmbushjes së detyrimeve, njëlloj si në rastin nëse bashkëshortët do të ishin dy persona të pa lidhur në martesë.

Bashkëshortët do të përgjigjen për përmbushjen e detyrimit me pasurinë e tyre vetjake, në përputhje me pjesën e detyrimit, që kanë marrë përsipër. Nëse në kontratë nuk janë përcaktuar pjesët e secilit bashkëshort debitor në detyrim, atëherë prezumohet nga ligji, që ato janë debitorë në pjesë të barabarta.

Nëse njëri prej bashkëshortëve është në pamundësi të përmbushë pjesën e tij të detyrimi, atëherë kreditori nuk mund të kërkojë përmbushjen e tij me pasurinë vetjake të bashkëshortit tjetër.

⁷⁷⁶ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 629.

Nëse njëri prej bashkëshortëve, në mënyrë vullnetare, përmbush edhe pjesën e detyrimit që i takonte bashkëshortit tjetër, atëherë ai, nuk mund të kërkojë nga kreditori kthimin e asaj që ka paguar apo ka dhënë në përmbushje, por ka të drejtën e regresit ndaj bashkëshortit tjetër.

C. Detyrimet ndërmjet bashkëshortëve. Gjatë martesës mund të lindin detyrime jo vetëm ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve por edhe ndërmjet vetë bashkëshortëve.

Në regjimin e bashkësisë ligjore/kontraktore, ligji parashikon që marrëdhëniet e detyrimit ndërmjet bashkëshortëve, që kanë lindur dhe janë bërë të kërkueshme gjatë kohëzgjatjes së martesës, zgjidhen në fazën e mbarimit të martesës, kur realizohet likuidimi i bashkësisë, nëpërmjet institutit të kthimeve dhe kompensimeve.

Nuk do të gjejnë zbatim të njëjtat rregulla të likuidimit të bashkësisë edhe në rastin e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara.

Asgjë nuk i ndalon bashkëshortët, që të t'i kërkojnë njëri-tjetrit përmbushjen e detyrimeve, që kanë lindur gjatë martesës ndërmjet tyre dhe janë bërë të kërkueshme. Megjithatë, ashtu siç tregon edhe praktika është e pazakontë për bashkëshortët që të ndërmarrin veprime ndaj njëri-tjetrit gjatë martesës. Kjo është edhe arsyeja që,

ligjvënësi ka parashikuar pezullimin e afateve të parashkrimit ndërmjet tyre, deri në momentin e marrjes së formës së prerë të vendimit të zgjidhjes së martesës⁷⁷⁷.

5.5. Kufijtë e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara

Pavarësisht regjimit pasuror të zgjedhur, bashkëshortët nuk mund të eliminojnë plotësisht një minimum bashkësie (solidariteti) mbi disa interesa pasurorë që i shërbejnë mbarëvajtjes së familjes dhe ruajtjes së solidaritetit ndërmjet anëtarëve të saj⁷⁷⁸.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar një regjim minimal bashkësie, i cili gjen zbatim në çdo rast, pavarësisht regjimit pasuror martesore, "*statut imperativ bazë*" ose "*regjimi primar i familjes*". Normat që rregullojnë statutin imperativ bazë të familjes, janë të pashmangshme, duke përbërë kështu limitet e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, për të pasur ekonomi plotësisht të ndara gjatë martesës.

Në regjimin e pasurive të ndara e drejta ekskluzive e bashkëshortit titullar mbi administrimin, përdorimin dhe disponimin e lirë të pasurisë së tij, duhet të koordinohet me disiplinën e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga martesa⁷⁷⁹.

Nga leximi i kombinuar i normave të kod.fam që rregullojnë regjimin e pasurive të ndara dhe atyre që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesa, mund të nxjerrim përfundimin që nuk mund të shmangen me marrëveshje të bashkëshortëve, detyrimet e mëposhtme:

A. Detyrimet që rrjedhin nga martesa. Bazuar në nenin 116 të kod.fam., i cili referon në nenin 54 të tij, bashkëshortët kanë detyrimin e kontributit material për nevojat e familjes dhe martesës.

Bashkëshortët, gëzojnë një autonomi të gjerë për të përcaktuar modalitetet e përmbushjes së këtij kontributi, në kontratën e martesës, por nuk mund të shmangen në asnjë rast nga përmbushja e tij.

⁷⁷⁷ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 613-614; Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 632-633.

⁷⁷⁸ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 552.

⁷⁷⁹ Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 130.

Nëse bashkëshortët nuk kanë përcaktuar në kontratën e martesës modalitetet e përbushjes së detyrimit material ndaj familjes, atëherë secili prej tyre do të kontribuojë në përputhje me të ardhurat dhe aftësinë për punë të secilit prej tyre.

Sipas nenit 65 dhe 67 të kod.fam. zbatohen me përparësi, pavarësisht regjimit pasuror martesor, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, të cilat janë të pashmangshme me marrëveshje të bashkëshortëve.

B. Detyrimet për mbajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve. Në ndryshim neni 54 i cili, përcakton mënyrën e përbushjes së detyrimeve ndaj familjes, në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve, neni 60 i kod.fam. përcakton mënyrën e përbushjes së detyrimeve në interes të familjes dhe edukimit të fëmijëve në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve (kreditorëve të tyre).

Duke parë këtë lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, doktrina ka gjykuar që vendosja e tyre në dy dispozita të veçanta nuk është shumë e kënaqshme nga pikëpamja e teknikës legislative dhe për rrjedhojë është i nevojshëm një formulim më i saktë i dy dispozitave, duke i bashkuar në një të vetme⁷⁸⁰. Ky është qëndrimi që mban doktrina franceze mbi përbajtjen e këtyre dy dispozitave (përkatësisht nenet 214 dhe 220 të KC Francez). Nga ana tjetër, qëndrimet e doktrinës italiane janë të ngjashme. Sipas një autori, detyrimet e marra përsipër në interes të familjes dhe të edukimit të fëmijëve, janë detyrime që tejkalojnë kufijtë e regjimit të bashkësisë ligjore dhe pozicionohen, për sa i përket rëndësisë dhe regjimit juridik të cilit i nënshtrohen, në të njëjtin nivel me detyrimin e kontributit material⁷⁸¹.

Në vija të përgjithshme neni 60 i kod.fam. parashikon që bashkëshortët janë së bashku solidarisht përgjegjës për detyrimet që së bashku ose secili veç e veç marrin përsipër gjatë martesës, që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes dhe edukimin e fëmijëve.

Gjykojmë të arsyeshme analizën e formulimi të paragrafit të dytë të nenit 115 të kod.fam.

*“Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur, para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të parashikuar në **nenin 70 të këtij Kodi**”*

Analiza do të realizohet në analogji me paragrafin e dytë të nenit 1536 të KC Francez, i cili ka shërbyer si model për hartimin e nenit 115 të kod.fam.

Si rregull i përgjithshëm, neni 115/2 parashikon parimin e pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, nën regjimin e pasurive të ndara. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, neni 115/2 referon në nenin 70 të kod.fam, në të cilin gjen rregullim ndalimi i lidhjes së kontratës martesore nga i mituri⁷⁸².

Nga leximi i vëmendshëm i nenit 115/2 dhe nenit 70 në të cilin i pari referon, patjetër që vihet re mungesa e lidhjes logjike ndërmjet tyre.

Në parim, neni 115/2 është ndërtuar në formën e një parimi (pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve) dhe të një përjashtimi nga parimi i përgjithshëm (neni 70 i kod.fam.), që në qoftë se lexojmë *expressis verbis* nuk kanë lidhje me njëri tjetrin.

Për të hedhur dritë mbi atë që ligjvënësi ka dashur të parashikojë në përjashtimin nga parimi i pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, referojmë tek neni 1536/2 i KC Francez, i cili

⁷⁸⁰ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 42.

⁷⁸¹ Tatarano dhe Capobianco, “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” fq. 552.

⁷⁸² Nga leximi i kombinuar i nenit 115/2 me nenin 70 të kod.fam. rezulton që, formulimi i nenit 115/2 është “Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur, para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të martesës së të miturit”.

pasi parashikon parimin e pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, referon në nenin 220 të tij (neni 60 i kod.fam), si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm.

Konkluzioni që mund të nxjerrim është që, ligjvënësi ynë ka bërë një **“gabim”**, një **“lapsus”** në përshtatjen e normës. Ky konkluzion rezulton jo vetëm nga leximi i së njejtës dispozitë të KC Francez, që ka shërbyer si model për nenin 115 të kod.fam, por edhe nga *ratio* e vetë nenit 115/3, i cili ka për qëllim që, pavarësisht pavarësisë së plotë pasurore të bashkëshortëve, të ruajë një minimum bashkëpunimi ekonomik të bashkëshortëve në interes të familjes.

Në analizë të fundit, ***de lege ferenda***, propozojmë që, formulimi i nenit 115/2 i kod.fam. të ndryshojë, si më poshtë vijon:

*“Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur atij para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të parashikuar në **“nenin 60”** të këtij kodi.”*

Bazuar në nenin 65 të kod.fam, pavarësisht lapsusit që mbart paragrafi i dytë i nenit 115 të kod.fam, neni 60 do të gjejë zbatim edhe për bashkëshortët e martuar në regjimin e pasurive të ndara, sepse neni 60 bashkë me të gjitha dispozita e tjera të Kreut I të Titullit II të kod.fam, zbatohen, me përparësi, për të gjithë bashkëshortët, pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i tyre.

C. Ndalimi i disponimit të banesës familjare. Sipas nenit 57 të kod.fam. pavarësisht nga regjimi pasuror martesor, të cilit i nënshtrohen, bashkëshortët nuk mund të disponojnë banesën familjare dhe pajisjet e saj, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër.

Për ligjin nuk ka rëndësi se cili bashkëshort është pronar i banesës familjare, apo nëse pronësia e saj është fituar para lidhjes së martesës apo gjatë saj, në çdo rast disponimi i saj, duhet të realizohet më pëlqimin e shprehur të të dy bashkëshortëve.

Veprimi juridik i disponimit të banesës familjare, i kryer pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër është relativisht i pavlefshëm. Të drejtën për të kërkuar pavlefshmërinë e veprimit e ka vetëm bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk është marrë.

5.6. Administrimi i pasurisë nën regjimin e pasurive të ndara

5.6.1. Konsiderata të përgjithshme

Parimi i përgjithshëm, mbi të cilin është ndërtuar regjimi juridik i administrimit të pasurisë së bashkëshortëve gjatë regjimit të pasurive të ndara është ai i pavarësisë së secilit prej tyre në administrimin e pasurisë vetjake.

Ky parim, së bashku me atë të pavarësisë së aktivitetit dhe pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, përbëjnë themelin e regjimit të pasurive të ndara.

Megjithatë, duke qenë se, gjatë jetesës së përbashkët, nuk është e pazakontë që bashkëshortët të administrojnë pasurinë e njëri-tjetrit, ligjvënësi ka parashikuar regjimin juridik të cilit do t'i nënshtrohet ky administrim dhe frytet e përfuara gjatë tij.

Administrimi i pasurisë së bashkëshortit jopronar nga bashkëshorti pronar jo vetëm që nuk është i ndaluar; sepse përderisa çdo individ i lejohet të autorizojë persona të tretë në administrimin e pasurisë së tij, nuk ka pse të ekzistojë si ndalim ndërmjet bashkëshortëve; por përkundrazi, bashkëpunimi i bashkëshortëve në administrimin e ndërsjelltë të pasurive të tyre, meriton të favorizohet nga ligji⁷⁸³. Bashkëshorti pronar ka të drejtë të përfaqësohet nga bashkëshorti jopronar, në administrimin e pasurisë së tij.

⁷⁸³ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 635.

Konkretisht nenet 117 dhe 118 të kod.fam, të interpretuara në lidhje të ngushtë me nenin 68 rregullojnë regjimin juridik, të cilit i nënshtrohet administrimi i pasurisë së njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër, gjatë regjimit të pasurive të ndara.

Nga formulimi i dispozitave të sipërpërmendura, natyrshëm evidentohen disa elementë të cilat kanë nevojë për sqarime të mëtejshme.

A. Natyra juridike e përfaqësimit. Ligjvënësi, në formulimin e neneve 117, 118 dhe 68 të kod.fam, nuk është gjithmonë koherente në termat që përdor, për t'iu referuar veprimit juridik mbi bazën e së cilit bashkëshorti pronar autorizon bashkëshortin jopronar për administrimin e pasurisë së tij.

Dy janë termat e përdorur si sinonime të njëri-tjetrit: **“mandat”** dhe **“prokurë”**. Ndërsa, nenet 68/2 dhe 118/1 të kod.fam. përdorin përkatësisht termat **“mandat përfaqësimi”** dhe **“mandat i heshtur”**, në nenin 117/2 i kod.fam. gjen përdorim termi **“prokurë”**⁷⁸⁴.

Ndërkohë, nga ana tjetër nuk gjejmë në asnjë dispozitë të kodit civil termin mandat dhe aq më pak rregullimin e institutit të mandatit.

Për të hedhur dritë mbi mandatin, i referohemi KC Francez dhe KC Italian, në të cilat termi mandat përdoret për t'iu referuar kontratës së porosisë⁷⁸⁵.

Shtrohet pyetja se cili është instituti i parashikuar nga ligjvënësi në nenet 117, 118 dhe 68 të tij instituti i përfaqësimit mbi bazën e prokurës apo instituti i kontratës së porosisë (mandati)⁷⁸⁶?

Të njëjtën pasaktësi e vëmë re edhe në KC Italian (neni 217), ndërsa KC Francez parashikon shprehimisht institutin e mandatit (nenet 1539 dhe 1540).

Bazuar në interpretimin doktrinal të nenit 217 të KC Italian, ligjvënësi ka dashur t'i referohet institutit të mandatit (**kontratës së porosisë**) dhe jo atij të prokurës, pavarësisht se gabimisht ka përdorur termin “prokurë”.

B. Veprimet e administrimit. Është gjithashtu e nevojshme të sqarohet kuptimi i termit **“administrim”** të përdorur nga ligjvënësi në nenet 115, 117 dhe 118 të kod.fam.

Shtrohet pyetja nëse me termin **“administrim”** ligjvënësi ka dashur të kuptojë të gjitha veprimet e administrimit të pasurisë, duke përfshirë këtu veprimet e administrimit të zakonshëm dhe ato të administrimit jo të zakonshëm (ku përfshihet edhe disponimi i pasurisë) apo i referohet vetëm veprimeve të administrimit të zakonshëm⁷⁸⁷.

Në nenin 115 të kod.fam, **“...secili bashkëshort ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij”**, termi **“administrim”** i referohet vetëm veprimeve të administrimit të zakonshëm, duke përjashtuar veprimet e disponimit, përderisa në tekstin e normës, termi disponim është veçuar nga ai i administrimit.

Situatë identike gjejmë edhe në nenin 118/1 të kod.fam, **“...konsiderohet se ka marrë mandat të heshtur, i cili mbulon veprimet lidhur me administrimin, por jo atë të disponimit”**, ku sërish

⁷⁸⁴ Sipas dispozitave të kod.civ. prokura është veprimi juridik i njënjshëm, nëpërmjet të cilit një person autorizon një person tjetër të kryejë, brenda tagreve që përmban prokura, veprime juridike në emër dhe për llogari të tij.

⁷⁸⁵ Mandati ose porosia është kontrata nëpërmjet së cilës njëra palë (përfaqësuesi) detyrohet të kryejë një ose disa veprime juridike për llogari të palës tjetër (i përfaqësuar).

⁷⁸⁶ Në sqarimin e situatën nuk ndihmon as referimi në paragrafin e parë të nenit 177 të kod.fam. tek rregullat e përfaqësimit, sepse bazuar në nenin 914 të kod.civ, nëse të porositurit i janë dhënë kompetencat për të vepruar në emër të porositurit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin. Në këtë hipotezë do të kemi atë që doktrina e njeh si porosia (mandati) me përfaqësim, kur i porosituri vepron në emër dhe për llogari të porositësit, për ta dalluar atë nga porosia (mandati) pa përfaqësim, kur i porosituri vepron vetëm për llogari të porositësit, por jo në emër të tij.

⁷⁸⁷ Kujtojmë këtu që, në regjimin juridik të bashkësisë ligjore, ligjvënësi ka dalluar qartë dy kategori të veprimeve të administrimit të bashkësisë, veprimet e administrimit të zakonshëm dhe ato të administrimit jo të zakonshëm, duke përcaktuar përkatësisht edhe regjimin juridik, që i zbatohet secilës kategori.

termi “*administrimi*” përfshin vetëm veprimet e administrimit të zakonshëm, duke përjashtuar shprehimisht veprimet e disponimit.

Situata paraqitet më e komplikuar në nenin 117 të kod.fam., “*nëse gjatë martesës njëri bashkëshort i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij...*”, mbetet e paqartë nëse në termin administrim përfshihet çdo veprim administrimi i zakonshëm dhe jo i zakonshëm i pasurisë.

Bazuar në interpretimin që doktrina italiane i bën nenit 217/1 të KC Italian, analog me nenin 117 të kod.fam., interpretim me të cilin pajtohem, mandati i përfaqësimit ka për objekt vetëm veprimet e administrimit të zakonshëm të pasurisë, me përjashtim të rastit kur palët kanë parashikuar shprehimisht që, administrimi do të përfshijë edhe veprimet e disponimit⁷⁸⁸.

Nëse në kontratën e porosisë nuk ka përcaktime specifike, por objekti është vetëm dhënia e një mandati të përgjithshëm përfaqësimi, atëherë veprimet e disponimit të pasurisë, janë të përjashtuara. Për këto veprime është e nevojshme një prokurë e posaçme.

Në analizë të fundit, gjykojmë që, për të shmangur çdo paqartësi që mund të lindë në praktikë, kod.fam. për t’i kishte qëndruar koherent terminologjisë së përdorur me atë të administrimit të bashkësisë ligjore, duhet të dallimit ndërmjet “*administrimit të zakonshëm*” dhe “*administrimit jo të zakonshëm*”.

C. Mundësia e shmangies së normave të administrimit. Gjykojmë të arsyeshme të ndalemi shkurtimisht në natyrën juridike të normave të administrimit (neni 117 dhe 118 kod.fam.) si norma lejuese apo urdhëruese dhe për rrjedhojë mbi mundësinë e shmangies ose jo të tyre, me marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve.

Nëse do të pranojmë karakterin urdhërues të tyre, atëherë rrjedhimisht do të arrijmë në përfundimin e pamundësisë së shmangies të tyre në marrëveshje të palëve; dhe anasjelltas karakteri lejues do t’i mundësonte palëve, parashikimin e rregullave të tjera të administrimit, të ndryshme nga ato ligjore.

Është mendimi mbizotërues i doktrinës që, nenet 117 dhe 118 të kod.fam. (bazuar në nenet respektive të KC Italian) janë plotësisht të shmangshme me marrëveshje të bashkëshortëve⁷⁸⁹.

5.6.2. Administrimi i pasurisë vetjake të njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër

Nisur nga formulimi i neneve 117 dhe 118 të kod.fam. dhe bazuar në interpretimin e doktrinës italiane dhe asaj franceze mbi dispozitat respektive të KC Italian dhe ai Francez, mund të identifikojmë katër hipoteza, në të cilat, gjatë regjimit të pasurive të ndara, administrimi i pasurisë së bashkëshortit pronar realizohet nga bashkëshorti jopronar.

5.6.2.1. Administrimi bazuar në ekzistencën e një mandati

Në hipotezën e administrimit të pasurisë së bashkëshortit pronar nga bashkëshorti tjetër, bazuar mbi mandatin e përfaqësimit duhet të dallojmë dy raste: a) hipoteza në të cilën administrimi mbështetet në një mandat të shprehur dhe b) hipoteza kur përfaqësimi realizohet me dijeninë, por pa kundërshtimin e bashkëshortit pronar, pra bazohet mbi një mandat të heshtur.

A. Administrimi mbi bazën e mandatit të përfaqësimit. Bazuar në nenin 117 të kod.fam., secili bashkëshort ka të drejtë t’i besojë bashkëshortit tjetër administrimin e pasurisë së tij, mbi bazën e një prokure, nëse i referohemi *expressis verbis* termit të përdorur nga ligjvënësi në

⁷⁸⁸ Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 140; Raggi, “I regimi convenzionali. La separazione dei beni.” fq. 99.

⁷⁸⁹ Zaccaria, “La separazione dei beni.” fq. 332.

tekstin e dispozitës, ose sipas interpretimit të bërë “ut supra” mbi bazën e kontratës së porosisë (mandati).

Mandati i përfaqësimit mund të përfshihet në kontratën e martesës, ose të paraqitet më vete. Pavarësisht përfshirjes së mandatit të përfaqësimit në përmbajtjen e kontratës martesore, ato janë dy veprime juridike të veçanta, të cilat janë objekt i rregullimit nga regjime të ndryshme juridike. Le të shikojmë disa karakteristika të mandatit të përfaqësimit, nëpërmjet të cilit njëri bashkëshort autorizohet të administrojë pasurinë e bashkëshortit pronar.

1. *Mandati (prokura) i përgjithshëm apo i posaçëm.* Pjesa më e madhe e doktrinës, duke u referuar në tekstin e nenit 117 të kod.fam “... njëri bashkëshort i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij...”, përderisa ligji nuk bën specifikime, janë të mendimit që mandati i përfaqësimit është i përgjithshëm dhe për rrjedhojë ka për objekt administrimin e të gjithë pasurisë⁷⁹⁰.

Ndërsa të tjerë autorë janë të mendimit që, mandati mund të jetë i posaçëm, me objekt vetëm një pjesë të pasurisë së bashkëshortit ose vetëm disa veprime juridike të caktuara ose të ketë për objekt të gjithë pasurinë e tij⁷⁹¹.

2. *Objekti i mandatit: veprimet e administrimit të zakonshëm.* Pavarësisht nëse mandati ka karakter të përgjithshëm ose të posaçëm, ai nuk përfshin veprimet e administrimit jo të zakonshëm, por vetëm ato të administrimit të zakonshëm, më përjashtim të rastit kur në mandat është lejuar *shprehimisht* administrimi jo i zakonshëm. Në rast të kundërt, nëse mandati përmban vetëm një referim të përgjithshëm mbi autorizimin e administrimit të pasurisë, objekti është vetëm administrimi i zakonshëm, duke përjashtuar çdo veprim juridik të disponimit të pasurisë, për të cilat është, në çdo rast, e nevojshme një prokurë e posaçme.⁷⁹² Ky konkluzion gjen mbështetje në nenin 917/2 të kod.civ. sipas së cilit, porosia e përgjithshme nuk përfshin aktet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm, përveç rastit kur është parashikuar shprehimisht në kontratë.

3. *Forma e mandatit.* Forma në të cilën duhet realizuar mandati i përfaqësimit është një çështje që ka angazhuar gjerësisht doktrinën.

Problemi i përcaktimit të formës së mandatit të përfaqësimit, në heshtje të dispozitave të kod.fam, të cilat nga ana e tyre referojnë në dispozitat e përfaqësimit të kod.civ, lidhet ngushtësisht me problemin e natyrës juridike të përfaqësimit, si prokurë apo kontratë porosi (mandat).

Një pjesë e doktrinës është e mendimit që, në lidhje me formën e mandatit të përfaqësimit, do të gjejnë zbatim normat e kod.civ. mbi prokurën⁷⁹³, konkretisht neni 72 i kod.civ, i cili parashikon formën e shkruar, atë të shkresës së thjeshtë, me përjashtim të rasteve kur për efektet vlefshmërie kërkohet forma noteriale.

Nga ana tjetër, nëse autorizimi i përfaqësimit të pasurisë së bashkëshortit pronar, nga ana e bashkëshortit jopronar, realizohet mbi bazën e kontratës së porosisë, atëherë asnjë detyrim formal nuk parashikohet nga ligji. Porosia është kontratë jo formale, e cila i nënshtrohet parimit të lirisë së formës kontraktore.

4. *Kohëzgjatja e mandatit të përfaqësimit.* Në mungesë të parashikimeve të ligjit, duke referuar në dispozitat ligjore të përfaqësimit me prokurë dhe në ato të kontratës së porosisë, është

⁷⁹⁰ Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 640; Raggi, “I regimi convenzionali. La separazione dei beni.” fq. 98.

⁷⁹¹ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 636.

⁷⁹² Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 140.

⁷⁹³ Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 638.

pranuar unanimisht nga doktrina⁷⁹⁴ që mandati i përfaqësimit mund të jetë me afat të caktuar ose pa afat, në varësi të vullnetit të bashkëshortëve.

5. *Mandat i revokueshëm në çdo kohë.* Bazuar në nenin 68/2 i kod.fam. mandati i përfaqësimit, nëpërmjet të cilit bashkëshorti pronar, autorizon bashkëshortin tjetër në administrimin e pasurisë së tij, mund të revokohet në çdo kohë.

Është pranuar gjerësisht në doktrinë që, mandati i përfaqësimit është në çdo kohë i revokueshëm, në mënyrë të njëanshme nga bashkëshorti mandatdhënës, pavarësisht nga vullneti i bashkëshortit tjetër. Mandati i përfaqësimit është i revokueshëm në mënyrë të njëanshme edhe në rastin kur mandati është i përfshirë në kontratën e martesës, pa qenë i nevojshëm ndryshimi i kontratës⁷⁹⁵, sepse mandati dhe kontrata martesore janë dy veprime juridike të ndryshme, të cilat megjithëse në aspektin formal mund të pasqyrohen në një dokument të vetë, në aspektin substancial i nënshtrohen regjimeve juridike të ndryshme.

Neni 68/2 i kod.fam. është i pashmangshëm me marrëveshje të bashkëshortëve dhe për rrjedhojë do të jetë e pavlefshme çdo klauzolë e cila parashikon përvokueshmërinë e mandatit të përfaqësimit.

6. *Elementi i shpërblimit.* Diskutime në doktrinë ka gjithashtu lidhur me elementin e shpërblimit.

Nëse pranojmë që përfaqësimi i bashkëshortit pronar nga bashkëshorti tjetër, në administrimin e pasurisë, realizohet nëpërmjet prokurës, atëherë në çdo rast, përfaqësimi realizohet pa shpërblim, bazuar në dispozitat e kod.civ. mbi përfaqësimin me prokurë.

Nga ana tjetër, nëse mandatit të përfaqësimit i njohim karakterin e kontratës së porosisë, atëherë, arsyetimi duhet të mbështetet në dispozitat e kod.civ. të kontratës së porosisë. Bazuar në nenin 920 të kod.civ. porosia prezumohet se është me shpërblim, në mungesë të një vullneti të kundërt të palëve kontraktore.

Megjithatë, sipas doktrinës, në mungesë të parashikimeve të bashkëshortëve, mandati i përfaqësimit do të prezumohet se është pa shpërblim, sepse prezumohet që është shpirti i solidaritetit ai që shtyn njërin bashkëshort të kujdeset për administrimin e pasurisë së bashkëshortit tjetër⁷⁹⁶.

7. *Marrëdhëniet me të tretët.* Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve do të rregullohen nga rregullat e përgjithshme të kod.civ. mbi institutin e përfaqësimit. Bazuar në nenin 66 të kod. civ. veprimet juridike që janë kryer nga bashkëshorti administrues në lidhje me pasurinë e bashkëshortit pronar do të sjellin drejtpërdrejtë pasojat mbi këtë të fundit, nëse janë kryer brenda tagreve që përmban mandati i përfaqësimit.

8. *Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve.* Kod.fam. rregullon edhe pasojat që lindin ndërmjet bashkëshortëve, në lidhje me frytet që janë marrë gjatë administrimit.

Parimi i përgjithshëm, bazuar në paragrafin e dytë të nenit 117 të kod.fam, është që, në mungesë të parashikimeve të kundërta në prokurë, bashkëshorti përfaqësues nuk është i detyruar të kthejë frytet që përfitohen gjatë administrimit të pasurisë së bashkëshortit pronar.

Mbetet e paqartë arsyeja që ka shtyrë ligjvënësin në këtë parashikim. Nëse analizojmë në aspektin krahasues, dispozitën analoge të KC Francez (neni 1539) vërejmë që, ligjvënësi francez ka parashikuar të kundërtën, konkretisht detyrimin e bashkëshortit përfaqësues për t'i kthyer bashkëshortit pronar frytet e marra gjatë administrimit, me përjashtim të rastit kur në prokurë është parashikuar e kundërta.

⁷⁹⁴ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 636;

⁷⁹⁵ Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 142; Galasso dhe Tamburello, "Del regime patrimoniale della famiglia I." fq. 848; Zaccaria, "La separazione dei beni." fq. 326-327.

⁷⁹⁶ Sesta dhe Vagliani, "Il regime di separazione dei beni." fq. 643; Zaccaria, "La separazione dei beni." fq. 327.

Nëse në paragrafin e parë të nenit 117 të kod.fam. ligjvënësi shqiptar ka marrë si model nenin 1539 të Code Civil francez, mbetet e paqartë pse në paragrafin e dytë nuk ka ndjekur të njejtin shembull, por ka parashikuar të kundërtën.

Nëse i referohemi interpretimit të nenin 1539 të KC nga doktrina franceze⁷⁹⁷, kuptojmë që, “ratio” e normës, pra e parashikimit të detyrimit të kthimit të fryteve, përveç parashikimit të kundërt, qëndron në përdorimin e këtyre fryteve nga ana e bashkëshortit pronar për përballimin e detyrimit material ndaj familjes dhe më gjerë për përballimin e detyrimeve që rrjedhin nga martesë. Aq më tepër që, mbajtja e fryteve nga bashkëshorti përfaqësues do të ndryshonte karakterin pa shpërblim të mandatit të përfaqësimit.

B. Administrimi mbi bazën e “mandatit të heshtur”. Në hipotezën kur njëri nga bashkëshortët administron pasurinë e bashkëshortit pronar, me dijeninë e këtij të fundit, por pa pasur prej tij një kundërshtim të shprehur, atëherë konsiderohet nga ligji që bashkëshorti jopronar ka marrë një mandat të heshtur nga bashkëshorti pronar për administrimin e pasurisë së këtij të fundit.

Pëlqimi i bashkëshortit pronar, për të autorizuar bashkëshortin tjetër në administrimin e pasurisë së tij, mund të shprehet edhe në heshtje shoqëruar me mungesën e kundërshtimit.

Iniciativa e njërit bashkëshort në administrimin e pasurisë së bashkëshortit tjetër, shoqëruar me pasivitetin e këtij të fundit, është barazuar nga ligji me mandatin e përfaqësimit⁷⁹⁸.

1. Objekti i mandatit. Bazuar në nenin 118/1 të kod.fam. bashkëshorti administrues, mbi bazën e mandatit të heshtur të përfaqësimit ka të drejtë të kryejë vetëm veprime të administrimit të zakonshëm të pasurisë së bashkëshortit pronar, ndërsa e ka të ndaluar të kryejë veprime disponimi.

Jemi të mendimit që, ndalimi i mësipërm nuk shtrihet ngushtësisht vetëm në veprimet e disponimit të pasurisë (si psh: dhurim, shkëmbim, shitje, hua), por do të shtrihet edhe më gjerë në ato që doktrina njih me termin veprime juridike që kalojnë kufirin e një administrimi të zakonshëm “veprimet e administrimit jo të zakonshëm”, si psh: vendosja e hipotekës marrja hua në emër të njërit bashkëshort, padia e rivendikimit etj.

Në dallim nga neni 117, në nenin 118 ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht përjashtimin e veprimeve të disponimit nga objekti i mandatit të heshtur të përfaqësimit.

2. Marrëdhëniet me të tretët. Në raport me të tretët, veprimet juridike të kryera nga bashkëshorti jopronar mbi pasurinë e bashkëshortit pronar do të sjellin pasoja për këtë të fundit, sepse mungesa e kundërshtimit nga ana e tij, prezumon dhënien e pëlqimit. Ky rregull është i vlefshëm vetëm për veprimet e administrimit të zakonshëm, ndërsa veprimet juridike të disponimit, të kryera nga bashkëshorti jopronar mbi pasurinë e bashkëshortit pronar, nuk do të sjellin pasoja për këtë të fundit, me përjashtim të rastit kur ai e ka miratuar më vonë veprimin. Jemi të mendimit që, në këtë rast, për të zgjidhur marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe të tertëve do të gjeje zbatim instituti i përfaqësimit pa tagra, i rregulluar nga neni 86 i kod.civ, sipas së cilit, veprimi i kryer në kapërcim të tagrave është i pavlefshëm, por personit të tretë, që ka qenë në mirëbesim, i lind e drejta të kërkojë shpërblimin e dëmit nga bashkëshorti përfaqësues.

3. Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve. Bazuar në paragrafin e dytë të nenit 118 të kod.fam, bashkëshorti administrues është i detyruar t’i kthejë bashkëshortit tjetër, vetëm frytet që ekzistojnë dhe jo ato që janë konsumuar.

⁷⁹⁷ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 636.

⁷⁹⁸ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 428.

Me fryte të konsumuara do të kuptojmë ato fryte natyrore apo civile, që nuk kanë më një ekzistencë materiale, ose frutet që ekzistojnë por janë disponuar, nëse në këtë rast të fundit nuk ekziston çmimi i tyre në posedim të bashkëshortit administrues⁷⁹⁹.

Gjithashtu, në mungesë të parashikimeve të ligjit (neni 118/2 i referohet në mënyrë të përgjithshme “frytet që janë konsumua”), nuk ka asnjë rëndësi se cili ka qenë qëllimi i konsumimit të fryteve nga bashkëshorti administrues. Cilido të ketë qenë qëllimi i përdorimit të tyre, interesat e familjes apo interesat vetjakë të bashkëshortit administrues, bashkëshorti pronar nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e tyre.

5.6.2.2. Administrimi në mungesë të një mandati

Administrimi i pasurisë së njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër, gjatë regjimit të pasurive të ndara, mund të realizohet edhe në mungesë të një mandati. Përveç rastit të administrimit të realizuar në kundërshtim me vullnetin e bashkëshortit pronar, doktrina ka identifikuar edhe ratin e administrimit të realizuar pa dijeninë e bashkëshortit pronar dhe në mungesë të kundërshtimit të këtij të fundit.

A. Administrimi në kundërshtim me vullnetin e bashkëshortit pronar. Paragrafi i tretë, i nenit 118 të kod.fam. parashikon hipotezën, në të cilën gjatë kohëzgjatjes së martesës bashkëshorti jopronar administron pasurinë e bashkëshortit tjetër, megjithë kundërshtimet e këtij të fundit.

Ligji jo vetëm që nuk e toleron një situatë të tillë, por madje parashikon sanksione ndaj atij bashkëshorti që cenon parimin e autonomisë që, ligji i ka dhënë secilit bashkëshort, në gëzimin dhe administrimin e lirë të pasurisë së tyre⁸⁰⁰.

Në lidhje me formën, në të cilën duhet të shprehet kundërshtimi i bashkëshortit pronar, doktrina është e mendimit që, kundërshtimi mund të shprehet në çdo formë, në mënyrë verbale apo të shkruar madje edhe nëpërmjet veprimeve konkludente (per facta concludentia), si dhe mund të provohet me çdo mjet prove⁸⁰¹.

Veprimi juridik i kryer në kundërshtim me vullnetin e bashkëshortit pronar është absolutisht i pavlefshëm. Bashkëshorti pronar ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit.

Bazuar në nenin 118/3 të kod.fam. bashkëshorti jopronar është i detyruar t'i shpërblejë bashkëshortit pronar dëmin e shkaktuar si dhe t'i kthejë frytet që duhet të ishin marrë.

Nga formulimi i nenit 118/3 të kod.fam. mund të nxjerrim dy konkluzione të rëndësishme:

Së pari, marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve do të rregullohen mbi bazën e institutit të dëmit jashtëkontraktor të rregulluar nga dispozitat e kod.civ, sipas së cilit bashkëshorti që ka administruar pasurinë e bashkëshortit të tij pa pëlqimin e këtij të fundit, është i detyruar t'i atij shpërblejë dëmin e shkaktuar, i cili përbëhet nga dëmi real dhe fitimi i munguar.

Së dyti, formulimi i nenit 118/3, mbart disa pasaktësi, sepse dispozita i referohet shprehimisht “fryteve që duhej të ishin marrë”, duke mos përmendur frytet që janë konsumuar. Megjithatë, pavarësisht pasaktësisë së normës, bashkëshorti administrues duhet t'i kthejë bashkëshortit pronar edhe frytet që janë konsumuar, të cilat fare mirë mund t'i përfshijmë në kategorinë e “dëmit real”.

⁷⁹⁹ Zaccaria, “La separazione dei beni.” fq. 328.

⁸⁰⁰ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 637.

⁸⁰¹ Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 644; Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 145.

Në përfundim duhet të pohojmë që, bashkëshorti jopronar është i detyruar të përgjigjet për të gjitha frytet që janë marrë apo duhej të ishin marrë, pavarësisht nëse janë konsumuar ose jo⁸⁰².

B. Administrimi në mungesë të një mandati dhe pa dijeninë e bashkëshortit pronar. Në mungesë të parashikimit nga ligjvënësi, doktrina⁸⁰³ ka identifikuar edhe një hipotezë të katërt, e cila verifikohet në rastet kur njëri bashkëshort administron pasurinë e bashkëshortit tjetër, pa pasur një mandat përfaqësimi (shprehur/heshtur) si dhe pa dijeninë e këtij të fundit, e për rrjedhojë pa kundërshtimin e tij.

Kjo hipotezë mund të verifikohet shpesh në praktikë, ku për shkak të shpirtit të solidaritetit, njëri bashkëshort mund të kujdeset për interesat e bashkëshortit tjetër pa pasur një detyrim ligjor.

Në mungesë të parashikimeve të kod.fam. shtrohet problemi i përcaktimit të disiplinës ligjore që do të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve, në këtë hipotezë të fundit.

Bazuar në mendimin dominant të doktrinës⁸⁰⁴, marrëdhëniet ndërmjet palëve do të rregullohen mbi bazën e institutit të “**gjerimit të punëve të tjetrit**” të rregulluar në nenet 648-652 të kod.civ.

Mbi bazën e institutit të gjerimit të punëve të tjetrit, veprimet që kryen bashkëshorti gjerues do të sjellin pasoja për bashkëshortin pronar, më përjashtim të rastit kur ai ka kundërshtuar veprimin paraprakisht (neni 649 kod.civ.).

Gjithashtu, bazuar në nenin 651/1 të kod.civ. sipas së cilit gjeruesi u nënshtrohet të njejtave detyrime që rrjedhin nga një kontratë porosie, bashkëshorti gjerues është përgjegjës për t’i kthyer bashkëshortit pronar të gjitha frytet që ekzistojnë dhe që janë konsumuar⁸⁰⁵.

5.7. Avantazhet dhe disavantazhet e regjimit të pasurive të ndara

Regjimi i pasurive të ndara është cilësuar si regjimi pasuror më i përshtatshëm për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtresave ekonomikisht të mesme dhe të larta të shoqërisë, të cilat kanë pasuri të konsiderueshme, sepse ky regjim përmban një rregullim më elastik (fleksibël) të marrëdhënieve pasurore⁸⁰⁶.

Nisur nga fakti që në Shqipëri jemi vetëm në fillimet e zbatimit, në praktikë, të institutit të kontratës martesore dhe në mungesë të statistikave mbi numrin e tyre, le t’i hedhim një vështrim të shkurtër trendeve të regjimit të pasurive të ndara, në Itali dhe Francë.

Që nga reforma, e institutit të regjimeve pasurore martesore, në Itali e vitit 1975, e cila si solli si risi ndryshimin e regjimit ligjor, nga regjimi i pasurive të ndara, që ekzistonte në KC të vitit 1945, në regjimin e bashkësisë, duke e konsideruar këtë të fundit si regjimin më të përshtatshëm për të garantuar barazinë ekonomike dhe morale të bashkëshortëve në familje, statistikat tregojë, që, që nga viti 1975 dhe deri në ditët tona, numri i bashkëshortëve që preferojnë të shmangin

⁸⁰² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 354; Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 644.

⁸⁰³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 354; Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 645; Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 146-152.

⁸⁰⁴ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 354; Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 152.

⁸⁰⁵ Nga ana tjetër, një pjesë e pakët autorësh janë të mendimit që, në këtë hipotezë nuk do të gjejë zbatim disiplina ligjore e gjerimit të punëve, por do të zbatohet disiplina e “mandatit të heshtur” të parashikuar në paragrafin e parë të nenin 118 të kod.fam., sepse argumentojnë ata, pasja dijeni për veprimet e administrimit shoqëruar me mungesën e kundërshtimit të bashkëshortit pronar përfaqëon një veprim “sjellje” konkludente nga e cila rrjedh dhënia e mandatit të heshtur të përfaqësimit. Për këtë shih: Zaccaria, “La separazione dei beni.” fq. 329.

⁸⁰⁶ Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 565.

regjimin ligjor të bashkësisë drejt regjimit kontraktor të pasurive të ndara ka ardhur gjithmonë e në rritje⁸⁰⁷.

Studimet sociale në Itali tregojnë që, ka një përpjesëtim të drejtë ndërmjet rritjes së numrit të zgjidhjeve të martesës me rritjen e numrit të bashkëshortëve që zgjedhin regjimin e pasurive të ndara. Në ato rajone të Italisë ku numri i zgjidhjeve të martesave është i lartë, edhe numri i kontratave martesore të regjimit të pasurive të ndara është po ashtu i lartë. Interpretimi që studiuesit i kanë dhënë këtyre statistikave, është që, regjimi i pasurive të ndara, shihet nga bashkëshortët, si regjimi më i përshtatshëm në eventualitetin e një krize bashkëshortore dhe një zgjidhje eventuale martesë, sepse paraqitet më i thjeshtë në fazën e likuidimit dhe pjesëtimit në raport me regjimin ligjor të bashkësisë, që paraqitet më i ndërlikuar në fazën e mbarimit⁸⁰⁸.

Pikërisht, një nga avantazhet që paraqet regjimi i pasurive të ndara, në raport me regjimin e bashkësisë ligjore, është thjeshtësia e likuidimit të regjimit, në fazën e zgjidhjes së martesës. Nëse likuidimi i bashkësisë ligjore, në fazën e zgjidhjes së martesës, paraqitet mjaft kompleks dhe në shumë raste konfliktet gjyqësore të palëve, lidhur me pretendimet pasurore dhe pjesëtimit të bashkësisë, zgjasin edhe vite⁸⁰⁹, regjimi i pasurive të ndara thjeshtëson fazën e pjesëtimit të pasurisë.

Statistikat në Francë tregojnë për një situatë analoge me atë në Itali. Sipas tyre, këto 30 vitet e fundit, që nga reforma e regjimeve pasurore e vitit 1965 dhe 1985, që vendosi edhe në Francë zëvendësimin e regjimit ligjor të pjesëmarrjes në fitime me regjimin ligjor të bashkësisë është rritur nga viti në vit numri i bashkëshortëve që preferojnë regjimin e pasurive të ndara.

Bazuar në interpretimin e këtyre statistikave, doktrina franceze ka arritur në përfundimin, që tre janë motivet kryesore që shtyjnë bashkëshortët drejt shmangies nga regjimi ligjor i bashkësisë, drejt atij të pasurive të ndara⁸¹⁰:

a) *Motivi psikologjik*. Regjimi i pasurive të ndara është më i preferuar në rastin e bashkëshortëve që duan të jenë më të pavarura ekonomikisht nga bashkëshorti i tyre, siç shprehet doktrina është më i preferuar nga feministët, megjithëse gjejmë vend këtu të kujtojmë që, ishin pikërisht lëvizjet feministë që kërkonin një mbrojtje më të madhe të kontributit të gruas në familje, që çuan në reformimin e regjimeve pasurore në këto dy shtete dhe më gjerë në Europë, drejt zëvendësimit të regjimit ligjor të pasurive të ndara me regjimin e bashkësisë.

b) *Motivi familjar*. Statistikat tregojnë që, regjimi i pasurive të ndara ndeshet më shumë në rastet e bashkëshortëve që lidhin martesën e dytë apo më shumë, veçanërisht nëse kanë fëmijë nga martesë e parë, në raport me bashkëshortët që lidhin martesën e parë. Kjo ndodh për arsye të ruajtjes dhe të mospërzierjes së pasurisë familjare me atë të bashkëshortit tjetër.

c) *Motivi profesional*. Regjimi i pasurive të ndara është më i përhapur dhe gjithashtu më i këshillueshëm në rastet kur njëri prej bashkëshortëve ushtron një veprimtari tregtare, që mbart risk financiar të lartë. Në këtë hipotezë, ky regjim është më i përshtatshmi për të mbrojtur pasurinë e bashkëshortit tjetër, nga kreditorët e bashkëshortit tregtar, në rast të një falimentimi të mundshëm të tij. Ky është një tjetër avantazh që paraqet regjimi i pasurive të ndara në raport me atë të bashkësisë.

Nga ana tjetër rritja gjithmonë e më e madhe e numrit të bashkëshortëve që zgjedhin regjimin e pasurive të ndara, dikton një mbrojtje më të madhe të familjes dhe një rregullim më të mirë të regjimit primar.

⁸⁰⁷Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 9-12.

⁸⁰⁸Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 10-11.

⁸⁰⁹Sesta dhe Valignani "Il regime di separazione dei beni." fq. 565.

⁸¹⁰Statistikat në lidhje me Fracën janë marrë nga: Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 12-13.

Përgjithësisht doktrina është e mendimit që, avantazhet e regjimit të pasurive të ndara janë: a) pavarësia pasurore që regjimi u garanton bashkëshortëve gjatë martesës si dhe b) thjeshtësia e regjimit në fazën e likuidimit të pasurisë. Megjithatë, thjeshtësia në parim nuk i përgjigjet gjithmonë realitetit, pasi faza e likuidimit mund të paraqitet e ndërlikuar në rastet kur sendet e bashkëshortëve janë përzier dhe bashkuar njëri me tjetrin gjatë martesës⁸¹¹.

5.8. Prova e pronësisë së pasurisë së luajtshme

5.8.1. Konsiderata të përgjithshme

Megjithëse gjatë regjimit të pasurive të ndara vepron parimi i pavarësisë së aktivitetit dhe pasivitetit të pasurisë së bashkëshortëve, për shkak të jetesës së përbashkët dhe solidaritetit në familje, mund të ndodhë që pasuria e bashkëshortëve të konfondohej, duke bërë të vështirë përcaktimin e titullarit të pronësisë.

Për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar disa prezumime ligjore, si në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve ashtu dhe në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve të tyre.

Prezumimet e pronësisë në regjimin e pasurive të ndara, të rregulluara nga neni 119 i kod.fam. paraqiten më të ndërlikuara në raport me prezumimin e sendeve vetjake në regjimin e bashkësisë ligjore⁸¹².

Zakonisht, në praktikë problemi i përcaktimit të bashkëshortit pronar të sendeve të luajtshme, në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve shtrohet në momentin e përfundimit të martesës, ndërsa në raport me kreditorët, problemi shtrohet gjatë martesës, kur detyrimi është bërë i kërkueshëm, sepse kreditorët mund të ndjekin vetëm pasurinë vetjake të bashkëshortit debitor, pa pasur asnjë të drejtë mbi pasurinë e bashkëshortit tjetër.

Neni 119 i kod.fam. parashikon tre prezumime ligjore, të cilët shfaqin disa karakteristika të përbashkëta⁸¹³.

Së pari, prezumimet e parashikuara në nenin 119 të kod.fam. vlejnë vetëm për sendet e luajtshme, ndërkohë që nuk mund të zbatohen në asnjë rast për sendet e paluajtshme, pronësia e të cilave do të përcaktohet, në çdo rast, mbi bazën e titullit të fitimit të pronësisë.

Së dyti, terminologjia e përdorur nga ligjvënësi nuk është plotësisht e saktë. Në të tre paragrafët e nenit 119 ligjvënësi ka përdorur termin **“pasuri të luajtshme”** dhe jo termin **“sende të luajtshme”**.

Duke qenë se termat “pasuri” dhe “sende” nuk janë sinonime të njëri-tjetrit, por termi “pasuri” mbart një kuptim më të gjerë në raport me termin “send”, gjykojmë që, ligjvënësi duhej të kishte përdorur termin send.

Në radhë të parë termi **“pasuri e luajtshme”** nuk ka kuptim, sepse në përbërje të pasurisë, përveç së drejtës së pronësisë mbi sendet përfshihen edhe të drejtat e tjera reale, të drejtat e kreditit (aktivi i pasurisë) si dhe detyrimet e bashkëshortëve ndaj të tretëve (pasivi i pasurisë)⁸¹⁴. Përbën nonsens juridik të flasim për të drejta reale të luajtshme apo të drejta krediti të luajtshme.

Për më tepër, nëse analizojmë në planin krahasues dispozitat që rregullojnë provën e pronësisë në regjimin e pasurive të ndara të KC Francez (art. 1538), KC Italian (art. 219) dhe BGB (art.

⁸¹¹ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 605.

⁸¹² Sipas nenit 105 të kod.fam. në mungesë të provave të kundërta, prezumohet që pasuria e luajtshme bën pjesë në bashkësi.

⁸¹³ Për më shumë, rreth karakteristikave të prezumimeve ligjore, shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 614.

⁸¹⁴ Për më shumë, mbi kuptimin e termit pasuri, bashkëpronësi ndërmjet bashkëshortëve dhe bashkësi shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 93.

1362), në modelin e të cilëve është hartuar neni 119 i kod.fam, vëmë re që, në të gjitha këto dispozita është përdorur termi “*send*” dhe jo termi “*pasuri*”.

Madje nëse shikojmë më konkretisht nenin 1362/1 të BGB, i cili ka shërbyer si model për hartimin e nenit 119 të kod.fam., vëmë re që, parashikon shprehimisht që rregulli i prezumimit do të zbatohet edhe ndaj “*titujve ndaj prurësit*”, të cilat barazohen me sendet e luajtshme.

Nga analiza *ut supra*, nxjerrim konkluzionin që, rregullat e prezumimit të parashikuara nga neni 119 i kod.fam. janë të vlefshme vetëm për sendet e luajtshme, ndërkohë që nuk mund t’i zbatohen të drejtave të tjera reale dhe tyre të kreditit, që janë në pronësi të bashkëshortëve.

Së *treti*, bazuar në analizën e krahasuar të kod.fam. me modelet ligjore, mbi bazën e të cilëve është hartuar kod.fam. rezulton që, ndërsa për rregullimin e të gjitha elementëve të regjimit të pasurive të ndara është marrë për bazë KC Francez dhe ai Italian, për rregullimin e prezumimeve të pronësisë është marrë si model neni 1362 i BGB Gjerman. Është e paqartë arsyeja që ka shtyrë ligjvënësin në marrjen e modeleve të dy legjislacioneve të ndryshme për rregullimin e të njëjtit institut. Megjithatë, siç do të shikojmë pak më poshtë, modeli gjerman nuk është ndjekur deri në fund dhe ka disa ndryshime të vogla, por të rëndësishme lidhur me fushën personale të zbatimit të prezumimeve, ndërmjet dy legjislacioneve.

Së *katërti*, megjithëse kjo nuk del qartë nga teksti i nenit 119, prezumimet e parashikuara nga neni 119 i kod.fam. janë prezumime relative, që do të thotë që bashkëshorti, i cili pretendon pronësinë e një sendi të caktuar ka të drejtë ta provojë atë me çdo mjet prove⁸¹⁵.

Në çdo rast, barra e provës do të bie mbi bashkëshortin që pretendon pronësinë mbi një send të caktuar. Pronësia mund të provohet me çdo mjet prove, si në lidhje me bashkëshortin tjetër ashtu dhe në lidhje me të tretët⁸¹⁶.

Le të analizojmë disa mjete të provës që shërbejnë për të provuar pretendimeve e pronësisë mbi sendet e luajtshme:

1. Titulli i pronësisë, është mjete më i mirë për të provuar pronësisë mbi sendet, por në pjesën më të madhe të rasteve, në praktikë është e vështirë të gjenden dokumente që të provojnë pronësinë mbi sendet e luajtshme, me përjashtim të rasteve kur, këto i nënshtrohen regjimit të regjistrimit si psh: autovetura.

Mund të shërbejë si titull për të provuar pronësinë e sendeve të luajtshme, listimi i tyre në kontratën e martesës, për sendet që bashkëshortët kanë pasur në pronësi në momentin e lidhjes së kontratës.

Nëse pronësia e sendeve është fituar me trashëgimi apo dhurim, atëherë titulli i pronësisë do të gjendet në kontratën e dhurimit, testamentin, inventarin e pasurisë trashëgimore apo në aktin e pjesëtimit të pasurisë⁸¹⁷.

Për sendet e luajtshme, që fitohen nëpërmjet veprimeve juridike me kundërshpërblim, pronësia është më e lehtë për tu provuar nëse është ruajtur “*fatura*”. Megjithatë, nëse i referohemi jurisprudencës së Court de Cassation⁸¹⁸ franceze, ajo nuk i ka njohur faturës vlerën e një titulli pronësie, por vetëm vlerën e një prezumimi pronësie, sepse argumenton gjykata qëndrimin e saj, fatura është lehtësisht e falsifikueshme dhe nuk mbart në përmbajtjen e saj identitetin e personit në emër të të cilit është lëshuar.

⁸¹⁵ Mundësinë e të provuarit të pronësisë së sendeve të luajtshme me çdo mjet prove e gjejmë të parashikuar shprehimisht në dispozitat analoge të KC Francez (art. 1538) dhe KC Italian (art. 219).

⁸¹⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 614.

⁸¹⁷ Savatier, *La séparation de biens en droit français*, fq. 70.

⁸¹⁸ Court de Cassation, Chambre Civile Ire, Mars 1993. Marrë nga: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 615.

2. **Posedimi**, përbën mjetin më normal të të provuarit të pronësisë mbi sendet e luajtshme, në mungesë të titullit të pronësisë⁸¹⁹. Sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës civile, prezumohet pronari i sendit të luajtshëm, personi (bashkëshorti) që e posedon atë. Megjithatë për shkak të jetesës së përbashkët dhe solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve, përcaktimi i titullarit të pronësisë së sendeve mbi bazën e rregullit të posedimit nuk është gjithmonë e thjeshtë. Le të mendojmë, për shembull hipotezën, kur njëri bashkëshort posedon sendet e bashkëshortit tjetër mbi bazën e prokurës ose kontratës së huasë, ose hipotezën, në të cilën bashkëshortja gjatë martesës përdor vazhdimisht bizhuteritë që janë në pronësi të bashkëshortit⁸²⁰. Probleme, gjithashtu, në provën e pronësisë paraqesin edhe sendet e mobilimit të banesës familjare. Në pamundësi për të provuar pronësinë mbi sendet e luajtshme, nëpërmjet çdo mjeti prove, atëherë do të zbatohen prezumimet e parashikuara në nenin 119 të kod.fam. të cilat mund të klasifikohen në dy grupe: a) prezumime në marrëdhëniet me kreditorët, b) prezumime në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve.

5.8.2. *Prezumimet ligjore të pronësisë*

Pas konsideratave të përgjithshme mbi prezumimet e pronësisë së sendeve të luajtshme, të parashikuara nga neni 119 i kod.fam., do të ndalemi konkretisht në analizën e secilit prej prezumimeve të parashikuara nga kjo dispozitë, me një fokus të veçantë në objektin personal të zbatimit të tyre.

A. Paragrafi i parë i nenit 119 të kod.fam: *“Pasuria e luajtshme që posedohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga të dy bashkëshortët prezumohet, në lidhje me kreditorët e secilit prej tyre, se i përket bashkëshortit debitor. Ky prezumim nuk është i vlefshëm në rast të ndërprerjes së jetës së përbashkët.”*

Prezumimi i pronësisë, i parashikuar në paragrafin e parë të nenit 119 të kod.fam, është i vlefshëm në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve dhe nuk mund të gjejë zbatim në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve.

Rregulli i përgjithshëm është që, sendet e luajtshme të cilat gjatë martesës posedohen nga të dy bashkëshortët apo nga njëri prej tyre, në raport me kreditorët e bashkëshortëve, prezumohen që janë në pronësi të bashkëshortit debitor.

Ky prezumim ka për qëllim mbrojtjen e kreditorëve nga veprimet fiktive të bashkëshortëve, të cilët me qëllim shmangien nga përbushja e detyrimeve ndaj kreditorëve të tyre, në mungesë të këtij prezumimi, do e kishin mjaft të lehtë kalimin e pronësisë së sendeve të luajtshme nga bashkëshorti debitor tek bashkëshorti tjetër.

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, ky prezumim nuk do të gjejë zbatim, në rastin kur bashkëshortët kanë ndërprerë jetën e përbashkët.

Nëse do të shikojmë dispozitën analoge në BGB (fjalja e dytë e nenit 1362/1) evidentojmë që, përjashtimi nga rregulli i prezumimit të pronësisë në favor të bashkëshortit debitor është formuluar në mënyrë më të plotë në raport me me fjalinë e dytë të paragrafët të parë të nenit 119 të kod.fam. Konkretisht neni 1362/1, fjalja e dytë, parashikon që: *“Ky prezumim nuk zbatohet nëse bashkëshortët jetojnë të ndarë dhe sendet ndodhen në posedim të bashkëshortit jo debitor”*.

Nuk është e kuptueshme pse ligjvënësi shqiptar në procesin e përshtatjes së normës me atë të BGB, ka lënë jashtë tekstit të saj togfjalëshin *“dhe sendet ndodhen në posedim të bashkëshortit debitor”*.

⁸¹⁹ Savatier, *La séparation de biens en droit français*, fq. 70.

⁸²⁰ Savatier, *La séparation de biens en droit français*, fq. 71-72.

B. Paragrafi i dytë i nenit 119 të kod.fam.: “Pasuria e luajtshme që posedohet nga të dy bashkëshortët, prezumohet në lidhje me njëri tjetrin që i përket të dy bashkëshortëve në pjesë të barabarta.”

Ky prezumim i bashkëpronësisë së sendeve të luajtshme, që gjatë martesës posedohen nga të dy bashkëshortët, do të gjejë zbatim vetëm në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe në asnjë rast në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve të tyre.

Në praktikë, zakonisht janë sende që posedohen nga të dy bashkëshortët, sendet e mobilimit të banesës familjare.

C. Paragrafi i tretë i nenit 119: “Pasuria e luajtshme, e përcaktuar për përdorim vetjak nga njëri prej bashkëshortëve, prezumohet se i përket këtij të fundit”.

Në tekstin e dispozitës së mësipërme nuk del qartë se cilëve subjekte i drejtohet zbatimi i saj.

Në heshtje të ligjit, jemi të mendimit që duhet të interpretojmë dispozitën në mënyrë të tillë që të zgjerojmë objektin personal të zbatimit të saj. Në bazë të interpretimit të zgjeruar do të pranojmë që, prezumimi i mësipërm do të gjejë zbatim si në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve ashtu dhe në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve të secilit prej tyre. Përderisa teksti i normës nuk bën dallime, aq më pak duhet të bëje interpretuesi i saj.

Në arritjen e këtij përfundimi, bazohemi në dispozitën respektive të BGB, neni 1362/2, e cila parashikon shprehimisht që ky prezumim zbatohet njëkohësisht në marrëdhëniet e bashkëshortëve me njëri-tjetrin dhe në marrëdhëniet e tyre me kreditorët.

5.8.3. Shmangia e prezumimeve të pronësisë

Në analizë të fundit, nuk mund të mos marrim në shqyrtim problemin e hapësirës së shtrirjes së autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në drejtim të modifikimit të prezumimeve të pronësisë së parashikuar nga neni 119 i kod.fam.

Bashkëshortët mund të parashikojnë që, në përfundim të martesës, bizhuteritë të kalojnë në pronësi të bashkëshortes, ndërsa kasetat e sigurisë ose depozitat bankare në pronësi të bashkëshortit, ose që sendet e mobilimit të banesës familjare të jenë në pronësi të bashkëshortit pronar.

Në KC Francez, neni 1538⁸²¹, lejohet shprehimisht që bashkëshortët të parashikojnë në kontratën martesore klauzola që modifikojnë prezumimet e pronësisë, duke parashikuara të tjera të ndryshme nga ato ligjore, apo të përjashtojnë tërësisht zbatimin e tyre, madje këto klauzola janë të vlefshme jo vetëm ndërmjet bashkëshortëve, por i kundërdrejtohen edhe të tretëve.

Një autor francez mban qëndrimin që, në rastin kur prezumimet kontraktore favorizojnë njërin bashkëshort në raport me bashkëshortin tjetër, jemi përpara dhurimit indirekt që bashkëshort i bëjnë njëri-tjetrit në kontratën martesore⁸²².

Ndërsa, në nenin 219 të Codice Civile, nuk gjejmë asnjë rregullim në drejtim të mundësisë së bashkëshortëve për të modifikuar apo për të përjashtuar zbatimin e prezumimeve të pronësisë së sendeve të luajtshme.

Në heshtje të ligjit, pjesa më e madhe e doktrinës italiane⁸²³ është shprehur në favor të mundësisë së bashkëshortëve për të modifikuar prezumimet ligjore, duke argumentuar që, përderisa ligji

⁸²¹ Teksti i nenit 1538/2 i Code Civil: “Les présomptions de propriété énoncées au contrat de mariage ont effet à l’égard de tiers aussi bien que dans les rapports entre époux, s’il n’en a été autrement convenu”.

⁸²² Savatier, *La séparation de biens en droit français*, fq.17.

⁸²³ Në mbështetje të këtij qëndrimi shih: Oberto, “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” fq. 324-325; Cattaneo, “Del regime di separazione dei beni.” fq. 488. Ndërsa janë kundër: Sesta dhe Vagliani, “Il regime di separazione dei beni.” fq. 631.

nuk e ndalon shprehimisht, atëherë është e lejuar. Në rastet kur ligjvënësi ka dashur të ndalojë shprehimisht të drejtën e bashkëshortëve për të modifikuar dispozitat e regjimit pasuror martesor, vazhdojnë arsyetimin e tyre këta autorë, është treguar i kujdesshëm që ta parashikojë shprehimisht një ndalim të tillë.

Ndërsa një pjesë tjetër e autorëve, ndonëse të paktë në numër, kanë mbajtur qëndrim të kundërt, duke argumentuar që modifikimi i prezumimeve të pronësisë, do të shkelte parimin e barazisë së bashkëshortëve.

Jemi të mendimit që, përderisa ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë ndalim të shprehur, rregullat e prezumimit të pronësisë së sendeve të luajtshme, të parashikuara në nenin 119 do t'i nënshtrohen modifikimit sipas vullnetit të bashkëshortëve, përveç prezumimeve në marrëdhënie me kreditorët, të cilat, në gjykimin tonë, janë të pashmangshme.

5.9. Mbarimi i regjimit të pasurive të ndara

5.9.1. Hipotezat e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara

Në mungesë të rregullimit të shprehur nga kod.fam. do të përpiqemi të përcaktojmë rastet e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara.

Problemi i parë që shtrohet për zgjidhje është nëse do të gjejnë zbatim rastet e mbarimit të bashkësisë të parashikuara në neni 96 i kod.fam edhe për mbarimin e regjimit të pasurive të ndara.

Në parantezë, duhet pohuar që, regjimi i pasurive të ndara dhe në përgjithësi të gjitha regjimet pasurore martesore, nuk mund t'i mbijetojnë përfundimit të martesës, për rrjedhojë të gjitha hipotezat e përfundimit të martesës do të sjellin njëkohësisht mbarimin e regjimit të pasurive të ndara.

Paragrafi i parë i nenit 96, përcakton të gjitha ato raste, me përjashtim të shpalljes së zhdukjes së njërit prej bashkëshortëve, kur regjimi i bashkësisë mbaron për shkak të mbarimit të martesës. Pa asnjë dyshim, neni 96/a do të gjejë zbatim edhe në rastin e regjimit të pasurive të ndara, me përjashtim të hipotezës së shpalljes së zhdukjes së njërit bashkëshort, hipotezë e cila meriton të merret në analizë më vete. Regjimi i pasurive të ndara mbaron me vdekjen ose shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort, me shpalljen e pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës. Në mënyrë indirekte këto raste të mbarimit të regjimit të pasurive të ndara, janë parashikuar edhe në nenet 120 dhe 121 të kod.fam.

Paragrafi i dytë i nenit 96 të kod.fam, i referohet mbarimit të regjimit të bashkësisë për shkak të pjesëtimit gjyqësor të sendeve, me pasojë vendosjen e bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara. Hipoteza e parashikuar nga neni 96/b është karakteristikë vetëm e regjimeve të bashkësisë ligjore/kontraktore dhe për rrjedhojë nuk do të gjejë zbatim në regjimin e pasurive të ndara.

Paragrafi i tretë i nenit 96 të kod.fam, parashikon ndryshimin e regjimit të bashkësisë, për shkak të vullnetit të bashkëshortëve, nëpërmjet parashikimit të një regjimi të ri kontraktor. Neni 96/c i kod.fam. do të gjejë zbatim në regjimin e pasurive të ndara dhe për rrjedhojë mund të pohojmë që, regjimi i pasurive të ndara do të përfundojë, nëse bashkëshortët kanë përcaktuar në kontratën e martesës zbatimin e regjimit të bashkësisë ligjore apo të një bashkësie me kontratë.

Le t'i rikthehemi hipotezës së **shpalljes së zhdukjes së njërit bashkëshort**, të parashikuar në nenin 96/a të kod.fam, hipotezë e cila sjell mbarimin e regjimit të bashkësisë. Jemi të mendimit që, shpallja e zhdukjes së njërit bashkëshort nuk do të sjellë mbarimin e regjimit të pasurive të ndara, sepse nëse do të pranohet zgjidhjen e kundërt do të arrinim në rezultatin që, automatikisht me mbarimin e regjimit të pasurive të ndara, për shkak të shpalljes së zhdukjes së njërit bashkëshort, do të vendosej regjimi i bashkësisë ligjore, përfundim i cili bie në kundërshtim me

vetë *ratio-n* e nenit 96/a, nen i cili parashikon mbarimin e regjimit të bashkësisë pikërisht për shkak të mungesës së kontributit të përbashkët në fitimin e pasurisë. Një argument më shumë në mbështetje të këtij qëndrimi është që, gjatë këtij punimi kemi pranuar zbatimin *ipso jure* të regjimit të pasurive të ndara, në hipotezën kur njëri prej bashkëshortëve, të martuar në regjimin e pasurive të ndara, shpallet i zhdukur me vendim gjykate, pavarësisht heshtjes së ligjit⁸²⁴.

Në analizë të fundit, jemi të mendimit që, neni 96 i kod.fam. i cili parashikon rastet e mbarimit të regjimit të bashkësisë, do të gjejë zbatim edhe në regjimin e pasurive të ndara, për aq sa është në përputhje me të.

Një tjetër problem, mjaft i diskutueshëm në doktrinë është problemi i mundësisë së bashkëshortëve për të përcaktuar me vullnetin e tyre mbarimin e regjimit të pasurive të ndara, nëpërmjet parashikimit në kontratën e martesës të një kushti apo afati zgjidhës, me verifikimin e të cilëve përfundon regjimi i bashkësisë.

Megjithëse doktrina është e ndarë, ndërmjet atyre autorëve që janë në favor⁸²⁵ të mundësisë së bashkëshortëve për të vendosur në kontratë afate apo kushte zgjedhëse dhe atyre që janë kundër⁸²⁶, gjejmë vendin të ripohojmë edhe një herë qëndrimin tonë në favor të klauzolave kontraktore që parashikojnë afate/kushte zgjidhëse, me kushtin e vetëm që, këto klauzola të mos parashikojnë vazhdimin e zbatimit të regjimit pasuror pas mbarimit të martesës⁸²⁷.

Në përmbledhje të diskutimeve të mësipërme, rastet e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara klasifikohen në dy grupe:

A. Mbarimi ligjor. Bazuar në nenet 120, 121 dhe 96 të kod.fam., regjimi i pasurive të ndara përfundon në të gjitha rastet e përfundimit të martesës. Të gjitha këto hipoteza sjellin automatikisht mbarimin e regjimit të pasurive të ndara. Janë raste ligjore të mbarimit të regjimit të pasurive të ndara:

- a) Vdekja dhe shpallja e vdekjes së njërit bashkëshort;
- b) Zgjidhja e martesës;
- c) Pavlefshmëria e martesës.

B. Mbarimi vullnetar. Në hipotezën e mbarimit vullnetar të regjimit të pasurive të ndara, dallojmë dy raste:

- a) Regjimi i pasurive të ndara përfundon në rastet kur bashkëshortët lidhin një kontratë të re martesore, nëpërmjet së cilës zgjedhin regjimin e bashkësisë ligjore ose një regjim bashkësie me kontratë;
- b) Verifikohet afati apo kushti zgjidhës i vendosur nga palët në kontratën e martesës.

5.9.2. Pasojat e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara

Për shkak të mungesës së masës së sendeve të përbashkëta, përcaktimi i pasojave që sjell mbarimi i regjimit të pasurive të ndara është më i thjeshtë në raport me pasojat e mbarimit të regjimit të bashkësisë.

Së pari, në të gjitha rastet e përmendura më sipër, të mbarimit të regjimit të pasurive të ndara, me përjashtim të rastit të mbarimit kontraktor të tij, pasuritë e fituara nga bashkëshortët gjatë

⁸²⁴ Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 92.

⁸²⁵ Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." fq. 92; Sesta dhe Vagliani, "Il regime di separazione dei beni." fq. 656; Zaccaria, "La separazione dei beni." fq. 323.

⁸²⁶ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 620.

⁸²⁷ Dy probleme shtrohen në këtë hipotezë: problemi i parë është ai i përcaktimit të regjimit pasuror që do të zbatohet pas verifikimit të afatit apo kushtit zgjidhës dhe problemi i dytë është ai i publicitetit të regjimit të ri, me qëllim sjelljen e pasojave ndaj të tretëve.

regjimit do të vazhdojnë të mbeten të ndara, por nuk do të gjejnë zbatim normat e parashikuara nga kod.fam. për regjimin e pasurive të ndara si: rregullat e administrimit të pasurisë së bashkëshortit pronar nga bashkëshorti jopronar dhe normat e prezumimeve ligjore të pronësisë⁸²⁸.

Së dyti, në rastet kur regjimi i pasurive të ndara përfundon për shkak të vullnetit të palëve, nëpërmjet lidhjes së një kontrate të re martesore, apo nëpërmjet verifikimit të afatit apo kushtit zgjidhës, do të zbatohet një regjimi i ri pasuror, që mund të jetë:

- a) Regjimi pasuror, që palët kanë përcaktuar në kontratë, i cili mund të jetë regjimi ligjor i bashkësisë ose një regjim bashkësie me kontratë;
- b) Automatikisht regjimi i bashkësisë ligjore⁸²⁹, nëse palët në kontratën e re martesore janë shprehur vetëm për përfundimin e regjimit të pasurive të ndara, pa përcaktuar regjimin e ri pasuror, ose nëse jemi para të njëjtës situatë, në rastin e verifikimit të afatit apo kushtit zgjidhës.

Në doktrinë janë shfaqur diskutime lidhur me natyrën juridike të regjimit të bashkësisë ligjore, në hipotezën kur bashkëshortët gjatë martesës, nëpërmjet një kontrate të re martesore vendosin përfundimin e regjimit të pasurive të ndara dhe zbatimin e regjimit të bashkësisë ligjore.

Autorë të ndryshëm shtrojnë diskutime lidhur me natyrën juridike të regjimit të bashkësisë së rregulluar në dispozitat e kod.fam, nëse akoma mund të flasim për një regjim ligjor⁸³⁰.

5.10. Likuidimi i regjimit të pasurive të ndara

5.10.1. Domosdoshmëria dhe karakteristikat e likuidimit

Teorikisht, në regjimin e pasurive të ndara mungon faza e likuidimit, sepse është pikërisht karakteristikë e këtij regjimi, mungesa e krijimit të masës së sendeve të përbashkëta, gjatë kohëzgjatjes së tij.

Megjithatë në praktikë, në shumë raste, faza e likuidimit është e pashmangshme dhe e domosdoshme për shkak të konfondimit të interesave pasurorë të bashkëshortëve, si pasojë e jetesës së përbashkët të tyre⁸³¹. Sjellim në vëmendje sendet e fituara së në emër të të dy bashkëshortëve apo konfondimin e sendeve të luajtshme gjatë martesës, apo sendet e fituara në emër të njërit bashkëshort nëpërmjet kontributit ekonomik bashkëshortit tjetër.

Nëse pjesëtimi i regjimeve të bashkësisë ligjore/me kontratë, karakterizohet nga likuidimi në total i masës së sendeve të përbashkëta si dhe realizimin e likuidimit vetëm në fazën pas

⁸²⁸ Sesta dhe Vagliani, "Il regime di separazione dei beni." fq. 596.

⁸²⁹ Zaccaria, "La separazione dei beni." fq. 323-324; Raggi, "I regimi convenzionali. La separazione dei beni." fq. 148.

⁸³⁰ Dy janë argumentet që merren për bazë nga doktrina në këtë diskutim. Së pari, parimi i parashikuar nga neni 66 i kod.fam.: "regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve do të rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve...", sipas së cilit regjimi i bashkësisë ligjore zbatohet në të gjitha rastet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë ndërmjet tyre.

Së dyti, përkufizimi që doktrina jep për kontratën martesore si: "marrëveshja e lidhur ndërmjet bashkëshortëve për rregullimin e regjimit pasuror martesor, në mënyrë të ndryshme nga regjimi ligjor i bashkësisë".

Megjithatë, në ndihmë na vjen një tjetër përkufizimi i doktrinës, sipas së cilit "Kontrata martesore është veprimi juridik, nëpërmjet të cilit palët përcaktojnë, ndryshojnë ose shuajnë, regjimin e tyre pasuror". Për këto dy argumente shih: Raggi, "I regimi konvencionali. La separazione dei beni." fq. 157.

⁸³¹ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 556; Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq.623; Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 639; Savatier, *La séparation de biens en droit français*, fq. 81.

përfundimit të bashkësisë, këto janë dy elementë nuk karakterizojnë likuidimin e regjimit të pasurive të ndara, sepse qëllimi i tij nuk është krijimi i një mase të përbashkët pasurie⁸³².

Likuidimi i regjimit të pasurive të ndara mund të realizohet gjatë të gjithë kohëzgjatjes së vetë regjimit dhe jo domosdoshmërisht në përfundim të regjimit ose të martesës⁸³³, megjithëse në pjesën më të madhe të rasteve në praktikë, realizohet nga bashkëshortët në fazën e përfundimit të martesës/regjimit⁸³⁴.

Gjithashtu, nuk kërkohet domosdoshmërisht nga ligji likuidimi në total i të gjitha interesave të përbashkëta pasurore që mund të jenë formuar gjatë martesës, siç ndodh në rastin e regjimit të bashkësisë. Pjesëtimi mund të realizohet edhe vetëm për një ose disa sende të caktuara.

Një tjetër karakteristikë është që, likuidimi i regjimit të pasurive të ndara nuk i jep jetë një “mekanizmi origjinal”⁸³⁵ si në rastin e regjimit të bashkësisë. Përkundrazi, në likuidimin e regjimit të pasurive të ndara do të gjejnë zbatim rregullat e parashikuara nga kod.civ. mbi bashkëpronësinë dhe ato mbi trashëgiminë, në të cilat referon edhe vetë neni 120 i kod.fam. I vetmi element specifik që, karakterizon likuidimin e regjimit të pasurive të ndara dhe që është origjinal vetëm për këtë regjim janë rregullat e prezumimeve të pronësisë mbi sendet e luajtshme, të parashikuara në nenin 119 të kod.fam.

Regjimi juridik i likuidimit të regjimit të bashkësisë ligjore nuk do të gjejë në asnjë rast zbatim në likuidimin e regjimit të pasurive të ndara.

Dy janë situatat që janë rregulluar në kod.fam, në lidhje me likuidimin e regjimit të pasurive të ndara: **detyrimet ndërmjet bashkëshortëve** (neni 121 dhe 122 të kod.fam.) dhe **pjesëtimi i sendeve në bashkëpronësi të bashkëshortëve** (neni 120 i kod.fam).

5.10.2. Detyrimet ndërmjet bashkëshortëve

Në përfundim të martesës mund të rezultojë që, njëri bashkëshort të jetë debitor i bashkëshortit tjetër, apo të rezultojë që, pasuria e njërit bashkëshort është shtuar si pasojë e formave të ndryshme të kontributit të bashkëshortit tjetër. Në vijim mund të marrim disa shembuj:

- Njëri bashkëshort kontribuon materialisht për nevojat e familjes edhe për llogari të bashkëshortit tjetër;
- Sendet e fituara në emër të njërit bashkëshort mund të jenë paguar tërësisht ose pjesërisht me të ardhurat e bashkëshortit tjetër;
- Njëri bashkëshort ndihmon bashkëshortin tjetër në administrimin e veprimtarisë së tij ekonomike, pa kundërshtim;
- Njëri bashkëshort kryen punime apo shtesa që sjellin rritjen e vlerës ekonomike të pasurisë së bashkëshortit tjetër;
- Njëri bashkëshort administron pasurinë e bashkëshortit tjetër dhe nuk kthen frytet që ka detyrimin t’i kthejë;
- Njëri bashkëshort pagan detyrimet që bashkëshorti tjetër ka ndaj të tretëve.

Këta janë vetëm disa shembuj, pasi jeta e përditshme mund të ofrojë shembuj nga më të shumtët, të ndërthurjes së interesave pasurore të bashkëshortëve, në regjimin e pasurive të ndara.

Në të gjitha këto hipoteza shtrohet problemi se cili do të jetë regjimi juridik që do të zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme, ndërmjet bashkëshortëve.

Duhet theksuar që, marrëdhëniet e detyrimit që lindin ndërmjet bashkëshortëve gjatë martesës mund të gjejnë zgjidhje jo vetëm në përfundim të martesës, por edhe gjatë të gjithë kohëzgjatjes

⁸³² Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 623.

⁸³³ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 624.

⁸³⁴ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les régimes matrimoniaux*, fq. 640.

⁸³⁵ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 624.

së saj, pasi siç theksuam *ut supra* likuidimi i regjimit të pasurive të ndara, mund të realizohet në çdo moment të martesës, pavarësisht se në praktikë, në pjesën më të madhe të rasteve realizohet në përfundim të martesës, për shkak të pengesave morale dhe emocionale që pengojnë bashkëshortët të veprojnë gjatë martesës.

Marrëdhëniet e detyrimit ndërmjet bashkëshortëve nuk do të zgjidhen sipas institutit të kthimeve dhe kompensimeve të bashkësisë ligjore, por përkundrazi do të gjejnë zgjidhje sipas rregullave të posaçme të parashikuara në nenet 121 të kod.fam, të cilat referojnë në dispozitat e kod.civ. Për ato marrëdhënie që nuk gjejnë rregullim në nenin 121 do të zbatohen dispozitat e kod.civ. mbi përmbushjen e detyrimeve.

Sipas nenit 121 të kod.fam ***“Nëse martesa mbaron ose shpallet e pavlefshme dhe pasuria e njërit prej bashkëshortëve është shtuar nga lidhja e martesës, bashkëshorti tjetër, në rastin kur ai ka kontribuar në një mënyrë apo në një tjetër për këtë shtim, ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës së shtuar nga kontributi i tij”***.

Nga leximi i nenit të mësipërm, mund të nxjerrim disa përfundime.

Së pari, kjo është një dispozitë shumë e përgjithshëm dhe paraqet karakteristika shumë të ngjashme me institutin e begatimit pas shkak, të parashikuar në kod.civ, pasi në të dy rastet kërkohet si kusht, shtimi i pasurisë së njërit bashkëshort, nga njëra anë, dhe kontributi i cilësdo formë të bashkëshortit tjetër, nga ana tjetër.

Së dyti, megjithëse neni 121 *expressi verbis* gjen zbatim vetëm pas përfundimit të martesës, jemi të mendimit që, nuk ka asnjë pengesë që ky nen të gjejë zbatim edhe gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Gjithashtu, formulimi i nenit 121 nuk është shumë i saktë sepse regjimi i pasurive të ndara nuk përfundon vetëm me përfundimin e martesës, por mund të përfundojë edhe gjatë martesës, në rastin kur bashkëshortët ndryshojnë regjimin pasuror drejt atij të bashkësisë. Për rrjedhojë në vend të togfjalëshit ***“nëse martesa mbaron ose shpallet e pavlefshme”*** duhet të ishte vendosur togfjalëshi ***“nëse mbaron regjimi i pasurive të ndara”***.

Së treti, zbatimi i nenit 121 kërkon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shtimit të pasurisë së njërit bashkëshort dhe kontributit të bashkëshortit tjetër. Për ligjin nuk paraqet asnjë rëndësi mënyra e kontributit të njërit bashkëshort në shtimin e pasurisë së bashkëshortit tjetër, ku kontribut mund të jetë realizuar në të holla apo në natyrë. Një ndër rastet të ndeshura më shpesh në praktikë është rasti i ndihmës që jep njëri bashkëshort (pa shpërblim) në administrimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit ekonomik të bashkëshortit tjetër.

Së katërti, bashkëshortit që ka kontribuar në shtimin e pasurisë së bashkëshortit tjetër, i lind e drejta të kërkojë kthimin e pjesës së shtuar nga kontributi i tij. Problemi që shtohet këtu, është se cili është momenti kohor i vlerësimit të shtimit të pasurisë së njërit bashkëshort, nga kontributi i tjetrit. Do të jetë momenti kur është realizuar shtimi, momenti i përfundimit të regjimit të pasurive të ndara apo momenti i paraqitjes së kërkesës për kthimin e shumës.

Së pesti, e drejta e kthimit është parashikuar nga ligjvënësi si një e drejtë personale, e cila mund të ushtrohet vetëm nga bashkëshorti kontribuues dhe nuk u kalon trashëgimtarëve të tij, si rregull i përgjithshëm. E drejta e kthimit i kalon trashëgimtarëve të bashkëshortit të vdekur, vetëm nëse gjykimi ndërkohë ka filluar, ose nëse kjo e drejtë i është njohur trashëgimtarëve në kontratën e martesës.

Së gjashti, e drejta e kthimit të pjesës së pasurisë së shtuar nga kontributi i njërit bashkëshort, i nënshtrohet afatit 2 vjeçar të parashkrimit, afat i cili fillon të llogaritet nga momenti i mbarimit apo shpalljes së pavlefshmërisë së martesës (neni 122/2 kod.fam.), që është momenti kur

vendimi i gjykatës për zgjidhjen apo shpalljen e pavlefshme të martesës merr formë të prerë, apo momenti i vdekjes së njërit bashkëshort.

Në analizë të fundit, mund të nxjerrim përfundimin që, instituti i kthimit të parashikuar nga nenet 121 dhe 122 të kod.fam, i nënshtrohet autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve. Bashkëshortët në kontratën e martesës mund të parashikojnë modifikime të këtij instituti ose të parashikojnë shmangien e zbatimit të tij. Këtë përfundim e arrijmë duke iu referuar nenit 122/1, i cili parashikon mundësinë e bashkëshortëve, për t'i dhënë të drejtën e padisë edhe trashëgimtarëve të tyre, në kontratën e martesës.

5.10.3. Pjesëtimi i sendeve në bashkëpronësi

Megjithëse qëllimi i regjimit të pasurive të ndara është ruajtja e pronësisë ekskluzive mbi pasurinë e fituar dhe është karakteristikë e tij mungesa e masës së sendeve të përbashkëta, në praktikë paraqiten raste kur formohet bashkëpronësi e bashkëshortëve mbi sendet e fituara gjatë këtij regjimi. Në praktikë, dy janë hipotezat që mund të çojnë drejt formimit të bashkëpronësisë, gjatë regjimit të pasurive të ndara:

- a) Bashkëshortët fitojnë një send në bashkëpronësi, nëpërmjet një veprimi juridik me ose pa kundërshtim (kontratë dhurimi në emër të të dy bashkëshortëve, kontrate shitje ku të dy bashkëshortët paraqiten blerës etj);
- b) Sendet e luajshme të cilat prezumohen në bashkëpronësi, në pjesë të barabarta, të të dy bashkëshortëve, kur asnjëri prej tyre nuk arrin të provojë pronësinë ekskluzive mbi këto sende (neni 119/2).

Neni 120 i kod.fam, i cili është një riprodhim *mot a mot* i nenit 1542 të KC Francez, për pjesëtimin e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve me regjime pasurish të ndara, referon në zbatimin e regjimit juridik të parashikuar nga kod.civ. të pjesëtimin të pasurisë trashëgimore.

Sipas nenit 120, ***nëse martesa përfundon për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort⁸³⁶, për pjesëtimin e sendeve që janë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, për sa i përket formës dhe ruajtjes së pandarë të sendit të papjesëtueshëm, radhës së preferencave, shitjes në ankand të sendeve të papjesëtueshme, efekteve të ndarjes, garancisë dhe diferencave, i nënshtrohen rregullave të trashëgimisë për ndarjen ndërmjet trashëgimtarëve.***

Të njëjtat rregullave për pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi të bashkëshortëve do të zbatohen edhe në rastin kur martesa përfundon për shkak të zgjidhjes, me përjashtim të radhës së preferencave. Në këtë rast, mund të vendoset që diferenca e mundshme të paguhet me para në dorë.

Pjesëtimi i sendeve në bashkëpronësi, të bashkëshortëve të martuar nën regjimin e pasurive të ndara, ka efekte deklarative dhe jo efekte konstitutive si në rastin e pjesëtimin të pasurisë së bashkësisë, pjesëtimi i së cilës ka fuqi retroaktive që nga data e përfundimit të martesës⁸³⁷. Në asnjë rast nuk do të gjejnë zbatim rregullat e pjesëtimin të bashkësisë ligjore, por do të zbatohen rregullat e kod.civ. për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore për elementët e listuar në nenin 120 të kod.fam. dhe më gjerë rregullat e përgjithshme të pjesëtimin të pasurisë, të parashikuara në kod.civ. për elementët që nuk janë listuar në nenin 120 të kod.fam.

Disa përfundime mund të nxirren, mbi bazën e analizës së nenit 120 të kod.fam.

⁸³⁶ Me vdekjen e njërit bashkëshort si shkak të përfundimit të martesës do të barazojmë edhe mbarimin e martesës për shkak të shpalljes së vdekjes së njërit bashkëshort, megjithëse nuk parashikohet shprehimisht në tekstin e nenin 120/1 të kod.fam.

⁸³⁷ E këtij mendimi është doktrina franceze: Shih: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 644.

Së pari, bazuar në nenin 354 të kod.civ, në zbatimin e të cilit referon neni 120 i kod.fam. (forma e pjesëtimit), pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi të bashkëshortëve mund të realizohen në mënyrë vullnetare, me marrëveshje të palëve, ose nëse nuk është e mundur një marrëveshje, në rrugë gjyqësore.

Në lidhje me gjykatën kompetente nga pikëpamja territoriale, për gjykimin e padisë së pjesëtimit nuk do të zbatohet neni 354/2, i cili përcakton gjykatën për shqyrtimin e padive që rrjedhin nga trashëgimia, sepse neni 120 nuk referon tek rregullat e pjesëtimit të trashëgimit për përcaktimin e gjykatës kompetente. Për rrjedhojë do të gjejnë zbatim rregullat e kompetencës territoriale të përcaktuara në kod.proc.civ, sipas nenit 45/1 të tij, paditë për pjesëtimin e sendeve do të ngrihen në gjykatën ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre.

Subjektet që kanë të drejtën të kërkojnë në gjykatë pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi të bashkëshortëve, sipas qëndrimit të doktrinës⁸³⁸ janë jo vetëm bashkëshortët, por edhe kreditorët e secilit prej tyre.

Së dyti, pjesëtimi i sendeve në bashkëpronësi mund të realizohet në çdo kohë, si gjatë martesës ashtu edhe pas përfundimit të saj, në ndryshim nga pjesëtimi i pasurisë në regjimin e bashkësisë ligjore, që kërkon domosdoshmërisht mbarimin paraprak të bashkësisë.

Problemi i shtruar në doktrinë dhe në praktikën gjyqësore është nëse neni 120 i kod.fam. do të gjejë zbatim edhe në hipotezën kur bashkëshortët vendosin pjesëtimin e sendeve të përbashkëta gjatë martesës, apo do të zbatohet vetëm në hipotezën e parashikuar *expressis verbis* nga ligji (pas përfundimit të martesës). Nëse bashkëshortët kërkojnë pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi gjatë martesës, pjesëtimi do të realizohet sipa rregullave të pjesëtimit të pasurisë trashëgimore, në të cilat referon neni 120 i kod.fam. apo do të realizohet sipa rregullave të kod.civ. të pjesëtimit të bashkëpronësisë në pjesë.

Doktrina franceze⁸³⁹ dhe jurisprudenca e Gjykatës Franceze të Kasacionit⁸⁴⁰ kanë mbajtur qëndrimin që, megjithëse ligji i referohet shprehimisht vetëm pjesëtimit pas përfundimit të martesës, zbatimi i nenit 1542 të KC Francez (neni 120 i kod.fam), do të shtrihet në të gjitha rastet kur bashkëshortët kërkojnë pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi gjatë martesës.

Së treti, shtrohet problemi i shtrirjes së autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në lidhje me mundësinë e modifikimit apo përjashtimit të zbatimit të rregullave të parashikuar në nenet 12, 121 dhe 122 të kod.fam. në lidhje me likuidimin e regjimit të pasurive të ndara.

Jemi të mendimit që, dispozitat e mësipërme kanë karakterin e normave lejuese dhe për rrjedhojë bashkëshortët janë të lirë të parashikojnë modifikimin ose përjashtimin e zbatimit të tyre. Ky përfundim gjen kryesisht mbështetje në nenin 122 të kod.fam. i cili i njeh mundësinë bashkëshortëve, që në kontratën e martesës, t'i njohin të drejtën për të kërkuar kthimin e shumës me të cilën është shtuar pasuria e njërit bashkëshort nga kontributi i bashkëshortit tjetër, edhe trashëgimtarëve të tyre.

Për të gjitha argumentet e dhëna *ut supra*, jemi të mendimit që, bashkëshortët në kuadër të autonomisë së njohur nga ligji, kanë të drejtë të modifikojnë apo të shmangin zbatimin e dispozitave ligjore mbi likuidimin e regjimit të pasurive të ndara (nenet 120, 121, 122 të kod.fam.), përderisa nuk ka asnjë ndalim të shprehur nga ligji.

⁸³⁸ E këtij mendimi është doktrina franceze. Shih: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 643-644.

⁸³⁹ Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 644; Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 561.

⁸⁴⁰ Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 9 October, 1990; Court de Cassation, Chambre Civile 3e, 6 Mars 1996; Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 22 October 1985; shënim i: Terré dhe Simler, *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*, fq. 643.

KAPITULLI VI

AUTONOMIA E VULLNETIT NË ZGJEDHJEN E LIGJIT TË ZBATUESHËM DHE KONTRATA MARTESORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE

6.1. Martesa me elementë të huaj⁸⁴¹

Për shkak të fluksit botëror të lëvizjes së individëve, shkëmbimeve ekonomike dhe të informacionit, të cilat kanë ardhur duke u rritur pas Luftës së II Botërore dhe janë intensifikuar veçanërisht pas rënies së komunizmit⁸⁴², është e pamundur në ditët tona, studimi i një instituti të së drejtës vetëm në aspektin e së drejtës së brendshme, pa marrë në konsideratë dimensionin europian dhe ndërkombëtar të tij. Studimi i dimensionit ndërkombëtar shtrohet si domosdoshmëri në hipotezën e martesave me elementë të huaj, i cili është një fenomen në rritje të vazhdueshme në realitetin tonë shoqëror dhe juridik. Mbi këtë fenomen ndikojnë faktorë të tillë si globalizimi⁸⁴³ i ekonomisë, lehtësia e shpejtësia e transferimit të individëve (mobiliteti) nga njëri shtet në tjetrin si dhe fluksi që ka karakterizuar lëvizjet emigratore në Europë dhe në vendin tonë, në këto 20 vitet e fundit⁸⁴⁴. Si pasojë e këtyre faktorëve, shoqëria europiane është bërë multikulturale si dhe kemi një ndërkombëtarizim në rritje të marrëdhënieve njerëzore në Europë⁸⁴⁵.

Shqiptarët, me gjithë vështirësitë, udhëtojnë më shumë jashtë vendit si dhe martohen me shtetas të huaj jashtë shtetit ose në Shqipëri, më shumë se më parë, duke kapërcyer paragjykimet në lidhje me shtetësinë, vendbanimin, vendqëndrimin, racën, besimin, dallime që dikur konsideroheshin si pengesa për të qenë “bashkëshortë të ardhshëm”⁸⁴⁶.

Ky fenomen sjell një seri problemesh në lidhje me përcaktimin e legjislacionit substancial të zbatueshëm mbi marrëdhëniet personale dhe pasurore të bashkëshortëve, në lidhje me

⁸⁴¹ Në ndryshim nga ligji i vitit 1964, ligji i ri DNP, jep përkufizimin e elementit të huaj, si element karakterizues i marrëdhënieve juridik-civile. Elementi i huaj nënkupton çdo rrethanë juridike që lidhet me subjektin, përmbajtjen ose objektin e një marrëdhënieje juridiko-civile (konkretisht të marrëdhënies martesore) dhe që bëhet shkak për lidhjen e kësaj marrëdhënie me një sistem ligjor të caktuar (neni 1/2 i ligjit DNP).

Zgjedhja e ligjvënësit për të dhënë përkufizimin e elementit të huaj është jo shumë e kuptueshme. Nëse hedhim një vështrim në legjislacionet e shteteve të tjera, vëmë re, që asnjë legjislacion nuk parapëlqen të përfshijë në ligj kuptimin e “elementit të huaj” duke ia lënë këtë detyrë doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore, për arsyen e vetme që elementi i huaj është një çështje fakti, përcaktimi i të cili realizohet rast pas rasti në praktikë.

⁸⁴² Masmejan, Denis. *La localisation des personnes physiques en droit international privé, Etude comparée de notions de domicile, de résidence habituelle et d'établissement, en droit suisse, français, allemand, anglais, américain et dans les Conventions de La Haye.*, Genève: Librairie Droz, 1994, fq. 13.

⁸⁴³ Dy studiues britanikë të shkencave politike japin këtë përkufizim për fenomenin e globalizimit “Procesi i rritjes së ndërlidhjeve ndërmjet shoqërive, në mënyrë të tillë, që ngjarjet në një pjesë të botës gjithmonë e më shumë kanë ndikim në njerëzit dhe shoqëritë e pjesës tjetër të botës. Një botë e globalizuar është një botë në të cilën, ngjarjet politike, ekonomike, kulturore dhe sociale janë gjithmonë e më shumë të lidhura ndërmjet tyre. Baylis, John. dhe Smith, Steve. *The globalization of world politics.* Oxford: 1997, fq.7. Marrë nga: Basedow, Jürgen. “The effects of globalization on private international law.” në *Legal aspects of Globalization, Conflicts of laws, internet capital markets and insolvency in a global economy*, J. Basedow, T. Kono, Kluwer Law Inter: 2000, fq. 2.

⁸⁴⁴ Cipriani, Nicola. “Rapporti patrimoniali tra coniugi, norme di conflitto e variabilità della legge applicabile.” në *Studi in onore di Giovanni Giacobbe I, Teoria generale, Persone e famiglia*, G. Della Torre, Milano: Giuffrè Editore, 2010, fq. 517.

⁸⁴⁵ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 19.

⁸⁴⁶ Mandro-Balili, Arta. “Vlefshmëria e martesës dhe përcaktimi i ligjit që duhet zbatuar në pavlefshmërinë e martesës me elementë të huaj.” *Revista Studime Juridike*, Nr.1/2005, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Qershor 2005, fq. 170.

përcaktimin e juridiksionit gjyqësor kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme ndërmjet bashkëshortëve⁸⁴⁷, si dhe njohjen në RSH të vendimeve gjyqësore të huaja.

Rritja e numrit të martesave me elementë të huaj⁸⁴⁸, të cilat do t'i emërtojmë me termin martesa ndërkombëtare⁸⁴⁹, ka sjellë nevojën e studimit dhe analizës të problemeve komplekse që ndeshen në këto situata. Duke dashur të citoj fjalët e një autori të huaj: “Janë të shkuara ditët, në të cilat një studiues i së drejtës familjare kishte luksin të përqendrohej vetëm në studimin e marrëdhënieve familjare në të drejtën e brendshme”⁸⁵⁰.

Për të gjitha arsyet e parashtuara më sipër, ky studim do të ishte i paplotë, vetëm me analizën e kontratës martesore dhe regjimeve pasurore në dimensionin e të drejtës së brendshme, pa marrë në analizë dimensionin ndërkombëtar privat dhe ndërkombëtar privat europian të institutit.

Studimi në planin krahasues i normave të së drejtës ndërkombëtare private dhe normave të së drejtës substanciale, në fushën e regjimeve pasurore martesore, nuk është punë e lehtë për shkak se, jo vetëm në sistemin tonë juridik, por edhe në shumë sisteme të tjera juridike, evoluimi i këtyre dy disiplinave (disiplinës ndërkombëtare private dhe asaj substanciale) është realizuar në mënyrë autonome nga njëra-tjetra⁸⁵¹.

Nisur nga fakti, që në Republikën e Shqipërisë nuk ka norma ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, në fushën e marrëdhënieve pasurore bashkëshortore me elementë të huaj, pasi Shqipëria nuk e ka miratuar Konventën e Hagës së vitit 1978⁸⁵², studimi i këtyre marrëdhënieve do të përqendrohet në ligjin e ri “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

Risitë e legjislacionit të ri, kanë sjellë problematika të panjohura më parë në sistemin tonë të normave të konfliktit, të cilat për shkak të kohës së pakët të zbatimit të ligjit, akoma nuk janë verifikuar në praktikë, por pritet në verifikohen vitet në vazhdim.

6.1.1. Problemet që shtrohen për diskutim

Para reformës së legjislacionit mbi të drejtën ndërkombëtare private, normat e konfliktit mbi marrëdhëniet personale dhe pasurore ndërmjet bashkëshortëve, gjenin rregullim në ligjin nr. 3920, të vitit 1964 “*Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj*”. Ligji i ri, ka reformuar thellësisht disiplinën e marrëdhënieve juridike me elementë të huaj, duke

⁸⁴⁷ Cipriani, “Rapporti patrimoniali tra coniugi, norme di conflitto e variabilita della legge applicabile.” fq. 518.

⁸⁴⁸ Martesa me elementë të huaj (martesa ndërkombëtare). Martesa është me elementë të huaj, në rastet kur një ose disa nga elementët e martesës, si marrëdhënie juridike, subjektet, objektet apo përmbajtja karakterizohen nga elementi i huaj. Kemi martesë me element të huaj në hipotezat e mëposhtme:

- a) Dy shtetas të huaj apo persona pa shtetësi lidhin martesë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) Dy shtetas shqiptarë lidhin martesë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) Një shtetas shqiptar lidh martesë me një shtetas i huaj apo person pa shtetësi pavarësisht nga territori në të cilin lidhet martesa (territori i shtetit shqiptar apo territori i një shteti të huaj).
- d) Pasuria e bashkëshortëve ndodhet në një tjetër shtet në raport me shtetin, shtetësinë e të cilit mbajnë.

Për këtë përkufizim të martesës me elementë të huaj shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 69; Audit, Bernard. “D’Avout, Louis, Droit International Privé, sixième ed.” në *Corpus droit privé*, Nicolas Molfëssis (Ed.), Paris: Economica Ed., 2010, fq. 752.

⁸⁴⁹ Në doktrinë, martesat me elementë të huaj emërtohen shpeshherë si: “martesat ndërkombëtare” ose “cross-border marriages”. Këtej e tutje gjatë këtij puimi do të përdorim termin “martesat ndërkombëtare” për t’iu referuar martesave me element të huaj.

⁸⁵⁰ *Family law. Jurisdictional comparison*. James Stewart Manches (Ed.) Second edition, London: Thomson Reuters, 2013.

⁸⁵¹ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 41-42.

⁸⁵² Konventa e Hagës ,së vitit 1978, nuk ka patur përhapje të madhe në praktikë. Deri tani është ratifikuar vetëm nga tre shtete: Franca, Luksemburgu, Holanda. Megjithë përhapjen e pakët në praktikë, Konventa ka shërbyer si model në reformimin e legjislacioneve të pjesës më të madhe të shteteve europiane në 20-30 vitet e fundit.

parashikuar kritere të reja lidhje për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm, si dhe në planin procedural civil, duke parashikuar një hapje më të madhe drejt juridiksioneve të huaja.

Reformimi i thellë i legjislacionit për të drejtën ndërkombëtare private në Shqipëri, me miratimin e ligjit të ri **“Për të drejtën ndërkombëtare private”**, nr. 10428, dt. 02.06.2011, i cili parashikon kritere të reja lidhje në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, dikton nevojën e studimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në të drejtën ndërkombëtare private, me qëllim jo vetëm evidentimin e risive që ka sjellë ligji i ri në këtë drejtim, por edhe pasqyrimin e problemeve që shtrohen për diskutim në kuadrin e ri ligjor. Studimi i reformave që kanë pësuar legjislacionet e vendeve të tjera europiane në fushën e së drejtës ndërkombëtare private do të na krijojë mundësinë për një kuptim më të mirë të legjislacionit tonë, si dhe do të na mundësojë evidentimin e problemeve që kanë lindur në praktikën e këtyre shteteve dhe parashtrimin e zgjidhjeve të mundshme, bazuar jo vetë mbi mendimin doktrinal, por edhe mbi praktikën gjyqësore të këtyre shteteve.

Një nga risitë më të rëndësishme të ligjit të ri për DNP, në përcaktimin e kritereve të lidhjes për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve është parashikimi, në ndryshim nga ligji i vitit 1964, që parashikonte ligjin e shtetësisë së bashkëshortëve, i një kriteri të ri lidhje, i **lex voluntatis**. Thënë ndryshe ligji i ri DNP parashikon mundësinë e bashkëshortëve për të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet tyre legjislacionin e zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore.

Një numër pyetjesh shtrohen për diskutim në lidhje me regjimin pasuror martesor dhe kontratën martesore në lëmin e së drejtës ndërkombëtare private.

Së pari, cilat janë kufijtë e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në zgjedhjes e ligjit të zbatueshëm, për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore? A është autonomia e vullnetit të bashkëshortëve e pakufizuar?

Së dyti, shtrohet problemi i pasojave që sjell ndryshimi i kritereve të lidhjes gjatë martesës, si psh: ndryshimi i shtetësisë së përbashkët të bashkëshortëve, apo ndryshimi i vendqëndrimit të zakonshëm të tyre.

Së treti, shtrohet problemi i formës së marrëveshjes së bashkëshortëve, si dhe legjislacionit mbi bazën e të cilit do të vlerësohen kushtet e vlefshmërisë dhe të formës së marrëveshjes, ndërmjet legjislacionit të vendit ku lidhet marrëveshja, apo legjislacionit të zgjedhur nga bashkëshortët për rregullimin e regjimit pasuror martesor.

Së katërti, do të analizohet natyra juridike e marrëveshjes së bashkëshortëve në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm, nëse marrëveshja mund të klasifikohet në kategorinë e kontratës martesore, apo është një figurë juridike **“sui generis”** e ndryshe nga kontrata martesore.

Së pesti, një nga problemet që janë shtruar për diskutim në doktrinë është mbrojtja e të tretëve, të cilët do të kryejnë veprime juridike më bashkëshortët. Në këtë drejtim, do të studiojmë nëse marrëveshja e bashkëshortëve, sjell pasoja vetëm *inter partes* apo mund t'i kundërdrejtohet edhe të tretëve. Nëse ka pasoja **“erga omnes”** mbi bazën e cilave kritere, marrëveshja mund t'i kundërdrejtohet të tretëve dhe a i nënshtrohet sistemit të regjistrimit për këtë qëllim.

Së gjashti, studimi do të fokusohet në legjislacionin e zbatueshëm mbi kontratën martesore, zotësinë për të lidhur kontratë, kushtet thelbësore të vlefshmërisë së kontratës, formën dhe përmbajtjen e saj, si dhe në mundësinë e njohjes dhe regjistrimit në RSH të kontratave martesore të lidhur jashtë saj.

6.2. Vështrim krahasues ndërmjet ligjit të ri DNP dhe legjislacionit të mëparshëm⁸⁵³. Risitë e ligjit të ri DNP.

Ligji i ri për DNP ka rimodeluar thellësisht disiplinën juridike, që i zbatohet marrëdhënieve personale dhe pasurore ndërmjet bashkëshortëve, në drejtim të përcaktimit të kritereve të reja të lidhjes në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për rregullimi e tyre.

Është e domosdoshme analiza, në planin krahasues, të legjislacionit të ri me legjislacionin e mëparshëm të vitit 1964, ligji i cili, megjithëse jo i përshtatshëm me zhvillimet shoqërore, ligjore dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare, ka rregulluar marrëdhëniet juridiko-civile me elementë të huaj deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri, në vitin 2011.

Ashtu siç kemi pasur rastin të përmendim *ut supra*, deri në miratimin e ligjit të ri DNP, ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni i gjykatave shqiptare në marrëdhëniet juridiko-civile me elementë të huaj, kanë gjetur rregullim në ligjin nr. 3920, datë 21.11.1964, “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”.

Ky ligj ishte tërësisht i papërshtatshëm me zhvillimet e reja të së drejtës ndërkombëtare private në panin ndërkombëtar dhe atë evropian. Ky ligj nuk përfshinte në themel të gjitha institutet e të drejtës ndërkombëtare private që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridike civile me elementë të huaj, si dhe mbetej një ligj shumë i vjetër, nuk ka pësuar ndryshimet e nevojshme me gjithë reformimin e gjithanshëm që ka pësuar legjislacioni shqiptar me ndryshimin e sistemeve. Duke marrë në konsideratë kohën e miratimit të tij, ai nuk ishte në gjendje të pasqyronte situatat e ndryshme sociale, ekonomike dhe juridike të vendit dhe nuk arrinte t’u përgjigjej ndryshimeve thelbësore, të tilla, si: institucioni i pronës private, ekonomia e tregut, lëvizja e lirë e njerëzve dhe e kapitaleve.

Ndryshimet shoqërore në vendin tonë, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe aderimi në konventa të ndryshme ndërkombëtare diktuan nevojën e krijimit të një kuadri të ri ligjor, i cili pasqyron zhvillimet e instituteve juridike të së drejtës ndërkombëtare.

Ligji i ri “Për të drejtën ndërkombëtare private” nr. 10428, dt. 02.06.2011 (këtej e tutje do t’i referohemi si ligji DNP) vendos rregulla të reja dhe bashkëkohore për gjykimin e mosmarrëveshjeve me elementë të huaj, duke marrë në konsideratë zhvillimet më të fundit juridike në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, por njëkohësisht edhe në krijimin e sigurive të duhura juridike në funksion të zgjidhjes së problemeve juridike të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në marrëdhëniet e tyre juridiko-civile. Ligji i ri merr në konsideratë ndryshimet e reja shoqërore, si dhe zhvillimet e reja konceptuale e doktrinale që kanë pësuar institutet e të drejtës ndërkombëtare private.

Ky ligj ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve juridike civile që kanë element të huaj si dhe përcaktimin e juridiksionit dhe rregullave procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile që kanë elementë të huaj⁸⁵⁴.

Në rregullimin e institutit të martesës me element të huaj, ligji i ri për DNP-në, ka sjellë një risi të dukshme si nga pikëpamja sasiore⁸⁵⁵ (numri i dispozitave ligjore) ashtu dhe nga pikëpamja cilësore.

⁸⁵³ Para hyrjes në fuqi të ligjit të ri DNP, marrëdhëniet juridiko-civile me elementë të huaj gjenin rregullim në ligjin nr. 3920., datë, 21.11.1964, “Për gëzimin e të drejtave civile për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi”. Ndërsa, nga ana tjetër, rëndësia praktike qëndron në vazhdimin e zbatimit të ligjit të mëparshëm, në rregullimin e ligjit të zbatueshëm, për të gjitha ato marrëdhënie pasurore ndërmjet bashkëshortëve, që kanë lindur para hyrjes në fuqi të tij. Dispozitat tranzitore të ligjit DNP, konkretisht neni 87 i tij, sanksionon parimin e mungesës së fuqisë prapavepruese të ligjit. Çështjet gjyqësore të papërfunduara, që janë në gjykim në gjykatë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjykohen sipas ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë.

⁸⁵⁴ Neni 1/1 i ligjit nr.10428, dt. 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

⁸⁵⁵ Ligji i ri ka sjellë përmirësimin e institutive ekzistuese, duke zgjeruar përmbajtjen e tyre, në përputhje me zhvillimet më bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare private.

Një nga risitë më të konsiderueshme në fushën e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, është largimi nga kriteri tradicional i lidhjes i parashikuar nga ligji i mëparshëm dhe parashikimi i kriterëve të reja të lidhjes. Ligji DNP ka parashikuar për herë të parë të drejtën e bashkëshortëve në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror martesor. Në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm, do të zbatohen kriteret e lidhjes së, së parashikuara për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve personale ndërmjet bashkëshortëve. Edhe në këtë rast sërish vëmë re kriteret e reja lidhje, në hipotezën e shtetësisë së ndryshme të bashkëshortëve si kriteri i vendqëndrimit të zakonshëm dhe ai i lidhjeve më të ngushta me jetën bashkëshortore. Regjimi pasuror martesor gjen rregullim në nenin 24 të ligjit DNP dhe në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, neni 24.1 referon për zbatim në nenin 23 të po këtij ligji.

6.3. Ligji i zbatueshëm mbi pasojat e martesës

Para se të kalojmë në analizën e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, është i nevojshëm të bëhet dallimi ndërmjet ligjit të zbatueshëm mbi martesën si veprim juridik “*matrimonium in fieri*” dhe ligjit të zbatueshëm mbi martesës si marrëdhënie juridike “*matrimonium in facto esse*”⁸⁵⁶.

A. Ligji i zbatueshëm mbi martesën si veprim juridik (kushtet thelbësore të lidhjes së martesës). Nga leximi i kujdesshëm i dispozitave të ligjit DNP, rezulton që, nuk gjendet një kriter i vetëm lidhje për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm mbi të gjitha kushtet e vlefshmërisë së martesës. Në zbatim të nenit 21/1 të ligjit DNP, kushtet materiale⁸⁵⁷ për lidhjen e martesës do të rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka secili prej bashkëshortëve të ardhshëm, në kohën e lidhjes së martesës⁸⁵⁸. Ky fakt tregon se ligjvënësi ynë i ka dhënë prioritet një kriteri personal për përcaktimin e kushteve materiale për të lidhur martesë, siç është kriteri i shtetësisë “*lex nationalis*”⁸⁵⁹. Nëse personat që do të lidhin martesë kanë shtetësi të ndryshme njëri nga tjetri, atëherë zotësia dhe kushtet materiale për lidhjen e martesës do të vlerësohen në mënyrë të veçantë në bazë të ligjit të shtetësisë së çdo njërit prej subjekteve që do të lidhin martesë. Gjithashtu, në zbatim të nenit 21/2 të ligjit DNP, shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi, që lidhin martesë në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç kushteve materiale që parashikon

⁸⁵⁶ Caravaca, Alfonso-Luis C. dhe Gonzalez, Javier C. *Derecho interbazonal Privado, Vol. II*. Décimo secunda edicion. Granada: Comares Ed., 2011, fq. 135. Për dallimin ndërmjet martesës si veprim juridik dhe martesës si marrëdhënie juridike shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 45.

⁸⁵⁷ Kushtet materiale përfaqësojnë komponentët esencialë për lidhjen e martesës. Në funksion të ekzistencës apo mungesës së kushteve që duhen respektuar për lidhjen e martesës, kushtet materiale ndahen në: kushte pozitive dhe kushte negative. Për më shumë, rreth klasifikimit të kushteve të lidhjes së martesës, shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 52.

⁸⁵⁸ Në raport me ligjin e vitit 1964, ligji i ri DNP-në ka bërë një rregullim ligjërish më të saktë dhe të plotë në lidhje me kriterin e shtetësisë, duke iu referuar specifikisht shtetësisë që kanë subjektet në *momentin e lidhjes së martesës*.

⁸⁵⁹ Në zbatim të nenit 8 të ligjit për DNP, nëse shtetasi shqiptar ka edhe shtetësi të ndonjë shteti tjetër, për qëllim të zbatimit të këtij ligji, shtetësia shqiptare ka epërsi. Nëse shtetasi i huaj ka dy ose më shumë shtetësi, zbatohet ligji i shtetit të shtetësisë, në të cilin ky person ka “*vendqëndrimin e tij të zakonshëm*”. Nëse shtetasi i huaj nuk ka vendqëndrim të zakonshëm në asnjë prej shteteve, shtetësinë e të cilave mban, për efekt të zbatimit të këtij ligji, konsiderohet se ai ka shtetësinë e shtetit, me të cilin ka “*lidhje më të ngushta*”. Një rregullim i ngjashëm ligjor parashikohet edhe për personat pa shtetësi.

legjislacioni i shtetësisë së tyre, duhet të përmbushin edhe kushtet thelbësore për lidhjen e martesës të parashikuara nga Kodi i Familjes⁸⁶⁰.

Për rregullimin e kushteve formale të lidhjes së martesës⁸⁶¹ (forma e martesës), ligji për DNP-në, përcakton një tjetër kriter lidhje *“lex loci celebrationis”*, pra ligjin e shtetit ku lidhet martesa. Nëse dy shtetas të huaj apo persona pa shtetësi ose një shtetas shqiptar dhe një shtetas i huaj apo person pa shtetësi vendosin të lidhin martesë në Republikën e Shqipërisë, atëherë martesa duhet patjetër të lidhet para nëpunësit të gjendjes civile, sipas të gjitha rregullimeve ligjore të parashikuara nga kod.fam, përndryshe martesa do të kondiserohet absolutisht e pavlefshme. Ligji për DNP-në, i jep mundësinë, shtetasve të huaj apo personave pa shtetësi, të lidhin martesë para përfaqësisë diplomatike ose konsullore të shtetit të tyre, në Shqipëri. Në këtë rast ligji i zbatueshëm për formën e lidhjes së martesës, nuk do të jetë *“lex loci celebrationis”* pra ligji shqiptar, por ligji i shtetit të përfaqësisë diplomatike apo konsullore të tyre.

Në zbatim të nenit 22/3 të ligjit për DNP-në, martesat e lidhura jashtë shtetit shqiptar, pavarësisht nga shtetësia e subjekteve, do të konsiderohen të vlefshme në Shqipëri, nëse forma e lidhjes së martesës do të konsiderohet e vlefshme në bazë të ligjit të shtetit, sipas të cilit është lidhur⁸⁶².

B. Ligji i zbatueshëm mbi martesës, si marrëdhënie juridike. Martesa nënkupton marrëdhënien juridike që krijohet si pasojë e shfaqjes së vullnetit të bashkëshortëve, që synon krijimin e kësaj marrëdhënie. Ligji i zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve personale jo pasurore dhe pasurore gjen rregullim në nenet 23 dhe 24 të ligjit DNP. Ndërsa në nenin 23 të ligjit DNP gjen rregullim ligji i zbatueshëm mbi të gjitha pasojat e martesës, në nenin 24 rregullohet ligji i zbatueshëm mbi pasojat (marrëdhëniet) pasurore të martesës.

Pjesa në vijim e këtij punimi ka për objekt studimi pikërisht ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, risitë e ligjit të ri, krahasimi me legjislacionin e mëparshëm dhe trajtimin teorik e praktik të problemeve që ndeshen në zbatimin e kriterëve të lidhjes së përcaktuara nga ligji DNP, në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor.

Dy janë parimet bazë të rregullimit të ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, të cilat mund të evidentohen nga interpretimi i nenit 24 të ligjit DNP: 1) parimi i autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor; 2) parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi të gjithë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve.

⁸⁶⁰ Kushtet thelbësore të lidhjes së martesës, të parashikuara në dispozitat e kod.fam. janë: pëlqimi i subjekteve që lidhin martesë (neni 8 KF); ndryshimi i sekseve ndërmjet personave që lidhin martesë (neni 7/1 KF); moshë 18 vjeç për të dy bashkëshortët (neni 7/1 KF); martesa e mëparshme e papërfunduar (neni 9 KF); sëmundja e rëndë psikike ose zhvillimi i metë mendor (neni 12 i KF); lidhja gjinore (neni 10 i KF); lidhja e krushqisë (neni 11 i KF); marrëdhënia e birësimi (neni 14 i KF) dhe marrëdhënia e kujdestarisë (neni 13 i KF).

⁸⁶¹ Kushtet formale i referohen procedurës së parashikuar në kod.fam. në drejtim të lidhjes së martesës, të cilat emërtohen forma e lidhjes së martesës. Për më shumë shih: Omari, *E drejta familjare*, fq. 51.

⁸⁶² Jam e mendimit që, formulimi që i është bërë kësaj dispozite nuk është plotësisht i saktë. Pyetja që shtrohet në këtë rast është: A do të jetë e vlefshme në rendin tonë të brendshëm juridik, martesa e lidhur, në një shtet të huaj, midis dy shtetasve shqiptarë që banojnë në Shqipëri, nëse forma e lidhjes së martesës nuk është forma civile, por një tjetër formë, për shembull fetare? Do të jetë e vlefshme në Shqipëri, martesa fetare e lidhur në Itali nga dy shtetas shqiptarë me banim në Shqipëri, martesë plotësisht e vlefshme në bazë të legjislacionit Italian? Nëse do t'i bëjmë një interpretim literal, nenit 22/3 të ligjit për DNP-në, përgjigja e pyetjeve të shtruar më sipër do të jetë “po”, martesa është e vlefshme. Problemi në dukje gjen zgjidhje në klauzolën e rendit publik, sipas së cilës nëse ligji i huaj bie ndesh me rendin publik shqiptar si nuk zbatohet.

Një formulim më i saktë i dispozitës 22/3 i ligji DNP-në, do të ishte plotësimi i dispozitës me frazën “nëse, në rastin e martesës së lidhur midis shtetasve shqiptarë që banojnë në Shqipëri, është në përputhje me legjislacionin shqiptar” ose duke ndjekur të njejtën logjikë juridike me ligjin e vitit 1964 “nëse, në rastin e martesës së lidhur midis shtetasve shqiptarë që banojnë në Shqipëri, është lidhur në formën e martesës civile”.

6.4. Parimet e unitetit të ligjit të zbatueshëm dhe autonomisë së vullnetit, në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor

6.4.1. Lidhja ndërmjet autonomisë materiale të vullnetit dhe autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm

Bazuar në të gjithë kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet pasurore martesore, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve, shfaqet në dy drejtime⁸⁶³:

- a) **Autonomia materiale e vullnetit** (të bashkëshortëve), më të cilën kuptojmë lirinë e bashkëshortëve për të vetërregulluar marrëdhëniet pasurore gjatë martesës, brenda kufijve të caktuar nga normat imperative në fuqi.
- b) **Autonomia konfliktuale e vullnetit**⁸⁶⁴, me të cilën kuptojmë lirinë e bashkëshortëve për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore. Në terma më të gjerë, autonomia konfliktuale e vullnetit mund të përkufizohet si e drejta e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm mbi një marrëdhënie juridiko-civile me elementë të huaj⁸⁶⁵.

Në martesat ndërkombëtare, ekziston një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet autonomisë materiale dhe autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, në kuptimin që ushtrimi i të parës është kushtëzuar nga ushtrimi i autonomisë konfliktuale. Vetëm pasi kanë ushtruar të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, bashkëshortët mund të rregullojnë përmbajtjen e regjimit pasuror, sipas kushteve dhe brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni i zgjedhur për zbatim⁸⁶⁶.

Nga sa analizuam më sipër duhet të konkludojmë që, autonomia e vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm duhet të dallohet thelbësisht nga autonomia materiale e vullnetit dhe liria kontraktore si shprehje e kësaj të fundit. Ajo mund të konsiderohet si një teknikë e lidhjes së një marrëdhënie juridike me elementë të huaj, me një rend juridik të caktuar⁸⁶⁷.

6.4.2. Autonomia e vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm

Risi, pa dyshim, e ligjit të ri DNP, në fushën e normave të konfliktit në rregullimin marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve është sanksionimi i parimit të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, parim i cili gjen shprehje në nenin 24.2 të ligjit; si dhe sanksionimi i parimit të barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve, i cili është një parakusht për parimin e autonomisë së vullnetit. Parimi i barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve gjen shprehje në të gjitha normat e konfliktit me objekt rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve, në kuptimin që "*lex nacionalis*" i bashkëshortit nuk është kriter mbizotërues në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm⁸⁶⁸.

Bashkëshortët, me marrëveshje ndërmjet tyre, kanë të drejtë të zgjedhin ligjin e zbatueshëm për regjimin pasuror martesor, megjithëse një e drejtë zgjedhje kjo e kufizuar ndërmjet mundësive (alternativave) të ofruara nga ligji (neni 24.2 DNP).

⁸⁶³ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 115.

⁸⁶⁴ Autonomia konfliktuale e vullnetit është një term që përdoret nga doktrina franceze. Në vijim të këtij punimi do të përdoret termi "*autonomia e vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm*."

⁸⁶⁵ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 112.

⁸⁶⁶ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 117.

⁸⁶⁷ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq.132.

⁸⁶⁸ Në fakt parimin e barazisë juridike të bashkëshortëve e gjejmë edhe në ligjin e vitit 1964.

Në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve, për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm do të gjejnë zbatim kriteret e lidhjes që shërbejnë për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm në rregullimin e marrëdhënieve personale të bashkëshortëve, të parashikuara në neni 23 i ligjit DNP. Është vetë paragrafi i parë i nenit 24, që referon në zbatimin e nenit 23, në eventualitetin e mungesës së marrëveshjes ndërmjet bashkëshortëve.

Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në funksion të përcaktimit të legjislacionit të zbatueshëm është njohur nga ligji vetëm në drejtim të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, ndërsa në drejtim të marrëdhënieve personale vazhdojnë të zbatohen kriteret objektive të lidhjes (neni 23 DNP)⁸⁶⁹.

Tradicionalisht parimi i autonomisë së vullnetit në të drejtën ndërkombëtare private ka gjetur zbatim ekskluzivisht vetëm në fushën e kontratave, ndërsa sot, në të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare private, ky parim zbatohet gjerësisht edhe në fushën e regjimeve pasurore martesore⁸⁷⁰.

Reforma e të drejtës ndërkombëtare private të shteteve të Europës kontinentale, të këtyre 30 viteve të fundit, është karakterizuar nga tendenca për shtrirjen e veprimit të parimit të autonomisë së vullnetit, në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, përtej fushës tradicionale të detyrimeve kontraktore, edhe në fushën e së drejtës familjare.

Edhe në fushën e akteve ndërkombëtare dhe atyre të BE-së, në të drejtën ndërkombëtare private, parimi i lirisë së zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm njihet sot si një nga parimet themelore të normave të konfliktit, në fushën e detyrimeve kontraktore dhe jashtëkontraktore, ashtu siç tregojnë Rregulloret Roma I dhe Roma II të Bashkimit Europian. Ndërsa në fushën e marrëdhënieve familjare parimi i autonomisë së vullnetit ka gjetur gjithmonë vështirësi⁸⁷¹. Megjithatë, në vitet e fundit parimi i autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm po kthehet në një parim qendror edhe në fushën e marrëdhënieve familjare dhe të trashëgimisë. Parë në planin e analizës historike, parimi i autonomisë së vullnetit në të drejtën ndërkombëtare private i ka rrënjët në Francën e shek. XVI, në çështjen “De Ganey”⁸⁷². **Charles Dumoulin** (1500-1556) konsiderohet si krijuesi i teorisë së autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, që sot është një ndër parimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare private. Dumoulin zbatimin e parimit të autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm e ka sugjeruar edhe në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve⁸⁷³. Bashkëshortët De Ganey pas lidhjes së martesës vendosën vendbanimin e tyre të përbashkët në Paris, ndërkohë që një pjesë e pasurisë së tyre ndodhej në Lion. Pas vdekjes së Zotit De Gany shtrohej problemi (**famosissima quaestio**) nëse do të zbatohet ligji i Parisit (coutumes de Paris parashikonte regjimin e bashkësisë - *communauté*), vendi ku bashkëshortët kishin vendbanimin e tyre të përbashkët; apo do të zbatohet ligji i Lionit (coutumes de Lyon – parashikonte regjimin e pasurive të ndara – *régime de la séparation*)⁸⁷⁴, vendi ku ndodhej pasuria e tyre⁸⁷⁵. Në çështjen De Ganey, Dumoulin ka

⁸⁶⁹ Edhe në drejtim të marrëdhënieve personale ligji i ri ka sjellë risi të rëndësishme, sepse krahas kriterit të shtetësisë së përbashkët të të dy bashkëshortëve, kriter lidhje të cilin e ndeshim edhe në ligjin e vitit 1964, ka zgjeruar kategorinë e kriterëve të lidhjes, duke parashikuar të tjera kriterë lidhje, të tilla si vendqëndrimi i zakonshëm dhe lidhjet më të ngushta të marrëdhënies bashkëshortore me një shtet të caktuar.

⁸⁷⁰ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 113.

⁸⁷¹ Jayme, Eric. “Party autonomy in international family and succession law: new tendencies.” në *Yearbook of Private international law*, Vol. XI-2009, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2009, fq. 1-2.

⁸⁷² Droz dhe Martin-Bosly, “Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes I.” fq. 207.

⁸⁷³ Kuçi Hajredin. dhe Bilalli, Asllan. *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*. Prishtinë: Botim i Universitetit Mbretëror Iliria, 2007, fq. 21.

⁸⁷⁴ Tradicionalisht për pasurinë zbatohet ligji i vendit ku pasuria ishte vendosur, për rrjedhojë për pasurinë e vendosur në Lyon Znj. De Gany nuk ishte bashkëpronare, pasi e drejta zakonore e Lionit parashikonte regjimin e pasurive të ndara.

mbajtur qëndrimin që, nëse bashkëshortët kanë lidhur martesë në Paris dhe është Parisi vendbanimi i tyre i përbashkët, atëherë ata heshturazi kanë pranuar që martesë e tyre (duke përfshirë edhe marrëdhëniet e tyre pasurore) do të rregullohet nga “*coutumes*”⁸⁷⁶ e Parisit, vendi i vendbanimit të tyre të përbashkët dhe jo nga “*coutumes*” e Lionit, vendi i vendndodhjes së pasurisë së tyre të paluajtshme. Në këtë drejtim shtrohej pyetja nëse pasuria e paluajtshme e ndodhur në Lion do të ishte pronë vetjake e bashkëshortit në emër të të cilit ishte fituar pronësia, sipas së drejtës së Lionit; apo do të ishte pronë e përbashkët e të dybashkëshortëve, bazuar në zbatimin e të drejtës së Parisit. Dumoulin mbështeste zgjidhjen e dytë, duke mbështetur qëndrimet e tij në teorinë e zgjedhjes së heshtur të ligjit të zbatueshëm⁸⁷⁷. Kjo tezë e Dumoulin ishte shumë e rëndësishme për kohën, sepse për herë të parë ai lidhte ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor me personin (pronarin) dhe jo me vendndodhjen e sendeve⁸⁷⁸ si dhe hodhi idenë e zbatimit të një legjislacioni të vetëm për të gjithë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve⁸⁷⁹. Ndërsa, një tjetër përfaqësues i shkollës franceze të epokës, **Bertrand D’Argantre** (1519-1590)⁸⁸⁰, në dallim nga idetë e bashkëkohësit të tij Dumoulin, e zgjidhi kolizionin e “*coutumes*”, në lidhje me pasurinë e paluajtshme në favor të së drejtës zakonore të vendit të vendndodhjes së saj, duke mbrojtur tezën e fuqisë ekskluzive territoriale të ligjeve rajonale (*coutume*), duke mbrojtur në këtë mënyrë autonominë juridike të rajoneve⁸⁸¹. Sipas tij vetëm normat që rregullojnë statusin personal të personit kanë mundësi të veprojnë jashtë territorit të shtetit, pra ndjekin personin⁸⁸².

Në analizë të krahasuar të legjislacioneve të së drejtës ndërkombëtare private të shteteve të ndryshme europiane, bazuar mbi kriterin e autonomisë së vullnetit në funksion të zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, doktrina realizon klasifikimin e këtyre sistemeve ligjore në tre kategori⁸⁸³:

- a) **Sisteme të autonomisë totale**, të cilët nuk parashikojnë asnjë kufizim, në drejtim të zgjedhjes ligjit të zbatueshëm, të tilla si: shtetet e traditës ligjore anglo-amerikane si: Kebek, Austria;
- b) **Sistemet e mohimit total të autonomisë**, në të cilat bashkëshortët nuk kanë të drejtë të zgjedhin legjislacionin e zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror, por zbatohen kriteret e lidhjes së përcaktuara nga ligji. Doktrina i klasifikon sistemet e mohimit total të autonomisë së vullnetit në dy nëngrupe:
 1. Legjislacione që parashikojnë **një kriter të vetëm lidhje** për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm, si pasojë e ndikimeve fetare dhe kulturore, që është *lex nationalis* i bashkëshortit, të tilla si: Egjipti, Algjeria, Korea e Jugut dhe Irani;

⁸⁷⁵ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq.56.

⁸⁷⁶ Edhe pse që në shek. XVI, në Francë, është realizuar bashkimi politik, e drejta civile ka mbetur e paunifikuar për një kohë të gjatë, deri në miratimin e Kodit Civil Napoleon, në vitin 1804. Çdo krahinë ka patur të drejtën e vet të veçantë zakonore (*coutumes*) për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile dhe në çdo krahinë janë zbatuar në mënyrë absolute vetëm *coutumes* si dhe juridiksioni i çdo krahine ka qenë i pavaruar nga ai i krahinave të tjera dhe nga juridiksioni i mbretit francez. Për më tepër shih: A. Lane, “Introduction au droit international privé”, Paris, 1888, fq. 258. Apud: Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 20-21.

⁸⁷⁷ Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 21-22.

⁸⁷⁸ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq. 57.

⁸⁷⁹ Wiederkehr, Georges. *Les conflicts de loi en matière de régime matrimonial*. Vol. VII. Paris: Dalloz, 1967, fq. 37.

⁸⁸⁰ Idetë e tij D’Argantre i ka prezantuar në veprën e tij të famshme “De statutibus, personalibus et realibus”.

⁸⁸¹ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq.57.

⁸⁸² Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 22.

⁸⁸³ Viarengo, Ilaria. “Autonomia della volonta e rapporto patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato.” në *Studi e pubblicazioni della rivista di diritto internazionale privato e procesuale*, nr.48, Padova: CEDAM, 1996, fq. 170-171; Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 179-192.

2. Legjislacione të cilat parashikojnë *disa kritere lidhje*, sipas një liste hierarkike të parashikuar nga ligji, të tilla si: Shqipëria para reformës së vitit 2011, Italia para reformës së vitit 1995, Gjermania, Spanja në periudhën para reformimit të legjislacioneve mbi të drejtën ndërkombëtare private.

c) *Sistemet e autonomisë së kufizuar*, të cilët lejojnë të drejtën e bashkëshortëve për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, e drejtë zgjedhje, e cila mund të ushtrohet brenda alternativave të parashikuara nga ligji, të tilla si: Shqipëria në ligjin e ri DNP, Italia me reformën e vitit 1995, Gjermania në reformën e vitit 1986, Spanja, si dhe Konventa e Hagës, nën modelin e së cilës janë realizuar reformat e këtyre shteteve.

Në klasifikimin e mësipërm, Shqipëria bën pjesë në grupin e shteteve të cilat, bazuar në modelin e Konventës së Hagës së vitit 1978 parashikojnë një autonomi të kufizuar vullneti të bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror martesor. Kjo ishte një risi e konsiderueshme e Konventës, për kohën e miratimit të saj. Deri në kohën e miratimit të saj, shumica e shteteve europiane nuk njihnin mundësinë e bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm për marrëdhëniet e tyre pasurore, dukë parashikuar si të vetmin kriter lidhje, për të gjitha efektet e martesës, atë të shtetësisë së përbashkët, ose në mungesë të saj, të shtetësisë së burrit⁸⁸⁴.

Paragrafi i dytë i nenit 24 të ligjit parashikon kriteret e lidhjes brenda të cilëve bashkëshortët mund të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, ndërmjet ligjit të shtetësisë apo të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit bashkëshort, apo ligjit të vendndodhjes së pasurisë së paluajtshme.

Legjislacioni gjerman dhe zviceran parashikojnë një autonomi të kufizuar vullneti në drejtim të zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, ndërmjet kritereve të lidhjes së përcaktuara në ligj. Në ndryshim nga legjislacioni zviceran, i cili parashikon parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi të gjitha marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, legjislacioni gjerman u lejon bashkëshortëve të zgjedhin si ligj të zbatueshëm për pasurinë e tyre të paluajtshme "*lex rei sitae*", ndërsa për pasurinë e luajtshme "*lex nationalis*" ose "*ligjin e rezidencës së zakonshme*". Nga ana tjetër, Austria lejon një autonomi të pakufizuar vullneti; bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin ligjin e zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore lirisht, pa u kufizuar nga kritere lidhje të rregulluara në ligj, marrëveshja mund të ndryshohet në çdo kohë gjatë martesës si dhe bashkëshortët mund t'i japin asaj fuqi prapavepruese. Ashtu si në rastin e legjislacionit gjerman, edhe sipas legjislacionit austriak, bashkëshortët kanë të drejtën e fragmentarizmit të ligjit të zbatueshëm duke zgjedhur ligje të ndryshme për pasurinë e paluajtshme në raport me atë të luajtshme.

Në Spanjë, autonomia e bashkëshortëve është akoma më e reduktuar, pasi ata kanë të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, vetëm nëse nuk kanë shtetësi të përbashkët. Gjithashtu marrëveshja mund të lidhet vetëm para lidhjes së martesës, pa pasur të drejtën e ndryshimit të ligjit të zbatueshëm gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Franca, Luksemburgu dhe Holanda kanë ratifikuar Konventën e Hagës së vitit 1978, e cila siç pamë pak më parë, parashikon një autonomi të kufizuar të vullnetit të bashkëshortëve. Italia, gjithashtu bën një rregullim ligjor të ngjashëm me atë shqiptar.⁸⁸⁵

⁸⁸⁴ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 198.

⁸⁸⁵ Për këtë analizë krahasuese të legjislacioneve ndërkombëtare private të shteteve europiane shih: Viarengo, *Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 177-198.

6.4.3. Natyra juridike e autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm

Ekzistojnë debate në doktrinë mbi natyrën juridike të autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm. Disa e konsiderojnë autonominë e vullnetit si një normë konflikti, ndërsa të tjera si një normë materiale të së drejtës ndërkombëtare private.

Sipas një grupi autorësh, nisur nga fakti që autonomia e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm nuk është e pakufizuar, por bashkëshortëve i lind e drejta e zgjedhjes ndërmjet *lex nationalis* të njërit prej tyre, ligjit të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit prej tyre apo *lex rei sitae*, atëherë autonomia e vullnetit përfaqëson një kriter për përzgjedhjen e “kriterëve të lidhjes” më shumë se sa një normë materiale konflikti⁸⁸⁶.

Në mbështetje të të njëjtit qëndrim, sipas një tjetër autori, autonomia e vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm është një normë materiale e së drejtës ndërkombëtare private, pasi ajo nuk mund të përmbushë asnjë funksion konfliktual, sepse nuk përmban një kriter objektiv lidhje, të nevojshëm për një normë konflikti. Zgjedhja e ligjit të zbatueshëm nuk përbën një normë konflikti⁸⁸⁷.

Nga ana tjetër, sipas një tjetër autori, autonomia e vullnetit përfaqëson një normë konflikti, e cila integron në përmbajtjen e saj edhe një aspekt substancial, që ka për qëllim thjeshtëzimin e marrëdhënieve kontraktore të palëve në qarkullimin civil ndërkombëtar⁸⁸⁸.

Në vazhdim të këtij qëndrimi, sipas një tjetër autori, nuk qëndron asnjë vështirësi në klasifikimin e autonomisë konfliktuale të vullnetit në kategorinë e normave të konfliktit, përderisa ajo përmban kriteret e lidhjes, elementët strukturalë, të cilët shërbejnë për të dalluar normat e konfliktit nga normat materiale, por në ndryshim nga normat e tjera të konfliktit, autonomia e vullnetit përdor një teknikë të tërthortë rregullimi⁸⁸⁹.

Në vazhdim të këtij qëndrimi një tjetër autor është i mendimit që, nëse pranojmë që parimi i autonomisë së vullnetit është një normë e mirëfilltë konflikti, atëherë kriteri i lidhjes së kësaj norme konflikti do të jetë “shprehja e pëlqimit të bashkëshortëve” ndërsa ligji i zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror përfaqëson konkretizimin e këtij kriteri (pasojnë që vjen si rezultat i shprehjes së këtij pëlqimi)⁸⁹⁰.

Një pyetje që shtohet për diskutim nga doktrina është problemi i kriterëve mbi bazën e të cilave, në kuadrin e alternativave që i ofrohen nga ligji, bashkëshortët do të zgjedhin ligjin e zbatueshëm, për regjimin pasuror martesor. Është e qartë që, në zgjedhjen e tyre, më shumë se sa legjislacioni me të cilin kanë lidhje me të ngushta, bashkëshortët do të priren të zgjedhin atë legjislacion që më mirë garanton interesat pasurorë të tyre⁸⁹¹. Në thelb, qëllimi i shtrirjes së autonomisë së vullnetit në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, si në dimensionin e së drejtës substancialë ashtu edhe asaj të së drejtës ndërkombëtare private, është përshtatja e regjimit pasuror me interesat pasurorë të palëve. Bashkëshortët do të bëjnë atë zgjedhje si në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm ashtu dhe në zgjedhjen e regjimit pasuror, që më mirë garanton interesat e tyre pasurore.

⁸⁸⁶ Lopez, Antonio M. Escudero, Mercedes M. Garcia, M.Luisa T. Gonzales, Javier C. *Derecho internacional privado español II*. Partes especial. 7 ed., Granada: 1991, fq. 149.

⁸⁸⁷ Deby-Gerard, France. *Le rôle de la règle de conflit dans le règlement des rapports internationaux*. Dalloz: Paris, 1973, fq. 121. Apud: Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 121.

⁸⁸⁸ Mayer, Pierre. *Droit international privé*. Paris: 1991, fq. 442. Apud: Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 121.

⁸⁸⁹ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 122.

⁸⁹⁰ Patocchi, Paolo M. “Règles de rattachement localisatrices et règles de rattachement substantiel.” në *Etudes suisses de droit international privé*, Volume 42, Genève: Librairie de l'Université Georg & CIE s.a., 1985, fq. 119.

⁸⁹¹ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 120.

Është më se e qartë që, funksioni i autonomisë së vullnetit është realizimi i interesave pasurorë të palëve, nëpërmjet zgjedhjes së atij ligji që më mirë garanton interesat pasurorë të palëve. Autonomia e vullnetit garanton zgjedhjen e *lex utilior*⁸⁹².

Në analizë të fundit mund të pohojmë që, autonomia e vullnetit është një normë konflikti, megjithëse nuk ka strukturën klasike të normave të konfliktit për shkak se i mungon karakteri lokalizues i ligjit të zbatueshëm, që është karakteristik për normat e konfliktit (lokalizimi i ligjit të zbatueshëm realizohet nga shprehja e vullnetit të bashkëshortëve)⁸⁹³. Në të drejtën ndërkombëtare private parimi i autonomisë së vullnetit dallohet dukshëm nga parimi i lirisë kontraktore, ai përfaqëson një kriter/technikë lidhje të një marrëdhënie juridike me elementë të huaj me një rend juridik të caktuar⁸⁹⁴.

6.4.4. Avantazhet e parimit të autonomisë së vullnetit në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm

Janë të shumta avantazhet që sjell për bashkëshortët parashikimi në ligj i të drejtës së zgjedhjes së legjislacionit material, si kriter lidhje në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve.

Së pari, mundësia zgjedhjes së legjislacionit të zbatueshëm mundëson zhvillimin e lirë të personalitetit të individit (bashkëshortëve), parim ky kushtetues.

Së dyti, mundësia e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm favorizon integrimin e bashkëshortëve emigrantë, në një shtet të ndryshëm nga shteti i origjinës, në realitetin social-kulturor të shtetit ku ata kanë vendqëndrimin e zakonshëm dhe në të njëjtën kohë mundëson që çdo bashkëshort të ruajë lidhjet kulturore dhe/ose juridike me vendin e tij të origjinës⁸⁹⁵.

Së treti, ashtu siç patëm vend të analizonim më sipër, parim i autonomisë konfliktuale të vullnetit i mundëson bashkëshortëve zgjedhjen e atij legjislacioni që i përgjigjet më mirë interesave ekonomikë të tyre.

Së katërti, zgjedhja e ligjit të zbatueshëm i mundëson bashkëshortëve koordinimin e ligjit rregullues të regjimit pasuror martesor me ligjin rregullues të pasojave të zgjidhjes së martesës dhe atë të trashëgimisë, në mënyrë që ligji rregullues i të tre këtyre elementëve të jetë i njëjtë, në funksion në të garancie më të madhe juridike për bashkëshortët në eventualitetin e përfundimit të martesës për shkak të zgjidhjes apo vdekjes së njërit bashkëshort.

Së fundi, autonomia e vullnetit në zgjidhjen e ligjit të zbatueshëm garanton sigurinë juridike në marrëdhëniet juridiko-civile me natyrë ndërkombëtare, duke korrigjuar në këtë mënyrë një nga problemet që shfaqen në marrëdhëniet ndërkombëtare private⁸⁹⁶.

6.4.5. Problemet që sjell zbatimi i parimit të autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm dhe parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm

Një nga problemet më të mëdha që sjell në praktikë parimi i autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit zbatueshëm është problemi i fragmentarizmit (*depeçage*) të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve.

⁸⁹² Patocchi, “Règles de rattachement localisatrices et règles de rattachement substantial.” fq. 115-116.

⁸⁹³ Patocchi, “Règles de rattachement localisatrices et règles de rattachement substantial.” fq. 121.

⁸⁹⁴ Carlier, *Autonomie de la volonté et statut personnel*, fq.132.

⁸⁹⁵ Caravaca dhe Gonzalez, *Derecho interbazonal Privado. Vol. II*, fq. 145.

⁸⁹⁶ Anoveros Terrada, Beatriz. “La autonomía de la voluntad como principio rector de las normas de derecho internacional privado comunitario de la familia.” në *Entre Bruselas y la Haya. Estudio sobre la unificación internacional y regional el derecho internacional privado. Liber amicorum Alegria Borrás*, Marcial Pons (Ed.), Madrid: 2013, fq. 128.

Në hipotezën kur bashkëshortët ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, regjimi pasuror martesor dhe marrëdhëniet personale ndërmjet tyre do të rregullohen nga legjislacionet e dy shteteve të ndryshme, çka sjell mjaft probleme në koordinimin e tyre. Në këtë mënyrë, regjimi pasuror do të rregullohet nga ligji i zgjedhur nga palët, sipas nenit 24.2 të ligjit DNP, ndërsa marrëdhëniet personale të bashkëshortëve do të rregullohen nga ligji i thirrur për zbatim mbi bazën e kriterëve të lidhjes së parashikuara nga neni 23 i ligjit DNP, kriteri i shtetësisë së përbashkët, vendqëndrimit të zakonshëm apo lidhjeve më të ngushta të marrëdhënies bashkëshortore.

Në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve legjislacioni i zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve personale dhe pasurore të bashkëshortëve do të përcaktohet mbi bazën e të njëjtave kriterë lidhje, të parashikuara në nenin 23 të ligjit DNP, në zbatimin e të cilit referon paragrafi i parë i vetë nenit 24 të tij.

Për të evituar problemin e fragmentarizmit të ligjit të zbatueshëm, ligjvënësi ka parashikuar, në paragrafin e parë të nenit 24 të ligjit për DNP, parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm për të gjitha marrëdhëniet personale dhe pasurore ndërmjet bashkëshortëve, ndërsa në paragrafin e dytë të nenit 24, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm lejon mundësinë e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm vetëm për regjimin pasuror martesor.

Uniteti i ligjit të zbatueshëm për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, duke përfshirë si marrëdhëniet me natyrë pasurore ashtu dhe ato me natyrë personale jopasurore, ka disa avantazhe për bashkëshortët⁸⁹⁷:

- a) Eleminon problemet e klasifikimit të marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve. Jo gjithmonë është e thjeshtë klasifikimi i disa pasojave që sjell martesë për bashkëshortët në pasurore ose personale, për shkak të ndërthurjes së tyre. Kujtojmë këtu, që vështirësitë më të mëdha në praktikë janë ndeshur në klasifikimin e regjimit primar.
- b) Forcon sigurinë juridike në marrëdhëniet juridike ndërmjet palëve. Zbatimi i një ligjit të vetëm, për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, thjeshtëzon marrëdhëniet juridike të bashkëshortëve në planin ndërkombëtar.

Nga sa më sipër, mund të japim këtë interpretim për nenet 23 dhe 24 të ligjit DNP: në parim ligji për DNP është bazuar mbi parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi të gjitha marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve (personale jopasurore dhe pasurore), përveç rastit kur bashkëshortët përcaktojnë me marrëveshje ndërmjet tyre ligjin e zbatueshëm për regjimin pasuror martesor. Parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm duhet analizuar edhe në kuadrin e vetë regjimit pasuror martesor. Pyetja që shtrohet për diskutim është, nëse është e mundur, që në kuadër të autonomisë së dhënë nga ligji, bashkëshortët të parashikojnë një pluralitet sistemesh ligjore për rregullimin e regjimit pasuror martesor dhe jo një sistem të vetëm ligjor. Nga leximi i nenit 24.2 të ligjit DNP, lind pyetja nëse është e mundur për bashkëshortët të zgjedhin "*lex rei sitae*" për pasurinë e paluajtshme të tyre dhe *les nacionalis* apo ligjin e vendqëndrimit të zakonshëm për pjesën tjetër të pasurisë, duke çuar në atë që doktrina e ka njohur me ternim e fragmentarizmit vullnetar⁸⁹⁸ të ligjit të zbatueshëm mbi një marrëdhënie të caktuar juridiko-civile.

Bazuar mbi këtë kriter, doktrina klasifikon sistemet ligjore të së drejtës ndërkombëtare private në dy kategori⁸⁹⁹:

⁸⁹⁷ Për këto avantazhe shih: Caravaca dhe Gonzalez, *Derecho interbazional Privado. Vol. II*, fq. 140.

⁸⁹⁸ Për përdorimin e këtij termi shih: Patocchi, "Règles de rattachement localisatrices et règles de rattachement substantial." fq. 100.

⁸⁹⁹ Për këtë kategorizim të sisteme ligjore të së drejtës ndërkombëtare private në sisteme unitare dhe sisteme të dyzuara shih: Viarengo, *Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 168-170.

- a) **Sisteme ligjore unitare**⁹⁰⁰, të cilat parashikojnë një grup të vetëm kritere lidhjesh për të gjithë regjimin pasuror në total: si pjesa më e madhe e legjislacioneve të vendeve europiane; Italia, Spanja, Gjermania, Zvicra, Austria;
- b) **Sisteme ligjore të dyzuara**, të cilat parashikojnë kritere/grupe të ndryshme kritere lidhje, në varësi të kategorizimit të sendeve në sende të luajtshme dhe sende të paluajtshme. Sistem tipik i dyzuar është ShBA, të cilat parashikojnë kriterin e *lex rei sitae* për sendet e paluajtshme dhe atë të *vendqëndrimit të zakonshëm* (habitual residence) të bashkëshortëve për sendet e luajtshme⁹⁰¹.

Pas kësaj analize të shkurtër krahasuese le të ndalemi në legjislacionin shqiptar të së drejtës ndërkombëtare private, për të përcaktuar se në cilën prej këtyre kategorive bën pjesë norma 24.2 e ligjit DNP.

Bazuar në faktin që neni 24.2 nuk parashikon në mënyrë të shprehur të drejtën e fragmentarizmit vullnetar të ligjit të zbatueshëm, por përkundrazi përdor termin **“Bashkëshortët me marrëveshje midis tyre... mund të vendosin që për regjimin pasuror martesor..., të zbatohet ligji i shtetit ...”** si dhe duke pasur parasysh faktin që të gjitha vendet e familjes ligjore romano-gjermanike⁹⁰² zbatojnë parimin e ligjit unitar mbi regjimin pasuror martesor, jemi të mendimit që neni 24 i kod.fam duket të interpretohet sipas kësaj fryme.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin që, Shqipëria bën pjesë në grupin e parë të klasifikimit, në grupin e sistemeve ligjore unitare. Neni 24 i ligjit, në kuadër të kritereve të lidhjes në funksion të përcaktimit të legjislacionit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor është bazuar në parimin e unitetit në legjislacionin e zbatueshëm: të gjitha marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, që përfshihen në kuadrin e regjimit pasuror martesor do të rregullohen nga një sistem i vetëm ligjor dhe jo nga disa sisteme të ndryshme ligjore, pavarësisht natyrës juridike të sendeve, të luajtshme apo të paluajtshme.

6.4.6. Raporti ndërmjet nenit 24.2 dhe nenit 36.1 të ligjit DNP

Problemi që shtrohet për diskutim është raporti që ekziston ndërmjet nenit 24.2 të ligjit DNP, të cilën e kemi marrë tashmë në analizë dhe nenit 36.1 të po këtij ligji, i cili parashikon kriteret e lidhjes për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm mbi të drejtat reale mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.

⁹⁰⁰ Ndërsa, në kuadrin e sistemeve unitare vihet re një gamë e gjërë zgjidhjesh që paraqesin shtetet e ndryshme, të cilat siç pamë më sipër ndahen në shtete të parashikojnë një autonomi zgjedhje të pakufizuar, ato që parashikojnë një të drejtë zgjedhje të kufizuar brenda kritereve të lidhjes së parashikuara në ligj dhe në shtete të cilat mohojnë të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm. Shih: Viarengo, *Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 170.

⁹⁰¹ Brenda këtyre dy kategorive mund të bëjmë të tjera klasifikime bazuar në kriteret e lidhjes së parashikuara nga legjislacionet e ndryshme. Në këtë mënyrë, sistemet e dyzuara shfaqin një lloj unifromiteti në kriterin e lidhjes mbi sendet e paluajtshme, duke parashikura “*lex rei sitae*”, ndërsa në lidhje me sendet e luajtshme zgjidhjet e ofurara janë të ndryshme, por përgjithësisht, pjesa më e madhe e sistemeve parashikonë ligjin e vendqëndrimit të zakonshëm të bashkëshortëve. Shih: Viarengo, *Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 169.

⁹⁰² Vetëm në Konvetën e Hagës së vitit 1978 ndeshim mundësinë e bashkëshortëve për të parashikuar *lex rei sitae* për pasurinë e paluajtshme dhe ligjin e një shteti tjetër për pjesën tjetër të pasurisë. Kjo zgjedhje e berë nga Konventa ka ardhur si pasojë e nevojës së harmonizimit të normave të konfliktit në fushën e regjimeve pasurore të vendeve të familjes ligjore romano-gjermanike, të cilat pranojnë parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm me traditën ligjore të vendeve të familjes ligjore anglo-amerikane, e cila bazohet në parimin zbatimit, në çdo rast, të *lex rei sitae* mbi pasurinë e paluajtshme, duke parashikuar, për bashkëshortët, të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm vetëm për pasurinë e luajtshme.

Sipas nenit 36.1 “*Pronësia, posedimi dhe të drejtat e tjera reale mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme rregullohen nga ligji i shtetit në të cilin ndodhet sendi.*”

Nëse pranojmë që neni 36.1 përbën “*lex generalibus*” dhe neni 24.2 përbën “*lex specialis*”, atëherë në bazë të parimit të mirënjohur të së drejtës private, “*specialis derogant generalibus*”, mund të pohojmë, që neni 24.2 përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm “*lex rei sitae*” i sanksionuar nga neni 36.1 të ligjit DNP.

Për të vazhduar më tej analizën e raportit ndërmjet dy disiplinave të mësipërme duhet të dallojmë dy momente të ndryshme⁹⁰³:

- a) Përcaktimi i titullarit të pronësisë dhe administrimi i pasurisë së pasurisë së fituar gjatë martesës, duke qenë se janë objekt i rregullimit të regjimi pasuror martesor, në kuadër të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, i nënshtrohen kriterëve të lidhjes, së parashikuar nga neni 24 i ligjit DNP, ndërsa
- b) Mënyrën e fitimit dhe përmbajtja e së drejtës së pronësisë dhe të drejtave të tjera reale dhe limitet brenda të cilëve mund të ushtrohet e drejta e pronësisë mbi pasurinë e fituar gjatë martesës, duke qenë se nuk përfshihet në objektin e rregullimit të regjimit pasuror martesor, por në atë të së drejtës së pronësisë, në kuadër të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, i nënshtrohet kriterëve të lidhjes së parashikuara nga neni 36.1 i ligjit DNP.

Në analizë të fundit, duhet pohuar që të gjitha elementët që përfshihen në kuadër të regjimit pasuror martesor do të rregullohen nga i njëjti legjislacion, nga ai legjislacion që palët kanë zgjedhur për zbatim, ose në mungesë të zgjedhjes së palëve nga legjislacioni që kriteret e lidhjes së parashikuara në nenin 23 të ligjit DNP thërrasin për zbatim. Ndërsa nga ana tjetër mënyra e fitimit dhe përmbajtja e të drejtave reale do të rregullohen nga *lex rei sitae*⁹⁰⁴.

6.4.7. Kufizimet e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm

Në të gjitha legjislacionet europiane duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë, e drejta e bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, mbi regjimin pasuror, është e kufizuar, nëpërmjet parashikimit të mundësisë së zgjedhjes së disa legjislacioneve, me të cilat marrëdhënia martesore paraqet lidhje, lidhje të cilat vlerësohen mbi bazën e kriterëve objektive⁹⁰⁵. Paragrafi i dytë i nenit 24 të ligjit DNP parashikon tre kriterë lidhje alternative brenda të cilëve bashkëshortët mund të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes.

Gjithashtu nga ana tjetër autonomia konfliktuale e vullnetit të bashkëshortëve është e kufizuar edhe nga normat imperative të ligjit si dhe nga klauzola e rendit publik.

Është më se e kuptueshme që në funksion të mbrojtjes së palës më të dobët dhe në funksion të mbrojtjes së familjes ligjvënësi ka parashikuar këto kufizime. Gjetja e një ekuilibri të drejtë ndërmjet interesit publik dhe së drejtës së palëve për të vetërregulluar interesat e tyre pasurore, nuk është e lehtë.

A. Parimi i afërsisë - Lista e mbyllur e kriterëve të lidhjes. Autonomia e bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor është e kufizuar ndërmjet alternativave të parashikuara nga ligji (neni 24.2 ligjit DNP).

⁹⁰³ Për me shumë shih: Zanobetti, Alessandra. “Il regime patrimoniale della famiglia nel diritto internazionale privato.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta (Eds.), në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti, Milano: Giuffrè Editore, 2012, fq. 36.

⁹⁰⁴ Batiffol, Henri. dhe Lagarde, Paul. *Droit International Privé*. Septième Ed., Tome II, Paris: Librairie générale de droit et de jurisprudence, 1983, fq. 381.

⁹⁰⁵ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 130.

Në paragrafin e dytë të nenit 24 të ligjit DNP është parashikuar një listë e mbyllur kriteresh lidhje, brenda kuadrit të së cilës bashkëshortët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të zgjedhjes. Ata mund të zgjedhin ndërmjet *lex nacionalis* të njërit prej tyre, ligjit të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit prej tyre dhe *lex rei sitae*. Lista e kriterëve të lidhje nuk është hirearkike, por është alternative, çka do të thotë që bashkëshortëve i është lënë e drejta e zgjedhjes së asaj alternative, e cila më mirë plotëson interesat e tyre pasurorë. Në këtë mënyrë kemi të bëjmë me një autonomi vullneti “*opcionale*”⁹⁰⁶, që lejon përzgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara nga ligji.

Natyrshëm lind pyetja se cila është ratio e kufizimit të së drejtës së zgjedhjes së legjislacionit të zbatueshëm në tre alternativat e mësipërme, si dhe cilat janë kriteret mbi bazën e të cilave ligjvënësi ka parashikuar këto tre alternativa dhe jo të tjera në vend të tyre.

Sipas doktrinës, e drejta zgjedhje së bashkëshortëve është e kufizuar në ato sisteme juridike, të cilat paraqesin lidhje të tilla me marrëdhënien martesore, aq sa të justifikojnë kompetencën e tyre në rregullimin e kësaj marrëdhënie⁹⁰⁷. Në përcaktimin e kriterëve të lidhjes, mbi bazën e të cilave bashkëshortët mund të bëjnë zgjedhjen e tyre, ligjvënësi është bazuar në parimin e afërsisë (*principe de proximité*) objektive⁹⁰⁸ të marrëdhënies bashkëshortore me një sistem juridik të caktuar. Edhe në rastin e mungesë së marrëveshjes për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, kriteret e lidhjes së përcaktuara nga legjislacioni – neni 23 ligjit DNP- janë të ndërtuara mbi bazën e parimit/kriterit të “afërsisë”. Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka evituar mundësinë e zgjedhjes nga bashkëshortët, të legjislacionit të një shteti, i cili paraqet lidhje të pakta ose nuk paraqet asnjë lidhje me marrëdhënien bashkëshortore, zgjedhja e cila mund të jetë abuzive, mund të realizohet me qëllim shmangien e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara⁹⁰⁹.

Duke qenë se në rastin e martesave ndërkombëtare, marrëdhënia martesore mund të paraqesë lidhje të ngushta me disa shtete të ndryshme, atëherë ligji ynë ka lejuar bashkëshortët të zgjedhin atë legjislacion që më mirë u përshtatet interesave të tyre.

B. Rendi publik (public policy). Një nga kufizimet më të rëndësishëm të zbatimit të ligjit të huaj në rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile me elementë të huaj është klauzola e rendit publik.

Klauzola e rendit publik ndalon zbatimin e atyre legjislacioneve të huaja (që thirren për zbatim nga normat e konfliktit), të cilat vijnë në kundërshtim me vlerat dhe parimet themelore të sistemit ligjor të “*lex forit*”⁹¹⁰, apo me vlerat dhe parimet ndërkombëtare⁹¹¹. Dispozitat që rregullojnë

⁹⁰⁶Anoveros Terrada, “La autonomia de la voluntad como principio rector de las normas de derecho internacional privado comunitario de la familia.” fq. 126.

⁹⁰⁷Viarengo, *Autonomia della volontà e rapporto patrimoniale tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 204.

⁹⁰⁸Anoveros Terrada, “La autonomía de la voluntad como principio rector de las normas de derecho internacional privado comunitario de la familia.” fq. 126.

⁹⁰⁹Zgjidhje të ngjashme evidentojmë edhe në pjesën më të madhe të legjislacioneve europiane, si psh: legjislacioni Italian (neni 30 i ligjit nr. 218/1995 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private), Gjerman (neni 15/3 EGBGB), spanjoll. Një zgjidhje të ngjashme vënë re edhe në Konvetën e Hagës së vitit 1978. Nga ana tjetër, e drejta Austriake (neni 19 i ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, 15 Qershor 1978) është akoma më liberale, pasi i lejon bashkëshortëve të zgjedhin pa asnjë kufizim ligjin e shtetit që atyre u duket më i përshtatshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore. Ndërsa shtetet e “common law” nuk kanë norma të posaçme konflikti për regjimin pasuror martesor dhe për rrjedhojë ato i nënshtrohen normave të konfliktit mbi pronësinë dhe kontratën, në përgjithësi. Si rrjedhojë autonomia e vullnetit të tyre në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm nuk i nënshtrohet kufizimeve të posaçme ligjore. Për këtë vështrim krahasues shih: Bonomi, Andrea. “Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare.” në *Les régimes matrimoniaux en droit compare et en droit international privé*, A. Bonomi, M. Steiner, Genève: Librairie Droz, 2006, fq.63-65.

⁹¹⁰Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 147.

⁹¹¹Martiny, Dieter. “Objectives and values of (private) international law in family law.” në *International family law for the European Union*, J. Meeusen, M. Pertegas, G. Straetmans, F. Swennen, Oxford: Intersentia, 2007, fq. 96.

rendin publik kanë **“karakter kombëtar”**, nuk ekziston një rend publik i njëjtë për të gjitha shtetet. Gjithashtu dispozitat e rendit publik kanë **“karakter relativ”**, brenda të njëjtit shtet përmbajtja e rendit publik ndryshon në kohë, në varësi të ndryshimit të ndryshimit të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, rendit juridik dhe atij politik⁹¹².

Është shumë e rëndësishme të bëjmë dallimin ndërmjet **“rendit publik”** dhe **“jus cogens”** (normat imperative) edhe pse shpesh të dy konceptet shihen si sinonime të njëri-tjetrit. Rendi publik është një kategori më e ngushtë se tërësia e normave imperative, në kuadër të të cilit përfshihen vetëm ato norma juridike, që mbrojnë vlerat themelore të sistemit juridik të **“lex fori”**⁹¹³.

Bazuar në nenin 7 të ligjit DNP, ligji i huaj nuk zbatohet kur efektet e zbatimit të tij janë dukshëm në kundërshtim me rendin publik apo mund të sjellin pasoja, të cilat janë haptazi të papajtueshme me parimet themelore, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin shqiptar. Në rast papajtueshmëri zbatohet një dispozitë tjetër e përshtatshme, që i përket së drejtës së shtetit të huaj dhe, kur ajo mungon, zbatohet ligji shqiptar. Kjo do të thotë që, funksioni juridik i rendit publik është ndryshimi i kriterit të lidhjes, mbi bazën e të cilit thirret për zbatim e drejta e huaj.

Verifikimi i përputhshmërisë ndërmjet parimeve themelore Kushtetuese dhe ligjore, të cilat përbëjnë rendin publik të brendshëm dhe ligjit të huaj, që thirret për zbatim do të realizohet mbi bazën e dy pikave të referimit: a) mbizotërimi i interesit të familjes dhe b) garantimi i barazisë ndërmjet bashkëshortëve.

Në aspektin e regjimit primar, përputhshmëria e ligjit të huaj të thirrur për zbatim me parimin e rendit publik duhet të verifikohet mbi bazën e parimit të përgjegjësisë së përbashkët për kontributin material për nevojat e familjes dhe parimit të marrëveshjes së përbashkët në mbarëvajtjen e jetës familjare.

Mbi bazën e këtyre parimeve do të jenë në kundërshtim me rendin tonë publik, të gjitha ato norma të huaja, të cilat parashikojnë detyrimin vetëm të njërit bashkëshort për kontributin material për nevojat e familjes, të fëmijë dhe bashkëshortit tjetër, duke përjashtuar këtë të fundit nga çdo detyrim⁹¹⁴.

Vlerësimi i përputhjes së ligjit të huaj të thirrur për zbatim me parimet rregulluese të regjimit primar, duhet të realizohet në mënyrë tepër rigoroze, për shkak se në bazë të normave të regjimit primar qëndron interesi i familjes.

Ndërsa, nga ana tjetër, në aspektin e regjimit sekondar, vlerësimi i parimit të rendit publik, duhet të realizohet në mënyrë më tolerante, në krahasim me regjimin sekondar, duke pasur parasysh faktin që, regjimi primar bazohet jo mbi interesat e familjes, por mbi interesat pasurorë të bashkëshortëve. Megjithatë, në lidhje me regjimin sekondar, neni 67 i kod.fam. përbën një klauzolë të rendit publik, vlerësimi i përputhshmërisë të së cilës me ligjin e huaj që thirret për zbatim, duhet të realizohet në mënyrë rigoroze.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, bashkëshortët nuk mund të zgjedhin për zbatim, megjithëse brenda kriteve të lidhjes së parashikuara nga neni 24.2 i ligjit DNP, atë legjislacion të huaj, i cili është haptazi në kundërshtim me rendin publik, pra me nenin 67 të kod.fam., apo kur pasojat e tij janë haptazi të papajtueshme me parimet themelore të parashikuara në Kushtetutën e RSH dhe në ligj. Në këtë rast, legjislacioni që do të shërbejë si bazë për vlerësimin e pajtueshmërisë së ligjit të zgjedhur për zbatim me rendin juridik shqiptar, përveç Kushtetutës, e

⁹¹² Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 101.

⁹¹³ Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 102-103.

⁹¹⁴ Kujtojmë këtu që, kontributi i përbashkët i bashkëshortëve në nevojat e familjes, sipas kod.fam. realizohet bashkërisht nga të dy bashkëshortët, në përputhje me mundësitë dhe aftësitë e secilit prej tyre. Bazuar në nenin 54 të kod.fam. çdo marrëveshje në bazë të së cilës bashkëshortet përjashtojnë përgjegjësinë e njërit apo të dyve në përmbushjen e kontributit material për nevojat e familjes, është e pavlefshme.

cila është përmendur shprehimisht në tekstin e nenit 7 të ligjit DNP, do të jetë kod.fam. dhe kod.civ.

Në rast të papajtueshmërisë së ligjit të zgjedhur nga palët me rendin publik shqiptar, atëherë bazuar në nenin 7 të ligjit DNP do të gjejë zbatim një dispozitë tjetër e përshtatshme e ligjit të huaj dhe në mungesë të saj ligji shqiptar.

Jemi të mendimit që, në rastin konkret në hipotezën e papajtueshmërisë së ligjit të zgjedhur nga palët me rendin publik shqiptar, ligji i huaj, i zgjedhur nga palët nuk do të gjejë zbatim, por do të thirret për zbatim norma e konfliktit, e cila zbatohet në mungesë të marrëveshjes së palëve, pra do të thirret për zbatim neni 23 i ligjit DNP. Vetëm, në hipotezën kur ligji i thirru për zbatim mbi bazën e kritereve të parashikuara nga neni 23 i ligjit për DNP është edhe ai i papajtueshëm me rendin publik shqiptar, atëherë do të zbatohet ligji shqiptar.

Në analizë të fundit, duhet pohuar që, në momentin e hartimit të kontratës martesore është i vështirë identifikimi paraprak dhe abstrakt i tyre dispozitave të ligjit të huaj, të zgjedhur për zbatim, që janë në kundërshtim me rendin publik, aq më tepër që, koncepti i rendit publik është i karakterizuar nga relativiteti në kohë, relativitet i shkaktuar nga evoluimi i kontekstit etiko-social. Për këto arsye është e nevojshme, që t'i lihet gjyqtarit një marzh relativisht i gjerë veprimi në vlerësimin e përputhshmërisë së ligjit të huaj me rendin publik shqiptar⁹¹⁵, në varësi të rastit konkret (rast pas rasti).⁹¹⁶

C. Normat e pashmangshme të lex forit. Me norma imperative do të kuptojmë ato norma, që reflektojnë disa vlera, të cilat konsiderohen si vlera themelore për një sistem juridik të caktuar.

Në kuadrin e regjimit pasuror martesor, me norma të pashmangshme të *lex forit* do të kuptojmë atë kategori dispozitash të kod.fam, të cilat parashikojnë të drejta dhe detyrime të cilat bashkëshortët nuk mund t'i shmangin me marrëveshje ndërmjet tyre.

Në parim, në hipotezën kur bashkëshortët kanë zgjedhur zbatim legjislacionin e një shteti tjetër dhe ajo atij shqiptar, brenda limiteve të parashikuara nga neni 24.2 të ligjit DNP, ose kriteret e lidhjes së parashikuar në nenin 23, referojnë në zbatimin e ligjit të një shteti tjetër dhe jo të atij shqiptar, normat e pashmangshme të parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kod.fam) nuk veprojnë më për këta bashkëshortë. Megjithatë normat e pashmangshme, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kod.fam.), do të veprojnë edhe në hipotezën kur regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet nga ligji i një shteti tjetër, vetëm në hipotezën kur këto norma përfshihen në parimin e rendit publik⁹¹⁷.

D. Mashtrimi i ligji. Me mashtrim në kuptimin “*sticto sensu*” kuptojmë në manipulimin e kritereve të lidhjes, në mënyrë që të thirret për zbatim një legjislacion që nuk paraqet lidhje me marrëdhënien bashkëshortore, duke konsistuar në një shmangie nga parimi i “*afërsisë*”⁹¹⁸.

⁹¹⁵ Në këtë mënyrë, është gjyqtari që do të vlerësojë rast pas rasti përputhshmërinë e ligjit të thirru për zbatim nga normat e konfliktit me parimet themelore të së drejtës dhe në veçanti të së drejtës familjare të *lex forit*. Nëse normat e ligjit të huaj të thirru për zbatim vijnë në kundërshtim me këto vlera dhe parime, atëherë gjyqtari ka për detyrë të kërkojë të tjera norma brenda të njejtit sistem ligjor dhe në pamundësi të tyre, ligji i zbatueshëm do të jetë *lex fori*.

⁹¹⁶ Cardillo, Franco S. “Rapporti patrimoniali tra coniugi nel nuovo diritto internazionale privato e riflessi sull’attività notarile.” në *Rivista del Notariato, Rassegna di diritto e pratica notarile*, Vol. L-1996, Milano: Giuffrè Editore, 1996, fq. 183; Cardillo, Franco S. *Regime patrimoniale tra coniugi nel diritto internazionale private italiano, Sintesi della normative dei principali paesi europei*. Collana studi nr.12 del consiglio nazionale del notariato. Milano: Giuffrè Editore, 1998.

⁹¹⁷ De Nova, “Disciplina inderogabile dei rapporti patrimoniali e autonomia negoziale.” fq. 262; Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 138-139.

⁹¹⁸ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq.102.

Mashtrimin e ligjit në të drejtën ndërkombëtare private e ndeshim në hipotezën kur palët (në rastin konkret bashkëshortët), ndryshojnë një nga kriteret e lidhjes, si psh. vendqëndrimin e zakonshëm apo shtetësinë e tyre, në mënyrë që të bëjnë të mundur shmangien e zbatimit të legjislacionit të një shteti, që në mungesë të këtij ndryshimi do të ishte kompetent për rregullimin e marrëdhënies juridike (në rastin konkret, regjimit pasuror) me qëllim mosrespektimin e normave imperative të këtij sistemi ligjor, ose në mënyrë që të mund të zgjedhin legjislacionin e sistemit juridik të shtetit të ri (shtetësinë e të cilit kanë fituar apo në të cilin kanë vendosur rishtazi vendqëndrimin e zakonshëm), që në mungesë të këtij ndryshimit nuk do të mund të zgjidhnin, për shkak të kufizimeve të parashikuara nga paragrafi i dytë i nenit 24 të ligjit DNP⁹¹⁹. Në të drejtën ndërkombëtare private rastet e mashtrimit të ligjit më së shumti vihen re në lëmin e së drejtës familjare dhe më konkretisht në kuadrin e martesës me elementë të huaj⁹²⁰.

Që të jemi përpara mashtrimit të ligjit duhen plotësuar në mënyrë kumulative dy elementë⁹²¹:

- a) **Elementi objektiv** – ndryshimi, nëpërmjet mjeteve ligjore, i kriterit të lidhjes që çon në zbatimin e së drejtës së huaj, zbatimi i së cilës kërkohet të shmanget;
- b) **Elementi subjektiv** – qëllimi i bashkëshortëve për të shmangur zbatimin e normave të së drejtës materiale, tek zbatimi i të cilave referojnë normat e konfliktit.

Në praktikë është mjaft e vështirë për të konstatuar mashtrimin e ligjit, pasi realizohet si rezultat i një marrëveshje të fshehtë mes palëve.

Në përfundim, është e rëndësishme të bëjmë dallimin ndërmjet **“mashtrimit të ligjit”** dhe **“rendit publik”**, megjithëse, në të dyja rastet pasoja është ajo e moszbatimit të së drejtës së huaj, në të cilën çojnë për zbatim normat e konfliktit. Gjykata do të verifikojë mashtrimin e ligjit vetëm në rastin kur është shmangur zbatimi i së drejtës materiale të *“lex forit”*. Në hipotezën e mashtrimit të ligjit nuk janë të cenuara vlerat themelore të një rendi juridik të caktuar⁹²².

6.5. Përcaktimi me marrëveshje i ligjit të zbatueshëm

Neni 23 dhe 24 i ligjit DNP përbëjnë së bashku kuadrin ligjor, mbi bazën e të cilit përcaktohet legjislacioni i zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, në eventualitetin e martesës me elementë të huaj.

A. Fusha materiale e zbatimit të nenit 24. Ligji i ri DNP, në ndryshim nga legjislacioni i mëparshëm⁹²³, nuk mbështet mbi parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi të gjitha pasojat e martesës (marrëdhëniet personale dhe ato pasurore të bashkëshortëve), në hipotezën kur ata kanë përcaktuar me marrëveshje legjislacionin e zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror. Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë unitar, vetëm në hipotezën e mungesës e marrëveshjes së bashkëshortëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm.

Kështu, në hipotezën kur bashkëshortët me marrëveshje kanë përcaktuar legjislacionin e zbatueshëm, marrëdhëniet pasurore dhe ato personale do të rregullohen nga legjislacione të

⁹¹⁹ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq.101-102.

⁹²⁰ Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 109.

⁹²¹ Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 110.

⁹²² Për këtë dallim shih: Kuçi dhe Bilalli, *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*, fq. 114.

⁹²³ Ky problem klasifikimi nuk shtrohej për zgjidhje në ligjin e mëparshëm të vitit 1964, për shkak se ky legjislacion parashikonte parimin unitar të ligjit të zbatueshëm si për marrëdhëniet pasurore ashtu dhe për ato personale jopasurore. Në këtë mënyrë marrëdhëniet pasurore dhe ato personale ndërmjet bashkëshortëve, bazuar në nenin 8 të ligjit të vitit 1964 rregulloheshin nga ligji i shtetësisë së përbashkët të të dy bashkëshortëve dhe në rastin e mungesës së shtetësisë së përbashkët nga ligji shqiptar. Në kohën e miratimit të ligjit të vitit 1964, pjesa më e madhe e shteteve europiane parashikonin kriterin e “lex nationalis” në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm për marrëdhëniet personale dhe pasurore ndërmjet bashkëshortëve. Këto legjislacione i janë nënshtruar reformimit në 20-30 vitet e fundit, nën modelin e Konventës së Hagës, së vitit 1978.

ndryshme, të parat nga ligji i zgjedhur nga bashkëshortët, brenda kufijve të parashikuar nga neni 24 i ligjit DNP dhe të dytat nga ligji i përcaktuar sipas kritereve të lidhjes së nenit 23 të ligjit DNP.

Në këtë pikë të punimit, problemi që lind natyrshëm është ai i përcaktimit të kuptimit që neni 24 i ligjit DNP i jep “*regjimit pasuror martesor*”, nëse në të përfshihet regjimi pasuror në kuptimin e ngushtë të fjalës, elementi kontributiv i tij (regjimi sekondar), apo regjimi pasuror në kuptimin e gjerë të fjalës, elementi distributiv (regjimi sekondar) së bashku me atë kontributiv (regjimi primar)⁹²⁴.

Në lidhje me të drejtën e brendshme, doktrina juridike e vendeve të ndryshme mban qëndrime të ndryshme në lidhje me kuptimin e regjimit pasuror dhe me klasifikimin e regjimit primar në kategorinë e të parit apo në kategorinë e marrëdhënies personale të bashkëshortëve. Kujtojmë këtu që doktrina juridike italiane dhe franceze bëjnë një klasifikim të regjimit pasuror martesor në këto dy kategori: a) regjimi primar (elementi kontributiv i regjimit pasuror): tërësia e normave ligjore, që kanë për qëllim garantimin e kontributit të çdo bashkëshorti në familje dhe në mbarëvajtjen e jetës së përbashkët; b) regjimi sekondar (elementi distributiv i regjimit pasuror): tërësia e normave ligjore që kanë për objekt rregullimin e titullarit, administrimit dhe gëzimit të pasurisë së fituar gjatë martesës.

Tani është e nevojshme paraqitja e kësaj analizë në këndvështrimin e nenit 24 të ligjit për DNP. Në mungesë të praktikës gjyqësore, diskutimi ynë do të mbështetet në mendimin doktrinal të disa prej shteteve të familjes ligjore romano-gjermanike.

Sipas një qëndrimi të doktrinës, regjimi primar i familjes nuk mund të përfshihet në objektin material të rregullimit të nenit 24 të ligjit DNP, sepse neni 24 parashikon parimin e *optio legis*, parimi i cili bie në kundërshtim me karakterin e pashmangshëm të regjimit primar. Karakteri i pashmangshëm i normave të regjimit primar, të cilat janë norma të rendit publik, qëllimi i të cilave është mbrojtja e interesave të grupit familjar, nuk është në përputhje me rregullimin ligjor të nenit 24 të ligjit DNP, që i lejon palëve nëpërmjet mekanizmit të *optio legis*, shmangien e rregullimit të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 24⁹²⁵. Këtë qëndrim mban edhe doktrina franceze, sipas së cilës, rregullat e regjimit primar konsiderohen “*loi de police*” dhe për rrjedhojë ligji i zbatueshëm në rregullimin e regjimit primar është *lex fori* dhe jo ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor. Ky është qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Franceze e Kasacionit në vendimin e 20 Tetorit të vitit 1987⁹²⁶.

Por, duke qenë se rregullimi i marrëdhënies të bashkëshortëve në ligjin e ri DNP nuk jep shumë alternativa për kategorizimin e regjimit primar, për shkak se klasifikon marrëdhëniet e bashkëshortëve në dy kategori: marrëdhëniet personale (neni 23) ndërmjet bashkëshortëve dhe regjimi pasuror martesor (neni 24); *tertium non datur*, atëherë regjimi primar i familjes do të përfshihet në fushën materiale të zbatimit të nenit 23 të ligjit DNP.

Nga ana tjetër, të tjerë autorë janë të mendimit, që në fushën materiale të zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP, do të përfshihet regjimi pasuror në “*lato sensu*”, si regjimi primar (kontributiv), që ka për qëllim garantimin e plotësimit të nevojave të familjes dhe regjimi sekondar (distributiv),

⁹²⁴ Nuk ka një koncept unik e të dhënë një herë e përgjithmonë për regjimin pasuror martesor. Megjithatë legjislacione të ndryshme japin përkufizime të ndryshme mbi regjimin pasuror martesor, elementi, që karakterizon të gjitha legjislacionet është karakteri pasuror i regjimit pasuror martesor. Shih: Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 62.

⁹²⁵ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 146-147.

⁹²⁶ Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq. 85.

ka për qëllim mbrojtjen e interesave pasurorë të bashkëshortëve⁹²⁷, bazuar në dy argumente kryesore:

- a) *Së pari*, regjimi primar dhe ai sekondar kanë karakter pasuror, objekti i rregullimit të tyre janë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve dhe për këtë arsye nuk ka kuptim klasifikimi i një instituti me përmbajtje pasurore në kategorinë e marrëdhënieve personale të bashkëshortëve. Në bazë të këtij argumenti kemi probleme në kategorizimin e regjimit primar në kategorinë e marrëdhënieve personale të bashkëshortëve;
- b) *Së dyti*, nëse do të pranohet teorinë që vendos regjimin primar në fushën e zbatimit të nenit 23 të ligjit DNP, atëherë në hipotezën kur bashkëshortët me marrëveshje ndërmjet tyre zgjedhin për zbatim një ligj të ndryshëm nga ai që zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve personale të tyre, do të arrinin në përfundimin që regjimi primar dhe ai sekondar do të rregulloheshin nga legjislacione të ndryshme, çka është një përfundim jo i logjikshëm. Ky fragmentarizmi i legjislacionit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit primar dhe atij sekondar rezulton jo i mundshëm nga pikëpamja logjike dhe praktike⁹²⁸. Regjimi primar është i lidhur ngushtësisht me atë sekondar, i pari përbën kufijtë e veprimit të të dytit dhe për rrjedhojë është jo vetëm praktikisht e pamundur, por edhe konceptualisht e gabuar të pohojmë që për rregullimin e tyre të zbatohen legjislacione të ndryshme.

Në analizë të fundit, duke përmbledhur të gjitha argumentet e parashtruara më sipër, mund të pohojmë, që në fushën e zbatimit të nenit 24 të kod.fam. nuk do të përfshihet regjimi primar, sepse ky regjim është i rregulluar nga ligji me norma urdhëruese, të cilat janë të pashmangshme në marrëveshje ndërmjet palëve. Përfshirja e regjimit primar në fushën e zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP do të nënkuptonte dhënien e mundësisë bashkëshortëve për të shmangur zbatimin e këtyre normave, nëpërmjet zgjedhjes për zbatim të një ligji tjetër. Në vijim, ligji i zbatueshëm për regjimin primar të familjes do të përcaktohet mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes, të përcaktuar në nenin 23 të ligjit DNP.

Në fushën e zbatimit të nenit 24 përfshihen si regjimi pasuror ligjor, ashtu edhe kontrata martesore dhe regjimet pasurore kontraktore, si dhe mekanizmi i kalimit nga regjimi ligjor në atë kontraktor, për rrjedhojë në këtë normë do të përfshihet edhe mundësia e bashkëshortëve (e cila rregullohet nga ligji i zbatueshëm që kriteret e kësaj norme referojnë) për të ndryshuar apo modifikuar regjimin pasuror, *constante matrimonii*⁹²⁹. Në parim, në fushën materiale të zbatimit të nenit 24 të kod.fam. përfshihen të gjitha aspektet e regjimit pasuror martesor duke përfshirë këtu përbërjen e aktivitetit dhe pasivitetit të pasurisë së përbashkët, masës e pasurisë vetjake të çdo bashkëshorti, regjimin e përmbushjes së detyrimeve të bashkësisë ndaj të tretëve, regjimin juridik të administrimit të pasurisë së përbashkët dhe asaj vetjake, rastet e modifikimit të regjimit pasuror martesor⁹³⁰, rastet e mbarimit të regjimit pasuror martesor si dhe likuidimin e tij⁹³¹.

Kontrata martesore do të përfshihet, gjithashtu, në fushën e zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP.

Në fushën e zbatimit të nenit 24 do të përfshihen edhe pasojat pasurore të martesës putative⁹³². Martesa putative është një fiksjon i parashikuar nga ligji (kod.fam.), fiksjon, i cili ka për qëllim moszbatimin e fuqisë prapavepruese të vendimit të pavlefshmërisë së martesës.

Duke qenë se legjislacioni për të drejtën ndërkombëtare private nuk përmban një disiplinë unitare për martesën si veprim juridik dhe si marrëdhënie juridike, por përmban rregullime të

⁹²⁷ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*; Pérez, Hélèn. dhe Fongaro, Enric. *Droit intenational privé patrimonial de la famille*. Collection de l'Institut National de Formation Notarile. Paris: Litec, 2010.

⁹²⁸ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 144.

⁹²⁹ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 130.

⁹³⁰ Batiffol dhe Lagarde, *Droit International Privé*, fq. 379.

⁹³¹ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 129.

⁹³² Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 131-132.

ndryshme, atëherë disiplina rregulluese për kushte e pavlefshmërinë së martesës do të jetë ë ndryshme nga ajo që rregullon pasojat pasurore të martesës putative. Nëse kriteret e pavlefshmërisë së martesës përfshihen në sferën materiale të zbatimit të nenit 21 të kod.fam, që rregulloj kushtet e lidhjes së martesës, pasojat pasurore të martesës putative do të përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 24 të kod.fam.

Do të përfshihen, gjithashtu në fushën e zbatimit të nenit 24 të ligjit, mbarimi i regjimit pasuror martesor, si rastet e mbarimit ashtu dhe pasojat që sjell mbarimi i regjimit pasuror martesor, si dhe likuidimi i regjimit pasuror martesor⁹³³.

Përfshihen nga fusha e zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP: detyrimi për ushqim ndërmjet bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, marrëdhëniet pasurore ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, detyrimi i mbështetjes materiale të prindërve ndaj fëmijëve, megjithëse në mënyrë jo të saktë është përfshirë nga kod.fam në kategorinë e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë (neni 53) e drejta e trashëgimisë së bashkëshortit pasjetues, sepse janë marrëdhëniet që, së pari nuk përfshihen në kuadrin e regjimit pasuror martesor dhe së dyti, rregullohen nga norma të tjera të ligjit DNP.

Nuk përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 24, gjithashtu marrëdhëniet pasurore ndërmjet ish-bashkëshortëve (pasojat pasurore që sjell zgjidhja e martesës) si: detyrimi për ushqim, kontributi kompensues dhe e drejta e përdorimit të banesës. Kjo është e kuptueshme, sepse bëhet fjalë për marrëdhënie pasurore, që nuk kanë lidhje me jetën e përbashkët bashkëshortore.

Duke dashur të japim një argument më shumë, është e drejtë të pohojmë që, tërësia e të drejtave dhe detyrimeve që zbatohen ndërmjet bashkëshortëve, pas zgjidhjes së martesës, nuk përfshihen në kuadrin e regjimit pasuror martesor dhe për rrjedhojë nuk janë objekti i zbatimit të normës në fjalë. Marrëdhëniet pasurore, që parashikohen për bashkëshortët pas zgjidhjes së martesës, do të jenë objekti i rregullimit të normës së ligjit DNP, që rregullon ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e martesës (neni 25 i ligjit), me përjashtim të detyrimit për ushqim, i cili gjen një rregullim të posaçëm në nenin 26 të ligjit DNP.

Gjithashtu, nuk përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP të drejtat e trashëgimisë së bashkëshortit të pasjetues mbi pasurinë (pjesë e së cilës është pasuria në bashkësi) e bashkëshortit të vdekur⁹³⁴. Megjithëse, ekziston një lidhje e ngushtë ndërmjet regjimit pasuror martesor dhe trashëgimisë, lidhje që rrjedh nga varësia ndërmjet së drejtës mbi pasurisë trashëgimore dhe së drejtës së pronësisë mbi ½ pjesë të pasurisë së bashkësisë së bashkëshortit pasjetues mbi pasurisë e bashkëshortit të vdekur, e drejta e trashëgimisë nuk mund të përfshihet në konceptin e regjimit pasuror martesor si dhe nuk mund të jetë objekt i marrëveshjes ndërmjet bashkëshortëve.⁹³⁵ Legjislacioni që rregullon trashëgiminë do të rregullojë: të drejtën për të trashëguar dhe pjesën takuese mbi pasurinë trashëgimore të bashkëshortit pasjetues, modalitetet e likuidimit të kësaj pasurie dhe çdo marrëdhënie tjetër që rrjedh nga statusi i bashkëshortit pasjetues.

Nuk përfshihen në objektin e zbatimit të nenit 23 të ligjit DNP dhurimet ndërmjet bashkëshortëve, gjatë martesës. Për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për dhurimet ndërmjet bashkëshortëve do të zbatohen kriteret e lidhjes, që shërbejnë për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm të kontratave.

B. Fusha personale e zbatimit të normës së konfliktit (nenit 24). Neni 24 i ligjit DNP gjen zbatim vetëm për personat e lidhur në martesë, bashkëshortët. Në hipotezën kur marrëveshja për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror martesor lidhet

⁹³³ Caravaca dhe Gonzalez, *Derecho interbazonal Privado. Vol. II*, fq. 148.

⁹³⁴ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 135-136.

⁹³⁵ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 66.

nga bashkëshortët e ardhshëm, para lidhjes së martesës, kjo marrëveshje do të sjellë pasoja vetëm nëse martesë lidhet. Martesa përfaqëson një *conditio juris* për marrëveshjen e përcaktimit të legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 24 i ligjit DNP nuk mund të gjejë zbatim për bashkëjetuesit *more uxorio* (personat që bashkëjetojnë pa lidhur martesë). Marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëjetuesve *more uxorio* në lidhje me përcaktimin e legjislacionit zbatueshëm do të rregullohen mbi bazën e normave të konfliktit të së drejtës së pronësisë, kontratave dhe detyrimeve jashtëkontraktore, në varësi të marrëdhënies konkrete që krijohet ndërmjet bashkëjetuesve⁹³⁶.

Ashtu siç u përmend *ut supra*, nuk përfshihen gjithashtu në fushën personale të zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP personat që kanë zgjidhur martesës.

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, mund të pohojmë që në fushën personale të zbatimit të nenit 24 të ligjit DNP përfshihen vetëm personat që gëzojnë statusin e bashkëshortit të ardhshëm (lidhja e martesës përfaqëson një *condicio juris* për marrëveshjen e përcaktimit të legjislacionit të zbatueshëm) dhe personat që gëzojnë statusin e bashkëshortit (në hipotezën kur legjislacioni i zbatueshëm ndryshon gjatë martesës).

6.6. Marrëveshja e bashkëshortëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm “*Pactum de lege utenda*”

Bazuar në paragrafin e dytë të nenit 24 të ligjit DNP, instrumenti nëpërmjet së cilit bashkëshortët në funksion të ushtrimit të autonomisë së dhënë nga ligji, përcaktojnë ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor është “marrëveshja”, e njohur në doktrinë me termin “*pactum de lege utenda*”.

6.6.1. Natyra juridike e “*pactum de lege utenda*”

Debate të shumta në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare private ekzistojnë rreth natyrës juridike dhe për rrjedhojë kategorizimit të *pactum de lege utenda*⁹³⁷: nëse marrëveshja do të konsiderohet “kontratë martesore”, si shprehje e vullnetit të palëve për vetërregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore; apo një kategori më vetë, e cila ka natyrën e veprimit juridik, por është një kategori më vete në raport me kontratën martesore⁹³⁸.

A. Sipas një grupi autorësh, marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm luan rol vetëm në kuadër të së drejtës ndërkombëtare private dhe në këtë drejtim **ka natyrën juridike të një norme konflikti**, funksioni i së cilës është funksioni që ka çdo normë tjetër konflikti, ai i përcaktimit të ligjit të zbatueshëm për rregullimin e një marrëdhënie juridike civile me elementë të huaj (në rastin konkret të regjimit pasuror martesor)⁹³⁹. Në gjirin e autorëve që mbështesin këtë teori, ka nga ata autorë të cilët jo vetëm mohojnë përfshirjen e marrëveshjes për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm në kategorinë e kontratës martesore, por gjithashtu e kategorizojnë këtë

⁹³⁶ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 70.

⁹³⁷ Për më shumë, mbi debatin doktrinal në lidhje me natyrën juridike të marrëveshjes për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, shih: Cardillo, Franco S. *La forma dell'accordo di scelta della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi (art.30 legge 218/1995)*. Consiglio Nazionale del notariato, Studio 05.09.46/EU, Approvato dalla Commissione Affari Europei e Internazionali il 10 settembre 2005. <http://www.notariato.it/it/primopiano/studi-materiali>. (konsultuar në 04.03.2013), fq. 5.

⁹³⁸ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 207.

⁹³⁹ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 207; Carella, Gabriella. *Autonomia della volonta e scelta di legge nel diritto internazionale privato*. Bari: Cacucci Editore, 1999, fq. 166-167.

marrëveshje në grupin e veprimeve juridike të njëanshme⁹⁴⁰. Ndërsa të tjerë autorë, megjithëse përjashtojnë *pactum de lege utenda* nga kategoria e kontratës martesore, i njohin marrëveshjes natyrën juridike të veprimit juridik të dyanshëm⁹⁴¹.

Përgjithësisht në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare private mbizotëron mendimi që, është e nevojshme bërja e dallimit ndërmjet *pactum de lege utenda*, si një shprehje vullneti në funksion të përcaktimit të kriterëve të lidhjes⁹⁴², në raport me kontratën martesore, si një instrument juridik, funksioni i së cilës është rregullimi i aspektit substancial të regjimit pasuror, mbi bazën e legjislacionit të zgjedhur për zbatim⁹⁴³. Në mbështetje të këtij qëndrimi, një tjetër autor shprehet që, *pactum de lege utenda* nuk ka natyrën juridike të kontratës martesore, pavarësisht se në praktikë të dyja këto veprime juridike gjenden të pasqyruara në një dokument të vetëm, atë të kontratës martesore⁹⁴⁴.

B. Ndërsa doktrina juridike e viteve të fundit është shprehur në drejtim të vendosjes së *shenjave të barazisë ndërmjet pactum de lege utenda dhe kontratës martesore*. Në këtë drejtim, është pohuar që, megjithëse konceptualisht *pactum de lege utenda* dhe kontrata martesore janë dy kategori të ndryshme, nga ana tjetër *pactum de lege utenda* është analoge me kontratën martesore për sa i përket thelbit dhe efekteve që sjell (pasojave që prodhon)⁹⁴⁵.

Sipas një autori, të pohosh që, *pactum de lege utenda* nuk ka natyrën juridike të kontratës martesore, nuk është e saktë. Është e pamohueshme, sipas tij që, e para (*pactum de lege utenda*) është pjesë thelbësore e kontratës martesore, e cila rregullon në mënyrë të plotë marrëdhëniet ekonomike të bashkësisë familjare⁹⁴⁶. Në vazhdim të këtij mendimi, në hipotezën e dy bashkëshortëve shqiptarë me rezidencë të zakonshme në shtetin italian apo atë francez, të cilët dëshirojnë të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore, nëpërmjet instrumentit të kontratës martesore, zgjedhja e ligjit të zbatueshëm do të jetë parakushti i rregullimit të regjimit pasuror martesor, do të përfaqësojë klauzolën e parë të kontratës martesore⁹⁴⁷.

C. Sipas një tjetër mendimi doktrinal, i cili *kombinon qëndrimet e kundërta* të dy doktrinave të parashtruara më sipër, nëse nga njëra anë është i drejtë qëndrimi mbizotërues i doktrinës të së drejtës ndërkombëtare private që i njej *pactum de lege utenda* natyrën juridike të normës së konfliktit; nga ana tjetër, është e pamohueshme që në ndryshim nga normat e tjera të konfliktit, për *pactum de lege utenda* shtrohet më tej problemi i përcaktimit të kushteve të vlefshmërisë (formale dhe materiale) të marrëveshjes⁹⁴⁸. Në vijim të këtyre opinioneve, sipas një tjetër autori, *pactum de lege utenda*, në kategorinë e marrëdhënieve jashtëkontraktore, përfaqëson një veprim juridik me funksion konfliktual⁹⁴⁹ (kryen funksionin e një normë

⁹⁴⁰ Carella, *Autonomia della volonta e scelta di legge nel diritto internazionale privato*, fq. 166-167.

⁹⁴¹ Viarengo, Ilaria, Problemi di individuazione della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi e ruolo della volonta delle parti, në *Rivista del Notariato, Rassegna di diritto e pratica notarile, Volume LIV - Luglio-Agosto 2000*, Giuffrè Ed., Milano, 2000, fq. 1149; Viarengo, *Autonomia della volonta e rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 208-209.

⁹⁴² Ky grup autorësh, që përfaqësojnë mendimin doktrinal mbizotërues, i njohin *pactum de lege utenda* natyrën juridike të normës së konfliktit.

⁹⁴³ Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq. 48.

⁹⁴⁴ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 57-58.

⁹⁴⁵ De Paola, Vincenzo. *Il diritto patrimoniale della famiglia nel sistema del diritto privato. I*. Milano: Giuffrè Editore, 2002, fq. 101.

⁹⁴⁶ Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq.49.

⁹⁴⁷ Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq.49.

⁹⁴⁸ Cardillo, *La forma dell'accordo di scelta della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi (art.30 legge 218/1995)*, fq. 6.

⁹⁴⁹ Carella, *Autonomia della volonta e scelta di legge nel diritto internazionale privato*, fq. 211.

konflikti). Në vazhdim të të njëjtit qëndrim, *pactum de lege utenda* është veprim juridik i dyanshëm, por nuk mund të klasifikohet në kategorinë e kontratës. Për rrjedhojë, kushtet e vlefshmërisë së marrëveshjes do të gjenden në disiplinën juridike materiale të veprimit juridik, të legjislacionit kompetent dhe jo në disiplinën juridike të kontratës martesore⁹⁵⁰.

Në analizë të fundit, jemi të mendimit që është e nevojshme realizimi i dallimit ndërmjet kontratës martesore në të drejtën substanciale (të cilën e kemi trajtuar deri tani dhe që gjen rregullim në normat e kod.fam) dhe kontratës martesore në të drejtën ndërkombëtare private, atë që doktrina e emëron si "*pactum de lege utenda*", e cila përfaqëson marrëveshjen, që ka për objekt përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve (neni 24.2 i DNP).

Kontrata martesore dhe *pactum de lege utenda*, janë dy institute juridike autonome ndërmjet tyre, sepse objekti i rregullimit të tyre është i ndryshëm dhe për rrjedhojë edhe regjimi juridik që do t'i zbatohet kushteve të vlefshmërisë së tyre do të jetë i ndryshëm, megjithëse në praktikë, zakonisht gjenden të pasqyruara në një dokument të vetëm⁹⁵¹. Të rralla janë rastet në praktikë, kur bashkëshortët mjaftohen vetëm me zgjedhjen e ligjit zbatueshëm mbi regjimin pasuror, pa rregulluar njëkohësisht këtë regjimi, brenda kufijve të lejuara nga legjislacioni i zgjedhur prej tyre.

Pavarësisht se kontrata martesore dhe *pactum de lege utenda* u përkasin dy kategorive të ndryshme, ekzistojnë disa ngjashmëri ndërmjet tyre:

a) Në të dy rastet objekti i rregullimit të tyre i referohet marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, në fakt ligji i zbatueshëm mbi marrëdhëniet personale jopasurore, përcaktohet mbi bazën e kritereve objektive të lidhjes, të parashikuar në nenin 23 të ligjit DNP;

b) Në të dy rastet realizohet një rregullim programatik, i ardhshëm i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, duke penguar zbatimin e regjimit ligjor të legjislacionit, në të cilin do të çonin kriteret objektive të lidhjes (neni 23 i ligjit DNP), në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve.

c) Ashtu si për kontratën martesore, edhe për *pactum de lege utenda* ligji përcakton disa kondita vlefshmërie, me qëllim mbrojtjen e bashkëshortëve, si psh; forma noteriale e kërkuar nga neni 24 i ligjit DNP.

6.6.2. Kushtet thelbësore dhe karakteristikat e *pactum de lege utenda*

Në nenin 24 të ligjit DNP nuk gjejmë asnjë referim të shprehur mbi ligjin e zbatueshëm për kushtet e vlefshmërisë së marrëveshjes për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm. Lind pyetja, se cili do të jetë legjislacioni, që do të rregullojë kushtet e vlefshmërisë së marrëveshjes.

Nisur nga përfundimi i arritur më sipër mbi kategorizimin e *pactum de lege utenda* jo në kategorinë e kontratës martesore, por në kategorinë e përgjithshme të veprimeve juridike⁹⁵², mund të pohojmë që, kushtet materiale dhe formale të vlefshmërisë së *pactum de lege utenda* do të përcaktohen mbi bazën e kushteve thelbësore të vlefshmërisë së veprimit juridik në përgjithësi, të përcaktuara nga legjislacioni që është kompetent për rregullimin e *pactum de lege utenda* dhe jo mbi bazën e kushteve të vlefshmërisë së kontratës martesore të parashikuara nga ky legjislacion, madje mund të jenë të ndryshme nga këto të fundit⁹⁵³. Gjithashtu, kushtet formale të

⁹⁵⁰ Carella, *Autonomia della volonta e scelta di legge nel diritto internazionale privato*, fq. 232.

⁹⁵¹ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 210-213; Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 55-56.

⁹⁵² Carrascosa Gonzales J. *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, Granada: Editorial Compareas, 2000, fq.134.

⁹⁵³ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 209.

vlefshmërisë së *pactum de lege utenda* duhen kërkuar dhe në vetë nenin 24.2 të ligjit DNP, i cili parashikon një minimum kriteresh formale, si kusht për vlefshmërinë e *pactum de lege utenda*. Në këtë aspekt neni 24.2 merr me shumë formën e një norme materiale se sa të një norme konflikti.

Ajo që paraqitet e rëndësishme është të analizojmë se cili do të jetë legjislacioni i zbatueshëm për përcaktimin e këtyre kushteve (materiale dhe formale).

6.6.2.1. Pëlqimi i palëve (shprehja e vullnetit)

Marrëveshja e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, në funksion të rregullimit të regjimit pasuror martesor mund të lidhet vetëm nga bashkëshortët e ardhshëm (*ante nuptial*) ose bashkëshortët (gjatë martesës). Pëlqimi duhet të shprehet personalisht nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga përfaqësues të pajisur me prokurë të posaçme.

A. Zotësia për të lidhur *pactum de lege utenda*. Një diskutim që ka përfshirë prej kohësh doktrinën, i përket ligjit të zbatueshëm mbi zotësinë për të vepruar të bashkëshortëve, zotësinë për të lidhur *pactum de lege utenda*. Mendimi doktrinal është ndarë ndërmjet atyre autorëve të cilët pranojnë që zotësia për të lidhur *pactum de lege utenda* përfshihet në kategorinë e zotësisë së përgjithshme për të vepruar dhe për rrjedhojë do të rregullohet mbi bazën e *lex nationalis* të secilit bashkëshort⁹⁵⁴, dhe atyre autorëve, të cilat, nga ana tjetër, janë të mendimit që jemi në rastin e zotësisë speciale për të vepruar dhe për rrjedhojë ligji që do të rregullojë zotësinë për të lidhur marrëveshjen do të jetë i njëjti ligj që rregullon dhe përmbajtjen e marrëveshjes, do të thotë ligji që palët kanë zgjedhur për rregullimin e regjimit pasuror martesor (*lex causae*)⁹⁵⁵.

Në mungesë të qëndrimeve të praktikës gjyqësore dhe nisur nga fryma e përgjithshme e legjislacionit tonë dhe mbi bazën e mendimit mbizotërues doktrinal të familjes ligjore romano-gjermanike, jemi të mendimit që, zotësia e bashkëshortëve për të lidhur *pactum de lege utenda* do të përfshihet në kuadrin e zotësisë së përgjithshme për të vepruar, e cila në bazë të nenit 11.1 të ligjit DNP do të rregullohet nga ligji i shtetit shtetësinë e të cilit kanë secili prej bashkëshortëve (*lex nationalis* i secilit bashkëshort).

B. Vlefshmëria e pëlqimit të palëve. Një tjetër debat, që ka përfshirë doktrinën është përcaktimi i ligjit të zbatueshëm mbi vlefshmërinë e vullnetit të shprehur nga palët (bashkëshortët). Përgjithësisht, edhe në këtë rast, mendimi doktrinal ndahet ndërmjet autorëve të cilët mendojnë që ligji i zbatueshëm mbi vlefshmërinë e pëlqimit të palëve do të jetë *lex fori* dhe nga ana tjetër, atyre autorëve që janë në favor të zbatimit të *lex causae*, ligjit që palët zgjedhin për rregullimin e regjimit pasuror martesor, nëpërmjet marrëveshjes në fjalë⁹⁵⁶.

Legjislacioni italian mbi të drejtën ndërkombëtare private (neni 30.2 i ligjit PIL) i jep zgjidhje situatës së mësipërme, nëpërmjet parashikimit që, pëlqimi i palëve është i vlefshëm nëse përmbush kushtet e parashikuara nga ligji i vendit të lidhjes së marrëveshjes ose ligji i zgjedhur nga palët për rregullimin e regjimit pasuror martesor, mjafton që njëri prej tyre të garantojë vlefshmërinë e aktit⁹⁵⁷.

⁹⁵⁴ Zanolotti, "Il regime patrimoniale della famiglia nel diritto internazionale private." fq. 40; Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq.52.

⁹⁵⁵ Mbi bazën e teorisë anglo-saksone, zotësia e palëve për të lidhur kontratë rregullohet nga ligji i kontratës. Për më tepër shih: Carrascosa Gonzales, *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, fq.149.

⁹⁵⁶ Mbi këtë debat doktrinal shih: Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq.214.

⁹⁵⁷ Mbi këtë debat doktrinal shih: Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq.214.

6.6.2.2. Objekti i marrëveshjes

Objekti i *pactum de lege utenda*, bazuar në nenin 24.2 të ligjit DNP është “*electio legis*”, pra përcaktimi i ligjit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor⁹⁵⁸. E drejta e bashkëshortëve në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, në funksion të rregullimit të regjimit pasuror martesor, është e kufizuar në listën e legjislacioneve të parashikuara nga norma në fjalë. Ligjvënësi ka parashikuar një listë të mbyllur “*law shopping*”, të tre legjislacione alternative, çka do të thotë që, bashkëshortët nuk mund të zgjedhin të tjera ligje përveç atyre të parashikuara shprehimisht nga norma në fjalë. Gjithashtu lista e kritereve të lidhjes së parashikuar në nenin 24 të ligjit DNP është një liste alternative dhe jo hierarkike.

Nga leximi i nenit 24.2 të ligjit DNP, mund të evidentojmë disa karakteristika, në lidhje me objektin e *pactum de lege utenda*:

Së pari, zgjedhja e ligjit të zbatueshëm duhet të ketë për objekt rregullimin në total të të gjithë regjimit pasuror martesor. Kemi përmendur edhe më sipër që legjislacioni ynë mbi DNP duke ndjekur parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm, nuk ka lejuar fragmentarizmin (*dépeçage*) e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor.

Së dyti, ajo që mund të evidentojmë si karakteristikë të përbashkët të kritereve të përcaktuara nga neni 24.2 i ligjit DNP është që, legjislatori nuk ka parashikuar fiksimin në kohë të këtyre kritereve. Të njëjtën karakteristikë evidentojmë edhe në rastin e kritereve të lidhjes që shërbejnë për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm, në mungesë të *pactum de lege utenda*.

Mos fiksimi në kohë i këtyre kritereve sjell fenomenin e ndryshimit automatik të ligjit të zbatueshëm, si pasojë e ndryshimit të tyre në kohë, psh: si pasojë e ndryshimit të shtetësisë së bashkëshortëve, apo e vendqëndrimit të tyre të zakonshëm; fenomen të cilin për shkak të problematikave, që mbart do të kemi vend ta trajtojmë në një pjesë të veçantë të këtij kreu.

Së treti, Megjithëse legjislatori nuk është shprehur, jemi të mendimit që, zgjedhja e ligjit të zbatueshëm nga bashkëshortët mund të realizohet: a) si në momentin kohor *ante nuptial* ashtu edhe; b) *constante matrimonii* (gjatë kohëzgjatjes së martesës)⁹⁵⁹.

Në rastin e lidhjes së *pactum de lege utenda* “*ante nuptias*”, marrëveshja do të sjellë pasoja për palët vetëm pas lidhjes së martesës, ndërsa në rastin e lidhjes së marrëveshjes *constante matrimonii*, ajo do të sjellë pasoja për palët që në momentin e lidhjes së saj. Në hipotezën e marrëveshjes për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm gjatë martesës, lind një tjetër problem; ai i fuqisë prapavepruese të marrëveshjes. Ligji i ri, i zgjedhur për zbatim nga palët do të ketë efekte që nga momenti i lidhjes së martesës apo do të sjellë, me efekt prapaveprues, pasoja që nga data e lidhjes së martesës? A është e lejuar për bashkëshortët t'i japin fuqi prapavepruese ligjit të zbatueshëm? Cilat janë mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e personave të tretë, nëse ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor nuk është i përcaktuar njëherë e përgjithmonë, por është potencialisht i ndryshueshëm në kohë?

Jemi gjithashtu të mendimit, që bashkëshortët mund të ndryshojnë ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, disa herë gjatë martesës, për aq sa dispozitat e ligjit DNP nuk parashikojnë asnjë ndalim të shprehur.

Mendimi i mësipërm mbi mundësinë e ndryshimit të ligjit të zbatueshëm, gjen mbështetje në dy argumente kryesorë:

⁹⁵⁸ Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq.51.

⁹⁵⁹ Zgjidhje të ngjashme bëjnë edhe disa legjislacionet Europiane si: Zvicra (neni 53/2 i ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private”; Gjermania (neni 15/2 i EGBGB); Austri (neni 19 i ligjit IPRG); Italia (neni 30 i ligjit nr. 218/1995) si dhe Konventa e Hagës e vitit 1978 (neni 3 dhe neni 6). Ndërsa, legjislacione të tjera, si psh. ai Spanjoll parashikon që ligji i zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor mund të zgjidhet vetëm para lidhjes së martesës dhe nuk mund të ndryshojë gjatë saj (neni 9/2 i Código Civil Espanol). Për më shumë rreth këtij vështrimi krahasues shih: Bonomi, “Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare.” fq.65.

a) *Prima ratio*, rëndësia e modifikimit të *pactum de lege utenda* qëndron në garantimin e mundësisë bashkëshortëve, që gjatë marrëdhënies martesore, të mund t'i përshtatin marrëdhëniet pasurore të tyre me situatën e re faktikë të krijuar në hipotezën e ndryshimit të shtetësisë apo të vendqëndrimit të zakonshëm, gjatë martesës. Qëllimi është që, të mos vazhdojë zbatimi mbi regjimin pasuror martesor, i ligjit të një sistemi juridik më të cilin marrëdhënia martesore nuk ka më asnjë lidhje⁹⁶⁰. Pamundësia e ndryshimit të ligjit të zbatueshëm gjatë martesës do të sillte një ngurtësim të ligjit të zbatueshëm gjatë të gjithë marrëdhënies martesore, ngurtësim i cili, nga njëra anë është pozitiv pasi shmang mundësinë e “*conflicto mobil*”, por nga ana tjetër rrezikon që në hipotezën e ndryshimit të rrethanave faktike të jetës bashkëshortore (shtetësia, vendqëndrimi) ligji i zbatueshëm të mos jetë më i përshtatshëm me situatën e re faktike⁹⁶¹.

b) *Ultima ratio*, e drejta e familjes në Shqipëri është larguar nga parimi i mosndryshimit të regjimit pasuror martesor, gjatë martesës, duke pranuar dhe rregulluar ndryshimin e këtij regjimi gjatë martesës. Do të ishte e pakuptueshme dhe jokohërente me të drejtën e familjes, nëse do të pranohet që ky parim nuk ka gjetur vend edhe në të drejtën ndërkombëtare private.

Tani le të marrim në analizë, gamën e legjislacioneve alternative, të cilat mund të zgjidhen nga bashkëshortët ose bashkëshortët e ardhshëm, në funksion të rregullimit të regjimit pasuror martesor.

A. Ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka njëri prej bashkëshortëve

Në këtë hipotezë, bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin për zbatim, ligjin e shtetit shtetësinë e të cilit, ka secili prej tyre në momenti e lidhjes së *pactum de lege utenda*, ante nuptial apo constante matrimonii.

Përcaktimi i *lex nacionalis* paraqitet një operacion juridik i ndërlikuar në hipotezën e personave pa shtetësi, apatridët dhe refugjatët; në rastin e gëzimit të dy apo më shumë shtetësive njëkohësisht; në rastin e ndryshimit të shtetësive si dhe kur sistemi juridik kombëtar nuk është i unifikuar.

a) *Mungesa ligjore apo faktike e shtetësisë-Apatridët dhe refugjatët*. Problemi i përcaktimit të “*lex nacionalis*” të personave pa shtetësi⁹⁶² ka gjetur për herë të parë rregullim në ligjin e ri DNP, në ndryshim nga ligji i përparshëm. Kështu, bazuar në nenin 9 të ligjit DNP, nëse personi është pa shtetësi ose shtetësia e tij nuk mund të përcaktohet (konkretisht, nëse bashkëshortët ose njëri prej tyre nuk kanë asnjë shtetësi ose shtetësia e tyre nuk mund të përcaktohet), atëherë për efekt të këtij ligji, “*lex nacionalis*” i secilit bashkëshort, do të konsiderohet ligji i shtetit në të cilin ai ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm ose nëse shteti i vendqëndrimit të zakonshëm nuk mund të përcaktohet, atëherë *lex nacionalis* i tij do të konsiderohet, shteti me të cilin ky person ka lidhjen më të ngushtë. Në këtë mënyrë, për një person pa shtetësi, me vendqëndrim të zakonshëm në RSH, ligji shqiptar do të konsiderohet si “*lex nacionalis*” i tij, vetëm për efekt të zbatimit të dispozitave të ligjit DNP.

Kjo zgjidhje është parashikuar nga shumë legjislacione të huaja dhe ka gjetur rregullim në Konventën e OKB-së, të 28 Shtatorit, të vitit 1954 “Mbi statusin e personave pa shtetësi”⁹⁶³.

Konventa e OKB-së “Mbi statusin e personave pa shtetësi” është hartuar në 28 Shtator të vitit 1954, në New York dhe hyri në fuqi në 6 Qershor të vitit 1960⁹⁶⁴. Shqipëria ka aderuar në këtë

⁹⁶⁰ Carella, *Autonomia della volonta e scelta di legge nel diritto internazionale privato*, fq. 165.

⁹⁶¹ Carrascosa Gonzales, *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, fq. 141.

⁹⁶² Sipas nenit 1 të Konventës së OKB mbi statusin e personave pa shtetësi, të vitit 1954, personi pa shtetësi përkufizohet si “çdo person që nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet brenda juridiksionit të tij.”

⁹⁶³ Batiffol dhe Lagarde, *Droit International Privé*, fq. 12.

konventë në 23 Qershor të vitit 2003. Qëllimi i konventës është të sigurojë një gamë të gjërë të drejtash dhe lirish themelore për personat pa shtetësi në shtetet anëtare⁹⁶⁵. Konventa parashikon, që statusi personal i personave pa shtetësi qeveriset nga ligji i shtetit të qëndrimit⁹⁶⁶.

Në lidhje me statusin personal të refugjatit⁹⁶⁷, Konventa e OKB-së, e hartuar në Gjenevë në 28 Qershor të vitit 1951, hyrë në fuqi në 22 Prill të vitit 1954, parashikon që pas marrjes së azilit, statusi personal i refugjatit rregullohet nga ligji i shtetit të vendbanimit apo rezidencës së tij⁹⁶⁸. Shqipëria ka aderuar në këtë konventë dhe në Protokollin shtesë të saj të vitit 1967, me dekretin nr. 200, dt. 03.06.1992.

b) *Pluraliteti i shtetësive*⁹⁶⁹. Në hipotezën kur bashkëshortët gëzojnë disa shtetësi njëkohësisht, zgjidhja paraqitet mjaft e thjeshtë, pasi bashkëshortët janë të lirë të zgjedhin për zbatim, ligjin e shtetit, shtetësinë e të cilit ka njëri bashkëshort, pavarësisht nga gëzimi edhe i shtetësive të tjera.

B. Ligji i shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit prej bashkëshortëve-Habitual Residence

Ligji i ri “Për të drejtën ndërkombëtare private”, duke pasqyruar zhvillimet më bashkëkohore në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, në përputhje me Konventën e Hagës, të vitit 1978 dhe me “*aquis communautaire*” (detyrimi i përafritimit të legjislacionit në bazë të MSA), sjell një kriter të ri lidhje në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm, atë të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit prej bashkëshortëve.

Megjithëse është një koncept i ri për të drejtën tonë, në planin ndërkombëtar nocioni i vendqëndrimit të zakonshëm është i vjetër. Këtë nocion e gjejmë të pasqyruar, për herë të parë, në paragrafin e dytë të “Allgemeine burgerliche prozessordnung fur das Konigsreich Hanover” të 4 dhjetorit të vitit 1847. Ky nocion mori një njohje të gjerë në planin ndërkombëtar, pasi filloi të përdorej në aktet e Konferencës së Hagës⁹⁷⁰, në fund të shekullit të XIX⁹⁷¹. Në vitet e fundit ky kriter lidhje është pranuar gjerësisht në Rregulloret e BE-së, që rregullojnë ligjin e zbatueshëm si dhe në kodifikimet më të fundit kombëtare të së drejtës ndërkombëtare private⁹⁷².

⁹⁶⁴ Kjo konventë është pasur nga Konventa “Mbi reduktimin e pashtetësisë”, së vitit 1961, hyrë në fuqi në 1975, aderuar nga RSH në 9 Korrik të vitit 2003. Konventa në fjalë është hartuar në kuadër dhe në respektim të frymës së të parës.

⁹⁶⁵ Ikonomi, Luljeta. *E drejta migratore. Manula trajnues*. Tiranë: Organizata ndërkombëtare për migracionin në Shqipëri, 2009, 40.

⁹⁶⁶ Ikonomi, *E drejta migratore. Manula trajnues*, fq. 40.

⁹⁶⁷ Sipas Konventës, refugjat është çdo person, i cili për shkak të frikës së bazuar nga përndjekja për shkak të racës, besimit, kombësisë, antarësisimit në një grup të caktuar social apo politik, gjendet jashtë vendit të origjinës dhe nuk ka mundësi apo për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendit, ose për shkak se nuk ka shtetësi dhe duke qenë jashtë vendit të rezidencës së zakonshme, si rezultat i ngjarjeve të tilla, apo për shkak të frikës, nuk ka dëshirë të kthehet.

⁹⁶⁸ Ikonomi, *E drejta migratore. Manula trajnues*, fq. 38.

⁹⁶⁹ Kujtojmë këtu që, legjislacioni shqiptar lejon ekzistencën e disa shtetësive. Kështu, në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, shtetasi shqiptar mund të jetë edhe shtetas i një shteti tjetër.

⁹⁷⁰ Fillimisht kriterin e *Habitual Residence* e gjejmë në konventat e Konferencës së Hagës: Konventa e Hagës “Mbi Procedurën Civie” e 14 Nëntor 1896; Konventat e Hagës në fushën e të Drejtës Familjare të vitit 1902 dhe 1905; Konventa e Hagës Për Mbrojtjen e të Miturve e vitit 1902; si dhe shumë Konventa të tjera të Konferencës së Hagës të pas viteve 1956.

⁹⁷¹ Masmegan, *La localisation des pesonnes physiques en droit international privé. Etude comparée de notions de domicile, de résidence habituelle et d'établissement, en droit suisse, français, allemand, anglais, américain et dans les Conventions de La Haye*, fq. 83.

⁹⁷² Kostić-Mandić, Maja. *New concepts in Montenegrin Private International Law*. GIZ, fq. 27.

Koncepti i vendqëndrimit të zakonshëm ka marrë një rëndësi të veçantë në përcaktimin e kriterëve të lidhjes, në pjesën më të madhe të instituteve të ligjit të ri DNP⁹⁷³, duke zëvendësuar konceptin e vendbanimit, që ishte dominant në ligjin e mëparshëm.

Për shkak se përfaqëson një koncept të ri për legjislacionin tonë, lind pyetja së çfarë kuptojmë me “vendqëndrimin e zakonshëm”. Është e kuptueshëm që koncepti i vendqëndrimit të zakonshëm ndryshon nga ai i “vendbanimit” të parashikuar në kod.civ. dhe në ligjin gjend.civ. Do të ishte e gabuar vendosja e shenjave të barazisë ndërmjet këtyre dy koncepteve.

Nga ana tjetër, nëse i referohemi instrumenteve europiane⁹⁷⁴ dhe atyre ndërkombëtare⁹⁷⁵, vëmë re që asnjëra prej tyre nuk jep një përkufizim të “*habitual residence*” të bashkëshortëve. Megjithatë nga ana tjetër, vitet e fundit, ekziston një trend në legjislacionin europian dhe atë kombëtar (shih Nenin 4(2) dhe (3) të Ligjit të së drejtës ndërkombëtare private në Belgjikë), për të dhënë një përkufizim të konceptit të “*habitual residence*”

Neni 12 i ligjit DNP, jep përkufizimin e vendqëndrimit të zakonshëm të një personi si:

“.....vendi në të cilin ai ka vendosur për të qëndruar në pjesën më të madhe të kohës, qoftë edhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Në përcaktimin e këtij nocioni gjykata merr parasysh rrethanat e natyrës personale dhe profesionale, që tregojnë lidhje të qëndrueshme me këtë vend apo synimin e personit për të krijuar lidhje të tilla”

Nga përkufizimi i dhënë më sipër mund të nxjerrim disa konkluzione në lidhje me kuptimin e “habitual residence”:

- a) Kriteri i lidhjes së vendqëndrimit të zakonshëm është një **kriter fakti** dhe jo një kriter ligjor⁹⁷⁶. Për këtë arsye është e pazakontë dhënia e një përkufizimi të këtij kriteri në tekstin e ligjit. Vendqëndrimi i zakonshëm tregon lidhjen e një personi me një vend të caktuar, përfaqëson qendrën e interesave të tij ekonomikë dhe kontakteve sociale⁹⁷⁷, si dhe “qendrën e interesave të familjes”. Në këtë drejtim është shprehur shumë herë edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë. Në çështjen Pedro Magdalena Fernandez C-452/93, GJED shprehet se **“Bëhet fjalë për një kriter fakti, jo kriter ligjor, është vendi ku subjekti ka qendrën kryesore të interesave të tij”**⁹⁷⁸.

⁹⁷³ Nga një veshtrim i përgjithshëm i ligjit DNP, rezulton, që kriteri i vendqëndrimit të zakonshëm në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, është parashikuar, herë si kriter kryesor dhe herë si kriter zëvendësues, në këto institute të së drejtës private: neni 19 (përfaqësimi vullnetar), neni 24 (regjimi pasuror martesor), neni 25 (zgjidhja e martesës), neni 26 (detyrimi për ushqim), neni 28 (amësia dhe atësia), neni 29 (marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve), neni 30 dhe 31 (birësimi dhe efektet e birësimit), neni 32 (kujdestaria), neni 33 (trashëgimia), neni 35 (vlefshmëria e testamentit), neni 46 (detyrimet dhe kontratat, në mungesë të zgjedhjes së palëve), neni 50 (kontrata e transportit), neni 51 (kontrata e sigurimit), neni 52 (kontratat me konsumatorin), neni 63 (përgjegjësia nga produktet), neni 64 (konkurenca e padrejtë dhe veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë), neni 67 (cenimi i të drejtave morale), neni 68 (begatimi pa shkak dhe pagimi i padetyruar), neni 69 (gjerimi i punëve të tjerëve) dhe neni 70 (përgjegjësia parakontraktore).

⁹⁷⁴Council Regulation (EU) No 2201/2003 of 27 November 2003 “On jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and in matters of parental responsibility”, e njohur si Rregullorja Brussels II bis.

⁹⁷⁵ Konventa e Hagës “Për ligjin e zbatueshëm mbi trustin dhe njohjen e tij”, 1 Qershor 1985.

⁹⁷⁶ Megjithatë nuk kanë munguar disa autorë të cilët e konsiderojnë rezidencën e zakonshme si kriter ligjor. Për këtë shih: Hall, Clifford. “Cruse vs. Chittum: Habitual residence judicially explored.” në *International and Comparative Law Quarterly*, Cambridge Journals, Vol. 24, January 1975, fq. 1, i cili shkruan “It is a question of law in the sense that it must be possible to draw a conclusion of residence from the fact of the case”. Apud: Masmejan, *La localisation des personnes physiques en droit international privé. Etude comparée de notions de domicile, de résidence habituelle et d’établissement, en droit suisse, français, allemand, anglais, américain et dans les Conventions de La Haye*, fq. 91.

⁹⁷⁷ Kostić-Mandić, “New concepts in Montenegrin Private International Law.” fq. 27.

⁹⁷⁸ Patti dhe Cubeddu, *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, fq. 65.

Nisur nga përkufizimi i mësipërm, ky kriter është i vlerësueshëm mbi bazën e dy elementëve: 1) elementit objektiv, që nënkupton “vendndodhjen fizike” (*domus colere*) të bashkëshortëve në një vend të caktuar dhe 2) elementi subjektiv “vullnetin e bashkëshortëve për të qëndruar” (*animus manendi*) në këtë vend⁹⁷⁹, ligji përdor termin “...vendi në të cilin ai ka vendosur për të qëndruar...”.

- b) Ligjvënësi nuk ka përcaktuar afate kohore të vendndodhjes së individit (bashkëshortëve) në një vend të caktuar, për rrjedhojë kriteri sasior nuk është i rëndësishëm në përcaktimin e vendit të rezidencës së zakonshme. Minimumi i kohëzgjatjes së vendqëndrimit të zakonshëm do të përcaktohet rast pas rasti.
- c) Megjithëse në ligjin DNP gjejmë një përkufizim të kriterit të vendqëndrimit të zakonshëm, duke qenë se ai është një kriter fakti, vlerësimi i tij do të realizohet rast pas rasti nga gjykata (paragrafi i dytë i nenit 12), në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. I takon bashkëshortëve të provojnë në gjykatë shtetin e vendqëndrimit të tyre të zakonshme.
- d) Ekzistenca e vendqëndrimit të zakonshëm nuk është kusht regjistrimi në regjistrat publikë shtetërorë. Ai mund të jetë edhe i paligjshëm, si pasojë e qëndrimit në një vend të caktuar pa leje apo autorizim të organeve kompetente shtetërore. Është pikërisht ky element që bën dallimin ndërmjet kriterit të vendbanimit dhe atij të vendqëndrimit të zakonshëm. Në praktikë këto dy nocione mund të mbivendosen, shteti i vendbanimit të personit fizik mund të jetë njëkohësisht edhe shteti i vendqëndrimit të tij të zakonshme, megjithëse ka shumë raste kur një korrespondencë e tillë nuk ekziston. Këtë e ndeshim në rastet e punëtorëve emigrantë sezonale. Kështu për shembull, një shtetas shqiptar, i cili banon në Shqipëri dhe punon në Greqi, në sezonin e verës dhe vjeshtës, e ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në shtetin grek, ndërsa vendbanimin në atë shqiptar.

Në doktrinë gjejmë dy këndvështrime të ndryshme mbi konceptin e rezidencës së zakonshme, njëri këndvështrim cilësor dhe tjetri sasior. Sipas këndvështrimit cilësor, këndvështrim të cilin e gjejmë në nenin 12 të ligjit DNP, rezidenca e zakonshme cilësohet si qendra e interesave të personit, ndërsa nga ana tjetër, nën këndvështrimin sasior, kohëzgjatja e qëndrimit të personit (bashkëshortëve) në një shtet të caktuar, është vendimtare për të përcaktuar vendqëndrimin e zakonshëm, me qëllim diferencimin e tij nga prezenca e përkohshme (tranzitore)⁹⁸⁰. Madje, autorët e grupit të dytë vazhdojnë arsyetimin e tyre, duke shprehur që, përdorimi i termit “e zakonshme”, në thelb tregon elementin “sasior” të vendqëndrimit.

Një tjetër problem që ndeshim në doktrinë është mundësia e ekzistencës së dy vendeve të rezidencës së zakonshme të një individi, në të njëjtën periudhë kohore. Marrim shembullin e një shtetasi shqiptar i cili banon në një qytet jugor të RSH (Sarandë), ndërsa punon në fshat kufitar të Greqisë. Në shembullin e marrë, ky individ, për një kohë relativisht të gjatë, jeton 4 ditë të çdo jave në Greqi (ku ai ushtron aktivitetin e tij profesional), supozojmë nga dita e hënë në të enjte dhe 3 ditë të çdo jave (nga dita e premte në të dielën) jeton në Shqipëri, ku qëndron bashkëshortja e tij. Pyetja që shtrohet në këtë shembull hipotetik është se në cilin shtet individ i ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm. A mund të pranojmë ekzistencën e vendqëndrimit të zakonshëm të individit njëkohësisht në dy shtete?

C. *Lex rei sitae*

Legjislatori, i ka dhënë mundësinë bashkëshortëve të zgjedhin për rregullimin e regjimit pasuror martesor, ligjin e vendit ku ndodhet pasuria e paluajtshme e bashkëshortëve.

⁹⁷⁹ Caravaca dhe Gonzalez, *Derecho interbazional Privado. Vol. II*, fq. 146.

⁹⁸⁰ Masmajan, *La localisation des personnes physiques en droit international privé. Etude comparée de notions de domicile, de résidence habituelle et d'établissement, en droit suisse, français, allemand, anglais, américain et dans les Conventions de La Haye*, fq. 93.

Duhet të theksojmë që në hipotezën e përzgjedhjes së sistemit ligjor të shtetit ku ndodhet pasuria e tyre e paluajtshme, në funksion të parimit të unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, *lex rei sitae* do të rregullojë në total të gjithë regjimin pasuror martesor dhe jo vetëm regjimin pasuror mbi pasurinë e paluajtshme. Ashtu siç kemi pasur vend të theksojmë deri tani, në sistemin tonë ligjor, ashtu si edhe në atë të shteteve të tjera të familjes ligjore romano-gjermanike, regjimi pasuror martesor është një institut autonom së drejtës. Në këtë mënyrë ligjvënësi ka dashur të evitojë fenomenin e fragmentarizmit të ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, fragmentarizëm i cili sjell mjaft probleme të kualifikimit të pasurisë së bashkëshortëve dhe të koordinimit të normave ndërmjet tyre.

Rregullin e zbatimit të "*lex rei sitae*" mbi sendet e paluajtshme dhe *lex domicilii* mbi sendet e luajtshme e ndeshim në sistemin *common law*, por në këtë sistem ky regjim i rregullimit ë marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve, është i justifikueshëm me faktin që instituti i regjimit pasuror martesor nuk njihet nga ligji dhe martesat nuk sjell asnjë pasojë mbi pasurinë e bashkëshortëve⁹⁸¹.

Ndërsa nga ana tjetër, në vendet e familjes ligjore romano-gjermanike, të cilat njohin dhe rregullojnë regjimin pasuror martesor si një institut autonom të së drejtës, tradicionalisht kriteri i lidhjes për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm ka qenë "*lex nationalis*" i përbashkët i bashkëshortëve dhe në mungesë të shtetësisë së përbashkët, *lex nationalis* i bashkëshortit. Ligjvënësi shqiptar është influencuar nga modeli i ofruar në Konventën e Hagës së vitit 1978, por duhet të kujtojmë këtu, që parashikimi i *lex rei sitae* në këtë konventë është realizuar me qëllim koordinimin e divergjencave që dy familjet e mëdha ligjore, të përmendura më sipër, paraqesin, në drejtim të ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor.

Gjithashtu, mundësinë e bashkëshortëve për të zgjedhur *lex rei sitae*, si legjislacion të zbatueshëm, mbi pasurinë e paluajtshme e ndeshim edhe në nenin 5, paragrafi 2 të IPL gjerman⁹⁸².

6.6.2.3. Shkaku

Shkaku i marrëveshjes së ligjit të zbatueshëm është zgjedhja, për rregullimin e regjimit pasuror martesor, të legjislacionit të një shteti me të cilin marrëdhënia martesore ka një lidhje të caktuar, (shtetësia e palëve, vendqëndrimi i zakonshëm ose lidhjet e ngushta), të ndryshëm nga legjislacioni i shtetit në të cilin çojnë për zbatim kriteret objektive të lidhjes (neni 23 i ligjit DNP)

6.6.2.4. Forma

Duke qenë se, pranuar që, *pactum de lege utenda* përfshihet në kategorinë e veprimit juridik, atëherë përveç nenit 24.2 të ligjit DNP, forma e marrëveshjes do të përcaktohet edhe mbi bazën e dispozitave të ligjit për DNP, që rregullojnë ligjin zbatueshëm mbi formën e veprimit juridik, konkretisht neni 18.1 i ligjit. Bazuar në nenin 18.1 të ligjit DNP, veprimi juridik është i vlefshëm, nëse përmbush kriteret e formës, sipas ligjit të shtetit, në të cilin është kryer veprimi juridik, ose kriteret e përcaktuara, sipas ligjit, i cili rregullon përmbajtjen e veprimit juridik.

Nga leximi i kombinuar i nenit 24.2 dhe nenit 18.1 të ligjit DNP, mund të pohojmë, që *pactum de lege utenda* do të jetë e vlefshme, nëse plotëson kushtet e formës së parashikuara nga njëra prej legjislacioneve të shtetit të *lex locus regit actum* ose të parashikuara nga *lex causa*, me kushtin që,

⁹⁸¹ Wiederkehr, *Les conflicts de loi en matière de régime matrimonial. Volume VII*, fq. 28.

⁹⁸² Martiny, "Objectives and values of (private) international law in family law." fq. 90.

pavarësisht formës së parashikuar nga këto legjislacione të jetë hartuar në formën e aktit noterial apo një akti tjetër të lëshuar nga një organ publik dhe të barazvlefshëm me aktin noterial.

Pactum de lege utenda është një marrëveshje formale për efekt vlefshmërie. Neni 24.2 i ligjit DNP parashikon shprehimisht që, marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor duhet të realizohet në formën e aktit noterial ose të një akti tjetër të barazvlefshëm me të dhe të lëshuar nga një organ publik.

Nga leximi i dispozitës në fjalë mund të nxjerrim disa konkluzione dhe të evidentojmë disa elementë, që kanë nevojë për interpretim.

Së pari, marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm është një veprim juridik formal dhe solemn. Forma e kërkuar nga ligji është akti noterial ose një akt tjetër që të jetë i barazvlefshëm me aktin noterial dhe të jetë lëshuar nga një organ publik. Forma noteriale apo ajo e aktit publik kërkohet nga ligji “*ad substantiam*”, për efekt vlefshmërie. Mosrespektimi i formës së kërkuar, sjell pavlefshmërinë e marrëveshjes dhe për rrjedhojë përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes (neni 23 të ligjit DNP).

Por, cila është *ratio* e formës noteriale të kërkuar nga ligji? Nga njëra anë *ratio* e aktit noterial, si kusht vlefshmërie të *pactum de lege utenda*, është garantimi i shprehjes së një vullneti real dhe serioz të palëve dhe mbrojtjen e palës më të dobët, dhe në anën tjetër, jemi të mendimit që, qëllimi i ligjvënësit ka qenë përshtatja e formës së marrëveshjes për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm me formën e kontratës martesore, duke qenë se, në të gjitha hipotezat kur bashkëshortët zgjedhin ligjin e zbatueshëm, zakonisht rregullojnë nëpërmjet kontratës edhe regjimin pasuror mbi bazën e ligjit të zgjedhur (*lex causae*)⁹⁸³. Zakonisht këto dy veprime juridike, *pactum de lege utenda* dhe kontrata martesore, gjenden në një dokument të vetëm. Gjithashtu, arsyeja që ligjvënësi parashikon për *pactum de lege utenda* të njëjtën formë me atë të kontratës martesore është sepse në disa aspekte të caktuara, marrëveshja e ligjit të zbatueshëm sjell të njëjtat pasoja të një kontrate martesore, në kuptimin që, sjell si pasojë, edhe pse në mënyrë indirekte, zbatimin e një regjimi pasuror të caktuar, që në mungesë të vullnetit të bashkëshortëve, do të jetë regjimi pasuror ligjor i shtetit, ligji i të cilit është zgjedhur për zbatim nga palët. Në këtë drejtim nuk ka dallim ndërmjet një kontrate martesore që sjell kalimin e bashkëshortëve nga regjimi ligjor në atë kontraktor ose anasjelltas, me marrëveshjen e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, që sjell të njëjtat pasoja nëpërmjet përcaktimit të ligjit të zbatueshëm⁹⁸⁴.

Në vijim të këtij qëndrimi, sipas opinionit të një prej autorëve më në zë në fushën e regjimit pasuror martesor në të drejtën ndërkombëtare private, opinionin e të cilit mbështesim, funksioni i aktit noterial është që të garantohet një minimum kushtesh të vlefshmërisë së kontratës martesore, në rastin kur ligji që kanë zgjedhur për zbatim bashkëshortët nuk kërkon ndonjë akt formal për vlefshmërinë e kontratës martesore, psh. legjislacioni anglez nuk e kushtëzon vlefshmërinë e kontratës martesore me asnjë akt formal⁹⁸⁵.

Së dyti, në lidhje me natyrën juridike të nenit 24.2 të ligjit DNP mund të pohojmë që, fjalia e parë e kësaj dispozite ka karakterin e një norme materiale dhe jo të një norme konflikti, sepse objekti i rregullimit të saj janë kushtet formale të vlefshmërisë së *pactum de lege utenda*. Kujtojmë këtu që, është element karakterizues i normave të konfliktit prezenca e “kriterëve të lidhjes”, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e legjislacionit të zbatueshëm për rregullimin e një marrëdhënie juridiko-civile me elementë të huaj.

⁹⁸³ Carrascosa Gonzales, *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, fq. 138-139.

⁹⁸⁴ Cardillo, *La forma dell'accordo di scelta della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi (art.30 legge 218/1995)*.

⁹⁸⁵ Kjo dispozitë është hartuar në modelin e Konventës së Hagës së vitit 1978. Për këtë interpretim shih: Droz dhe Martin-Bosly, “*Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I.*” fq. 230.

Së treti, nuk është shumë e qartë se çfarë ka dashur ligjvënësi të kuptojë me **“një akt tjetër publik të barazvlefshëm dhe të lëshuar nga një organ publik”**. Mund të jetë akt tjetër publik, për shembull ai i lidhur para një përfaqësie konsullore të shtetit shqiptar.

Së katërti, në vazhdim të konkluzioneve të realizuara më sipër, mund të pohojmë që, zgjedhja e ligjit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, duhet të realizohet gjithmonë në formë të shprehur dhe formale⁹⁸⁶ dhe asnjëherë nuk mund të jetë e nënkuptuar (në heshtje)⁹⁸⁷.

Neni 24/3 i ligjit DNP rregullon mbrojtjen e të tretëve në rastin e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm me marrëveshje të bashkëshortëve. Marrëveshja i kundërdrejtohet të tretit kur ai e dinte ekzistencën e saj ose kur nuk e dinte për faj të tij. Por kur i treti ka qenë në mirëbesim, pra nuk e dinte dhe nuk kishte mundësi të merrte dijeni për ekzistencën e marrëveshjes, cili është ligjit që i zbatohet regjimit pasuror martesor, për sa i përket marrëdhënies ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretit⁹⁸⁸. Nuk gjendet një referim i shprehur për zgjidhjen e këtij problemi në nenin 24/3 të ligjit DNP. Me interpretim mund të themi që, do t'i zbatohet ligji i thirrur për zbatim mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes (neni 23 të ligjit DNP).

6.7. Kontrata martesore në të drejtën ndërkombëtare private

6.7.1. Ligji i zbatueshëm mbi kushtet e vlefshmërisë së kontratës martesore

Legjislacioni i zbatueshëm për rregullimin e kontratës martesore është legjislacioni i zgjedhur nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre, ose në mungesë të një marrëveshje legjislacioni që thirret për zbatim, mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes (neni 23 i ligjit DNP).

Në përmbledhje të analizës së mësipërme, ripohojmë që, kontrata martesore do të rregullohet nga *“lex causae”*, pra nga legjislacioni i thirrur për zbatimin për rregullimin e regjimit pasuror martesor. Për rrjedhojë kontrata martesore nuk i nënshtrohet ligjit të zbatueshëm mbi kontratat në përgjithësi, por ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor.

Të njëjtin përfundim, të arritur më sipër, mund të pohojmë edhe për kushtet e vlefshmërisë⁹⁸⁹ së kontratës martesore, kushte të cilat do t'i kërkojmë në ligjin material (substancial), të cilin normat e konfliktit thërrasin për zbatim. Këto do të jenë kushtet e përgjithshme të vlefshmërisë së kontratave si dhe kushtet specifike, që gjenden në legjislacionin material të thirrur për zbatim. Në vija të përgjithshme, ligji i zgjedhur nga palët për rregullimin e regjimit pasuror martesor – *lex causae* – do të rregullojë: pëlqimin e palëve, vlefshmërinë e kontratës martesore, shkallën e lirisë kontraktore të palëve në drejtim të zgjedhjes së regjimit pasuror martesor, mundësinë e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, fuqinë retroaktive e tij, objektin e regjimit pasuror martesor, rregullat e administrimit të pasurisë si dhe mbarimin dhe likuidimin e regjimit pasuror martesor dhe rregullat e pjesëtimit të tij⁹⁹⁰.

⁹⁸⁶ Kështu për shembull, në të drejtën ndërkombëtare private franceze është pranuar prej kohësh mundësia e shprehjes së nënkuptuar të zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm. Këtë hipotezë e ndeshim për shembull në rastin e dy shtetasve të huaj me rezidencë të zakonshme në Francë, të cilët lidhin një kontratë martesore, në të cilën zgjedhin regjimin e pjesëmarrëjs në fitime (participation aux acquets) të rregulluar nga Code Civil Francez. Bazuar në legjislacionin dhe jurisprudencën franceze, nisur nga fakti që bashkëshortët kanë vendosur të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore mbi bazën e legjislacionit francez, atëherë prezumohet (është e nënkuptuar) që, legjislacioni i zgjedhur prej tyre në rregullimin e regjimit pasuror martesor është ai francez.

⁹⁸⁷ Carrascosa Gonzales, *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, fq. 139.

⁹⁸⁸ Viarengo, *Autonomia della volonta e rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 181.

⁹⁸⁹ Bartholet, Julie. “Les régimes matrimoniaux en droit international privé Suisse.” në *Les régimes matrimoniaux en droit compare et en droit international privé*, A. Bonomi, M. Steiner (Eds.), Genève: Librairie Droz, 2006, fq. 49.

⁹⁹⁰ Për këtë qëndrim shih: Pintens, “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” fq.87.

Ky është rregulli i përgjithshëm nga i cili ka përjashtime të shumta dhe çështje mjaft delikate dhe të debatueshme në doktrinë dhe jurisprudencë⁹⁹¹.

pavlefshmëria e kontratës martesore dhe pasojat e saj rregullohen nga i njëjti ligj që rregullon kushtet thelbësore të vlefshmërisë së kontratës dhe më konkretisht kushtin, që nuk është përmbushur dhe për rrjedhojë ka sjellë pavlefshmërinë e kontratës. Gjithashtu, ligji që rregullon pavlefshmërinë e kontratës do të rregullojë edhe regjimin juridik të pavlefshmërisë si dhe pasojat e pavlefshmërisë.⁹⁹²

I njëjti ligj rregullon gjithashtu faktin, nëse kushti i paplotësuar do të sjellë pavlefshmërinë e të gjithë kontratës martesore ose vetëm pavlefshmërinë e klauzolës kontraktore të hartuar në kundërshtim me dispozitat urdhëruese.

Le të marrim në analizë kushtet e kontratës martesore, në funksion të përcaktimit të legjislacionit të zbatueshëm mbi secilin prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe debatin doktrinal mbi këto çështje.

Në lidhje me pëlqimin e palëve për lidhjen e kontratës martesore, dy janë elementët në të cilët do të ndalemi dhe që, përgjithësisht, kanë ndarë mendimin e doktrinës: a) zotësia për të lidhur kontratë martesore dhe b) kushtet e vlefshmërisë së pëlqimit të palëve (bashkëshortëve).

A. Zotësia për të lidhur kontratë martesore. Në bazë të legjislacionit shqiptar dhe të pjesës më të madhe të legjislacioneve europiane të së drejtës ndërkombëtare private, zotësia për të vepruar e një subjekti rregullohet nga ligji i shtetësisë së tij. Sipas nenit 11/1 i ligjit DNP, zotësia për të vepruar e një personi fizik dhe kufizimi apo heqja e zotësisë për të vepruar rregullohet nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ai ka. Gjithashtu, nëse zotësia për të vepruar është fituar një herë, ajo nuk humbet për shkak të ndryshimit të shtetësisë.

Problemi që shtrohet në doktrinë, lidhur me zotësinë për të lidhur kontratë martesore, konsiston në debatin ndërmjet asaj pjese të doktrinës që e konsideron zotësinë për të lidhur kontratë martesore si **zotësi speciale për të vepruar**⁹⁹³ dhe pjesës tjetër që, e klasifikon në kategorinë e **përgjithshme të zotësisë për të vepruar**⁹⁹⁴. Zotësia speciale për të vepruar përfaqëson një ndalim ligjor të bazuar në nevojën e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm⁹⁹⁵. Nga klasifikimi i zotësisë për të lidhur kontratë martesore, në njërën apo tjetrën kategori, do të varet ligji që do t'i zbatohet, ndërmjet **lex causae** (legjislacionit të regjimit pasuror) në rastin e klasifikimit në kategorinë e

⁹⁹¹ Batiffol dhe Lagarde, *Droit International Privé*, fq. 374

⁹⁹² Couchez, Gérard. *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Volume XII. Paris: Librairie Dalloz, 1972, fq. 76-81.

⁹⁹³ Sipas doktrinës juridike, jemi përpara zotësisë speciale për të vepruar në rastin kur ligji për kryerjen e veprimeve të caktuara juridike parashikon disa kushte të posaçme të fitimit të zotësisë për të vepruar, që nuk korespondojnë me kushtet e përgjithshme. Për më shumë rreth dallimit ndërmjet zotësisë së përgjithshme dhe zotësisë speciale për të vepruar shih: Ubertazzi, Benedetta. "La capacita delle persone fisiche nel diritto internazionale privato." në *Studi e pubblicazioni della rivista di diritto internazionale privato e processuale*, Vol. 66, Padova: CEDAM, 2006, fq. 271-283. Konkretisht do të kemi zotësi speciale për të vepruar në të gjitha ato raste, kur për kryerjen e një veprimi juridik të caktuar, ligjvënësi nuk mjaftohet me kushtin e plotësimit të moshës 18 vjeç të zotësisë së plotë për të vepruar, por parashikon kushte shtesë (Psh: Bazuar në nenin 86.2 të Kushtetutës së RSh, president i Republikës mund të zgjidhet personi që ka mbushur moshën 40 vjeç) ose përcakton fitimin e zotësisë për të kryer një veprim juridik të caktuar edhe para mbushjes së moshës 18 vjeç (Psh: a) Rasti i njohjes vullnetare të amësisë. Sipas nenit 176 të kod.fam. "Njohja e amësisë mund të bëhet edhe nga nëna e mitur"; ose b) sipas nenit 373/2 të kod.civ. rasti i njohjes së zotësisë së të mitur që ka mbushur moshën 14 vjeç për të hartuar testament, vetëm për pasurinë e fituar nga puna e tij).

⁹⁹⁴ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 124-125.

⁹⁹⁵ Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 24.

zotësisë speciale për të vepruar dhe *lex nacionalis* të secilit bashkëshort, në rastin e klasifikimit në kategorinë e zotësisë së përgjithshme për të vepruar⁹⁹⁶.

Sipas një autori, *lex nacionalis* i secilit bashkëshort do të rregullojë kuptimin e zotësinë dhe pazotësinë për të vepruar të një personi si dhe kriteret për fitimin dhe humbjen e saj, por nuk mund të rregullojë hipotezën nëse një person me ose pa zotësi për të vepruar mund të lidhë ose jo kontratë martesore. Do të jetë ligji i regjimit pasuror, ai që do të përcaktojë se deri në çfarë mase zotësia për të vepruar është një kusht për vlefshmërinë apo jo të kontratës⁹⁹⁷.

Ashtu siç e kemi sqaruar edhe më parë, gjatë këtij punimi, zotësia për të lidhur kontratë martesore nuk klasifikohet në kategorinë e zotësisë së përgjithshme për të vepruar, pasi kujtojmë sërish që, ligjvënësi nuk ka zgjedhur parimin “*habilis ad nuptias, habilis ad pacta nuptialia*”, por ka kushtëzuar lidhjen e kontratës martesore, jo me fitimin e zotësisë së plotë për të vepruar, por me mbushjen e moshës 18 vjeç.

Mbi bazën e argumentit të mësipërm, jemi të mendimit që, zotësia për të lidhur kontratë martesore përfshihet në kategorinë e zotësisë speciale për të vepruar dhe për rrjedhojë do të rregullohet nga legjislacioni që rregullon përmbajtjen e kontratës martesore, *lex causae* (ligji i zgjedhur nga palët).

Nëse zotësia e përgjithshme për të vepruar rregullohet nga neni 11 i ligjit DNP, zotësia speciale për të kryer veprime të caktuara juridike, siç është në rastin konkret zotësia për të lidhur kontratë martesore, rregullohet nga vetë ligji që rregullon veprimin juridik, pra nga ligji që palët kanë zgjedhur për rregullimin e regjimit pasuror martesor⁹⁹⁸.

B. Pëlqimi i bashkëshortëve. Pëlqimi për lidhjen e kontratës martesore mund të ndikohet nga veset e vullnetit: mashtrimi, lajthimi ose kanosja. Duke qenë se, në ligjin DNP nuk ekziston asnjë dispozitë që të rregullojë shprehimisht ligjin e zbatueshëm mbi vlefshmërisë e pëlqimit të palëve, atëherë, jemi të mendimit që ky problem do të gjejë rregullim bazuar në ligjin rregullues të vlefshmërisë së kontratës martesore. Në vijim të këtij arsytimi, duhet pohuar që, vlefshmëria e pëlqimit për lidhjen e kontratës martesore rregullohet nga ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor, pra ligji që rregullon kontratën martesore (*lex causae*).

C. Objekti dhe shkak. Përgjithësisht mendimi doktrinal është unanim në pohimin që, objekti dhe shkak si kushte të vlefshmërisë së kontratës martesore rregullohen nga ligji që rregullon përmbajtjen e kontratës, *alias* ligji që rregullon regjimin pasuror martesor “*lex causae*”.

Nga leximi i dispozitave të ligjit DNP, konstatojmë që legjislatori shqiptar ka mbështetur teorinë, sipas së cilës, ekzistenca dhe kushtet e vlefshmërisë së kontratës do të rregullohen nga legjislacioni, që rregullon përmbajtjen e kontratës, ligji i zgjedhur nga palët (neni 45.5 ligjit DNP).

Palët mund të rregullojnë regjimin pasuror martesor sipas rregullave dhe brenda limiteve, që u lejojnë atyre normat materiale të legjislacionit që kanë zgjedhur për zbatim. Ky është dhe qëndrimi *quasi* unanim i doktrinës, sipas së cilës, liria kontraktore e bashkëshortëve, pra kufijtë brenda të cilëve bashkëshortët kanë të drejtë të rregullojnë regjimin pasuror martesor, rregullohet

⁹⁹⁶ Cardillo, “Rapporti patrimoniali tra coniugi nel nuovo diritto internazionale privato e riflessi sull’attività notarile.” fq. 190-191.

⁹⁹⁷ Wiederkehr, *Les conflicts de loi en matière de régime matrimonial. Volume VII*, fq. 238; Bartholet, “Les régimes matrimoniaux en droit international privé Suisse.” fq. 49.

⁹⁹⁸ Për këtë mendim të doktrinës shih: Zanobetti, “Il regime patrimoniale della famiglia nel diritto internazionale private.” fq. 36.

nga ligji që rregullon regjimin pasuror martesor⁹⁹⁹. *Lex causae* rregullon, gjithashtu, përbërjen e pasurisë vetjake të secilit bashkëshort dhe përbërjen e pasurisë së bashkësisë, rregullat e administrimit si dhe pjesët takuese¹⁰⁰⁰. Mbi këtë problem është shprehur edhe *Gjykata Franceze e Kasacionit*, sipas së cilës **“Ligji i zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor rregullon gjithashtu përbërjen e pasurisë vetjake të bashkëshortëve dhe atë të bashkësisë”**¹⁰⁰¹.

Në kapitujt e parë të këtij punimi kemi pranuar, që në përmbajtjen e kontratës martesore mund të gjenden të rregulluara edhe marrëdhënie të tjera të karakterit pasuror, të cilat nuk përfshihen në objektin e regjimi pasuror *stricto sensu*. Jemi të mendimit që, duke qenë se këto marrëdhënie pasuror nuk përfshihen në objektin e rregullimit të regjimit pasuror, megjithëse formalisht mund të paraqiten në një dokument me atë të kontratës martesore, mbi këto marrëdhënie nuk mund të zbatohet i njëjti legjislacion që zbatohet për rregullimin e regjimit pasuror martesor. Legjislacioni i zbatueshëm mbi këto marrëdhënie juridike do të rregullohet nga të tjera dispozita të ligjit DNP, në varësi të marrëdhënies konkrete.

D. Forma. Ligji për DNP nuk parashikon asnjë rregullim të posaçëm mbi formën e kontratës martesore. Në këtë kuadër, shtrohet problemi nëse ligji i zbatueshëm mbi formën e kontratës martesore është ligji i shtetit të lidhjes së kontratës **“lex loci regit actum”** apo ligji që rregullon regjimin pasuror martesor **“lex causae”**.

Jemi të mendimit që, nisur nga fakti që kontrata martesore është një veprim juridik si dhe në mungesë të rregullimeve të posaçme ligjore, në ligjin DNP, përcaktimi i ligjit të zbatueshëm mbi formën e kontratës martesore do të realizohet mbi bazën e nenit 18 të ligjit DNP, dispozitë e cila rregullon ligjin e zbatueshëm mbi formën e veprimit juridik.

Bazuar në rregullimet e nenit 18 të ligjit DNP, kontrata martesore do të jetë e vlefshme, nëse përmbush kriteret e formës sipas ligjit të shtetit në të cilën është lidhur kontrata ose ligjit të shtetit që rregullon përmbajtjen e saj. Nga interpretimi i nenit 18, rezulton që forma e kontratës martesore do të rregullohet në mënyrë alternative nga **“lex loci regit actum”** ose nga **“lex causae”**, mjafton që të përmbushë kriteret formale të njërit prej këtyre legjislacioneve.

Nga leximi i nenit 24 të ligjit DNP, rezulton, gjithashtu që, ligjvënësi nuk ka parashikuar një minimum kriteresh formale për kontratën martesore, siç bën për marrëveshjen për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm. Konventa e Hagës e vitit 1978 dhe Projekt-Rregullorja e BE-së mbi ligjin e zbatueshëm mbi regjimet pasurore martesore, parashikojnë që, krahas respektimit të kriterëve formale të *lex loci regit actum* ose *lex causae*, kontrata martesore duhet bërë të paktën në formë të shkruar, të përmbajë datën e lidhjes si dhe nënshkrimin e të dy palëve.

Referuar mungesës së një minimumi kriteresh formale për kontratën martesore, në ligjin DNP, lind pyetja, nëse do të jetë e vlefshme në Shqipëri një kontratë martesore e lidhur verbalisht në Angli, shtet i cili nuk kërkon formën e shkruar të kontratës martesore. Jemi të mendimit që, në këtë hipotezë, kontrata nuk do të jetë e vlefshme në Shqipëri. Megjithëse, **“de lege lata”** bazuar në nenin 18 të ligjit DNP, një kontratë verbale do të ishte e vlefshme, jemi të mendimit që, **“de lege ferenda”** duhet zbatuar me analogji nenin 24/2 i ligjit DNP. Bazuar në këtë arsyetim, **“de lege ferenda”**, kontrata martesore e lidhur në një shtet tjetër është e vlefshme në RSH, nëse është lidhur sipas kriterëve formale të *lex loci regit actum* ose të *lex causae*, por në çdo rast duhet të

⁹⁹⁹ Në mbështetje të këtij opinioni shih: Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 32-33. Në të njëjtin punim gjenden të paqyruara edhe pikëpamjet e një pjese, megjithëse në pakicë, të doktrinës, sipas së cilës, do të jetë ligji i shtetësisë së bashkëshortëve, ligji rregullues i lirisë së tyre kontraktore. Kjo teori është mjaft e kritikuar në doktrinë.

¹⁰⁰⁰ Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 100.

¹⁰⁰¹ Court de Cassation, Chambre Civile Ire, 12 Avril 1967.

bëhet me akt noterial ose në një akt tjetër të barazvlefshme me të, të lëshuar nga një organ publik (neni 24/2).

Në analizë të fundit, jemi të mendimit që, për një rregullim më të mirë të kontratës martesore në të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe për të shmangur paqartësitë që mund të lindin në zbatimin e ligjit DNP, në të ardhmen, duhet të ishte parashikuar në ligj një kriter minimal në drejtim të formës së kontratës martesore. Rekomandojmë që, një ndryshim i ligjit DNP, në këtë drejtim, do të ishte i nevojshëm.

6.7.2. Regjistrimi i kontratës martesore

Problemi i përcaktimit të ligjit të zbatueshëm mbi regjistrimin e kontratës martesore e gjen zgjidhjen në debatin mbi klasifikimin ose jo të regjistrimit në kuadër të kushteve të formës së kontratës martesore.

Sipas një gupi autorësh, regjistrimi është pjesë e formës së kontratës martesore dhe për rrjedhojë, ligji i zbatueshëm mbi regjistrimin përcaktohet mbi bazën e të njëjtave kritere lidhje të veprimit juridik, “*lex loci regit actum*” ose “*lex causae*”. Ndërsa, pjesa tjetër e autorëve është e mendimit që regjistrimi nuk është pjesë e formës së kontratës martesore, por është një element procedural që ka si funksion informimin e të tretëve mbi regjimin pasuror të bashkëshortëve dhe për rrjedhojë nuk mund të zbatohet e njëjta zgjidhje¹⁰⁰².

Nisur nga fakti që, sipas nenit 69 të kod.fam. regjistrimi i kontratës martesore në regjistrat publikë ka funksionin e një publikimi njoftues, t’i bëjë të njohur të tretëve regjimin pasuror të bashkëshortëve, jemi në mbështetje të grupit të dytë të autorëve.

6.7.3. Njohja në RSH e kontratës martesore të lidhur jashtë territorit të saj

Problem paraqitet njohja dhe zbatimi në Republikën e Shqipërisë së një kontrate martesore të lidhur në një shtet tjetër. Në lidhje me këtë problem, do të merren në shqyrtim dy aspekte: a) njohja dhe zbatimi i kontratës martesore në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve; b) kundërdrejtimin e kontratës martesore të tretëve.

A. Kundërdrejtimi i kontratës martesore të tretëve. Lind pyetja, nëse një kontratë martesore e lidhur dhe e regjistruar në një shtet tjetër, jashtë territorit të RSH, do të mund t’i kundërdrejtohet të tretëve në RSH. Për shembull, një kontratë martesore e lidhur në Gjermani nga dy bashkëshortë me shtetësi shqiptare dhe e regjistruar në regjistrat publikë të shteti gjerman, a mund t’i kundërdrejtohet një të treti, me vendbanim në Shqipëri?

Në këtë rast, pavarësisht se kontrata martesore ka plotësuar kriteret formale të *lex causae* apo të *lex loci regit actum*, ajo mund t’i kundërdrejtohet të tretëve në RSH vetëm nëse është regjistruar në regjistrat publikë shqiptarë, sipas kërkesave të kod.fam, në Aktin e Martesës dhe kur është nevojë edhe në Regjistrin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ose në atë Tregtar.

Në mungesë të regjistrimit në këto regjistra, kontrata martesore është e vlefshme në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, por ajo nuk mund t’i kundërdrejtohet të tretëve në RSH, nëse kontrata nuk është regjistruar në regjistrat publikë shqiptarë (akti i martesës). Në këtë hipotezë, jemi të mendimit që, për të tretët bashkëshortët do të jenë të martuar nën regjimin ligjor të ligjit të thirrur për zbatim.

Në lidhje me të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme, pasojat ndaj të tretëve janë të kushtëzuara nga respektimi i kushteve të formës dhe regjistrimit në shtetin e vendit ku ndodhet pasuria e

¹⁰⁰² Për debatin doktrinal mbi ligjin e zbatueshëm për regjistrimin e kontratës martesore shih: *Couchez, Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial. Vol. XII, fq. 61-62.*

paluajtshme. Nëse nuk janë respektuar kushtet e formës dhe regjistrimit, të parashikuara nga *lex rei sitae*, prezumohet që, megjithëse të tretët kanë pasur dijeni për regjimin pasuror martesor (marrëveshjen për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm dhe kontratën martesore), kjo dijeni nuk është e mjaftueshme për t'i kundërdrejtuar atyre të drejtat mbi pasurisë e paluajtshme¹⁰⁰³. Për rrjedhojë, duhet ritheksuar që, kontrata martesore, sipas kërkesave të ligjit shqiptar, duhet regjistruar edhe në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme në RSH, nëse përmban ndryshimin e gjendjes juridike të pasurisë së paluajtshme të ndodhur në territorin e RSH, në mënyrë që të mund t'i kundërdrejtohet të tretëve në RSH.

Që kontrata martesore të regjistrohet në Aktin e Martesës, në zyrat shqiptare të gjendjes civile, në eventualitetin e martesave të lidhura jashtë territorit të RSH është e nevojshme që, fillimisht të njihet dhe regjistrohet martesa e lidhur jashtë RSH dhe më pas, në aktin e martesës, të regjistrohet edhe kontrata martesore e lidhur¹⁰⁰⁴. Në lidhje me njohjen dhe regjistrimin në gjendjen civile të RSH-së, të dokumenteve zyrtare, të lëshuara nga autoritet e shteteve të huaja (akti i martesës dhe kontrata martesore), është fillimisht e nevojshme pajisja e tyre me vulën Apostile¹⁰⁰⁵ nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar¹⁰⁰⁶, për ato shtete me të cilat RSH ka nënshkruar Konventën Apostile. Ndërsa, në rastin e martesës dhe kontratës të lëshuara nga administrata e një shteti tjetër, që nuk është pjesë e Konventës së Hagës, së vitit 1961, procedura e legalizimit të këtyre akteve është e detyrueshme, në mënyrë që, këto akte të regjistrohen në regjistrat shqiptarë të gjendjes civile. Legalizimi konsiston në njohjen formale nga punonjësit konsullorë, të vulës dhe nënshkrimit të autoritetit që e ka lëshuar dokumentin. Kjo e bën dokumentin njësoj të vlefshëm, nga pikëpamja ligjore edhe jashtë territorit të vendit ku është lëshuar.

B. Njohja e kontratës martesore ndërmjet bashkëshortëve. Edhe në mungesë të regjistrimit, kontrata martesore është e vlefshme ndërmjet palëve, pavarësisht se nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve. Megjithatë, problem paraqet njohja dhe ekzekutimi i një kontrate martesore në juridiksione të tjera, madje në shumë raste edhe shumë vite pas lidhjes së martesës. Ekziston rreziku që kontrata martesore nuk do të njihet si e vlefshme në juridiksione të tjera ose nuk do të jetë plotësisht e ekzekutueshme apo e detyrueshme për palët.

¹⁰⁰³ Andrini, *L'autonomia privata dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*, fq. 41.

¹⁰⁰⁴ Në këtë kuadër, lind pyetja, nëse mund të njihet në RSH një kontratë martesore e lidhur jashtë saj, ndërmjet dy bashkëshortëve të së njëjtës gjini, në kuadrin kur në RSH martesa e tyre është e pavlefshme? PSH: një shtetas spanjoll dhe një shtetas francez, që kanë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm në RSH, lidhin martesë dhe kontratë martesore në Francë. Në KM zgjedhin si ligj të zbatueshëm atë shqiptar dhe bazuar në kod.fam. zgjedhin regjimin e pasurive të ndara. A do të njihet si e vlefshme KM në Shqipëri?

¹⁰⁰⁵ Vula Apostile, apo më saktë Apostille, e lindur nga një marrëveshje ndërkombëtare të quajtur Konventa e Hagës, nuk është tjetër veçse një vulë e standardizuar në përmasa e përmbajtje nga vetë konventa, një lloj legalizimi që autoriteti kompetent i një shteti i bën dokumentit publik duke e kthyer dokumentin në të vlefshëm edhe për shtetet e tjera që kanë nënshkruar konventën. Pra Apostille është një legalizim i mundshëm i parashikuar vetëm për shtetas që vijnë nga vendet që kanë nënshkruar Konventën e Hagës së 5 tetorit 1961 lidhur me heqjen e legalizimit të akteve publike të huaja. Gjatë viteve konventa është ratifikuar dhe zbatuar nga shumë e shumë vende dhe parashikon që të mos kërkohet më legalizimi i certifikatave pranë autoriteteve konsullore, por të njihen si të vlefshme të gjitha ato certifikata që kanë të ashtuquajturën apostille të vënë nga autoritetet e vendit që kanë lëshuar dokumentin. Konventa është ratifikuar nga Shqipëria më 3 shtator 2003 dhe ka hyrë në fuqi më 9 maj 2004

¹⁰⁰⁶ Duhet saktësuar që, Konventa përcakton heqjen e legalizimit të akteve publike të huaja mes të cilave bëjnë pjesë, të parashikuara shprehimisht, dokumentet që lëshon një autoritet apo një funksionar i administratës së shtetit (përfshirë prokurorinë, gjykatën), dokumentet administrative, aktet noteriale, deklaratat zyrtare që dëshmojnë një regjistrim, një autentifikim firme mbi një akt privat, por konventa nuk aplikohet për dokumentet e lëshuara nga një diplomat apo konsull dhe as në dokumentet administrative tregtare dhe të doganës.

6.8. Ndryshimi i regjimit pasuror dhe domosdoshmëria e mbrojtjes së të tretëve

Marrëdhënia martesor fillon në momentin e lidhjes së martesës dhe zgjat në kohë, deri në momentin e përfundimit të martesës (vdekja e njërit bashkëshort ose zgjidhja). Gjatë kësaj periudhe kohore, që mund të jetë relativisht e gjatë, mund të ndryshojnë kriteret që kanë çuar në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, si psh: ndryshimi i shtetësisë së bashkëshortëve ose i vendqëndrimit të tyre të zakonshëm¹⁰⁰⁷. Ky ndryshim ndikon në ndryshimin e regjimit pasuror martesor të bashkëshortëve. Gjithashtu ndryshime mund të ndodhin në vetë ligjin e thirrur për zbatim nga palët.

Ndryshimi i regjimit pasuror martesor, gjatë martesës, është një parim i njohur dhe pranuar edhe në të drejtën ndërkombëtare private. Në nenin 24.1/2 të ligjit DNP, legjislatori përdor termin **“ndryshimi i regjimit pasuror martesor”**.

Ndryshimi i regjimit pasuror, mund të jetë vullnetar, në hipotezën kur bashkëshortët ndryshojnë në marrëveshje ndërmjet tyre ligjin e zbatueshëm, ose ndryshojnë regjimin pasuror pa ndryshuar ligjin e zbatueshëm; ose jovullnetar, në hipotezën kur ndryshon një nga rrethanat, që ka sjellë përcaktimin e ligjit të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore, ndërmjet bashkëshortëve¹⁰⁰⁸.

Gjithashtu, bërë dallimin ndërmjet dy koncepteve të rëndësishëm: ndryshimi material i regjimit pasuror dhe ndryshimi konfliktual (ndryshimi i ligjit të zbatueshëm)¹⁰⁰⁹. Si ndryshimi material ashtu dhe ai konfliktual i regjimit pasuror mund të jenë të pavarura nga vullneti i bashkëshortëve (ndryshime objektive) ose mund të realizohen nëpërmjet një marrëveshje të bashkëshortëve (ndryshimet vullnetare).

Nga analiza e mësipërme dallojmë katër raste kryesore të ndryshimit të regjimit pasuror martesor, të cilat do t'i marrim analizojmë në vazhdim¹⁰¹⁰:

- 1) **Ndryshimi konfliktual vullnetar** – ndryshimi i ligjit të zbatueshëm më marrëveshje të bashkëshortëve;
- 2) **Ndryshimi konfliktual automatik** (ipso jure) – ndryshimi i ligjit të zbatueshëm për shkak të ndryshimit të kriterëve të lidhjes;
- 3) **Ndryshimi material vullnetar** – ndryshimi i regjimit pasuror martesor me marrëveshje të bashkëshortëve (ndryshim kontraktor i regjimit pasuror);
- 4) **Ndryshimi material ligjor** – ndryshimi i regjimit pasuror në legjislacionin material të thirrur për zbatim nga normat e konfliktit.

Në të gjitha rastet e ndryshimit të regjimit pasuror martesor dy probleme shtrohen për diskutim: *së pari*, fakti nëse ndryshimi i regjimit pasuror martesor do të ketë fuqi prapavepruese që nga çasti i lidhjes së martesës dhe; *së dyti*, mënyra e mbrojtjes së të tretëve, që do të hyjnë në marrëdhënie kontraktore me bashkëshortët, nga ky ndryshim i regjimit pasuror martesor dhe nga fuqia prapavepruese e tij¹⁰¹¹.

¹⁰⁰⁷ Bonomi, “Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare.” fq.71.

¹⁰⁰⁸ Mayer, Pierre. dhe Heuzé, Vincent. *Droit International privé*. 10 édition. Paris: Montchrestien Lextenso ed., 2010, fq.607.

¹⁰⁰⁹ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 330.

¹⁰¹⁰ Për këtë klasifikim të hipotezave të ndryshimit të regjimit pasuror martesor jemi mbështetur në trajtimet e: Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq.337; Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 330.

¹⁰¹¹ Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq. 338.

6.8.1. Ndryshimi konfliktual vullnetar

Ndryshimi konfliktual vullnetar i regjimit pasuror shfaqet në hipotezën kur bashkëshortët me marrëveshje ndërmjet tyre, ndryshojnë ligjin e zbatueshëm, gjatë kohëzgjatjes së martesës, ndryshim, i cili sjell ndryshimin e regjimit pasuror martesor¹⁰¹².

Ligji DNP nuk parashikon në mënyrë të shprehur mundësinë e bashkëshortëve për të ndryshuar, gjatë martesës, ligjin e zbatueshëm.

Jemi të mendimit që, në mungesë të një ndalimi të shprehur nga neni 24 i ligjit DNP, bashkëshortët janë të lirë të ndryshojnë, gjatë kohëzgjatjes së martesës, ligjin e zbatueshëm për regjimin pasuror martesor, mjafton që të respektojnë kriterin formal të parashikuar nga neni 24.2 i ligjit DNP (akti noterial ose një akt tjetër i barazvlefshëm i lëshuar nga një organ publik). Është e kuptueshme që, e drejta e ndryshimit të ligjit të zbatueshëm do të ushtrohet brenda kriterëve të lidhjes së parashikuar nga neni 24.2 i ligjit. Në këtë drejtim, nisur nga fakti që, ligji DNP nuk parashikon kufizime, bashkëshortët mund të ndryshojnë ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor edhe disa herë gjatë martesës.

Shtrohet pyetja, se nga cili moment kohor do të sjellë pasoja ndryshimi i ligjit të zbatueshëm, ndryshim i cili do të pasjellë ndryshimin e regjimit pasuror martesor. Regjimi i ri pasuror do të sjellë efekte vetëm për të ardhmen apo do të sjellë efekte prapavepruese, që nga momenti i lidhjes së martesës? A kanë të drejtë bashkëshortët të ndryshojnë me efekte prapavepruese ligjin e zbatueshëm?

Jemi të mendimit që, në mungesë të një ndalimi të shprehur në ligj, bashkëshortët mund të ndryshojnë me efekt prapaveprues ligjin e zbatueshëm. Në këtë hipotezë, fuqia prapavepruese e regjimit të ri pasuror do të sjellë efekte vetëm për bashkëshortët dhe jo për të tretët, pasojat për të cilët do të zbatohen vetëm për të ardhmen. Ndërsa, në mungesë të një rregullimi të shprehur në marrëveshjen e bashkëshortëve, ndryshimi i ligjit të zbatueshëm do të sjellë pasoja vetëm për të ardhmen¹⁰¹³.

6.8.2. Ndryshimi material vullnetar

Ndryshimin material vullnetar e ndeshim në hipotezën kur bashkëshortët, me marrëveshje ndërmjet tyre, ndryshojnë regjimin pasuror martesor, ose ndryshojnë disa aspekte të tij, pa ndryshuar ligjin e zbatueshëm.

Regjimi pasuror martesor mund të ndryshohet me marrëveshje të bashkëshortëve, gjatë martesës, sipas kushteve dhe vetëm nëse është e lejuar sipas legjislacionit të thirrur për zbatim nga normat e konfliktit. Kujtojmë këtu që, megjithëse pjesa më e madhe e legjislacioneve europiane sot pranon ndryshimin e regjimit pasuror martesor, gjatë martesës, ka akoma disa legjislacione që, parashikojnë parimin e pandryshueshmërisë së regjimit pasuror (psh. KC Portugez) ose

¹⁰¹² Ndryshimi konfliktual vullnetar i shoqëruar me ndryshimin material vullnetar. Ndryshimi konfliktual vullnetar, shpeshherë në praktikë, shoqërohet me ndryshimin material vullnetar të regjimit pasuror. Zakonisht, në rastin kur bashkëshortët vendosin të zgjedhin një ligj tjetër të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor, vendosin të rregullojnë, nëpërmjet kontratës martesore, regjimin pasuror, në përputhje me kuadrin ligjor të ofruar nga legjislacioni i zgjedhur prej tyre. Për këtë shih: Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 331.

¹⁰¹³ Në legjislacionin Zciverian ligji i zgjedhur për zbatim nga bashkëshortët ka fuqi prapavepruese që nga çasti i lidhjes së martesës, nëse bashkëshortët me marrëveshje nuk kanë përcaktuar ndryshe (neni 53/2 i ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private). Të njëjtën zgjidhje, duke parashikuar shprehimisht edhe mbrojtjen e të tretëve bën edhe Konventa e Hagës së vitit 1978. Ndërsa legjislacioni Gjerman bën një zgjidhje të kundërt, për të, ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka efekte "ex nunc", me përjashtim të rastit kur bashkëshortët me marrëveshje kanë vendosur ndryshe. Për këtë vështrim krahasues shih: Bonomi, "Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare." fq. 65.

legjislacione që kërkojnë plotësimin e kushteve të caktuara, si psh. kalimin e një afati 2 vjeçar (KF Shqiptar) ose miratimin gjyqësor (KC Italian).

Sipas mendimit mbizotërues të doktrinë, nëse ligji material, tek i cili referojnë për zbatim normat e konfliktit nuk lejon ndryshimin e regjimit pasuror martesor (gjatë martesës), atëherë bashkëshortët nuk mund ta ndryshojnë atë. Por, në zgjidhje të këtij problem, bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë ligjin e zbatueshëm (ndryshimi konfliktual vullnetar) dhe të zgjedhin për zbatim, legjislacionin e një shteti që u jep atyre mundësinë e ndryshimit të regjimit pasuror martesor *constante matrimonii*¹⁰¹⁴. Mundësia ose jo e efekteve prapavepruese të regjimit pasuror martesor si dhe mbrojtja e të tretëve do të rregullohet nga ligji i zgjedhur për zbatim nga palët.

6.8.3. *Ndryshimi konfliktual automatik*

Ndodhemi përpara rastit të ndryshimit konfliktual automatik, të regjimit pasuror, në hipotezën e ndryshimit “*ipso jure*” të kriterit të lidhjes, i cili ka shërbyer për të përcaktuar legjislacionin e zbatueshëm për rregullimin e këtij regjimi, psh. nëse ndryshon shtetësia e bashkëshortëve ose vendqëndrimi i tyre i zakonshëm ose shteti me të cilin ata kanë lidhjet më të ngushta. Ndryshimi i kriterëve të lidhjes sjell si pasojë ndryshimin e legjislacionit të zbatueshëm dhe për rrjedhojë ndryshimin e normave materiale rregulluese të regjimit pasuror martesor, i cili nga ana e tij sjell ndryshimin e vetë regjimit pasuror martesor të bashkëshortëve¹⁰¹⁵.

Për ti dhënë zgjidhje problemit të ndryshimit të regjimit pasuror martesor pa vullnetin e bashkëshortëve, doktrina dallon dy hipoteza të “ndryshimit konfliktual automatik”¹⁰¹⁶:

- a) *Mungesa e një marrëveshje të bashkëshortëve për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm.* Në këtë hipotezë legjislacioni i zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor është përcaktuar mbi bazën e kriterëve të lidhjes të Nenit 23 të ligjit DNP;
- b) *Ekzistenca e një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve për përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor,* sipas kushteve të parashikuar në nenin 24 të ligjit DNP. Në këtë hipotezë shfaqet problemi i ndryshimit të kriterit të lidhjes që ka qenë vendimtar për palët në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm.

Në hipotezën e dytë, përgjithësisht, doktrina juridike është shprehur kundër ndryshimit të legjislacionit rregullues të regjimit pasuror martesor, tek i cili referojnë kriteret e lidhjes sepse, ky ndryshim automatik bien ndesh me vullnetin e bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët, me marrëveshje, kanë zgjedhur legjislacionin e zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, atëherë vetëm një marrëveshje e dytë ndërmjet tyre mund të sjellë ndryshimin e ligjit të zbatueshëm dhe për rrjedhojë të regjimit pasuror martesor¹⁰¹⁷.

Ndryshimi konfliktual automatik i ka dhënë jetë debateve të shumta dhe për rrjedhojë zgjidhje të ndryshme janë propozuar nga doktrina, legjislacionet e vendeve të ndryshme ose konventat ndërkombëtare. Ndër problemet që shtrohen për diskutim janë; a) cili është ligji që do të rregullojë mbarimin, pjesëtimin ose vazhdimin e regjimit pasuror martesor; b) si do të rregullohen marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve në hipotezën e kalimit nga një regjim bashkësie në një regjim të pasurive të ndara; c) si do të rregullohen marrëdhëniet ndërmjet

¹⁰¹⁴ Për këtë mendim doktrinal shih: Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 344-345.

¹⁰¹⁵ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 348.

¹⁰¹⁶ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 349.

¹⁰¹⁷ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 350.

bashkëshortëve dhe të tretëve¹⁰¹⁸. Le t'i hedhim një vështrim zgjidhjeve të propozuara nga doktrina.

A. Zgjidhjet e propozuara nga doktrina. Për të zgjidhur këtë problem doktrina propozon disa zgjidhje.

Zgjidhja e parë e propozuar është fiksimi (përcaktimin) në kohë i kriterëve të lidhjes¹⁰¹⁹ (psh: të përcaktohet që “*ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor është ligji i shtetësisë së përbashkët/vendqëndrimit të përbashkët të zakonshëm në kohën e lidhjes së martesës*”)¹⁰²⁰. Neni 23 dhe 24 i ligjit DNP nuk parashikojnë fiksimin në kohë të kriterëve të lidhjes dhe për rrjedhojë bashkëshortët janë të ekspozuar ndaj ndryshimit konfliktual automatik. Kjo zgjidhje është e kritikuar nga një pjesë tjetër e doktrinës, me argumentin që, megjithëse nga njëra anë fiksimi në kohë i kriterëve të lidhjes parandalon problemin e ndryshimit konfliktual automatik, nga ana tjetër, ky fiksion do të sillte pasoja akoma më të rënda. Ky fiksion do të sillte si pasojë mungesën e lidhjes ndërmjet ligjit të zbatueshëm dhe marrëdhënies bashkëshortore, çka vjen në kundërshtim me një nga qëllimet e të drejtës ndërkombëtare private moderne, që është përshtatja e marrëdhënies bashkëshortore me mjedisin social në të cilin ata jetojnë¹⁰²¹. Argumenti i dytë kundër fiksimit në kohë të kriterëve të lidhjes është nevoja e mbrojtjes së të tretëve që kontraktojnë me bashkëshortët, për të cilët është më e lehtë njohja e ligjit të vendqëndrimit të zakonshëm aktual të bashkëshortëve, në raport me ligjin e vendqëndrimit të zakonshëm të mëparshëm të tyre¹⁰²².

Zgjidhja e dytë e propozuar nga doktrina është ruajtja e ndryshimit konfliktual automatik dhe dhënia e fuqisë prapavepruese¹⁰²³ që nga data e lidhjes së martesës, të legjislacionit të ri, të cilin thërret për zbatim kriteri i ri i lidhjes. Kjo zgjidhje, e parashikuar nga disa legjislacione, ka si avantazh evitimin e fragmentarizmit të regjimit pasuror martesor, sipas legjislacioneve të ndryshme.¹⁰²⁴

B. Zgjidhja e legjislacionit shqiptar. Nga leximi i përbashkët i nenit 23 dhe 24 të ligjit DNP rezulton, që ligjvënësi shqiptar nuk ka parashikuar asnjëherë nga zgjidhjet e propozuara nga doktrina, që do të thotë se kriteret e lidhjes nuk janë të fiksuara në kohë si dhe nuk ka parashikuar fuqinë prapavepruese të regjimit të ri pasuror¹⁰²⁵.

Ky rregullim i ligjvënësit sjell si pasojë fragmentarizmin e regjimit pasuror martesor (rregullimin nga disa legjislacione), fragmentarizëm i cili sjell vështirësi të konsiderueshme në fazën e likuidimit të pasurisë.

¹⁰¹⁸ Herzfelder, François. *Problèmes relatifs au régime matrimonial en droit international privé français et allemand*. Paris: Librairies Technique, Librairie de la Cour de Cassation, fq. 138.

¹⁰¹⁹ Këtë zgjidhje parashikojnë, në legjislacionet e tyre të së drejtës ndërkombëtare private, shtete të tilla si: Gjermani, Angli, Austri, Spanjë, Portugali, Turqi, Greqi. Për këtë shih: Bonomi, “Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare.” fq. 71.

¹⁰²⁰ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 351.

¹⁰²¹ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 351-352; Carlier, *Autonomie de la volonte et statut personnel*, fq. 339.

¹⁰²² Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 352-353.

¹⁰²³ Në këtë drejtim neni 55 i ligjit Zvicerian dhe ai Italian për DNP parashikon fuqinë prapavepruese të legjislacionit të ri, nëse palët nuk parashikojnë ndryshime me marrëveshje ndërmjet tyre. Për këtë shih: Bonomi, “Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare.” fq. 71.

¹⁰²⁴ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 353.

¹⁰²⁵ Kjo do të thotë që, bazuar në legjislacionin shqiptar, ndryshimi i kriterëve të lidhjes që kanë qenë përcaktues në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, gjatë martesës, do të sjellë ndryshimin e ligjit të zbatueshëm dhe për rrjedhojë ndryshimin e regjimit pasuror martesor. Ky ndryshim do të sjellë pasoja vetëm për të ardhmen (nuk ka fuqi prapavepruese). Në këtë drejtim ligji shqiptar DNP është plotësisht konform Konventës së Hagës së vitit 1978.

Megjithatë, nenin 24.1/2 parashikon që, ndryshimi i regjimit pasuror martesor nuk prek të drejtat e fituara më parë nga bashkëshortët.

Në mënyrë që bashkëshortët të parandalojnë fragmentarizmin e regjimit pasuror martesor, rekomandojmë që ata, në rastin e ndryshimit të automatik të regjimit pasuror martesor, për shkak të ndryshimit të kriterëve të lidhjes, me marrëveshje ndërmjet tyre t'i japin fuqi prapavepruese regjimit pasuror të ri. Në drejtim të kësaj zgjidhje nenin 24 i ligjit DNP nuk shprehet, megjithatë është një zgjidhje e lejuar përderisa nuk ndalohej në mënyrë të shprehur nga ligji.

Gjithashtu, rekomandojmë që, bashkëshortët, nëpërmjet kontratës martesore, të ndryshojnë regjimin pasuror martesor, në përputhje me kufizimet e ligjit material të legjislacionit të ri të thirrur për zbatim ose një zgjidhje alternative do të ishte ndryshimi me marrëveshje i ligjit të zbatueshëm dhe zgjedhja e ligjit të një shteti tjetër, që i përshtatet më mirë marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve.¹⁰²⁶

6.8.4. *Ndryshimi material ligjor*

Ndryshimi material ligjor ndodh në rastin kur ndryshon regjimi pasuror martesor për shkak të ndryshimit të vetë ligjit material rregullues të marrëdhënieve familjare, të legjislacionit, të cilin normat e konfliktit kanë thirrur për zbatim. Dy hipoteza duhen dalluar në rastin e ndryshimit material ligjor.

A. *Konflikti tranzitor i normave materiale.* Ndryshimi i ligjit material që, rregullon regjimin pasuror martesor të bashkëshortëve, nëse sjell ndryshimin e regjimit pasuror martesor (psh. ndryshon kodi i familjes i legjislacionit të zbatueshëm – ndryshimi i KF në Shqipëri në vitin 2003).

Në praktikë, nuk krijohen probleme në këtë drejtim, sepse zakonisht çdo legjislacion parashikon norma tranzitore që bazohen në mungesën e fuqisë prapavepruese të ligjit material civil¹⁰²⁷. Probleme paraqiten në hipotezën kur ligji i ri parashikon zbatimin me efekte prapavepruese të regjimit pasuror ligjor të rregulluar në këtë ligj, që nga data e lidhjes së martesës. Jemi të mendimit që, nëse legjislacioni i zbatueshëm është përcaktuar nga kriteret objektive të lidhjes (neni 23 i ligjit DNP), atëherë ndryshimi i ligjit material, edhe nëse ai ka fuqi prapavepruese, do të sjellë pasoja për bashkëshortët. Ndërsa, nëse ligji i zbatueshëm është përcaktuar me marrëveshje të bashkëshortëve dhe bashkë me caktimin e ligjit të zbatueshëm palët kanë rregulluar edhe regjimin pasuror martesor, atëherë ndryshimi i normave materiale nuk do të sjellë pasoja për palët. Në rastin kur palët, kanë përcaktuar me marrëveshje vetëm ligjin e zbatueshëm dhe jo regjimin pasuror martesor, atëherë ndryshimi i regjimit pasuror në normat materiale do të sjellë pasoja edhe për bashkëshortët¹⁰²⁸.

B. *Konflikti tranzitor i normave materiale të së drejtës ndërkombëtare private.* Ndryshimi i ligjit material ndërkombëtar privat, që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile me elementë të huaj, nëse përcakton kriterë të reja lidhje (psh: ndryshimi i ligjit DNP në Shqipëri në vitin 2011). Ndryshimi i ligjit rregullues të së Drejtës Ndërkombëtare Private të “*lex fori*” mund të shoqërohet me ndryshimin e kriterëve të lidhjes (nëse ligji i ri parashikon të tjera kriterë lidhje), ndryshimi i të cilave mund të çojë në zbatimin e ligjit të një shteti tjetër, të ndryshëm nga i pari dhe për rrjedhojë të ndryshojë regjimi pasuror martesor. Në praktikë nuk krijohen probleme në

¹⁰²⁶ Për këtë zgjidhje shih: Carlier, “Autonomie de la volonté et statut personnel.” fq.343-344.

¹⁰²⁷ Në të njëjtin parim mbështetet edhe kodi aktual i familjes. Sipas nenit 314, ky kod zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij.

¹⁰²⁸ Diago D, *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*, fq. 370.

këtë drejtim, sepse zakonisht çdo legjislacion parashikon norma tranzitore që, bazohen në mungesën e fuqisë prapavepruese të ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private¹⁰²⁹.

6.9. Mbarimi dhe likuidimi i regjimit pasuror martesor

6.9.1. Rastet e mbarimit të regjimit pasuror martesor

Bazuar në parimin e unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi tërësinë e regjimit pasuror martesor, nxjerrim përfundimin që, ligji i zbatueshëm mbi rastet e mbarimit të regjimit pasuror rregullohen nga ligji i zbatueshëm mbi vetë regjimin pasuror “*lex causae*” (që mund të jetë ligji i zgjedhur me marrëveshje nga palët, apo ligji i përcaktuar mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes së nenit 23 të ligjit DNP, në mungesë të marrëveshjes së palëve). *Lex causae* do të rregullojë të gjitha rastet e mbarimit të regjimit pasuror martesor: a) mbarimi për shkak të zgjidhjes së martesës; b) mbarimi nëpërmjet pjesëtimit gjyqësor dhe c) mbarimi për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort. Gjithashtu, *lex causae* do të rregullojë jo vetëm rastet e mbarimit të regjimit pasuror, por edhe pasojat që sjell mbarimi i regjimit, megjithëse jo në mënyrë ekskluzive¹⁰³⁰.

A. Mbarimi për shkak të zgjidhjes së martesës. Ligji që rregullon mbarimin e regjimit pasuror për shkak të zgjidhjes së martesës është “*lex causae*”. Debate në doktrinë ekzistojnë lidhur me ligjin e zbatueshëm mbi momentin kohor të fillimit të ardhjes së pasojave. Në disa legjislacione vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës sjell pasoja që nga data e paraqitjes së kërkesës, ndërsa në disa legjislacione të tjera, duke përfshirë këtu edhe ligjin tonë (kod.fam.), pasojat vijnë nga data që vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës merr formë të prerë. Pavarësisht debateve doktrinale¹⁰³¹, është pranuar gjerësisht që, ligji i zbatueshëm është “*lex causae*”, sepse duke qenë se, vendimi i gjykatës sjell njëkohësisht me mbarimin e martesës edhe mbarimin e regjimit pasuror martesor, momenti kohor i ardhjes së pasojave trajtohet si një çështje e ligjit material dhe jo atij procedural.

B. Mbarimi i regjimit pasuror për shkak të pjesëtimit gjyqësor të bashkësisë. Ekzistojnë debate në doktrinë, në drejtim të ligjit të zbatueshëm mbi “*pjesëtimin gjyqësor të pasurisë, gjatë regjimit të bashkësisë*”, debate të cilat ndahen ndërmjet një pjese të doktrinës që e gjen zgjidhjen tek *lex nationalis* i secilit bashkëshort, një tjetër mendimi doktrinal që zgjidhjen e gjen tek “*lex fori*”, me argumentin që, pjesëtimi gjyqësor bën pjesë në klauzolën e rendit publik dhe pjesës më të madhe të doktrinës, e cila zgjidhjen e gjen tek “*lex causae*” ligji i regjimit pasuror martesor¹⁰³². Jemi të mendimit që zbatimi i “*lex causae*” mbi pjesëtimin gjyqësor të pasurisë është zgjidhja më e pranueshme dhe gjithashtu ka gjetur mbështetjen më të madhe në doktrinë. Argumentet kryesor në mbështetje të kësaj teze mbështeten në faktin që, pranimi i kërkesës për pjesëtimin gjyqësor të pasurisë sjell si pasojë mbarimin e regjimit të bashkësisë dhe vendosjen e bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara, pra lidhet ngushtësisht me funksionimin e regjimit pasuror martesor si dhe gjithashtu pjesëtimi përfaqëson një sanksion që zbatohet në rast të keq administrimit të pasurisë së bashkësisë¹⁰³³.

¹⁰²⁹ Në nenin 87 të ligjit DNP parashikohet që ky ligj zbatohet vetëm për marrëdhëniet juridiko-civile që lindin pas hyrjes në fuqi të tij.

¹⁰³⁰ Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 253.

¹⁰³¹ Për më shumë rreth këtij debati doktrinal shih: Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 253-254.

¹⁰³² Për më shumë rreth këtij debati doktrinal shih: Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 230-232.

¹⁰³³ Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 233.

Gjithashtu, ka debate në doktrinë në lidhje me momentin kohor kur vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurisë do të sjellë efektet për vetë palët dhe për të tretët. Kujtojmë këtu që, shumë legjislacione, duke përfshirë edhe kod.fam. i japin efekte prapavepruese vendimit të gjykatës, që nga data që është paraqitur padia. Edhe në kuadër të këtij debati, pavarësisht se nuk mungojnë edhe opinionet e kundërta¹⁰³⁴, pjesa më e madhe e doktrinës mban qëndrimin që, ligji i zbatueshëm mbi pasojat e pjesëtimin gjyqësor të pasurisë së bashkësisë dhe momentin e ardhjes së tyre është *lex causae*. Argumentin doktrina e bazon tek qëllimi i ligjvënësit, në rregullimin e efekteve prapavepruese të vendimit të gjykatës, qëllim i cili është mbrojtja e pasurisë së bashkësisë nga veprimet abuzive të njërit bashkëshort. Për rrjedhojë, nuk është aspak e gabuar të pohojmë, që fuqia prapavepruese e vendimit të gjykatës është element i ligjit material dhe jo i atij procedural, argument i cili përjashton zbatimin e "*lex fori*"¹⁰³⁵.

C. Mbarimi i regjimit pasuror për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort. Ekziston një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet institutit të regjimit pasuror martesor dhe atij të trashëgimisë. Rregullimi ligjor i tyre paraqet pika të shumta interference dhe bashkëveprimi.

Në hipotezën e përfundimit të martesës me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, përbërja e pasurisë trashëgimore të bashkëshortit të vdekur do të varet shumë nga regjimi pasuror martesor të cilit i janë nënshtruar bashkëshortët gjatë martesës, regjimit të bashkësisë apo atij të pasurive të ndara.

Duhet dalluar qartë e drejta që i lind bashkëshortit pasjetues mbi pasurinë e fituar gjatë martesës dhe e drejta që i lind bashkëshortit pasjetues mbi pasurinë e bashkëshortit të vdekur, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor apo testamentar të këtij të fundit. Këto dy të drejta, të bashkëshortit pasjetues, rregullohen nga dy legjislacione të ndryshme që, thirren për zbatim mbi bazën e kritereve të ndryshme të lidhjes.

Rregulli që ndiqet është realizimi, në fazën e parë, të pjesëtimin të pasurisë trashëgimore, ose njohjes së të drejtës së bashkëshortit pasjetues mbi këtë pasuri dhe në fazën e dytë, realizohet njohja e të drejtave të bashkëshortit pasjetues (pjesës takuese) mbi pasurinë e bashkëshortit të vdekur¹⁰³⁶. Përcaktimi i përbërjes së pasurisë trashëgimore mund të realizohet vetëm pas përfundimit të regjimit pasuror martesor. Problemi qëndron që, nisur nga fakti që këto dy faza realizohen mbi bazën e legjislacioneve të shteteve të ndryshme dhe realizimi i këtyre dy etapave bëhet mbi bazën e procedurave të ndryshme. Kështu, nga leximi i kombinuar i neneve 23, 24 dhe 33 të ligjit DNP, rezulton qartë që, ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor dhe ai për trashëgiminë, rregullohen mbi bazën e kritereve të ndryshme të lidhjes.

Në këtë mënyrë, një koordinim ndërmjet ligjit që rregullon regjimin pasuror martesor dhe legjislacionit që rregullon trashëgiminë është shumë i nevojshëm, mungesa e një koordinimi të tillë mund të sjellë si pasojë dëmtimin e interesave pasurorë të bashkëshortit pasjetues ose favorizimin e tij¹⁰³⁷. Shumë autorë shprehen për një domosdoshmëri të koordinimit të ligjit të

¹⁰³⁴ Sipas një mendimi tjetër doktrinal, fuqia prapavepruese e vendimit të gjykatës lidhet me aspektin procedural, nuk është element i ligjit material dhe për rrjedhojë rregullohet nga "*lex fori*". I gjithë diskutimi doktrinal ndalet në zgjidhjen e problemit të kualifikimit të efektit prapaveprues të pasojave të vendimit të gjykatës, në kuadër të ligjit procedural (aspekti procedural i pjesëtimin) apo në kuadër të ligjit material.

¹⁰³⁵ Në mbështetje të këtyre argumenteve shih: Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 254-255.

¹⁰³⁶ Garofalo, *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, fq. 137.

¹⁰³⁷ P.sh: mund të sjellë dëmtim të interesave të bashkëshortit pasjetues, situata në të cilën, ligji i zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, parashikon regjimin e pasurive të ndara, ndërsa, ligji i zbatueshëm për trashëgiminë nuk parashikon për bashkëshortin pasjetues njohjen e të drejtës trashëgimore mbi pasurinë e bashkëshortit të vdekur. Shih: Herzfelder, *Problèmes relatifs au régime matrimonial en droit international privé français et allemand*, fq. 96; Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Vol. XII, fq. 265.

zbatueshëm mbi regjimin pasuror dhe atij të zbatueshëm mbi trashëgiminë në mënyrë që të shmangen probleme të kualifikimit¹⁰³⁸.

6.9.2. Likuidimi dhe pjesëtimi i regjimit pasuror martesor

Si rregull i përgjithshëm, ligji i zbatueshëm mbi likuidimin dhe pjesëtimin e regjimit pasuror martesor është *lex causae*. Megjithatë, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, disa çështje vlejné për tu diskutuar.

A. Prova e pronësisë së sendeve. Bazuar në dispozitat e kod.fam. konstatojmë që rregullat e provës së pronësisë së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme janë elementë thelbësorë dhe integrale jo vetëm të regjimeve të bashkësisë, por edhe të regjimit të pasurive të ndara. Për rrjedhojë, prova e pronësisë së sendeve është çështje e ligjit material dhe jo atij procedural dhe si e tillë do të rregullohet nga i njëjti ligj që rregullon regjimin pasuror martesor "*lex causae*"¹⁰³⁹.

B. Marrëveshja e pjesëtimit të pasurisë. Debati doktrinal, në drejtim të ligjit të zbatueshëm mbi marrëveshjen e bashkëshortëve për pjesëtimin e pasurisë, shtrihet ndërmjet mbështetësve të *lex causae* dhe asaj pjese të doktrinës që, është e mendimit se, përcaktimi i ligjit të zbatueshëm mbi marrëveshjen e pjesëtimit duhet kërkuar tek kriteret e lidhjes që përcaktojnë legjislacionin e zbatueshëm mbi kontratën në përgjithësi¹⁰⁴⁰, të rregulluar në nenet 45, 46 dhe 47 të ligjit DNP.

C. Pjesëtimi gjyqësor i pasurisë pas mbarimit të regjimit pasuror. Në kuadër të pjesëtimit gjyqësor të pasurisë së fituar gjatë martesës shtrohet problemi se cili do të jetë raporti dhe roli që kanë *lex cause*, *lex fori* dhe *lex rei sitae*.

Jemi të mendimit që, përcaktimi i masës së pasurisë objekt pjesëtimi, përcaktimi i bashkëpronarëve, përcaktimi i pjesëve takuese, të drejtat e kompensimit rregullohen nga ligji i regjimit pasuror martesor "*lex causae*"¹⁰⁴¹.

Bazuar në nenin 82¹⁰⁴² të ligjit DNP, nga pikëpamja procedurale gjykimi i kërkesës për pjesëtimin e pasurisë së bashkësisë (rregullat procedurale), afatet e ankimimit të vendimit si dhe publiciteti i vendimi gjyqësor do të rregullohen nga *lex fori*¹⁰⁴³. Kështu, nëse pjesëtimi i pasurisë së dy bashkëshortëve, me shtetësi të ndryshme, realizohet në gjykatat shqiptare, pavarësisht ligjit që rregullon regjimin e tyre pasuror, në aspektin procedural, gjykatat shqiptare gjithmonë do të zbatojnë *lex forin*, pra ligjin shqiptar (ligjin e vendit ku është paraqitur padia për pjesëtim), që në rastin konkret do të përfaqësohet nga kod.proc.civ., si dhe nga dispozitat procedurale të kod.fam dhe kod.civ.

¹⁰³⁸ Wiederkehr, *Les conflicts de loi en matière de régime matrimonial. Volume VII*, fq. 34-35; Herzfelder, *Problèmes relatifs au régime matrimonial en droit international privé français et allemand*, fq. 96.

¹⁰³⁹ Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial. Vol. XII*, fq. 258.

¹⁰⁴⁰ Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial. Vol. XII*, fq. 256.

¹⁰⁴¹ Mendimi ynë është i mbështetur në argumentet e: Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial. Vol. XII*, fq. 276.

¹⁰⁴² Neni 82 i ligjit DNP "1. Gjykimi i çështjeve gjyqësore me elemente të huaja para gjykatave shqiptare bëhet sipas ligjit procedural shqiptar.

2. Subjektet e huaja, si dhe personi pa shtetësi gëzojnë në gjykimet civile, të cilat zhvillohen para gjykatave shqiptare, të njëjtat të drejta dhe garanci procedurale si subjektet shqiptare."

¹⁰⁴³ Batiffol dhe Lagarde, *Droit International Privé*, fq. 383. Couchez, *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial. Vol. XII*, fq. 276.

6.10. Regjimet pasurore dhe kontrata martesore në aktet ndërkombëtare dhe europiane në planin e së drejtës ndërkombëtare private

Megjithëse në Republikën e Shqipërisë nuk janë të detyrueshme për zbatim Konventa e Hagës (nuk janë ratifikuar nga RSH) apo legjislacioni europian, në fushën e regjimeve pasurore martesore, studimi i këtyre normave paraqet rëndësi, si në aspektin doktrinal ashtu dhe në atë praktik, pasi ato kanë shërbyer si modele në hartimin e legjislacionit shqiptar mbi të drejtën ndërkombëtare private, dhe në këtë drejtim studimi i tyre do të shërbente një kuptimi më të mirë të legjislacionit tonë, në mungesë të praktikës gjyqësore dhe mendimit doktrinal të brendshëm.

Nga ana tjetër, edhe studimi i legjislacionit europian është i rëndësishëm në kuadër të detyrimit të shtetit shqiptar për përafrimin e legjislacionit me “*acqui communautaire*”, si një ndër kushtet e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Si në planin ndërkombëtar ashtu dhe në atë europian, përpjekjet e realizuara në fushën e harmonizimit të së drejtës së regjimeve pasurore martesore, janë shtrirë vetëm në nivelin e normave të së drejtës ndërkombëtare private, duke lënë të parregulluar harmonizimin e së drejtës materiale, rregullimi i së cilës vazhdon të jetë në kompetencën ekskluzive të shteteve anëtare të BE-së. Kjo është një zgjidhje e mirëkuptueshme, pasi për shkak të ndryshimeve thelbësore që paraqesin legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare, në fushën e regjimit pasuror martesor, ndryshime këto të diktuar nga faktorë të tillë si, tradita, kultura, zhvillimi social dhe ekonomik i çdo shteti, harmonizimi i legjislacionit material është tepër i vështirë.

Në planin ndërkombëtar, i vetmi instrument në fushën e regjimit pasuror martesor është Konventa e Hagës, e vitit 1978 “*Mbi ligjin e zbatueshëm mbi regjimet pasurore martesore*”, e cila ka zëvendësuar Konventën e vitit 1905, ndërsa në nivelin e BE-së Projekt-Rregullorja e vitit 2011.

6.10.1. Konferenca e Hagës

Megjithë përhapjen e pakët, të Konventave të fushën së regjimeve pasurore, ndërmjet shteteve anëtare të Konferencës së Hagës, studimi i tyre është i rëndësishëm, sepse kanë shërbyer si model për reformimin e legjislacioneve të së drejtës ndërkombëtare private, në fushën e regjimeve pasurore, të pjesës më të madhe të vendeve të Europës Kontinentale, duke përfshirë këtu: Italinë, Gjermaninë, Zvicrën, Spanjën, Austrinë, Holandën, vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe së fundi Shqipërinë, me reformën e vitit 2011. Dy janë Konventat e Hagës në fushën e ligjit të zbatueshëm mbi regjimet pasurore martesore, Konventa e vitit 1905 dhe Konventa e vitit 1978, e cila ka zëvendësuar të parën.

A. Konventa e Hagës, e vitit 1905. Kjo Konventë është miratuar në seksionin e katërt të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, në vitin 1904. Konventa është miratuar nga Gjermania, Franca, Italia, Holanda, Portugalia, Rumania, Suedia (23 Gusht 1912), Belgjika (15 Prill 1913) si dhe Polonia (28 Nëntor 1923)¹⁰⁴⁴.

Fusha materiale e zbatimit të Konventës ishte vetëm regjimi pasuror martesor, ndërsa marrëdhëniet e karakterit personal jopasuror gjenin rregullim vetëm në Nenin 1 të Konventës.

Parimi themelor mbi të cilin mbështetej Konventa, në drejtim të përcaktimit të legjislacionit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, ishte parimi i atashimit (lidhjes) të regjimit pasuror

¹⁰⁴⁴ Vite më vonë nga miratimi Konventa është denoncuar nga shumica e shteteve që e kanë miratuar atë, si: Franca (1917), Belgjika (1922), Suedia (1962), Polonia (1972), Holanda (1977) dhe Gjermania (1987). Për më shumë shih: Droz dhe Martin-Bosly, “*Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I.*” fq. 208.

martesor me *statusin personal të bashkëshortëve*¹⁰⁴⁵. Gjithashtu, një parim tjetër i rëndësishëm i Konventës ishte edhe *parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm* mbi tërësinë e pasurisë së bashkëshortëve, pa bërë dallime ndërmjet pasurisë së luajtshme dhe asaj të paluajtshme.

Kriteri kryesor i lidhjes si për pasurinë e bashkëshortëve ashtu edhe për statusin e tyre pasuror ishte "*kriteri i shtetësisë*". Ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor ishte¹⁰⁴⁶:

- a) Ligji i shtetësisë së përbashkët të bashkëshortëve, në kohën e lidhjes së martesës;
- b) Në rastin e shtetësive të ndryshme të bashkëshortëve, zbatohet ligji i shtetësisë së bashkëshortit, në kohën e lidhjes së martesës.

Konventa eliminonte problemin e ndryshimit automatik të kriterëve të lidhjes, duke parashikuar që, ndryshimi i shtetësisë së përbashkët të bashkëshortëve ose i njërit prej tyre, nuk do të ndikonte në regjimin pasuror martesor¹⁰⁴⁷ (kriteret e lidhjes ishin të fiksuara në momentin e lidhjes së martesës).

Në bazë të nenit 5 të Konventës, vlefshmëria dhe efektet e kontratës martesore rregulloheshin nga ligji i shtetësisë së bashkëshortit, në momentin e lidhjes së martesës¹⁰⁴⁸.

B. Konventa e Hagës, e vitit 1978. Konventa është miratuar në seksionin e trembëdhjetë të Konferencës së Hagës, të vitit 1976 dhe hyri në fuqi në 1 Shtator, të vitit 1992. Konventa nuk ka pasur shumë sukses, ajo është ratifikuar nga vetëm tre shtete: Francë, Luksemburg dhe Holandë; si dhe është nënshkruar nga dy shtete të tjera: Austri dhe Portugali¹⁰⁴⁹. Pavarësisht suksesit të pakët, një numër i madh shtetesh kanë reformuar legjislacionin e tyre kombëtar mbi të drejtën ndërkombëtare private, nën modeli e dispozitave të Konventës.

Bazuar në nenin 1 të Konventës, në fushën materiale të zbatimit të saj përfshihet regjimi pasuror martesor, duke përjashtuar nga fusha e zbatimit detyrimin për ushqim, të drejtat e trashëgimisë së bashkëshortit pasjetues si dhe zotësisë juridike dhe atë për të vepruar të bashkëshortëve (neni 1.2). Mbetet ende e paqartë nëse disa marrëdhënie pasurore të bashkëshortëve, të tilla si kontributi material për nevojat e familjes, mbrojtja e banesës familjare dhe përfaqësimi ndërmjet bashkëshortëve, do të përfshihen ose jo në kuadrin e regjimit pasuror¹⁰⁵⁰. Në disa shtete këto marrëdhënie përfshihen në kuadër të regjimit pasuror, ndërsa në disa shtete të tjera bëhet dallimi ndërmjet regjimit primar dhe atij sekondar.

Konventa e vitit 1978 është larguar totalisht nga parimet e Konventës së vitit 1905. Ajo bazohet në parimin e ndarjes së regjimit pasuror martesor nga statusi personal i bashkëshortëve. Si rregull i përgjithshëm, përcaktimi i ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor bazohet në vullnetin e palëve. Nën ndikimin e Konventës, parimi i autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e

¹⁰⁴⁵ Ky parim u influencua nga ndikimet e juristit italian Mancini dhe Kodit Civil Italian të vitit 1865. Për më tepër shih: Droz dhe Martin-Bosly, "Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes I." fq. 210.

¹⁰⁴⁶ Droz dhe Martin-Bosly, "Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes I." fq. 210

¹⁰⁴⁷ Droz dhe Martin-Bosly, "Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes I." fq. 208.

¹⁰⁴⁸ Ky rregullim i Nenit 5 ishte një kompromis ndërmjet pjesës më të madhe të shteteve, të cilët mendonin që kontrata martesore duhej të nënshtrohej të njëjtave rregulla të zbatueshme për regjimin pasuror ligjor dhe përfaqësuesve të Francës, të cilët insistuan që, duhej të merrej në konsideratë deri në një masë të caktuar vullneti i palëve. Për më tepër shih: Droz dhe Martin-Bosly, "Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes I." fq. 211.

¹⁰⁴⁹ Marrë nga: <http://www.hcch.net>. Data e Aksesit: 12 Dhjetor 2013.

¹⁰⁵⁰ Droz dhe Martin-Bosly, "Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes I." fq. 217.

ligjit të zbatueshëm, në kuadër të regjimit pasuror martesor, është bërë në vitet në pasuese tendenca e legjislacioneve të të gjitha shteteve europiane¹⁰⁵¹.

Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve, në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, nuk është e pakufizuar. Bashkëshortët mund të zgjedhin për zbatim (neni 3):

- a) Ligjin e shtetit, të shtetësisë së njërit prej bashkëshortëve në momentin e lidhjes së marrëveshjes;
- b) Ligjin e shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit prej bashkëshortëve në momentin e lidhjes së marrëveshjes;
- c) Ligjin e shtetit të parë, në të cilin njëri prej bashkëshortëve do të vendosë vendqëndrimin e tij të zakonshëm, pas lidhjes së martesës.

Nën influencën e sistemit ligjor “*common law*”, paragrafi i dytë i nenit 3 të Konventës i jep të drejtën bashkëshortëve që për rregullimin e pasurisë së paluajtshme të zgjedhin për zbatim “*lex rei sitae*”, një ligj të ndryshëm nga ai që do të rregullojë marrëdhëniet e tjera pasurore të tyre. Në këtë mënyrë Konventa është larguar nga parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi të gjithë regjimin pasuror martesor, parimi i cili është karakteristikë e legjislacioneve romano-gjermanike. Konventa parashikon të drejtën e bashkëshortëve për të ndryshuar ligjin e zbatueshëm, në marrëveshje ndërmjet tyre, gjatë martesës, një risi kjo e konsiderueshme për shtetet anëtare në periudhën e miratimit të Konventës (neni 6).

Sipas nenit 10 të Konventës, pëlqimi i bashkëshortëve, për lidhjen e marrëveshjes së ligjit të zbatueshëm, rregullohet nga ligji i zgjedhur për zbatim nga bashkëshortët (ligji që rregullon regjimin pasuror martesor).

Bazuar në neni 5 të Konventës, në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, do të zbatohen kriteret objektive të lidhjes. Si rregull i përgjithshëm do të zbatohet ligji i vendqëndrimit të përbashkët të zakonshëm të bashkëshortëve. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, zbatohet ligji i shtetësisë së tyre të përbashkët, në këto raste:

- a) Në mungesë të vendqëndrimit të përbashkët të zakonshëm të bashkëshortëve;
- b) Nëse shtetet ratifikuese kanë bërë një deklaram për zbatimin e “*lex nationalis*” për shtetasit e tyre;
- c) Për shtetasit e shteteve që nuk janë palë të Konventës dhe vendosin vendqëndrimin e tyre të zakonshëm, pas lidhjes së martesës, në një shtet kontraktues që ka bërë rezervën e nenit 5 të Konventës.

Në alternativë të fundit, nëse bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme dhe kanë vendosur vendqëndrimin e tyre të zakonshëm në shtete të ndryshme, atëherë do të zbatohet ligji i shtetit me të cilin bashkëshortët kanë lidhjet më të ngushta.

Konventa rregullon disa aspekte të kontratës martesore, në drejtim të ligjit të zbatueshëm mbi zotësinë për të lidhur kontratë dhe të formës së deklaramit të vullnetit. Sipas nenit 3 të Konventës, zotësia për të lidhur kontratë martesore rregullohet nga ligji i shtetësisë së secilit bashkëshort, ndërsa forma e kontratës rregullohet nga ligji i vendit të lidhjes së kontratës (*lex loci regit actum*) ose sipas ligjit të shtetësisë së secilit prej bashkëshortëve, në kohën e lidhjes së martesës (neni 6). Në drejtim të formës, kontrata martesore është e vlefshme nëse është e lidhur në përputhje me kërkesat e formës së parashikuar nga ligji që rregullon regjimin pasuror martesor (*lex causae*), ose ligji i shtetit ku është lidhur kontrata (*lex loci regit actum*). Ligji parashikon një minimum kërkesash formale për vlefshmërinë e kontratës, për rrjedhojë në çdo rast kontrata martesore duhet të realizohet në formë të shkruar dhe duhet nënshkruar nga të dy bashkëshortët (neni 12/2). Neni 12 përfaqëson më shumë një normë materiale se sa një normë

¹⁰⁵¹ Droz dhe Martin-Bosly, “Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I.” fq. 219.

konflikti¹⁰⁵². Të njejtin rregullim ligjor Konventa bën edhe për formën e marrëveshjes së ligjit të zbatueshëm (neni 13).

Në drejtim të ndryshimit të regjimit pasuror martesor, si pasojë e ndryshimit të kriterëve të lidhjes, Konventa pranon vetëm ndryshimin vullnetar (marrëveshje) të kriterëve të lidhjes, ndërsa nuk pranon ndryshimin automatik të tyre. Për këtë arsye, Konventa parashikon fiksimin në kohë të kriterëve objektive të lidhjes.

Bazuar në nenin 8/1 të Konventës, ndryshimi i ligjit të zbatueshëm nuk ka fuqi prapavepruese, por i sjell pasojat vetëm për të ardhmen. Ky rregullim, i parashikuar nga Konventa sjell si pasojë zbatimin e disa regjimeve pasurore (një seri regjimesh), njëri pas tjetrit, në varësi të ndryshimit të kriterëve të lidhjes gjatë martesës. Kjo seri regjimesh pasurore mund të sjellë vështirësi në fazën e likuidimit të regjimit pasuror martesor, në përfundim të martesës¹⁰⁵³.

Për të parandaluar këtë problem, Konventa parashikon të drejtën e bashkëshortëve për të vendosur që i gjithë regjimi i tyre pasuror, që nga data e lidhjes së martesës, të rregullohet nga ligji i ri, të cilin thërrasin për zbatim kriteret e reja të lidhjes, por ky veprim prapa në kohë i regjimit pasuror martesor, nuk mund të prekë të drejtat e fituara nga të tretët.

Në analizë të fundit, duhet nxjerrë në pah që, megjithë kufizimet dhe imperfeksionet që e karakterizojnë atë, të cilat janë rezultat i përpjekjes për të harmonizuar sisteme të ndryshme ligjore, Konventa është instrumenti i vetëm që mund të vendosë sadopak rregull në kaosin e krijuar nga regjimet pasurore, në planin ndërkombëtar¹⁰⁵⁴.

6.10.2. Bashkimi European

Bazuar në nenet 67(1),(4)¹⁰⁵⁵ dhe 81¹⁰⁵⁶ të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European (TFEU), Këshilli i BE-së ka kompetenca në fushë e ligjit të zbatueshëm, juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në fushën civile, me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve europianë në drejtësi. Disa Rregullore janë miratuar në fushën e të drejtës familjare, në lidhje me ligjin e zbatueshëm, juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e martesës (Roma III), martesën dhe përgjegjësinë prindërore (Rregullore Bruksel II dhe Bruksel II bis) dhe detyrimin për ushqim.

¹⁰⁵² Ky rregullim ka pasur për qëllim harmonizimin e legjislacioneve të shteteve të “common law” në raport me ato të “civil law”. Për shembull: nëse bashkëshortët zgjedhin për zbatim ligjin anglez dhe kontrata lidhet në Angli, shtet i cili nuk kërkon formën e shkruar të kontratës martesore, bazuar në nenin 12 të Konventës kontrata duhet të këtë të paktën formën e shkruar për efekt vlefshmërie. Për më shumë rreth këtij argumenti shih: Droz dhe Martin-Bosly, “Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I.” fq. 230.

¹⁰⁵³ Droz dhe Martin-Bosly, “Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I.” fq. 226-227.

¹⁰⁵⁴ Droz dhe Martin-Bosly, “Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités, në Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I.” fq. 238.

¹⁰⁵⁵ Sipas nenit 67(1) të TFEU, Komisioni dhe Këshilli kanë të drejtë të marrin masa në fushën e bashkëpunimit juridik, në funksion të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore dhe të respektimit të traditave dhe sistemeve të ndryshme ligjore të shteteve anëtare. Ndërsa në paragrafin 4 të nenit 67, parashikon kompetencat e BE-së në drejtim të lehtësimit të aksesit të qytetarëve europianë në drejtësi, nëpërmjet parimit të njohjes reciproke të vendimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile.

¹⁰⁵⁶ Neni 81 i TFEU përcakton kompetencat e Këshillit në drejtim të sigurimit të “njohjes reciproke dhe ekzekutimit në shtetet anëtare të vendimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore” si dhe në drejtim të “përcaktimit të ligjit të zbatueshëm në marrëdhëniet juridiko-civile me elementë të huaj dhe juridiksionit gjyqësor”.

Asnjëra nga rregulloret e përmendura nuk mbulon fushën e regjimeve pasurore martesore. Duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të martesave me elementë të huaj, në hapësirën e BE-së¹⁰⁵⁷, si dhe problemet praktike dhe ligjore të cilat ndeshnin bashkëshortët, kryesisht në administrimin e pasurisë së fituar gjatë martesës dhe në pjesëtimin e saj, në përfundim të martesës, pas kryerjes së disa studimeve (2003)¹⁰⁵⁸ dhe publikimit të një Green Paper (17 Korrik 2006)¹⁰⁵⁹ Këshilli i BE-së, në vitin 2011 ka paraqitur dy Projekt-Rregullore: njëra mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën e regjimeve pasurore martesore, ndërsa e dyta, në fushën e juridiksionit, ligjit të zbatueshëm dhe njohjes së vendimeve në fushën e marrëdhënieve pasurore të bashkëjetuesve.

Projekt-Rregullorja **“Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve të huaja”** është e ndarë në 5 Kapituj, në të cilët trajtohen përkatësisht: Kapitulli i parë trajton qëllimin dhe përkufizimet; Kapitulli i dytë, juridiksionin; Kapitulli i tretë ligjin e zbatueshëm; Kapitulli i katërt, njohjen, zbatimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja; ndërsa Kapitulli i pestë dhe i fundit trajton efektet ndaj palëve të treta.

Qëllimi i Projekt-Rregullores është miratimi i një një korpusi rregullash me natyrë ndërkombëtare private me objekt rregullimin e ligjit të zbatueshëm, juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në fushën e regjimeve pasurore martesore. Ky propozim, në asnjë rast, nuk synon harmonizimin e së drejtës së brendshme të shteteve anëtare, të regjimeve pasurore martesore.¹⁰⁶⁰

Fusha materiale e zbatimit të Projekt-Rregullores është *“regjimi pasuror martesor”* (neni 1/1), ndërsa çështjet e zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar të bashkëshortëve, detyrimi për ushqim, dhurimet ndërmjet bashkëshortëve, të drejtat e trashëgimisë së bashkëshortit pasjetues, shoqëritë tregtare të krijuara nga bashkëshortët, të drejtat reale, janë të përjashtuara nga fusha e zbatimit të saj (neni 1/3).

Në të jepet një përkufizim autonom i regjimit pasuror martesor, si **“tërësia e normave që rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet tyre dhe të tretëve”** (neni 2(a)). Ndërsa kontrata martesore përkufizohet si **“çdo marrëveshje nëpërmjet së cilës bashkëshortët rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre dhe në lidhje me të tretët”** (neni 2(b)).

Në drejtim të ligjit të zbatueshëm, mbi regjimin pasuror martesor, Projekt-Rregullorja bazohet mbi dy parime të rëndësishme: a) parimi i unitetit të ligjit të zbatueshëm mbi të gjithë pasurinë e bashkëshortëve, pavarësisht nëse është pasuri e luajtshme ose e paluajtshme (neni 15); dhe b)

¹⁰⁵⁷ Study in comparative law on the rules governing conflicts of jurisdiction and the laws on matrimonial property regimes and the implementation for property issues of the separation of unmarried couples in the Member States, ASSER-UCLC Consortium, COM (2006)400. Marrë nga interneti <http://www.europa.eu.int>, Data e aksesit, 23 Shtator 2013.

¹⁰⁵⁸ Fillimisht legjislati i mbi regjimet pasurore martesore ishte një ndër prioritetet e Plan-Veprimit të Vienës, së vitit 1998; më vonë në Programin e Hagës së 4 dhe 5 Nëntorit të vitit 2004 u ngarkua Komisioni Europian me përgatitjen e një Green Paper në fushën e regjimeve pasurore. Gjithashtu, Programi i Stokholmës, i miratuar nga Këshilli Europian në 11 Dhjetor 2009, rikonfirmoi edhe një herë domosdoshmërinë e rregullimit të juridiksionit, ligjit të zbatueshëm dhe njohjes e ekzekutimit të vendimeve në fushën e regjimeve pasurore dhe të marrëdhënieve pasurore të bashkëjetuesve. Për më shumë rreth historikut të Projekt Rregullores shih: Raportin shpjegues të Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions in matters of matrimonial property regimes, COM (2011) 126/2.

¹⁰⁵⁹ Commission Green Paper of 17 July 2006, on conflict of laws in matters concerning matrimonial property regimes, including the question of judicial and mutual recognition COM(2006)400.

¹⁰⁶⁰ Për këtë shih: Raporti shpjegues i Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions in matters of matrimonial property regimes, COM (2011) 126/2; Viarengo, Ilaria. “The EU proposal on matrimonial property regimes, Some general remarks.” në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, fq. 201.

parimi i autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor (neni 16).

Një nga risitë më të mëdha të Projekt-Rregullores është parashikimi i “*vendqëndrimit të zakonshëm*” (habitual residence) si kriteri kryesor i lidhjes, ndërsa shtetësia e bashkëshortëve shfaqet si një kriter sekondar (zëvendësues) i të parit.

Bazuar në nenin 16 të saj, bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin me marrëveshje ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor¹⁰⁶¹, zgjedhje e cila është e kufizuar ndërmjet alternativave të parashikuara nga vetë Projekt-Rregullorja:

- a) Ligji i shtetit të vendqëndrimit të përbashkët të zakonshëm të bashkëshortëve;
- b) Ligji i shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të njërit bashkëshort, në kohën e lidhjes së marrëveshjes;
- c) Ligji i shtetit të shtetësisë së njërit prej bashkëshortëve në kohën e lidhjes së marrëveshjes.

Bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë ligjin e zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, gjatë kohëzgjatjes së martesës (neni 18). Ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka pasoja vetëm për të ardhmen, përveç rastit kur bashkëshortët vendosin t’i japin regjimit të ri pasuror fuqi prapavepruese. Në këtë hipotezë të fundit, fuqia prapavepruese e regjimit pasuror nuk do të sjellë efekte mbi të drejtat e fituara nga të tretët.

Marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm duhet të respektojë kriteret e formës së ligjit të zgjedhur për zbatim (*lex cusae*) ose të ligjit të shtetit të lidhjes së marrëveshjes (*lex loci regit actum*) (neni 19/1), por në çdo rast marrëveshja duhet të paktën të lidhet në formë të shkruar, me datë dhe me nënshkrimin e të dy palëve (neni 19/2).

Gjithashtu, në Projekt-Rregullore rregullohet edhe ligji i zbatueshëm mbi kontratën martesore, bazuar mbi të njëjtat kritere lidhje si ligji i zbatueshëm mbi marrëveshjen “*pactum de lege utenda*” (neni 20).

Projekt-Rregullorja parashikon moszbatimin e ligjit të thirrur për zbatim, nga normat e konfliktit të saj, nëse ai bie në kundërshtim me rendin publik (neni 23). Gjithashtu referimi (*renvoi*) është i përjashtuar (neni 24).

¹⁰⁶¹ Në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve, për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, ligji i zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, përcaktohet mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes (neni 17):

- a) Ligji i shtetit të vendqëndrimit të parë të zakonshëm të bashkëshortëve, pas lidhjes së martesës;
- b) Ligji i shtetësisë së përbashkët të bashkëshortëve në momentin e lidhjes së martesës;
- c) Ligji i shtetit me të cilin bashkëshortët kanë lidhjet më të ngushta, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat, në veçanti vendin e lidhjes së martesës.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Pas analizës së thelluar të kontratës martesore dhe regjimeve pasurore martesore në legjislacionin shqiptar dhe në legjislacionin e atyre shteteve, ligjet e të cilëve kanë shërbyer si model për hartimin e Kodit tonë të Familjes, janë përpunuar disa konkluzione, të cilat kanë për qëllim të evidentojnë risitë që ka sjellë Kodi i Familjes, në kuadrin e rregullimi të marrëdhënieve pasurore martesore, si dhe janë evidentuar disa probleme të nivelit teorik dhe praktik. Në përfundim janë parashtruar disa rekomandime në funksion të zgjidhjes së problemeve që paraqet ligji dhe praktika, në kuadrin e regjimit pasuror martesor dhe kontratës martesore. Duhet theksuar që, pavarësisht imperfeksioneve, në kuadrin e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, reforma është e lavdërueshme, për shkak të rritjes së shkallës së autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, në drejtim të vetërregullimit ekonomik të marrëdhënieve të tyre pasurore.

A. PËRFUNDIME

Bazuar në të gjithë analizën e realizuar gjatë këtij punimi, në mënyrë të përmbledhur, e gjejmë të arsyeshme të parashtrojmë disa përfundime, në të cilat kemi arritur.

➤ Nga leximi i kombinuar i dispozitave të kod.fam. evidentojmë që, efektet personale jopasurore të martesës e kanë humbur rëndësinë e tyre objektive, për një sërë arsesh:

Së pari, kategoria e efekteve personale jopasurore të martesës, së parashikuara nga kod.fam. është zvogëluar në raport me legjislacionet e mëparshme. Kështu, në kod.fam. gjejmë të parashikuara detyrimin për respekt dhe mirëkuptim reciprok (neni 1 kod.fam), detyrimin reciprok për besnikëri, ndihmë morale, bashkëpunim në interes të familjes dhe bashkëjetesës (neni 50/2 kod.fam.) dhe detyrimin për jetesë të përbashkët (neni 55/1 kod.fam).

Së dyti, këto të drejta dhe detyrime reciproke personale jopasurore paraqesin më shumë një karakter moral se sa ligjor, shfaqen më shumë në formën e një modeli të jetës bashkëshortore;

Së treti, mospërbushja e këtyre të drejtave dhe detyrimeve, nuk i jep jetë veprimeve ligjore të drejtpërdrejta për mospërbushje të detyrimeve (siç ndodh për shembull në rastin e detyrimeve kontraktore), por sipas kushteve të parashikuara në kod.fam, mospërbushja i jep të drejtë bashkëshortëve për të kërkuar zgjidhjen e martesës.

Së fundi, përbushja e të drejtave dhe detyrimeve të karakterit personal jopasuror nuk realizohet nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit, por realizohet, në mënyrë vullnetare, nga vetë bashkëshortët, në funksion të respektimit të jetës së tyre private. Përbushja e tyre mbetet në vullnetin e bashkëshortëve, të cilët nuk mund të ndër marrin veprime ligjore për të kërkuar përbushjen e detyruar, të detyrimeve personale që rrjedhin nga martesa.

➤ Ashtu si në të gjitha legjislacionet e vendet të sistemit ligjor *romano-gjermanik*¹⁰⁶², Kodi i Familjes rregullon marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, nëpërmjet institutit të regjimit pasuror martesor, si dhe nëpërmjet normave që rregullojnë pasojat pasurore të zgjidhjes së martesës, në ndryshim nga vendet e sistemit ligjor "*common law*", të cilat nuk e njohin konceptin e regjimit pasuror martesor dhe për rrjedhojë marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve rregullohen nga normat e përgjithshme mbi pronësinë.

➤ Marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve, të cilat nuk janë konsideruar të rëndësishme për legjislatorin shqiptar, në 50 vitet e shkuara, kanë marrë një rëndësi të veçantë në

¹⁰⁶² Për më shumë shih: Pintens, "Marital agreements and private autonomy in France and Belgium." fq.69.

Kodin e ri të Familjes, duke u njohur një shkallë të gjerë autonomie bashkëshortëve në vetërregullimin e interesave të tyre pasurorë.

Në terma të përgjithshëm mund të shprehemi që, një nga risitë që ka sjellë kodi i ri i familjes është nga njëra anë, “liberalizimi” i marrëdhënieve personale jopasurore të bashkëshortëve dhe nga ana tjetër, privatizimi i marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre.

Njohja e një shkalle më të lartë të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve, në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të tyre, në Kodin aktual të Familjes ishte një domosdoshmëri dhe plotësisht në përputhje me zhvillimin e marrëdhënieve ekonomiko-sociale të shoqërisë shqiptare, të pas viteve 90’.

Mund të arrijmë në disa përfundime të rëndësishme, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e parimit të autonomisë së vullnetit në fushën e regjimit pasuror martesor.

Së pari, nën dritën e kodit të ri të fam. është e pamohueshme që, parimi i autonomisë së vullnetit është njohur edhe në kuadrin e marrëdhënies martesore, veçanërisht regjimit pasuror martesor, marrëdhënie të cilat tradicionalisht në të shkuarën janë përjashtuar nga fusha e veprimit të autonomisë së vullnetit. Njëpërmjet kontratës martesore, bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin regjimin pasuror martesor, që më mirë u përshtatet interesave të tyre pasurorë. Megjithatë, për shkak të rëndësisë shoqërore të familjes dhe me qëllim ekuilibrimin e interesave privatë të bashkëshortëve me interesin publik të mbrojtjes së familjes, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve, në rregullimin e regjimit pasuror martesor, është më e kufizuar në raport me atë të marrëdhënieve të tjera kontraktore. Bazuar në nenet 66 dhe 67 të kod.fam. autonomia e vullnetit të bashkëshortëve i nënshtrohet jo vetëm kufizimeve specifike, të parashikuara në kod.fam, por nga ana tjetër, i nënshtrohet edhe kufizimeve të përgjithshme të parashikuara në dispozitat e kod.civ.

Së dyti, me qëllim garantimin e unitetit të familjes dhe ruajtjen e një minimumi solidariteti pasuror ndërmjet anëtarëve të saj, legjislatori ka parashikuar një kategori të drejtash dhe detyrimesh të karakterit pasuror, të cilat janë të pashmangshme në marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve dhe janë të zbatueshme pavarësisht nga lloji i regjimit pasuror martesor, të emërtuara nga doktrina si **“regjimi primar i familjes” ose “statuti imperativ bazë”**. Është e pamohueshme që, hapësira për autonominë private të bashkëshortëve ekzistojnë edhe në kuadër të regjimit primar¹⁰⁶³, autonomi e cila është më e reduktuar në raport me regjimin pasuror sekondar.

Së treti, autonomia private e bashkëshortëve, në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, është njohur, së fundi, me miratimin e ligjit të ri DNP, edhe në kuadër të martesës me elementë të huaj, në drejtim të mundësisë së zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, ndërmjet kritereve alternative të lidhjes, të ofruara nga ligji (neni 24.2 i ligjit DNP).

“Në kuadër të zgjerimit të fushës së autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në vetërregullimin e marrëdhënieve pasurore, shumë autorë flasin për “privatizimin” e së drejtës familjare”.

➤ Kodi i familjes në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve përmban dy grupe normash:

a) ***Norma të detyrueshme***, të cilat kanë për qëllim ruajtjen e një solidariteti minimal ndërmjet anëtarëve të familjes, të cilat janë të pashmangshme në marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, të tilla si: kontributi material për nevojat e familjes (neni 54); ndalimi i tjetërsimit të banesës familjare dhe përgjegjësia solidare për detyrimet në drejtim të familjes dhe fëmijëve. Ky grup normash, të njohura në doktrinë me termin **“régime primaire”**, përbëjnë

¹⁰⁶³ De Nova, “Disciplina inderogabile dei rapporti patrimoniali e autonomia negoziale.” fq. 263.

kufizimin më të rëndësishëm të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në drejtim të rregullimit kontraktor të regjimit pasuror martesor. Në fushën e regjimit pasuror martesor funksioni i normave imperative është mbrojtja e vetë palëve kontraktore (bashkëshortit në pozitë më të dobët), mbrojtja e familjes dhe e fëmijëve¹⁰⁶⁴.

b) *Norma fakultative*, të cilat kanë për objekt rregullimin e regjimit pasuror martesor, të njohura si “*régime secondaire*”. Në këtë drejtim bashkëshortët gëzojnë një autonomi të gjerë në drejtim të zgjedhjes së regjimit pasuror martesor që më mirë i përshtatet interesave të tyre pasurorë, autonomi e cila ushtrohet nëpërmjet kontratës martesore.

➤ Evolucionin e marrëdhënieve pasurore në familje, evolucionin e shkallës së autonomisë së bashkëshortëve në vetërregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, të strukturës, objektit, subjekteve dhe përmbajtjes së kontratës martesore, nuk mund ta studiojmë të veçuar, nga funksioni dhe roli që një shoqëri e caktuar, në një periudhë të caktuar kohe, i jep familjes dhe martesës. Kontrata martesore është parashikuar për herë të parë, në legjislacionin shqiptar, në Kodin Civil të vitit 1929. Gjatë periudhës së regjimit komunist, bashkëshortëve nuk i njihej mundësia e zgjedhjes së regjimit pasuror martesor. Për çdo bashkëshort zbatohet, në mënyrë të detyrueshme, që nga data e lidhjes së martesës, regjimi ligjor i bashkëpronësisë, i cili nga njëri kod në tjetrin erdhi gjithmonë duke zgjeruar objektin e bashkëpronësisë dhe duke ngushtuar objektin e sendeve në pronësinë vetjake të bashkëshortëve. Kulmin e tij, solidariteti pasuror i anëtarëve të familjes, e arriti me Kodin Civil të vitit 1981, i cili parashikonte një regjim bashkëpronësie “*quasi universale*”. Sipas këtij regjimi, çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës ishte në bashkëpronësi. Përrjashtim nga bashkëpronësia bënin vetëm sendet e përdorimit ngushtësisht personal të bashkëshortëve. Çdo marrëveshje e bashkëshortëve, për të përcaktuar një regjim pasuror të ndryshëm nga ai ligjor, ishte e pavlefshme.

➤ Në përpjekje për të ruajtur këtë balancë të drejtë ndërmjet ruajtjes së unitetit të familjes dhe pavarësisë pasurore të secilit bashkëshort, ligjvënësi, ka parashikuar si regjim ligjor, regjimin e bashkësisë, e cila është shprehje e solidaritetit të bashkëshortëve, por i ka dhënë njëkohësisht të drejtën atyre për të shmangur zbatimin e regjimit ligjor nëpërmjet instrumentit të *kontratës martesore*. Mundësia e rregullimit kontraktor të marrëdhënieve pasurore është, pa dyshim, risia më e madhe që ka sjellë Kodi aktual i Familjes, në kuadër të regjimit pasuror martesor.

“Bazuar mbi nenin 66 të kod.fam, me kontratë martesore do të kuptojmë kontratën nëpërmjet së cilës bashkëshortët-në kuadrin e autonomisë private të njohur atyre nga rendi juridik-përrjashtojnë ose modifikojnë regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore, rregulluar nga nent 73-107 të kod.fam, dhe e zëvendësojnë atë me një tjetër regjim kontraktor”.

➤ Sipas doktrinës juridike italiane, kontratat martesore klasifikohen në dy grupe: a) *kontratat martesore programatike* dhe b) *kontrata martesore dispozitive*.

Në grupin e kontratave martesore *programatike*, përfshihen të gjitha ato kontrata të cilat kanë për objekt përcaktimin e regjimit juridik që do të zbatohet pasurisë së ardhshme (që do të fitohet në të ardhmen) të bashkëshortëve dhe jo të pasurisë që ekziston në momentin e lidhjes së kontratës martesore. Funksioni programatik gjendet në kontratat martesore, që kanë për objekt rregullimin e pasurisë që bashkëshortët do të fitojë së bashku ose veç e veç, gjatë martesës.

Ndërsa, janë kontrata martesore *dispozitive*, ato kontrata të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të menjëhershme në një marrëdhënie të caktuar juridike, si psh: ato kontrata që, parashikojnë përfshirjen në bashkësi të një pasurie, e cila i përkiste më parë pronësisë ekskluzive

¹⁰⁶⁴ Scherpe, “Introduction.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, fq. 1.

të secilit bashkëshort ose ato kontrata që, parashikojnë përjashtimin nga bashkësia të një pasurie, e cila më parë i përkiste bashkësisë. Gjithashtu, bën pjesë në kontratën dispozitive edhe bashkësia universale, sipas së cilës bashkëshortët vendosin të përfshijnë në bashkësi të gjithë pasurinë që ka qenë në pronësi ekskluzive të secilit prej tyre para lidhjes së kontratës martesore.

➤ Kontratat martesore në thelb janë kontrata të zakonshme, për ekzistencën, vlefshmërinë dhe interpretimin e të cilave do të zbatohen rregullat e përgjithshme të kontratave të parashikuara në kod.civ¹⁰⁶⁵. Për rrjedhojë, kontrata martesore do t'i nënshtrohet nga njëra anë, regjimit juridik të veprimit juridik dhe kontratës, të rregulluar nga dispozitat e kod.civ. për aq sa janë të pajtueshme me të; dhe nga ana tjetër, regjimit juridik të posaçëm, të parashikuar në dispozitat e kod.fam.

Bazuar në parimin e mirënjohur të së drejtës “*specialia derogat generalibus*”, normat e kod.fam. (ligji special i kontratës martesore) do të zbatohen me përparësi në raport me normat e kod.civ. (ligji i përgjithshëm), nëse këto të fundit bien në kundërshtim me regjimin e posaçëm të parashikuar në kod.fam. Kujtojmë këtu që, bazuar në rregullimin e nenit 70 të kod.fam., zotësia për të lidhur kontratë martesore bën pjesë në kuadrin e zotësisë speciale për të vepruar dhe për rrjedhojë **nuk** do të gjejnë zbatim normat e kod.civ. që rregullojnë zotësinë e plotë për të vepruar. Në çdo rast, kur elementë të caktuar të regjimit pasuror martesor dhe kontratës martesore nuk gjejnë rregullim në kod.fam. do të zbatohet kod.civ. Në mungesë të rregullimit të shkaqeve dhe pasojave të pavlefshmërisë së kontratës martesore në kod.fam. do të zbatohet regjimi juridik i pavlefshmërisë së veprimit juridik, të rregulluar në kod.civ.

➤ Kontrata martesore është “**aksesore**” në raport me martesën, pasi lidhja e martesës ndikon drejtpërdrejtë në ardhjen e pasojave të kontratës. Kontrata martesore “*ante nuptial*” lidhet me kushtin “*si nuptiae sequantur*”. Ekziston domosdoshmëria e një martese të ardhshme ose një martese ekzistuese për lidhjen e kontratës martesore, pa ekzistencën e së cilës, kontrata nuk ka kuptim, nuk prodhon pasoja ligjore. Për këtë arsye nga doktrina, kontrata martesore është konisderuar, si një kontratë “*causa matrimonii*”.

Karakterit aksesor është një nga tiparet dalluese të kontratës martesore, në raport me kontratat e së drejtës civile.

➤ Kontrata martesore ka karakter “**statutor**”, “**rregullues**”, apo “**programatik**”, në kuptimi që, ajo përfaqëson një statut për marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Në doktrinën juridike të shekujve të kaluar ajo emërtohej ndryshe si “**pakti i familjes**”. Kontrata martesore nuk sjell të drejta dhe detyrime të menjëhershme për palët, në ndryshim nga kontratat e tjera të kod.civ. Sipas doktrinës shqiptare, ajo të konsiderohet si një akt rregullues ose statut për familjen, nëpërmjet së cilës, palët fiksojnë statutin pasuror të familjes që do të themelohet si dhe rregullojnë regjimin e veprimeve juridike, që do të kryejnë me të tretët. Ky është aspekti më origjinal i kontratës martesore.

➤ Kontrata martesore i kundërdrejtohet të tretëve, thënë ndryshe, në ndryshim nga parimet e përgjithshme të së drejtës private, kontrata martesore ka efekte “**erga omnes**”. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i fuqisë “*inter partes*” të kontratës, kontrata martesore mund t'i kundërdrejtohet çdo personi. Për këtë arsye, për mbrojtjen e interesave të të tretëve që kontraktajnë me bashkëshortët, kod.fam ka parashikuar sistemin e regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë.

¹⁰⁶⁵ Për këtë qëndrim shih: Dutta, “Marital agreements and private autonomy in Germany.” fq. 160.

➤ Referuar objektit të saj, kontrata martesore është një **“veprim juridik kompleks”**. Edhe pse nuk parashikohet në mënyrë të shprehur në kod.fam. në përmbajtjen e kontratës martesore, bashkëshortët, jo vetëm kanë të drejtë të rregullojnë regjimin pasuror martesor, të cilit do t’i nënshtrohet pasuria e fituar gjatë martesës, por mund të rregullojnë edhe marrëdhënie të tjera, si dhurimet ndërmjet tyre apo dhurimet e të tretëve në favor të bashkësisë ose të bashkëshortëve, kontributi material për nevojat e familjes, pasojat e zgjidhjes së martesës.

Marrëveshja e bashkëshortëve përfaqëson aktin formal ku mund të përfshihen si kontrata martesore me objekt rregullimin e regjimit pasuror, ashtu dhe paktet e tjera të bashkëshortëve me objekt rregullimin e marrëdhënieve të tjera pasurore dhe personale midis tyre, deri në kufijtë e njohura nga kod.fam.

Në kuptimin *stricto sensu*, objekti i kontratës martesore është vetëm përcaktimi i një regjimi pasuror të ndryshëm nga ai ligjor. Megjithatë, në kuptimin *lato sensu*, objekt i kontratës martesore mund të jenë edhe marrëveshjet e sipërpërmendura.

Nga sa kemi analizuar deri tani, arrijmë në përfundimin që, në aspektin substancial, regjimi juridik i parashikuar nga kod.fam. për kontratën martesore nuk i zbatohet këtyre marrëveshjeve, megjithëse nga ana formale ato mund të paraqiten në një dokument të përbashkët me kontratën martesore.

➤ Sipas nenit 69/1 të kod.fam: **“Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre”**. Bazuar në nenin 69/1 të kod.fam, kontrata martesore është një veprim juridik formal **“ad substantiam”** dhe për rrjedhojë, mungesa e formës noteriale sjell si pasojë pavlefshmërinë absolute të kontratës martesore.

Qëllimi kryesor, i parashikimit të formës noteriale, për kontratën martesore është mbrojtja e palëve kontraktore. Nëpërmjet formës noteriale dhe pjesëmarrjes së njëkohshme të të dy bashkëshortëve ose përfaqësuesve të tyre, në lidhjen e kontratës martesore, duket që ligjvënësi ka dashur të bëjë të mundur që bashkëshortët të kuptojnë **“pasojat”** që mund të sjellë për to derogimi i regjimit ligjor dhe zbatimi i regjimit të ri kontraktor si dhe të realizojë një shprehje reale dhe serioze të vullnetit të tyre¹⁰⁶⁶, të pandikuar nga faktorë të tjerë. Noterit ka detyrimin të sqarojë palët mbi pyetjet apo paqartësitë që ato mund të kenë.

➤ Me qëllim mbrojtjen e kreditorëve dhe personave të tretë që, mund të përfshihen në marrëdhënie juridike me bashkëshortët gjatë martesës, ligjvënësi ka parashikuar sistemin e regjistrimit të kontratës martesore. Një nga risitë që ka sjellë legjislacioni aktual i familjes, është padyshim ndërtimi i një sistemi të shumëfishtë të publicitetit të kontratës martesore, në regjistrat publikë.

Bazuar në nenin 69 dhe 71 të kod.fam. si dhe në dispozitat e kod.civ. kontrata martesore duhet të regjistrohet, në çdo rast, në Aktin e Martesës, duhet të regjistrohet në Regjistrin Tregtar, nëse bashkëshortët kanë veprimtari tregtare, si dhe në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, nëse, në kontratën e martesës, parashikohet ndryshimi i gjendjes juridike të pasurisë së paluajtshme.

Duhet theksuar që, regjistrimi nuk është pjesë e formës së kontratës martesore. Në mungesë të regjistrimit, kontrata martesore është e vlefshme për bashkëshortët, por nuk mund t’i kundërdrejtohet të tretëve.

➤ Neni 70 i kod.fam. në drejtim të zotësisë për të lidhur kontratë martesore, në ndryshim nga legjislacionet e tjera të familjes ligjore romano-gjermanike, parashikon jo vetëm kushtin e zotësisë së plotë për të vepruar, por njëkohësisht edhe moshën madhore, 18 vjeç të

¹⁰⁶⁶ De Rubertis, “Convenzioni matrimoniali in generale.” fq. 940.

secilit bashkëshort. Në këtë drejtim, kod.fam. nuk ka ndjekur parimin e mirënjohur të së drejtës *“habilis ad nuptias habilis ad pacta nuptialia”*, të cilin e ndeshim edhe në legjislacionet e shumë shteteve europiane (KC Francez, Italian, Zvicerian)¹⁰⁶⁷. *Ratio* e këtij kufizimi ligjor është mbrojtja e interesit më të lartë të të miturit që lidh martesë¹⁰⁶⁸, nën moshën 18 vjeç (sipas kushteve të parashikuara në nenin 7/2 të kod.fam).

➤ Me lidhjen e kontratës martesore, bashkëshortët nuk marrin menjëherë përsipër të drejta dhe detyrime dhe as nuk realizohet transferimi i të drejtave reale nga njëri bashkëshort drejt tjetrit. Kontrata martesore do të prodhojë efektet e saj juridike, për palët, në të ardhmen me verifikimin e disa fakteve juridike të ardhshme si: blerja e sendeve nga njëri prej bashkëshortëve, shtimi i prodhimit të pasurisë së bashkëshortëve, fitimi i të ardhurave nga puna, shpërblimi i një dëmi vetjak etj¹⁰⁶⁹.

Efektet që prodhon kontrata martesore konsistojnë në vetë vendosjen e një regjimi të caktuar pasuror kontraktor. Këto lloj efektesh janë cilësuar nga doktrina si *“efekti final”*, i cili është një lloj efekti juridik, nëpërmjet të cilit realizohet qëllimi kontraktor i palëve, pa qenë e nevojshme kryerja ose moskryerja e të tjera veprimeve, apo dorëzimi i sendeve. Qëllimi kontraktor i palëve përmbushet me vendosjen e një regjimi të caktuar kontraktor.

➤ Një nga parimet mbi të cilin ligjvënësi ka bazuar rregullimin e regjimit pasuror martesor, përveç parimit të autonomisë së vullnetit dhe barazisë së bashkëshortëve, është ai i ndryshueshmërisë së regjimit pasuror, gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Në këtë mënyrë ligjvënësi, nën shembullin e legjislacioneve të tjera Europiane, është larguar nga parimi klasik i pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor, që ka karakterizuar këto legjislacione në të kaluarën. Kështu psh. KC i Zogut, KC Francez i vitit 1804 dhe ai Italian, parashikonin parimin pandryshueshmërisë së kontratave martesore gjatë martesës, si një parim absolut. Kontrata martesore mund të ndryshohej para lidhjes së martesës, por pas lidhjes së saj bashkëshortëve nuk i njihej asnjë mundësi modifikimi qoftë edhe të pjesshme të tyre. Pandryshueshmëria ishte parashikuar në favor të mbrojtjes së bashkëshortit më të dobët, i cili gjatë martesës mund të bënte një zgjedhje jo të duhur dhe t’i bindej bashkëshortit tjetër në kërkesën e tij për të ndryshuar kontratën martesor si dhe garantonte edhe mbrojtjen e të tretëve, kur ata kontraktinin me bashkëshortët.

➤ Kodi aktual i familjes parashikon një pluralitet regjimesh pasurore, kështu që, është e pamundur të flasim vetëm për *“regjimin pasuror martesore”*, ndërsa më korrekte do të ishte përdorimi i termit *“regjime pasurore martesore”*, të cilat bazuar në kriterin e burimit të krijimit të tyre, klasifikohen në: 1) **regjime ligjore** (regjimi i bashkësisë dhe regjimi i pasurive të ndara, vetëm në hipotezën e nenit 98 të kod.fam) dhe 2) **regjime kontraktore**.

Dy janë regjimet kontraktore që gjejnë rregullim të shprehur në dispozitat e kod.fam: regjimi i bashkësisë me kontratë, që paraqitet si një modifikim i regjimit ligjor dhe regjimi i pasurive të ndara.

➤ Regjimi ligjor i bashkësisë, mbi pasurinë e fituar gjatë martesës, e gjen rregullimin e tij të parë në kodin Napoleon, kod i cili nga ana e tij e huazoi nga e drejta zakonore e Parisit *“coutumes de Paris”*. Regjimi pasuror martesor është rregulluar mbi bazën e modelit ligjor të

¹⁰⁶⁷ Një rregullim të ndryshëm bën kodi aktual i familjes, në nenin 70, parashikon që, në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore, derisa të mbushë moshën 18 vjeç, rast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.

¹⁰⁶⁸ Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, *E drejta familjare*, fq. 325.

¹⁰⁶⁹ Russo, “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” fq. 532.

sistemit francez, deri diku ai italian si dhe gjithashtu është mbajtur në konsideratë edhe Kodi i Familjes i RPSSH, i vitit 1965 (hyrë në fuqi 1 Janar 1966).

➤ Mund të përkufizojmë **“bashkësinë me kontratë”** si regjimin pasuror, në të cilin përfshihen të gjitha ato rregullime ligjore, të cilat bashkëshortët, në kuadrin e autonomisë së tyre private, por gjithmonë brenda limiteve të normave të pashmangshme ligjore, rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre, sipas nevojave të tyre specifike¹⁰⁷⁰, duke modifikuar një ose disa aspekte të caktuara të regjimit të bashkësisë ligjore.

Duke dashur të japim një paraqitje të përmbledhur të të gjitha elementëve të trajtuara Kapitullin IV, një listim i hapësirës së veprimit të autonomisë kontraktore të bashkëshortëve, në rregullimin e marrëdhënieve pasurore, në bashkësinë me kontratë, do të ishte¹⁰⁷¹:

A. Bashkësia me kontratë me objekt të zgjeruar (zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore):

- a) Zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore, nëpërmjet përfshirjes në të (si bashkësi me natyrë aktuale apo eventuale) të një/disa/të gjitha kategorive të sendeve të parashikuara në nenin 77 të kod.fam., me përjashtim të pasurisë së parashikuar në nenin 77/(c,ç,d) të kod.fam. (neni 109 dhe 114 i kod.fam.);
- b) Zgjerimi i objektit të bashkësisë aktuale, nëpërmjet përfshirjes në të, të pasurisë që bën pjesë në bashkësinë eventuale, neni 74/(b,c) dhe neni 75 i kod.fam. (kalimi nga bashkësia eventuale në atë aktuale);
- c) Përfshirja në bashkësi e sendeve të veçanta apo të kategorive të veçanta të sendeve që janë në pronësi të bashkëshortëve (në këtë rast, kontrata martesore merr natyrë dispozitive, duke u shmangur nga natyra programatike që e karakterizon);
- d) Kombinimi i të gjitha apo disa prej mundësive të mësipërme.

B. Bashkësia me kontratë me objekt të reduktuar, e cila mund të përfshijë:

- a) Përjashtimin nga bashkësia të pasurisë së bashkësisë aktuale, neni 74/1 pikat (a,d) dhe 74/2 i kod.fam.;
- b) Përjashtimi nga bashkësia i pasurisë së bashkësisë eventuale, neni 74(b,c) dhe neni 75 i kod.fam.;
- c) Përjashtimi nga bashkësia i sendeve të veçanta apo kategorive të veçanta të sendeve, që janë në pronësi të bashkësisë;
- d) Kombinimi i disa prej hipotezave të mësipërme.

C. Ndryshimi i rregullave të administrimit si dhe krijimi i regjimit të administrimit të përbashkët të pasurisë në bashkësi.

D. Ndryshimi i pjesëve takuese, ndryshim i cili, mund të realizohet në dy mënyra:

- a) Nëpërmjet përcaktimit konkret të pjesëve që gëzojnë mbi pasurinë në bashkësi, secili prej bashkëshortëve. Në këtë drejtim bashkëshortët kanë të drejtë të përcaktojnë pjesë jo të barabarta ndërmjet tyre;
- b) Përcaktimi i barazisë së pjesëve dhe vendosja njëkohësisht e rregullës së proves së kontributit. Ky rregull i lejon bashkëshortët, që në përfundim të bashkësisë të përcaktojnë pjesët takuese në varësi të kontributit konkret të secilit prej tyre në fitimin dhe shtimin e pasurisë.

E. Kontrata martesore mikse (atipike), në të cilat bashkëshortët mund të zgjedhin:

- a) Të kombinojnë një/ disa/ të gjitha, elementët e përmendur në pikat A, B, C, D, për aq sa është i mundur kombinimi i tyre;

¹⁰⁷⁰ Monforte, Guido. “La comunione convenzionale.” në *Il diritto di famiglia e delle persone*, Milano: Giuffrè Editore, 1976, fq.1773.

¹⁰⁷¹ Për më shumë rreth këtij klasifikimi shiko: Lo Sardo, “La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.” fq. 1307-1308.

- b) Regjime pasurore atipike, të cilat nuk gjejnë një rregullim të shprehur në kod.fam; si psh: regjimi i pjesëmarrjes në fitime, të cilin e analizuam më sipër.

➤ **Bashkësia universale**, e rregulluar në nenin 114 të kod.fam, nuk ka karakterin e një regjimi pasuror autonom, por paraqitet si një variant i regjimit të bashkësisë me kontratë. Në regjimin e bashkësisë universale, çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët, para dhe pas lidhjes së kontratës martesore, është në bashkëpronësi të tyre. Pavarësisht emërimit “universal”, ky regjim nuk përfshin absolutisht çdo pasuri të tashme dhe të ardhshme të bashkëshortëve, por disa kategori të caktuara të pasurisë janë të përjashtuara nga bashkësia, si psh: mjetet e ushtrimit të profesionit, sendet e përdorimit ngushtësisht vetjak, shpërblimi i dëmit vetjak, me qëllim ruajtjen e një minimumi pavarësie pasurore të bashkëshortëve, në raport me njëri-tjetrin. Ky rregullim ligjor ka karakter absolut, ai nuk mund të shmanget me marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve.

➤ Nisur nga analiza e dispozitave të kod.fam. që rregullojnë **regjimin e pasurive të ndara**, si dhe duke e analizuar këtë regjim, në kompleks, së bashku me regjimet e tjera pasurore martesore, nga doktrina italiane dhe ajo franceze janë përpunuar disa elementë që karakterizojnë këtë regjim, të cilat do ti paraqesim, më poshtë, përmbledhtazi.

Regjimi i pasurive të ndara karakterizohet nga **“mungesa e masës së sendeve të përbashkëta”**, pra mungesa e bashkësisë. Secili prej bashkëshortëve ruan pronësinë ekskluzive, jo vetëm të pasurisë që ka fituar para lidhjes së martesës, por edhe të pasurisë që do të fitojë në të ardhmen gjatë martesës ose më saktë gjatë regjimit të pasurive të ndara. Ky regjim karakterizohet nga mungesa e bashkësisë si mbi aktivin ashtu dhe mbi pasivin e pasurisë së bashkëshortëve.

Një tjetër karakteristikë e regjimit të pasurive të ndara është **“pavarësia pasurore reciproke”** e bashkëshortëve. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij regjimi, bashkëshortët nuk fitojnë asnjë të drejtë mbi pasurinë e njëri-tjetrit. Bashkëshortët në lidhje me pasurinë e njëri-tjetrit (në lidhje me fitimin e pasurisë) qëndrojnë në të njëjtën pozitë sikur të mos kishin lidhur martesës.

Regjimi i pasurive të ndara ka **“karakter autonom”**, në raport me regjimin ligjor të bashkësisë.

Regjimi i pasurive të ndara ka **“karakter të përgjithshëm”**. Është i vetmi regjim që përjashton çdo formë të regjimit të bashkësisë dhe shtrihet **“in toto”** mbi të gjitha pasuritë e fituara nga bashkëshortët, si për të shkuarën ashtu dhe për të ardhmen. Regjimi i pasurive të ndara nuk bashkekziston me asnjë regjim tjetër pasuror. Në këtë kuptim mund të shprehemi që është regjim pasuror **“universal”**.

➤ Bazuar në burimin e krijimit, regjimi i pasurive të ndara mund të klasifikohet në dy grupe:

a) **regjimi pasuror kontraktor**, burimi i krijimit të të cilit është vullneti i bashkëshortëve, kontrata martesore;

b) **regjimi pasuror ligjor**, zbatimi i të cilit nuk është vullneti i bashkëshortëve, por ligji (kod.fam.), më konkretisht vendimi i gjykatës për pjesëtimin e pasurisë së bashkësisë, sipas parashikimeve të nenit 98 të kod.fam. Ky është i vetmi rast kur regjimi i pasurive të ndara shndërrohet në një regjim ligjor të detyrueshëm.

Në mënyrë thuajse unanime, doktrina juridike mban qëndrimin që, megjithëse nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj, regjimi i pasurive të ndara do të veprojë në të gjitha ato raste, në të cilat mbarimi i regjimit të bashkësisë ligjore nuk shoqërohet njëkohësisht edhe me mbarimin e martesës. Si rrjedhojë, **de lege ferenda**, jemi të mendimit që, në rastin e shpalljes së zhdukjes së njërit bashkëshort, do të gjejë zbatim regjimi i pasurive të ndara, megjithëse **de lege lata** mungon një parashikim i tillë ligjor.

➤ Një çështje mjaft e diskutuar në doktrinë, i referohet mundësisë së bashkëshortëve, për të zgjedhur nëpërmjet kontratës martesore, regjime pasurore që nuk gjejnë rregullim në dispozitat e kod.fam, të njohura në doktrinë si “*regjimet pasurore atipike*”. Jemi të mendimit që, bazuar në formulimin e nenit 66 të kod.fam. bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin edhe të tjera regjime pasurore, përveç skemave tipike të parashikuara në kod.fam, psh. ti referohen regjimit të pjesëmarrjes në fitime, pavarësisht mungesës së një parashikimi *expressis verbis* në ligj. Regjimet pasurore kontraktore, të rregulluara në kod.fam, kanë për qëllim të orientojnë palët (bashkëshortët) në zgjedhjen e regjimit pasuror më të përshtatshëm për ta, funksioni i tyre nuk është kufizimi i vullnetit të palëve.

➤ Parimi i autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, që në dekadat e kaluara ka njohur një zbatim të gjerë në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në legjislacionet ndërkombëtare private të shumë shteteve europiane si dhe në konventat ndërkombëtare ashtu dhe në Rregulloret e Bashkimit Europian, në ditët e sotme po fiton një njohje të gjerë si kriter lidhje, në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare familjare dhe veçanërisht në regjimin pasuror martesor. Këtë e dëshmon, njohja e këtij parimi si në legjislacionet e së drejtës ndërkombëtare private të shteteve europiane, ashtu edhe në aktet ndërkombëtare, mjafton të kujtojmë edhe një herë këtu, Konventën e Hagës, së vitit 1978 si dhe në legjislacionin e BE-së (Projekt-Rregulloren e vitit 2011).

➤ Në martesat ndërkombëtare, ekziston një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet autonomisë materiale dhe autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, në kuptimin që ushtrimi i të parës është kushtëzuar nga ushtrimi i autonomisë konfliktuale. Vetëm pasi kanë ushtruar të drejtën e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm, bashkëshortët mund të rregullojnë përmbajtjen e regjimit pasuror, sipas kushteve dhe brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni i zgjedhur për zbatim

➤ Njohja e autonomisë së vullnetit si kriter lidhje, në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në marrëdhëniet familjare, në legjislacionin shqiptar mbi DNP dhe në pjesën më të madhe të legjislacioneve europiane është një njohje e kufizuar, e kujdesshme¹⁰⁷², për disa arsye:

- a) Në legjislacionin shqiptar DNP dhe në shumicën e legjislacioneve europiane njihet autonomia e vullnetit si kriter lidhje në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm, në formën e mundësisë së zgjedhjes së njëres prej alternativave të parashikuara nga ligji (neni 24.2 ligjit DNP).
- b) Zgjedhja e ligjit të zbatueshëm i nënshtrohet kushteve thelbësore formale dhe materiale. Kujtojmë këtu që, në zbatim të parimit të unitetit të ligjit të zbatueshëm, bashkëshortët nuk mund të zgjedhin legjislacione të ndryshme për elementë të ndryshëm të regjimit pasuror martesor (psh: të diferencojnë ligjin e zbatueshëm për sendet e luajtshme dhe ato të paluajtshme).
- c) Nga ana tjetër, marrëveshja e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm (pactum de lege utenda) duhet të respektojë një minimum kushtesh formale të parashikuara nga neni 24.2 të ligjit DNP, siç është forma noteriale, përveç kushteve formale të kërkuara nga *lex causae*.

¹⁰⁷² Carrascosa Gonzales, *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, fq. 44-45. Sipas tij: “De todos modos, y en general, cabe afirmar que la entrada de la autonomia de la voluntad en el DIPr. matrimonial de los países occidentales esta siendo muy prudente: injustificadamente timida y excesivamente cautelosa.”

➤ *Natyrja juridike e pactum de lege utenda.* Bazuar në mendimin mbizotërues të doktrinës të së drejtës ndërkombëtare private, marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm nuk përfshihet në kategorinë e kontratës martesore (ky është qëndrimi i një pjese tjetër të autorëve), por ka natyrën juridike të normës së konfliktit. Pavarësisht se kontrata martesore dhe *pactum de lege utenda* u përkasin dy kategorive të ndryshme, ekzistojnë disa ngjashmëri ndërmjet tyre:

- a) Në të dy rastet, objekti i rregullimit të tyre i referohet marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, në fakt ligji i zbatueshëm mbi marrëdhëniet personale jopasurore, përcaktohet mbi bazën e kriterëve objektive të lidhjes, të parashikuar në nenin 23 të ligjit DNP;
- b) Në të dy rastet realizohet një rregullim programatik, i ardhshëm i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, duke penguar zbatimin e regjimit ligjor të legjislacionit, në të cilin do të çonin kriteret objektive të lidhjes (neni 23 i ligjit DNP), në mungesë të marrëveshjes së bashkëshortëve;
- c) Ashtu si për kontratën martesore, edhe për *pactum de lege utenda* ligji përcakton disa kondita vlefshmërie, me qëllim mbrojtjen e bashkëshortëve, si psh; forma noteriale e kërkuar nga neni 24 i ligjit DNP.

➤ *Forma e pactum de lege utenda.* Neni 24.2 i ligjit DNP parashikon shprehimisht që marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor duhet të realizohet në formën e aktit noterial ose të një akti tjetër të barazvlefshëm me të dhe të lëshuar nga një organ publik. Funkzioni i aktit noterial është që të garantohet një minimum kushtesh të vlefshmërisë së kontratës martesore, në rastin kur ligji që kanë zgjedhur për zbatim bashkëshortët nuk kërkon ndonjë akt formal për vlefshmërinë e kontratës martesore, psh. legjislacioni anglez nuk e kushtëzon vlefshmërinë e kontratës martesore me asnjë akt formal.

➤ Zgjedhja e ligjit të zbatueshëm për rregullimin e regjimit pasuror martesor, që është padyshim një nga risitë e ligjit DNP në kuadër të rregullimit të ligjit të zbatueshëm në marrëdhëniet familjare, paraqet disa karakteristika¹⁰⁷³:

- a) Marrëveshja e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm realizohet në formën e aktit noterial, për efekt vlefshmërie;
- b) Marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm ka për objekt vetëm marrëdhëniet pasurore martesore (regjimi pasuror martesor), ndërsa nuk mund të ushtrohet për marrëdhëniet personale jopasurore;
- c) Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në drejtim të zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror martesor është një autonomi e kufizuar brenda kriterëve të lidhjes së parashikuar në nenin 24 të ligjit DNP.

➤ Ndërkohë në nivelin ndërkombëtar e vetmja përpjekje për të unifikuar rregullat e së drejtës ndërkombëtare private, në fushën e legjislacionit të zbatueshëm është **Konventa e Hagës e vitit 1978**, e cila zëvendësoi atë të vitit 1905. Megjithëse pa sukses, në arenën ndërkombëtare (aktualisht konventa është ratifikuar vetën nga tre shtete dhe është nënshkruar nga dy të tjera), konventa ka shërbyer si model për reformimin e legjislacioneve të së drejtës ndërkombëtare private të pjesës më të madhe të vendeve europiane, duke përfshirë këtu edhe vendin tonë.

➤ Nga ana tjetër, në nivelin evropian, 10 vitet e fundit, janë bërë përpjekje për unifikimin e legjislacionit në fushën e ligjit të zbatueshëm mbi marrëdhëniet familjare, nëpërmjet

¹⁰⁷³ Për karakteristika e marrëveshjes së ligjit të zbatueshëm shih: Cardillo, *La forma dell'accordo di scelta della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi (art.30 legge 218/1995)*.

Rregulloreve Bruksel II, Bruksel II bis dhe Roma III, Rregullorja e Trashëgimisë, të cilat përfshijnë në fushën e rregullimit të tyre rregullat mbi juridiksion gjyqësor, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën e marrëdhënieve martesore dhe përgjegjësisë prindërore (Rregullorja Bruksel II dhe II bis) si dhe në fushën e përcaktimit të ligjit të zbatueshëm në rastin e zgjidhjes së martesës dhe veçimit personal të bashkëshortëve. Së fundi, është miratuar një Projekt-Rregullore **“Për ligjin e zbatueshëm, juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën e regjimit pasuror martesor”** (Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions in matters of matrimonial property regimes, COM (2011) 126/2).

B. REKOMANDIME

Me modesti dhe me shpresën që ky punim do të sjellë sado pak vlera në kërkimin shkencor në shkencën e së drejtës civile, në Shqipëri, parashtrohen disa sugjerime të cilat finalizojnë këtë punim dhe mbartin qëllimin e tij.

I. Përmirësimi i kuadrit ligjor të kontratës martesore

➤ Bazuar në dispozitat e kod.fam. nuk ekziston detyrimi i bashkëshortëve për t’i bërë të njohur njëri-tjetrit gjendjen e tyre pasurore, në momentin e lidhjes së kontratës martesore. Ky rregullim i kod.fam. parashikohet edhe në pjesën më të madhe të legjislacioneve europiane dhe gjen justifikimin e tij në vetë qëllimin e martesës. Qëllimi i martesës nuk është përfitimi ekonomik nga bashkëshorti tjetër, për rrjedhojë në lidhjen e martesës duhet të jenë të parëndësishme të ardhurat ose gjendja pasurore e bashkëshortit tjetër.

Megjithatë, me qëllim mbrojtjen e bashkëshortëve nga veprimet abuzive të njëri-tjetrit *rekomandojmë* që, ligji (kod.fam) duhet të parashikojë detyrimin e bashkëshortëve për t’i bërë të njohur njëri-tjetrit pasurinë e tyre, para lidhjes së kontratës martesore, veçanërisht nëse regjimi i zgjedhur prej tyre është ai i bashkësisë. Ligjvënësi mund t’i referohet në këtë drejtim parimeve të CEFL “Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve”. Në lidhje me këtë çështje, në **parimin 4:12 të CEFL** parashikohet **“detyrimi i bashkëshortëve për t’i bërë të ditur njëri-tjetrit të drejtat e pronësisë dhe të kreditit (asetet) dhe detyrimet që përbëjnë pasurinë e tyre, në momentin e lidhjes së kontratës martesore”**.

➤ *Rekomandojmë* që, ligji të parashikojë detyrimin e noterit për këshillimin ligjor të të dy bashkëshortëve veçmas nga njëri-tjetri, në lidhje me pasojat e kontratës martesore. Në këtë drejtim, ligjvënësi mund t’i referohet parimeve të CEFL “Mbi marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve”. Në parimin 4:13 parashikohen **detyrimet e noterit** a) për të dhënë këshillim secilit prej bashkëshortëve, veçantë nga njëri-tjetri; dhe b) për të siguruar që çdo bashkëshort të kuptojë pasojat ligjore të kontratës martesore.

➤ Në drejtim të sistemit të **regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë**, me qëllim garantimin e një mbrojtje më të mirë të kreditorëve të bashkëshortëve nga kontratat martesore fiktive, të lidhura për pakësimin e pasurisë së bashkëshortit debitor me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tij, *rekomandojmë* që, përveç regjistrimit mund të parashikohet edhe detyrimi i bashkëshortëve për të vënë personalisht në dijeni kreditorët e tyre, në hipotezën e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, gjatë martesës. Për këtë qëllim KC Francez, përveç sistemit të regjistrimit në regjistrat publikë, parashikon edhe detyrimin e bashkëshortëve, në eventualitetin e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, për të

njoftuar paraprakisht për këtë ndryshim fëmijët madhorë dhe kreditorët e tyre (të bashkëshortëve), nëpërmjet një njoftimi në gazetë.

➤ Nëpërmjet akteve nënligjore duhet rregulluar edhe procedura që duhet të ndiqet për konsultimin, nga kreditorët e bashkëshortëve dhe të tretët, e kontratës martesore, të regjistruar në Regjistrat publikë.

Gjithashtu domosdoshmëri paraqet koordinimi i Regjistratit të Pasurive të Paluajtshme dhe Regjistratit Tregtar me Regjistrin e Gjendjes Civile (regjistri i martesës), për një mbrojtje më të mirë të të tretëve, të cilët hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me bashkëshortët.

Mund të evidentojmë gjithashtu problemin e mungesës së koordinimit të kod.fam. (dispozitive që rregullojnë regjistrimin e kontratës martesore) me ligjin Për Gjendjen Civile.

➤ Bazuar në ndalimin e lidhjes së kontratës martesore nga ***bashkëshorti i mitur*** (neni 70 kod.fam), gjykojmë që, është shumë e diskutueshme, nëse vërtet regjimi ligjor i bashkësisë është regjimi më i përshtatshëm për mbrojtjen më të mirë të interesave të të miturit që lidh martesë. Jo gjithmonë, regjimi pasuror më i përshtatshëm për të miturin që lidh martesë është regjimi i bashkësisë ligjore. Megjithatë, regjimi i bashkësisë është më i përshtatshëm në rastin kur bashkëshortët që lidhin martesë janë të rinj në moshë dhe nuk kanë pasuri të konsiderueshme, nga ana tjetër, regjimi i bashkësisë ligjore do të ekspozonte pasurinë e bashkëshortit të mitur para kreditorëve personalë të bashkëshortit tjetër, veçanërisht në hipotezën e ushtrimit të një veprimtarie tregtare nga ana e bashkëshortit tjetër.

Jemi të mendimit që, do të garantonte më mirë mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit që lidh martesë, parashikimi i mundësisë së rregullimit kontraktor të marrëdhënieve pasurore. Në këtë hipotezë, ligji mund të kushtëzojë vlefshmërinë e kontratës martesore të të miturit, që lidh martesë, duke ndjekur modelin e legjislacioneve të tjera të familjes ligjore romano-gjermanike, si psh: a) kushtëzimin e vlefshmërisë së kontratës, me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor të të miturit, përveç pëlqimit të vetë të miturit; ose b) kushtëzimin e vlefshmërisë së kontratës martesore të bashkëshortit të mitur, me kontrollin dhe miratimin gjyqësor të kontratës.

➤ Duke pasur parasysh përhapjen e pakët të kontratës martesore në praktikë, në Shqipëri *rekomandojmë që*, të mundësohet në kod.fam. zgjedhja, e regjimeve pasurore me kontratë, të rregulluara në dispozitat e kod.fam, nga bashkëshortët jo vetëm nëpërmjet kontratës martesore, por edhe nëpërmjet ***regjistrimit në aktin e martesës***, nëpërmjet deklarimit të vullnetit të të dy bashkëshortëve, në momentin e lidhjes së martesës. Kjo formë më e lehtë, në terma praktikë, e zgjedhjes së regjimeve pasurore me kontratë do të ndihmonte në një përhapje më të madhe të tyre. Për këtë do të duhej një ndërhyrje në dispozitat e kod.fam., ndërhyrje për të cilën mund të merren si model referues KC Italian dhe KC Gjerman. Kështu psh. regjimi i pasurive të ndara mund të ishte parashikuar, që të zgjidhej, me deklarimin e vullnetit të bashkëshortëve, nëpërmjet regjistrimit në Aktin e Martesës, sepse ai përbën një skemë të plotë ligjore.

Nisur nga thjeshtësia e përmbajtjes së regjimit të pasurive të ndara, legjislacionet e disa shteteve, në ndryshim nga Kodi Familjes shqiptar: si KC Italian, KC Francez dhe BGB Gjerman, parashikojnë mundësinë e bashkëshortëve për të deklaruar në momentin e lidhjes së martesës, para nëpunësit të gjendjes civile, zgjedhjen e regjimit të pasurive të ndara, pa qenë nevoja e lidhjes së një kontrate martesore. Kjo është një procedurë më thjeshtë për bashkëshortët dhe është e mundur të realizohet për shkak se në këto legjislacione regjimi i pasurive të ndara gjen një rregullim të detajuar në ligj.

➤ Në legjislacionin shqiptar (kod.fam, Ligji “Për gjendjen civile” apo akte të tjera nënligjore) nuk parashikohet asnjë zgjidhje, për problemin e bërjes së njohur të tretëve të pavlefshmërisë së kontratës martesore, në eventualitetin kur ajo është deklaruar apo është shpallur e pavlefshme nga gjykata. Duke pasur parasysh që, vendimi i gjykatës për pavlefshmërinë e kontratës martesore, sjell si pasojë vendosjen e bashkëshortëve në regjimin ligjor të bashkësisë, shtrohet problemi i regjistrimit të këtij vendimi. Jemi të mendimit që, një përgjigje për këtë problem do të ishte detyrimi i gjykatës për t’i dërguar një kopje të vendimit gjyqësor, që konstaton apo shpall pavlefshmërinë e kontratës martesore, zyrës së gjendjes civile ku është regjistruar kontrata martesore. Në vazhdim të këtij arsytimi, nëpunësi i gjendjes civile bën shënimin përkatës të pavlefshmërisë së kontratës, në akti e martesës, ku është regjistruar kontrata martesore.

Ligji duhet të kishte parashikuar shprehimisht zgjidhjen e këtij problemi.

➤ Në lidhje me pjesëtimin gjyqësor të pasurisë së bashkësisë, neni 98 duhet të kishte parashikuar që vendosja e bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara, sjell pasoja për të tretët, jo nga data e paraqitjes së kërkesës për pjesëtim, por 3 muaj nga data e regjistrimit të vendimit në Regjistrin e Martesave, duke ndjekur të njëjtën logjikë të nenit 72/3 të kod.fam. Megjithatë edhe në mungesë të një rregullimi të shprehur ligjor, rekomandojmë zbatimin e nenit 98, paragrafi i fundit i kod.fam. në mënyrë të kombinuar me nenin 72/3.

➤ Gjithashtu, rekomandojmë që, ligji të parashikojë zbatimin e regjimit të pasurive të ndara, në mënyrë të detyrueshme edhe në hipotezën e mbarimit të regjimit të bashkësisë, për shkak të shpalljes së zhdukjes së njërit bashkëshort.

II. Regjimi më i përshtatshëm pasuror për bashkëshortët

➤ ***Cili është regjimi pasuror më i përshtatshëm për bashkëshortët?*** Ky është problemi që shtrohet për zgjidhje për bashkëshortët para lidhjes së martesës. Nuk mund të ekzistojë një regjim pasuror unik i përshtatshëm për të gjithë personat që lidhin martesë. Bazuar në gjendjen pasurore të secilit bashkëshort, në momentin e lidhjes së martesës, bazuar në profesionin e secilit prej tyre si dhe në gjendjen dhe përbërjen familjare, secili prej regjimeve pasurore paraqet avantazhe dhe disavantazhe të caktuara.

➤ ***Regjimi i bashkësisë ligjore.*** Avantazhi më i madh i regjimit të bashkësisë është fakti që ky regjim është më i përshtatshëm për bashkëshortët e rinj në moshë, të cilët nuk kanë pasuri të konsiderueshme në pronësi të tyre para lidhjes së martesës. Sepse, ky regjim vlerëson kontributin e të dy bashkëshortëve në fitimin e pasurisë, gjatë kohëzgjatjes së martesës, duke barazuar si kontributin në të holla ashtu dhe atë në natyrë. Për këtë arsye është zgjedhur nga ligjvënësi, si regjimi pasuror më i përshtatshëm për popullsinë shqiptare, bazuar në kushtet ekonomiko-sociale të saj.

Nga ana tjetër, regjimi i bashkësisë ligjore paraqet disa disavantazhe. *Së pari*, vështirësohet qarkullimi civil i pasurisë së fituar gjatë martesës, për shkak të rregullit të pëlqimit të të dy bashkëshortëve për kryerjen e veprimeve të administrimit jo të zakonshëm mbi pasurinë e bashkësisë, të parashikuar në nenin 90 të kod.fam. *Së dyti*, pasuria e bashkësisë është e rrezikuar nga kreditorët personalë të secilit bashkëshort. Nëse bashkëshorti debitor është në paaftësi paguese ose pasuria e tij nuk mjafton për përmbushjen e detyrimeve, atëherë kreditorët kanë të drejtë të kërkojnë ekzekutimin e detyrimit mbi ½ pjesë që i takon bashkëshortit debitor, në bashkësi. Për këtë arsye, ky regjim nuk është i këshilluar në rastin kur njëri prej bashkëshortëve

ushtron veprimtari tregtare, që përmbajnë risk të lartë financiar. *Së treti*, në rastin e zgjidhjes së martesës, vështirësitë e mëdha që paraqet regjimi i bashkësisë në drejtim të përcaktimit të objektit të bashkësisë mund të jenë burim konfliktesh të mëtejshme ndërmjet ish-bashkëshortëve. Nëse i referohemi praktikës gjyqësore shqiptare, evidentohet që proceset gjyqësore të pjesëtimit të pasurisë së fituar gjatë martesës kanë kohëzgjatje të madhe.

Për të shmangur gjithë këto disavantazhe *rekomandohet* që, bashkëshortët - zakonisht kur njëri prej tyre ka pasuri të konsiderueshme para lidhjes së martesës, ka fëmijë nga në martesë e mëparshme ose kryen një veprimtari tregtare me risk të lartë financiar - të zgjedhin një tjetër regjim pasuror, psh: regjimin e pasurive të ndara ose atë të pjesëmarrjes në fitime, ose të modifikojnë aspekte të caktuara të regjimit ligjor.

➤ **Regjimi i bashkësisë universale.** Ky regjim pasuror ka si avantazh kryesor që eviton konfliktet dhe problemet që mund të shfaqen në drejtim të pjesëtimit të pasurisë në eventualitetin e përfundimit të martesës. Gjithashtu, ky regjim paraqet avantazhe për bashkëshortin pasjetues, në rastin e përfundimit të martesës me vdekjen e njërit bashkëshort.

Nga ana tjetër ky regjim paraqet disa disavantazhe. *Së pari*, regjimi i bashkësisë universale cenon interesat pasurorë (pjesën në pasurinë trashëgimore) të fëmijëve të secilit bashkëshort, për këtë arsye *nuk është i këshillueshëm* për bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë nga martesë të mëparshme. *Së dyti*, duke qenë se e gjithë pasuria e bashkëshortëve është e përbashkët, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet, atëherë e gjithë pasuria e bashkësisë është e rrezikuar nga kreditorët personalë të bashkëshortëve. Në fakt, kreditorët e secilit bashkëshort janë njëkohësisht edhe kreditorë të bashkësisë. Për rrjedhojë, ky regjim pasuror *nuk rekomandohet* nëse njëri bashkëshort kryen aktivitete tregtare me risk të lartë financiar. *Së treti*, ky regjim është shumë pak i preferuar nga prindërit dhe të afërmit e secilit bashkëshort, sepse e gjithë pasuria që ato mund tu kalojnë fëmijëve të tyre nëpërmjet dhurimeve ose testamentit do të përfshihet në bashkësi dhe për rrjedhojë, automatikisht mbi ½ pjesë të tyre do të bëhet pronar bashkëshorti tjetër. Kjo sjell hezitimin e prindërve apo të afërmeve të bashkëshortëve për të realizuar dhurime në drejtim të këtyre të fundit.

➤ **Regjimi i pasurive të ndara.** Ky regjim avantazhon (lehtëson) transferimin e pasurisë brenda familjes, nëpërmjet dhurimeve apo trashëgimisë testamentare, nga prindërit tek fëmijët. Një avantazh tjetër është mbrojtja e pasurisë personale të njërit bashkëshort nga kreditorët personalë të bashkëshortit tjetër. Kreditorët personalë të njërit bashkëshort nuk kanë të drejtë të kërkojnë ekzekutimin e detyrimeve në drejtim të pasurisë së bashkëshortit tjetër, me përjashtim të detyrimeve solidare, që bashkëshortët marrin përsipër në drejtim të rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Për këtë arsye, ky regjim pasuror *rekomandohet* në rastin kur bashkëshortët ose njëri prej tyre kryejnë veprimtari tregtare me risk të lartë financiar.

Nga ana tjetër, regjimi i pasurive të ndara paraqet disa disavantazhe. *Së pari*, në përfundim të martesës shfaqen probleme në drejtim të pasurisë së fituar gjatë martesës me kontributin e përbashkët të të dy bashkëshortëve, e cila do të nënshtrohet regjimit të bashkëpronësisë në pjesë, të rregulluar në dispozitat e kod.civ. Problematike mbetet të provuarit e kontributit dhe pjesës takuese të bashkëshortit tjetër, në hipotezën kur pasuria është fituar apo regjistruar vetëm në emër të bashkëshortit tjetër. *Së dyti*, ky regjim nuk vlerëson kontributin në natyrë që mund të japë njëri bashkëshort, gjatë martesës, në drejtim të rritjes, edukimit të fëmijëve, mirëmbajtjes së banesës familjare dhe në përgjithësi kryerjes së të gjitha atyre aktiviteteve, të cilat evitojnë shpenzimet për familjen. Për rrjedhojë, ky bashkëshort nuk do të mund të përfitojë asnjë pjesë në këtë pasuri, në rastin e përfundimit të martesës.

➤ Në përmbledhje të analizës së mësipërme, **rekomandojmë** regjimin e pasurive të ndara për ata bashkëshortë të cilët kanë pasuri të konsiderueshme në pronësi të tyre, para lidhjes së martesës, ose kanë një disbalancë të theksuar të pasurisë, në pronësi të secilit prej tyre; ose kanë fëmijë nga martesa të mëparshme; ose ushtrojnë veprimtari tregtare, të cilat mbartin risk të lartë financiar, risk me të cilin nuk dëshirojnë të ekspozojnë pasurinë e familjes ose pasurinë e bashkëshortit tjetër¹⁰⁷⁴. Nga ana tjetër, rekomandojmë regjimin e bashkësisë ligjore, si regjimin më të përshtatshëm për bashkëshortët e rinj në moshë, të cilët nuk kanë pasuri të konsiderueshme në pronësi të tyre, para lidhjes së martesës. Gjatë martesës, bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë regjimin pasuror ose të modifikojnë aspekte të caktuara të tij, në varësi të ndryshimit të gjendjes së pasurisë së tyre. Gjithashtu, regjimi pasuror i bashkësisë është më i përshtatshëm për shoqëritë tradicionale (shoqëria shqiptare), në të cilat zakonisht njëri nga bashkëshortët është i varur ekonomikisht nga bashkëshorti tjetër¹⁰⁷⁵.

➤ Me qëllim shmangien e aspekteve negative që shfaq secili prej regjimeve pasurore të sipërpërmendura, bashkëshortët mund të zgjedhin regjimin pasuror të **“pjesëmarrjes në fitime”**, regjim i cili kombinon regjimin e bashkësisë me regjimin e pasurive të ndara. Në regjimin e pjesëmarrjes në fitime, gjatë të gjithë kohëzgjatjes së martesës, bashkëshortët i nënshtrohen regjimit të pasurive të ndara, duke përfutur nga të gjitha avantazhet që ofron ky regjim, në drejtim të administrimit të pasurisë dhe mbrojtjes së pasurisë së secilit bashkëshort nga kreditorët personalë të bashkëshortit tjetër. Ndërsa, në përfundim të martesës, krijohet një bashkësi mbi vlerën, më të cilën është shtuar pasuria e secilit prej tyre, duke realizuar në këtë mënyrë një shpërndarje më të mirë, ndërmjet bashkëshortëve, të pasurisë së fituar gjatë martesës. Në këtë mënyrë, në përfundim të martesës, llogaritet vlera me të cilën është shtuar pasuria e secilit bashkëshort gjatë martesës dhe llogaritet diferenca ndërmjet vlerës më të madhe dhe asaj më të vogël. Ky regjim pasuror është krijim i së drejtës gjermane dhe është rregulluar për herë të parë në KC Gjerman, në të cilin vazhdon të mbetet edhe sot i rregulluar në formën e regjimit pasuror ligjor.

Regjimi i pjesëmarrjes në fitime bashkon avantazhet e regjimit të bashkësisë me ato të regjimit të pasurive të ndara duke evituar disavantazhet respektive të tyre¹⁰⁷⁶.

➤ Megjithëse regjimi i pjesëmarrjes në fitime nuk gjen rregullim në dispozitat e kod.fam, në kuadër të autonomisë së vullnetit, të njohur bashkëshortëve nga neni 66 i kod.fam. dhe neni 660 i kod.civ, bashkëshortët janë të lirë të zgjedhin çdo regjim pasuror që u përshtatet më mirë interesave të tyre pasurorë, me kushtin që të mos bie në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të kod.civ dhe kod.fam. Regjimet pasurore kontraktore, të parashikuara në kod.fam. shërbejnë si modele për të orientuar bashkëshortët në zgjedhjen e tyre dhe nuk kanë për qëllim të kufizojnë vullnetin e bashkëshortëve.

Duke marrë në konsideratë avantazhet që sjell për bashkëshortët regjimi i pjesëmarrjes në fitime, **rekomandojmë** që ky regjim të gjej rregullim të detajuar në kod.fam. në formën e një regjimi kontraktor. Model referues për këtë rregullim ligjor mund të merret regjimi ligjor i pjesëmarrjes në fitime të rregulluar në KC Gjerman, regjimi kontraktor i pjesëmarrjes në fitime i rregulluar në KC Francez ose modeli opsional franko-gjerman, i cili është hartuar nga ekspertë të të dy shteteve, duke kombinuar dy modelet e sipërpërmendura.

¹⁰⁷⁴ Galasso dhe Tamburello, “Del regime patrimoniale della famiglia I.” fq. 1040.

¹⁰⁷⁵ Scherpe, “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” fq. 474-475.

¹⁰⁷⁶ Oberto, Giacomo. “La comunione coniugale nei suoi profile di diritto comparato, internazionale ed europeo.” në *Il diritto di famiglia e delle persone. Rivista Trimestrale*, V. Lojaco, S. Ciccarello (Ed.), Volumi XXXVII-Gennaio-Marzo 2008, Milano: Giuffrè Editore, 2008, fq. 375.

➤ Në hipotezën e martesave ndërkombëtare, i rekomandohet bashkëshortëve zgjedhja e legjislacionit që do të rregullojë regjimin pasuror martesor, pasi zgjedhja e ligjit të zbatueshëm paraqet disa avantazhe në raport me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm mbi bazën e kritereve të lidhjes, së përcaktuara nga nenin 23 i ligjit DNP. Avantazhet e “*pactum de lege utenda janë*”¹⁰⁷⁷:

- a) Individualizimi i ligjit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror martesor është më i lehtë;
- b) Përfshihet veprimi i institutit të referimit (renvoi);
- c) Parandalon ndryshimin e regjimit pasuror martesor, në rastin e ndryshimit të kritereve objektive të lidhjes, të tilla si: shtetësia e bashkëshortëve ose vendqëndrimi i tyre i zakonshëm;
- d) I mundëson bashkëshortëve që të zgjedhin për zbatim legjislacionin e të njëjtit shtet, si për trashëgiminë ashtu edhe për regjimin pasuror martesor, duke evituar në këtë mënyrë problemin e kualifikimit, që është një ndër temat më të debatueshme në të drejtën ndërkombëtare private.

➤ Në mungesë të statistikave dhe studimeve zyrtare, nuk njihet numri i kontratave martesore të lidhura në territorin e RSH. Pavarësisht mungesës së rekordeve zyrtare, bazuar në praktikën gjyqësore shqiptare dhe bisedave me noterë të ndryshëm, evidentohet një rritje vit pas vitit e numrit të kontratave martesore, në vendin tonë. Gjithashtu, edhe në nivelin evropian evidentohet një rritje e numrit të kontratave martesore, nga viti në vit, pavarësisht se nuk ekzistojnë statistika të sakta për secilin shtet evropian.

Megjithatë, krahasuar me shtete të tjera europiane¹⁰⁷⁸ numri i kontratave martesore në vendin tonë është akoma i ulët. Shkaqet mund të gjejmë në faktin që instituti i kontratës martesore është relativisht i ri dhe në mungesën e informacionit të nevojshëm të shtetasve shqiptarë mbi mundësinë e rregullimit kontraktor të regjimit pasuror martesor. Një arsye tjetër e suksesit të pakët të kontratës martesore në praktikë, mund të jetë hezitimi i bashkëshortëve të rinj për të diskutuar mbi problemet pasurore në fazën para lidhje së martesës, fazë e cila karakterizohet më shumë nga ndjenjat afektive të bashkëshortëve. Kryesisht, tek bashkëshortët e rinj në moshë hezitimi bazohet në drojën që, nëpërmjet propozimit palës tjetër për të rregulluar marrëdhëniet

¹⁰⁷⁷ Për avantazhet e marrëveshjes së zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm shih: Cardillo, *La forma dell'accordo di scelta della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi (art.30 legge 218/1995)*.

¹⁰⁷⁸ Në nivelin Evropian nuk ka statistika zyrtare, por megjithatë ekzistojnë statistika mbi numrin e kontratave martesore për shtete të ndryshme europiane. Kështu për shëmbull sipas statistikave zyrtare në Danimarkë numri i kontratave martesore të regjimit të pasurive të ndara ka ardhur në rritje nga viti 1992 e deri sot; në vitin 1992 numërohen 5000 kontrata, në vitin 1994 numërohen 6250, ndërsa në vitin 2005 janë lidhur 11000 kontrata martesore. Në Finlandë statistikat tregojnë që ka patur një rritje të numrit të kontratave nga vitet 70' deri sot; kështu ndërsa në vitet 70' vetëm 10% e bashkëshortëve rregullonin marrëdhëniet e tyre pasurore nëpërmjet kontratës martesore, në vitet 90' kjo shifër shkoi në 20%, ndërsa pas viteve 2000 në 25%. Gjithashtu edhe në Francë vërehet ky trend; sipas statistikave zyrtare rreth 19% e bashkëshortëve lidhin kontratë martesore, ndërsa regjimi kontraktor më i preferuar për francezët është regjimi i bashkësisë me kontratë (7,4%), më pas vjen ai i pasurive të ndara me 6,3% dhe në fund regjimi i bashkësisë universale me 3,3%). Në Gjermani nuk ka statistika zyrtare, por vlerësohet se më pak se 10% e bashkëshortëve lidhin kontrata martesore. Në Lituanë, që nga 1 Qershori i vitit 2002 kur u krijua Regjistri i Kontratës martesore dhe deri në vitin 2008 figuronin të regjistruara vetëm 1919 kontrata martesore me një trend në rritje nga viti në vit. Në Holandë rreth 25% e bashkëshortëve rregullojnë me kontratë marrëdhëniet e tyre pasurore ashtu si dhe në Suedi ku regjimi kontraktor më i preferuar është ai i pasurive të ndara. Statistikat zyrtare në Spanjë tregojnë që nga viti 1921 e deri në vitin 2001 ka patur një rritje të kontratave martesore me 981,4%; në vitin 2001 rezultoi që 30,8% e bashkëshortëve spanjollë preferojnë të rregullojnë me kontratë marrëdhëniet e tyre pasurore dhe regjimi më i preferuar është ai i pasurive të ndara. Për këto statistika shih: *European family Law in action. Volume IV. Property relations between spouses*, K. Boele-Woelki, B. Braat (Eds.), Oxford: Intersentia, 2009, fq. 1184-1188 (question 197).

pasurore me kontratë, mund të tregohet mungesë besimi, e cila mund të cenojë ekuilibrat e jetës në çift. Për këtë arsye, nga pjesa më konservative e doktrinës kontrata martesore është cilësuar si prishje e romanticitetit të martesës.

Statistika të sakta janë të nevojshme edhe në Shqipëri.

III. Formulimi i dispozitave të Kodit të Familjes

➤ Kontributi material për interesat e familjes, gjen rregullim në dy dispozita të kod.fam., neni 54, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve në funksion të përmbushjes së kontributit material dhe neni 60, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, nga njëra anë, dhe kreditorëve të tyre, nga ana tjetër, për detyrimet që secili prej tyre merr përsipër në funksion të mbajtjes së familjes dhe edukimit të fëmijëve. Sipas doktrinës franceze, dispozitat respektive të Code Civil (nenet 214 dhe 220), sipas modelit të të cilave janë hartuar nenet 54 dhe 60 të kod.fam., për një sistematizim më të mirë të normave, do të ishte më mirë, të ishin përmbledhur në një dispozitë të vetme, ose në dy dispozita, të cilat duhej të paraqiteshin në tekstin e ligjit njëra pas tjetrës¹⁰⁷⁹. Arsyeja është e evidente, të dy normat rregullojnë dy aspekte të të njëjtit institut, atë të kontributit material të bashkëshortëve në funksion të mbarëvajtjes së familjes. Ndërsa, neni 54 rregullon përmbushjen e kontributit material, në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, neni 60 i kod.fam. rregullon përmbushjen e këtij kontributi, në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve.

Rekomandojmë që, për një sistemim më të mirë të dispozitave të kod.fam, neni 54 dhe 60 të jenë të integruara në një dispozitë të vetme, në dy paragrafë, ose të vendosen në radhë njëra pas tjetrës.

➤ Në neni 69/1,2 rezulton që, noteri është subjekti i cili ka detyrimin ligjor për të regjistruar kontratën martesore në zyrën e gjendjes civile, duke dorëzuar atje një kopje të saj. Nga ana tjetër, ligji parashikon detyrimin e noterit për t'i dorëzuar bashkëshortëve një certifikatë me përmbajtje të elementëve të tillë si: identiteti i plotë i palëve, adresa e tyre dhe vendi i lidhjes së kontratës. Mbetet e paqartë se përse kod.fam parashikon detyrimin e noterit për dorëzimin e certifikatës, bashkëshortëve. Cili është funksioni i certifikatës, që noteri i dorëzon bashkëshortëve dhe përse u duhet bashkëshortëve një certifikatë me këto të dhëna, përderisa palët kontraktore mbajnë gjithmonë secila nga një kopje të kontratës.

Nëse analizojmë në tërësi nenin 69 të kod.fam, rezulton që, certifikata e dorëzuar nga noteri palëve, nuk luan asnjë rol në gjithë procesin e regjistrimit të kontratës martesore dhe është e paqartë pse ligji ka parashikuar një detyrim të tillë. Për të kuptuar më mirë këtë rregullim ligjor mund të referojmë në KC Francez, i cili parashikohet detyrimin e noterit për t'i pajisur bashkëshortët me një certifikatë të tillë, nëpërmjet së cilës bashkëshortët, si subjekte të detyruar nga ligji, bëjnë regjistrimin e kontratës në zyrën e gjendjes civile. Në KC Francez, certifikata i shërben bashkëshortëve për të realizuar regjistrimin e kontratës martesore, në zyrën e gjendjes civile, sepse sipas KC Francez subjekti i detyruar për regjistrimin e kontratës martesore janë bashkëshortët dhe jo noteri. Ndërsa, sipas KC Italian, është noteri subjekti që ka detyrimin ligjor të regjistrimit të kontratës martesore dhe për rrjedhojë nuk parashikohet detyrimi i noterit për dorëzimin e një certifikatë bashkëshortëve.

Mospërputhja e paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 69 duket vjen si pasojë e pakujdesisë në përshtatjen e Kodit të Familjes me modelin Francez dhe atë Italian. Një përshtatje më e kujdesshme e normave është e nevojshme, për të shmangur problemet që mund të sjellë në praktikë, në të ardhmen, formulimi i paqartë i tyre.

¹⁰⁷⁹ Colomer, *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*, fq. 42.

➤ *Expresis verbis*, neni 100/1 parashikon “... **vendimi i ndarjes së pasurisë duhet të depozitohet pranë zyrës së gjendjes civile dhe, nëse është rasti, edhe në regjistrin tregtar**”.

Për një koordinim më të mirë të normave ligjore, jemi të mendimit që, ligji duhet të kishte përdorur termin “*pjesëtim*” në vend të termit “*ndarje*”. Nga leximi i dispozitave të kod.civ, kod.proc.civ. dhe kod.fam, rezulton që në të gjitha rastet ligjvënësi ka përdorur termin “*pjesëtim*”.

➤ Formulimi i nenit 108/a nuk është shumë i kënaqshëm, sepse i referohet vetëm situatës së kontratës martesore së lidhur para lidhjes së martesës. Sipas nenit 108/a “**Bashkëshortët mund të bien dakort që, bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme që kanë qenë në pronësi të bashkëshortëve para lidhjes së martesës**”.

Bazuar në nenin 72/1 të kod.fam, bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë regjimin pasuror edhe gjatë martesës, me kushtin e respektimit të afatit 2 vjeçar, nga data e fillimit të zbatimit të tij. Bazuar në këtë argument propozojmë një formulim më të saktë të nenit 108/a të kod.fam: “**Bashkëshortët mund të bien dakort që, bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme që kanë qenë në pronësi të bashkëshortëve para lidhjes së kontratës martesore**”.

➤ Formulimi i nenit 110 nuk është, gjithashtu i saktë. Duhej të ishte zgjedhur një formulim më i qartë, i cili do të ndihmonte si studiuesit e kod.fam ashtu dhe zbatuesit e tij, për një kuptim dhe përdorim më të qartë të kësaj dispozite, në të ardhmen.

“**Bashkëshortët, për detyrimet e tyre para martesës, përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi, deri në kufirin e vlerës së pasurisë së tyre, e cila, në bazë të kontratës së lidhur, sipas këtij Kodi, është pjesë përbërëse e bashkësisë**”. (Neni 110 i kod.fam.)

Për një interpretim më të mirë të nenit 110 në kod.fam, gjykojmë të nevojshme t’i referohem nenit 1501 të KC Francez dhe interpretimeve të doktrinës franceze.

Sipas doktrinës franceze¹⁰⁸⁰, neni 110 (neni 1501 i Code civil) parashikon që, kreditori personal i njërit bashkëshort ka të drejtë të ndjekë të gjitha sendet që debitori i tij kishte në pronësi vetjake ditën e lidhjes së martesës (ose lidhjes së kontratës martesore), pavarësisht nga fakti nëse nëpërmjet kontratës martesore, këto sende janë përfshirë në bashkësi ose kanë mbetur vetjake¹⁰⁸¹. Përfshirja në bashkësi e sendeve të luajtshme, në pronësi të bashkëshortëve ose e fitimeve të pasurisë vetjake, do të sjellë efekte vetëm për bashkëshortët dhe jo për kreditorët e tyre, të cilët për detyrimet e lindura para lidhjes së martesës (kontratës martesore) do të sillen ndaj këtyre sendeve njëlloj sikur këto sende të vazhdonin të ishin në pronësi vetjake të bashkëshortit debitor.

➤ Gjithashtu, sërish në nenin 110, vihet re një lapsus i përsëritur shpesh nga ligjvënësi në dispozitat që rregullojnë kontratën martesore, lapsus, i cili i referohet përdorimit të termit “... **omissis ... për detyrimet e tyre para lidhjes së martesës**”. Termi më i saktë do të ishte: “**për detyrimet para lidhjes kontratës martesore**”.

➤ Neni 111 të kod.fam, sipas së cilit “**Bashkëshortët mund të bien dakort që të administrojnë së bashku bashkësinë. Në këtë rast, aktet e administrimit të zakonshëm dhe të disponimit të pasurisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të të dy bashkëshortëve...**”

Formulimi i nenit 111 nuk është shumë i saktë. Përdorimi i fjalës “*nënshkrim*” nga ana e ligjvënësit nuk është e përshtatshme. Jo të gjitha veprimet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë, duhet patjetër, nga pikëpamja formale, të realizohen në një akt të shkruar. Kod. civ. ka

¹⁰⁸⁰ Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, fq. 568.

¹⁰⁸¹ Të njetin interpretim të nenit 110 të kod.fam. e gjejmë edhe në doktrinën shqiptare. Për më shumë shiko: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 72.

njohur lirinë e formës së veprimit juridik, ndërsa akti formal është detyrim ligjor vetëm për veprime juridike të caktuara.

De lege lata, megjithëse termi i përdorur është **“nënshkrim”**, *de lege ferenda*, termi më i saktë do të ishte **“pëlqim”**. *De lege ferenda*, formulimi më i saktë i normës duhet të ishte si më poshtë:

“... omissis...në këtë rast, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë bëhen me pëlqimin e përbashkët të të dy bashkëshortëve...”

➤ Paragrafi i dytë i nenit 115 pasi parashikon parimin e pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, nën regjimin e pasurive të ndara, parashikon edhe një përjashtim nga ky parim duke referuar në nenin 70 të kod.fam, në të cilin gjen rregullim ndalimi i lidhjes së kontratës martesore nga i mituri.

Nga leximi i vëmendshëm i nenit 115/2 dhe nenit 70 në të cilin i pari referon, patjetër që vihet re mungesa e lidhjes logjike ndërmjet tyre.

Në parim, neni 115/2 është ndërtuar në formën e një parimi të përgjithshëm (pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve) dhe të parashikimit të një përjashtimi nga parimi i përgjithshëm (neni 70 i kod.fam), që në qoftë se lexojmë *expressis verbis* nuk kanë lidhje me njëri tjetrin.

Për të hedhur dritë mbi atë që ligjvënësi ka dashur të parashikojë në përjashtimin nga parimi i pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, referojmë tek neni 1536/2 i KC Francez, i cili pasi parashikon parimin e pavarësisë së pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, referon në nenin 220 të KC Francez (neni 60 i kod.fam), si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm.

Konkluzioni që mund të nxjerrim këtu është që, ligjvënësi ka bërë një *gabim*, që më shumë mund ta quajë **“lapsus”** në përshtatjen e normës. Ky konkluzion rezulton jo vetëm nga leximi i së njëjtës dispozitë të Code Civil, që ka shërbyer si model për nenin 115 të kod.fam, ky konkluzion rezulton edhe nga *ratio* e normës, e cila ka për qëllim që, pavarësisht pavarësisë së plotë pasurore të bashkëshortëve, të ruajë një minimum bashkëpunimi ekonomik të bashkëshortëve në interes të familjes.

De lege ferenda, formulimi i nenit 115/2 i kod.fam. duhet të ndryshojë, si më poshtë vijon:

“Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur atij para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të parashikuar në “nenin 60” të këtij kodi.”

➤ Ligjvënësi, në formulimin e neneve 117, 118 dhe 68 të kod.fam, nuk është gjithmonë koherent në termat që përdor, për t’iu referuar veprimit juridik mbi bazën e së cilit bashkëshorti pronar autorizon bashkëshortin jopronar për administrimin e pasurisë së tij.

Dy janë termat e përdorur si sinonime të njëri-tjetrit: **“mandat”** dhe **“prokurë”**. Ndërsa, nenet 68/2 dhe 118/1 të kod.fam. përdorin përkatësisht termat **“mandat përfaqësimi”** dhe **“mandat i heshtur”**, në nenin 117/2 i kod.fam. gjen përdorim termi **“prokurë”**.

Është e rekomandueshme që, ligjvënësi, për një koherencë më të madhe ndërmjet normave, të përdorë të njëjtën terminologji.

➤ Terminologjia e përdorur nga ligjvënësi në nenin 119 nuk është plotësisht e saktë. Në të tre paragrafët e nenit 119 ligjvënësi ka përdorur termin **“pasuri të luajtshme”** dhe jo termin **“sende të luajtshme”**.

Duke qenë se termat “pasuri” dhe “sende” nuk janë sinonime të njëri-tjetrit, por termi “pasuri” mbart një kuptim më të gjerë në raport me termin “send”, gjykojmë që, ligjvënësi duhej të kishte përdorur termin send.

Në radhë të parë termi “*pasuri e luajtshme*” nuk ka kuptim, sepse në përbërje të pasurisë, përveç së drejtës së pronësisë mbi sendet përfshihen edhe të drejtat e tjera reale, të drejtat e kreditit (aktivi i pasurisë) si dhe detyrimet e bashkëshortëve ndaj të tretëve (pasivi i pasurisë)¹⁰⁸². Për më tepër, nëse analizojmë në planin krahasues dispozitat që rregullojnë provën e pronësisë në regjimin e pasurive të ndara të KC Francez (art. 1538), KC Italian (art. 219) dhe BGB (art. 1362), në modelin e të cilëve është hartuar neni 119 i kod.fam, vëmë re që, në të gjitha këto dispozita është përdorur termi “*send*” dhe jo termi “*pasuri*”.

➤ Në nenin 115 të kod.fam, “*...secili bashkëshort ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij*”, termi “*administrim*” i referohet vetëm veprimeve të administrimit të zakonshëm, duke përfshirë veprimet e disponimit, përderisa në tekstin e normës, termi disponim është veçuar nga ai i administrimit.

Situatë identike gjejmë edhe në nenin 118/1 të kod.fam, “*...konsiderohet se ka marrë mandat të heshtur, i cili mbulon veprimet lidhur me administrimin, por jo atë të disponimit*”, ku sërish termi “*administrimi*” përfshin vetëm veprimet e administrimit të zakonshëm, duke përfshirë shprehimisht veprimet e disponimit.

Gjykojmë që, për të shmangur çdo paqartësi që mund të lindë në praktikë, kod.fam. për t’i kishte qëndruar koherent terminologjisë së përdorur me atë të administrimit të bashkësisë ligjore, duhet të dallimit ndërmjet “*administrimit të zakonshëm*” dhe “*administrimit jo të zakonshëm*”.

➤ Megjithë aspektet pozitive dhe risitë që ka sjellë ligji i ri DNP në rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile me elementë të huaj, konkretisht të marrëdhënieve familjare, përmirësime të tjera janë të nevojshme me qëllim përmirësimin dhe riformulimin e disa dispozitave. Në kuadër të zgjedhje së ligjit të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurorë të bashkëshortëve, ligjvënësi duhet të kishte parashikuar shprehimisht hipotezat e ndryshimit vullnetar ose “*ipso jure*” të kriterëve të lidhjes që shërbejnë për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor. Gjithashtu, duhet të ishin parashikuar pasojat që një ndryshim eventual i kriterëve të lidhjes, sjell për bashkëshortët dhe veçanërisht për pasojat ndërmjet bashkëshortëve dhe të tretëve. Gjithashtu, duhet të parashikohet mundësia nëse ndryshimi i kriterëve të lidhjes ka efekte “*ex nunc*” apo “*ex tunc*”. Gjithashtu, një mbrojtje më e madhe për të tretët është e nevojshme.

➤ Rekomandohet një *studim social-ligjor mbi kontratën martesore*, jo vetëm në nivelin e brendshëm, por edhe në atë europian. Disa pyetje kanë nevojë për zgjidhje, të tilla si: pse, kur dhe sa shpesh bashkëshortët kontraktajnë për përjashtimin e regjimit ligjor dhe për rrjedhojë zgjedhjen e një regjimi kontraktor. Dhe pyetja më e rëndësishme është se, cili është ekzaktësisht lloji i regjimit pasuror kontraktor, që preferohet më shumë nga bashkëshortët¹⁰⁸³.

➤ Në kuadër të kontratës martesore dhe regjimeve pasurore martesore, në Shqipëri, rekomandohet të kryhen *studime ligjore, konferenca dhe trajnime* të gjyqtarëve, noterëve dhe avokatëve, me qëllim kuptimin dhe interpretimin më të mirë të dispozitave të kod.fam. Nga analiza e praktikës gjyqësore, të trajtuar në këtë punim, evidentohen probleme të shumta në interpretimin dhe zbatimin e kod.fam. nga gjyqtarët dhe noterët.

¹⁰⁸² Për më shumë mbi kuptimin e termit pasuri, bashkëpronësi ndërmjet bashkëshortëve dhe bashkësi shih: Omari, *E drejtë familjare*, fq. 93.

¹⁰⁸³ Mbi nevojën e realizimit të një studimi social-ligjor për kontratën martesore në nivelin europian shih: Boele-Woelki, Katharina, Braat, Bente, *Marital agreements and private autonomy in Netherlands, Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, Ed. Scherpe, Jens, Hart Publishing, Oxford, 2012, fq. 255.

BIBLIOGRAFIA

I. Doktrinë

- “La famiglia, Matrimonio-Regime primario I.” në *Il diritto private nella giurisprudenza*, P. Cendon (Ed.), Torino: UTET, 2002.
- Aliu, Abdulla. *E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme*. Prishtinë: Botimi i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2013.
- *Analyse comparative des rapports nationaux et propositions d’harmonisation, Etudes sur les regimes matrimoniaux des couple marie et sur le patrimoine des couples non marie dans le droit international prive et le droit interne des etats de l’union europeenne*. Commission Européenne.
- Anderson, David, *Marriage contracts after the recent Supreme Court decision in Radmacher vs. Garantino* (2010), Tetor 2010.
- Andrini, Maria C. *L’autonomia privta dei coniugi tra status e contratto. Le convenzioni coniugali*. Torino: G. Giappichelli Editore, 2006.
- Andrini, Maria Claudia. “L’autonomia negoziale nella riforma del diritto internazionale private: la modifica delle convenzioni matrimoniali e dei patti conseguenti alla separazione personale.” në *Studi in onore di Pietro Rescigno II, Diritto Privato, Persone, famiglia, seccesioni e proprieta*, Milano: Dott. A. Giuffre Editore, 1998, 3-12.
- Anelli, Franco, dhe Sesta Michele. “Regime patrimoniale della famiglia.” në *Trattato di diritto di famiglia*, Paolo Zatti (Ed.), Vol. III, Milano: Giuffré Editore, 2012.
- Anelli, Franco. “Sul’esplicazione dell’autonomia privata nel diritto matrimoniale.” në *Studi in onore di Pietro Rescigno II, Diritto Privato, Persone, famiglia, seccesioni e proprieta*, Milano: Giuffré Editore, 1998, 13-54.
- Anoveros Terrada, Beatriz. “La autonomia de la voluntad como principio rector de las normas de derecho internacional privado comunitario de la familia.” në *Entre Bruselas y la Haya. Estudio sobre la unification internacional y regional el derecho internacional privado. Liber amicorum Alegria Borrás*, Marcial Pons (Ed.), Madrid: 2013, 119-131.
- Arcani, Caterina. “I negozi patrimoniali nella convivenza more uxorio.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Alessandra Arceri, Mauro Bernardini (Eds.), Maggioli Editore, 2009, 877-923.
- Arceri, Alessandra dhe Bernardini, Mauro. *Il regime patrimoniale della famiglia*. Maggioli Editore, 2009.
- Arceri, Alessandra. “Regime patrimoniale primario e regime patrimoniale secondario.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Alessandra Arceri, Mauro Bernardini, Maggioli Editore, 2009, 13-34.
- Auciello A, Badiali F, Iodice C, dhe Mazzeo S. “La volontaria giurisdizione e il regime patrimoniale della famiglia.” në *Manuale e applicazioni pratiche dale lezioni*, Guido Capozzi, Milano: Giuffré Editore, 2000.
- Audit, Bernard. “D’Avout, Louis, Droit International Privé, sixième ed.” në *Corpus droit privé*, Nicolas Molfessis (Ed.), Paris: Economica Ed., 2010.
- Baratta, Paolo. “Il regolamento comunitario dul diritto internazionale private della famiglia.” në *Diritto internazionale private e comunitario*, Paolo Picone (Ed.), Milano: Cedam, 2004, 163-204
- Bariatti, Stefania. “Mupltiple nationalities and EU private international law, Many questions and some tentatives to answers.” *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 1-20.

- Bariatti, Stefania. *La famiglia nel diritto internazionale private comunitario*. Milano: Giuffrè Editore, 2007.
- Bartholet, Julie. “Les régimes matrimoniaux en droit international privé Suisse.” në *Les régimes matrimoniaux en droit compare et en droit international privé*, A. Bonomi, M. Steiner (Eds.), Genève: Librairie Droz, 2006, 35-57.
- Basedow, Jurgen. “The effects of globalization on private international law.” në *Legal aspects of Globalization, Conflicts of laws, internet capital markets and insolvency in a global economy*, J. Basedow, T. Kono, Kluwer Law Inter: 2000, 1-10.
- Batiffol, Henri. dhe Lagarde, Paul. *Droit International Privé*. Septième Ed., Tome II, Paris: Librairie générale de droit et de jurisprudence, 1983.
- Baylis, John. dhe Smith, Steve. *The globalization of world politics*. Oxford: 1997.
- Begeja, Ksanthipi. *E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i shkencave politike dhe juridike, 1984.
- Benussi, Baltasar. *Komentar i Kodit Civil. Obligimet dhe kontratat përgjithsisht (Titulli II i librit të Kodit Civil)*. Tiranë: Botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1931.
- Benussi, Baltasar. *Komentar i Kodit Civil. Sendet, zotënimi dhe modifikimet e tija*. Tiranë: Botimi i Ministrisë së Drejtësisë, 1931.
- Bessone, Mario. *Giurisprudenza del diritto di famiglia, Rapporti personali e patrimoniali tra coniugi, famiglia di fatto*. Quinta Edizione, Milano: Giuffrè Edizione, 1997.
- Boele-Woelki, Katharina dhe Braat, Bente, “Marital agreements and private autonomy in Netherlands.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe, Oxford: Hart Publishing, 2012, 229-255.
- Boele-Woelki, Katharina dhe Jänträ Jareborg, Maarit. “Initial results of the work of CEFL in the field of property relations between spouses.” në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe, (Eds), Cambridhe: Intersentia, 2011, 47-64.
- Boele-Woelki, Katharina. Ferrand, Fédérique. Gonzales Beilfuss, Christina. Jänträ-Jareborg, Maarit. Lowe, Nigel. Martiny, Dieter. dhe Pintens, Walter. *European Family Law regarding property relations between spouses*, Cambridge: Intersentia, 2013.
- Bogdan, Michael. *Concise Introduction to Comparative Law*, Europa Law Publishing, 2013.
- Bonilini, Giovanni. *Manual i së drejtës familjare*. Tiranë, Luarasi, 2005.
- Bonomi, Andrea. “Les régimes matrimoniaux en droit international privé compare.” në *Les régimes matrimoniaux en droit compare et en droit international privé*, A. Bonomi, M. Steiner, Genève: Librairie Droz, 2006, 59-76.
- Bonomi, Andrea. “The interaction among the Future EU instruments on matrimonial property, registered partnerships and successions.”, në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne : Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 217-232.
- Borrás, Alegria. “Dritto internazionale privato comunitario e rapporti con stati terzi.” në *Diritto internazionale private e comunitario*, P. Picone, Milano: Cedam, 2004, 449-484.
- Brusuglia, Luciano. Gorgoni, Marilena. “La separazione e dei beni.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta, në Trattati di diritto private, M. Bessone (Ed), Torino: Giappichelli Ed, 2000, 73-174.
- Buscher, Andreas. *Droit international privé Suisse, Tome II, personnes, Famille, Successions*. Bale: Helbing & Lichtenhahn, 1992.
- Cabanillas Sánchez, Antonio. “Las Capitulaciones matrimoniales, Capitulo II.” në *Derecho de Familia*, G. Díez-Picazo Giménez, Thomson Reuters, 2012, 589-654.

- Calo, Emanuele. “Le convivenze registrate in Europa, Verso un secondo regime patrimoniale della famiglia.” në *Collana studi nr.14 di Consiglio Nazionale del Notariato*, Milano: Giuffré Editore, 2000.
- Campos, Gonzales D. “Diritto privato uniforme e diritto internazionale privato.” në *Diritto internazionale private e comunitario*, P. Picone, Milano: Cedam, 2004, 33-64.
- Campuzano Diaz, Beatriz. “The coordination of the Eu regulations on divorce and legal separation with the proposal on matrimonial property regimes.” në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 233-254.
- Caparros, Ernest. Damé-Castelli, Mireille. dhe Matrin-Bosly. *Bernardette, Rapports patrimoniaux dans la famille en droit compare, në Régimes matrimoniaux, successions et libératils dans les relations internationales et internes*. Tome I, M. Verwilghen, S. Mahieu (Eds.), Bruxelles: 2003, 373-467.
- Caravaca, Alfonso-Luis C. dhe Gonzalez, Javier C. *Derecho interbazonal Privado, Vol. II*. Décimo secunda edicion. Granada: Comares Ed., 2011.
- Caravaglios, Raffaele. “La comunione legale. Tommo II.” në *Il diritto private oggi*, P. Cendon (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 1995.
- Cardillo, Franco S. “Rapporti patrimoniali tra coniugi nel nuovo diritto internazionale privato e riflessi sull’attivita notarile.” në *Rivista del Notariato, Rassegna di diritto e pratica notarile*, Vol. L-1996, Milano: Giuffré Editore, 1996, 179-210.
- Cardillo, Franco S. *La forma dell’accordo di scelta della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi (art.30 legge 218/1995)*. Consiglio Nazionale del notariato, Studio 05.09.46/EU, Approvato dalla Commissione Affari Europei e Internazionali il 10 settembre 2005. <http://www.notariato.it/it/primo-piano/studi-materiali>. (konsultuar në 04.03.2013).
- Cardillo, Franco S. *Regime patrimoniale tra coniugi nel diritto internazionale private italiano, Sintesi della normative dei principali paesi europei*. Collana studi nr.12 del consiglio nazionale del notariato. Milano: Giuffré Editore, 1998.
- Carella, Gabriella. “La convenzione europea dei diritti dell’uomo e il diritto internazionale private.” në *I diritti umani e la giurisprudenza delle corti. Dottrina, giurisprudenza e documentazione*, G. Carella (Ed.), Torino: Giappichelli Editore, 2009.
- Carella, Gabriella. *Autonomia della volonta e scelta di legge nel diritto internazionale private*. Bari: Cacucci Editore, 1999.
- Carleo, Liliana R. “Cause di scioglimento della comunione.” në *La comunione legale*, Tomo II, B. Massimo (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 1989, 863-918.
- Carlier, Jean-Yves. *Autonomie de la volonte et statut personnel*. Travaux de la Faculte de droit de l’Universite Catholique de Louvain. Bruylant, Bruxelles: 1992.
- Carnevali, Ugo. “Le convenzioni matrimoniali.” në *Il regime patrimoniale della famiglia* në *Il diritto di famiglia*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, 15-48.
- Carol, Crowdy. *Family law in a nutshell*. Second edition. London: Sweet and Maxwell, 1992.
- Carpino, Brunetto. “Effetti dello scioglimento.” në *La comunione legale*. Tomo II, M. Bianca, Milano: Giuffré Editore, 1989, 939-988.
- Carrascosa Gonzales J. *Matrimonio y eleccion de ley. Estudio de derecho internacional privado*, Granada: Editorial Compares, 2000.

- Cassano, Giuseppe. “Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II, Il regime patrimoniale della famiglia.” në *Trattati*, P. Cendon, Milano: Giuffré Editore, 2006.
- Cattaneo, Giovanni. “Del regime di separazione dei beni.” në *Commentario alla riforma del diritto di famiglia*, Tomo I (Artt.1-89), L. Carraro, G. Oppo, A.Trabucchi, Padova: CEDAM, 1977, 462-488.
- Cerri, Francesca. *Gli accordi prematrimoniali*. Milano: Giuffré Editore, 2011.
- Cian, Giorgio. “Sulla pubblicità del regime patrimoniale della famiglia. Una revisione che si impone.” *Rivista di diritto civile I*, Padova: CEDAM, 1976, 32-65.
- Cianci, Alberto G. “Matrimonio, elementi di internazionalità ed ordine pubblico.” *Il diritto di famiglia e delle persone, Rivista Trimestrale*, V. Lojacono S. Cissarello (Ed.), Volumi XXXII-Gennaio-Marzo 2003, Milano: Giuffré Editore, 2003, 461-482.
- Cipriani, Nicola. “Rapporti patrimoniali tra coniugi, norme di conflitto e variabilità della legge applicabile.” në *Studi in onore di Giovanni Giacobbe I, Teoria generale, Persone e famiglia*, G. Della Torre, Milano: Giuffré Editore, 2010, 517-552.
- Cizskovska, Vera. *Il regime patrimoniale tra coniugi nel diritto socialista (studio di diritto comparato)*. Traduzioni della scuola di perfezionamento in diritto civile dell'Università di Camerino, Jovente Editore: 1977.
- Colomer, André. “The modern French law.” në *Comparative Law of matrimonial property. A symposium at the International Faculty of Comparative Law at Luxembourg on the laws of Belgium, England, France, Germany, Italy and The Netherlands*, A. Kiralfy (Ed.), Leiden: A.W. SIJTHOFF, 1972, 80-109.
- Colomer, André. *Droit civil, Régimes Matrimoniaux*. dixième édition. Paris: Litec, 2000.
- Comparative law of matrimonial property, A. Kiralfy (Ed.), Leiden: A.W. Sijthoff, 1972.
- Confrontini, Massimo. “La comunione convenzionale tra coniugi.” në *Il diritto di famiglia, Il regime patrimoniale della famiglia II*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, 285-316.
- Cornu, Gérard. *Le régimes matrimoniaux*. Paris: Presses Univ. de France, 1974.
- Corsi, Francesco. “Le convenzioni matrimoniali, famiglia e impersa, II.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Milano: Giuffré Editore, 1984.
- Couchez, Gérard. *Essai de délimitation du domaine de la loi applicable au régime matrimonial*. Volume XII. Paris: Librairie Dalloz, 1972.
- Cubeddu, Maria G. “Autonomia privata e regimi patrimoniali.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.) në *Trattati di diritto private*, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, 1-26.
- Cubeddu, Maria G. “Le convenzioni matrimoniali.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.) në *Trattati di diritto private*, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, 27-72.
- De Montis, Alessandra. “Divisione dei beni della comunione.” në *La comunione legale II*, M. Bianca, Milano: Giuffré Editore, 1989, 989-1000.
- De Nova, Giorgio. “Disciplina inderogabile dei rapporti patrimoniali e autonomia negoziale.” në *Studi in onore di Pietro Rescigno I*, Persone, famiglia, successioni e proprietà, Milano: Giuffré Editore, 1998, 259-263.
- De Paola, Vincenzo. dhe Macri, Antonio. *Il nuovo regime patrimoniale della famiglia*. Milano: Giuffré Editore, 1978.

- De Paola, Vincenzo. *Il diritto patrimoniale della famiglia nel sistema del diritto privato. I*. Milano: Giuffrè Editore, 2002.
- De Paola, Vincenzo. *Il regime patrimoniale della famiglia II*. Milano: Giuffrè Editore, 1995.
- De Rubertis, Giovanni. "Il nuovo regime patrimoniale della famiglia e la trascrizione immobiliare." *Vita Notarile*, I, Nr. 28, Palermo: Butitta Edizioni Giuridice, 1976, 5-38.
- De Rubertis, Giovanni. "Le Convenzioni matrimoniali in generale." *Vita Notarile*, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo: Buttitta Edizioni Giuridice, 1975.
- Deby-Gerard, France. *Le rôle de la règle de conflit dans le règlement des rapports internationaux*. Dalloz: Paris, 1973.
- Delestraint, Pierre D. *Contrat de mariage et régimes matrimoniaux, successions, libéralités*, Dixième édition. Paris: Dalloz, 1988.
- Depinguente, Romana P. "Autonomia dei coniugi e mutamento del regime patrimoniale legale." *Rivista del diritto civile II*, Padova: CEDAM, 1980, 518-539.
- Dethloff, Nina. "Contracting family law: A European perspective." në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe (Eds.), Cambridge: Intersentia, 2011, 65-94.
- Diago D., Maria del Pilar. *Pactos o capitulaciones matrimoniales en Derecho Internacional Privado*. Zaragoza: El Justicia de Aragon Colección, 1999.
- Dogliotti Massimo. "Rapporti patrimoniali tra coniugi: Lo scoglimento della comunione legale e convenzionale." në *Studi in onore di Pietro Schlesinger I*, Milano: Giuffrè Editore, 2004, 469-485.
- Donatuti, Guido. "Separazione." në *Enciclopedia Italiana*, 1936. Marrë në <http://www.treccani.it>.
- Donisi, Carmine. *Giurisprudenza e diritto civile-raccolta sistematica di questi e decisioni-persone fisiche ed enti, famiglie e filiazione, negozio giuridico, contratti in genere*. Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane, 1997.
- Droz, George A.L dhe Martin-Bosly, Bernadette. "Traité multilatéraux relatifs aux régimes matrimoniaux, successions et libéralités." në *Régimes matrimoniaux, successions et libéralités dans les relations internationales et internes I*, M. Verwilghen, S. Mahieu (Ed.) Bruylant, Bruxelles, 2003, 191-372.
- Dutoit, Bernard. *Droit International privé Suisse, Commentaire de la loi fédérale du 18 décembre 1987, 4 éd. revue et argumente*, Bale: Helbing & Lichtenhahn, 2005.
- Dutta, Anatol. "Marital agreements and private autonomy in Germany." në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, 158-199.
- Elezi, Ismet. "Marrëdhëniet familjare e martesore sipas së drejtës zakonore në Labëri." *Revista Drejtësia*, Nr. 2/1993 (Tetor-Dhjetor), Tiranë: 1994.
- Emiliozzi, Enrico-Antonio. *Autonomia contrattuale e invalidità del matrimonio*. Pubblicazione della Facoltà di Giurisprudenza, Università di Macerata. Milano: Giuffrè Editore, 2001.
- Epstein, Louis M. *The Jewish marriage contract. A study in the status of woman in Jewish law*, Clark, New Jersey: The Lawbook Exchange Ltd., 2004.
- *European family Law in action. Volume IV. Property relations between spouses*, K. Boele-Woelki, B. Braat (Eds.), Oxford: Intersentia, 2009.
- Fadlallah, Ibrahim. *La famille légitime en droit international privé (Le domaine de la loi applicable aux effets du mariage)*. Paris: Dalloz, 1977.

- Falcone, Ennio. “Scoglimento parziale della comunione legale fra coniugi, estromissione di un singolo bene e rapporto con la pubblicità legale.” në *Rivista del notariato*, 1987, Milano: Giuffré Editore, 1987, 694-703.
- Falzea, Angelo. “Il dovere di contribuzione nel regime patrimoniale della famiglia.” në *Rivista di diritto Civile I*, Padova: CEDAM, 1997.
- *Family law. Jurisdictional comparison.* James Stewart Manches (Ed.) Second edition, London: Thomson Reuters, 2013.
- Fauvarque-Cosson, Bénédicte. *Libre disponibilité des droits et conflicts de lois, Bibliothèque de droit privé.* Paris: L.G.D.J. Ed., 1996.
- Feola Dominique. “La pubblicità del regime patrimoniale dei coniugi.” në *Il diritto di famiglia. Il regime patrimoniale della famiglia II*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, 411-436.
- Ferrando, Gilda. “La crisi delle unioni di fatto.” në *Separazione e divorzio II*, G. Ferrando (Ed.), Torino: UTET, 2003.
- Ferrari, Sussane. “Marital agreements and private autonomy in Austria.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, 51-67
- Ferrer-Riba, Josep. “Marital agreements and private autonomy in Spain.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe, Oxford: Hart Publishing, 2012, 350-369.
- Ferri, Luigi. “La pubblicità del regime patrimoniale della famiglia.” në *Il regime patrimoniale della famiglia a dieci anni dalla riforma – Convengo di studi organizzato dal Comitato Regionale dei Consigli Notarili dell’ Emiglia-Romagna në bashkëpunim me l’Universita degli Studi di Bologna (Bologna 10-11 Maggio 1895)*, Milano: Giuffré Editore, 1988, 41-46.
- Finocchiaro, Alfio. dhe Finocchiaro Mario. *Diritto di famiglia, Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151.* Volume I, Milano: Giuffré Editore, 1984.
- Flour, Jacques dhe Champenois, Gérard. *Le régimes matrimoniaux.* Paris: Armand Colin Ed., 1995.
- Franzoni, Massimo. “Le convenzioni patrimoniali tra conviventi more uxorio.” në *Il diritto di famiglia. Il regime patrimoniale della famiglia II*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, 461-490.
- Furgiule, Giovanni. *Liberta e famiglia.* Giuffré Editore: Milano, 1979.
- Fusaro, Andrea, “Sistemi di comunione dei beni e sistemi a separazione.” *Rivista di diritto Civile*, W. Bigiavi, A. Trabucchi, Nr.2, 2001, Padova: CEDAM, 99- 104.
- Fusaro, Andrea. “Il regime patrimoniale della famiglia.” në *I grandi orientamenti della giurisprudenza civile e commerciale*, F. Galgano (Ed.), Padova: CEDAM, 1990.
- Gabrieli, Enrico. *I contratti in generale.* Torino: UTET, 2006.
- Gabrielli, Giovanni. Dhe Cubeddu, Maria G. *Il regime patrimoniale dei coniugi.* Milano: Giuffré Editore, 1997.
- Galasso, Alfredo. dhe Tamburello, Mimma. “Del regime patrimoniale della famiglia I.” në *Commentario del c.c. Scialoja-Branca*, Bologna: Zanichelli Editore, 1999.
- Galgano, Francesco. *E drejta Private.* Botim i tretë. Tiranë: Luarasi University Press, 2006.
- Galgano, Francesco. *Il contratto.* Seconda edizione. Milano: Cedam, 2011.
- Galletta, Franca. “La comunione convenzionale.” në *La comunione legale*, M. Bianca, Milano: Giuffré Editore, 1989, 1033-1070.

- Garofalo, Luciano. *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*. Seconda Ed. Torino: Giappichelli Ed., 1997.
- Garrison, Marsha. "Cohabitation obligations: Contract versus status." në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpen (Eds.), Cambridge: Intersentia, 2011, 115-140.
- Gennari, Giuseppe. "Lo scioglimento della comunione." në *Regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta, në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 2012, 461-518.
- Giunchi, Paolo. "Brevi note sulla, autonomia private dei coniugi nei rapporti familiari." në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Arceri, M. Bernardini (Eds.): Maggioli Ed., 2009, 35-66.
- Glendon, Mary Ann. "Introduction: Family law in a time of turbulence." në *International Encyclopedia of Comparative Law*, Vol. IV, A. Chloros, M. Rheinstein, M.A. Glendon (Eds.), Tübingen: Mohr Siebeck, 2007.
- Gonzales Beilfluss, Cristina. "The proposal for a council regulation on the property consequences of registered partnerships." në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 183-198.
- Gonzáles, Beilfluss. "The unification of private international law in Europe: A success story?." në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe, Cambridge: Intersentia, 2011, 329-340.
- Goré, Marie. "La détermination du régime matrimonial." në *Droit Patrimonial de la Famille*, M. Grimaldi (Ed.), Paris: Dalloz, 1998.
- Green Paper on less bureaucracy for citizens: promoting free movements of public documents and recognition of the effects of civil records, COM (2010) 747 final.
- Guerinoni, Ezio. "I regimi patrimoniali convenzionali. La comunione convenzionale." në *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II. Il regime patrimoniale della famiglia*, G. Cassano (Ed.) në *Trattati* P. Cendon (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 2006.
- Guernioni, Enzo. dhe Ganzarolli, Emiliano. "Il regime di separazione dei beni", në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Fusaro (Ed.), Padova: Padova, 1990.
- Gugu, Aida. dhe Qarri, Eniana. "Private international law in family matters.", në *11th Regional International Scientific Private International Law Conference "Private International Law in the Jurisprudence of the European Courts-Family at Focus"*, Osijek (Croatia), 11-12 Qershor 2014.
- Guido, Tedeschi. "I rapporti patrimoniali dei coniugi." në *Il Matrimonio*, A.C. Jemolo, në *Trattato di Diritto Civile Italiano*, F. Vassalli (Ed.), Torino: UTET.
- Hall, Clifford. "Cruse vs. Chittum: Habitual residence judicially explored." në *International and Comparative Law Quarterly*, Cambridge Journals, Vol. 24, January 1975, 1-30.
- Hamilton, Carolyn. dhe Perry, Alison. *Family Law in Europe*. Second Ed. Edinburgh: Butterworths Lexis Nexis, 2002.
- Herzfelder, François. *Problèmes relatifs au régime matrimonial en droit international privé français et allemand*. Paris: Librairies Technique, Librairie de la Cour de Cassation.
- Ieva, Marco. "Le convenzioni matrimoniali." në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta (Eds.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 2012, 55-112.

- Ikonomi, Luljeta. *E drejta migratore. Manula trajnues*. Tiranë: Organizata ndërkombëtare për migracionin në Shqipëri, 2009.
- *International Encyclopedia of Comparative Law*. Volume IV. Persons and family, A. Chloros, M. Rheinstein, M.A. Glendon, Tubingen: Mhor Siebeck, 2007.
- International Pree-Nuptial and Post-Nuptial agreements. D. Salter, Ch. Cardew-Butruille, S. Grant (Eds.), *International Pre-Nuptial and Post-Nuptial Agreements*, Bristol: Jordan Publishing Ltd., 2011.
- *Islamic marriage contract: case studies in Islamic Family Law*, A. Quraishi, F.E. Vogel (Eds.), Havard Series: 2009.
- Jacquet, Jean-Michel. *Principe a'autonomie et contrants internationaux*. Paris: Economica Ed., 1983.
- Jänträ-Jareborg, Maarit. "Marital agreements and private autonomy in Sweden." Në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, 370-402.
- Jayme, Eric. "Party autonomy in international family and succession law: new tendencies." në *Yearbook of Private international law*, Vol. XI-2009, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2009, 1-10.
- Kalia, Ardian. *E drejta ndërkombëtare private*. Tiranë: Sejko: 2007.
- Kinsch, Patrick. "Private international law topics before the European court of human rights. Selected judgments and decisions (2010-2011)." në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 37-50
- Konomi (Perolla), Rezarta. *Rendi etnojuridik në Shqipëri: Nga statutet, tek kanunet*. Studim monografik. Tiranë: 2013.
- Kostić-Mandić, Maja. *New concepts in Montenegrin Private International Law*. GIZ.
- Kuçi Hajredin. dhe Bilalli, Asllan. *Kolizioni i ligjeve. Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve*. Prishtinë: Botim i Universitetit Mbretëror Iliria, 2007.
- Laurini, Giancarlo. "L'esclusione parziale dalla comunione legale." *Revista del Notariato*, Milano: Giuffrè Editore, 1985, 1069-1078.
- Légier, Gérard. *E drejta Civile. Detyrimet*. botim i 19-të. Tiranë: Papyrus, 2008.
- *Les régimes matrimoniaux en droit compare et en droit international privé*, A. Bonomi, M. Steiner (Eds.), Genève: Librairie Droz, 2006.
- Libri i Gjellbër (Green Paper) Mbi konfliktin e ligjit në fushën e regjimit pauro martesor, COM (2006) 400, 17 Qershor 2006.
- Lo Sardo, Giuseppe. "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." në *Rivista del Notariato*, Milano: Giuffrè Editore, 1991, 1211-1391.
- Lopez, Antonio M. Escudero, Mercedes M. Garcia, M.Luisa T. Gonzales, Javier C. *Derecho internacional privado espanol II*. Partes especial. 7 ed., Granada: 1991.
- Luarasi, Aleks. *Studime për të drejtën zakonore shqiptare. Marrëdhëniet familjare*. Tiranë: Luarasi University Press, 2001.
- Macri, Antonio. "Scoglimento della comunione legale e suoi effetti." në *Il regime patrimoniale della famiglia a dieci anni dalla riforma – Convengo di studi organizzato dal Comitato Regionale dei Consigli Notarili dell' Emiglia-Romagna in collaborazione con l'Universita degli Studi di Bologna (Bologna 10-11 Maggio 1895)*, Milano: Giuffrè Editore, 1988, 48-96.

- Malatino, Giuseppe A. “La separazione dei beni nel nuovo diritto di famiglia.” në *Rivista Il diritto della famiglia e delle persone, diretto*, V. Lojacono (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 1981, 889-912.
- Malaurie, Philippe. dhe Aynès, Laurent. *Les régimes matrimoniaux*. 3 edition. Paris: Lextenso Ed., 2010.
- Mandro-Balili, A. Meçaj, V. Zaka, T. dhe Fullani, A. *E drejta familjare*. Botim i parë, Tiranë, Kristalina KH, 2006.
- Mandro-Balili, Arta. “Vlefshmëria e martesës dhe përcaktimi i ligjit që duhet zbatuar në pavlefshmërinë e martesës me elementë të huaj.” *Revista Studime Juridike*, Nr.1/2005, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Qershor 2005, 168-191.
- Mandro-Balili, Arta. *E drejta familjare. Familja, martesë, bashkëshortët*. Botim i parë. Tiranë: Emal, 2009.
- Marinai, Simone. “Matrimonial matters and the harmonization of conflicts of law: A way to reduce the role of the public policy as a ground for non-recognition judgments.” në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 255-272.
- *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*. J. Scherpe. Oxford: Hart Publishing, 2012.
- Marmocchi, Enrico. “Modifica delle convenzioni matrimoniali.” *Rivista del Notariato*, Milano: Giuffrè Editore, 1981, 354-383.
- Martiny, Dieter. “Objectives and values of (private) international law in family law.” në *International family law for the European Union*, J. Meeusen, M. Pertegas, G. Straetmans, F. Swennen, Oxford: Intersentia, 2007, 69-100.
- Mascia, Katia. “La comunione convenzionale.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, di A. Arceri, M. Bernardini, Maggiolino Ed., 2009, 277-312.
- Mascia, Katia. “La comunione legale, inquadramento storico e fondamento.” në *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II. Il regime patrimoniale della famiglia*, G. Cassano (Ed.), në *Trattati*, P. Cendon (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2006.
- Masméjan, Denis. *La localisation des personnes physiques en droit international privé, Etude comparée de notions de domicile, de résidence habituelle et d'établissement, en droit suisse, français, allemand, anglais, américain et dans les Conventions de La Haye.*, Genève: Librairie Droz, 1994.
- Mayer, Pierre. dhe Heuzé, Vincent. *Droit International privé*. 10 édition. Paris: Montchrestien Lextenso ed., 2010.
- Miles, Jo. Scherpe, Jens M. “The future of family property in Europe.” në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe, Cambridge: Intersentia, 2011, 423-433.
- Minervini, Enrico. “Divisione contrattuale ed atti equiparati.” në *Quaderni della Rassegna di diritto civile*, P. Perlingieri (Ed.), Napoli: Ed. Scientifiche It., 1990.
- Monforte, Guido. “La comunione convenzionale.” në *Il diritto di famiglia e delle persone*, Milano: Giuffrè Editore, 1976, 1773-1783.
- Montecchiari, Tiziana. “In tema di forma e contenuto delle convenzioni matrimoniali modificative.” në *Il diritto di famiglia e delle persone*, Milano: Giuffrè Editore, 1997, 1328-1343.
- Mora, Andrea. *Il contratto di divisione*. Milano: Giuffrè Editore, 1995.
- Morvidi, Leto. *Il patrimonio familiare*. Udine: Istituto delle edizioni accademiche, 1941.

- Moscarini, Lucio V. “Convenzioni.” në *La comunione legale II*, M. Bianca (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 1989, 1003-1032.
- Mosconi, Franco. *Diritto Internazionale private e processuale. Parte generale e contratti*. Torino: UTET, 1996.
- Mossini, Lanfranco. *Quattro studi di diritto di famiglia*. Università degli studi di Parma. Padova: Pubblicazioni della Facoltà di Giurisprudenza, CEDAM, 1989.
- Murat, Pierre. *Droit de la famille*. Cinquième Ed. Paris: Dalloz, 2010.
- Navarretta, Emanuela. dhe Orestano, Andrea. “Dei contratti in generale.” në *Commentario del codice civile*, E. Gabrielli (Ed.), Milano: UTET Giuridica, 2011.
- Navarrini, Gianluca. “Contributo allo studio dell’azione di separazione giudiziale dei beni tra i coniugi.” në *Studi in onore di Giovanni Giacobbe. Tomo I. Teoria generale, Persona e Famiglia*, G. della Torre (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 2010, 620-674.
- Nuni, A. Mustafaj, I. dhe Vokshi, A. *E drejta e detyrimeve*. Pjesa I. Tiranë: 2008.
- Nuni, Ardian. “Padia Pauliane – Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit (Neni 607 i Kodit Civil).” *Revista Studime Juridike*, Nr. 1/2002, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë: Tetor 2002, 55-62.
- Nuni, Ardian. *Hyrje në të drejtën civile*. Tiranë: Botimet Morava, 2006.
- Oberto, Giacomo. “Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219.” në *Il Codice Civile. Commentario fondato da Schlesinger, P., D. Busnelli* (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 2005.
- Oberto, Giacomo. “La comunione coniugale nei suoi profile di diritto comparato, internazionale ed europeo.” në *Il diritto di famiglia e delle persone. Rivista Trimestrale*, V. Lojacono, S. Ciccarello (Ed.), Volumi XXXVII-Gennaio-Marzo 2008, Milano: Giuffré Editore, 2008, 367-400.
- Oberto, Giacomo. *I contratti della crisi coniugale I. Ammissibilità e fattispecie*. Milano: Giuffré Editore, 1999.
- Omari, Sonila. *E drejta familjare*. Botim i parë. Tiranë: Botimet Morava, 2010.
- Omari, Sonila. *E drejtë familjare*. Botim i dytë. Tiranë, 2008.
- Oppo, Giorgio. “Autonomia negoziale e regolamento tipico nei rapporti patrimoniali tra coniugi.” *Rivista di Diritto Civile*, Padova: Cedam, 1997, 19-24.
- Paladini, Mauro. “La comunione convenzionale.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.), në *Trattati di diritto private*, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, 685-696.
- Paladini, Mauro. “Lo scioglimento della comunione legale e la divisione dei beni.” në *I rapporti patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.), në *Trattati di diritto private*, M. Bessone, Torino: Giappichelli Ed., 2000, 597-684.
- Parente, Ferdinando. “I rapporti patrimoniali tra i coniugi e il regime normativo del accordo di scelta della legge applicabile.” në *Rassegna di diritto civile*, P. Perlingeri, Volumi 2007/2, Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane, 2007, 663-694.
- Patocchi, Paolo M. “Règles de rattachement localisatrices et règles de rattachement substantiel.” në *Etudes suisses de droit international privé*, Volume 42, Genève: Librairie de l’Université Georg & CIE s.a., 1985, 100-138.
- Patti, Salvatore dhe Cubeddu, Maria G. *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*. Milano: Giuffré Editore, 2008.
- Patti, Salvatore. “Regime patrimoniale della famiglia e autonomia privata.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta Michele (Eds.), në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti, Milano: Giuffré Editore, 2012, 3-28.

- Patti, Salvatore. dhe Cubeddu, Maria G. *Diritto della famiglia*. Milano: Giuffrè Editore, 2011.
- Péroz, Hélèn. dhe Fongaro, Enric. *Droit intenational privé patrimonial de la famille*. Collection de l'Institut National de Formation Notarile. Paris: Litec, 2010.
- Picone, Paolo. “Diritto internazionale private comunitario e pluralita dei metodi di coordinameno tra ordinamenti.” në *Diritto internazionale private e comunitario*, P. Picone (Ed.), Milano: Cedam, 2004, 33-64.
- Picone, Paolo. *La riforma italiana del diritto internazionale private*. Milano: Cedam, 1998.
- Pinheiro, Luis de Lima. *Direito Internacional Privado, Parte Especial (direito de conflictos)*. Coimbra: Almedina, 1999.
- Pintens, Walter. “Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, 68-88.
- Pintens, Walter. “Matrimonial property law in Europe.” në *The future of family Law in Europe*, K. Boele-Woelki, J. Miles, J.M. Scherpe, Cambridge: Intersentia, 2011, 19-46.
- Pittalis, Margherita. “Modifiche convenzionali alla comunione dei beni.” në *Il regime patrimoniale della famiglia. Vol. III*, F. Anelli, M. Sesta (Ed.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti (Ed.), Milano: Giuffrè Editore, 2012, 519-556.
- Podvorica, Hamdi. *E drejta familjare*. Prishtinë: 2005.
- Polidori, Stefano. dhe De Cicco, Maria C. “Il regime primario della famiglia.” në *La famiglia, Matrimonio-Regime primario I* në *Il diritto private nella giurisprudenza*, P. Cendon (Ed.), Torino: UTET, 2002, 269-486.
- *Premarital agreements. West's Encyclopedia of American Law*. 2 Edition. Volume 8 Thomson Gale, 65-67.
- Procesverbali i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, mbajtur më datë 04.04.2011, për miratimin e projektligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private”.
- Quadri, Enrico. “Profili attuali del dovere di contribuzione.” në *Studi in onore di Bianca, Cesare M. II*. Milano: Giuffrè Editore, 2006, 397.
- Ragazzini, Luigi. *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*. Rimini: Maggioli Editore, 1987.
- Raggi, Silvia. “La separazione dei beni.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Arceri, M. Bernardini, Rimini: Maggioli Editore, 2009, 67-164.
- Raison, André. *Les donations entre époux. Seconde éd.* Paris: Librairie du Journal des notaires et des avocats, 1990.
- René, Savatier. *La séparation de biens en droit français*. Paris: Dalloz, 1973.
- *Répertoire de droit international II. Nga Factoring deri në Zone contiguë*. Ph. Francescakis (Ed.), Paris: Jurisprudence Générale Dalloz, 1969.
- Resigno, Pietro. “Il diritto di famiglia a un ventennio dalla riforma.” në *Rivista di diritto Civile*, Nr.1, Padova: CEDAM, 1998, 109-117.
- Rheinstein, Max. dhe Glendon, Mary A. “Intersposual Relations.” në *International Encyclopedia of Comparative Law*, Vol. IV, A. Chloros, M. Rheinstein, Glendon M. A. (Eds.), Tubingen: Mhor Siebeck, 2007.
- Rigaux, François. dhe Fallon, Marc. *Droit international privé*. Troisième éd. Bruxelles: Larcier éd., 2005.

- Rodota, S. “Le droit italien.” në *Comparative Law of matrimonial property. A symposium at the International Faculty of Comparative Law at Luxembourg on the laws of Belgium, England, France, Germany, Italy and The Netherlands*, A. Kiralfy, Leiden: A.W. SIJTHOFF, 1972, 223-256.
- Roppo, Vincenzo. *Il Contratto*. Seconda Edizione. Milano: Giuffré Editore, 2001.
- Roy, Alain. “Le changement de qualification d’un bien en cours de régime matrimonial est-il permis?” në *La Revue du Notariat*, Vol. 102, Montréal: Mars 2000, 151-157.
- Ruggiero, Domenico G. *Gli accordi prematrimoniali*. Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane, 2005.
- Russo, Ennio. “L’autonomia privata nella stipulazione di convenzioni matrimoniali.” në *Rivista Notarile*, Nr.34, Maggio-Aprile 1982/2, Palermo: Edizioni Giuridice Buttitta, 1982.
- Russo, Ennio. “L’oggetto della comunione legale, Art. 177-179.” në *Il codice Civile. Commentario diretto da Schlesinger*, Milano: Giuffré Editore, 1999.
- Russo, Ennio. *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*. Milano: Giuffré Editore, 1983.
- Saliko, Hysen. *Regjimet pasurore martesore*. Disertacion. Tiranë: 2008.
- Salomone, Luigi M. “Lo sicoglimento della comunione legale dei conuigi.” në *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II. Il regime patrimoniale della famiglia*, G. Cassano (Ed.) në *Trattati* P. Cendon (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 2006.
- Santosuosso, Fernando. “Il divorzio.” në *Trattato di diritto privato*, P. Rescigno (Ed.), Torino: UTET, 2009.
- Scannicchio, Nicola. *Beni, soggetti e famiglia nel regime patrimoniale e primario. Un’analisi comparata*. Bari: Cacucci Editore, 1992.
- Scannicchio, Nicola. *Beni, Soggetti e famiglia nel regime patrimoniale e primario, Un’analisi comparata (comunione e contribuzione in Italia, Francia, Inghilterra)*. Bari: Cacucci Editore, 1992.
- Scherpe, Jens M. “Introduction.” në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe, Oxford: Hart Publishing, 2012, 1-7
- Scherpe, Jens M. “Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective.” në *Marital agreements and private autonomy in a comparative perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, fq. 443-518.
- Schlesinger, Piero. “Divisione dei beni della comunione. Art. 194.” në *Commentario alla riforma di diritto di famiglia I*, Padova: Cedam, 1977, 449.
- Semini-Tutulani, Marjana. *E drejta e detyrimeve dhe kontratave. Pjesa e posaçme*. Tiranë: Skanderbegbooks, 2006.
- Semini-Tutulani, Marjana. *E drejta e detyrimeve dhe kontratave. Pjesa e përgjithshme*. Tiranë: Skanderbegbooks, 2006.
- Sesta, Michele. dhe Valiagni B. “Il regime di separazione di beni.” në *Regime patrimoniale della famiglia*, F.Anelli, M. Sesta (Eds.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P.Zatti (Ed.). Milano: Giuffré Editore, 2012, 557-678.
- Smiroldo, Antonino. “Effeti dello scioglimento.” në *La comunione legale*, M. Bianca (Ed.), Milano: Giuffré Editore, 1989, 939-979.
- *Study in comparative law on the rules governing conflicts of jurisdiction and the laws on matrimonial property regimes and the implementation for property issues of the separation of unmarried couples in the Member States, ASSER-UCLC Consortium, COM (2006)400*. Marrë nga: <http://europa.eu.int>.

- Tardugno, Maria A. *Regimi patrimoniali e annullamento del matrimonio*. Napoli: E.G. Simone, 2003.
- Tatarano, Giovanni. dhe Capobianco, Ernesto. “Il regime della separazione dei beni tra coniugi.” në *Rassegna di diritto civile*, P. Perlingieri (Ed.), 1996, 526-571.
- Tedeschi, Guido. “Il regime patrimoniale della famiglia. Quinta edizione.” në *Tratatto di diritto civile*, Vol. III, Torino: UTET, 1963.
- Terré, François. dhe Simler, Philippe. *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*. Paris: Éd. Dalloz, 2008.
- Trabucchi, Alberto. *Istituzioni di diritto civile*. Quarantesima edizione. Padova: CEDAM, 2001.
- *The future of family Law in Europe*. K. Boele-Woelki, J. Miles, J. Scherpe (Eds.). Cambridge: Intersentia, 2011.
- *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law*. Vol. II, J. Basedow, K.J. Hopt, R. Zimmermann, A. Stier (Eds.), Oxford: University Press, 2012.
- Thomas, Geneviève. *Les interferences du droit des obligations et du droit matrimonial*. Grenoble: Presses Universitaires de Grenoble, 1974.
- Ubertazzi, Benedetta. “La capacita delle persone fisiche nel diritto internazionale privato.” në *Studi e pubblicazioni della rivista di diritto internazionale privato e processuale*, Vol. 66, Padova: CEDAM, 2006.
- Venditti, Amedeo. “La comunione legale tra coniugi. Lo scioglimento.” në *Il regime patrimoniale della famiglia II*, në *Il diritto di famiglia. Tratatto*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, 242-284.
- Vermelle, George. *E drejta Civile. Kontratat. Pjesa e posaçme*. Botim i pestë. Tiranë: Papyrus, 2008.
- Vettori, Giuseppe. “Il dovere coniugale di contribuzione.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, në *Il diritto di famiglia*, G. Bonilini, G. Cattaneo, Torino: UTET, 1997, 1-14.
- Viarengo, Ilaria. “Autonomia della volonta e rapport patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale private.” në *Studi e pubblicazioni della rivista di diritto internazionale private e procesuale*, nr.48, Padova: CEDAM, 1996.
- Viarengo, Ilaria. “Problemi di individuazione della legge applicabile ai rapporti patrimoniali tra coniugi e ruolo della volonta delle parti.” në *Rivista del Notariato. Rassegna di diritto e pratica notarile*, Vol. LIV- Luglio-Agosto, Milano: Giuffré Editore, 2000, 1127-1154.
- Viarengo, Ilaria. “The EU proposal on matrimonial property regimes, Some general remarks.” në *Yearbook of Private International Law*, Vol. XIII-2011, Lausanne: Swiss Institute of Comparative Law, 2011, 199-216.
- Watté, Nadine. *Le droit patrimonial des familles en droit international privé: perspectives du recent Code belg*, Montréal: Ed. Thémis, Université de Montréal, 2008.
- Wiederkehr, Georges. *Les conflicts de loi en matière de régime matrimonial*. Vol. VII. Paris: Dalloz, 1967.
- Zaccaria, Alessio. “La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina.” në *Rivista di diritto civile*, 1980, Vol. II, Padova: CEDAM, 1980, 416-450.
- Zaccaria, Alessio. “La separazione dei beni.” në *Il diritto di famiglia. Il regime patrimoniale della famiglia II*, G. Bonilini, G. Cattaneo, Torino: UTET, 1997, 317-342.
- Zaçe, Valentina. *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë: Dituria, 1999.

- Zaka, Tefta. “Kodi i ri i Familjes – Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” në *Jeta Juridike*, Nr. 2, Shkurt, Tiranë: Botim i Shkollës së Magjistraturës, 2004, 5-15.
- Zaka, Tefta. *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*. Disertacion. Tiranë: 1999.
- Zanobetti, Alessandra. “Il regime patrimoniale della famiglia nel diritto internazionale privato.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, Vol. III, F. Anelli, M. Sesta (Eds.), në *Trattato di diritto di famiglia*, P. Zatti, Milano: Giuffrè Editore, 2012, 29-54.
- Zavaglia, Susanna. “La comunione legale, lo scioglimento.” në *Il regime patrimoniale della famiglia*, A. Arceri, M. Bernardini, Rimini: Maggiolino Ed., 2009, 769-814.

II. Legjislacion

➤ Legjislacion i Republikës së Shqipërisë

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994.
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8166, datë 29.03.1996.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003.
- Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, i cili hyri në fuqi në 1 Prill të vitit 1929 (i njohur si Kodi Civil i Zogut).
- Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, ka hyrë në fuqi në 1 Janar të vitit 1982.
- Kodi i Familjes i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 4020, datë 23.06.1965, i cili hyri në fuqi në 1 Janar 1966.
- Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6599, datë 29.06.1982.
- Ligji “Mbi martesën”, nr. 601, datë 18.05.1948
- Dekreti “Mbi Pronësinë”, nr. 2083, datë 06.08.1955.
- Ligji, “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”, nr. 3920, datë 21.11.1964.
- Ligji “Për Noterinë”, nr.7829, datë 01.06.1994.
- Ligji “Për shtetësinë shqiptare”, nr. 8389, datë 05.08.1998.
- Ligji “Për gjendjen civile”, nr. 10 129, datë 11.05.2009.
- Ligji “Për të drejtën ndërkombëtare private”, nr. 10428, datë 02.06.2011.
- Vendim i Këshillit të Ministrave “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, nr. 134, datë 07.03.2003.
- Vendim i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formës, elementëve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, nr. 332, datë 17.03.2010.

➤ Akte ligjore të shteteve të huaja

- Kodi Civil Italian.
- Kodi Civil Francez.
- Kodi Francez i Procedurës Civile, neni 1292.
- Kodi Civil Gjerman (BGB).
- Ligji Italian mbi të drejtën ndërkombëtare private i vitit 1995, neni 30.

➤ Akte ligjore të organizatave ndërkombëtare dhe europiane

Këshilli i Europës

- Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950.
- (CM) Resolution (78)37 of 27 September 1978 on equality of spouses in civil law.
- (CM) Recommendation (81)15 of 16 October 1981 on the rights of spouses relating to the occupation of family home and the use of the household contents.
- (CM) Declaration of 16 November 1988 on equality of women and men.
- (CM) Recommendation (2007)17 of 21 November 2007 on gender equality standards and mechanisms.
- (CM) Declaration (2009) 68 of 6 May 2009 on making gender equality a reality.
- Recommendation of Council of Europe, No. R (81)15, of the Committee of Ministers to Member States on the rights of the spouses relating to the occupation of the family home and the use of the household contents.

Konferenca e Hagës

- Konventa e Hagës “Për ligjin e zbatueshëm mbi regjimet pasurore martesore”, 14 Mars, 1978.
- Konventa e Hagës “Për konfliktet e ligjit mbi pasojat e martesës, mbi të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në marrëdhëniet e tyre personale dhe mbi pasurinë e bashkëshortëve”, 17 Qershor 1905.
- Konventa e Hagës “Për ligjin e zbatueshëm mbi trustin dhe njohjen e tij”, 1 Qershor 1985.
- Konventa e Hagës “Për ligjin e zbatueshëm mbi trashëgiminë për shkak të vdekjes”, 1 Gusht, 1989.
- Konventa e Hagës “Për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja”, 5 Tetor 1963, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9060, datë 08.05.2003. Është e njohur si Konventa Apostile.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e OKB-së, viti 1948.
- Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grujave, OKB, viti 1979.
- Konventa Ndërkombëtare Mbi statusin e personave pa shtetësi, e 28 Shtatorit të vitit 1954, hyrë në fuqi në 6 Qershor të vitit 1960. Shqipëria ka aderuar në këtë konventë në 23 Qershor të vitit 2003.
- Konventa e OKB “Mbi reduktimin e pashtetësisë” e vitit 1961, fyre në fuqi në 1975 dhe aderuar nga Shqipëria në 9 Korrik të vitit 2003.
- Konventa e OKB “Mbi statusin e refugjatit” dhe Protokollin e saj shtesë (viti 1967), hyrë në fuqi në 22 Prill të vitit 1954, aderuar nga Shqipëria në 3 Qershor të vitit 1992, me dekretin nr.200.

Bashkimi Europian

- Traktati mbi funksionimin e Bashkimit Europian (TFUE).
- Council Regulation (EU) No 1347/2000 of 29 May 2000 “On jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and in matters of parental responsibility of children of both spouses”, e njohur si Rregullorja Brussels II.

- Council Regulation (EU) No 2201/2003 of 27 November 2003 “On jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and in matters of parental responsibility”, e njohur si Rregullorja Brussels II bis.
- Council Regulation (EU) No 1259/2010 of 20 December 2010 “On implementing enhanced cooperation in the area of the law applicable to divorce and legal separation”, e njohur si Roma III.
- Regulation (EC) No. 4/2009 of 18 December 2009 “On jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and cooperation in matters relating to maintenance obligations”.
- Regulation (EU) No. 650/2012 of 4 July 2012 “On jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and authentic instruments in matters of succession and the creation of a European Certificate of Succession”.
- Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions in matters of matrimonial property regimes, COM (2011) 126/2.
- Proposal for a Regulation on jurisdiction, applicable law and the recognition and enforcement of decisions regarding the property consequences of registered partnerships, COM (2011) 127/2.

III. Jurisprudencë

➤ Vendime të gjykatave shqiptare

- Vendim i Gjykatës së Diktimit, nr. 168, datë 07.09.1938.
- Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë, vitit 1973, fq. 302).
- Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 24, datë 13.03.2002.
- Vendimin Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 03.02.2006.
- Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009.
- Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009.
- Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 61, datë 09.02.2010.
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2712, datë 16.11.2011.
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 1298, datë 25.05.2012.
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2423, datë 16.10.2012.
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2712, datë 16.12.2012.
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 646, datë 20.12.2012.
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 1048, datë 30.04.2013.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 8526, datë 22.10.2009.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 4361 datë 25.05.2011.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 8090, datë 18.10.2011.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 6139, datë 14.02.2012.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3403, datë 10.04.2012.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3921, datë 20.04.2012.

➤ **Vendime të gjykatave të huaja**

Gjykata Italiane e Kasacionit - Corte Suprema di Cassazione

- Corte di Cassazione, Camera Civile 8/03/1971, nr. 475.
- Corte di Cassazione, Camera Civile 11/06/1981, nr. 3777
- Corte di Cassazione, Camera Civile 16/3/01982, nr. 759.
- Corte di Cassazione, Camera Civile 17/01/1984, nr. 245.
- Corte di Cassazione, Camera Civile Sez I, 27/11/1987, nr. 8824.
- Corte di Cassazione, Camera Civile 12/09/1997, nr. 9034.

Gjykata Franceze e Kasacionit - Court de Cassation

- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 12 Avril 1967.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 9 Mai 1967.
- Court de Cassation, Chambre Social 26 Octobre 1972.
- Court de Cassation, Chambre Civile 2e, 5 Janvier 1973.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 22 Octobre, 1974.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 27 Octobre, 1976.
- Court de Cassation, Chambre Civile, 1re, 21 Juin 1978.
- Court de Cassation, Chamber Civile 1re, 18 Fevrier, 1981.
- Court de Cassation, Chambre Civile 2e, Décembre 1982.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 13 Avril 1983.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 1 Juin 1983.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 16 Juillet 1985.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 22 Octobre 1985.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 20 Octobre 1987.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 7 Juin 1989.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, 9 Octobre, 1990.
- Court de Cassation, Chambre Civile 1re, Mars 1993.
- Court de Cassation, Chambre Civile 3e, 6 Mars 1996.

Gjykata e Lartë Angleze – UK Supreme Court

- Radmacher v. Garantino, 20 October 2010, (2010) UKSC.

Gjykata Kushtetuese Gjermane - Bundesverfassungsgericht

- BverfG, 06.02.2001 - 1BvR 12/92.
- BverfG, 29.03.2001 - 1BvR 1766/92.

Gjykata e Lartë e Spanjës - Tribunal Supremo

- Vendim i Gjykatës së Lartë Spanjolle dt. 31.03.2011 (RJ 2011/3137).

Gjykata Europiane e Drejtësisë – European Court of Justice (ECJ)

- C-143/78 Jacques de Cheval vs Louise de Cheval (17 March 1978).
- C-25/81 C.H.W vs C.H.W (31 March 1982).
- C-452/93 Pedro Magdalena Fernandez (15 September 1994).

IV. Web Faqe

- <http://www.europa.eu.int>
- <http://www.hcch.net>
- <http://www.ceflonline.net>
- <http://www.gjykataelartw.gov.al>
- <http://www.qpz.gov.al>
- <http://www.diritto.it>

Abstrakt

Punimi është realizuar në kuadër të reformimit të institutit të regjimit pasuror martesor dhe kontratës martesore, në Shqipëri, me miratimin e Kodit të Familjes së vitit 2003 si dhe në kuadër të disa juridiksioneve të tjera, të cilat kanë shërbyer si model referues për reformimin e legjislacionit shqiptar (Francë dhe Itali).

Punimi analizon probleme të tilla si: zbatimi i parimit të autonomisë së vullnetit në rregullimin e marrëdhënieve pasurore dhe limitet e ushtrimit të tij; zbatimi i normave të Kodit Civil mbi kontratën martesore; kushtet thelbësore të vlefshmërisë së kontratës martesore; regjimet pasurore me kontratë, si dhe zbatimi i parimit të autonomisë së vullnetit në zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm në rregullimin e regjimit pasuror martesor, në hipotezën e martesës me elementë të huaj.

Është e pamohueshme që, parimi i autonomisë së vullnetit është njohur edhe në fushën e regjimit pasuror martesor, fushë e cila, tradicionalisht ka qenë e përjashtuar nga vullneti i palëve. Nëse, nga njëra anë, ligjvënësi ka zgjeruar autonominë e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e regjimit pasuror martesor, nga ana tjetër është treguar i kujdesshëm në ruajtjen e një minimumi solidariteti pasuror ndërmjet anëtarëve të familjes, nëpërmjet parashikimit të “regjimit primar”, i cili është i pashmangshëm me marrëveshje të palëve.

Gjithashtu, në punim janë marrë në analizë normat e së drejtës ndërkombëtare private, në kuadër të martesës me elementë të huaj. Ligji i ri “Për të Drejtën Nderkombëtare Private”, në ndryshim nga ligji i mëparshëm, parashikon për herë të parë të drejtën e bashkëshortëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm mbi regjimin pasuror martesor, nëpërmjet një marrëveshje.

Në fund të punimit, jepet një prezantim mbi të gjitha gjetjet dhe përfundimet e arritura gjatë analizës së problemeve të mësipërme, si dhe jepen disa rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të Kodit të Familjes, të cilat, shpresojmë t'i vijjnë në ndihmë jo vetëm studiuesve të së drejtës, por edhe ligjvënësit në procesin e reformimit të ligjit, gjyqtarëve, studentëve dhe cilido, që dëshiron të marrë informacione mbi këtë fushë studimi.

Fjalë kyçe: *autonomia e vullnetit, martesë, regjimi pasuror martesor, kontrata martesore, bashkësia me kontratë, regjimi i pasurive të ndara, normat e konfliktit, marrëveshja për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm.*

Abstract

One of the most important novelties that the new Family Code of 2003 has brought is the possibility of the spouses to regulate their matrimonial property regime through the marriage contract.

Based on the regulation of marriage in the Albanian Family Code provisions, it is undeniable that the principle of party autonomy is well known in the context of matrimonial relationships, especially matrimonial property regime, relations which in the past have traditionally been excluded from the scope of party autonomy. However, because of the family social importance and in order to balance spouses' private interests with the public interest, the spouses' party autonomy, in the regulation of the matrimonial property regime is limited in comparison with that of other contractual relationships, through non-derogable legal norms.

On the one hand, the legislator has expanded the scope of application of the principle of spouses autonomy in the current Family Code, in the field of matrimonial property relations and on the other hand, it has been cautious in maintaining the solidarity among family members, through the regulation of the family primary regime (spouses material contribution for the family needs, the family dwelling protection), which is compulsory for the spouses, despite their property regime and it is unavoidable through any agreement.

The focus of this study is to analyze the contractual property regimes provided in the Family Code, such as the contractual community property regime and the separation property regime, with the focus in the socio-economic advantages and disadvantages of each regime.

Unlike the old PIL Act, the new PIL Act introduces for the first time, the principle of the party autonomy in the marital property regime. It provides for the right of the spouses to determine through agreement, the applicable law of the marital property regime.

At the end of the study, you can find a presentation on all findings and conclusions reached during the analysis of the above problems, and some recommendations for the improvement of the Family Code articles, which, we hope can be useful not only for the researchers, but also for the lawmakers in the process of reforming the Family Code, for the judges, students and anyone who wants to get some information about this field of study.

Key words: *party autonomy, marriage, matrimonial property regime, marriage contract, community regime, separation property regime, conflict norms, pactum de lege utenda.*